FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 12

Tiranë – E martë, 31 janar 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 25.1.2017	Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020....	319

VENDIM
Nr. 42, datë 25.1.2017

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2017–2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Integrimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020 (PKIE 2017–2020), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Integrimit Evropian orienton, bashkërendon dhe monitoron zbatimin e PKIE 2017–2020 nëpërmjet grupeve ndërinstitucionale të punës (GNP) për çdo kapitull, të ngritura me urdhrin nr. 107, datë 28.2.2014, të Kryeministrit, "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian".

3. Ministria e Integrimit Evropian raporton çdo tre muaj në Këshillin e Ministrave për ecurinë e zbatimit të PKIE 2017–2020.

4. Ministritë dhe institucionet e tjera koordinuese të grupeve ndërinstitucionale të punës (GNP) raportojnë pranë Ministrisë së Integrimit Europian çdo tre muaj (java e tretë e muajit të fundit) për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga PKIE 2017–2020.

5. Ngarkohet Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimit Evropian, të monitorojë përfshirjen në programin buxhetor afatmesëm, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara në PKIE 2017–2020.

6. Varianti i përkthyer në gjuhën angleze i PKIE 2017–2020 i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Vendimi nr. 74, datë 27.1.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2016–2020", shfuqizohet.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, për të cilat në PKIE 2017–2020 janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN
2017–2020
Janar 2017

PJESA 1 – Hyrje dhe menaxhimi i Procesit të Integrimit Europian

Hyrje
1. Anëtarësimi në BE

Integrimi Europian është objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë, që qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme. Procesi i aderimit mori një hov të fuqishëm me rekomandimin pozitiv të Komisionit Europian të shprehur në Raportin për Shqipërinë 2016, si vlerësim për reformat e ndërmarra.
Rekomandimi pozitiv për hapjen e negociatave është edhe inkurajim për të përshpejtuar ritmin e reformave të nisura sidomos Reformës në Drejtësi, është sinjal politik tepër i rëndësishëm për Shqipërinë, që tregon se vendi po ecën në drejtimin e duhur, përmes reformave të vështira, por të domosdoshme.

Shqipëria është pjesë e Procesit të Stabilizim-Asocimit të shpallur për vendet e Europës Juglindore në Samitin e Zagrebit, në vitin 2000. Shqipëria nënshkroi dhe ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian dhe Shtetet Anëtare të tij, e cila hyri në fuqi më 1 prill 2009. Siç përcakton neni 1, MSA synon "të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; për të kontribuar në stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit; të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë; të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat që mbulon kjo Marrëveshje".

Gjithashtu, kjo Marrëveshje e detyron Shqipërinë të respektojë parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të drejtat e njeriut siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Europë të Re. Përveç kësaj, Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit, përfshi një nivel të përshtatshëm lëshimesh të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, sidomos ato që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parasë, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, përfshi në veçanti trafikimin e qenieve njerëzore dhe tregtinë e drogës. Ky angazhim përbën një faktor kyç në zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuuar kështu në stabilitetin rajonal dhe bashkëpunimin e qëndrueshëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian.

Neni 70 i MSA-së përcakton një angazhim të veçantë të Republikës së Shqipërisë: përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Europian, proces ky që duhet të përfundohet në dy faza 5-vjeçare, brenda vitit 2019. Përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit do të rrisë zhvillimin ekonomik dhe tregtinë me Bashkimin Europian, do të përmirësojë mirëqenien dhe kushtet e jetesës së qytetarëve shqiptarë, duke u kurorëzuar në fund me asocimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

2. Menaxhimi i procesit të Integrimit Europian

Për koordinimin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian, Qeveria shqiptare ka ngritur një sërë organesh koordinuese dhe drejtuese të cilat kanë për detyrë:

- hartimin e planeve për procesin e anëtarësimit;
- koordinimindh e zbatimin e këtyre planeve;
- monitorimin e zbatimit të planeve dhe identifikimin e mangësive;
- raportimin mbi përparimin e Shqipërisë pranë shërbimeve të Komisionit Europian.

Këto organe janë:

- Komiteti Ndërministror për Integrimin Europian (KNIE);
- Komiteti për Koordinimin Ndërinstitucional për Integrimin Europian (KKNIE);
- Ministria e Integrimit Evropian
- Grupet Ndërinstitucionale të Punës (GNP);
- Njesitë e Integrimit në Ministritë e Linjës.

Përbërja dhe funksionimi i strukturave të bashkërendimit ndërministror është përcaktuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 46, datë 1.04.2009 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e strukturave të bashkërendimit ndërministror, për realizimin e angazhimeve, të ndërmarra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit" (Urdhri Nr. 46). KNIE-ja kryesohet nga Kryeministri ose, në mungesë të tij, nga ministri i Integrimit. KNIE-ja është përgjegjëse për:

a) drejtimin dhe miratimin e politikave të përgjithshme e të strategjisë për integrim në Bashkimin Europian;
b) bashkërendimin e politikave për zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, dhe të dokumenteve strategjike, për procesin e integrimit europian;
c) miratimin e planit kombëtar të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
d) drejtimin e fazave të procesit të integrimit europian dhe të negociatave, për pranimin në Bashkimin Europian;
e) përfaqësimin e qeverisë Shqiptare në Këshillin e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, i cili mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
f) dh) shqyrtimin dhe miratimin të materialeve për mbledhjet e Këshillit të Asociimit – BE - Shqipëri;
g) rishikimin dhe miratimin e kontributit të qeverisë shqiptare për raportin vjetor të Komisionit Europian.

KKNIE-ja kryesohet nga ministri i Integrimit dhe përbëhet nga përfaqësues të ministrive, në nivel zëvendësministri ose të sekretarit të Përgjithshëm, dhe nga përfaqësues të institucioneve, në varësi të Kryeministrit e ministrave, në nivel drejtori të përgjithshëm.

KKNIE-ja është përgjegjëse për:

a) monitorimin dhe bashkërendimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të rekomandimeve të dokumenteve strategjike,për procesit e integrimit europian;
b) zbatimin e kërkesave dhe të udhëzimeve të KNIE-së;
c) raportimin në KNIEpër veprimtaritë në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Europian;
d) drejtimin e procesit të përditësimit të planit kombëtar të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
e) përfaqësimin e Shqipërisë në Komitetin e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri;
f) vlerësimin dhe finalizimin e dokumenteve e të raporteve, të përgatitura në kuadër të takimeve të Komitetit dhe nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit;
g) vlerësimin e ndikimit te financave publike të buxhetit të shtetit, nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
h) vlerësimin e ndikimit të përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*;

i) vlerësimin e përparësive të programit komunitar, IPA, ecurinë e projekteve, të financuara nga programet e asistencës së Bashkimit Europian apo nga donatorë të tjerë, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Urdhri Nr. 46 parashikon se KNIE mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj dhe sa herë që është e nevojshme. KNIE-ja mblidhet për të diskutuar çështjet që parashikon kalendari i mbledhjes, i miratuar nga Kryeministri, me sugjerimin e ministrit të Integrimit. Ndërsa KKNIE mblidhet dy herë në muaj, me njoftim të kryetarit. Në mbledhje ftohen përfaqësues nga institucione shtetërore të pavarura, shoqëria civile, rrethet akademike, autoritetet vendore dhe media, si dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Përbërja dhe funksionimi i Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Europian është përcaktuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 107, datë 28.02.2014 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP) për Integrimin Europian" (Urdhri Nr. 107).

Fusha e veprimit e këtyre GNP-ve përfshin këto detyra:

- realizojnë bashkëpunimin dhe komunikimin ndërinstitucional në nivel teknik, me synim zbatimin e angazhimeve në kuadrin e dokumenteve të politikave për integrimin europian;
- mbikëqyrin zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA);
- kontribuojnë në përgatitjen e takimeve të Komitetit të MSA-së dhe Nënkomiteteve si edhe ndjekin dhe zbatojnë rekomandimet që jepen në këto takime;
- bashkë me Ministrinë e Integrimit Europian, koordinojnë rishikimet vjetore të Planit Kombëtar për Integrimin Europian 2015-2020 në kapitujt përkatës si edhe garantojnë konsistencën e Planit Kombëtar me planin vjetor të punës të Qeverisë si edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) si edhe strategji të tjera kombëtare/sektoriale;
- koordinojnë dhe mbikëqyrin procesin e përafrimit të legjislacionit, duke përfshirë respektimin e afateve të përcaktuara në Planin Kombëtar për Integrim Europian 2015-2020;
- koordinojnë dhe garantojnë shpërndarje në kohë të acquis të BE-së ndërmjet ministrive të linjës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse, si edhe shërbejnë si forum për zgjidhjen e debateve ndërministror mbi shpërndarjen e *acquis*;
- monitorojnë periodikisht zhvillimet në lidhje me legjislacionin e BE-së, duke përfshirë propozimet për legjislacion të ri, legjislacionin e miratuar rishtas si edhe jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian;
- informojnë rregullisht stafin përkatës në ministritë e linjës, shërbimet e ekspertëve pranë parlamentit si edhe autoritetet e tjera përgjegjëse për ndryshimet më të fundit në acquis të BE-së;
- analizojnë periodikisht kapacitetet institucionale në fushat relevante dhe bëjnë rekomandimet përkatëse;
- përcaktojnë prioritetet dhe monitorojnë zbatimin e planit për përkthimin e acquis të BE-së;
- identifikojnë prioritetet strategjike dhe nevojat në lidhje me procesin e integrimit europian për të formuluar propozime për asistencë nga BE-ja dhe donatorë të tjerë, në

bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Integrimit Europian dhe departamentin përgjegjës pranë Këshillit të Ministrave, si edhe hartojnë dhe i japin rekomandime Komitetit të Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Europian (KNIE).

Secili grup kryesohet nga zëvendësministri i ministrisë kryesore për kapitullin përkatës dhe koordinohet nga drejtori i Njësisë së Integrimit Europian të asaj ministrie. Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Europian përbëhen nga përfaqësues të Kryeministrisë, ministrive të linjës, institucioneve të tyre të varësisë dhe institucioneve publike sipas fushës së *acquis* të BE-së. Pavarësisht nga kapitulli i *acquis*, përfaqësuesit e Ministrisë së Integrimit Europian dhe të Ministrisë së Financave marrin pjesë në mbledhjet e të gjitha GNP-ve.

Urdhri Nr. 107 parashikon se GNP-të për Integrimin Europian duhet të mbajnë takime të rregullta mujore që të analizojnë zhvillimet dhe të vendosin për kursin e veprimit. Grupet e punës mund të takohen edhe jashtë radhe (*ad hoc)*, nëse është nevoja.

Sekretariati i GNP përbëhet nga anëtarët e institucionit kryesor për çdo kapitull të *acquis.*

Përgjegjësitë e Sekretariatit të GNP përfshijnë asistencë teknike dhe rrjedhjen e informacionit brenda GNP-së.

3. Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2017 – 2020

Kyçi i suksesit të Shqipërisë në rrugën e integrimit europian është zbatimi i shpejtë i reformave, përmes aktiviteteve të planifikuara, siç janë paraqitur në dy dokumente bazë të Qeverisë:

- Udhërrëfyesi për plotësimin e pesë prioritetet kyçe të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 330, datë 28.5.2014;
- Plani Kombëtar për Integrimin Europian.

Këto dy plane, ndonëse të sinkronizuar, janë të ndryshëm në natyrën dhe qëllimin e tyre.

Udhërrëfyesi është plan i projektuar posaçërisht për të plotësuar pesë prioritetet kyçe të Strategjisë së Zgjerimit të Komisionit Europian, të vitit 2013, që përmban masa zbatuese afatshkurtra të shënjestruara në fusha të ndryshme.

Plani Kombëtar për Integrimin Europian përfshin masa afatshkurtra dhe afatmesme që shtrihen deri në vitin 2020, me synimin që Shqipëria të ketë përafruar plotësisht legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së, si edhe që të gjithë sektorët të kenë përmbushin standardet e përcaktuara në kapitujt e *acquis.*

PKIE rishikohet çdo vit duke pasur parasysh progresin e arritur, jo vetëm në ritmin e përafrimit, por edhe në zbatimin e legjislacionit të përafruar.

Përafrimi i legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së konsiston në këto hapa:

- Analiza e legjislacionit të Bashkimit Europian;

- Identifikimi i mangësive/akteve kontradiktore të legjislacionit shqiptar;
- Hartimi/rishikimi i akteve shqiptare të përafruara;
- Monitorimi i zbatimit të legjislacionit të përafruar.

PKIE synon të koordinojë këtë proces përafrimi duke përcaktuar prioritetet për aktet që do të përafrohen, ministritë përgjegjëse për hartimin/rishikimin e projektakteve shqiptare, shkallën e përafrimi, si dhe datat e miratimit dhe afatet e hyrjes në fuqi.

Hartimi në kohë dhe me cilësi i Planit dhe miratimi i tij do të përmirësojnë koordinimin e këtij procesi dhe monitorimin e tij. Mosmiratimi në kohë do të cenojë procesin e koordinimit ndërinstitucional për procesin e integrimit europian dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Europian.

Përgatitja e Planit Kombëtar për Integrim Europian 2017 – 2020 dhe përditësimet vjetore të tij koordinohen nga Ministria e Integrimit Europian në bashkëpunim me GNP-të. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 946, datë 9.10.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Integrimit Europian", Ministria e Integrimit Europian përcakton metodologjinë dhe jep orientime mbi hartimin dhe monitorimin e PKIE.

PKIE përgatitet në përputhje të plotë me Programin Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave. Kjo përputhje monitorohet nga MEI gjatë përgatitjes së këtyre dy dokumenteve.

Po ashtu, PKIE është në përputhje me buxhetin e vitit në vazhdim dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA). Përgjegjësia për realizimin e kësaj përputhjeje, ndahet mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integrimit Europian. Në këtë kuadër, përfaqësues të Ministrisë së Integrimit Europian marrin pjesë dhe asistojnë në shqyrtimin e projektprogrameve buxhetore të ministrive të linjës.

PKIE-ja është e strukturuar në 3 pjesë kryesore:

- Hyrja, në të cilën jepet një përshkrim i shkurtër i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian, strukturat e koordinimit në këtë proces dhe një përshkrim i vetë PKIE;
- Pjesa e dytë është e ndarë në dy kapituj, Kriteri politik dhe Kriteri ekonomik, të ndarë më tej në nënkapituj. Këta dy kapituj i përgjigjen kritereve politike dhe ekonomike të anëtarësimit, sikurse përcaktuar nga Këshilli i Bashkimit Europian në Kopenhagen në qershor 1993, si dhe paraqesin bazën ligjore relevante, situatën aktuale dhe arritjet më të fundit në plotësimin e këtyre kritereve, si dhe masat që do të merren për të përshpejtuar për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE.
- Pjesa e tretë është pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve të parë negociues.

Plani nuk përfshin *Kapitullin 34: Institucionet* dhe *Kapitullin 35: Çështje të tjera*. Kapitulli 34 rregullon pjesëmarrjen e shtetit anëtar në institucionet e Bashkimit Europian, ndërsa, Kapitulli 35 (aktet ligjore të BE-së që bëjnë pjesë në këtë kapitull) përvijon fazat e fundit të negociatave për anëtarësim.

Implikimet Financiare

Në hartimin e PKIE 2017 – 2020 është vazhduar procesi i kostimit të hartimit të projektakteve shqiptare të përafruara me legjislacionin e Bashkimit Europian. Për çdo projektakt të veçantë shqiptar që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Europian tregohen kostot e institucionit propozues të projektaktit dhe ato të institucioneve kontribuuese në hartimin e tij, të kategorizuara sipas llojit të shpenzimeve: shpenzime për pagat për personelin ekzistues, shpenzimet për pagat për personelin e ri që do të punësohet, shpenzime trajnimi, shpenzime për konsulentë, si dhe shpenzime kapitale dhe korrente. Këto shpenzime janë të treguara në Lek. Për çdo kapitull të veçantë është treguar po ashtu, edhe lista e projekteve të asistencës së huaj, institucioni/ institucionet përfituese, buxheti i secilit prej këtyre projekteve në Euro dhe një përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të pritshme nga secili projekt.

PJESA 2 – Kriteret Politike dhe Ekonomike

1. KRITERI POLITIK

Anëtarësimi në Bashkimin Europian është objektivi kombëtar madhor dhe strategjik i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Kriteret e anëtarësimit që kërkojnë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si edhe ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, janë themelet e politikës kombëtare dhe të jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Stabilizim-Asocimit, Shqipëria do të vazhdojë të adresojë realizimin e kritereve politike dhe ekonomike të përcaktuara nga BE, si parakusht për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e vetëdijshme se përmbushja e kritereve kryesore politike është e një rëndësie themelore në procesin për t'u bërë anëtar i BE-së, dhe për këtë arsye është e vendosur të bëjë përpjekje shtesë në reformën e saj gjyqësore, politikat anti-korrupsion, luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe në administratën publike.

1.1 Demokracia dhe Shteti i së Drejtës

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar të ndërmarrë dhe të zbatojë të gjitha reformat e nevojshme për të forcuar procesin legjislativ, sistemin zgjedhor, qeverinë qendrore dhe lokale, administratën publike, si dhe sistemin e drejtësisë.

Përveç kësaj, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë janë të angazhuar për marrjen e masave të veçanta për të siguruar funksionimin e duhur të Parlamentit. Këto masa do të bazohen në dialogun politik konstruktiv mes të gjitha partive dhe ndërveprimin me institucionet e pavarura me synimin për të përmirësuar funksionet rregullatore dhe për të siguruar transparencën e procesit legjislativ, si dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Parlamentit në mënyrë që të rritet roli i tij mbikëqyrës, për të mbikëqyrur zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe procesi i integrimit të Shqipërisë në BE.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për një reformë të vërtetë të administratës publike, për trajtimin dhe vlerësimin bazuar në merita, në krijimin e një rrjeti institucional efektiv dhe efiçient për punonjësit e saj, në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Qeveria shqiptare ndjek objektivin përfundimtar të krijimit të një administrate publike efiçente, të aftë për zbatimin e plotë të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Çdo veprim që duhet të ndërmerret nga Qeveria shqiptare në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës, ka për qëllim final krijimin e një sistemi të drejtësisë të pavarur, të përgjegjshëm dhe efiçent në Shqipëri, i cili është në gjendje të japë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe të zbatojë legjislacionin e përafruar me *acquis* të BE-së.

Lufta kundër korrupsionit është prioritet kyç për qeverinë e Shqipërisë. Drejtimet kryesore të politikës kundër-korrupsionit përfshijnë një seri veprimesh për parandalimin e fenomenit, forcimin e institucioneve, monitorimin e përgjithshëm edhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe dënimin administrativ dhe penal të zyrtarëve të korruptuar. Zbatimi i strategjisë kundër-korrupsionit, të miratuar në vitin 2015, do të kontribojë në reduktimin e qëndrueshëm të fenomenit të korrupsionit.

Veç kësaj, Qeveria shqiptare është e angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për të zbatuar më tej politikat e anti-diskriminimit, përmirësimin e gjendjes me të drejtat sociale, me fokus të veçantë te grupet vulnerabël dhe të miturit. Reformat në fushën e të drejtave të pronësisë dhe në veçanti plani i veprimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ECHR) për kthimin dhe kompensimin e pronave do të jenë pjesë e prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme.

Fokusi i punës së Qeverisë shqiptare ka qenë zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe në mënyrë të veçantë adresimi i rekomandimeve të Raportit të Progresit 2015 të Komisionit Evropian. Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar për të adresuar 5 prioritetet kyçe të përcaktuara në Strategjinë e Zgjerimit 2013-2014 të Komisionit Europian për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE.

1.1.2 Parlamenti

Kuvendi i Shqipërisë, si organi më i lartë ligjvënës në vend, luan një rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri. Kuvendi është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike në vend, për realizimin e reformave të domosdoshme në dobi të zhvillimit të vendit dhe integrimit në Bashkimin Europian. Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ushtron edhe funksionin e kontrollit politik ndaj qeverisë si dhe monitoron zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit europian, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Gjatë vitit 2017 Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë që funksionon pranë Komisionti të Posaçëm Parlamentar do të vijojë punën për hartimin e paketës së 26 projektakteve të tjera, nga të cilat 25 projektligje dhe 1 projektstrategji ("Për edukimin ligjor të publikut"), të listuara më poshtë:

1. Projektligji "*Për Presidentin në Republikën e Shqipërisë*",
2. Kodi i Procedurës Civile,
3. Projektligji "*Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore*",
4. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*",
5. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*"",
6. Projektligji "Për Policinë e burgjeve",

7. Projektligji "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*",
8. Projektligji "*Për të Drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar dhe mbajtja në paraburgim*",
9. Kodi për Drejtësinë e të Miturve,
10. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar*"",
11. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese*"", (Antimafia),
12. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9157, datë 4.12.2003 "Mbi përgjimin e telekomunikimit" i ndryshuar*"",
13. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.157, datë 10.10.2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit*"",
14. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpuntorëve të drejtësisë", i ndryshuar"",*
15. *Projektligji "Për provimin e shtetit për juristët*",
16. Mbi projektstrategjinë "*Për edukimin ligjor të publikut*",
17. Projektligji për Shkollën e Magjistraturës,
18. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10031, datë.11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat*"",
19. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit*"",
20. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.9.1994 "Për noterinë", i ndryshuar*"",
21. Projektligji "*Për ndihmën ligjore*",
22. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*"
23. Projektligji "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për profesionin e avokatit*"",
24. Projektligji "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"" ,
25. Projektligji "*Për zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor*",
26. Projektligji "*Për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë*".

Pas procesit të draftimit nga grupet e ekspertëve hartues ose konsultimit me grupet e konsultimit Think-Tank, keto projekt-ligje do të vijojnë më tej me prezantimin dhe shqyrtimin e tyre nga Komisioni i Posacëm Parlamentar.

Konsolidimi i mëtejshëm i demokracisë dhe i parlamentarizmit në Shqipëri si dhe sfidat me të cilat Kuvendi do të përballet gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, e bëjnë të domosdoshme që Kuvendi të përmirësojë më tej funksionet e ligjvënies dhe kontrollit parlamentar me qëllim për të forcuar përmbushjen me efiçensë të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri dhe procesi i anëtarësimit në BE.

Puna në këtë drejtim do të përqendrohet kryesisht në objektivat dhe masat e mëposhtme:

- **Forcimi i funksionit ligjvënës të Kuvendit përmes**: shqyrtimit më të mirë të legjislacionit gjatë procesit legjislativ; përmirësimit të procedurave legjislative dhe bazës metodologjike të punës së Kuvendit me qëllim për të garantuar një përafrim më efektiv të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian; përgatitjes dhe publikimit të një "*Manuali mbi sistemin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së në nivel parlamentar*", bazuar në praktikat më të mira evropiane lidhur me përafrimin e ligjislacionit kombëtar me Acquis e BE-së;
- **Realizimi me sukses i objektivave të fazës së tretë të procesit të reformës në drejtësi, përmes:** hartimit dhe miratimi nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar si dhe shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi në Seancë plenare i 6 projektligjeve të tjera, pjesë e paketës së 7 projektligjeve prioritare që shoqërojnë amendimet kushtetuese, brenda datës 6 Tetor 2016; hartimit dhe miratimit nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar si dhe shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi në seancë plenare i 26 projektakteve të tjera (25 projektligje dhe 1 projektstrategji), sipas 7 shtyllave të reformës në drejtësi (shtylla e institucioneve kushtetuese, gjyqësorit, drejtësisë penale, arsimit juridik, profesioneve të lira, masave anti-korrupsion dhe e financimit të sistemit të drejtësisë);
- **Përmirësimi i kuadrit ligjor për zgjedhjet në Shqipëri, përmes** ndryshimit të Kodit Zgjedhor, me qëllim adresimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODHIR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 dhe ato vendore të vitit 2015 në Shqipëri;
- **Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit, përmes**: rritjes së kapaciteteve të Kuvendit për të monitoruar zbatimin efektiv të legjislacionit të përafruar me acquis të BE-së; forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të Kuvendit për të monitoruar veprimtarinë e qeverisë në çështjet e integrimit europian; adoptimit të një mekanizmi efektiv për mbikëqyrjen e veprimtarisë së qeverisë (shqyrtimit të pozicioneve negociuese të qeverisë), gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, bazuar në modelet/praktikat më të mira evropiane në këtë fushë; forcimit të mëtejshëm të rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj me qëllim për të garantuar pavarësinë, efiçencën dhe përgjegjshmërinë e tyre;
- **Forcimi i mëtejshëm i rolit të KKIE, si garantues i bashkëpunimit gjithëpërfshirës, ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, përmes**: zhvillimit të takimeve dhe kontakteve të rregullta me të gjithë këta aktorë, përfshirë edhe ata që nuk janë pjesë e këtij Këshilli; organizimit të forumeve dhe tryezave të rrrumbullakëta të fokusuara në politika specifike të BE, të cilat janë të rëndësishme për publikun e gjerë shqiptar, duke inkurajuar debatin konstruktiv për cështjet problematike të evidentuara nga grupet e ndryshme të shoqërisë; rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të të gjithë aktorëve të shoqërisë të përfshirë në procesin e integrimit europian, si dhe rritjes e ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet dhe detyrimet e vendit por edhe të qytetarëve në kuadër të këtij procesi.
- **Forcimi i autonomisë financiare dhe buxhetore të Kuvendit nga qeveria, përmes** rishikimit të kuadrit kushtetues dhe ligjor ekzistues lidhur me buxhetin e shtetit dhe hartimit të një ligji të veçantë për buxhetin e Kuvendit;

- **Forcimi i transparencës në veprimtarinë e Kuvendit përmes**: rritjes së transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin legjislativ, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së publikut dhe shoqërisë civile në procesin vendimmarres; miratimit të Strategjisë së Komunikimit të Kuvendit; instalimit dhe vënies në funksionim të sistemeve Audio - Video në Komisionet parlamentare të Kuvendit; projektimit dhe zbatimit të teknologjive të reja në fushën e informatizimit dhe të automatizimit në Kuvend; zhvillimit të aktiviteteve profesionale për informimin e opinionit publik mbi veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë me synim përmirësimin e imazhit dhe rritjen e perceptimit publik për rolin e Kuvendit në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit;
- **Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit, përmes**: trajnimit bazë dhe të thelluar të të gjitha shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me procesin e integrimit europian; pjesëmarrjes së stafit të Kuvendit në vizita studimore në parlamentet kombëtare të vendeve anëtare të BE-së, me qëllim shkëmbimin e përvojës dhe njohjen me praktikat më të mira lidhur me organizimin dhe funksionimin e parlamenteve europiane; organizimit të trajnimeve të specializuara në çështjet e BE-së me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe të ekspertizës të stafit të Kuvendit që mbulon çështjet e integrimit evropian; alokimit të fondeve të mjaftueshme financiare për trajnimin e stafit të Kuvendit.

1.1.3 Qeveria

Qeverisja qendrore përcakton vizionin dhe politikat kyçe, si dhe propozon legjislacionin për forcimin e demokratizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Qeverisë/Këshillit të Ministrave (që përbëhet nga Kryeministri, Zv. Kryeministri dhe Ministrat e Kabinetit) parashikohet në dispozitat themelore kushtetuese, si edhe në Ligjin Nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave". Përshpejtimi i reformave dhe përgatitja e vendit për t'iu bashkuar Bashkimit Europian mbetet prioriteti madhor i Qeverisë së Shqipërisë.

Ky prioritet do të ndiqet përmes objektivave dhe masave politike të mëposhtme:

- pjesëmarrje konstruktive në Dialogun e Nivelit të Lartë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së për pesë prioritetet e mbetura për hapjen e negociatave dhe përshpejtimin e reformave përkatëse;
- hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020
- forcimi i Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave;
- ngritja dhe funksionimi i strukturave institucionale të nevojshme për fillimin e procesit *screening* dhe negociatave të anëtarësimit në BE;
- përmbushja e mëtejshme e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit;
- përmirësimi dhe rritja e eficiencës në koordinimin dhe monitorimin e procesit të integrimit europian si element kyç për shpejtimin e procesit të integrimit në BE;
- përshpejtimi i harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së në përputhje me nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- forcimi i bashkëpunimit me vendet dhe vendet kandidate të rajonit, në kuadrin e shkëmbimit të përvojave dhe teknikave më të mira për procesin e përafrimit të legjislacionit europian;
- forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në përgatitjen për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të BE-së;
- zhvillimi i takimeve periodike të strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri të ngritura në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Komiteti i Stabilizim-Asociimit, Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit dhe Nënkomitetet);
- përgatitja e një databaze me legjislacionin e përafruar dhe shkallën e përafrimit, ku të kenë akses të gjitha ministritë e linjës, institucionet e tjera qendrore dhe institucionet e pavarura;
- trajnimi i nëpunësve të administratës publike mbi çështjet e integrimit europian;
- trajnimi i mëtejshëm i stafit të Departamentit të Përkthimit mbi përdorimin e softuerëve të specializuar të përkthimit;
- koordinimi i punës për përkthimin e *acquis* të BE-së me autoritetet kompetente të Qeverisë së Kosovës, në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit;
- përgatitja për nxitjen dhe akreditimin e strukturave të nevojshme për të përfituar nga IPA 2015-2020;
- rritja e sensibilizimit dhe komunikimit me palët e interesuara në lidhje me procesin e integrimit, si edhe përfitimet dhe detyrimet që rrjedhin nga marrja e statusit kandidat dhe anëtarësimi në BE.

1.1.4 Administrata Publike

Reforma e administratës publike, si një prioritet thelbësor për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian, ka përparësi të lartë për Qeverinë shqiptare e cila synon të zhvillojë një administratë publike në kuadër të Hapësirës Administrative Evropiane dhe në përputhje me të, që të sigurojë shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne, shërbimeve inovative në përputhje me kërkesat e integrimit evropian, si dhe nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efiçente.

Në këtë kontekst Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike (SNRAP 2015-2020), e cila u miratua më 15 Prill 2015, me VKM nr. 319 fokusohet në këto fusha:

- Politikbërja dhe Cilësia e Legjislacionit;
- Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike;
- Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja.

Vizioni që udhëheq këtë Strategji është *"Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integrimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficente."*

Në këtë kuadër, zbatimi i SNRAP 2015-2020 është një sfidë e rëndësishme për të siguruar përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare në fusha të ndryshme si dhe për të arritur objektivat dhe rezultatet e përcaktuara. Për këtë arsye, monitorimi i zbatimit të saj është një detyrë e rëndësishme e cila duhet të përmbushet. Me asistencën e OECD/SIGMA, është përgatitur një sistem monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë, që përfshin një Pasaportë Indikatorësh të cilët përcaktojnë mënyrën e matjes së rezultateve në bazë vjetore. Me nisjen e zbatimit të Strategjië janë përgatitur edhe raportet e monitorimit, mbi baza tre-mujore dhe vjetore, sipas këtij sistemi.

Sipas Raportit të fundit të Komisionit Evropian, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur me reformën e administratës publike. Ka patur ecuri të mirë në fushat e këtij prioriteti kyç, veçanërisht me miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe Kodit të ri të Procedurave Administrative. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme edhe në zonat jashtë fushëveprimit të këtij prioriteti. Me qëllim përmbushjen e Prioriteti 1 prioriteti, në veçanti Shqipëria duhet të:

- vazhdojë të tregojë rekrutime transparente bazuar në merita dhe lirime të nëpunësve civilë në të gjitha institucionet shtetërore, në mënyrë qe të arrije objektivin e një administrate publike të depolitizuar dhe profesionale;
- të përcjellë informacion të saktë mbi shërbimet publike në dispozicion përmes Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, dhe lidhjen e tij me sistemin e thesarit;
- të përgatitet për zbatimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative dhe të kryejë një rishikim paralel dhe përafrimin me legjislacion tjetër përkatës.

Ligji *"Për nëpunësin civil"* është në përputhje me parimet e Administratës Publike ndërkohë që zbatimi dhe monitorimi i tij është thelbësor. Miratimi dhe zbatimi i këtij legjislacioni që hyri në fuqi më 26 Shkurt 2014, ishte një reformë e nevojshme ligjore për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve të administratës shtetërore. Pas implementimit të tij dhe sfidave të hasura, ligji pësoi disa amendime. Në këtë kuadër, legjislacioni dytësor u përshtat në mënyrën e duhur, në përputhje me këto ndryshime. Me synimin e unifikimit të procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ri, u bë edhe rishikimi i udhëzimeve dhe manualeve shpjeguese.

Ndërkohë, vijon puna për sigurimin e zbatimit të duhur të legjislacionit dhe Departamenti i Administratës Publike është në komunikim të vazhdueshëm jo vetëm me institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, por edhe me institucionet e pavarura si dhe njësitë e qeverisjes vendore, për implementimin e saktë të legjislacionit nëpërmjet dhënies së udhëzimeve dhe ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme. Gjithashtu, për të siguruar dhe monitoruar kështu zbatimin e legjislacionit, është krijuar një mekanizëm monitorues nëpërmjet të cilit sigurohen raportime periodike nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Përgjatë vitit 2017, DAP do të vazhdojë të mbikqyrë zbatimin e legjislacionit për nëpunësin civil si dhe do të punojë për shtrirjen e SIMBNj në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore duke ofruar edhe trajnimet përkatëse për to. Për më tepër, do të ofrohen trajnime të mëtejshme mbi Kodin e ri të Procedurave Administrative, do të vazhdojë monitorimi dhe zbatimi i aktivitete të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020. Gjithashtu, në fokus do të jetë edhe përmirësimi i cilësisë së raportimeve në lidhje me emërimet, lirimet, masat displinore, ecurinë e proceseve gjyqësore,etj si dhe përmbushja e funksioneve të DAP sipas përcaktimeve në legjislacion.

1.1.5 Avokati i Popullit

Krijimi i institucionit të Avokatit të Popullit është parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Funksionimi i këtij institucioni rregullohet nga ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Avokati i Popullit në mënyrë aktive promovon të drejtat e njeriut, në veçanti ato të grupeve më vulnerabël, dhe bashkëpunon intensivisht me shoqërinë civile. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

Për të forcuar rolin e Avokatit të Popullit, parashikohen prioritetet dhe masat e mëposhtme:

- informimi i Avokatit të Popullit në kohën e duhur për propozimet përkatëse legjislative në mënyrë që të mundësohet dhënia e komenteve;
- përmirësimi i shqyrtimit nga Kuvendi i raportit të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit;
- mbështetje për institucionin përmes rritjes buxhetore dhe parashikimit të personelit për zyrat rajonale.
- përmirësime të ligjit organik nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, bazuar në rekomandimet e projektit Euralius.

1.1.6 Shoqëria Civile

Zhvillimi i sektorit të organizatave të Shoqërisë civile në Shqipëri ka qenë i lidhur me nisma dhe ndryshime ligjore të cilat janë përpjekur të krijojnë një mjedis mundësues për organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Në lidhje me lirinë e organizimit, Shqipëria ka një kuadër ligjor, sipas të cilit çdo person ka të drejtë të themelojë shoqatë, fondacion dhe qendër për çfarëdo qëllimi të lejuar nga ligji.

Miratimi i Ligjit Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Në kuadër të programit të transparencës bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe detyrimit për konsultim publik të dokumenteve strategjikë bazuar në ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, institucionet po vijojnë procesin e konsultimeve me shoqërinë civile dhe grupet e interesit të të gjitha nismave ligjore të ndërmarra.

Ka nisur implementimi i sistemit “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK)”, bazuar në Ligjin Nr. 146/2014 për Njoftim dhe Konsultim Publik datë 30.10.2014 si dhe VKM-së Nr. 828 datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”.

Në lidhje me kuadrin fiskal, pas hyrjes në fuqi të standardeve të reja kombëtare për trajtimin financiar të organizatave jofitimprurëse në Janar 2016, ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator në regjimin e taksave për OSHC-të.

Udhërrëfyesi për krijimin e një mjedisi mundësues për ShC

Në prill 2016, Kuvendi miratoi ligjin për vullnetarizmin duke përmbushur një nga 9 prioritetet e identifikuara në Udhërrëfyesin për shoqërinë civile.
Ndërkohë, po vijon puna për zbatimin e masave të këtij Udhërrëfyesi përmes Asistencës Teknike nga fondet e Bashkimit Europian.

Prioritetet e këtij Udhërrëfyesi të identifikuara nga qeveria shqiptare janë në të njëjtën linjë me Udhëzuesin e Bashkimit Europian për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet që aspirojnë anëtarësimin 2014-2020, të shtjelluar nga Drejtoria e Zgjerimit pranë Komisionit Europian.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Pas miratimit të ligjit për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, të miratuar në nëntor 2015 nga Kuvendi i Shqipërisë, është bërë konstituimi i Këshillit dhe ka nisur funksionimi i tij. Ky Këshill pritet të shërbejë për intensifikimin e bashkëpunimit mes Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), shoqërisë civile dhe institucioneve, në nivel konsultativ dhe ekspertësh.

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian

Mbas kalimit në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë, datë 5.3.2015, ligji nr.15/2015 "Për Rolin e Kuvendit në Procesin e Integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian" parashikon në nenet 6, 7 dhe 8 ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian. Siç edhe parashikuar në këtë ligj, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian është struktura më e lartë këshillimore në fushën e integrimit evropian, që monitoron dhe jep udhëzime strategjike mbi procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke garantuar konsensusin dhe bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore, partive politike dhe shoqërisë civile në këtë proces. Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian në aktivitetin e tij synon të nxisë dhe përshpejtojë realizimin e reformave madhore të nevojshme në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

1.1.7 Sistemi Gjyqësor

(Për më shumë informacion shih pikën 1.1.2)

Cilësia e drejtësisë

Shkolla e Magjistraturës do t'i kushtojë rëndësi realizimit të objektivave të mëposhtme për vitet 2017-2019:

- Ofrimi i kushteve cilësore të punës për zhvillimin e aktivitetit akademik dhe administrativ me qëllim konsolidimin dhe rritjen e qëndrueshmërisë së Shkollës së Magjistraturës si një institucion bashkëkohor;
- Realizimi i procesit të mësimdhënies për ciklin 3 vjeçar të formimit fillestar nëpërmjet ruajtjes së qëndrueshmërisë institucionale të Shkollës së Magjistraturës, si nga përmbajtja e trajnimit fillestar edhe nga objektiviteti i seleksionimit të kandidatëve për magjistratë, formimin dhe vlerësimin e tyre;
- Vazhdimin e organizimit dhe zhvillimit të sesioneve trajnuese, nëpërmjet konsolidimit të programeve të trajnimit vazhdues, orientimit cilësor të tematikës së tyre mbi bazën e nivelit të kualifikimit të magjistratëve në çështje të përgjithshme dhe specifike që lidhen me detyrat e tyre, në fusha të edukimit ligjor.
- Fusha e publikimeve dhe puna kërkimore-shkencore si kusht i domosdoshëm për rritjen e nivelit profesional të magjistratëve gjatë formimit fillestar dhe të vazhduar, krahas qëllimit të përfshirjes së tyre si autorë në përgatitjen e këtyre botimeve dhe publikimeve, 6 botime viti 2017, 6 botime viti 2018, 6 botime viti 2019.

Aksesi në drejtësi

Në kuadër të rekomandimeve të progres raportit të fundit të Komisionit Europian lidhur me aksesin në drejtësi, pranë Ministrisë së Drejtësisë në Maj të vitit 2016 është ngritur dhe funksionon klinika ligjore falas. Aspekti i parë i misionit të klinikës ligjore është shërbimi ose e mira që klinika i ofron në mënyrë të drejtpërdrejt qytetarit. Qëllimi i ofrimit të këtij shërbimi është rritja e aksesit në drejtësi, për të siguruar shërbime ligjore për personat që paraqiten në Ministrinë e Drejtësisë për të kërkuar informacion lidhur me procedura ligjore apo me procedura administrative, persona që kanë pamundësi financiare.Synimi i Klinikës ligjore është përmirësimi i aksesit në drejtësi, lufta ndaj korrupsionit dhe në zbatimin e strategjisë për edukimin ligjor.

Funksionet e klinikës ligjore përfshijnë një shumëllojshmëri shërbimesh juridike të tilla si:

1. Orientimin e qytetarit për identifikimin e saktë të problemit, institucionit që duhet t`i drejtohet dhe formës nëpërmjet së cilës duhet të kërkojë shërbimin;
2. Asistimin në hartimine shkresave dhe kërkesave sipas nevojës së qytetarit lidhur me ankesat me shkrim në marrëdhënie me administratën.
3. Këshillim ligjor mbi ndihmën juridike falas. Klinika ofron këshillim ligjor për qytetarët në nevojë. Klinika merr raste të cilat janë të referuara nga organizata të ndryshme sociale dhe gjithashtu ata që paraqiten vetë në qendër duke kërkuar ndihmë. Organizata jo-fitimprurëse ose grupe komunitare mund të ofrojnë mbështetjen e tyre në këtë drejtim.
4. Klinika përpiqet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me anë të stafit të saj të specializuar nëpërmjet ndërmjetësimit. Promovimi i ndërmjetësimit përbën edhe një fazë të re të ndryshimit të mentalitetit lidhur me qasjen në të drejta dhe marrëdhënie me administratën dhe drejtësinë.
5. Mjetet alernative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjatë ndihmës juridike që ofron klinika, mund të vihen në zbatim edhe mjetet jashtëgjyqësore për zgjidhjen alernative

të mosmarrëveshjeve, si mjete të shpejta, fleksibël dhe me pak kosto. Këtu përfshihet pajtimi, negocimi, ndërmjetësimi. Qytetarët mund të këshillohen në lidhje me këto metoda, duke iu shpjeguar si funksionojnë, procedura që ndiqet, avantazhet që sjellin, mjetet e ankimit ndaj tyre, etj. Ata gjithashtu duhet të marrin disa njohuri bazë mbi :
- Procesin gjyqësor në shkallë të parë;
- Procesin gjyqësor në apel;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve administrative;
- Procedurat që ndiqen në mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

6. Një element shumë i rëndësishëm në funksionimin e kësaj zyre është dhënia e informacionit parësor mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë qytetarët.
7. Komunikimi me qytetarët duhet thjeshtuar pasi ndodhemi para faktit që jo të gjithëe njohin realisht ligjin dhe e kanë të vështirë të kuptojnë terma specifikë juridikë, në këto kushte kërkohet një mënyrë e thjeshtuar e të komunikuarit me qytetarët. Komunikimi është çelësi për të hyrë në marrëdhënie me qytetarët. Në rastin e klinikës ai është faktor bazë që realizon ndërveprimin e palëve dhe përshpejton rezultatet, prandaj i duhet kushtuar një rëndësi thelbësore.
8. Nëpunësit janë të përfshirë në të gjitha fazat e procesit për të kërkuar dhe regjistruar marrjen e informacionit nga qytetari duke mbajtur evidenca dhe marrë*feedback* nga qytetari për zgjidhjen e problemit dhe sugjerime për përmirësimin e shërbimit.

Për vitin 2017 Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, ka si prioritet kryesor bërjen të aksesueshme të klinikave ligjore në 6 qarqet kryesore te Shqiperise, shtimin e numrit të avokatëve si dhe ofrimin e shërbimeve me efektive të dhënies së ndihmës juridike.

1.1.8. Politikat Kundër Korrupsionit

(shih gjithashtu kapitullin 23 të PKIE)

Lufta kundër korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare. Politikat kundër-korrupsionit synojnë reduktimin e korrupsionit në mënyrë progresive, duke rritur integritetin e institucioneve dhe promovimin e qeverisjes përmes përmirësimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve, zbatimit të ligjit dhe transparencës. Pavarësisht të gjitha masave të marra për të reduktuar korrupsionin dhe për të rritur transparencën dhe hetimet, korrupsioni vazhdon të jetë një fenomen i përhapur gjerësisht.
Qeveria synon rritjen e kapaciteteve të institucioneve për kontrollin dhe inspektimin e brendshëm, vlerësimin e riskut për korrupsion në institucionet e administratës shtetërore si dhe atë të hapësirave për korrupsion në hartimin e legjislacionit.

Prioritetet e ILDKPKI lidhen me përmirësime ligjore në vijim të rekomandimeve të ndryshme (GRECO, projekti ACFA etj) për zbatimin më të mirë të kuadrit ligjor për konfliktin e interesit dhe deklarimet e pasurive të zyrtarëve.

Gjithashtu, ILDKPKI ka si prioritet dixhitalizimin e procesit të deklarimit të pasurive (deklarimin online) për të mundësuar rritjen e efikasitetit si dhe publikimin brenda afateve kohore të përcaktuara të deklaratave të interesave private pa kërkesë. Më tej, synohet rritja e

kapaciteteve të ILDKPKI për zbulimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit rast pas rasti si dhe bashkëpunimi më i ngushtë me institucionet e tjera për shkëmbimin e informacionit për rastet e konfliktit të interesave, sidomos në fusha me risk për korrupsion. Me miratimin e ligjit të ri nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" të rasteve korruptive, roli i ILDKPKI-së fuqizohet më tej si organi i pavarur i cili do të monitorojë dhe zbatojë këtë kuadër ligjor. Në zbatim të ligjit nr.60/2016, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe ILDKPKI po konsolidojnë bazën e akteve nënligjore.

Objektiv strategjik i luftës kundër Korrupsionit është:

- Përmirësimi i efiçiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

Objektivat specifik janë:

- Rritja e numrit të operacioneve ku përdoren teknika speciale të hetimit;
- Rritja e hetimeve proaktive dhe rritja e kapaciteteve të strukturave të organeve ligjzbatuese;
- Përdorimi dhe menaxhimi më i mirë i informacionit për hetimin e korrupsionit;
- Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit;
- Garantimi i qëndrueshmërisë të oficerëve të policisë gjyqësore (OPGj) dhe zyrtarëve të organeve ligjzbatuese;
- Rritja e bashkëpunimit dhe zhvillimit të takimeve dhe analizave me Njësitë e Përbashkëta Hetimore(NJPH);

Objektiv madhor në kuadër të ndëshkimit të korrupsionit është edhe reforma në drejtësi e cila pritet të ndërmarrë ndryshime ligjore në fushën e ndëshkimit të korrupsionit, në vlerësimin e gjyqtarëve, parandalimin e korrupsionit në gjyqësor, si dhe në hetimin e korrupsionit.

Përsa i përket veprimeve edukuese dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit parashikohen një seri masash për të forcuar rolin e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit si dhe në rritjen e pjesëmarrjes e bashkëpunimit të publikut në luftën kundër korrupsionit. Aktualisht po zbatohen dhe është planifikuar një plan masash edukuese në formatin e një fushatë kombëtare të ndërgjegjësimit për rastet korruptive dhe prezantimi i mjeteve inovative për denoncimin e korrupsionit.

1.1.9 Lufta Kundër Krimit të Organizuar

Sfera e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme është gjithashtu një fushë prioritare e qeverisë shqiptare, si dhe një element shumë i rëndësishëm në përmbushjen e standardeve në kuadër të integrimit të Shqipërisë dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Shqipëria është e angazhuar për të çuar përpara rezultatet pozitive të arritura dhe për të adresuar rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2015.

Per vitin 2017 objektiv paresor mbetet thellimi i metejshem i luftes kunder krimit te organizuar dhe korrupsionit, per realizimin e te cilit jane parashikuar:

- Goditja e krimit të organizuar nëpërmjet hetimeve dhe operacioneve bazuar në analizën e informacionit kriminal dhe mjetet speciale të hetimit.
- Intensifikimi dhe goditja e rrjeteve kriminale dhe individëve të përfshirë në aktivitetet kriminale të trafiqeve të paligjshme
- Fuqizimi i kapaciteteve të hetimit të korrupsionit, evidentimi dhe dokumentimi sa me efektiv i hetimeve për korrupsion
- Parandalimi dhe goditja e pastrimit të parave dhe rritja e treguesve për luftën kundër tij.
- Parandalimi dhe ulja në mënyrë të ndjeshme e prodhimit të drogës në Shqipëri

1.1.10 Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Mbështetur në prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Drejtësisë për forcimin dhe sundimin e shtetit të së drejtës, bazuar në rekomandimet e institucioneve monitoruese të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile, dhe mbi të gjitha mbështetur fort në respektimin e parimeve dhe të drejtave themelore dhe transparencës me publikun, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka hartuar një plan masash për vitin 2017 e periudhën në vazhdim, në të cilin janë përcaktuar prioritetet themelore të Sistemit të Burgjeve, duke nënvizuar respektimin e të drejtave të njeriut, reformën legjislative, masat antikorrupsion, krijimi i një sistemi bashkëkohor të sigurisë, mos-diskriminimi dhe parandalimi i torturës dhe keqtrajtimeve në institucionet penitenciare. Më konkretisht, objektivat kryesore të sistemit të burgjeve përfshijnë:

- Përqasja e legjislacionit të sistemit të burgjeve në përputhje me legjislacionin e BE.
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruar për kategorinë e personave me liri të kufizuar, duke përfshirë grupet vulnerabël, mbështetur në trajtimin human dhe jo-diskriminues.
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike, materiale dhe teknologjisë në sistemin e burgjeve.
- Përmirësimi i sigurisë në sistemin e burgjeve.
- Rritja e partneritetit për respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve.
- Forcimi i masave antikorrupsion në sistemin e burgjeve dhe parandalimi i fenomeneve të tjera negative.

Iniciativa të tjera për përmirësimin e situatës së përgjithshme të sistemit të burgjeve përfshijnë ri-kategorizimin e institucioneve penitenciare, si dhe aplikimin e mekanizmit të standardizuar për vlerësimin e riskut të burgosurve. Si dy nga komponentët kryesorë të projektit të binjakëzimit "Mbështetje për Sistemin Penitenciar dhe Shërbimin e Provës në Shqipëri" të financuar nga Bashkimi Evropian, këto masa do të përbëjnë dhe bazën e reformimit të sistemit të burgjeve. Rikonfigurimi i burgjeve do të ndikojë në shpërndarjen e të burgosurve dhe vendosjen në kategoritë e sigurisë bazuar në instrumentin e riskut. Nisur nga këto aktivitete do të propozohen dhe ndryshimet në legjislacion, përkatësisht në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Një politikë lokale për vlerësimin e të gjithë institucioneve bazuar në indikatorët e performancës së drejtuesve të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët, si dhe vlerësimin e institucionit është konsideruar si prioritet i rëndësishëm. Bazuar në objektivat e sistemit të burgjeve janë përcaktuar disa indikatorë të veçantë për çdo institucion, të cilët do të jenë objekt monitorimi, vlerësimi dhe kontrolli për punën e stafit dhe të drejtuesve.

Gjithashtu, krijimi i një sistemi efektiv kontrolli dhe inspektimi është parë si një hallkë e rëndësishme për parandalimin e korrupsionit. Politika kryesore në këtë drejtim do të

fokusohet në hartimin e rregullave dhe udhëzimeve specifike, si dhe plane kontrolli në institucionet e varësisë. Gjithashtu, inicimi i fushatave ndërgjegjësuese për parandalimin e korrupsionit në sistemin e burgjeve është pjesë e planit.

Respektimi i të drejtave themelore të personave me liri të kufizuar në të cilat përfshihen e drejta e kërkesë ankesave mbetet një aspekt thelbësor i mbarëvajtjes së punës. Referuar parashikimeve në planin e punës të vitit 2017 është planifikuar ngritja e një sistemi vetëm për adresimin e kërkesë ankesave për trajtimin shëndetësor të personave me liri të kufizuar.

Parandalimi i torturës dhe akteve të tjera çnjerëzore

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka shprehur vullnetin për përmirësimin e situatës së trajtimit të personave me liri të kufizuar, duke bashkëpunuar në mënyrë të hapur dhe transparente me të gjithë aktorët vendas dhe ndërkombëtar. Progres raporti i fundit i Bashkimit Evropian vlerësonte pozitivisht masat e marra për përmirësimin e kushteve të trajtimit të personave me liri të kufizuar.

Respektimi i të drejtave të grupeve vulnerable

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është e angazhuar që të sigurojë një gamë të gjerë të programeve ndërhyrëse për personat në konflikt me ligjin, të cilat janë të fokusuara në uljen e recidivizmit, sigurinë e komunitetit dhe parandalimin e krimit nëpërmjet kontrollit, mbikëqyrjes, rehabilitimit dhe përgatitjes për ri-integrim të kësaj kategorie.Si pjesë e procesit rehabilitues, DPB harton programe, të para dhe pas lirimit për t'iu siguruar të burgosurve mundësi që të zvogëlojnë riskun për recidivizëm.Një manual trajtimi është miratuar dhe vënë në funksion për trajtimin e grupeve vulnerabël në sistemin e burgjeve duke përfshirë ofrimin e asistencës psiko-sociale dhe masat rehabilituese.Në funksion të zbatimit të programeve të ri-integrimit për kategorinë e personave me liri të kufizuar pas lirimit të tyre, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka qenë aktive në ndërmarrjen e nismave të bashkëpunimit me institucione përgjegjëse dhe aktorë aktiv në çështjet e ri-integrimit të personave në konflikt me ligjin.

Shërbimi i provës

Institucioni i Shërbimit të Provës ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve që kanë të bëjnë me misionin e vet Institucionit, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, lirive themelore, si dhe rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve dhe krijimin e një sistemi të sigurt dhe të efektshëm për të gjithë shoqërinë nëpërmjet zhvillimit të programeve të rehabilitimit social.

Ne kuader te reformes ne drejtesi eshte hartuar projekt ligji "Per sherbimin e proves", i cili synon jo vetëm ne rregullimin ligjor te aktiviteteve të deritanishëm të Shërbimit të Provës por synon gjithashtu përcaktimin shprehimisht te detyrimeve të reja për punonjësit e këtij institucioni, të cilat kanë për qëllim garantimin e standardeve të përcaktuara në mbrojtje të të dënuarve sipas rekomandimeve të Këshillit të Evropës.

Të drejtat e pronës

Në zbatim të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e Pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" janë miratuar nje pjesë e konsideruesheme e akteve nënligjore. Agjencia e Trajtimit të Prones ka të parashikuara si objektiva për vitin 2017:

- Të ekzekutoj vendimeve përfundimtare për kompensim;
- Të trajtoj kërkesat/dosjet pa vendim;
- Të kryej shperndarjen e fondit të të ardhurave nga ALUIZNI.
- Të mbroj interesat e ATP-së në proceset gjyqësore.

Mbrojtja e Pakicave

Hartimi i projektligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare është një angazhim i Qeverisë shqiptare dhe projekti do t’i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave brenda muajit dhjetor 2016. Gjithashtu institucionet përkatëse do të identifikojnë edhe aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e projektligjit mbi pakicat, me qëllim përgatitjen e tyre gjatë vitit 2017.

1.2 Çështjet Rajonale dhe Detyrimet Ndërkombëtare

Shqipëria luan një rol të rëndësishëm dhe konstruktiv në rajon. Interesi i saj kryesor është një rajon i qëndrueshëm ku paqja, marrëdhëniet social-ekonomike dhe kulturore, si dhe marrëdhëniet e qëndrueshme të përfitimit të ndërsjellë me fqinjët të mbizotërojnë. Marrëdhëniet e mira të fqinjësisë dhe bashkëpunimi me vendet e rajonit dhe, në veçanti, me vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të jenë një nga prioritetet e politikës së jashtme shqiptare, sidomos, në kuadër të procesit të integrimit në BE.

Shqipëria është duke treguar një angazhim dhe përfshirje pro-aktive, duke nxitur më tej bashkëpunimin rajonal dhe duke nxitur axhendën e interkonjeksionit dhe ndërlidhjes midis njerëzve, përmes procesit të Berlinit dhe iniciativave rajonale. Shqipëria aktualisht është e përfshirë plotësisht në zbatimin e dy iniciativave të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor (BP), të tilla si, Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF) dhe Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO) në BP. Të dyja këto iniciativa të rëndësishme do të zhvillohen në Tiranë dhe pritet të kenë një ndikim të fortë pozitiv, sidomos në pjesëmarrjen e shoqërisë civile në zbatimin e agjendave të bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Gjithashtu, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare, qeveria shqiptare do të angazhohet plotësisht për të rritur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, duke iu përgjigjur programeve të partnerëve rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë fushë, në përputhje dhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (nenet 1, 2, 4, 13 dhe 81 i MSA-së). Veç kësaj, ajo do të marrë të gjitha hapat e nevojshëm, si në kuadrin ligjor dhe institucional për ta bërë bashkëpunimin më efektiv dhe të plotë në këtë fushë.

Objektivi i Shqipërisë është që nëpërmjet angazhimit aktiv në të gjitha forumet dhe nismat rajonale të kontribuojë me qëndrime parimore dhe të balancuara për çështje të ndryshme. Nëpërmjet aktivitetit të saj në këto forume rajonale, Shqipëria synon promovimin e zhvillimit ekonomik rajonal përmes projekteve të përbashkëta në fusha të tilla si energjia dhe transporti.

Shqipëria do të marrë më tepër përgjegjësi në aspektin e bashkëpunimit rajonal dhe do të rrisë praninë e saj aktive dhe kontributin në iniciativat rajonale.
Në vijim të Konferencës së Vjenës (27 gusht 2015) dhe të Deklaratës së Përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO-WB) Shqipëria po luan një rol aktiv për realizimin e këtij objektivi, sipas modelit të Zyrës Rinore Franko-Gjermane (FGYO). Selia e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim me Rininë është vendosur në Tiranë. Ngritja e Zyrës Rajonale të Rinisë është pjesë e iniciativës së përbashkët të Kryeministrave të Shqipërisë dhe Serbisë, me qëllim mbështetjen e shkëmbimeve kulturore në Ballkanin Perëndimor. Mbështetja për krijimin e Zyrës (RYCO-WB) u nënshkrua në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Paris, më 4 korrik 2016.

Fondi i Ballkanit Perëndimor dhe Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor do të kenë një impakt pozitiv, veçanërisht për përfshirjen e shoqërisë civile në zbatimin e agjendës së bashkëpunimit rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Qeveria shqiptare do të vazhdojë të marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që lidhen me zbatimin e suksesshëm të projekteve (TAP) Gazsjellësit Trans Adriatik - dhe (IAP) Ionian Adriatic Pipeline.

Shqipëria vazhdon të lobojë për përfaqësimin e Kosovës në organizatat rajonale dhe nismat që kontribuojnë për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon.Vendi ynë do të vazhdojë të nxisë marrëdhëniet e shkëlqyera dhe vëllazërore me **Republikën e Kosovës** me synim rritjen ekonomike, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përshpejtimin e procesit të integrimit Evropian. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë dialogun e vazhdueshëm të nivelit të lartë mes Kosovës dhe Serbisë. Shqipëria ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë fort Kosovën në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe në integrimin Euroatlantik të saj.

Objektiva përgjatë vitit 2017 në fushën e politikës së Jashtme do të jenë:

- Njohjen e mëtejshme ndërkombëtare e shtetit të Kosovës, pjesëmarrja dhe anëtarësimi i saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare;
- Pjesëmarrjen aktive në procesin e bashkëpunimit rajonal (nismat dhe organizatat rajonale);
- Kryesiminnë disa nisma rajonale dhe organizata ndërkombëtare;
- Realizimine kontributit politik të Republikës së Shqipërisë në kuadër të NATO-s si vend anëtar me të drejta të plota;
- Zbatimin e detyrimeve të anëtarësimit në organizatat e forumet shumëpalëshe, ku jemi palë, si dhe kontributi i vendit tonë si anëtare e Këshillit të të Drejtave të Njeriut;

- Zbatimi i detyrimeve për çështjet e sigurisë, parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftëtarëve të huaj terroristë.

2. KRITERI EKONOMIK

Ky seksion i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian jep një vlerësim dhe tablo të punës, arritjeve dhe përparimit të Shqipërisë në zbatimin e reformave ekonomike, si parakusht për përmbushjen e kritereve të Kopenhagenit. Gjithashtu, kjo pjesë e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, duke qenë në përputhje të plotë me Programin Kombëtar të Reformës Ekonomike dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, ve theksin te prioritetet për periudhën në vijim, me qëllim forcimin e konkurrueshmërisë dhe funksionimit të ekonomisë së tregut. Që Shqipëria të integrohet me sukses në BE, është tepër e rëndësishme që të zbatohen plotësisht reformat e nevojshme ekonomike, politike dhe institucionale.

2.1 Ekonomia e tregut funksionale

Ekonomia shqiptare u zgjerua me 3.21% në terma vjetorë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016. Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë degët e ekonomisë si *Tregti Hotele dhe Restorante dhe Transporti* me +0,70 pikë përqindje, *Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative* me +0,51 pikë përqindje, aktiviteti *Pasuritë e paluajtshme* me +0,43 pikë përqindje, *Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia* me +0,35 pikë përqindje, *Informacioni* dhe *Komunikacioni* me +0,23 pikë përqindje, *Industria, Energjia dhe Uji* me +0,18 pikë përqindje, *Shërbimet e tjera* me +0,17 pikë përqindje, *Ndërtimi* me +0,16 pikë përqindje dhe *Aktivitetet financiare dhe të Sigurimit* me +0,09 pikë përqindje.

Po ashtu, kontribuoi në këtë ecuri edhe rritja e konsumit të popullatës dhe të investimeve private si element kryesorë. Kushtet dhe standartet e lehtësuara të financimit nga bankat tregtare për individët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, normat e ulëta të interesit, klima më e përshtatshme e biznesit dhe projektet e rëndësishme me financim të huaj kanë qenë faktorët përcaktues në këtë dinamikë.

Negativisht në rritjen ekonomike kanë ndikuar sektorët si: *Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi* me -0,32 pikë përqindje. Taksat Neto mbi produktet kontribuan pozitivisht me +0,72 pikë përqindje.
Konsumi final i popullatës, i cili përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi në tremujorin e dytë 2016 u rrit me 3,98 % krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2015. *Konsumi final i qeverisë,* në tremujorin e dytë 2016 u rrit me 1,68 % krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2015. Komponenti i *Formimit bruto të kapitalit fiks* u rrit me 4,37 % krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2015. *Eksportet e mallrave* dhe *shërbimeve** u rritën me 3,86 % krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2015 ndërsa *Importet e mallrave* dhe *shërbimeve* u rritën me 19,76 % krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2015.

Sektori i jashtëm po ashtu ka dhënë një kontribut negativ gjatë tremujorit të dytë. Eksportet reale të mallrave kanë shfaqur tendenca rënëse si pasojë e kushteve jo të favorshme të

kërkesës së huaj dhe të çmimeve ndërkombëtare. Nga ana tjetër, importet kanë shfaqur prirje rritëse.

Ritmet e rritjes së ekonomisë priten të përshpejtohen gjatë tremujorëve në vijim. Nga pikëpamja e strukturës, pritet që konsumi i popullatës dhe investimet private të vazhdojë të japin kontributin kryesor në ecurinë e ekonomisë. Sektori publik parashikohet të japë një kontribut të lehtë negativ në kushtet e politikës fiskale konsoliduese. Kontributi i sektorit të jashtëm gjithashtu vlerësohet të jetë negativ. Ky rezultat është i lidhur kryesisht me pritjet për vijimësinë e zgjerimit të importeve gjatë tremujorëve në vazhdim.

Zhvillimet pozitive të ekonomisë janë shoqëruar me tregues të përmirësuar të tregut të punës. Në fund të tremujorit të dytë, norma e papunësisë shënoi vlerën 15.9% (për grup moshën 15-64 vjeç), një vlerë më e vogël si krahasuar me një vit më parë ashtu edhe me tremujorin paraardhës. Punësimi u rrit në masën 6.8% në terma vjetorë me kontribute pozitive nga të gjithë sektorët e ekonomisë.

Në periudhën afatmesme, ekonomia shqiptare pritet të përshpejtojë prirjen e saj rritëse. Kjo ecuri pritet të ndihmohet prej kushteve të lehtësuara monetare, politikës konsoliduese fiskale, e cila krijon hapësira më të mëdha për kreditimin e biznesit dhe për uljen e primeve të rrezikut, dhe prej përmirësimit të klimës së biznesit. Megjithatë, duhet theksuar se ky parashikim qendror është i shoqëruar me rreziqe të ndryshme, të zhvendosura për poshtë, që mund të godasin ekonominë. Kështu, vijimësia e dobësisë së kërkesës së jashtme për produkte shqiptare edhe në periudhën afatmesme, në kushtet e vështirësive ekonomike në vendet e Eurozonës dhe e çmimeve të ulta të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare, mund të ndikojnë në ecurinë e eksporteve të Shqipërisë dhe në zvogëlimin e prodhimit në vend. Në të njëjtën kohë, intensiteti i kreditimit për sektorin privat në afat të mesëm mund të kushtëzohet prej suksesit në uljen e kredive më probleme në ekonomi.

Ekonomia shqiptare ka themele të shëndosha ekonomike dhe financiare, pavarësisht kontekstit sfidues makroekonomik. Presionet e ulëta inflacioniste në muajt e parë të vitit dhe zhvendosja për poshtë të balancës së rreziqeve, kërkuan reagimin e politikës monetare. Norma bazë e interesit u reduktua me 0.5 pikë përqindjeje në total në muajt mars e prill, duke zbritur në nivelin 1.25%.

Përgjatë gjysmës së parë të vitit 2016, zhvillimet e deri tanishme ekonomike tregojnë se ritmi rritës i ekonomisë shqiptare po përshpejtohet dhe se hendeku i negativ i prodhimit po ulet gradualisht. Ecuria e ekonomisë ka gjeneruar presione për shtimin e punësimit. Megjithatë, presionet për rritjen e pagave dhe të kostove të prodhimit mbeten ende të dobëta. Gjithashtu, ambienti i jashtëm përcjell presione të dobëta inflacioniste në vend. Për shkak të materializimit të goditjeve të përkohshme të ofertës gjatë muajve janar-prill 2016 të çmimet e konsumit shënuan norma të ulëta. Efekti i këtyre goditjeve u shua gjatë periudhës maj-gusht dhe për rrjedhojë inflacioni nisi një prirje rritëse. Norma më e fundit e inflacionit rezultoi 2.0% në muajin gusht 2016. Megjithatë, inflacioni mbetet ende nën objektiv e Bankës së Shqipërisë dhe vazhdon të përcaktohen nga rritja e ekonomisë nën potencial, nga presionet

dizinflacioniste nga ambienti i huaj, dhe nga natyra adaptive e pritjeve inflacioniste. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë reagoi dy herë gjatë vitit 2016 duke ulur normën bazë të interesit duke synuar kontrollimin e pritjeve inflacioniste dhe mundësimin e kthimit të inflacionit në objektiv në periudhën afatmesme.
Gjatë këtyre tre viteve, qeveria shqiptare do të fillojë uljen e borxhit publik nga 70.9% që parashikohet të jetë në fund të vitit 2016, në 59.3% të PBB-së deri në vitin 2019. Faktorët kryesorë që do të mbështesin arritjen e objektivit të uljes së borxhit janë: (i) lufta e vijueshme dhe pa tolerancë ndaj evazionit fiskal; (ii) reformimi i mënyrës së përdorimit të fondeve publike me qëllim rritjen e eficencës dhe efektivitetit të tyre; si dhe (iii) ndërmarrja e reformave të rëndësishme tatimore.

Për periudhën 2016 – 2018, ritmet e rritjes reale të PBB-së priten të përshpejtohen më tej. Kërkesa e brendshme pritet të jetë nxitësi kryesor i rritjes së projektuar. Kjo e fundit pritet të mbështetet prej politikës monetare zgjeruese, prej përmirësimit të besimit në ekonomi, prej rritjes së kreditimit dhe prej zgjerimit të investimeve të huaja direkte. Hendeku i prodhimit pritet të mbyllet në gjysmën e dytë të vitit 2017. Mbyllja e hendekut të prodhimit, e shoqëruar me shfrytëzimin më të plotë të kapaciteteve prodhuese në vend, pritet të ndikojë në rritjen e punësimit, të pagave dhe të marzheve të fitimit. Për rrjedhojë, presionet inflacioniste që burojnë nga ekonomia e brendshme pritet të shtohen. Projeksionet më të fundit sugjerojnë për një prirje rritëse të inflacionit përgjatë tremujorëve në vijim, duke arritur në objektivin e Bankës së Shqipërisë në një periudhë afatmesme.

2.1.1 Prioritetet

Në përputhje me rekomandimin e Komisionit Evropian në Raport 2016 për Shqipërinë, prioritet në fushën e shërbimeve bankare dhe financiare sa i përket kriterit ekonomik është:

- *forcimi i stabilitetit të sektorit financiar duke zbatuar planin e veprimit të kredive me probleme dhe zhvillimi i një strategjie afatmesme për të nxitur përdorimin e monedhës vendase*;

2.1.2 Zhvillimet në lidhje me bilancin e pagesave

Deficiti i llogarisë korente për gjysmën e parë të vitit 2016 ishte 578 milionë euro. Ky deficit është zgjeruar me rreth 56.9% në terma vjetore. Si raport me PBB-në nominale, deficiti i llogarisë korente u vlerësua në rreth 11%.

Sipas zërave të nën-llogarive, kontributin kryesor në zgjerimin e deficitit të llogarisë korente e ka dhënë deficiti më i lartë i eksportit të mallrave dhe nivelet më të ulta të suficitit të të ardhurave dytësore. Nga ana tjetër, llogaria shërbimeve dhe e të ardhurave primare dhanë një kontribut të kahut të kundërt. Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve në tërësi u zgjeruan me mesatarisht 2% gjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Importet e mallrave dhe të shërbimeve përjetuan një rritje të shpejtë duke u zgjeruar me mesatarisht 12% gjatë të njëjtës periudhë. Si

rrjedhojë, deficiti i përgjithshëm tregtar u zgjerua mesatarisht me 31.1% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2015. Për sa i përket nën-kategorive të tjera të llogarisë korrente, bilanci negativ i llogarisë së të ardhurave primare përjetoi ngushtim, ndërkohë që bilanci pozitiv i të ardhurave dytësore gjithashtu u zvogëlua. Në rastin e të ardhurave dytësore, flukset më të larta hyrëse të remitancave dhanë kontributin kryesor në ecurinë e regjistruar.

Hyrjet neto të llogarisë së kapitalit arritën 13.8 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2016, nga 47.3 milionë euro gjatë gjysmës së parë të vitit të kaluar. Në llogarinë financiare, pozicioni neto shënoi një rritje vjetore prej 21.7% dhe duke u shtuar me rreth 77 milionë euro. Hyrjet neto në llogarinë e kapitalit dhe në atë financiare kanë financuar mesatarisht 75% të deficitit të llogarisë korente. Investimet e huaja direkte neto u pakësuan me rreth 10.6% në terma vjetorë si pasojë e zvogëlimit të investimeve në industrinë e nxjerrjes së naftës. Defiçiti i llogarisë korente u financua kryesisht nëpërmjet flukseve jo-borxh krijuese. Varësia nga hyrjet rritëse të borxhit ka rënë disi krahasuar me gjysmën e parë të vitit të mëparshëm. Mjetet e rezervës janë pakësuar me 49.6 milionë euro gjatë gjysmës së parë të këtij viti.

2.1.3 Klima e biznesit

- Këshilli Kombëtar i ekonomik është një platformë plotësisht funksionale që institucionalizon diskutimet dhe bashkëveprimet midis institucioneve shtetërore dhe komunitetit të biznesit. Ne vitin 2016 janë zhvilluar 2 mbledhje ku çështjet për diskutim kanë qënë: paketa fiskale dhe plani i zhvillimit të turizmit.

- Këshilli i Investimeve është krijuar në bazë të VKM Nr 294, datë 08.04.2015 "Për krijimin e Këshillit të Investimeve". Këshilli Investimeve është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e BERZH për intensifikimin e dialogut midis qeverisë dhe sektorit privat, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të promovuar qeverisjen e mirë. Këshilli i investimeve ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje me fokus : reformën e derrugullimit, informalitetin, formalizimin e bujqësisë .

- AIDA ka ngritur në kuadër të paketës stimuluese të krijuar nga Qeveria shërbimin (Help Desk), cili i dedikohet plotësimit të nevojave të NVM-ve, përfshirë këtu ndërmarrjet "fason" . Kështu, me anë të shërbimit Help-Desk, janë informuar, këshilluar dhe ndihmuar një numër i madh i NVM-ve, lidhur me hulumtimin e tregut, planet e biznesit, partnerët e biznesit, panaire ndërkombëtare, takime B2B, etj.

2.1.4 Rezervat ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016, borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë arriti një total prej EUR 7,880 milionë euro duke u vlerësuar në 75.1% ndaj PBB-së nominale dhe duke u rritur me 9% në terma vjetorë. Sipas ndarjes sektoriale, raporti i borxhit të qeverisë në borxhin e jashtëm total është 42.6%; ai i korporatave depozituese është 16.5%; sektorët e tjerë 16.5%;

IHD-të 23.5%; dhe autoriteti monetar 0.9%. Sipas instrumenteve të investimit, kategoria e "investimeve të tjera" mbulon rreth 61.6% të stokut total të borxhit të jashtëm. Ndërkohë, sipas strukturës të maturitetit, borxhi afatgjatë mbulon 80.9% të totalit të borxhit të jashtëm bruto, duke u rritur me 1.3 pikë përqindje krahasuar me fundin e tremujorit të dytë të vitit 2015.

Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2016, stoku i rezervave ndërkombëtare bruto ishte 2,803 milionë euro, duke u rritur me 17.4% në terma vjetorë. Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervës valutore shfaqen në nivele të kënaqshme. Kështu raporti i stokut të rezervave ndërkombëtare ndaj borxhit afatshkurtër rezulton 170%, ku niveli minimal i qëndrueshmërisë është 100%. Në të njëjtën kohë, stoku i rezervës valutore është i mjaftueshëm të mbulojë 7 muaj të importeve të mallrave dhe shërbimeve.

.

2.1.5 Kuadri i kursit të këmbimit dhe zhvillimet e fundit

Banka e Shqipërisë zbaton një regjim të kursit të lirë të këmbimit ku çmimi i monedhave të huaja përcaktohet lirisht prej kërkesës dhe ofertës për to.

Monedha vendase ka shfaqur një prirje mbiçmuese kundrejt monedhave kryesore ndërkombëtare gjatë vitit 2016. Gjatë periudhës janar-gusht 2016, Leku është mbiçmuar me mesatarisht 3.4% në terma nominale efektive[1], duke reflektuar një vlerë më të lartë të monedhës vendase kundrejt të gjithë monedhave kryesore ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe, Leku u mbiçmua me 1.7% në terma vjetorë kundrejt euros. Pavarësisht zgjerimit të deficitit tregtar, tregu vendas është karakterizuar nga një ofertë e lartë e monedhës Euro kryesisht për shkak prurjeve të larta prej turizmit. Deri në muajin maj, kursi i këmbimit Euro/Lek ishte i stabilizuar në mesataren 138.4. Efekti sezonal veror i këtij viti ishte më intensiv dhe kulmoi në muajt korrik e gusht ku kursi i këmbimit Euro/Lek arriti nivelin 135.9. Megjithatë, shenjat e para të përmbysjes së këtij efekti sezonal kanë filluar të vërehen në muajin shtator.

Kursi i këmbimit të Lekut kundrejt Dollarit amerikan vijoi të shfaqë luhatshmëri të lartë, i ndikuar kryesisht prej zhvillimeve të kursin e këmbimit Euro/Dollar në tregjet ndërkombëtare. Në linjë me mbiçmimin e Euros kundrejt dollarit amerikan, Leku forcoi pozicionin e tij kundrejt Dollarit amerikan me mesatarisht 1.8% në terma vjetore gjatë periudhës janar-gusht të vitit 2016.

[1] Matja KNEK – Kursi Nominal Efektiv i Këmbimit – vlerësohet bazuar në një shportë monedhash ndërkombëtare (Euro, Dollar amerikan, Lira turke dhe Renmibi kinez) dhe në pesë partnerë tregtar ndërkombëtarë (Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kina). Një rritje e KNEK-ut nënkupton një nënçmim të Lekut.

2.1.6 Papunësia

Pjesëmarrja në fuqinë e punës, e vlerësuar në rreth 65.9% në terma mesatarë gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, ndoqi prirjen rritëse të shënuar në vitin 2015. Fuqia e punës u rrit, si rezultat i rritjes së numrit të personave të punësuar, krahasuar me të njëjtën periudhë 1 vit më parë. Sherbimet e tregut dhe industria përpunuese shënuan rritjen vjetore më të lartë në punësim gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016.

Të dhënat për tregun e punës tregojnë për një dinamikë pozitive përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2016. Shkalla e papunësisë ishte 15.9% në këtë tremujor, ose 1 pikë përqindje më e ulët se një tremujor më parë (dhe1.4 pikë përqindje më e ulët se tremujori i dytë i vitit 2015). Punësimi u rrit me 5.8 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2015 dhe me 1 pikë përqindje më shumë se tremujori i mëparshëm. Shkalla e forcës së punës në tremujorin e dytë të vitit 2016, ishte 2.1 pikë përqindje më e lartë (në terma vjetore). Forca e pjesëmarrjes në punë përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2016 ishte 65.8%. Kjo vlerë ishte më e lartë se vlera 63.7% që u regjistrua në tremujorin e dytë të vitit 2015.

Tabela 2. Të dhënat e tregut të punës (mosha 15 -64 vjeç).

(In %)		**Norma e Papunësisë**	**Norma e Punësimit**	**Norma e pjesëmarrjes në Fuqinë e Punës**
2012	**T1**	13.4	58.2	67.1
	T2	13.7	56.8	65.8
	T3	14.1	54.2	63.1
	T4	14.1	54.4	63.4
2013	**T1**	14.8	52.8	62.0
	T2	16.4	49.9	59.7
	T3	17.2	48.6	58.6
	T4	17.1	48.2	58.1
2014	**T1**	18.6	47.1	57.9
	T2	17.7	50.5	61.3
	T3	17.4	52.3	63.4
	T4	18.0	52.1	63.6
2015	**T1**	17.3	52.1	63.0
	T2	17.3	52.7	63.7
	Q3	17.5	53.3	64.7
	Q4	17.7	53.7	65.3
2016	**Q1**	16.9	54.8	65.9
	Q2	15.9	55.3	65.8

2.1.7 Inflacioni

Presionet inflacioniste kanë rezultuar të ulëta gjatë tetë muajve të parë të vitit 2016. Veçanërisht gjatë katër muajve të parë të vitit, ndikimet kryesisht të jashtme dhanë efekt në regjistrimin e vlerave mjaft të ulta të normës së inflacionit. Efektet e këtyre ndikimeve ashtu sikundër pritej, rezultuan të përkohshme. Nga ana tjetër, edhe kontributet e brendshme kanë rezultuar në rritje për shkak ngushtimit të hendekut të prodhimit.

Inflacioni mesatar vjetor ishte 1.0% për periudhën Janar – Gusht 2016, duke mbetur më ulët se objektivi i Bankës së Shqipërisë. Këto fenomene janë lidhur me ndikime të dobëta nga çmimet ndërkombëtare për lëndët e para. Pas normave të ulta të periudhës shkurt-prill (0.3%), norma e inflacionit ka ndjekur një trajektore rritëse në muajt në vazhdim për të arritur vlerën 2% në muajin gusht.

Në terma të kontributeve, inflacioni ka vijuar të përcaktohet nga luhatjet e çmimeve të ushqimeve. Më konkretisht, kontributet e ushqimeve të papërpunuara kanë qenë mjaft të ulta dhe për gjithë periudhën në fjalë rezultojnë me një kontribut prej 1.1 pikë përqindjeje. Gjithashtu, kontributet e ushqimeve të përpunuara kanë pasur kah negativ për katër muajt e parë të vitit. Ndërkohë, për periudhën prill-gusht, kontributet e ushqimeve të papërpunuara kanë qenë më të larta dhe kontributet e ushqimeve të përpunuara kanë kaluar në territor pozitiv me tendencë rritëse.

Sinjalet pozitive nga kërkesa e brendshme janë reflektuar në një trajektore rritëse të inflacionit bazë. Për tetë muajt e parë të vitit 2016, inflacioni bazë ishte -0.27%. Ai rezulton më i ulët se inflacioni bazë i regjistruar gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Për shkak të hendekut ende negativ të prodhimit, ai mbetet nën mesataren e tij historike.

Banka e Shqipërisë parashikon një rritje graduale të inflacionit, duke iu afruar kështu objektivit brenda horizontit kohor të veprimit të politikës monetare. Në periudhën afatshkurtër, inflacioni parashikohet të mbetet nën objektiv si pasojë e rritjes ekonomike nën potencial dhe si pasojë e presioneve të ulta inflacioniste nga jashtë.

2.1.8 Politika monetare

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë hartohet dhe zbatohet në përmbushje të objektivit për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve sipas kuadrit të shënjestrimit të inflacionit. Procesi vendimmarrës udhëhiqet nga devijimi i inflacionit nga objektivi prej 3% në periudhën afatmesme. Dobësia ciklike e ekonomisë dhe presionet e dobëta inflacioniste kanë kërkuar ndjekjen e një politike monetare stimuluese gjatë viteve të fundit. Kjo politikë synon të mbështesë rritjen e ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda horizontit të veprimit të saj. Norma bazë e interesit është ulur më tej në muajt prill e maj, duke e çuar atë në 1.25% nga 1.75% në fillim të vitit. Gjithashtu, korridori i lehtësirave të përhershme u ngushtua me 1.50 pikë përqindje, duke synuar përcjellje më të mirë të politikës monetare dhe uljen e luhatshmërisë së normave të interesit. Stimuli monetar ka kontribuar në reduktimin e kostove të financimit dhe në përmirësimin e flukseve të parasë të agjentëve ekonomikë. Komunikimi i politikës monetare mbështetet në orientimin e tregut për qëndrimin e politikës monetare në të ardhmen (forward guidance). Banka e Shqipërisë ka komunikuar se stimuli monetar parashikohet të mbetet i pandryshuar gjatë vitit 2016, duke synuar uljen e primeve të rrezikut dhe përmirësimin e transmetimit të politikës monetare në tregjet financiare. Normat e interesit janë në nivelet më të ulëta historike dhe kanë nxitur rritjen e kërkesës për kredi në monedhën vendase. Rritja e saj ka mbështetur rritjen e kreditimit të sektorit privat në dy vitet e fundit. Duke përjashtuar efektin e kredive me probleme, rritja vjetore e kredisë për sektorin privat është 3.7% në korrik, nga 1.5% për vitin 2015. Megjithatë, kreditimi mbetet i ngadaltë

për shkak të kërkesës së ulët dhe rrezikut të lartë të kredisë. Zbatimi i planit kombëtar për uljen e kredive të këqija pritet të sjellë uljen e këtij rreziku dhe të reflektohet në përmirësimin e ofertës dhe në rritjen më të shpejtë të kredisë.

2.1.9 Vlerësimi i miksit të politikës makroekonomike

Dobësia ciklike e ekonomisë shqiptare ashtu si edhe dobësitë fiskale kanë përcaktuar kombinimin e politikave makroekonomike. Rritja e ekonomisë nën-potencialin e saj afatgjatë dhe normat e inflacionit nën objektivin e Bankës së Shqipërisë kanë ndikuar në kahun zgjerues të politikës monetare. Në anën tjetër, borxhi i lartë publik dhe implikimet që ai ka në qëndrueshmërinë afatgjatë të balancave fiskale kanë kushtëzuar kahun konsolidues të politikës fiskale.

Politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë ka për qëllim rikthimin e inflacionit në objektiv në harkun kohor afatmesëm. Në të njëjtën kohë, kjo politikë synon sigurimin e mbështetjes kundërciklike ndaj ekonomisë, duke gjeneruar kushte të nevojshme të financimit, si dhe duke incentivuar shpenzimet dhe investimet për të mbështetur kërkesën agregate. Në këtë mënyre, politika monetare lehtësuese ka ndihmuar në sigurimin e një ambienti të favorshëm për një rritje ekonomike më të përshpejtuar

Në anën tjetër, kahu konsolidues i politikës fiskale ka ndihmuar në zgjerimin e burimeve financiare për të mundësuar kreditimin e mëtejshëm të sektorit privat. Në afat të gjatë, konsolidimi fiskal pritet të kontribuojë pozitivisht në reduktimin e primeve të rrezikut në ekonomi dhe duke forcuar qëndrueshmërinë e ekonomisë ndaj goditjeve të papritura.

Kombinimi aktual i politikave makroekonomike është optimal. Në total, drejtimi i politikave mbetet zgjerues, me qëllim mbështetjen e kërkesës agregate në afat të mesëm, gjenerimin e rritjes së qëndrueshme pa presione mbi inflacionin dhe forcimin e treguesve të tregut të punës në ekonomi. Ky kombinim i politikave publike adreson dobësitë në lidhje me një borxh të lartë publik, ndërkohë që krijon hapësira për kreditim të mëtejshëm të sektorit privat, me qëllim përforcimin e konsumit dhe investimeve.
Sipas Ministrisë së Financave, gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2016, rritja ekonomike shënoi një nivel relativisht të lartë rritjeje 3.21%, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Në procesin e përgatitjes së politikave të përshtatshme, çështjet kyçe kanë qenë ruajtja e stabilitetit të çmimeve të konsumit, borxhit publik dhe sistemit financiar.

Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe në konsultim me bankat, BB dhe FMN, qeveria ka hartuar nja plan masash që synon uljen e huave me probleme. Ky plan u finalizua në vjeshtën e vitit 2015 dhe përmban masa ligjore dhe rregullatore të cilat do të lehtësojnë ndjeshëm procesin e administrimit të rrezikut të kreditit nga sektori bankar. Banka e Shqipërisë gjykon se zgjidhja e çështjeve që lidhen me kreditë me probleme dhe ekzekutimin e kolateralit, do të ketë një ndikim parësor në përmirësimin e ofertës për kredi.

2.2.10 Politika fiskale

Politika Fiskale do të jetë kryesisht e fokusuar drejt konsolidimit fiskal në periudhën afat-mesme. Objektivi kryesor është rduktimi i nivelit të borxhit nën 60% të PBB-së për periudhën afatmesme. Gjithashtu, do të synohet të përcaktohen arsyet kryesore që lidhen me deficitin nëpërmjet politikave mbi shpenzimet dhe mbledhjes së taksave dhe nëpërmjet zgjerimit të manaxhimit të financave publike, si dhe nëpërmjet reformave mbi grumbullimin e të ardhurave. Skenari bazë synon të arrijë një nivel të deficitit prej 2.2% të PBB-së për vitin 2016, nga 4% të PBB-së që ishte në vitin 2015. Konsolidimi fiskal do të vazhdoj edhe në vitin 2017 dhe 2018 duke synuar nivelet prej 1.4 dhe 0.5 % të PBB-së.

Politika fiskale shtrënguese e planifikuar për periudhën afat-mesme do të reflektohet kryesisht një nivel të palëvizshëm të konsumit publik. Konsumi privat pritet të rimëkëmbët gradualisht, ndërkohë që besimi i konsumatorit pritet të përmirësohet dhe taksat e ndërmarra nga qeveria për vitin 2015 do të konsiderohen si masa drastike që nuk do të përsëriten në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, politika monetare akomoduese e planifikuar për periudhën afat-mesme, për aq kohë sa nivelet inflacioniste do të qëndrojnë të ulëta, do të mbështesin konsumin privat po ashtu edhe investimet.

Qeveria ka futur tashmë një paketë fiskale që prek kryesisht të ardhurat tatimore dhe administrimin tatimor. Autoritetet janë angazhuar fort për të paguar borxhet e akumuluara gjatë viteve të fundit, duke injektuar likuiditet të freskët në ekonomi. Njëkohësisht, po merren masat e duhura për të parandaluar akumulimin e detyrimeve në të ardhmen. Shqipëria ka nënshkruar me FMN-në një marrëveshje trevjeçare huaje, që pritet ta ndihmojë vendin të plotësojë nevojat financiare, ndërkohë që siguron mbështetjen e duhur për zbatimin me sukses të reformave strukturore. Në këtë aspekt, reformat e planifikuara dhe masat fiskale synojnë të përmirësojnë klimën e investimeve në vend. Të ardhurat pritet të rriten për shkak të ndryshimeve të politikës tatimore dhe përpjekjeve për të përmirësuar performancën e mbledhjes së taksave. Të ardhurat fiskale për periudhën janar-gusht të vitit 2016 ishin 265,766 milionë Lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015, të ardhurat fiskale shënuan rritje me 7.2%

2.1.11 Borxhi publik

Borxhi publik gjatë tetë muajve të vitit 2016 është karakterizuar nga një ecuri pozitive, kryesisht në aspektin e plotësimit të nevojave të Qeverisë për likuiditet, si dhe në aspektin e rritjes së qendrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe riskut. Gjithashtu, për tu përmendur vlejnë aktivitetet që janë ndërmarrë në kuadër të zhvillimit të tregut primar dhe krijimit të kushteve për zhvillimin e tregut sekondar.

Në kuadër të mbulimit të nevojave të Qeverisë për likuiditet, borxhi në terma nominal është rritur me 29.8 miliard lekë. Megjithatë, duke iu referuar deficitit buxhetor të planifikuar,

parashikimeve të rritjes ekonomike dhe kursit të këmbimit[2], në fund të vitit 2016 borxhi pritet të ulet me rreth 1 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar.

Ecuria e humarrjes neto në tregun e brendshëm gjatë tetë mujorit të vitit 2016 ka qenë pozitive pasi ka arritur të përmbush nevojën për financim në nivelin e 62.4% të planifikimit vjetor *(rreth 12.5 miliardë lekë).* Financimi i brendshëm është realizuar plotësisht nëpërmjet titujve afatgjatë dhe njëkohësisht është shoqëruar me maturim të titujve afatshkurtër, duke kontribuar në zgjatjen e jetëgjatësisë së borxhit *(jetgjatësia mesatare është rritur nga 706 ditë në fund të vitit 2015 në 767 ditë në gusht 2016)* dhe uljen e ekspozimit ndaj riskut të ri-financimit dhe atij të normave të interesit. Kërkesa për titujt shtetëror ka qenë relativisht e lartë, duke gjeneruar një raport mbulimi pozititiv *(1.28)* dhe duke dëshmuar një kërkesë relativisht më të lartë sesa oferta e Qeverisë.

Në kuadër të zhvillimit të tregut primar të titujve shtetërorë, menaxhimi i borxhit ka ndërmarr disa aktivitete të cilat konsistojnë në shmangien e fragmentimit të kërkesë së investitorëve, krijimin e madhësive benchmark dhe lehtësimin e procesit të zbulimit të çmimit të titujve. Në terma afat-mesëm dhe në terma afat-gjatë këto aktivitete mund të kenë ndikim pozitiv edhe në zhvillimin e tregut sekondar.

Në aspektin e kompozimit të portofolit të borxhit të brendshëm, gjatë vitit 2016 ka vazhduar diversifikimi i portofolit, duke vlejtur për tu përmendur shtimi i financimit nëpërmjet instrumentave 5 dhe 10 vjeçare, përkatësisht në shumat 9.6 dhe 11.4 miliard lekë. Ndërkohë, vërehet një rritje e peshës së intrumenteve me norma interesi fikse dhe rënie e atyre me norma interesi të ndryshueshme.

Kosto e borxhit të brendshëm për njësi është ulur ndjeshëm për shkak të rënies së vazhdueshme të normave të interesit në të gjitha segmentet e titujve qeveritarë *(kosto mesatare për njësi është ulur me rreth 0.8 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit të kaluar).* Nga ana tjetër, edhe kosto e përgjithshme është ulur, pavarësisht shtesës në stokun e borxhit afatgjatë, duke dëshmuar në përmirësimin e raporteve ndërmjet kostos dhe riskut. Kosto mesatare e borxhit të huaj nuk ka pësuar ndryshime, ndërkohë që ka një rritje të shërbimit në vlerë për shkak të rritjes së stokut krahasur me vitin e kaluar.

Borxhi i jashtëm, ai paraqitet i qëndrueshëm duke pësuar disa ndryshime relativisht të vogla në kuadër të diversifikimit të mëtejshëm të monedhave që e kompozojnë këtë portofol, si edhe në kuadër të rritjes së peshës së stokut me norma interesi koncesionale, kryesisht për shkak të disbursimeve të mbështetjes buxhetore.
Tetëmujori i vitit 2016 është karakterizuar nga një ritie e disbursimit të fondeve për projektet me financim të huaj duke u vlerësuar rreth 23% ritie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, disbursimet për mbështetjen buxhetore kanë qënë më të ulta se vitin e kaluar, por në përputhje të marrëveshjes me partnerët ndërkombëtarë (FMN).

---

[2] PBB i referohet kuadrit makro-fiskal 2017-2019 të miratuar me VKM Nr. 80, datë 03/02/2016;
Deficiti buxhetor i referohet Aktit Normativ të miratuar me ligjin Nr.85/2016, datë 29/07/2016;
Supozimet për kursin e këmbimit EUR/LEK=140, USD/LEK=127.

Republika e Shqipërisë vazhdon të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme me kreditorët e projekteve me financim të huaj duke paraqitur një nivel bashkëpunimi të lartë dhe duke përcjellë besim tek kreditorët nëpërmjet likuidimit të detyrimeve të saj në kohë.

2.1.12 Privatizimi

Procesi i privatizimit mbetet prioritet, sidomos në sektorët strategjikë që synojnë tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendas që do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik.

Më 10 mars të vitit 2016, u hapën ofertat për privatizimin e 100% të aksioneve të INSIG SH.A., ku u paraqitën katër ofertues. Oferta më e lartë, 16.1 milion euro u paraqit nga EUROSIG SH.A., e cila ishte pak më e lartë se sa vlerësimi i aksioneve të INSIG, bërë nga konsulenti BDO Albania LTD. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë vlerësimin e ofertave në bazë të kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 18.06.2015 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimin të aksioneve të shoqërisë INSIG SH.A.". Pas vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, u miratua, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 23.03.2016 "Për miratimin e procedurës së tenderimit për shitjen e paketës së aksioneve (100%), të zotëruara nga shteti në shoqërinë INSIG SH.A. Tiranë, dhe shpalljen fitues të tenderit shoqërinë Eurosig SH.A. Kontrata për shitjen e aksioneve të kompanisë aksionare INSIG SH.A., u nënshkrua mes Ministrisë së Financave dhe EUROSIG SH.A më, 1.06.2016.

Në gjysmën e parë të vitit 2016, nga shitja e 8 aseteve shtetërore u siguruan, në total, 93,686,844 lekë (rreth 680,000 euro). Shitja e aseteve bëhet nëpërmjet procedurës së ankandit publik ku ish-pronarët e tokës kanë të drejtën e parablerjes. Katër prej këtyre aseteve janë blerë nga pronarët e tokës që ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë përgatitur 20 dosje të privatizimit të aseteve shtetërore të përfshira në paketën e tretë të privatizimit. Paketa e tretë për Privatizim është pjesë e Planit të Veprimit për Privatizimin e Aseteve për periudhën 2016- 2020, miratuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, më 29.04.2016.

2.1.13 Sektori bankar

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, treguesit e veprimtarisë së sistemit financiar ishin të qëndrueshëm. Sektori bankar rezultoi me fitim dhe me tregues të mirë të kapitalit dhe likuiditetit. Segmentet e tjera të sistemit financiar kanë zgjeruar aktivitetin. Pesha e institucioneve financiare që kryejnë aktivitet jobankar në totalin e aktiveve të sistemit financiar shënoi rreth 10%, ku kontributin kryesor e japin fondet e investimeve. Sipas madhësisë së ekspozimeve të ndërsjella, vlerësohet që rreziku i drejtpërdrejtë i përcjelljes së rreziqeve në sektorin bankar prej segmenteve të tjera të sistemit financiar është i ulët; ndërsa qëndrueshmëria e sektorit bankar është me rëndësi kritike edhe për institucionet financiare jobankare. Gjatë periudhës, treguesit kryesorë të veprimtarisë së sistemit financiar ishin të qëndrueshëm, por ndërmjetësimi financiar u zgjerua më ngadalë. Ky i fundit i matur nga

raporti i aktiveve të sistemit ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) arriti nivelin 100.7%, duke shënuar rënie ndaj niveleve të dy viteve të fundit. Kontributin kryesor në këtë rënie e ka dhënë aktiviteti i sektorit bankar, i cili është zgjeruar me ritme më të ulëta se rritja e PBB-së. Struktura e aktiveve të sistemit financiar mbizotërohet nga bankat, aktivet e të cilave zënë rreth 90.8% të aktiveve të sistemit ose rreth 90.5% e PBB-së.

Banking Sector. Në gjysmën e parë të vitit 2016, gjendja dhe ecuria e sektorit bankar u paraqit e qëndrueshme. Sektori bankar zgjeroi veprimtarinë me ritme më të ulëta se një vit më parë, mbështetur kryesisht në investimet në letra me vlerë. Treguesit prudencialë në terma të aftësisë paguese, likuditetit dhe krijimit të fondeve rezervë për rreziqet përkatëse u shfaqën në nivele të përshtatshme, duke qenë në përputhje me kërkesat rregullatore. Cilësia e portofolit të kredisë ka ardhur në rënie, pavarësisht procesit të vazhdueshëm të fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave. Ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrollueshëm, por kërkon një monitorim dhe vlerësim të rregullt.

Në strukturën e aktiveve, zërat kryesorë janë "Veprimet me klientë," që përfaqësojnë aktivitetin kreditues, "Veprime me thesarin dhe ndërbankare" dhe "Veprime me letra me vlerë". Gjatë vitit të fundit, ndër to, rritjen më të shpejtë e ka shënuar zëri "veprime me letra me vlerë", duke reflektuar kryesisht stanjacionin e ecurisë së aktivitetit kreditues dhe kanalizimin e fondeve nga ana e sektorit bankar drejt investimeve me kthim relativisht më të lartë. Fondet rezervë të krijuara, kryesisht për cilësinë e aktiveve kanë rënë, përgjithësisht për shkak të procesit të fshirjes së kredive të humbura. Në anën e pasiveve, zërat kryesorë vijojnë të mbeten "Veprimet me klientë", që përfaqësojnë aktivitetin depozitues dhe "Burimet e përhershme", që përfaqësojnë fondet e veta vetë (kapitalin) e bankave.

Gjatë periudhës, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me 0.9%, në nivelin 1,329 miliardë lekë, duke përbërë rreth 90.5% të PBB-së. Në terma vjetorë, aktivet e sektorit bankar u rritën me 1.3% nga 4.8% një vit më parë. Zgjerimi i aktiveve u evidentua në formën e investimeve në letra me vlerë, kryesisht në tituj të borxhit qeveritar, por edhe në tituj të subjekteve jorezidente. Zotërimet e sektorit bankar në titujt e borxhit të qeverisë shqiptare janë rritur në 23.1% të totalit të aktivit, nga 22.3% një gjashtëmujor më parë.

Financimi i aktivitetit bankar sigurohet kryesisht nga depozitat, të cilat përbëjnë rreth 82.3% të totalit të aktiveve. Raporti hua/depozita shënon 54.3%. Baza e depozitave ka rënë lehtësisht në terma gjashtëmujorë (rreth 0.04%), si pasojë e rënies së depozitave në lekë, ndërsa në terma vjetorë ajo u zgjerua me 2.1%.

Në fund të periudhës, teprica e kredisë shënoi nivelin 597.4 miliardë lekë, duke qenë 2% më e lartë krahasuar me fundin e vitit 2015. Gjatë periudhës, janë fshirë nga bilancet e bankave rreth 5.9 miliardë lekë kredi të klasifikuara "të humbura". Nëse kredia e humbur nuk do të ishte fshirë, rritja e tepricës së kredisë gjatë periudhës do të ishte 3%. Në terma vjetorë, e ndikuar nga procesi i fshirjes së kredive të humbura , teprica e kredisë shënon një tkurrje prej 0.3% në fund të periudhës. E korrigjuar për vlerën e kredive të fshira, rritja vjetore e tepricës së kredisë do të ishte 3.1%.

Ecuria e tepricës së kredisë është mbështetur kryesisht nga zgjerimi i kredisë në lekë. Përveç prirjes së bankave për kreditim në monedhën vendase, ky zhvillim reflekton edhe peshën më të madhe që ka pasur kredia në valutë në totalin e kredive të fshira si "të humbura" nga bankat (rreth 74%). Gjatë periudhës, kreditimi në monedhën vendase u zgjerua me 3.9%, ndërsa ai në valutë shënoi rritje vetëm me 0.7%. Sipas afatit të maturimit, kredia afatgjatë ka dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e kredisë gjatë periudhës dhe në të njëjtën kohë, shfaq zgjerim të lehtë në terma vjetorë. Sipas subjekteve, kreditimi i individëve ruan ritme pozitive në terma vjetorë dhe gjatë periudhës.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit, vlera e depozitave prej rreth 1,100 miliardë lekë, ishte pothuaj e njëjtë me atë të fundit të vitit 2015, por rreth 2% më e lartë në krahasim me një vit më parë. Ritmi mesatar i rritjes vjetore të depozitave është ngadalësuar ndjeshëm dhe qëndron poshtë mesatares afatgjatë. Struktura e depozitave dhe norma vjetore e rritjes vazhdon të dominohet nga depozitat në valutë, të cilat u rritën me mesatarisht 5.4% ndërsa depozitat në lekë shënuan rënie me 0.4%. Si rezultat, në fund të periudhës, depozitat në valutë përfaqësonin rreth 52% të totalit të depozitave. Nëse nga vlera e depozitave në valutë përjashtohet efekti i ndryshimeve në kursin e këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë në fund të muajit qershor 2016 do të ishte 5.9%, ndërsa ajo e depozitave në total 2.4%.

Në qëndrueshmërinë e depozitave gjatë periudhës, ka kontribuar rritja e depozitave të individëve dhe rënia e depozitave të bizneseve. Depozitat e individëve, të cilat zënë rreth 85% të depozitave të sektorit bankar, u rritën mesatarisht 1.5% gjatë gjashtëmujorit të parë, duke qëndruar poshtë mesatares vjetore të tre viteve të fundit (prej 2.6%). Depozitat e bizneseve regjistruan një rënie me 4.5% prej nivelit të tyre në dhjetor 2015, megjithëse qëndrojnë 8.6% më lartë së vlera e tyre një vit më parë. Në krahasim me një vit më parë, midis depozitave të individëve në lekë dhe në valutë, dhe të bizneseve në lekë dhe në valutë, rritjen më të shpejtë e kanë shënuar depozitat e bizneseve në valutë, ndërsa depozitat e individëve në lekë kanë shënuar rënien më të madhe. Në fund të periudhës, depozitat në valutë përbëjnë rreth 50% të depozitave të individëve dhe rreth 63% të depozitave të bizneseve.

Rënia e normave të interesit është shoqëruar me tkurrje të depozitave me afat dhe me rritje të konsiderueshme të peshës dhe nivelit të llogarive rrjedhëse. Vlera e llogarive rrjedhëse pranë sektorit bankar, u rrit më tej gjatë periudhës duke qenë në fund të saj rreth 31.2% më e lartë se një vit më parë. Nga ana tjetër, depozitat me afat ranë gjatë periudhës si në vlerë, ashtu edhe në peshë (ndaj totalit të depozitave), ndonëse mbizotërojnë në vlerën e depozitave pranë sektorit bankar. Në krahasim me fundin e vitit të kaluar, depozitat me afat ranë me 22.7 miliardë lekë ose me 3.2%, dhe pesha e tyre zbriti në 63% të totalit të depozitave.

Rezultati financiar neto i sektorit bankar është pozitiv, por në rënie gjatë periudhës. Rënia me e shpejtë e të ardhurave nga interesi krahasuar me rënien e kostove të financimit ka ndikuar në uljen e të ardhurave neto nga interesi dhe marzhi neto i interesave. Shpenzimet në formën e provigjioneve për rrezikun e kredisë, dhe në tërësi, u rritën ndjeshëm, duke qenë faktor

kryesor pas rënies së fitimit në sektorin bankar. Veprimtaritë e tjera kanë pasur efekt të ulët në fitimin e sektorit bankar. Për sektorin, treguesit e kthimit mbi kapitalin (RoE) dhe të kthimit mbi aktivet (RoA) treguan rënie në terma vjetorë. Në qershor 2016, sektori bankar raportoi një rezultat financiar pozitiv prej rreth 5.1 miliardë lekësh, ose rreth 3.2 miliardë lekë më pak se një vit më parë. Pavarësisht se rritja e shpenzimeve për provigjione ishte faktor kryesor në këtë rënie të fitimit, aktiviteti kryesor bankar tregoi gjithashtu rënie, duke ndikuar në rënien e të ardhurave nga interesi. Treguesit kryesorë të rentabilitetit, kthimi mbi aktivet (ROA) dhe kthimi mbi kapitalin (ROE), u vlerësuan respektivisht në 0.8% dhe 8%, në rënie me përkatësisht 0.5 p.p. dhe 6.2 p.p. ndaj një viti më parë.

Gjatë periudhës, kapitalizimi i sektorit bankar u vlerësua në nivel të mirë dhe bankat kanë respektuar normën rregullatore të kërkuar për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Injektimi me kapital si dhe niveli i mirë i përfitueshmërisë së sektorit bankar, kanë ndikuar pozitivisht në ecurinë e kapitalit rregullator. Nga ana tjetër, kërkesat për kapital për rrezikun e kredisë dhe për investimet në subjekte jorezidente kanë rritur aktivet e peshuara me rrezik të sektorit bankar. Në fund të muajit qershor 2016, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit arriti nivelin 16.1%, nga 16.0% në fund të vitit 2015 dhe 15.9% një vit më parë. Aktivet e ponderuara me rrezik janë zgjeruar me rreth 3.9% krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2015, duke kontribuar në uljen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.6 p.p.. Nga ana tjetër, për shkak të injektimeve të kapitalit dhe vazhdimësisë së rezultatit financiar pozitiv, kapitali rregullator u rrit me 4.2%, duke përmirësuar raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.64 p.p.. Aktivet e ponderuara për rrezikun e kredisë janë zgjeruar me rreth 16.8 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2015, duke u ngjitur në nivelin 677.1 miliardë lekë., Kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe atë operacional kanë shënuar rritje krahasuar me fundin e vitit 2015. Ato janë rritur me përkatësisht 807.4 milionë lekë dhe 8.0 miliardë lekë, në nivelet 16.1 miliardë lekë dhe 83.9 miliardë lekë.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2016 shënoi përkeqësim të cilësisë së kredisë, kryesisht nga prurjet e reja në stokun e kredive me probleme për subjektin biznes në monedhë të huaj, përqendruar në grupin e bankave të mëdha. Rreziku i kredisë zbutet nga nivelet e mira të fondeve rezervë (provigjioneve), pavarësisht se norma e mbulimit me provigjione të kredive me probleme, ka rënë. Banka e Shqipërisë ka qenë aktive në procesin e zgjidhjes së kredive me probleme, duke thelluar bashkëpunimin me autoritetet publike dhe me sektorin bankar, për uljen e rrezikut të kreditit.

Gjatë periudhës, teprica e kredisë me probleme është zgjeruar me 11.7%, në nivelin 119.3 miliardë lekë, duke u reflektuar në zgjerimin e raportit të kredive me probleme. Prurjet e reja të kredive me probleme nuk kanë mundur të mbulohen nga kreditë e fshira në gjysmën e parë të vitit, duke rezultuar në zgjerim të stokut të kredive me probleme (RKP). Vlera e kredisë së fshirë në gjysmën e parë të vitit, shënon rreth 5.9 miliardë lekë.

Në fund të qershorit 2016, raporti i kredive me probleme (RKP) shënoi 19.96%, duke u zgjeruar me 1.7 p.p. ndaj nivelit në dhjetor 2015. Brenda strukturës së kredive me probleme, zgjerimi i konsiderueshëm i klasës nënstandard (në 30.8% të totalit të kredive me probleme,

nga 23.3% në dhjetor 2015) tregon se ka një fluks të ri në klasat e kredisë me probleme; nga ana tjetër, tranzicioni brenda klasave të kredisë me probleme shfaq migrimin drejt klasës së "humbur", e cila është zgjeruar me 2% gjatë periudhës, pa konsideruar efektin e kredive të fshira.

Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme ka rënë, ndaj ecuria e tij duhet të monitorohet me kujdes. Në qershor 2016, raporti i mbulimit me provigjione ra në 65.9% nga niveli 70.8% në dhjetor 2015 dhe 68.7% një vit më parë. Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të qëndrueshme dhe ruan përqendrimin e lartë të formës së kolateralit tek "pasuria e paluajtshme". Në qershor 2016, mbulimi me kolateral ra në nivelin 71.0%, nga 71.8% referuar muajit dhjetor 2015. Kreditë me kolateral pasuri të paluajtshme zënë 71% të kredive të kolateralizuara, dhe 51% të tepricës së kredisë. Në përgjithësi, cilësia e kredisë së kolateralizuar ka rënë gjatë periudhës, duke bërë që raporti i kredive me probleme të rritet me 1.2 p.p., në nivelin 20.7%.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë vijon të mbetet i lartë. Pavarësisht se në dy vitet e fundit sektori ka ngushtuar peshën e kredisë të pambrojtur nga ky rrezik ndaj totalit të kredisë në valutë, ajo vijon të jetë e konsiderueshme. Në qershor 2016, kredia e pambrojtur në valutë përbën 44.1% të tepricës së kredisë në valutë (1.4 p.p. më pak se dhjetor 2015) dhe 26.5% të tepricës totale të kredisë (1.2 p.p. më pak se dhjetor 2015). Raporti i kredive me probleme për kredinë e pambrojtur në valutë është ngjitur në nivelin 22.9% (+0.4 p.p. krahasuar me muajin dhjetor 2015), për efekt të rënies më të shpejtë të tepricës së kredisë së pambrojtur. Ky zhvillim reflekton orientimin e kredisë së re drejt monedhës vendase, si dhe fshirjen e kredive të humbura.

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar është në nivele të mira. Treguesit e likuiditetit, në lekë dhe valutë, janë mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator. Burimi kryesor i financimit mbeten depozitat, të cilat mbulojnë gati dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Sektori bankar vijon të ruajë një pozitë të mirë likuiditeti me një tepricë të konsiderueshme të depozitave të klientëve mbi kreditë. Në qershor 2016, raporti "depozita/kredi" shënoi 184.1% (kredi/depozita 54.3%). Sipas valutës, ky raport shënon 223.0% për monedhën vendase dhe 158.2% për valutën. Nivelet e aktiveve likuide në bilancet e bankave vijojnë të mbeten të larta, në vijim të një ecurie të ngadaltë të aktivitetit kreditues. Në fund të muajit qershor 2016, aktivet likuide përbëjnë 31.0% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, lehtësisht në rënie gjatë periudhës me 1.3 p.p.. Ecuria e treguesit tjetër të likuiditetit "aktive likuide/totali i detyrimeve afatshkurtra" ra gjithashtu me 1.0 p.p., në nivelin 40%.

Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator reflekton një mbrojtje të kënaqshme ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit të lekut. Në qershor 2016, bankat e mëdha vijojnë të qëndrojnë në pozicionin "në blerje" në nivelin 12.0% të kapitalit rregullator; bankat e mesme kanë lëvizur nga pozicion "në shitje" në dhjetor 2015, drejt pozicionit "në blerje" në nivelin 1.23%. Ekspozimi i bankave ndaj kursit të këmbimit duke përfshirë dhe kredinë e pambrojtur (nga lëvizjet në kursin e këmbimit) shënon ulje gjatë periudhës, kryesisht për shkak të tkurrjes së kredisë së pambrojtur në valutë.

Sektori bankar paraqitet i ekspozuar ndaj luhatjeve të normës së interesit në kushtet kur diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit sipas periudhave të riçmimit, është negative. Sidoqoftë, duhet konsideruar edhe efekti i tërthortë i rrezikut të normës së interesit, ku një rritje e mundshme e normës së interesit ndikon negativisht në aftësinë paguese të huamarrësve dhe mund të shoqërohet me probleme në cilësinë e kredisë.

Vlerësimi i rreziqeve dhe rekomandi

- Rreziku i kreditit, njohu rritje gjatë periudhës

Rritja e kredive me probleme gjatë periudhës tregon për vështirësinë që ka procesi i zgjidhjes së tyre dhe nevojën për monitorimin nga afër të këtij procesi. Banka e Shqipërisë pret që prirja e kurbës së kredive me probleme të vijë në rënie, ndonëse mund të ketë luhatshmëri të vlerës së tyre përgjatë kohës. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë do të mbikëqyrë me kujdes proaktivitetin me të cilin veprojnë bankat për të evidentuar në kohë kredinë me probleme dhe për ta provigjionuar atë, si edhe mënyrën se si ato po zbatojnë kërkesat rregullative për largimin nga bilanci të kredive të humbura.

- Rreziku i likuiditetit në veprimtarinë bankare vlerësohet i ulët.

Vlera e ulët e raportit të kredive ndaj depozitave, vijimi i rritjes së depozitave, dhe prania e lartë e aktiveve likuide mbi kërkesat minimale të kuadrit rregullator, tregojnë për një situatë mjaft të mirë të gjendjes së likuiditetit të sektorit bankar. Kjo gjendje evidenton edhe hapësirën dhe nevojën që ekziston për përmirësimin e ndërmjetësimit financiar, si një dukuri të nevojshme për të ndikuar, mes të tjerash, në përmirësimin e eficiencës së veprimtarisë bankare. Megjithatë, këtu duhet pasur në vëmendje fakti që pesha e burimeve shumë afatshkurtra të sektorit bankar, në formën e llogarive rrjedhëse dhe të depozitave pa afat, vijon të rritet. Kjo ecuri dikton ruajtjen e niveleve të larta të aktiveve likuide dhe ndikon negativisht në ecurinë e të ardhurave nga interesat.

- Sektori bankar është i ekspozuar në mënyrë të ndjeshme ndaj rrezikut të tregut (ku përfshihen rreziku i kursit të këmbimit dhe ai i normës së interesit) pavarësisht uljes së madhësisë së ekspozimit gjatë periudhës.

Rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit në veprimtarinë bankare është i kufizuar, në kushtet kur aktivet dhe detyrimet në valutë janë në vlera të përafërta. Por rreziku shtohet në rastin kur në vlerësim përfshihet edhe ndikimi i tërthortë i kursit të këmbimit, që përcillet kryesisht nëpërmjet kredisë në valutë për subjektet rezidente që të ardhurat kryesore i kanë në lekë. Si bankat ashtu edhe klientët huamarrës, duhet të vlerësojnë me kujdes rrezikun që buron nga kreditimi në valutë, ku palët janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit.

Përsa i takon rrezikut të normës së interesit, ai është i pranishëm në veprimtarinë bankare si në formën e tij të drejtpërdrejtë, ashtu edhe atë të tërthortë. Në formën e tij të drejtpërdrejtë, rreziku përcillet nëpërmjet hendekut që ekziston midis aktiveve dhe pasiveve të sektorit bankar sipas periudhave të riçmimit. Ky hendek është negativ dhe është thelluar disi për periudhën afatshkurtër. Rreziku do të materializohej në rastin e një rritjeje të normës së interesit, e cila, për shkak të hendekut negativ do të ndikonte më shpejt kostot e veprimtarisë së bankës, në krahasim me të ardhurat e saj.

- Prania e ndjeshme e bankave të huaja në vend si edhe ekspozimi i sektorit bankar me jorezidentët, ruan nevojën për monitorimin e afërt të zhvillimeve ndërkombëtare.

Gjatë periudhës, tregjet financiare evropiane treguan një rritje të luhatshmërisë në veprimtarinë e tyre në fund të saj, në vijim të rezultatit disi të papritur të "Brexit". Lëvizjet më të mëdha ishin në tregjet e këmbimit të valutave, ku monedha britanike u nënçmua me shpejtësi. Humbja e vlerës së monedhës britanike, mund të shoqërohej në afat të shkurtër me rënie të vlerës së produkteve bankare shqiptare në këtë monedhë. Nga analiza e kryer, Banka e Shqipërisë vlerësoi se ky efekt ishte minimal, pasi kredia dhe depozitat e publikut në monedhën britanike ishin në vlera të papërfillshme.

2.2 Aftësia për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së

2.2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Ekonomia e tregut funksionale kërkon që Shqipëria të ruajë stabilitetin e vet makroekonomik, përfshi qëndrueshmërinë e financave publike, të mbajë stabilitetin e çmimeve dhe të bilancit të pagesave, të ketë ekuilibër ndërmjet kërkesës dhe ofertës, të eliminojë barrierat ekzistuese dhe të sigurojë sundimin e ligjit dhe ekzekutimit të kontratave dhe të titujve të pronësisë.

Në vitet e fundit, Shqipëria e ruajti stabilitetin makroekonomik, por ngadalësimi ekonomik rezultoi në tkurrje të deficitit të llogarisë korrente, por disbalancat në sektorin e jashtëm janë ende të mëdha, duke pasqyruar bazën e ngushtë të prodhimit. Shqipëria ka marrë disa masa për të realizuar procesin e privatizimit dhe ka nisur reforma për të adresuar çështjen e të drejtave pronësore.

Kapitali njerëzor: Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe tregu i punës funksional janë faktorë kyçë që kontribuojnë në rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë dhe pozicionin e sistemit ekonomik shqiptar si pjesëmarrës në tregun evropian dhe global. Problemet kryesore me të cilat përballet Shqipëria dhe që pengojnë realizimin e plotë të kapitalit njerëzor janë: ndryshimet në sistemin e ekonomisë, "bjerrja e trurit" në vitet e fundit, informaliteti dhe mungesa e arsimit dhe sistemit të formimit profesional. Si rezultat, bizneset shpesh përballen me mungesë aftësish që kufizon rritjen e tyre.

Në fund të Tremujori II 2016, shkalla e papunësisë ishte 16.4 %, siç është raportuar nga INSTAT.

Politikat e punësimit

Në lidhje me politikën e punësimit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka vazhduar të zbatojë masat e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësi 2014-2020, në bashkëpunim me institucionet zbatuese, Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP) dhe institucionet e tjera të varësisë.

Përsa i përket të dhënave për punëkërkuesit e papunë, që janë të regjistruar pranë zyrave të punësimit, për periudhën Janar - Gusht 2015 në të gjithë territorin e vendit (36 zyra rajonale/vendore), rezultojnë si më poshtë:

- Totali i punëkërkuesve të papunë është 151.926 persona, nga të cilët rreth 50% janë femra;
- Të rinj të moshës 15-30 vjeç janë 42.550 punëkërkues të papunë ose 28% e totalit;
- Punëkërkues të papunë në pagesë papunësie jane 5.902 ose 4% e totalit të punëkërkuesit e papunë;
- Punëkërkues të papunë në ndihmë ekonomike janë 65.626 ose rreth 43% e totalit të punëkërkuesit e papunë;
- Punëkërkues të papunë nga komuniteti rom dhe egjyptian janë 9.856 ose rreth 6% e totalit të punëkërkuesit e papunë;

Për vitin 2015 fondi për programet e nxitjes së punësimit është 450 milion leke dhe nga totali i këtyre 250 milion ka për qëllim të mbështesë industrinë fasone.

Gjatë vitit 2015 janë zbatuar 6 programe të nxitjes së punësimit dhe janë përfshirë 5631 punëkërkues të papunë, të regjistruar pranë zyrave të punësimit. Në këto programe kanë përfituar 582 subjekte dhe gjithashtu janë shpenzuar 97% e fondeve. Shumë përfitues janë nga Tirana e Durrësi, kryesisht në fushat e shërbimit spitalor, arsimit, shëndetësisë, tregtisë, ndërtimit, turizmit, prodhim mobilje, hoteleri-turizmit, telemarketing, bukëpjekës, autoservis, duralumin, prodhime pasticerie, qepje, konfeksione, prodhim tekstile, përpunimit të bimëve medicinale, prodhimit të ndërtimit metalike, etj.

5631punëkërkues të papunë, të cilët janë përfshirë në këto programe, janë të ndarë sipas kategorive:

- 72% femra, dominance që vihet re në të gjitha llojet e programeve te zbatuara, kjo lidhet me llojin e kompanive të perfshira në projekte, ku industria fason zë mbi 55 %.
- 57% të rinje deri në 29 vjeç dhe 22% të moshave mbi 40 vjeç
- 46% me nivel arsimor deri në 9 vjeçar (pjesemarrje e cila ne VKM nr.47 dhe VKM nr.48 shkon deri në 60%.)
- 7% e pjesëmarrësve jane nga skemat e mbështetjes me të ardhura.
- 25% punëkërkues të papune afatgjatë, pra që kanë mbi nje vit të regjistruar në Zyrat e Punësimit.

- 180 punëkërkues të papunë nga komuniteti Rom dhe Egjyptian, pjesemarrës në programe sipas VKM nr.47 dhe VKM nr.48.
- 29 Persona me aftesi te kufizuar, pjesemarres ne programe sipas VKM 248 dhe 2 te tjere ne VKM nr.48 dhe VKM nr.873.
- 10 punëkërkues të papunë, emigrantë të kthyer, janë përfshirë në programe të subvensionimit në punë.

Në lidhje me zbatimin e Strategjisë së Punësimit në këtë periudhën deri në Gusht të vitit 2015, është duke u punuar për riorganizimin e zyrave të punësimit nëpërmjet modernizimit të infrastrukturës, ri-konceptimit dhe kompjuterizimit të shërbimeve të ofruara. Trembëdhjetë zyra të reja punësimi janë ngritur në nivel rajonal dhe vendor, sipas modelit të ri të shërbimeve, që është model unik i ofrimit të shërbimeve me tre nivele, informacion, shërbime punësimi dhe këshillim individual, të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme me institucionet homologe evropiane.

Nr.	**Treguesit e monitorueshëm**	**Arritjet Gusht 2015**
1.	Punësimi	17,826
2.	Ndërmjetësimet nga zyrat e punësimit	10.086
3.	Të trajnuar në kurse profesionesh në QFP	10.356
4.	Pjesëmarrës në programet e nxitjes së punësimit	5.631
5.	punëkërkues të papune, të punësuar pas mbarimit të një kursi	460

Kapitali fizik: Starategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020, është në faz 0235n finale të miratimit. Pritet të miratohet brenda shtatorit 2016. Të gjitha investimet janë fokusuar kryesisht në ndërtimin dhe përmirësimin e rrjetit bazë.

Rrjeti rrugor kombëtar përbëhet nga 3740 km. Investimet infrastrukturore synojnë integrimin e rrjetit rrugor kombëtar në rrjetin rajonal dhe europian TEN-T, duke përfshirë arterie strategjike si, ndërtimi i Autostradës Adriatiko–Joniane (*në kuadër të procesit të Berlinit*); përfundimi i akseve rrugore kryesore, si segmenti Tiranë –Elbasan, dhe ndërtimi i Rrugës së Arbrit, etj.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është i përfshirë, në Rrjetin kryesor rajonal të transportit, me gjatësi rreth rreth 420 km. Rehabilitimi dhe ndërtimi i segmentit hekurudhor Durrës-Tiranë-Aeroport mendohet të fillojë brenda vitit 2017 dhe të mbarojë brenda 2019.

Infrastruktura portuale është përmirësuar, në vitin 2013 përfundoi ndërtimi i terminalit të pasagjereve në Portin e Durrësit, gjithashtu ka përfunduar rehabilitimi i kalatave nr. 7 dhe nr. 8. Rehabilitimi i infrastrukturës vijon gjithashtu në Portin e Vlorës, ndërkohë që investime janë kryer edhe në portet e Shëngjinit dhe të Sarandës; (*Shih Kapitullin 21 Rrjetet Trans – Europiane*)

Prioritetet në fushën e transportit janë:

i) Ndërtimi i korridoreve kryesore rrugore të transportit, duke përfshirë Korridorin 8 Pan-Evropian, Korridorin Durrës-Morinë, që bën të mundur lidhjen me Korridorin 10, Korridorin Rrugor Veri-Jug (pjesë e Autostradës Adriatiko – Joniane), Rrugën e Arbrit, si një degë e Korridorit 8 dhe Aksin Qendror;

ii) Integrimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor shqiptar në rrjetin rajonal të Evropës Juglindore, si dhe rehabilitimi dhe ndërtimi i segmentit hekurudhor Durrës-Tiranë-Aeroport;

iii) Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës portuale në Shqipëri

2.2.2 Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve eshte pjese e Rrjetit Europian te Ndermarrjeve (EEN) qe prej vitit 2012 si Koordinatore e te vetmit Konsorcium shqiptar. Ne vitin 2015 AIDA ka fituar financimin nga BE per aderimin ne kete Rrjet. Pjesëmarrja në rrjetin më të madh, Rrjetin Europian të Ndërmarrjeve (EEN) synon të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të shfrytëzuar sa më mirë mundësitë për biznes në kuadër të tregut të përbashkët (single market) të Bashkimit Europian, si dhe të vendeve të tjera që janë partnere në këtë rrjet. Fondi i Konkurrueshmërisë: menaxhohet nga AIDA. Në vitin 2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-ne e re, Nr. 24, Datë 20.01.2016 për "Fondin e Konkurueshmërisë", për periudhën 2016-2018, me një buxhet total prej 84 milionë lekë. Për vitin 2016 janë alokuar 22 milionë lekë për këtë fond.Aktualish ,kanë përfituar 26 kompani, dhe fondi është disbursuar në masën 100%. Ky fond mbulon deri ne 70% te kostove te projektit. Çdo kompani perfiton deri në 1.400.000 lekë. Mbulohen nga skema kostot për aktivitetet e mëposhtme:

i. Përmirësim Produkkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiktetimin, ,certifikim produktivlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë.
ii.Pjesëmarje në panaire jashtë vëndit
iii.Krijim faqeje interneti,zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim,publikim dhe hartim materialesh promovuese.

Fondi i Inovacionit është miratuar me VKM Nr. 406 datë 13.05.2015 "Për krijimin e fondit të inovacionit".Ky fond ka një vlerë prej 40.000.000 lekë.për një peridhë 3-vjecare,për vitin 2015 vlera e fondit 10.000.000 lekë dhe per vitet 2016-2017 nga 15.000.000 lekë secili.

Qëllimi i Fondit nuk është zëvendësimi i asaj që ndërmarrja do të financonte me burimet e veta, por t'i shtohet buxhetit të ndërmarrjes, duke shërbyer si një nxitje për NVM-të për të audituar nevojat e tyre për inovacion dhe teknologji, për të identifikuar furnizues teknologjie dhe partnerë në shtete të tjera, të ndihmoj dhe lehtësoj promovimin dhe licencimin apo patentimin e inovacioneve të NVM-ve duke bërë të mundur që NVM-të përfituese të arrijnë më shumë nga sa ato do të mund të arrinin vetëm me mjetet e tyre.Një ndërmarrje mund të përfitojë maksimalisht 400,000 Lek për një projekt. Skema mbulon 50% të kostove të pranuara brenda limitit të mësipërm.

Fondi i Ekonomisë Kreative është miratuar me VKM Nr.954 datë 05.09.2012 “Për krijimin e fondit të Ekonomisë Kreative(Artizanatit)” dhe është përmirësuar së fundmi me VKM -në 25 dt 20.01.2016. Jane akorduar 40 milionë lekë gjithsej, 10 milionë në vit, për periudhën 2013-2016. Ky fond siguron mbështetje për (i) zhvillimin e produktit, (ii) marketingun, (iii) kualifikimin dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e artizanatit, dhe (iv) blerjen e paisjeve artizanale per nxitjen e prodhimit. Mbulon 60% – 80% të kostove të pranueshme dhe jo më shumë se 500.000 lekë për projekt-aplikim.

Fondi i Grave sipërmarrëse është krijuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.592, datë 10.09.2014 “Për Krijimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse”. Qëllimi i përgjithshëm i fondit është të kontribuojë në rritjen ekonomike të sipërmarrjeve femërore duke nxitur investimet e reja nëpërmjet rritjes se financimeve nga institucionet financiare jo bankare dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Buxheti i parashikuar per kete fond ne 2016 eshte 10 000 000 leke. Fondi në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse ka për qëllim subvencionimin e normës së interesit të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat drejtohen nga gratë si pronare apo administratore. Kjo skemë konsiston në pagesën e interesave për kreditë e marra nga gratë dhe që do të përdoren për investime në biznes. Ndihma financiare do të mbulojë 50 % të normës së interesit, për 4 (katër) vite radhazi, dhe jo më shumë se 1 000 000 lekë për një kredi.

Fondi Start-up i krijuar me VKM nr.593, datë 2014/09/10 "Për krijimin e fondit për mbështetjen e ndërmarrjeve të reja start-up". Ky fond ka për qëllim të mbështesë me fond grant bizneset e reja të krijuara. Fondi ka një shumë totale prej 25 milionë lekë për një periudhë prej 4 vjetësh dhe menaxhohet nga AIDA. Skema mbulon 70% të kostove të pranueshme të miratuara nga Komisioni Vlerësues i këtij fondi dhe jo më shumë se 300,000 Lekë. Buxheti total për vitin 2016 është 10.000.000 lekë. Aktualisht kanë përfituar 21 kompani ,vlera totale e alokuar është 6.300.000lekë. Fondi është realizuar në masën 63%, aplikimet vazhdojnë dhe deri në fund të vitit pritet realizimi 100% i këtij fondi.

Fondi Start-up është krijuar për t’i shërbyer Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në: a) Sektorët prodhues dhe të shërbimit; b) Sektorin e industrisë së lehtë; c) Sektorin e turizmit; ç) Fushën e kërkimit dhe të zhvillimit; d) Procesin e agropërpunimit; dh)Fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

Skema Voucher, është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.715 datë 26.08.2015 "Për ngritjen e Skemës Voucher". Kjo skemë ka për qëllim të ofrojë ndihmë për SME-të e sektorit te prodhimit, përpunimit agrobiznesit, dizajn-in e softëare-ve si dhe kryerjen e ekspertizave dhe transferimin e teknologjisë, zhvillimit e produkteve të reja, marketingut, etj. Skema voucher do të financohet nga qeveria me nje vlere totale prej 9.000.000 lekë për periudhën 2015 - 2017, 1.000.000 lekë në vitin 2015 dhe 4. 000.000 lekë në vitin 2016 dhe 2017. Skema voucher do të mbulojë deri në 85 % e shpenzimeve të pranuara, por jo më shumë se 350 .000 lekë të shpenzimeve të pranueshme.

Skema Voucher miratuar me VKM nr. 57, datë 13.07.2015 “Plani i Ndihmës Shtetërore “Për Krijimin e Skemës “Voucher”””” ka të caktuar 9.000.000 lekë për periudhën 2015-2017. Kjo skemë mbulon 85% të kostove të pranueshme nga buxheti i shtetit dhe jo më shumë se 350.000 lekë për çdo projekt-aplikim.

Në vijim të projektit “Triple Helix” me suportin e OECD është hartuar një plan veprimi 2016-2020 - "Për mbështetjen për Zhvillimin e Politikave të Inovacionit bazuar në qasjen Triple Helix". Ky dokument do të shërbejë si bazë për forcimin e bashkëpunimit të biznesi-akademia-qeveria dhe për të nxitur inovacionin.

2.2.3 Integrimi ekonomik me BE-në

Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë dominohen gjerësisht me tregtinë me vendet BE28. Gjatë tetë muajve të parë të vitit 2016, eksportet e mallrave në vendet BE28 shkuan në 124.3 billion lekë, ose 79.4% të totalit të eksporteve, me një rritje prej 3.5% në krahasim me një vit më parë. Importet e mallrave nga vendet BE28 shkuan në 236.9 billion lekë, ose 63.1% të totalit të importeve, me një rritje vjetore prej 9.8%.

Italia ishte destinacioni kryesor për eksportet shqiptare (55.7% të totalit të eksporteve). Gjithashtu, përsa i përket tregtisë me vendet BE28, eksportet janë rritur në terma vjetorë me Italinë (8.7%), Greqinë (20.2%), Gjermaninë (4.2%). Eksportet në Spanjë, Maltë dhe Austrikanë rënë në terma vjetorë. Gjatë 8 muajve të parë të vitit 2016, importet nga vendet BE28 kanë origjinë kryesisht nga Italia (29.5%), Greqia (7.9%), Gjermania (9.2%) dhe Spanja (2.2%).

Që me futjen në CEFTA, aktiviteti tregtar i Shqipërisë me vendet anëtare është intensifikuar nga rreth 3% e totalit para vitit 2007, në 8.2% 8 muajt e parë të vitit 2016.

Eksportet e mallrave drejt vendeve CEFTA kapën vlerën 21.4 billion lekë ose 13.7% të totalit të eksporteve, me ulje 14.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit pararendës.

Importet e mallrave prej vendeve CEFTA arritën vlerën 22.2 billion lekë, ose 5.9% të totalit të importeve, me rënie 15.3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit pararendës.

PJESA 3 - Aftësia për të marrë përsipër detyrimet që burojnë nga anëtarësimi

KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Lëvizja e lirë mallrave është një nga fushat kryesore për zbatimin e drejtë të parimeve të tregut të lirë**.** Parimi i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton që produktet duhet të tregtohen lirisht brenda Bashkimit Evropiane**.** Në një numër sektorësh ky parim i përgjithshëm plotësohet nga një kuadër i harmonizuar rregullator, duke ndjekur si 'Përqasjen e Vjetër' (që përcakton specifikimet e sakta të produktit) ashtu dhe 'Përqasjen e Re' (që përcakton kërkesat e përgjithshme të produktit). Transpozimi i legjislacionit të harmonizuar evropian të produktit është i përfshirë në pjesën më të madhe të detyrimeve sipas këtij kreu. Implementimi i qetë dhe i duhur i legjislacionit evropiane kërkon kapacitete të mjaftueshme administrative për të notifikuar kufizimet në tregti dhe për të zbatuar masa horizontale dhe procedurale në fusha si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut. Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit krijon një numër detyrimesh në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, të tilla si krijimi i një zone të tregtisë së lirë. Ajo gjithashtu parashikon përafrimin gradual të rregullave teknike dhe standardeve të BE-së si dhe të metrologjisë, akreditimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

I.2 Situata në Shqipëri

Në qershor të vitit 2014, KE i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidatit. Sikurse është theksuar edhe në Raportin 2016 për Shqipërinë, në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave përgatitjet janë në një fazë të moderuar. Është hartuar legjislacioni mbi masat horizontale në lidhje me standardizimin, akreditimin, metrologjinë, tregtimin e produkteve, mbikëqyrjen e tregut dhe vlerësimin e konformitetit.

Në fund të vitit 2011 është miratuar paketa ligjore horizontale për i) sigurinë e përgjithshme dhe ii) për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut e produkteve jo ushqimore, që transpozojnë dispozitat përkatëse të Kuadrit të Ri Ligjor Evropian (Rregulloren (KE) 765/2008/KEE dhe Vendimin 768/2008/KEE). Ky i fundit siguron gjithashtu bazën ligjore për transpozimin e direktivave të Përqasjes së Re dhe të Vjetër, nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe shfuqizon ligjin 9779/2007 për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo ushqimore. Në këtë kuptim të gjitha rregullat teknike në fushën e makinerive, ashensorëve, pajisjeve mbrojtëse personale, etj janë rishikuar në

zbatim të ligjit 10489/2011 por dhe në kontekstin e riorganizimit të ministrive lidhur me ndarjen e përgjegjësive me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë. Tekstet përkatëse janë bashkërenduar dhe në dhjetor të viti 2015 janë miratuar nga Këshilli i Ministrave 16 rregulla teknike për 16 grupe produktesh që transpozojne legjislacionin përkatës evropian të kapitullit 1 të *acquis*, përfshirë tekstilin, pajisjet e voltazhit të ulet, makineritë, ashensorët, pajisjet me gaz, pajisjet nën presion, pajisjet mbrojtëse personale, përputhshmërinë elektromagnetike, enët e thjeshta nën presion, emetimin e zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura, pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyese, kërkesat e eficensës për bojlerët e ujit që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë,etj.

VKM nr. 753, datë 16.09.2015 miraton Strategjinë 2020 "Për Mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut", përfshirë një plan veprimi të detajuar. Kjo strategji ka pjesë të saj integrale edhe objektivat afat-shkurtër dhe afat-gjatë për institucionet e Infrastrukturës së Cilësisë si dhe hartimin e rregullave teknike që transponojnë legjislacionin përkatës të këtij kapitulli.

Legjislacioni në fushën e standardizimit në mënyrë të qartë përcakton rregullat dhe procedurat në përputhje me ato të përdorura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit si CEN, CENELEC, ETSI, ISO, IEC. Ligji Nr. 53/2015 "mbi disa ndryshime në Ligjin nr. 9870/2008 "Për Standardizimin", i ndryshuar, ka transponuar vetëm pikën 2 të nenit 26 të Rregullores së EU 1025/2012 "Mbi Standardizimin Evropian". Përveç legjislacionit në fuqi, i gjithë procesi i standardizimit bazohet në rregulloret e brendshme të DPS të cilat janë në përputhje me ato të institucioneve përkatëse europiane dhe ndërkombëtare.

Në shtator 2014 është miratuar nga Parlamenti shqiptar Ligji ri nr. 116, datë 11.09.2014 Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit, që ka për qëllim përputhjen e legjislacionit shqiptar me dispozitat përkatëse te akreditimit në Rregulloren Nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit i datës 9 korrik 2008 "Përcaktimi i kërkesave për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut". Të gjitha aktet nënligjore në fushën e akreditimit janë miratuar në Korrik – Shtator 2015. DPA ka nënshkruar marrëveshjen EA-MLA për laboratorët testues, që është një arritje shumë e rëndësishme në drejtim të eliminimit të barrierave të panevojshme teknike në tregti.

Gjithashtu janë pjesë e legjislacionit shqiptar metodologjia e klasifikimit të risqeve dhe vlerësimit të riskut serioz si dhe procedurat standarde të operimit që duhen zbatuar nga gjithë inspektoret e mbikëqyrjes së tregut.

Janë të ngritura dhe funksionale strukturat kryesore administrative, përgjegjëse për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është anëtare me të drejta të plota në Institutin Evropiane të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI) dhe anëtar "affiliate" në Komitetin Evropian për Standardizimin (CEN)dhe Komitetin Evropiane për Standardizimin në fushën e Elektroteknikës(CENELEC). Baza e të dhënave në DPS është përmirësuar në lidhje me regjistrimin dhe përditësimin e standardeve të

publikuara. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është anëtare me të drejta të plota në Organizatës Evropiane për Akreditim (EA) që nga Maj 2015. DPA ka nënshkruar marrëveshjen e EA-MLA për fushën e testimit. Aktualisht numri i përgjithshëm i organeve të akredituara të vlerësimit të konformitetit është 46, nga të cilat 25 laboratorë testimi, 3 laborator mjekësore, 1 laborator kalibrues,6organizma certifikuese dhe 11organe inspektuese.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është anëtare me të drejta të plota në EURAMET (Shoqata evropiane e instituteve kombëtare të metrologjisë dhe anëtare e asociuar në WELMKE. Kalibrimi dhe aftësitë e matjes në fushën e masës së DPM janë regjistruar në databasën e Krahasimit të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave. Aktualisht, është funksionale Qendra e re Kombëtare e Metrologjisë në Tiranë.

Ka vazhduar konsolidimi i grupit të punës ndërministror për kapitullin 1 "Lëvizja e Lirë e Mallrave" dhe janë përmirësuar strukturat përgjegjëse në ministritë e linjës për transpozimin e *acquis* në kapitullin e parë. Ky grup po kthehet një një forum diskutimi për gjithe iniciativat ligjore nen kapitullin 1 te EU acquis me qellim “përkthimin” në të njëjtën mënyre te parimeve të këtij kapitulli dhe ruajtjen e të njëjtës qasje në transpozimin e legjislacionit sektoral.

I.3 Struktura e kapitullit

1. ÇËSHTJET HORIZONTALE
   1.1. STANDARDIZIMI
   1.2. AKREDITIMI
   1.3. VLERËSIMI I KONFORMITETIT
   1.4. METROLOGJIA
   1.5. MBIKQYRJA E TREGUT
2. DIREKTIVAT E PËRQASJES SË VJETËR
   2.1. MJETET MOTORIKE
   2.2. KIMIKATET
   2.3. PRODUKTET FARMACEOTIKE
   2.4. PRODUKTET KOZMETIKE
   2.5. DETERGJENTËT
   2.6. XHAMI I KRISTALIT
   2.7. TEKSTILE

2.8. KËPUCE
2.9. PLEHRA KIMIKE

3. DIREKTIVAT E PËRQASJES SË RE
3.1. PAJISJET ELEKTRIKE BRENDA DISA KUFIJVE TË TENSIONIT
3.2. PAJISJET E THJESHTA NËN PRESION
3.3. SIGURIA E LODRAVE
3.4. SIGURIA E MAKINERIVE
3.5. PAJISJET MBROJTËSE PERSONALE
3.6. LËNDËT PLASËSE PËR PËRDORIME CIVILE DHE FISHEKZJARRET
3.7. PAJISJET DHE SISTEMET NË AMBIENTE POTENCIALISHT SHPËRTHYESE
3.8. ASHENSORËT
3.9. INSTRUMENTAT E PESHIMIT JO AUTOMATIK
3.10. INSTRUMENTAT MATËS
3.11. PAJISJET NËN PRESION
3.12. BOILERËT ME UJË TË NXEHTË
3.13. PAJISJET E GAZIT
3.14. PAJISJET RADIO DHE FUNDORE TË TELEKOMUNIKACIONIT
3.15. PËRPUTHSHMËRIA ELEKTROMANJETIKE
3.16. ANIJET ÇLODHËSE
3.17. PAJISJE DETARE
3.18. SISTEMI HEKURUDHOR I SHPEJTËSISË SË LARTE
3.19. INSTALIME TELEFERIKE TË PROJEKTUARA PËR PRANSPORT PERSONASH
3.20. PRODUKTET E NDËRTIMIT
3.21. PAKETIMI DHE PAKETIMI I MBETJEVE
3.22. PAJISJET MJEKËSORE
3.23. PAJISJET MJEKËSORE AKTIVE TË TRANSPLANTUESHME
3.24. PAJISJET MJEKËSORE TË DIAGNOSTIFIKIMIT IN VITRO
3.25. PAJISJET E TRANSPORTUESHME NEN PRESION
3.26. EMETIMI I ZHURMAVE NË AMBIENT NGA PAJISJET PËR PËRDORIM NË MJEDISE TE HAPURA

4. PERQASJA E RE DHE GLOBALE
   4.1. INFORMACIONI I KONSUMIT TË ENERGJISË DHE BURIMEVE TË TJERA PËR PRODUKTET ME NDIKIM NË ENERGJI
   4.2. INFORMACIONIN E THARËSEVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK NË LIDHJE ME KONSUMIN E ENERGJISË
   4.3. ETIKETIMI I MAKINAVE LARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK NË LIDHJE ME KONSUMIN E ENERGJISË
   4.4. ETIKETIMI I PAJISJEVE FRIGORIFERIKE PËR PËRDORIM SHTËPIAK NË LIDHJE ME KONSUMIN E ENERGJISË
   4.5. ETIKETIMI I ENERGJISË PËR KONDICIONERËT E AJRIT
   4.6. ETIKETIMI I ENERGJISE PER LLAMBAT DHE NDRICUESIT ELEKTRIKE
   4.7. ETIKETIMI I ENERGJISE PER FURRAT DHE ASPIRATORET

5. MASAT PROCEDURIALE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE-së

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me kapitullin 1 të Legjislacionit Evropian buron nga neni 70 dhe 75 i MSA-së.
Këto dispozita detyrojnë Shqipërinë që teknikisht të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të hyjë ne fuqi. Kështu, tashmë në këtë fazë të procesit të para-anëtarësimit, organet e ndryshme shtetërore duhet të jenë të përfshira në ushtrimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të *acquis* që është në fuqi.

Për më tepër, kur legjislacioni i BE-së është subjekt konstant zhvillimi, përafrimi i ligjeve nuk do të jetë i plotë me përshtatjen e legjislacionit shqiptar me atë të legjislacionit evropian aktualisht në fuqi. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve të BE-së është i nevojshëm si për përpjekjet e parapranimit, ashtu dhe përgatitjen e Shqipërisë si realitet i përditshëm për anëtarësimin në të ardhmen në BE.

Në kuadër të MSA-së, Partneriteti Europian me Shqipërinë është instrumenti kryesor për të ndihmuar autoritetet shqiptare në realizimin e perspektivës evropiane të vendit.

Partneriteti Evropian trajton me përparësi kohore afatshkurtër dhe afatgjatë çështjet e lëvizjes së lirë të mallrave. Kur vjen puna për të parë këtë përmbajtje rekomandohet: rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standardeve dhe certifikimit dhe rëndësinë e tyre në tregtinë ndërkombëtare; adoptimi dhe implementimi i strategjisë kombëtare të mbikëqyrjes së tregut dhe miratimi i një legjislacioni të ri për mbrojtjen e konsumatorit.

Lista e prioriteteve afatmesme përfshin:

- sigurimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar kërkesat e MSA-së;
- progres në transpozimin e direktivave të përqasjes së re dhe të vjetër;
- krijimin i sistemit të mbikëqyrjes së tregut;
- sigurimin e funksionimit të duhur të organeve përgjegjëse për standardizimin, akreditimin, certifikimin si dhe metrologjisë dhe kalibrimit;

Përmbledhje e legjislacionit të BE së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave

Parimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë të mallrave është që produktet të tregtohen lirisht nga një vend i Bashkimit Europiane në një tjetër. Ky parim është i sanksionuar në Traktatin për funksionimin e Bashkimit Europian, në veçanti Nenet 28-30 (ndalimi i detyrimeve doganore dhe tarifave që kanë të njëjtin efekt) dhe Nenet 34-36 (Ndalimi i kufizimeve sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me to) si dhe nenin 110 (ndalimi i diskriminimit taksor) siç interpretohet në praktikat ligjore të Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Për më tepër, Direktiva e Komisionit 70/50/KEE dhe komunikimet interpretuese janë të një rëndësie të veçantë.

Një parim që duhet pasur në vëmendje për këtë kapitull ka të bëjë me ndalimin rreptësisht të taksave doganore, tarifave dhe gjithë masave që kanë efekt të njëjtë me kufizimet saiore në importe dhe eksporte. Në rastin e fundit, disa përjashtime jepen në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe në legjislacionin dytësor. Janë të ndaluara masat që kanë efekt të njëjtë me kufizimet sasiore me disa përjashtime të limituara dhe të kufizuara. Kjo nënkupton, eliminimin e barrierave teknike në tregti sipas neneve dhe përputhshmërinë me parimin e njohjes reciproke sipas procedures në Rregulloren 764/2008/EC për përcaktimin e procedurave lidhur me aplikimin e disa rregullave kombetare teknike për produktet e tregtuara ligjërisht në një vend anëtar dhe që shfuqizon Vendimin 3052/95/EC.

.

Në një numër sektorësh parimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë të mallrave i shprehur në nenet 34-36 të TFBE është i plotësuar nga një kuadër i harmonizuar ligjor rregullator në një numër të konsiderueshëm sektorësh. Masat horizontale përcaktojnë infrastrukturën e cilësisë të cilën Vendet Anëtare e vendosin në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Legjislacioni i harmonizuar europian për produktet, i cili përshtatet në çdo Shtet Anëtar, paraqet pjesën më të madhe të *acquis* në këtë kapitull. Ai bazohet kryesisht në "Përqasjen e Vjetër" (përcakton specifikime të sakta të produktit) dhe "Përqasjen e Re dhe Globale" (vendosja e kërkesave thelbesore të sigurisë). Legjislacioni i "Përqasjes se Re dhe Globale" mbulon fushat e lidhura me instrumentet e peshimit jo automatik dhe instrumente matës (2014/32/BE), pajisjet e tensionit të ulët (LVD 2014/35/BE), përputhshmëria elektromagnetike (EMC 2014/30/BE), lodrat (2009/48/KEE), makineritë (2006/42/KE amenduar nga 2009/12/KEE), ashensorët (2014/33/EU) pajisjet personale mbrojtëse (PPM 89/686/KEE e cila në prill të 2018 do të shfuqizohet nga Rregullorja 2016/425/BE), pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera shpërthyese (ATEX 2014/34/BE), pajisjet e gazit (2009/142/KE), enët nën presion (2009/105/KEE), instalimet kabllore (2000/9/KEE që në prill të 2018 do të shfuqizohet nga Rregullorja 2016/425/BE), radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve (R & TTE, 2014/53/BE), etj.

Legjislacioni i harmonizuar evropian i "Përqasjes së Vjetër" mbulon fushat e lidhura me mjetet motorike, kimikatet, produktet farmaceutike, produktet kozmetike, metrologjinë ligjore dhe parapaketimet, tekstilet (1007/2011/EU), etiketimin e këpucëve (94/11/KE), produktet e xhamit të kristalit (69/493/KEE), etj. Tërësia e masave procedurale kërkon gjithashtu kapacitete të mjaftueshme administrative në mënyrë që të zbatohen siç duhet. Këto përfshijnë një procedurë notifikimi në fushën e standardeve teknike dhe rregullave të përcaktuara në Direktivën 98/34/KE e ndryshuar, Rregulloren (KEE) Nr. 339/93 mbi kontrollet kufitare në lidhje me sigurinë e produktit, Direktiva 91/477/KEE mbi kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve dhe direktivën 93/7/KEE mbi produktet kulturore.

Për gjithë sektorët apo dispozitat kombëtare, që nuk janë të harmonizuar në nivel evropian lidhur me masat me efekt të njejte me kufizimet sasiore, zbatohen drejtpërsëdrejti nenet 34-36 të TFBE si dhe në referencë të vendimeve të Gjykates Evropiane të Drejtesise.

Në korrik të vitit 2008 u miratua një paketë ligjore në kuadër të masave për të ndihmuar funksionimin më mirë të tregut të brendshëm për mallra dhe për të forcuar dhe modernizuar kushtet për vendosjen e një game të gjerë të prodhimeve industriale në tregun e BE- së. Kuadri i ri ligjor konsiston në a) Rregulloren nr 765/2008 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 9 korrik 2008 që përcakton kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut në lidhje me tregtimin e produkteve dhe shfuqizimin e Rregullores (KEE) Nr. 339/93; b) Vendimin Nr. 768/2008/KE i Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 9 korrik 2008 mbi një kuadër të përbashkët për tregtimin e produkteve, dhe shfuqizimin e Vendimit të Këshillit 93/465/KEE dhe c) Rregulloren Nr. 764 / 2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 9 korrik 2008 që përcakton procedurat në lidhje me zbatimin e disa rregullave teknike kombëtare të produkteve të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një Shtet tjetër Anëtar dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 3052/95KE.

Rregullorja 765/2008 dhe Vendimi 768/2008 janë plotësisht komplementare dhe së bashku formojnë bazën e një kuadri të qëndrueshëm ligjor për tregtimin e produkteve ndërsa Rregullorja 764/2008 (rregullorja mbi njohjen reciproke) forcon gjithashtu tregun e brendshëm për një gamë të gjerë të produkteve të tjera që nuk janë objekt i harmonizimit të BE-së, për shembull për ushqime si buka dhe makarona, mobilie, metale të çmuara, etj.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore legjislative

Janë miratuar në total si standarde shqiptare afërsisht 95% e standardeve të CEN (ENs & HD i nryshuar), rreth 97% te standardeve te CENELEC) dhe rreth **58%** te standardeve ETSI.
- Këshilli i Ministrave;
- Ministria e Shëndetësisë (ISSh);
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punëve të Jashtme;

- Ministria e Integrimit Evropian;
- Avokati i Popullit;
- INSTAT.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

	2017	2018	2019
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	3,030,000	2,504,000	0
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	0	0	0
Buxheti total i Kapitullit	3,030,000	2,504,000	0

III. Prioritetet

Një nga prioritetet kryesore të Shqipërisë në këtë fushë është vijimi i negociatave për të lidhur marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen shoqërore, sidomos me Shtetet Anëtare të BE-së. Kuadri ligjor në fushën e sigurimeve shoqërore, për sa i përket lëvizjes së lirë të personave, konsiston në marrëveshje dypalëshe që bashkërendojnë sistemet e sigurimeve shoqërore të vendeve nënshkruese.

- Marrëveshja e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Belgjikës është ratifikuar dhe ka hyre ne fuqi ne 1 janar 2016.
- Marrëveshja e mbrojtjes shoqërore me Luksemburgun, eshte ratifikuar dhe ka hyre ne fuqi 1 Korrik 2016
- Marrëveshja e mbrojtjes shoqërore me Hungarinë eshte ratifikuar dhe ka hyre ne fuqi ne 1 Korrik 2016
- Marreveshja me Maqedoninë eshte ratifikuar dhe ka hyre ne fuqi 1 Qershor 2016
- Marreveshja me Rumaninë eshte ratifikuar dhe pritet te hyje ne fuqi ne 1 Shtator 2016.
- Marreveshjet me Çekinë dhe Gjermanine jane ratifikuar. Po vazhdojne procedurat per miratimin e formulareve zbatues te marreveshjeve dhe me pas do te ndiqen procedurat per hyrjen ne fuqi.
- Eshte ne proces miratimi ne KM mareveshja me Austrinë
- Pritet nënshkrimi i marrëveshjes me Kanadane dhe me pas procedurat për hyrjen në fuqi të saj.

- Ne Gusht 2016 , u zhvilluan ne Tirane negociatat per marreveshjen ndërmjet qeverive të Kosovës dhe asaj shqiptare, për vërtëtimin e periudhave të sigurimit për realizimin e së drejtës për pension. Projektvendimi ndodhet në preces miratimi ne KM.

Me Italinë ka filluar bashkëpunimi ne nivelin teknik për te analizuar dhe vlerësuar sistemet e sigurimeve shoqërore ne dy vendet respektive, për te vazhduar me pas me negociatat për marrëveshje dypalëshe. Vizita e Ministrit te Mirëqenies Sociale dhe Rinise, z. Klosi , në Rome, ne shtator 2016 do te coje me tej bisedimet per fillimin e negociatave per marreveshje te mbrojtjes shoqerore ndermjet dy vendeve.

Negociatat me Republikën e Maqedonisë janë finalizuar për një marrveshje dypalëshe në Tiranë, në 14 Nëntor 2014. Është dërguar për miratim në Këshill të Ministrave dhe kjo marrëveshje është firmosur në Mars, 2015. Këto negociata do të vazhdojnë deri në miratimin e marrveshjes administrative.

Në kuadër të zgjerimit të procesit të koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore, në janar të vitit 2015, u zhvilluan në Vjenë, diskutimet e para për marrëveshjen dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë. Janë kryer negociatat në shkurt dhe qershor të vitit 2015, janë diskutuar dhe aprovuar nga delegacionet përkatëse. Në nëntor 2015 janë finalizuar negociatat për marrëveshjen e sigurimeve shoqërore dhe marrëveshjen administrative.

Ka filluar bashkëpunimi edhe me Qeverinë spanjolle, Kroacinë, Danimarkën, SH.B.A, Francën, te cilat kane shprehur interesin për të nisur negociatat për marrëveshje dypalëshe, propozim ky që është pritur pozitivisht nga Qeveria shqiptare dhe konkretisht kane filluar shkëmbimet e informacioneve te ndërsjellta për sistemet e mbrojtjes shoqërore. Shqipëria është e interesuar që të nisë bashkëpunimin edhe me Bullgarinë pasi janë vërejtur mjaft probleme te cilat do te gjejnë zgjidhje me hartimin e një marrëveshje te re te mbrojtjes shoqërore ndërmjet dy vendeve. Shqipëria po punon që të lidhë marrëveshje edhe me të tjera Shtete Anëtare të BE-së dhe vende evropiane jashtë BE-së, siç është Zvicra.

Në fushën e integrimit të të huajve në shoqërinë shqiptare, do të ketë ndryshime mjaft pozitive në të ardhmen duke qenë se Ligji "Për të huajt" Nr. 108/2013 parashikon hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Integrimit Social të të huajve nga Ministritë përgjegjëse.

Institucionet publike kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë, sipas kompetencave, me partnerët socialë, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare për promovimin dhe zbatimin e programeve të integrimit të të huajve në shoqëri.

Shqipëria do të vazhdojë përpjekjet për të përafruar më tej legjislacionin me *acquis* dhe ta zbatojë plotësisht. Nismat që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe të bashkërendimit ndërinstitucional do të zbatohen më mënyrë konsistente.

Në këtë drejtim është miratuar Ligji nr 74 2016 datë 14.7.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 1082013 "Për të huajt" i cili ka për qëllim zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë zbatimit të tij dhe përafrimin e mëtejshëm me *aquis* të Bashkimit Europian, konkretisht të dispozitave që rregullojnë regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë, si dhe ndryshimeve e zhvillimeve që kanë ndodhur në fushën e imigracionit.

Nismat që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe të bashkërendimit ndërinstitucional do të zbatohen më mënyrë konsistente.

- Autoritetet shqipëtare janë të angazhuar për të vijuar me përgatitjet për pjesemarrje ne programin **EURES** (deri ne aderim) të punësimit dhe iniciativat për marrjen e hapave për krijimin e databasave të shërbimeve kombëtare të punësimit. Në këtë kuadër është miratuar VKM Nr. 191, datë 9.3.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e shërbimeve të punësimit". Ky vendim është në zbatim të Ligjit nr.10325 "Për bazën e të dhënave shtetërore" dhe synon të realizojë krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Shërbimeve të Punësimit. Objektivi I tij është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore, duke siguruar dhe ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe lidhjen me portalin e punësimit të Bashkimit Europian EURES.

IV. Plani i masave për periudhën 2017 – 2020

IV.1 Aksesi në tregun e punës

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 –2020	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2014 – 2020

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Shkalla e përafrimi	Data e miratimit	Hyrja në fuqi

				(legjislacioni shqiptar)	**(legjislacioni shqiptar)**
Direktiva 2009/50/KE	Ligji nr. 108/2013 "Për të huajt"	Ministria e Punëve të Brendshme	E papërafruar	28.03.2013	20.4.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e miratimit**	**Hyrja në fuqi**
na				

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

***Acquis* e BE-së**	**Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)**	**Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)**	**Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Shkalla e synuar e përafrimit (e plotë/ e pjesshme)**	**Data e planifikuar për miratim**	**Hyrja në fuqi**
AFAT SHKURTËR (2017)							
Traktatet e Bashkimit Evropian Karta e të Drejtave Themelore Programet e Këshillit të Evropës Strategjia-Evropa 2020	Jo	Projekt-VKM-Programi Kombëtar I Integrimit Social të të Huajve	Jo	MMSR MASH MZHETTS	E Plote	Tremujori IV 2017	Tremujori IV 2017
AFAT MESËM (2018– 2020)							

IV.2 Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

IV.2.1 Legjislacioni

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
s'ka	s'ka	s'ka

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Shkalla e përafrimit	Data e miratimit (Legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacion shqiptar)
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	VKM nr. 530/2014 "Për miratimin e Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut."	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	6.8.2014	2016
Rregullorja (KE) nr. 987/2009 Rregullorja (KE) nr. 883/2004	Ligji nr. 35/2014 "Për ratifikimi i Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Belgjikës"	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	3.4.2014.	2016
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	VKM nr. 626 "Për miratimi i Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë"	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	24.9.2014	2017
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	VKM nr. 531 "Për miratimi i Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë."	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	6.8.2014	2017

Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	VKM nr. 728 "Për miratimi i Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Cekisë"	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	02.09.2015	2017
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	VKM nr. 228 "Për miratimi i Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë"	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	11.03.2015	2017
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	VKM nr. 336 "Për miratimi i Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë."	Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	22.04.2015	2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2019

***Acquis* e BE-së**	**Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)**	**Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)**	**Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Shkalla e synuar e përafrimit (e plotë/ e pjesshme)**	**Data e planifikuar për miratim**	**Hyrja në fuqi**
AFAT SHKURTËR (2017)							
AFAT MESËM (2018– 2019)							

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela Fondeve të Planifikuara në Buxhetin e Shtetit

Kapitulli: 2 Aksesi në tregun e punës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**

Aktiviteti	Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit	2016	2017	2018	Total (3+4+5)
Projekt-VKM-Programi Kombëtar I Integrimit Social të të Huajve	A) Paga –stafi ekzistues		24.000		24.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total		**24.000**		**24.000**
Kapitulli: 2 Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës"	A) Paga –stafi ekzistues	40.000			40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	900.000			900.000
	Aktiviteti total	**940.000**			**940.000**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë"	A) Paga –stafi ekzistues	40.000			40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	900.000			900.000
	Aktiviteti total	**940.000**			**940.000**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Zvicrës"	A) Paga –stafi ekzistues	50.000			50.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	1.100.000			1.100.000

	Aktiviteti total	**1.150.000**			**1.150.000**
Kapitulli: 2 Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe ....."	A) Paga –stafi ekzistues		40.000		40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		1.200.000		1.200.000
	Aktiviteti total		**1.240.000**		**1.240.000**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe ....."	A) Paga –stafi ekzistues		40.000		40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		1.200.000		1.200.000
	Aktiviteti total		**1.240.000**		**1.240.000**
	Kapitulli total				**5,534,000**

KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e Kapitullit

Legjislacioni i BE-së për të drejtën e vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime është i një natyre horizontale, i cili mbulon një larmi të madhe të fushave dhe profesioneve si edhe përfshirjen e shumë institucioneve dhe organeve publike. Legjislacioni kombëtar në përputhje me legjislacionin evropian, nuk duhet të cenojë të drejtat e përcaktuara të neneve 49 dhe 56 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, me përjashtim të atyre të përcaktuara në Traktat. Pjesa kryesore e *acquis* në këtë fushë është Direktiva 2006/123 (KE) datë 12.12.2006 "Për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve)" e amenduar, e cila përbën masën më të madhe, dhe është e bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës të Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Në fushën e shërbimeve postare, është Direktiva 97/67/KE datë 15.12.1997 "Mbi rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit" e amenduar, dhe përcakton parimet për të siguruar ofrimin e një shërbimi universal postar, krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare dhe të shërbimit postar me cilësi të lartë për përdoruesit fundorë.

Në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, është Direktiva 2005/36/KE datë 7.09.205 "Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale" e amenduar, që përcakton rregullat në lidhje me njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të tjera midis vendeve anëtare. Direktiva gjithashtu lehtëson masat dhe shërbimet e rastit të profesionistëve për disa profesione të tjera të rregulluara

I.2 Situata në Shqipëri

Sa i përket legjislacionit sektorial, një Plan Task për Kapitullin 3 është finalizuar. Ky dokument do të shërbejë si një mjet monitorimi për Kapitullin 3 dhe planin e aktiviteteve për Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për Kapitullin 3.
Në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve, Shqipëria garanton të drejtën e vendosjes për kompanitë e themeluara në BE duke u ofruar atyre trajtim të njëjtë si kompanive shqiptare. Në këtë drejtim, është miratuarligji Nr. 66 datë 9.6.2016 "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë"i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën 2006/123/KEE "Për shërbimet në tregun e brendshëm".Aktet nënligjore janë hartuar dhe priten të finalizohen brenda viti 2017. Këto akte synojnë harmonizimin e plotë të legjislacionit ekzistues për shërbimet në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime brenda 3 vjetëve pas hyrjes në fuqi të ligjit duke parashikuar një mekanizëm për të

siguruar pajtueshmërinë e plotë të legjislacionit të ri në këtë fushë. Rishikimi i legjislacionit kombëtar në 5 sektorë në përputhje me Planin Kombëtar do të finalizohet brenda tre mujorit të parë të 2017..

Në fushën e shërbimeve postare legjislacioni përafrohet plotësisht me Direktivën 97/67/KE të amenduar me direktivën 2002/39/KE dhe direktivën 2008/6/KE.

Në fushën e *njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale*, Ministria e Arsimit dhe Sporteve është duke punuar për të zbatuar detyrimet e Direktivës 2013/55/KE, e cila ndryshon me Direktivën 2005/36/KE "Për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale". Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 952 datë 12.12.2012 "Për përjashtimin nga përgjegjësia profesionale për provimin shtetëror në profesionet", përcakton përjashtimin nga përgjegjësia për provimin e shtetit profesional, i cili ka fituar të drejtën për të ushtruar ndonjë nga profesionet e rregulluara në vendet si të BE-së, EFTA shtetet, si: Zvicra, Lihtenshtejni, Norvegjia dhe vendet me të cilat Shqipëria ka një marrëveshje dypalëshe, si me SHBA-në, Kanada-në dhe Japoni-në. Ndërkohë, është duke u punuar për ofrimin e programeve të studimit cilësor sipas eksperiencave më të mira evropiane duke mundësuar njohjen e diplomave të arsimit të lartë të përfituara në Shqipëri në vendet e BE-së, si dhe njohjen e kualifikimeve në BE për të mundësuar punësimin e specialistëve shqiptarë në vendet e BE-së. Për këtë arsye, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka planifikuar qe në përputhje me Direktivën 2005/36/KE, të bëj ndryshimet në Ligjin Nr. 10171 datë 22.10.2009 " Për rregullimin e profesioneve, i ndryshuar". Këto ndryshime pritet të miratohen në tre mujorin e parë të vitit 2017.

I.3 Struktura e kapitullit

1. E DREJTA E THEMELIMIT
2. LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËR KUFITARE
3. SHËRBIMI POSTAR
4. NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMET PROFESIONALE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të BE

Nenet e MSA-së me rëndësi për këtë kapitull janë nenet : 50, 57, 58, 70, 100.

Acquis të BE-së në këtë kapitull përfshijnë, *ndër të tjera*:

- Direktiva 2006/123/KE datë 12.12.2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për shërbimet në tregun e brendshëm";
- Vendimi i Komisionit 2009/767/KE i 16 tetor 2009 që "Përcakton masat që lehtësojnë përdorimin e procedurave me mjete elektronike përmes pikave të kontaktit të vetëm nën Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm";
- Vendimi i Komisionit 2010/425/BE të 28.07.2010 i cili ndryshon "Vendimin 2009/767/KE datë 16.12.2009 përcakton masat që lehtësojnë përdorimin e procedurave me anë të mjeteve elektronike përmes 'pikave të kontaktit të vetëm sipas Direktivës 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm, në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe publikimin e listave të besuara të ofruesve të shërbimeve të certifikimit të mbikëqyrur/akredituar nga Shtetet Anëtare";
- Direktiva 2013/55 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 nëntor 2013 që ndryshon Direktivën 2005/36/KE "Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Rregulloren Nr. 1024/2012 mbi bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm ("Rregullorja IMI") Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor1996 "Mbi zhvendosjen e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve";
- Direktiva 2014/67 / KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi zbatimin e Direktivën 96/71 / KE në lidhje me postimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe që ndryshon Rregulloren Nr. 1024/2012 mbi bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit të Tregut të Brendshëm Informacionit ("Rregullorja IMI");
- Direktiva 98/5/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shkurt 1998 "Për lehtësimin e praktikës së profesionit të avokatit në mënyrë të përhershme në një Shtet Anëtar tjetër nga ai në të cilin është marrë kualifikimi";
- Direktiva e Këshillit 77/249/KEE e 22 mars 1977 "Për të lehtësuar ushtrimin efektiv nga avokatët lidhur me lirinë për të ofruar shërbime";
- Direktiva e Këshillit 86/653/KEE e 18 dhjetor 1986 "Mbi koordinimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me agjentët e vetëpunësuar të nivelit të dytë";
- Direktiva 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 dhjetor 1997 "Mbi rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit";

- Direktiva e Këshillit 63/474/KEE e 30 korrik 1963 “Për liberalizimin e transfertave në lidhje me transaksionet e padukshme që nuk janë të lidhura me lëvizjen e mallrave, shërbimeve, kapitalit ose personave”.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore legjislative

1&2 E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËRKUFITARE

Nënkapitujt 1 dhe 2 së bashku, për shkak të lehtësisë për t’u kuptuar, në veçanti në lidhje me shfaqjen e legjislacionit sektorial, që do të mbulojë monitorimin për të dy sektorët (1) të drejtën e vendosjes dhe (2) lirinë për të ofruar shërbime.

Task plani i Kapitullit 3 është finalizuar. Qëllimi i taskplanit është forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe roli i GNP duke përgatitur për procesin e shqyrtimit të këtij kapitulli dhe hapat e tjera deri në fazën e anëtarësimit. Ky dokument është hartuar me qëllim që të vlerësojë hapësirat ligjore, nëse ka, dhe nevojat në (i) kapacitetin administrativ dhe koordinimin, (ii) harmonizimin legjislativ. Finalizimi i këtij dokumenti është përgatitur pas tre takimeve konsultative me GNP.
Me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, është miratuar ligji nr 66/2016 "Për shërbime në Republikën e Shqipërisë". Aktet nënligjore janë në fazën përfundimtare dhe priten të miratohen në Prill 2017-tës. Është ngritur një grup pune ndërministror me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 39 të 2013/04/02 "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e kuadrit institucional për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve”.

3. SHËRBIMI POSTAR

Në zbatim të angazhimeve të marra të MSA-së dhe të programit qeveritar për shërbimet postare, është miratuar ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” i cili është në përputhje të plotë me direktivën 97/67/EC të amenduar me direktivën 2002/39/EC dhe Direktivën 2008/6/EC.Dokumenti strategjik: Politika e Zhvillimit në Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë, e miratuar me vendimin Nr. 625, datë 24/07/2013, përcaktoi liberalizimin e mëtejshëm të tregut të shërbimeve postare nëpërmjet reduktimit të menjëhershëm të zonës së rezervuar nga 100 gram në 50 gram. Heqja e plotë e zonës së rezervuar është përcaktuar në fund të vitit 2016. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 46/2015, janë miratuar dhe aktet nënligjore që mundësojne zbatimin e tij.. Me Vendimin Nr. 11, datë 20/02/2014 Parlamenti miratoi një

strukturë të re të AKEP-it, e cila është miratuar nga Parlamenti me datë 20.02.2014 dhe strukturat që përfshijnë një drejtori për rregullimin e sektorit postar.

4. NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Më datë 17.7.2014 u miratua me Ligjin Nr. 90/2014 "Për një shtesë në ligjin Nr. 10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i cili i shton listës aktuale me 10-të profesionet të rregulluara edhe 2 profesione të tjera, atë të punonjësit social dhe psikologut. Tashmë edhe aplikantët për ushtrimin e këtyre profesioneve ju nënshtrohen provimeve të shtetit pranë AKP-së.Është miratuar Urdhri i Përbashkët i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me Nr.7340/1 Prot., datë 29.09.2015 dhe Nr. 4906 Prot., datë 29.09.2015 "Për ngritjen e Task Forcës për zhvillimin dhe zbatimin e mëtejshëm të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve".

II.3 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është institucioni kryesor që drejton. Për ta përafruar legjislacionin shqiptar me *acquis* e BE-së mbi të drejtën e vendosjes dhe të lëvizjes së lirë të shërbimeve, është ngritur një grup pune ndërinstitucional sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 39 datë 2013/02/04 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e kuadrit institucional për përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis-në e BE-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë së lëvizjes të shërbimeve".

Ajo është e përbërë nga përfaqësues të këtyre institucioneve:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
3. Ministria e Integrimit Evropian
4. Ministria e Arsimit dhe e Sporteve;
5. Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike;
6. Ministria e Drejtësisë;

7. Ministria e Financave;
8. Ministria e Mbrojtjes;
9. Ministria e Brendshme;
10. Ministria e Shëndetësisë;
11. Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës;
12. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
13. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
14. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
15. Ministria e Mjedisit;
16. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
17. Autoriteti i Medias Audio-vizuale ;
18. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
19. Banka e Shqipërisë;
20. Qendra Kombëtare e Biznesit;
21. Enti Rregullator i Energjisë;
22. Agjencia e Prokurimit Publik;
23. Njësia Monitorimi të Lojërave të Fatit;
24. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;

25. Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

26. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Organizimi institucional në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve përfshin shumë institucione dhe ka tri fusha kryesore: (i) ekipet sektoriale në terren, (ii) ekipi bazë që vërteton çdo raport të sektorit, (iii) grupi ndër-ministror i punës

II.4 Ndarja buxhetore

Year	**2017**	**2018**	**2019**
Total budget for this chapter of the leading institution	**0**	**0**	**0**
Total budget for this chapter of the other contributing institutions	0	0	**0**

III. Prioritetet

Prioritetet kryesore të kapitullit përfshijnë:

- Zbatimi i Task Plan për Kapitullin 3 për të lejuar adresimin e hershëm të të gjitha detyrimeve që lejojnë hapjen e negociatave për kapitullin;
- Krijimi i një rrjeti konsultues me shoqërinë civile dhe paltë e tjera të interesuara për diskutimin paraprak të sfidave të negocimit të kapitullit
- Ekzaminimi i legjislacionit sektorial në përputhje me *acquis* të BE në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime;
- Forcimi i kapaciteteve administrative për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave themelore në këtë fushë;
- Përshtatja dhe implementimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas përcaktimeve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe direktivave të BE dhe përgatitja e kornizës sektoriale.

- Ofrimi i programeve të studimit cilësore sipas eksperiencave më të mira evropiane duke mundësuar njohjen e diplomave të arsimit të lartë të përfituara në Shqipëri në vendet e BE, si dhe njohjen e kualifikimeve në BE për të mundësuar punësimin e specialistëve shqiptarë në vendet e BE-së.

IV. Plani i veprimit për periudhën 2017 – 2020

IV.1E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar
Strategjia e Zhvillimit të Investimeve dhe Biznesit 2014-2020 VKM nr. 635 datë 1.10.2014	MZHETTS	2014 – 2020
Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së	MZHETTS	2014 – 2020

Inventari i masave ekzistuese ligjore

Acquis i BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Shkalla e përafrimit (të plotë / të pjesshme / jo e-përafruar	Data e miratimit (legjislacionit shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2006/123/KE	Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara, I ndryshuar nga Ligji Nr. 90 / 2014"Për një shtesë në ligjin nr 10,171 datë 22.10.2009," Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë"	MAS	I pjesshëm	22.10.2009 17.7.2014	22.10.2009 17.7.2014
	Ligji Nr. 10081 datë 23.02.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet	MZHETTS	I pjesshëm	23.02.2009	23.02.2009
	Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit	MZHETTS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007
Direktiva 2006/123/KE	gji Nr. 66/2016	MZHETTS	I pjesshëm	09.06.2016	01.08.2016

Kuadri i politikave të planifikuara në periudhën 2017 – 2020

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi

Masat ligjore e planifikuara në 2016– 2018

Acquis të BE	Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në shqip	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (e plotë / përafrim i pjesshëm)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
		VKM "Për njoftimin dhe format e vlerësimit të përputhshëmrisë së legjislacionit të ri sektorial"		MZHETTS		2Q 2017	2Q 2017
		VKM "Për metodologjinë e shqyrtimit të përputhshmërisë së kritereve të legjislacionit sektorial ekzistues"		MZHETTS		2Q 2017	2Q 2017
AFAT MESME (2018 – 2020)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.2 Shërbimi postar

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha

Politika e Zhvillimit në Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë VKM 625 dt.24.7.2013	MIAP	2013 – 2017

Korniza ligjore ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Niveli i përafrimit (i plotë/pjesor/ jo i përafruar)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 97/67/KE	Ligji Nr. 8530, datë 23.09.1999 "Në shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë"	MIAP	I pjesshëm	23.9.1999	5.10.1999
Direktiva 2008/6/KE	Ligji Nr 46/2015 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë	MIAP	I pjesshëm	7.05.2015	10.6.2015
Direktiva 2008/6/KE	VKM nr. 360 datë 11.5.2016 "Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar".	MIAP	I pjesshëm	11.5.2016	18.5.2016

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Rishikim i dokumentit të politikave për sektorin postar	MIAP	2018-2020	T1 2018	T1 2018

Masat ligjore për periudhën 2017 – 2020

Acquis të BE-së	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFATSHKURTËR (2017)							
AFATMESME (2018 – 2020)							

N/A	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.3 Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	MAS	2009 – 2013
Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2015-2020 dhe Plani i Veprimit	MAS	2015-2020

Kuadri ligjor ekzistues

Acquis i BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2005/36/KE	Ligji Nr. 10171 datë 22.10.2009 " Për rregullimin e profesioneve, i ndryshuar".	MAS/ Agjencia Kombëtare e Provimeve	I pjesshëm	22.10.2009	22.11.2009
Direktiva 2013/55/BE	Vendimi Nr. 952, datë 12.12.2012 "Për përjashtimin nga përgjegjësia profesionale për provimin e shtetit për profesionet".	MAS / Agjencia Kombëtare e Provimeve	I pjesshëm	12.12.2012	12.12.2012

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (strategji, AP, dokument)	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Manuali për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve	MAS, MMSR	2015-2017	Tremujori II 2017	Tremujori III 2017

Masat ligjore të planifikuara në 2017 – 2020

Acquis të BE	Statusi i përkthimit në	Legjislacioni shqiptar	Statusi përkthimit në	Institucioni përgjegjës dhe	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar e	Hyrja në fuqi

	shqip (y/n)		anglisht (y/n)	pika e kontaktit	(përputhja e plotë / e pjesshme)	miratimit	
AFAT SHKURTËR (2017)							
Direktiva 2005/36/KE	n	Ndryshimi i Ligjit Nr. 10171 datë 22.10.2009 " Për rregullimin e profesioneve, i ndryshuar".	jo	MAS/ Agjencia Kombëtare e Provimeve	I pjesshëm	T I 2017	T II 2017
AFAT MESME (2018 – 2020)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitulli 3 : Legjislacionitregtar,					
Përfituesi: KëshilliKombëtar i Kontabilitetit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kostoqë do tëfinancohenngabuxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali(3+4+5)**
	A) Paga –stafiekzistues (400 orë *560 All/orë)				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbimembështetësetë ndryshme				
	E) Infrastrukturadhekostotnëvazhdim				
	Aktiviteti total				
	Kapitulli total				

KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet Anëtare pritet të heqin të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit dhe pagesave, si brenda BE-së, ashtu edhe mes Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. Acquis përfshin gjithashtu, edhe rregullat për pagesat ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon që bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë të identifikojnë klientët dhe të raportojnë disa transaksione, sidomos kur bëhet fjalë për objekte me vlerë të lartë dhe për transaksione me para në dorë me vlera të mëdha. Një kërkesë kyçe në luftën kundër krimit financiar është krijimi i kapaciteteve efektive administrative dhe zbatuese, përfshi edhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve që merren me mbikëqyrjen, zbatimin dhe ndjekjen penale.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) përcakton kalendarin për liberalizimin e kapitalit. Gjithashtu, parashikon lirinë dhe konvertueshmërinë e pagesave të llogarive korrente dhe të transfertave.

I.2 Situata në Shqipëri

Në fushën e lëvizjeve të kapitalit, Shqipëria ka bërë progres sa i përket, liberalizimit të transfertave dhe transaksioneve të llogarive korente dhe kapitale, dhe transfertave unilaterale ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve.
Ne fushën e sistemeve te pagesave ligji "Për sistemet e pagesave" ka realizuar një përafrim të pjesshëm me: Direktivën 98/26/KE, datë 19.05.1998 “Për finalitetin e shlyerjeve në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë”; Direktivën 2002/47/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 6 qershor 2002 mbi marrëveshjet financiare të kolateralit; Protokollin (Nr. 4) mbi statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane dhe Parimet Themelore të Bankës për Rregullimet Ndërkombëtare për Sistemet e Pagesës me Rëndësi Sistemike.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë përmes Vendimit nr.32, datë 30.04.2014 të Këshillit Mbikëqyrës miratoi "Dokumentin e Politikës së Mbikëqyrjes për Sistemet e Pagesës dhe Shlyerjes". Ky dokument politik ka për qëllim zbatimin e objektit, instrumenteve dhe metodave për mbikëqyrjen në zbatim të ligjit "Për sistemet e pagesave". Njëkohësisht dokumenti ka realizuar një përafrim të mëtejshëm me kuadrin e politikës së mbikëqyrjes së Eurosistemit (korrik 2011) si dhe ka zbatuar parimet e reja CPSS – IOSCA[1] për Infrastrukturën e Tregut Financiar (prill 2012) në ambientin shqiptar.

Me qëllim përafrimin e funksioneve mbikëqyrëse të sistemeve të pagesave me standardet e Bankës Qëndrore Evropiane (BQE), Banka e Shqipërisë ka hartuar një manual për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave. Dispozitat e këtij manuali janë harmonizuar pjesërisht me Rregulloren e Bankës Qëndrore Evropiane nr. 795/2014 për kërkesat mbikëqyrëse të sistemeve të pagesave me rëndësi sistemike; publikimin e BQE-së mbi rishikimin e kuadrit mbikëqyrës të sistemit të pagesave me vlerë të vogël dhe metodologjisë së vlerësimit të BQE-së për sistemet e pagesave.

Njëkohësisht, në kuadër të forcimit të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë, ka ndërmarë një set masash me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator dhe procedurave të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave. Në këtë kontekst, vlen të përmendet miratimi i rregullores "Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe shtëpive të klerimit" përmes Vendimit nr.82, datë 04.11.2015 të Këshillit Mbikëqyrës.

Kjo rregullore ka për qëllim të nxisë tregun e sistemeve të pagesave dhe të inkurajojë iniciativat për klerimin dhe shlyerjen e pagesave. Krijimi i infrastrukturës për klerimin dhe shlyerjen nxit përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike dhe në këtë mënyrë redukton qarkullimin e *cash*-it në ekonomi.

Parë nga perspektiva integruese, kjo rregullore përafron rregulloren e BQE-së 2014/28/ECB për kërkesat e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave me rëndësi sistemike.

Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave (KKSP) është krijuar bazuar në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 37, datë 25.06.2014, bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 133, datë 29.04.2013 "Për Sistemin e Pagesave".

Komiteti ka si qëllim që nëpërmjet veprimtarisë së tij, të mbështesë dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri, në përmbushje të objektivit ligjor të Bankës së Shqipërisë për të nxitur funksionimin normal të sistemit të pagesave

Krijimi i Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave është bazuar në praktikat më të mira të Bashkimit Evropian në fushën e pagesave, si dhe në nevojat dhe specifikat e tregut vendas. Komiteti është një entitet me karakter strategjik, konsultues dhe komunikues, vendimet e të cilit kanë për objektiv mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve pjesëmarrëse në fushën e pagesave.

Blerja e pasurive të paluajtshme nga të huajt është objekt kufizimesh: të huajt nuk lejohen të blejnë tokë bujqësore, pyje, lëndina dhe kullota. MSA parashikon përshtatjen progresive të legjislacionit në këtë fushë, me synimin që deri në 1 prill 2016 të garantohet që trajtimi i shtetasve të BE-së të jetë jo më pak i favorshëm sesa trajtimi që u akordohet shtetasve shqiptarë.

Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit koordinues për reformën në fushën e të drejtave të pronësisë ka si objektiv themelor reformën e të drejtave të pronësisë në mbështetje të konsolidimit të investimeve të qytetarëve shqiptar dhe të huaj. Në këtë kontekst, Ministria e Drejtësisë bazuar në Urdhrin e Ministrit nr.615 datë 23.01.2015 ka ngritur një grup pune për të analizuar legjislacionin në fuqi me qëllim identifikimin e ndryshimeve potenciale të akteve ligjore dhe rregullatore me objektiv lehtësimin e së drejtës së fitimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme nga të huajt.

Në këtë këndvështrim, synohet të hartohet një dokument politik ku të trajtohet problematika e heqjes së barrierave në lidhje me shit-blerjen e pasurive të paluajtshme nga qytetarët e huaj bazuar në praktikat më të mira me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimin e Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Zbatimi i kuadrit ligjor si dhe rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, ka forcuar sigurinë e kufijve dhe ka ndihmuar në reduktimin e trafikimit. Për parandalimin e pastrimit të parave, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit të sistemit parandalues dhe shkallës së përafrimit me standardet ndërkombëtare. Janë përmirësuar ndjeshëm Raportet e Aktivitetit të Dyshimtë (RAD), për vitin 2015, ku përqindjen e lartë dhe me peshë, në masën 73 %, të numrit të rasteve të dërguara në organet ligjzbatuese kanë pasur për indicie RAD të subjekteve të ligjit.

Nga strukturat përkatëse janë bërë përpjekje të vazhdueshme për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në atë ndërkombëtar, për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të subjekteve dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre, si edhe për forcimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme.

Veçanërisht për vitin 2015 ka një përmirësim të raportimit të aktiviteteve të dyshimta e cila për vitin 2015 është rritur me 7% krahasuar me vitin 2014 dhe me 136% krahasuar me vitin 2013, çka ka dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në numrin e rasteve të dërguara në agjencitë ligj zbatuese dhe në informacionet shtesë me të dhëna për to.

I.3 Struktura e kapitullit

1. REGJIMI I LËVIZJEVE TË KAPITALIT DHE PAGESAVE AKTUALE
2. SISTEMI I PAGESAVE
3. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në fushën e liberalizimit të lëvizjeve të kapitalit rrjedhin nga neni 70 dhe nenet 60-62 të MSA-së. Në fushën e pastrimit të parave rrjedhin nga neni 4 dhe neni 82 i MSA-së.

Siç duket qartë nga këto dispozita, Shqipëria ka jo vetëm detyrimin të përafrojë teknikisht legjislacion e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, por edhe të sigurojë zbatimin e duhur të tij. Në këtë etapë të procesit para-anëtarësimit, autoritete të ndryshme shtetërore duhet të përfshihen në ushtrimin për anëtarësimin. Për më tepër, meqenëse ligji i BE-së është subjekt zhvillimi të vazhdueshëm, përafrimi i ligjeve nuk përfundon me përshtatjen e ligjit shqiptar ndaj acquis aktualisht në fuqi. Është i domosdoshëm monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve në BE, si për përpjekjen para anëtarësimit ashtu edhe për përgatitjen e Shqipërisë për realitetin e përditshëm të anëtarësimit të ardhshëm në BE. Duket qartë se përafrimi me acquis të BE-së mbi lëvizjen e lirë të kapitalit nuk është një ndër fushat e prioriteteve në nenin 70 të MSA-së. Arsyetimi vetëkuptohet, pasi ligji i BE-së në këtë fushë do të zbatohet vetëm në lidhje me Shqipërinë nga data e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Duhet të vihet në dukje se MSA nuk parashikon ndonjë dispozitë të posaçme për përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në këtë fushë.

Acquis e BE-së në fushën e lëvizjes së kapitalit përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Nenet 63-66 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU);
- Direktiva 88/361/KEE, datë 24 qershor 1988 për zbatimin e Nenit 63 të Traktatit;
- Direktiva 2015/2366/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25 nëntor 2015 për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm;
- Direktiva 2009/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 6 maj 2009 që ndryshon Direktivën 98/26/EC mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së titujve dhe Direktivën2002/47/KE mbi marrëveshjet për kolateralin financiar;
- Direktiva 2009/110/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009 "Për sipërmarrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë së institucioneve te parasë elektronike", qëndryshon Direktivën 2005/60/KE dhe 2006/48/KE dhe shfuqizon Direktivën 2000/46/KE;
- Rregullorja (KE), Nr. 924/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009 mbi pagesat ndërkufitare në Komunitet dhe shfuqizim i Rregullores (KE), Nr. 2560/2001;
- Rregullorja (KE) nr. 1781/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 nëntor 2006 mbi informacionin për paguesin, që shoqëron transfertat e fondeve;
- Direktiva 2005/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (Direktiva kundër Pastrimit të Parave);
- Direktiva e Komisionit 2006/70/KE, datë 1 gusht 2006 e cila parashtron zbatimin e masave për Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me përkufizimin e 'personave të ekspozuar politikisht' dhe kriteret teknike për procedurat e thjeshtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit (customer due diligence) dhe për përjashtimin në rastin e një aktiviteti financiar të kryer në bazë rastësore ose shumë të kufizuar.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion në Shqipëri

Në përgjithësi, Shqipëria ka vepruar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja në këtë fushë:

- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Mbi taksën ndaj të ardhurave” është përafruar pjesërisht me Nenin 65 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU);Ligji Nr. 7764, datë 02.11.1993 “Mbi investimet e huaja” është përafruar pjesërisht me nenin 63 të TFEU;Ligji "Për sistemet e pagesave", është përafruar pjesërisht me: Direktivën 98/26/KE, datë 19.05.1998 “Për finalitetin e shlyerjeve në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë”; Direktivën 2002/47/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 6 qershor 2002 mbi marrëveshjet financiare të kolateralit; Protokollin (Nr. 4) mbi statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane dhe Parimet Themelore të Bankës për Rregullimet Ndërkombëtare për Sistemet e Pagesës me Rëndësi Sistemike;Ligji 9917 date 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimt te parave dhe financimin e terrorizmit” përafruar plotësisht me Direktivën 2005/60/KE mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (Direktiva kundër Pastrimit të Parave).

Ligjet dhe rregulloret e mëposhtme janë përafruar pjesërisht me Direktivën 2007/64/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 nëntor 2007 “Mbi shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”:

- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”; i ndryshuar
- Ligji nr. 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave” është përafruar pjesërisht me Direktivën 98/26/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 maj 1998 “Mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të titujve”, e ndryshuar; Direktivën 2002/47/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 qershor 2002 “Mbi marrëveshjet për kolateralin financiar”, e ndryshuar; dokumentit të Bankës për Rregullimet Ndërkombëtare (BIS) “Mbi Parimet Themelore për Sistemet e Pagesave me Rëndësi Sistemike” dhe Protokollin nr. 4 “Mbi Statutin Evropian të Bankave Qendrore”;
- Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar dhe rregulloret në zbatim të tij, janëë në përputhje me Direktivën 2005/60 EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare për qëllime të pastrimit te parave dhe financimit të terrorizmit;
- Vendimi nr. 70, datë 14.10.2009 i Këshillit Mbikëqyrës (KM) të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Për veprimtarinë valutore”, i ndryshuar, është përafruar pjesërisht me Direktivën 88/361/KEE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 qershor 1988 mbi zbatimin e nenit 67 të Traktatit.

II.3 Përmbledhje e Institucioneve përgjegjëse

Institucioni përgjegjës kryesor është Banka e Shqipërisë. Ajo mbikëqyr pagesat ndërkombëtare që rrjedhin nga veprimet tregtare, transaksionet jotregtare dhe angazhimet e bankave të tjera shqiptare, që kanë lidhur kontrata me shtete, banka apo shoqëri të huaja.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të objektivit të saj primar dhe tregut të brendshëm bankar, promovon dhe mbështet zhvillimin në bazë tregu të sistemit valutor, tregut të brendshëm financiar, sistemit të pagesave, dhe nxitjes së kushteve të favorshme monetare dhe të kreditimit për zhvillimin e rregullt, të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Në cilësinë e autoritetit monetar e mbikëqyrës të vendit, Banka e Shqipërisë ushtron funksionet e mëposhtme:

- Harton, miraton dhe zbaton politikën monetare;
- Ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të kartëmonedhës dhe të monedhës kombëtare;
- Mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë;
- Harton, miraton e zbaton regjimin e këmbimit valutor si dhe politikën e kursit të këmbimit;
- Licencon ose revokon licencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare si dhe mbikëqyr aktivitetin bankar me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar;
- Shërben si bankier, këshilltar e agjent fiskal i Republikës së Shqipërisë;
- Shërben si bankë e bankave tregtare;
- Nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave;

.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) është Njësia e Inteligjencës Financiare shqiptare e fuqizuar nga legjislacioni kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (AML / CFT për të mbledhur, administruar dhe analizuar raportet e dorëzuara nga detyruesit për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

DPPPP shpërndan informacionin drejt autoriteteve shqiptare të zbatimit të ligjit nëse ka bazë për të dyshuar se veprat e pastrimit te parave apo financimit të terrorizmit kanë qenë ose janë duke u kryer. Ajo gjithashtu bashkëpunon ngushtë me Njësitë e tjera të Inteligjencës Financiare

nëpër botë. Për më tepër, DPPPP ka edhe rol mbikëqyrës ku ajo kontrollon përputhshmërinë e detyruesit me kërkesat e ligjit për PP/FT dhe në këtë drejtim ajo bashkëpunon me të gjitha autoritetet mbikëqyrëse, veçanërisht me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

DPPPP lidhet në mënyrë aktive me zbatuesit e ligjit vendor, rregullatorët dhe homologët ndërkombëtarë, qe në mënyrë efektive të ndihmojë në zbulimin, vlerësimin dhe zhdukjen e të gjitha kërcënimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në ekonominë kombëtare. Numri total i punonjësve të DPPPP-së është 28.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave zbaton programin e Qeverisë në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Objektivat e saj kryesore renditen si më poshtë vijon:

- Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë rritjen e qëndrueshme të bujqësisë dhe prodhimit;
- Hartimi dhe përafrimi i legjislacionit në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit në përputhje me kërkesat e BE-së;
- Garantimi i informacionit mbi bujqësinë;
- Administrimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore;

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian në kuadër të Kapitullit 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit" kryesohet nga Banka e Shqipërisë dhe përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

II.4 Sqarim në lidhje me parashikimet financiare – në mijë lekë

Kapitulli 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit"	2017	2018	2019
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	**3,047**		
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	**-**		

Buxheti total i Kapitullit	**3,047**		

III. Prioritetet

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian në Raport 2016 për Shqipërinë, prioritetet në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit janë:

- zbatimi me efektivitet i legjislacionit kundër pastrimit të parave në të gjitha nivelet dhe forcimi i mëtejshëm i sistemit kombëtar të luftës kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT);
- zbatimi i plan veprimit për blerjen e pronës nga të huajt;

Ne përputhje me detyrimet qe rrjedhin nga rekomandimet e Bankes Qendrore Evropiane dhe Komisionit Evropian prioritetet ne fushën e sistemeve te pagesave janë :

- Harmonizimi i dokumentit politik dhe manualit të mbikëqyrjes me Parimet e CPSS-IOSCO dhe legjislacionin e Bankës Qëndrore Evropiane;
- Përafrimi i acquis së BE-së e rregullon fushën e shërbimeve të pagesave në Komunitet me legjislacionin bankar.

Në përputhje me dokumentet strategjik të integrimit evropian në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit prioritetet janë :

- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional, me agjencitë dhe institucionet e përfshira në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Bashkëpunimi me institucione dhe agjenci të tjera shtetërore për të bërë të mundur zgjerimin e aksesit në ato databaza të cilat janë të nevojshme në kuadër të analizës dhe shpërndarjes së informacionit për agjencitë e zbatimit të ligjit;
- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (PP/ FT) me standardet ndërkombëtare të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar dhe Acquis së BE-së.
- Rritja e bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse/licencuese të subjekteve të ligjit në drejtim të rritjes së përputhshmërisë së këtyre të fundit me legjislacionin në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

- Forcimi i sistemit parandalues për rritjen dhe përmirësimin e raportimit të transaksioneve të dyshimta.

REGJIMI I LËVIZJEVE TË KAPITALIT DHE PAGESAVE AKTUALE

IV. Plani

IV.1 Kuadri i politikave ekzistuese

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Fushën e të Drejtave të Pronësisë, 2012-2020" dhe të Planit të saj të Veprimit"	Ministria e Drejtësisë	2012 – 2020
Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2016-2018;	Banka e Shqipërisë	2016 – 2018
Politikat e mbikëqyrjes së sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 30.04.2014	Banka e Shqipërisë	2017 dhe ne vijim

IV.2 Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Nenet 63-66 TFEU	Ligi nr. 9590, datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare"	Ministria e Financave; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Ministria e Drejtësisë; Ministria e Bujqesisë.	Pjesshëm	27.07.2006	29.08.2006
	Ligji nr. 7764, datë 02.11.1993"Për investimet e huaja" i ndryshuar	Ministria e Financave; Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	2.11.1993	25.11.1993
	Rregullore nr. 70, datë 30.09.2009 "Për veprimtarinë valutore" e ndryshuar	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	14.10.2009	07.12.2009

Direktiva 88/361/KEE për zbatimin e nenit 67 të Traktatit	Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", e ndryshuar	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ;	E pjesshme	21.02.2008	27.03.2008
	Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave";	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore;	Pjesshëm	30.04.1998	23.05.1998
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar:	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Ligji nr. 7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja" i ndryshuar	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	02.11.1993	25.11.1993
	Vendimi nr. 12, datë 23.02. 2011 i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës se Shqipërisë për miratimin e disa m ndryshimeve në rregulloret "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS" dhe "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)"	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	23.02.2011	07.03.2011
	Rregullore Nr. 70 i 30.09.2009 "Për Veprimtarinë Valutore" e	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	14.10.2009	07.12.2009

	ndryshuar				
Direktiva 2007/64/BE per sherbimet e pagesave ne tregun e brendshëm	Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar"	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar"	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Ligji nr. 9902, i datës 17.04.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve"	Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	17.04.2008	22.05.2008
	Rregullore nr. 1, datë 17.01.2013. "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka";	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	17.01.2013	21.02.2013
	Rregullore nr. 28, datë 30.03.2005 "Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike"	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	30.03.2005	30.03.2005

	Rregullore nr. 11, datë 06.02.2008 "Për instrumentet e pagesave elektronike", e ndryshuar	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	06.02.2008	21.02.2013

IV.3 Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji, PV, AP, dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha referencë	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.4 Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU acquis	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2018– 2020)							

N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

SISTEMI I PAGESAVE

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2016-2018;	Banka e Shqipërisë	2016 – 2018
Dokumenti "Politikat e mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës" nr. 32, datë 30.04.2014	Banka e Shqipërisë	2017 dhe ne vijim

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 98/26/KE Mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave dhe titujve në sistemet e shlyerjes, e ndryshuar.	Ligji nr. 133, datë 29.04.2013 "Për sistemin e pagesave"	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	29.04.2013	29.05.2013
Direktiva 2002/47/KE Mbi marreveshjet e kolateralit financiar, e	Ligji nr. 9974, datë 28.07.2008 "Për kontratën e riblerjes së	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	28.07.2008	19.08.2008

ndryshuar	titujve”;				
	Ligji nr 8537, datë 18. 10.1999 “Për barrët siguruese”, i ndryshuar	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	18. 10.1999	04.12.1999
	Ligji nr. 110/2016, datë 27.10.2016 “Për falimentimin”;	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	27.10.2016	22.05.2017
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.	Banka e Shqipërisë;	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
Direktiva 2009/110/KE për sipërmarrjen , ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit së institucioneve të parasë elektronike	Rregullore nr.11, datë 06.02.2008 "Për instrumentet e pagesave elektronike"	Banka e Shqipërisë;	Pjesshëm	06.02.2008	21.02.2008
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	Banka e Shqipërisë;	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Rregullore nr. 14, datë 11.03.2009 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë” e ndryshuar;	Banka e Shqipërisë;	Pjesshëm	11.03.2009	02.03.2016
	Rregullore nr. 2 datë 17.01.2013 “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”.	Banka e Shqipërisë;	Pjesshëm	17.01.2013	21.02.2013

Direktiva 2007/64/KE per sherbimet e pagesave ne tregun e brendshem	Rregullore nr.11, datë 06.02.2008 " Për instrumentet e pagesave elektronike";	Banka e Shqipërisë;	Pjesshëm	06.02.200	21.02.2013
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Rregullore nr. 14 datë 11.03.2009 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	11.03.2009	02.03.2016
	Rregullore nr. 28, datë 30.03.2005 “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	30.03.2005	30.03.2005
	Ligji nr. 8269 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 20120

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU acquis	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2018 – 2019)							
Direktiva 2015/2366/BE per sherbimet e pagesave ne tregun e brendshem	Po	Implementimi i Direktivës 2015/2366/BE për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm në kuadrin ligjor ose	Jo	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	T4 2018	T1 2019

		rregullator bankar					

PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva2005/60/KE	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 " Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", i ndryshuar	DPPPP	I Plotë	21.05.2008	21.08.2008

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi

dokument politikash)				
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU acquis	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2017– 2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e planifikuar e fondeve të Buxhetit të Shtetit (në mijë lekë):

Kapitulli 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit“
Përfituesi:

1	2	3	4	5	6
Aktiviteti	Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit	2017	2018	2019	Totali (3+4+5)
Implementimi i Direktivës 2015/2366/BE "Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm" në kuadrin ligjor ose rregullator Shqiptar3	A) Paga –stafi ekzistues	3,047			3,047
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi	0			0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	0			0
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0			0
	Aktiviteti total	3,047			3,047
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				

3Ky aktivitet nuk do të financohet nga buxheti i shtetit por nga buxheti i Bankës së Shqipërisë.

Tabela B – Fondet e planifikuar nga asistenca e huaj

Kapitulli 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit"				
1	2	3	5	5
Përfituesi	Titulli i Projektit	Titulli i Programit/ Donatorë	Vlera ne €/ EU &GoA	Aktivitetet
		Totali për Kapitullin:		

KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE për prokurimin publik bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati për Bashkimin Evropian dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Këto parime përfshijnë transparencën, trajtimin e barabartë, konkurrencën e lirë dhe mos-diskriminimin. Parimet e lartpërmendura aplikohen në të gjitha procedurat e prokurimit, përfshirë edhe ato jashtë fushës së veprimit të direktivave evropiane për prokurimin, për shembull, procedurat e prokurimeve nën kufijtë monetarë të parashikuar nga këto direktiva, apo procedurat e koncesioneve për shërbimet. Prokurimi publik rregullohet plotësisht në legjislacionin dytësor të BE.

I.2 Situata në Shqipëri

Në fushën e prokurimit publik ka pasur progres të mirë në procesin e përafrimit me legjislacionin respektiv të BE. Legjislacioni i prokurimit publik ka pësuar gjatë viteve disa ndryshime me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me parimet e përgjithshme dhe legjislacionin e BE për dhënien e kontratave publike. Në këtë kuadër, ndryshimet më të fundit në ligjin e prokurimit publik u miratuan në muajin Dhjetor 2014, me Ligjin Nr. 182/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Në vijim, u miratuan edhe ndryshimet përkatëse në legjislacionin dytësor.

Në vitin 2013 u miratua edhe Ligji i ri për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, i ndjekur nga miratimi i legjislacionit dytësor respektiv. Ky ligj u amendua në vitin 2014 me Ligjin Nr. 88/2014, si edhe në vitin 2015 me Ligjin nr. 77/2015.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit, punë e mëtejshme duhet të ndërmerret me qëllim përafrimin e legjislacionit, përkatësisht të prokurimeve dhe koncesioneve, me direktivat e reja respektive të BE, të miratuara në fillim të vitit 2014.

Agjencia e Prokurimit Publik ka marrë masa për të siguruar transparencën e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

Ndërkohë, Komisioni i Prokurimit Publik është organi kryesor që shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë lidhur me procedurat e prokurimit.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimit publik me legjislacionin e BE në këtë fushë rrjedh nga Nenet 70 dhe 74 të MSA.

Legjislacioni i BE në fushën e prokurimit publik përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Direktiva 2004/18/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime, Gazeta Zyrtare nr. 134, Seria L e datës 30.4.2004.
- Direktiva 2004/17/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, që koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe postar, Gazeta Zyrtare nr. 134, Seria L e datës 30.4.2004.
- Direktiva 2014/24/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/EC, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- Direktiva 2014/25/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për prokurimin nga entet që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/EC, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për dhënien e kontratave të koncesioneve, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- Direktiva 2014/55/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 Prill 2014 për faturimin elektronik në prokurimin publik.
- Direktiva 2009/81/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 Korrik 2009, për koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon Direktivat 2004/17/EC dhe 2004/18/EC, Gazeta Zyrtare nr. 216, Seria L e datës 20.8.2009.

- Direktiva e Këshillit 92/13/EEC, datë 25 Shkurt 1992, që koordinon ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në lidhje me zbatimin e rregullave komunitare për procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit, Gazeta Zyrtare nr. 76, Seria L e datës 23.3.1992.
- Direktiva 89/665/EEC e Këshillit, datë 21 Dhjetor 1989, për koordinimin e ligjeve, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me aplikimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave publike të furnizimit dhe të punëve publike, Gazeta Zyrtare nr. 395, Seria L e datës 30.12.1989.
- Rregullore (EC) Nr. 2195/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 Nëntor 2002, për Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit, Gazeta Zyrtare nr. 340, Seria L e datës 16.12.2002.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi, detyrimet që rrjedhin nga MSA, në fushën e prokurimit publik, janë përmbushur. Kuadri rregullator në këtë fushë është në përgjithësi i pajtueshëm, por jo plotësisht i përafruar me *acquis*. Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, është pjesërisht i përafruar me direktivat e mëposhtme të BE:

Direktiva 2004/18/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime (e ndryshuar), Direktiva 2004/17/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, që koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin e shërbimimeve ujore, energjetike, të transportit dhe postare (e ndryshuar), Direktiva 89/665/EEC e Këshillit, datë 21 Dhjetor 1989, për koordinimin e ligjeve, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me aplikimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave publike të furnizimit dhe të punëve publike (e ndryshuar me Direktivën 2007/66/EC).

Përsa i përket koncesioneve, në reflektim të progres raporteve, në këtë fushë, të BE, në muajin Prill 2013 u miratua Ligji Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Ky ligj është pjesërisht i përafruar me Direktivën 2004/18/EC për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime. Ky ligj është amenduar së fundmi me ligjin nr. 77/2015 miratuar në muajin Korrik 2015. Ndryshimet e bëra përafrojnë pjesërisht Direktivën 2014/23/EC, Ndërkohë gjatë vitit 2016 janë miratuar

ndryshimet në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 575 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ppp” datë 10.07.2013.

Për të përafruar kuadrin ligjor kombëtar me Direktivat e reja të miratuara në këto fusha nevojiten ndryshime të mëtejshme në legjislacionin Shqiptar të prokurimit.

Për këtë, gjatë vitit 2016 është filluar nga puna për hartimin e një ligji të posaçëm për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë i cili do të transpozojë pjesërisht Direktivën 2009/81/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit. Për këtë qëllim, me Urdhrin nr. 133, datë 23.08.2016, të Kryeministrit, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektligjit ‘Për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë’” është përcaktuar edhe Grupi Ndërinstitucional i Punës i cili përbëhet nga përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

Sa i takon ndryshimeve që duhet të bëhen në ligjin bazë të prokurimit, këto janë shtyrë për shkak të procesit të vlerësimit të sistemit të prokurimit në Shqipëri të kryer gjatë vitit 2016 nga Banka Botërore në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankën Islamike

II.3 Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional rregullator në fushën e prokurimit publik përbëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP), Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) dhe Ministria e Mbrojtjes.

APP është organi qendror për mbikëqyrjen dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike. Gjithashtu, APP ka disa kompetenca, të cilat përfshijnë paraqitjen e propozimeve për ndryshime legjislative në fushën e prokurimit publik dhe ankandeve publike si edhe dhënien e këshillave dhe asistencës ligjore (sipas kërkesës) për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin procedura prokurimi publikdhe ankande publike.

Sa i takon koncesioneve/ppp, me ndryshimet e fundit të ligjit kompetencat e mësipërme i janë hequr APP dhe i kanë kaluar ATRAKO dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (MZHETTS). Kështu, në përputhje me këto ndryshime ATRAKO

asiston autoritetet kontraktore për të gjitha projektet dhe në të gjitha fazat e koncesionit/ppp si edhe mban një regjistër mbi kontratat e koncesionit/ppp të dhëna në vend. ATRAKO është organi përgjegjës për hartimin dhe propozimin e ndryshimeve të legjislacionit në këtë fushë dhe të udhëzimeve përkatëse për zbatimin e tij.

Ndërkohë, me Vendimin Nr. 12, datë 14.01.2015, "Për rishpërndarje të numrit të punonjësve, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, për vitin 2015", numri i punonjësve të APP është shtuar me 5 persona, duke çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të saj në 28 persona.. Në vijim të këtij vendimi, APP ka marrë masa për rekrutimet e stafit të ri.

KPP është organi i rishikimit, i cili trajton ankesat e operatorëve ekonomikë për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandit publik. Vendimet e KPP janë përfundimtare administrativisht. KPP përbëhet nga 20 punonjës.

Ministria e Mbrojtjes është përfshirë në Grupin Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 5 si institucioni kryesor përgjegjës për çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë. Në këtë kuadër, ky institucion, në bashkëpunim me APP, do të jetë përgjegjës për transpozimin e Direktivës 2009/81/EC mbi prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian përgjegjës për kapitullin 5 (Prokurimi publik) drejtohet nga APP.

II.4 Përcaktim i alokimeve financiare

	2017	**2018***	**2019**
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	5,330,000 ALL	n/a	5,330,000 ALL
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	718,321.6 ALL	**n/a**	**n/a**
Buxheti total i Kapitullit	**6,048,321.6 ALL**	**n/a**	**5,330,000 ALL**

***Për vitin 2018 nuk ka masa të parashikuara në plan. Për këtë arsye nuk ka as parashikim për shpenzime buxhetore.**

Per tabelat buxhetore te legjislacionit te planifikuar, ju lutem referojuni Aneksit te Tabelave Buxhetore

III. Prioritetet

Ligji aktual i prokurimit publik është pjesërisht i përafruar me legjislacionin përkatës të BE. Megjithëse disa dispozita janë plotësisht ose pjesërisht të përafruara, punë e mëtejshme legjislative nevojitet me qëllim përafrimin e plotë, sikurse përcaktuar në MSA, për këtë fushë.

Në fillim të vitit 2014 u miratuan Direktivat e reja të BE, në fushën e prokurimit publik, dhe legjislacioni shqiptar në këtë fushë duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve të nevojshme, me qëllim përafrimin me këto direktiva.

Prioritetet e Qeverisë Shqiptare reflektojnë rekomandimet e dhëna nga Komisioni Europian në Raportin e tij për Shqipërinë për vitin 2015 dhe 2016. Sipas Raportit të vitit 2016, Qeveria Shqiptare duhet të përmbushë me prioritet detyrat e mëposhtme:

1. Të marrë masa për harmonizimin e sistemit të ankimimit administrativ për procedurat e prokurimit me standartet e pavarësisë të përcaktuara në acqis-në përkatëse;
2. Të marrë masa për adresimin rekomandimeve të studimeve më të fundit me qëllim përforcimin e pajtueshmërisë me rregullat e prokurimit dhe eficencën e procedurave të prokurimit, rritjen e transparencës dhe përforcimin e monitorimit;
3. Të marrë masa për harmonizimin e mëtejshëm të rregullave të prokurimit, përfshirëfushën e koncesioneve dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si edhe ngritjen e regjistrit të koncesioneve/partneriteteve publike private.

Gjithashtu, në vijim të misionit të tyre vlerësues në fillim të vitit 2016 Banka Botërore, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillimi dhe Banka Islamike kanë përgatitur një raport me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse , i cili u prezantua në Tiranë në datën 26 Shtator 2016. Rekomandimet e dhëna në këtë raport do të shërbejnë si bazë për rishikimin e legjilsacionit shqiptar në fushën e prokurimit duke pasur parasysh edhe parashikimet e direktivave të BE-së në këtë drejtim.

IV. Plani

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategji për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë, e përfshirë në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (2014-2020)	Agjencia e Prokurimit Publik	2014-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e miratimit (legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2004/18/EC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
	Ligji Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	25.04.2013	25.05.2013
Direktiva 2004/17/EC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 2014/23/EU	Ligji Nr. 125/2015, "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat. (i ndryshuar)	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë,Turizmit dhe Sipërmarrjes, Agjencia e Trajtimit te Koncesioneve.	I pjesshëm	16.07.2015	14.08.2015
Direktiva 2014/24/EU	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 2014/25/EU	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 89/665/EEC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 92/13/EEC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007

Direktiva 2009/81/EC	-	Agjencia e Prokurimit Publik, Ministria e Mbrojtjes	Mospërputhje	-	-
Rregullore 2195/2002/EC	-	Agjencia e Prokurimit Publik	Mospërputhje	-	-

Kuadri i politikave i planifikuar

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
na				

Masat ligjore të planifikuara

Legjislacioni i BE	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për miratim	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Direktiva 2014/24/EU	Jo	-Ligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i dytë 2017	3-mujori i tretë2017
	Jo	-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014,	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i dytë 2017	3-mujori i tretë2017

		"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".					
Direktiva 89/665/EEC	Jo	-Ligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i dytë 2017	3-mujori i tretë2017
Direktiva 2014/23/EC	Jo	VKM "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.575 datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ppp"" .	Jo	MZHETTS	I pjesshëm	3-mujori i dytë 2017	3-mujori i tretë2017
	Jo	-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i dytë 2017	3-mujori i tretë2017

		prokurimit publik”.					
Direktiva 2009/81/EC	Jo	-Ligj “Për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë, furnizime, dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë”.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik Ministria e Mbrojtjes	I pjesshëm	3-mujori i parë 2017	3-mujori i dytë 2017
AFAT MESËM (2018 – 2020)							
Direktiva 2014/24/EU	Jo	-Ligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2019	3-mujori i parë 2020
	Jo	-Vendim i Këshillit të	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2019	3-mujori i parë 2020

		Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".					
Direktiva 2014/25/EU	Jo	-Ligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2019	3-mujori i parë 2020
	Jo	-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2019	3-mujori i parë 2020
Direktiva 89/665/EEC	Jo	-Ligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2019	3-mujori i parë 2020

		Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.					
	Jo	-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2019	3-mujori i parë 2020

KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI TREGTAR

I. Hyrja

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së për këtë kapitull përmban rregulla të harmonizuara në fushën e legjislacionit tregtar, të ligjit për shoqëritë tregtare, duke përfshirë edhe kërkesat e raportimit financiar, të destinuara për të lehtësuar ushtrimin e të drejtës së themelimit. Pjesa kryesore e *acquis* në këtë fushë të ligjit, janë direktivat për rregullimin e kompanive të cilat përfshijnë kërkesat e detyrueshme për falimentimin, për përcaktimin e rregullave për kompanitë publike, rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve, rregullat dhe procedurat për të lehtësuar bashkimet ndërkufitare të kompanive, etj. Gjithashtu ky kapitulli përfshin rekomandimet e Komisionit të cilat adresojnë parimet e qeverisjes së korporatave dhe direktivën për të drejtat e aksionarëve.

Acquis e BE-së në fushën e rregullave të kontabilitetit dhe auditimit përfshijnë vlerësimin e ekspozimit dhe bilancet, llogaritë vjetore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar publike dhe private, kërkesat e auditimit, si dhe sigurimin e informacionit dhe publikimin e detyrimeve. Ekzistojnë dhe rregullore që i detyrojnë kompanitë të cilat janë të listuara në një treg të rregulluar, në mënyrë që llogaritë e tyre të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të adoptuara nga Komisioni Evropian. Së fundi, Direktiva 2006/43/KE "Për Auditimin Ligjor" harmonizon rregullat duke përfshirë mes të tjerash, miratimin dhe regjistrimin e auditorëve ligjor, sigurimin e jashtëm, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e auditorit dhe zbatimin e mundshëm të standardeve ndërkombëtare të auditimit.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka bërë progres në përafrimin me *acquis* në fushën e legjislacionit tregtar duke miratuar në vitin 2008 ligjin Nr.9901 datë 14.4.2008 “Për shoqëritë tregtare”,si dhe në vitin 2012 ligjin 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitare të shoqërive tregtare”. Ka përfunduar infrastruktura teknike për aplikimin e nënshkrimit elektronik. Gjithashtu janë akredituar dy ente për lëshimin e certifikatave, një publik, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), dhe një privat, Aleat sh.k.p.

Në fushën e kontabilitetit të korporatave, ka përfunduar procesi i rishikimit të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.Në korrik 2014 me Urdhër të Ministrit të Financavenr. 64, datë 22/07/2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre” janë shpallur të detyrueshme për zbatim Standardet e Përmirësuara Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara kanë hyrje nëfuqi në 1 janar 2015. Kërkesat e standardeve kombëtare janë në linjë me SNRF për NVM, ndërsa paraqitja e pasqyrave financiare është tërësisht e përafruar me kërkesat e Direktivës 2013/34 të BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 qershor 2013 mbi pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të ndërmarrjeve, amenduar me Direktivën 2006/43 / EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit dhe shfuqizimin e Direktivave të Këshillit 78/660 / EEC dhe 83/349 / EEC Text me EEA. Ka përfunduar përkthimi dhe rishikimi i përkthimit të të gjitha përditësimeve të SNK / SNRF, të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (Londër) deri në dhjetor 2013. Janë në proces përkthimi përditësimet e

publikuara nga BSNK gjatë vitit 2015. Ndërsa në fushën e auditimit, Organi i Mbikëqyrjes Publike ka vazhduar me aktivitetet monitoruese dhe përfshirjen në auditim të drejtpërdrejtë të entiteteve me interes publik. Me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 35, datë 02.08.2013 është miratuar "Udhërrëfyesi për reformën e kontabilitetit dhe auditimit për periudhën 2013-2015".

I.3 Struktura e kapitullit

1. LEGJISLACIONI TREGTAR
2. KONTABILITETI DHE AUDITIMI

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhja e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të BE-së

Përafrimi i legjislacionit shqiptar për të drejtën tregtare buron nga neni 70 i MSA-së në bazë të së cilës Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me të drejtën e BE-së, por gjithashtu për të siguruar edhe zbatimin e saj.

Acquis të BE-së që përfshihen në këtë kapitull janë :

- Direktiva 2009/101/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 "Mbi koordinimin e masave mbrojtëse" të cilat, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, shtetet anëtare kërkojnë nga kompanitë qe t'i bëjnë këto masa ekuivalente sipas paragrafit të dytë të nenit 48-të të Traktatit, e ndryshuar;
- Direktiva 2009/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009, "Që ndryshon" Direktivat e Këshillit 77/91/KE, 78/855/KEE dhe 82/891/KEE, Direktivën 2005/56/KE dhe sa i përket kushteve për raportim dhe dokumentacion në rastin e bashkimeve dhe ndarjes;
- Direktiva 2005/56/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2005 "Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar";
- Direktiva 89/666/KEE e 21 dhjetor 1989 "Mbi kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese për degët e hapura në një shtet anëtar nga lloje të caktuara të shoqërive të qeverisura nga ligji i një shteti tjetër";
- Direktiva 2011/35/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prill 2011 "Mbi bashkimet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar publike";
- Direktiva 2004/25/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004 "Mbi tentativat për blerje";

- Direktiva 2009/102/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 “Në fushën e ligjit të kompanive për kompanitë me përgjegjësi të kufizuar private njëemërore”;
- Direktiva 2012/30/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 “Mbi koordinimin e masave mbrojtëse ose mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, të cilat janë kërkuar nga shtetet anëtare të kompanive sipas paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, në lidhje me formimin e kompanive publike me përgjegjësi të kufizuar, për mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me synimin për ti bërë ekuivalente masat mbrojtëse”;
- Direktiva 2007/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 “Mbi ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve të kompanive të listuara”;
- Rregullorja (KE) Nr. 1606/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 korrik 2002 “Mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit”;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1126/2008 e 3 nëntor 2008 “Mbi adoptimin e standardeve të caktuara ndërkombëtare të kontabilitetit në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1606/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”;
- Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershor 2013 “Lidhur me pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet që kanë të bëjnë me lloje të caktuara të ndërmarrjeve, qe ndryshon Direktivën 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE”;
- Direktiva 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 maj 2006 "Për auditim ligjor të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara".

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore legjislative

1. LEGJISLCIONI TREGTAR

Shqipëria ka bërë progres në fushën e ligjit të shoqërive tregtare, përmes miratimit të legjislacionit në fushën e bashkimeve ndërkufitare. Ligji Nr. 110, datë 15/11/2012 "Për bashkimet ndërkufitare", i cili siguron drejtimin e bashkimeve ndërkufitare bazuar në Direktivën 2005/56/KE mbi kompanitë me përgjegjësi të kufizuar.

Harmonizimi me kërkesat e Direktivës 2009/101/KE mbi koordinimin e masave për të mbrojtur interesat e anëtarëve dhe palëve të treta, si dhe Direktiva 2009/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat e Këshillit 77/ 91/KEE, 78/855/KEE dhe 82/891/KEE dhe Direktivën 2005/56/KE në lidhje me kërkesat e raportimit dhe të informacionit në rastin e bashkimit dhe ndarjeve, janë transpozuar në ligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ", i cili është miratuar me

ligjin Nr. 129/2014. Gjithashtu, janë miratuar dhe ndryshimet e ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të cilat transpozojnë plotësisht Direktivën 2009/101/ KE, me ligjin nr. 8/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. . 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. KONTABILITETI DHE AUDITIMI

Ligji shqiptar Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për Auditimin Ligjor dhe Organizmit e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Direktiva e auditimit të vitit 2006. Ky ligj është ndryshuar dhe miratuar nga Parlamenti me ligjin nr. 47/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit dhe të Kontabilistit të Miratuar”. Ligji, duke përfshirë edhe ndryshimet, është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2014/56 / EU të Parlamentit Evropian dhe te Këshillit të 16 Prill 2014 i ndryshuar me Direktivën 2006/43 / EC “Mbi auditimet statutore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara”, si dhe Rregulloren (EU) Nr 537/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 16 prill 2014 “Mbi kërkesat specifike në lidhje me auditimin e njesive ekonomike me interes publik” dhe shfuqizimin e Vendimit të Komisionit 2005/909 / EC. Fokusi kryesor i këtyre amendimeve është të forcojë pavarësinë dhe kapacitetet e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) si dhe krijimi i një strukturë profesionale të përhershme, e cila do të asistojë BMP dhe do të kryejë kontrollin e cilësisë për njësitë ekonomike me interes publik.
Në lidhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, është miratuar Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 109të 26/12/2014 "Për shpalljen e amendamenteve të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe raportimit financiartë përkthyera në gjuhën shqipe”. Urdhri i Ministrit amendohet çdo vit. Amendimet kanë hyrë në fuqi më 01.07.2014.

Të gjitha përditësimet janë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Ministria e Financave;

- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë Informatike;
- Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar,;
- Agjencia për Komunikimin Elektronik dhe;
- Postar dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

II.4 Ndarja buxhetore

Viti	**2017**	**2018**	**2019**
Buxheti total per kete kapitull I Institucionit lider Ministria e Financës	**0**	**0**	**0**
Buxheti total per kete kapitull I institucioneve te tjera	140000	140000	**0**
Buxheti total I Kapitullit	140000	140000	**0**

III. Prioritetet

Legjislacioni tregtar mbetet një nga fushat më të rëndësishme të ligjit të BE. Megjithatë, mbetet një sfidë për të përmbushur të gjitha kërkesat e *acquis* për shkak të rritjes së vëllimit të *acquis* në këtë fushë, si dhe ndryshimet e përhershme ligjore. Edhe pse disa pjesë të ligjit shqiptar mund të jetë në pajtueshmëri të plotë, ka fusha të tjera ku rishikimi më tej është i nevojshëm, sidomos në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, kryesisht në forcimin e kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

IV. Plani i veprimit për 2017 – 2020

IV.1 Legjislacioni tregtar

Kuadri ligjor ekzistues

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar
Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020 miratuar me VKM nr. 635 datë 1.10.2014	Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	2014 – 2020
Strategjia e Evropës Juglindore 2020 miratuar me VKM 611 datë 17.9.2014	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	2014 – 2020
Plani kombëtar i zbatimit të SEE 2020	MZHETTS	2014/ 17.9.2014

Kuadri ligjor ekzistues

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni	Shkalla e përafrimit (të plotë / të pjesshme / jo e-përafruar	Data e miratimit (legjislacionit shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2009/102/KE	Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar	MZHETTS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008
	Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar	MZHETTTS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007
Direktiva 89/666/KEE	Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar	MZHETTS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008
	Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të	MZHETTS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007

	Regjistrimit” i ndryshuar				
Direktiva 2009/109/KE	Ligji Nr. 9901 date 14.04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar	MZHETTS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008
	Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar	MZHETTS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007
	Ligji Nr. 110, date 15.11.2012 "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”	MZHETTS	I pjesshëm	15.11.2012	15.11.2012
Direktiva 2011/35/BE	Ligji Nr. 9901 date 14.042008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar”	MZHETTS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008
Direktiva 2005/56/BE	Ligji Nr. 110, date 15.11.2012 "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”	MZHETTS	I pjesshëm	15.11.2012	15.11.2012
Direktiva 2001/86/KE	Ligji Nr. 110, date 15.11.2012 Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”	MZHETTS	I pjesshëm	15.11.2012	15.11.2012
Direktiva 2004/25/KE	Ligji Nr. 10236 datë 18.02.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me	MZHETTS	I plotë	18.02.2010	18.02.2010

	ofertë publike"				
Direktiva 2009/101/ KE,	Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar	MZHETTS	I pjesshëm	02.10.2014	7.11.2014
Direktiva 2009/109/KE, e ndryshuar	Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar	MZHETTS	I pjesshëm	02.10.2014	7.11.2014
Direktiva 2009/101/ KE, e ndryshuar	Ligji Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar	MZHETTS	I plotë	19.2.2015	21.3.2015

Masat ligjore për periudhën 2017– 2020

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të planifikuara për periudhën 2017– 2020

Acquis e BE	Statusi i përkthimit në shqip (Y/N)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në anglisht (Y/N)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar I përafrimit (përputhja e plotë/ e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT-SHKURTËR (2017							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT-MESËM (2018– 2020)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.2 Kontabiliteti dhe auditimi

Kuadri ligjor ekzistues

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar
Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 35, date 02.08.2013 " Për Udhërrëfyesit për reformën e kontabilitetit dhe auditimit"	MF	2013-2015

Kuadri ligjor ekzistues

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni	Shkalla e përafrimit (të plotë / të pjesshme / jo e-përafruar	Data e miratimit (legjislacionit shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2006/43/KE	Ligji Nr. 10091 date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të autorizuar	MF Bordi i Mbikëqyrjes Publike të ekspertëve kontabël të regjistruar. IEKA	I pjesshëm	05.03.2009	20.03.2009
Direktiva 2013/34/BE	Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 64, date 22.07.2014 "për shpalljen e standardeve kombëtare standardet shqiptare të kontabilitetit te përmirësuara"	MF KKK	I pjesshëm	22.7.2014	01.01.2015
Direktiva 2014/56/EU	Ligji Nr. 10091 date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të autorizuar	MF Bordi i Mbikëqyrjes Publike te eksperteve kontabël te regjistruar IEKA	I pjesshëm	28.4.2016	3.6.2016

Masat ligjore për periudhën 2017– 2020

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të planifikuara në 2017– 2020

Acquis e BE	Statusi i përkthimit në shqip (Y/N)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në anglisht (Y/N)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë/ e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT-SHKURTER (2017)							
Direktiva 2013/34/BE	jo	Ligji Nr. 9228, date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar	po	MF KKK	I pjesshem	Tremujori II 2017	Tremujori II 2017
AFAT-MESME (2018– 2020)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve të buxhetit të shtetit të planifikuara për Kapitullin 6 "Legjislacioni tregtar"

Kapitulli 6 : Legjislacionitregtar,					
Përfituesi: KëshilliKombëtar i Kontabilitetit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohen nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali(3+4+5)**
Rishikim i Ligjit nr.9228, date 29.04.2004	A) Paga –stafiekzistues (400 orë *560 All/orë)				

“Përkontabilitetindhepasqyratfinanciare”	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbimembështetësetë ndryshme	140000			140000
	E) Infrastrukturadhekostotnëvazhdim				
	Aktiviteti total				
	Kapitulli total				140000

KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli paraqet një vështrim të situatës aktuale të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri, duke përfshirë njohjen me legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet përkatëse por dhe rezultatet konkrete të punës të dy institucioneve përgjegjëse. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe Ministria e Kulturës/Drejtoria e të Drejtës së Autorit janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuara direkt me çështjet e Pronësisë

Intelektuale në Shqipëri. Ato bashkëpunojnë me një sërë institucionesh të tjera, siç janë Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, etj, të cilat janë pjesë e mekanizmit zbatues të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe sigurimi i një niveli mbrojtjeje , të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e Qeverisë Shqiptare parashikuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, (neni 73). Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e Pronësisë Intelektuale me acquis communitaire, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

I.2 Situata aktuale në Shqipëri

E Drejta Autorit dhe të drejtat e lidhura me të

Ligji i Ri për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to u miratua nga Parlamenti Shqiptar më datë 31 mars 2016. Ligji hyri në fuqi 6 muaj pas botimit në fletoren zyrtare, pra me datë 20.10.2016. Ligji i ri është më i plotë dhe i integruar me zhvillimet e fundit të direktivave evropiane dhe adreson problematikat e hasura me ligjin aktual në fuqi si në kuadrin e parashikimeve më të gjera të drejtave vetjake jo pasurore ashtu edhe në parashikimet e detajuara te drejtave pasurore. Ligji për të drejtën e autorit sjell harmonizim të legjislacionit, në shkallën më të lartë të mundshme në juridiksionin shqiptar të legjislacionit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me Direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të autorit në të njëjtin nivel, nga pikëpamja juridike, me ato të vendeve të Bashkimit Evropian, detyrim që buron drejtpërsëdrejti nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.
Ligji i ri siguron gjithashtu, një mbulim më të gjerë të rasteve që përfshijnë kundërvajtje administrative apo penale, si dhe rrit sanksionet shtrënguese. Krahas këtij ligjipër të drejtën e autorit, janë bërë të gjitha sugjerimet, amendimet dhe propozimet përkatëse në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Penal. Këto amendime i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë për mendim dhe pritet miratimi i tyre. Gjithashtu, ligji i ri qartëson fushën e veprimit dhe rolet e qarta të instancave publike, kryesisht të asaj që në ligj e quajmë Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA), e cila është një transformim i Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit. DDA do të jetë një drejtori e dedikuar politikash me një gamë të gjerë kompetencash në rritje të profesionalizmit. DDA do të ketë kompetenca të reja për mbikëqyrjen e agjencive, bashkëpunim me aktorët e tjerë dhe me organet tatimore. Gjithashtu do të jetë e orientuar qartë drejt ndërgjegjësimit publik të të drejtave pasurore të krijuesve dhe fushatave të edukimit.

Nga ana tjetër, ky ligj sjell një instancë të re, që futet për herë të parë, Këshilli Kombëtar i të Drejtave të Autorit (KKDA), organ i ri i specializuar për vendosjen e tarifave të shpërblimit. KKDA do të jetë organ me vendimmarrje që certifikon metodologjinë e tarifave, për çdo

përdorues. Tarifat do të jenë transparente, konkurruese për subjektet, jo arbitrare, çka do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në formalizmin e tregut. Ligji i ri i jep fund kontestimit të tarifave nga palët dhe ndihmon artistët të përfitojnë më shumë.

Në përmbushje të gjitha detyrimeve që burojnë nga ligji Nr. 35/2016, Ministria e Kulturës dhe ZSHDA është duke punuar për përpilimin dhe hartimin e akteve ligjore dhe nënligjorë të cilat prodhon ky ligj. Këto akte do u dërgohen për mendim dhe grupeve të interesit të cilat janë pjesë e zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Me VKM nr 36 datë 20.01.2016 ngrihet Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut i cili do të jetë përgjegjës dhe për inspektimin, kontrollin dhe zbatimin e ligjit për te drejtat e autorit. Kjo pritet të rrisë performancën e monitorimit të tregut dhe efikasitetin në luftën kundër informalitetit dhe piraterisë. Aktualisht inspektorët e ZSHDA nuk janë më pjesë e strukturës organike të institucionit tonë.

Gjithashtu është planifikuar një kalendar aktivitetesh dhe fushatë ndërgjegjësimi deri ne hyrjen në ligjit të ri në fuqi.

Pronësia Industriale

Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale (2016-2020) si dokumenti kryesor strategjik në fushën e Pronësisë Intelektuale u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.527 dt. 20.07.2016, dhe u publikua në fletoren Zyrtare nr.140 dt.28/07/2016. Strategjia u hartua nga grupi Ndërinstitucional, i krijuar me urdhërin e Kryeministrit nr.112, date 26 Gusht 2015. Përgjatë procesit të hartimit të Strategjisë, DPPM-ja kishte rolin e Sekratariatit teknik, duke koordinuar punën e të gjithë Grupit Ndërinstitucional. Kontribut të veçantë në këtë kuadër dhanë dhe përfaqësuesit e Organizatës Botërore të PI-së. Qëllimet strategjike të këtij dokumenti lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor, zhvillimin dhe forcimin e institucioneve, forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet tyre, si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar, si dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit në lidhje me Pronësinë Intelektuale në vend. Fokusi i saj është përmirësimi i funksionimit të sistemit të Pronësisë Intelektuale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët, për të asistuar ekonominë shqiptare dhe qytetarët në rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe drejt standardeve më të larta. Në mënyrë specifike ajo do të mund të shërbejë si një mjet i politikës për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe garanton suksesin në treg.

Gjatë vitit 2016, DPPM hartoi një projektligj për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit nr. 9947 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Qëllimi i hartimit të këtij projektligji është përmbushja e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian, zbatimi i prioriteteve të parashikuara në

Strategjinë Kombëtare 2016-2020, shkurtimi i afateve të ekzaminimit, rritja e cilësisë së shërbimit, përafrimi me Direktivat e BE-së në fushën e pronësisë industriale të miratuara nga viti 2012 deri 2015, si dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikat e zyrave homologe ndërkombëtare.

Institucionet e zbatimit të ligjit

1- Drejtoria e Policisë së Shtetit

DPSH ka realizuar iniciativën ligjore për ndryshimin e Kodit Penal dhe me Ligjin nr 135/2015, është hartuar një dispozitë shtesë në Kodin Penal, për prodhimin dhe tregtimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara dhe të rrezikshme për jetën dhe shëndetin. Konkretisht është shtuar Neni 284/d : "Prodhimi dhe tregtimi i barnave dhe pajisjeve mjekësore te falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin", me këtë përmbajtje: "Prodhimi, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja ose ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi, importimi i barnave, substancave aktive ose lëndëve ndihmëse për prodhimin e tyre, si dhe produkteve e pajisjeve mjekësore, aksesorëve, pjesëve përbërëse ose materialeve të tyre të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, nëpërmjet internetit, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda në jetën ose shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet."

- Është realizuar iniciativa ligjore për të nënshkruar dhe ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë, Konventën e Këshillit të Europës "Për Falsifikimin e Produkteve Mjeksore dhe Krimeve të Ngjashme që Përbëjnë Kërcënim për Shëndetin Publik", ("MEDICRIME CONVENTION"- Moskë 28.10.2011), konventë kjo e cila me Vendim Nr. 520, datë 16.06.2015, të Këshillit të Ministrave është miratuar në parim; më datën 17.12.2015 është nënshkruar në Strasburg nga Ambasadori ynë në Këshillin e Europës; më datë 10.03.2016 me Ligjin nr. 18/2016 është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

DPD ka miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 1090 datë 28.12.2015 "Për disa shtesa dhe Ndryshime në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" i cili është përafruar me rregulloren 608/2013 e BE-së.

- DMPI ka përfunduar punën për:
- Draft-udhëzimin "Për disa shtesa dhe Ndryshime në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" (VKM Nr. 1090, datë 28.12.2015) i cili përafrohet me rregulloren 608/2013 e BE-së, që do të minimizojë fushat e interpretimit dhe do të formatizojë procedurat e mbrojtjes së pronësisë intelektuale.
- Draft-Manualin për doganierët bazuar në VKM Nr. 1090, datë 28.12.2015.
- Draft-Udhëzimin për IT Tools bazuar në Rregulloren (VKM Nr. 1090, datë 28.12.2015) për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale nga Shërbimi Doganor.

Në zbatim të VKM Nr 1090 datë 28.12.2015 "Për disa shtesa dhe Ndryshime në VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", DMPI ka administruar 71 aplikime për veprim të paraqitura nga mbajtësit e së drejtave të pronësisë intelektuale si dhek a miratuar 60 aplikime.

Në fushën ligjzbatuese të të drejtave të pronësisë intelektuale nga ADSH janë pezulluar mallrat të dyshuara si cenuese të një pronësie intelektuale dhe janë në proçes verifikimi 21.809 cope artikuj te ndryshem. Gjithashtu, janë shkatërruar 3815 cope artikuj te ndryshëm pasi u verifikua që cënonin një pronësi intelektuale.

Gjatë periudhës shtator 2015 – prill 2016 është trajnuar personeli i ADSH në fushën e Pronësisë Intelektuale, DMPI ka zhvilluar trajnime për stafit doganor në terren sipas planeve të punës mujore dhe sipas planit 300 ditor të trajnimit. (të trajnuar 200 persona staf i administratës Dogananore Shqiptare).

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe EU acquis

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në fushën e Pronësisë Intelektuale me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 73 i MSA-së.

Acquis e BE-së mbi Pronësisë Intelektuale përbëhen nga disa direktiva të miratuara nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. Kjo përfshin, ndër të tjera:

- Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 22 Majit 2001 mbi “Harmonizimin e disa aspekteve te te drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të ne Shoqërinë e Informacionit;
- Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 27 Shtatorit 2001 mbi “Të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti”;
- Direktiva 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi “Të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e hua-qerasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale”;
- Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi “Kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të”;
- Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Marsit 1996 mbi “Mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave”;Direktiva 2009/24/ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 Prill 2009 Mbi Mbrojtjen Ligjore të Programeve Kompjuterike.
- Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 “Mbi koordinimin e rregullave te caktuara lidhur me te drejtën e autorit dhe te drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore”;
- Direktiva 2012/28/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 “Mbi përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor”;
- Direktiva 2014/26/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 “Mbi administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura dhe licencimin e të drejtave multi-territoriale të veprave muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm”;
- Direktiva 2008/95/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 Tetor 2008 për të përafruar ligjet e Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare;
- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 6 korrik 1998 mbi “Mbrojtjen ligjore të shpikjeve bio teknologjike”;
- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 13 Tetor 1998 mbi “Mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale”;
- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 29 prill 2004 mbi “Zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale”;
- Rregullorja e Këshillit (EEC) nr. 1768/92 të datës 18 qershor 1992 "Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve mjekësore";
- Rregullorja (KE) nr. 1610/96 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 korrik 1996 "Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve";
- Rregullorja e Këshillit (EEC) nr. 2081/92 të datës 14 korrik 1992 "Për mbrojtjen e të dhënave gjeografike dhe emërtimet e origjinës së produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore".

II.2 Përmbledhja e arritjeve në legjislacion

Legjislacioni Shqiptar ne fushën e të drejtës së autorit përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Ligji Nr. 35/2016"Për të drejtën e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me të"në Republikën e Shqipërisë.
- Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 22 Majit 2001 mbi "Harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shoqërinë e Informacionit;
- Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 27 Shtatorit 2001 mbi "Të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti";
- Direktiva 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi "Të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e hua-qerasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave ë tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale";
- Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi "Kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të";
- Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Marsit 1996 mbi "Mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave";
- Direktiva 2009/24 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Prill 2009 "Mbi Mbrojtjen Ligjore të Programeve Kompjuterike"Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 mbi "Koordinimin e rregullave te caktuara lidhur me te drejtën e autorit dhe te drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore".
- Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 "Mbi koordinimin e rregullave te caktuara lidhur me te drejtën e autorit dhe te drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore";
- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 29 prill 2004 mbi "Zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale";
- Direktiva 2014/26/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 26 shkurt 2014 "Për menaxhimin Kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi-territorial i te drejtave të veprave muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm;
- Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri ushtrohet në përputhje me Instrumentet kombëtarë dhe ndërkombëtarë të mëposhtëm:

Kushtetuta (neni 58)

Konventat/ Marrëveshjet/ Traktatet ndërkombëtare ku aderon RSH-ja;

Aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat do të miratohen brenda 6 muajve nga hyrja ne fuqi e këtij ligji, si më poshtë:

- Procedurat e regjistrimit, organizimi, klasifikimi dhe tarifat e regjistrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Lista e pajisjeve, si dhe tarifat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Procedura dhe mënyra e shpërblimit të drejtë për huadhënien publike, në kuptim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrive;
- Mënyra e funksionimit, shpërblimit dhe e organizimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Tarifat e shërbimeve që kryhen nga DDA-ja dhe ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Mënyra e hartimit dhe miratimit të kodeve të standardeve e të konformitetit, si dhe e publikimit të tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin;

Legjislacioni Shqiptar në fushën e Pronësisë Industriale përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Ligji 9947 datë 07.07.2008 i ndryshuar me ligjet:
- Ligji Nr. 10/2013 datë 01.03.2013,"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale".
- Ligji Nr. 55/2014 datë 24 Qershor 2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale".

Ky ligj është përafruar me direktivat e mëposhtme:

- Direktiva 98/44/EC "Mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike";
- Direktiva 98/71/EC "Mbi mbrojtjen ligjore të disenjove industriale";
- Direktiva 2008/95/EC "Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare për markat tregtare dhe të shërbimit";
- Direktiva 2004/48/EC "Mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale.
-
- Ligji 8488 datë 13.05.1999, "Për mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara" i ndryshuar me ligjin:
- Ligji Nr. 66/2014 datë 24.07.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 8488 datë 13.05.1999 "Për mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara".

Përafruar me direktivën e mëposhtme:

- Direktiva Nr. 87/54 “Për mbrojtjen ligjore të topografisë së qarqeve të integruara”.

Aktet e mëposhtme nënligjore dalë në zbatim të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” të ndryshuar janë:

- Vendimi nr.38, datë 21.01.2015, Për “Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr.1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullores për Lëshimin e Patentave për Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit", të ndryshuar.
- Vendimi Nr. 37, datë 21.01.2015, Për Disa Shtesa dhe Ndryshime Në Vendimin Rr.883, Datë 13.5.2009, Te Këshillit Te Ministrave, “Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale”, të ndryshuar.
- Vendimi Nr. 548, date 18.06.2015, “Për disa ndryshime në Vendimin 381, datë 08.04.2009 “Për miratimin e rregullores “Për regjistrimin e disenjove industriale”.
- Vendimi Nr. 550 datë 18.06.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vedimin Nr.1706 datë 29.12.2008, “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit”.
- Vendimi nr. 549 datë 18.06.2015, “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.1705 datë 29.12.2008 “Për miratimin e rregullores “Për regjistrimin e treguesve gjeografikë”.

Gjatë vitit 2016, DPPM hartoi një projektligj për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit nr. 9947 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Gjithashtu në projektligj gjejnë zbatim Direktivat e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 98/44/EC “Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike.”
- Direktiva 2015/2436/EC, dt.16.12.2015 “Për përafrimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat.”
- Rregullorja Nr. 1151/2012/EC dt. 21.11.2012 “Për skemat e cilësisë për produktet agrikulturore dhe ushqimore”.
- Rregullorja Nr. 1308/2013/EC dt.17.12.2013 “Për themelimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve agrikulturore dhe shfuqizimi i rregulloreve (EEC) No 922/72, (EEC) No 234/79, (EC) No 1037/2001 and (EC) No 1234/2007”.
-

Projektligji u hartua në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtar WIPO, EPO, dhe EUIPO. Ndryshimet ligjore për kapitullin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës u realizuan në bashkëpunim me dy ekspertë të projektit FAO (Project TCP / ALB / 3503: Implementation of the Inter-Sectorial Strategy for agriculture and rural development in Albania 2014-2020.

Ndryshimet ligjore u konsultuan edhe me Delegacionin e Komisionit Evropian si dhe me të gjitha grupet e interesit. Si reflektim i sugjerimeve të Delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë u amendua neni 19 i ligjit 9947, në përputhje me nenet 13 dhe 14 të Direktivës 98/44/EC “Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike”.

Konkretisht objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- *Lehtësimi dhe përmirësimi i procedurave të aplikimit të objekteve të PI*

- Krijimi i mundësisë së aplikimit on-line.
- Ekzaminimi i menjëhershëm i aplikimeve për lëshimin e datës së depozitimit.

- *Lehtësimi dhe përmirësimi i procedurave të ekzaminimit.*

- Parashikimi i proçedurave për shtyrjen e afateve dhe rivendosjes në afat
- Krijimi i dhomës së kundërshtimeve
- Rikompozimi i Bordit të Apelit si një strukture edhe me ekspertë të jashtëm .
- Saktësimi i procedurave per rregjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emertimeve të origjinës.
- Përcaktimi ligjor i kritereve për markat e mirënjohura.

- *Lehtësimi dhe përmirësimi i procedurave të mbrojtjes së objekteve të PI.*

- Krijimi i bazës ligjore për liçensimin e ekspertëve të PI nga DPPM për nevojat e proceseve gjyqësore.
- Rikompozimi i Bordit të Apelit si një strukturë edhe me ekspertë të jashtëm, dhe pajisja e tij kompetenca të rëndësishme ligjore.
- Rishikimi i kritereve për licensimin e përfaqësuesve të autorizuar.
- Krijimi i bazës ligjore për krijimin e dhomës së shqyrtimit të kërkesave për shfuqizim/zhvlerësim, si strukturë brenda zyrës si dhe përcaktimi i kompetencave të kësaj dhome. Dhoma merr në shqyrtim kërkesat për shfuqizim, zhvlerësim dhe apelimet e vendimeve për refuzim të dala nga zyra.

- *Forcimi i kapaciteteve të zyrës*

a) Ndryshimi i emërtimit dhe strukturës administrative të DPPM-së nga një institucion publik buxhetor në një Agjenci Autonome në bazë të neneve 10 e 20 të Ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore," me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, si element kryesor i realizimit të misionit të saj.

Ndryshimi i strukturës organizative të DPPM do të ndikojë në:

- fleksibilitetin në marrjen e vendimeve për përmbushjen e detyrave të saj;
- mjete logjistike dhe administrative në përputhje me kërkesat e kohës;

- investimin e të ardhurave që krijohen nga PI në aktivitetet e kësaj fushe.
- fleksibilitet në përmbushjen e detyrës së saj për promovimin e objekteve të PI-së dhe trajnimin e aktorëve në sistem.

b) Ngritja e qendrës së trajnimeve për PI-në si një strukture brenda DPPM e cila do të organizojë aktivitete trajnuese me aktorët në sistemin e mbrojtjes së PI-së, si dhe aktivitete promovuese si detyrë funksionale e zyrës.

- *Krijimi i bazës ligjore për sigurimin e objekteve të PI-së, si dhe për përdorimin e tyre si kolateral.*
- Të krijojë një bazë ligjore për sigurimin e objekteve të PI dhe përdorimin e tyre si kolateral;

Aktualisht projektligji është dërguar pranë MZHETTS dhe i është përcjellë për mendim ministrive të linjës. Pas miratimit të këtij projekt ligji do të amendohen rregulloret e lartpërmendura si dhe do të hartohen rregulloret e poshtëshënuara:

- Rregullorja për ekspertët e PI , përfaqësuesit e autorizuar dhe komisionin e vlerësimit.
- Rregullorja për përcaktimin e kritereve për markat e mirënjohura;
- Rregullorja për Bordin e Apelit;
- Rregullorja për regjistrimin dhe administrimin e bazës së të dhënave shtetërore (SAPI).
- Rregullorja e brendshme e DPPIsë.
- Rregullorja për akademinë e PI.

II.3 Institucionet përgjegjëse

II.3.1 Të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të lidhura me të

Institucionet qendrore, përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Kulturës si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, konkretisht Drejtoria e të Drejtës së Autorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave. Institucione të tjera, të përfshira në procesin e zbatimit, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;

- Inspektoriati i Tregut (pas krijimit të këtij organi);
- Policia e Shtetit – Drejtoria e Krimit Ekonomik;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit/IZHA
- Shkolla e Magjistraturës;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;

II.3.2 Të drejtat e pronësisë industriale

Institucionet kryesore për zbatimin e këtij kapitulli janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe Drejtoria e të Drejtës së Autorit.

Institucionet drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale janë:
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Prokuroria;
- Policia e Krimit Ekonomik;
- Sistemi gjyqësor që ka të bëjë kryesisht me Gjykatën e Tiranës;
- Ministria e Arsimit;
- Ministria e Drejtësisë;
- Inspektoriati i Mbikqyrjes së Tregut;
- Shkolla e Magjistraturës.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian që merret me kapitullin 7 "Pronësia Intelektuale", udhëhiqet dhe koordinohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe përbëhet nga:
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
Ministria e Kulturës, Drejtoria për të Drejtën e Autorit

II.4 Përcaktim i alokimeve financiare

	2016	2017	2018
Buxheti total per kete kapitull i Institucionit lider	255,024		
Buxheti total per kete kapitull i institucioneve te tjera	1,410,130	10.321 mln –Ministria e Kulturës	
Buxheti total i Kapitullit	1,665,154		

III. Prioritetet

Rekomandimet e Komisionit Evropian (Raporti i Progresit 2016) janë si më poshtë:
Shqipëria ka nivel të caktuar përgatitje (some level of preparation) për sa i përket të drejtave të pronësisë intelektuale. Ka pasur progres në vitin e kaluar me miratimin e ligjit të ri të drejtave të autorit dhe të strategjisë së re të pronësisë intelektuale, si dhe ngritjen e Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:
→ të sigurojë zbatimin efektiv të ligjit të ri për të drejtën e autorit,
→ të përmirësojë funksionimin e agjencive të administrimit kolektiv dhe pagesën e honorareve për mbajtësit e të drejtave.

Arritjet :

- Në fushën e të drejtave të autorit, në 31 mars 2016, parlamenti miratoi ligjin e ri per te drejten autorit me qëllim përafrimin e plotë të ligjit me shtatë direktivat e BE dhe pjesërisht për ta përshtatur atë me dy të tjera.
- Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, ndryshimet e reja në ligjin e vitit 2008 mbi pronësinë industriale janë përgatitur dhe janë në fazën e konsultimit. Strategjia 2016-2020 të Pronësisë Intelektuale është miratuar më 20 korrik 2016.
- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, Zyra Evropiane e Patentave dhe Zyra e Pronësisë Intelektuale të BE-së. Bashkëpunimi i saj me institucionet relevante shtetërore është forcuar, ndërsa kapaciteti i saj administrativ ka arritur në 24 punonjës. Si rezultat i aktiviteteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, që nga shtatori 2015 numri i aplikimeve për të regjistruar marka tregtare është rritur me 24.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014-2015.

- Janë nisur procedurat penale për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale kundër 97 subjekteve, 114 persona janë ndjekur penalisht dhe 23 shkelës janë dënuar.
- Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut është kompetent për të inspektuar, kontrolluar dhe zbatuar të drejtën e autorit dhe të drejta të lidhura me të.

Prioritetet afat shkurtra të DDA-së janë:

- Përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, trajnimi dhe rritja e ekpertizës së tyre;
- Krijimi i një mekanizmi të vazhdueshëm për të forcuar bashkëpunimin me agjencitë e administrimit kolektiv si dhe për të përmirësuar gjithë sistemin në tërësi;
- Trajnimi i vazhdueshëm i sistemit gjyqësor si një nga hallkat kryesore në gjithë këtë proces mbetet prioritet;
- DDA do të sigurojë mbështetje për AKEP dhe AMA për të monitoruar zonat e tyre të tregut;
- Organizimi dhe zbatimi i mëtejshëm i fushatave të ndërgjegjësimit publik mbi çështjet e pronësisë intelektuale;
- Aplikimi i regjistrimit on-line (e-registration) të të drejtave të autorit;

Prioritetet Afat-mesme të DDA:

- Krijimi i grupit të punës për shkeljet në internet me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), dhe Autoriteti i Medias Audiovizuale (AMA)
- Forcimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;
- Futja në kurikulën mësimore dhe në cikle të tjera të arsimimit para-universitar;
- Fushata të gjera ndërgjegjësimi për komunitetin e biznesit dhe shoqërisë në tërësi;

Prioritetet e DPPM-së në periudhë afatshkurtër (2017-2018):

- Miratimi i ndryshimeve të ligjit të pronësisë industriale si dhe hartimi dhe miratimi i akteve nenligjore në zbatim të tij;
- Rikompozimi i Bordit të Apelit, si dhe pajisja e tij kompetenca të rëndësishme ligjore;
- Krijimi i dhomës për shfuqizim dhe pavlefshmëri si pjesë e DPPM;

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Lisbonës dhe Akti i Gjenevës;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Lokarnos;
- Nënshkrimi i marrëveshjes e Vjenës për krijimin e një Klasifikimi Ndërkombëtar të elementeve figurative të Markave;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të saj dhe të infrastrukturës së TIK-ut;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Industriale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- Shtimi i numrit të stafit të DPPM;
- Hartimi i udhërrëfyesit për ekzaminimin e markave dhe patentave;
- Shtimi I shërbimeve online të përmirësuara;
- Fuqizimi i qendrës së informacionit teknik dhe shkencor;
- Krijimi i qendrave të informacionit në Universitetin teknik të Vlorës;
- Përgatitja dhe organizimi i trajnimeve specifike për stafin e qendrave të informacionit mbi përdorimin e sistemit;
- Zhvillimi e aktiviteteve promovuese dhe trajnuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe biznesit;
- Trajnimi i stafit të DPPM-së, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit;
- Përfundimi i Arkivës on-line per marka, disenjo industriale dhe tregues gjeografikë;
- Kontrollimi dhe pastrimi i të dhënave të hedhura në bazën elektronike të të dhënave të DPPM;
- Forcimi i kapaciteteve administrative;
- Rritja e ndërgjegjësimit në publik për regjistrimin dhe respektimin e të drejtave të objekteve të PI, trajnimin e palëve të përfshira në sistem, etj;
- Përfundimi i saktësimit në SAPI, i të dhënave të markave ndërkombëtare;
- Implementimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale (2016-2020);
- Identifikimi i bizneseve me potencial të mundshëm inovativ si dhe organizimi i seminareve dhe aktiviteteve trajnuese në lidhje me to.
- Identifikimi i bizneseve me potencial të mundshëm për regjistrimin e shërbimeve që ato ofrojnë, si markë tregtare.
- Asistencë në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e markës tregtare dhe patentave.
-

Prioritetet e DPPM-se në periudhe afat-mesme (2019 – 2020):

- Krijimi i një Qendre Trajnimi në fushën ePI-së brenda strukturës së saj, e cila do të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve në sistem, si dhe do të hartojë tekste informuese në këtë fushë.
- Përmirësimi i strukturës organizative dhe funksionale të DPPM;

- Modernizimi i sistemeve TIK me qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve të përfshira në sistemin e regjistrimit dhe zbatimit të të drejtave të PI
- Zhvillimi i kapaciteteve dhe pajisjeve në mënyrë që të implementojë një sistem TIK modern. Sigurimi i një përputhshmërie të plotë të sistemit TIK kombëtar më atë të OBPI, ZEP dhe ZPIEU;
- Aplikimi online për të gjitha shërbimet që ofron DPPM dhe integrimi i sistemit SAPI në rrjetin e ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore, implementimin 100% për çdo dokument i depozituar në DPPM në sistemin EDMS duke e kthyer procedurat e zyrën në e-dossie.
- Nxitja e krijimtarisë tek brezat që rriten përmes aktiviteteve promovuese të ndryshme në formën e konkurseve të talenteve të rinj të degëve të ndryshme: art, letërsi, art, pikturë, interpretim ne kuadër dhe të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, çdo 26 prill. (2018-2020).
- Trajnimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në;
- Krijimi i qendrave të informacionit në Universitetet e Gjirokastrës dhe Shkodrës.
- Trajnimin e autoriteteve gjyqësore me çështjet e PI-së nëpërmjet projekte dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.
- Trajnimi i stafit të DPPM-së, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit;
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese dhe trajnuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe biznesit;
- Studimi në krahinat e ndryshme dhe sidomos në zonat rurale të Shqipërisë për të evidentuar produktet potenciale për tu mbrojtur si TG.
- Hartimi i analizës dhe përcaktimi kritereve dhe karakteristikave të produkteve potenciale të secilës krahine, për tu mbrojtur si TGJ
- Organizimi i aktiviteteve promovuese dhe trajnuese për mbrojtjen dhe regjistrimin e TGJ të organizuar sipas rretheve: Gjirokastër, Tepelene, Elbasan, Vlorë, Malësia e Madhe etj.
- Reformimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar në kurrikulë me bazë kompetencat.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve me bizneset për ndërgjegjësimin e tyre në financimin e departamenteve te kërkim zhvillimit, dhe regjistrimin e objekteve te PI-se.
- Fushata ndërgjegjësuese, me qëllim rritjen dhe forcimin e besimit të biznesit dhe qytetarëve tek administrata dhe ndryshimin e imazhit apo perceptimit qytetar për të.
- Bashkëpunim i ngushtë me Dhomat e Tregtisë në RSH për organizimin e sesioneve të ndryshme informative për kategorinë e biznesit

IV. Plani i veprimit për vitet 2017-2020

IV.1 E drejta e autorit dhe të drejta të lidhura me të

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni përgjegjës	Periudha e referencës
Strategjia Kombëtare për të drejtat e pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, (DPPM në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës/DDA	2016 – 2020

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis i BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni përgjegjës	Niveli i përshtatjes (i plotë/ i pjesshëm/ jo në përputhje)	Data e miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 93/83/EC	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Ministria e Kulturës/DDA	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne Fletoren Zyrtare Tetor 2016
Direktiva 2001/84 EC	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Ministria e Kulturës/DDA	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne fletoren Zyrtare Tetor 2016
Direktiva 2006/115 EC	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Ministria e Kulturës/DDA	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne fletoren Zyrtare Tetor 2016
Direktiva 2006/116 EC	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Ministria e Kulturës/DDA	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne fletoren Zyrtare Tetor 2016
Direktiva 96/9/EC	Ligji Nr. 35/2016 "Për të	Ministria e	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne fletoren

	Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Kulturës/DDA			Zyrtare Tetor 2016
Direktiva 2009/24/EC	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Ministria e Kulturës/DDA	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne fletoren Zyrtare Tetor 2016
Direktiva 2001/29/EC	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Ministria e Kulturës/DDA	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne fletoren Zyrtare Tetor 2016
Direktiva 2014/26 / BE	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Ministria e Kulturës/DDA	Plotësisht i përputhur	31.03.2016	6 muaj pas botimit ne fletoren Zyrtare Tetor 2016

Korniza Politike e planifikuar në 2017

Titulli	**Institucioni përgjegjës**	**Periudha e referencës**	**Data e miratimit**	**Hyrja në fuqi**

Masat ligjore e planifikuara në 2017

Acquis i BE	**Statusi i përkthimit në shqip**	**Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Statusi i përkthimit në anglisht**	**Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përshtatjes (përshtatje e plotë / e pjesshme)**	**Data e planifikuar e miratimit**	**Hyrja në fuqi**
AFAT SHKURTËR (2017)							
Direktiva 2004/48/EC	Jo	Rishikim i Kodit Penal	Jo	Ministria e Kulturës Ministria e	E plotë	3 mujori i I / 2017	3 mujori i II /2017.

		Kodit të Procedurës Penale		Drejtësisë. DDA			
AFAT MESËM (2017 –2018)							
Direktiva 2012/28/EU	Jo	Ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Jo	Ministria e Kulturës DDA	E Plote	3 mujori i I i 2018	3 mujori i I i 2018

Plan i veprimeve për periudhën 2017 – 2018

IV.2 E drejta e pronësisë industriale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM	2016-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Direktiva 98/44/EC	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	i plotë	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për	DPPM	I plotë	7.7.2008	1.11.2008

98/71/EC	pronësinë industriale", i ndryshuar				
Direktiva 2008/95/EC	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I plotë	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 2004/48/EC	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I plotë	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 87/54/EEC	Ligji Nr 8488 i 1999/05/13 "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara", i ndryshuar	DPPM	I plotë	17.07.2008	31.10.2008

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e përshtatjes**	**Hyrja në fuqi**
na				

Masat ligjore të planifikuara 2017– 2020

Acquis i BE	**Statusi i përkthimit në shqip**	**Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Statusi i përkthimit në anglisht**	**Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përshtatjes (përshtatje e plotë / e pjesshme)**	**Data e planifikuar e miratimit**	**Hyrja në fuqi**
AFAT SHKURTËR (2017)							

Direktiva 98/44/EC "Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike		Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar		DPPM	E plotë		6-mujori I/2017
Direktiva 2015/2436/EC,dt.16.12.2015 "Për përafrimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat."		Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar		DPPM	E plotë		6-mujori I/2017
Rregullorja Nr. 1151/2012/EC dt. 21.11.2012 "Për skemat e cilësisë për produktet agrikulturore dhe ushqimore".		Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar		DPPM	E plotë		6-mujori I/2017
Rregullorja Nr. 1308/2013/EC dt.17.12.2013 "Për themelimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve agrikulturore dhe shfuqizimi i rregulloreve (EEC) No 922/72, (EEC) No 234/79, (EC) No 1037/2001 and (EC) No 1234/2007".		Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar		DPPM	E plotë		6-mujori I/2017
AFAT MESËM (2018 – 2020)							

Plani i veprimit për vitet 2017 – 2020

IV.3 Zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM	2016-2020

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU acquis	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Direktiva 2004/48/EC	Ligji nr. 23/2012, datë 01.03.2012 "Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon sanksione penale kundër atyre që shkelin të drejtat e pronësisë industriale”.	Ministria e Drejtësisë	E plotë	01.03. 2012	11.04.2012

Korniza Politikave të planifikuara në 2017-2020

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi

Masat ligjore të planifikuara 2017-2020

Acquis i BE	Statusi i përkthimit në shqip	Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përshtatjes (përshtatje e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Direktiva 2004/48/EC	Po	Rishikimi I Kodit Penal dhe Kodin e Procedurës Penale	Jo	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës	I pjesshëm	Trem/1 2017	Tre mujori i 2 i 2017

AFAT MESËM (2017 – 2018)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve te buxhetit te shtetit te planifikuara

Kapitulli: 7					
Përfituesi: MZHETTS					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Miratimi i shtesave dhe ndryshimeve në ligjin 9947 datë 07.07.2008 për " Pronësisë Industriale ", i ndryshuar.	A) Paga –stafi ekzistues				
	DPPM	2,398,000			2,398,000
	Institucione te tjera				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	2,398,000			2,398,000
	Buxheti i Përfituesit total				

Përfituesi: Ministria e Kulturës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Rishikimi i Kodit Penal dhe Kodin e Procedurës Penale	A) Paga –stafi ekzistues	956,000	960,000		1,916,000
	B) Paga –stafi i ri	0	0		0
	C) Trajnimi	0	0		0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	0	0		0
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0	0		0
	Aktiviteti total	956,000	960,000		1,916,000
	Buxheti i Përfituesit total				
	Kapitulli total	4,314,000			4,314,000

KAPITULLI 8: POLITIKAT E KONKURRENCËS

I. Hyrje

1.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës” përfshin rregullat në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, rregullat lidhur me zbatueshmërinë e ndihmës shtetërore, si dhe pjesën e liberalizimit. Autoriteti i Konkurrencës është institucioni i cili mbron konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Mbrojtja e konkurrencës është një fushë e rëndësishme për zbatimin e parimeve të ekonomisë së lirë të tregut. Për të vendosur një konkurrencë të lirë dhe efektive në tregun shqiptar, Autoriteti i Konkurrencës është i angazhuar të zbatojë detyrimet e përcaktuara

në nenet 71 dhe 72 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), në zbatim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), të dokumenteve strategjikë, të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, si dhe të gjithë kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e një institucioni publik, të pavarur në vendimmarrje.

Kuadri ligjor i BE në fushën e konkurrencës përfshin rregullat e antitrust, kontrollin e përqendrimeve si dhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Ajo përfshin rregullat dhe procedurat për sjelljet anti konkurruese të ndërmarrjeve (marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimi me pozitën dominuese), kontrollin e përqendrimeve si dhe parandalimi i qeverive në dhënien e ndihmës shtetërore që shtrembëron konkurrencën në tregun e brendshëm. Rregullat e Konkurrencës janë direkt të zbatueshme në Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë me Komisionin për zbatueshmërinë e tyre. Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është promovimi dhe mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive nëpërmjet ruajtjes së mjedisit konkurrues dhe nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Ruajtja apo nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat, apo ai shtetëror, mund t'i bëjnë konkurrencës, prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, ndarjen e tregut, kufizimin apo kontrollin e prodhimit, të zhvillimit teknik, zbatimin e kushteve të ndryshme për transaksione të njëjta etj, abuzimin me pozitën dominuese, si dhe kontrollin e përqendrimeve që rrezikojnë të krijojnë, ose forcojnë një pozitë dominuese në treg.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për 2016, Shqipëria ka bërë përgatitje të moderuar në fushën e politikës së konkurrencës. Kapaciteti administrativ i AK-së është i mjaftueshëm dhe stafi i tij ka nivel të mirë ekspertize. Megjithatë, vonesat në proceset gjyqësore janë shumë të gjata dhe duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e trajnimit për gjyqtarët mbi politikën e konkurrencës. Ne fushen e ndihmes shteterore rekomandohet rritjea e pavaresise operacionale te Komisionit te Ndihmes Shteterore si dhe rritja e kapaciteteve administrative te Njesise se Ndihmes Shteterore ne MZHETS.

I.2 Situata ne Shqipëri

Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet veprimtarisë së tij, synon për një treg sa më funksional dhe objektiv, për një mirëfunksionim të tregjeve i cili të sigurojë edhe mirëqenien e konsumatorëve edhe për ti bërë tregjet më të hapura për hyrjet e reja dhe konkurruese. Autoriteti i Konkurrencës ka ndërhyrë në shumë sektorë të ekonomisë, në të cilat janë evidentuar dhe zbuluar praktika anti-konkurrenciale, duke marrë masat e duhura për rikthimin e konkurrencës në treg. Gjithashtu, janë përdorur gjerësisht instrumentet e duhura për rritjen e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës, në synim edhe të ndërgjegjësimit të aktorëve në treg për rregullat dhe parimet e konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me atë të *Acquis Communautaire* të BE-së, në synim të një kuadri të plotë ligjor në

fushën e konkurrencës. Veprimtaria e institucionit ka qenë në zbatim të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës, duke trajtua me kujdes ankesat lidhur me problematikat që shfaqen në tregje të ndryshme, si dhe të detyrave të përcaktuara në raportet e progresit nga Komisioni Evropian.

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA E KONKURRENCËS
2. NDIHMA SHTETËRORE

II. Situata aktuale

Autoriteti i Konkurrencës ushtron veprimtarinë e tij në mbështetje të rregullave të konkurrencës së lirë dhe efektive, në respektim të të gjithë kuadrit ligjor në fuqi. Në fokus të veprimtarisë së tij janë të gjitha praktikat anti-konkurrenciale, të cilat shtrembërojnë, deformojnë, apo kufizojnë, konkurrencën në treg. Sektorë dhe tregje të ndryshme dhe të ndjeshme të ekonomisë kanë qenë nën vëmendjen e Autoritetit të Konkurrencës. Për realizimin e misionit të përcaktuar në ligjin e konkurrencës, ky institucion përdor instrumentet ligjorë dhe nënligjorë siç janë procedurat hetimore për të zbuluar praktikat anti-konkurruese. Këto praktika shfaqen në formën e: marrëveshjeve të ndaluara për fiksimin e çmimeve, ndarjen e tregjeve, kufizimin apo kontrollin e prodhimit; të abuzimit me pozitën dominuese në formën e vendosjes së çmimeve të padrejta, kufizimin e prodhimit apo të shërbimit, vendosjen në pozita jo të barabarta të klientëve, apo vendosja e kushteve dhe detyrimeve shtesë në kontratë me palët e treta etj.

Autoriteti i Konkurrencës mbikëqyr ndryshimin e strukturave të tregut nëpërmjet kontrollit të përqendrimeve të ndërmarrjeve, të cilat realizohen nëpërmjet transaksioneve të shit-blerjes së aksioneve midis tyre, për të mos lejuar krijimin ose forcimin e pozitës dominuese në tregjet përkatëse.

Një nga karakteristikat e ligjit të konkurrencës dhe e aktivitetit të institucionit të konkurrencës është gjithë përfshirja dhe bashkëpunimi i faktorëve dhe i aktorëve, që është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me Parlamentin, institucionet qendrorë dhe vendore, entet rregullatorë, bizneset e organizatat e tyre, si dhe shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve. Në vijim të aktivitetit të tij Autoriteti i Konkurrencës i ka dhënë një rëndësi të veçantë advokacisë së konkurrencës. Nxitja e konkurrencës së lirë të ndërmarrjeve në treg, përbën një nga objektivat e Ligjit, i cili realizohet edhe nëpërmjet instrumentit të advokacisë dhe aktiviteteve për rritjen e kulturës së konkurrencës. Puna e Autoritetit të Konkurrencës për rritjen e kulturës së konkurrencës është përqendruar kryesisht në transparencën e plotë të procedurave të ndjekura nga Autoriteti. Kjo transparencë është respektuar edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve të Komisionit, në kohë reale, si dhe dëgjimit të aktorëve të

tjerë (institucioneve shtetërore) përpara dhënies së rekomandimeve. Gjithashtu kjo transparencë është realizuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes publike në media, e cila ka shërbyer dhe për rritjen e kulturës së konkurrencës në Shqipëri.

II.1 Përmbledhja e kërkesave te MSA dhe *Acquis Communautaire* të BE

Nenet 70, 71 dhe 72 të MSA parashikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive nga veprimet dhe praktikat anti-konkurruese, që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Neni 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", parashikon përgjegjësinë që ka Autoriteti i Konkurrencës dhe ndërhyrjen që duhet të bëjë në rastet e (1) të gjitha marrëveshjeve ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve, të cilat kanë si objektiv të tyre, ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës; (2) Abuzimit me pozicionin dominues nga një ose më shumë ndërmarrje në territoret e BE, apo të Shqipërisë, si një e tërë, ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre. Referenca janë nenet e Traktatit të Funksionimit të bashkimit Evropian dhe konkretisht nenet 101, 102 dhe 106 të tij. Gjithashtu, në bazë të Nenit 72 "Sipërmarrjet publike", parashikohet se Shqipëria zbaton për sipërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e parashikuara në Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, me referencë të veçantë tek Neni 86 (tani neni 106 I TFEU-së).

Neni 71 i MSA-së

Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Nuk janë të pajtueshme me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, në masën që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë:
   (i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;
   (ii) abuzimi me pozicionin dominues nga një ose më shumë sipërmarrje në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;
   (iii) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara.
2. Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës që zbatohen në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretues të adoptuara nga institucionet e Komunitetit.

3. Palët sigurojnë që një institucioni publik dhe funksionalisht të pavarur t'i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (i) dhe (ii) të këtij Neni, lidhur me sipërmarrjet private dhe publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta.
4. Shqipëria do të ngrejë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (iii) të këtij neni brenda katër vjetësh që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ky autoritet do të ketë, *inter alia*, kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.
5. Secila prej Palëve garanton transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke i paraqitur, *inter alia*, Palës tjetër një raport të rregullt vjetor, ose i njëjtë me të, duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të Komunitet për ndihmën shtetërore. Me kërkesë të njërës Palë, Pala tjetër jep informacione për çështje të veçanta të ndihmës publike.
6. Shqipëria do të hartojë një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4 dhe të sigurojë pajtueshmërinë e këtyre skemave ndihme me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
7. (a) Me qëllim zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 (iii), Palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se Shqipëria konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkruara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian.

   (b) Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Evropiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Autoriteti i përmendur në paragrafin 4 dhe Komisioni i Komuniteteve Evropiane atëherë do t'i vlerësojnë bashkërisht nevojën e zonave të Shqipërisë si dhe intensitetet maksimal të ndihmës në lidhje me to për hartimin e një harte ndihmash zonale në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.
8. Në lidhje me produktet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:
   - paragrafi 1 (iii) nuk zbatohet;
   - çdo praktikë në kundërshtim me paragrafin 1(i) vlerësohet sipas kritereve të vendosura nga Komuniteti në bazë të Neneve 36 dhe 37 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve specifikë të Komunitetit të adoptuar mbi këtë bazë.
9. Në qoftë se një nga Palët është e mendimit se një praktikë e veçantë nuk përputhet me termat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas këshillimeve me Këshillin e Stabilizim-Asociimit ose tridhjetë ditë pune pas kërkesës për këshillim.

   Asgjë në këtë Nen nuk cënon ose ndikon në ndonjë mënyrë marrjen, nga secila prej Palëve, të masave antidumping ose masave kundërbalancuese në përputhje me Nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

Kuadri ligjor i BE-së në fushën e konkurrencës përbëhet ndër të tjera nga aktet e mëposhtme:

- Nenet e Traktatit të Lisbonës , neni 101-102 i Traktatit të Funksionit të BE-së
- Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 "Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit;
- Rregullorja e Komisionit Evropian (EC) nr. 773/2004, e datës 7 Prill 2004 mbi kryerjen e procedurave nga ana e Komisionit në mbështetje të neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE;
- Rregullorja e Komisionit nr. 330/2010 e datës 20 Prill 2010 mbi zbatimin e nenit 101/3 të traktatit të Funksionimit të BE-së për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikat e bashkërenduara;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1217/2010, e datës 14 dhjetor 2010 "Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1218/2010, e datës 14 dhjetor 2010 "Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të specializimit;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 772/2004, e datës 27 prill 2004 "Për zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike;
- Rregullorja e Komisionit Nr 316/2014 e datës 21 Mars 2014 mbi zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike;
- Rregulloren e Komisionit Nr. 461/2010 e datës 27 Maj 2010 Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike;
- Rregullorja e Këshillit Evropian Nr 487/2009 e datës 25 Maj 2009, "Mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori marrëveshjesh dhe praktika të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror;
- Rregullorja e BE-së: Rregullorja e Këshillit nr. 246/2009 e datës 26 shkurt 2009 mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar;
- Rregullorja e Komisionit nr. 906/2009 e datës 28 Shtator 2009 mbi zbatimin e nenit 6 të ligjit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar. (kosorcium)
- Direktiva 2014/104/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 Nëntorit 2014 mbi disa rregulla qe menaxhojnë veprimet për dëmtimet sipas legjislacionit vendas për shkeljet e provizioneve te ligjit te konkurrencës te vendeve anëtare dhe te Bashkimit Evropian.

Kuadri ligjor për kontrollin e përqendrimeve përbëhet nga aktet e mëposhtme:

- Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" (Rregullorja e Përqendrimit të KE);
- Rregullorja e Komisionit 802/2004 e datës 21 Prill 2004 që implementon Rregulloren e këshillit (EC) Nr 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore ne fushën e legjislacionit

Autoriteti i Konkurrencës e mbështet veprimtarinë e tij në Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar) si dhe në një set të plotë aktesh nënligjore, përfshirë rregullore dhe udhëzime konkrete. Ligji dhe kuadri ligjor dytësor janë plotësisht të përfaruar me kuadrin ligjor të BE-së në fushën e konkurrencës , ndër te tjera me nenet e Traktatit të Lisbonës , neni 101-102-106 i Traktatit të Funksionit të BE-së; Rregulloren e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 "Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit; Rregulloren e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" (Rregullorja e Përqendrimit të KE); Njoftimin e Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës; Njoftimin e Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve ; Udhëzimin për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003; Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis), etj, si dhe akte të tjera ligjore të BE-së.

Baza ligjore e miratuar e ndihmon Autoritetin e Konkurrencës në veprimtarinë e tij dhe realizimin e misionit dhe të objektit të ligjit, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Në përgjithësi Shqipëria ka plotësuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në këtë fushë. Ligji shqiptar për ndihmën shtetërore, Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore" është amenduar dhe është plotësisht i përfaruar me direktivat e mëposhtme të BE-së: Rregullore Nr. 69/2001, (KE) e datës 12 Janar 2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën "de minimis"; Rregullore 70/2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 te Traktatit te BE-se lidhur me ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; Rregullore Nr 2204/2002 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore për punësimin" ; Rregullore Nr. 68/2001, "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën për trajnim"; Rregullore e Këshillit nr. 659/1999 "Për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE-së; Rregulloren e Komisionit "Për ndihmën De minimis" nr. 1407/2013; Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 651/2014 e 17 qershor 2014 "Për deklarimin e disa kategori të ndihmës shtetërore në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të Nenit 107 dhe 108 të

Traktatit", Vendimi i Komisionit Evropian "Për zbatimin e Nenit 106(2) TFBE "Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve që janë mandatuar për të ofruar shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik"...

II.3 Institucionet Përgjegjëse

1. Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës;
2. Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
3. Komisioni i Ndihmës Shtetërore

Autoriteti i Konkurrencës është koordinator dhe përgjegjës për kapitullin e 8 "Politika e Konkurrencës". Anëtarë të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian janë përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë ashtu si dhe të Ministrisë së Integrimit Evropian.

II.4 Direktivat e parashikimeve financiare

Autoriteti i Konkurrencës është institucion buxhetor qe financohet 100% nga buxheti i shtetit.

Viti	2017	2018	2019	
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit lider: Autoritetit të Konkurrencës	814 400	2 629 000	960 600	
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve te tjera: Ndihma Shtetërore,MZHETTS				-
Buxheti total i kapitullit	814 400	2 629 000	960600	
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit lider: Autoritetit të Konkurrencës	814 400	2 629 000	960 600	

Shpenzimet për funksionimin e Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të Komisionit të Ndihmës Shtetërore janë të përfshira në planifikimin e shpenzimeve në kuadër të programit buxhetor afat-mesëm 2017-2019 në nën programin "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi" të Ministrisë.

III. Prioritetet

Në përparësitë e Autoritetit të Konkurrencës është ruajtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, nëpërmjet zbatimit të rregullave dhe parimeve të konkurrencës, duke zbatuar dispozitat e ligjit. Në funksion të arritjes së synimeve të ligjit organik dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës, aktivitetet zbatuese të institucionit do të shtrihet në këto fusha kryesore:

- Zbatimi i ligjit antitrust, zbulimi i marrëveshjeve të ndaluara, abuzimi me pozitën dominuese si dhe kontrolli i përqendrimeve;
- Avokatia e konkurrencës nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në sektorët/tregjet ku ka të drejta ekskluzive/të veçanta, barriera të hyrjes në treg, monopolet natyrore etj.
- Realizimi i studimeve mbi të drejtat ekskluzive/të veçanta, me qëllimin kryesor rekomandimin e ndërhyrjeve për liberalizimin e tregjeve në funksion të rritjes së konkurrencës së ndërmarrjeve private dhe/ose publike sipas tregjeve përkatëse.
- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative;
- Monitorimi i tregut,
- Hetimi i përgjithshëm në sektor të ekonomisë,
- Hetimi paraprak dhe hetimi i thelluar me synim rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.
- Procesi i përfarimit të legjislacionit;
- Organizimi i seminareve dhe workshop-eve për rritjen e kapaciteteve administrative, duke kërkuar edhe asistencën e programit TAIEX
- Pjesëmarrja në seminaret trajnuese të organizuara nga ICN, RCC (OECD) etj, për trajtimin e çështjeve të konkurrencës; etj.
- Bashkëpunimi në projektin e përbashkët me Unctad në fushën e konkurrencës.

Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2015 për Shqipërinë, ka dhënë rekomandimet e mëposhtme:

- Vonesat ne procedurat e gjyqësorit janë shume te gjata dhe nevojiten përpjekje te mëtejshme për te rritur disponibilitetin dhe cilësinë e trajnimeve te gjyqtareve mbi politikat e konkurrencës.
- Te rrisë pavarësinë operacionale te Komisionit te Ndihmës Shtetërore
- Te forcoje kapacitetet administrative te njësisë se Ndihmës Shtetërore

IV. Plani i Veprimeve 2017 – 2020

VI.1 Politika e konkurrencës

Kuadri ekzistues

Titulli (Dokument strategjik ose dokument politikash)	Institucioni Kryesues	Periudha e referencës
Politika Kombëtare e Konkurrencës	Autoriteti i Konkurrencës	2006 në vijim

Inventar i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Kryesues	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/jo i zbatueshëm)	Data e miratimit	Hyrja ne fuqi
.Nenet e Traktatit të Lisbonës (neni 101-102-106 i Traktatit të Funksionit të BE-së);	Ligji Nr. 9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar);	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	28.11.2003	01.12.2003
Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003 Rregullorja e Komisionit Evropian (EC) nr. 773/2004,	Ligji Nr. 9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar); Ligji Nr. 9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar);	Autoriteti i Konkurrencës Autoriteti i Konkurrencës	I plotë I plotë	28.11.2003 28.11.2003	01.12.2003 01.12.2003

Njoftimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave nga Komisioni sipas neneve 81dhe 82 i Traktatit të KE;	Ligji Nr. 9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar);	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	28.11.2003	01.12.2003
Njoftimi i Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës;	Ligji Nr. 9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar);	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	28.11.2003	01.12.2003
Udhëzimi për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003; udhëzimi për imunitetin nga gjobat dhe reduktimin e gjobave në rastet e karteleve.	Ligji Nr. 9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar);	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	28.11.2003	01.12.2003
Njoftimi i Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis), etj.	Ligji Nr .9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar);	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	28.11.2003	01.12.2003
Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004	Ligji Nr. 9121, dt 28. 07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar);	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	28.11.2003	01.12.2003
Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1218/2010	Rregullorja "Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit"	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	26.05.2011	26.05.2011
Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1217/2010	Rregullorja "Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	03.05.2011	03.05.2011

	kërkimit dhe zhvillimit”;				
Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 772/2004	Rregullorja “Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transfertave Teknologjike”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	02.03.2011	02.03.2011
Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003	Rregullorja “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	24.02.2011	24.02.2011
Njoftimi i Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis);	Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	08.11.2011	08.11.2011
Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004	Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	14.12.2010	14.12.2010
Njoftimi i Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve dhe Udhëzime për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003;	Rregullorja “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	10.09.2009	10.09.2009
Rregulloren e Komisionit nr. 330/2010	Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	19.07.2012	19.07.2012
Rregulloren e Komisionit Nr.	Rregullorja “Për kategoritë e	Autoriteti i	I plotë	19.07.2012	19.07.2012

461/2010	marrëveshjeve në sektorin e mjeteve motorike”	Konkurrencës			
Rregulloren e Komisionit të BE-së Nr. 267/2010,	Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve”	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	18.03.2013	18.03.2013
Rregullorja e Këshillit Evropian Nr 487/2009	Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror”	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	21.05.2013	21.05.2013
Njoftimi i Komisionit - Udhëzues mbi kufizimet vertikale;	Udhëzim “Mbi vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	15.04.2010	15.04.2010
Rregullorja (EC) Nr 139/2004	Rregullorja “Mbi zbatimin e procedurave te përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”	14.12.2010	I plotë	14.12.2010	14.12.2010
Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 802/2004	Udhëzim “Mbi formën e Njoftimit të përqendrimit” si dhe Anekset përkatëse I dhe II;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	23.06.2008	23.06.2008
Udhëzime Mbi vlerësimin e përqendrimeve horizontale sipas Rregullores së Këshillit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”;	Udhëzuesi “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale ndërmjet ndërmarrjeve”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	07.12.2009	07.12.2009
Udhëzime mbi vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale sipas Rregullores së Këshillit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”;	Udhëzim “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglometare ndërmjet ndërmarrjeve”;	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	07.12.2009	07.12.2009

Njoftimi i Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës;	Udhëzimi"Për përcaktimin e tregut";	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	07.06.2008	07.06.2008
Njoftimi juridik i konsoliduar të Komisionit sipas Rregullores së Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004	Udhëzimi "Për kontrollin e përqendrimeve"	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	19.07.2012	19.07.2012
Udhëzimi "Për zbatueshmërinë e nenit 101 mbi funksionimin e bashkimit evropian për marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit"	Udhëzimi "Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale".	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	14.11.2013	14.11.2013
Rregullorja (EC) No 246/2009 Rregullorja (EC) No 906/2009	Rregullorja "Mbi kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave te bashkërenduara ne sektorin e transportit detar	Autoriteti i Konkurrencës	I Plotë	03.07.2014	03.07.2014
Njoftim I Komisionit-Udhëzim mbi zbatimin e nenit 82 te Traktatit për abuzimin me pozitën dominuese	Udhëzim" Mbi zbatimin e nenit 8 dhe 9 te ligjit nr. 9121, date 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës"	Autoriteti i Konkurrencës	I Plotë	09.10.2014	09.10.2014
Njoftimi I Komisionit "Udhëzues mbi kufizimet vertikale"	Udhëzim "Për Kufizimin e marrëveshjeve vertikale"	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	03.03.2015	03.03.2015
Njoftim i Komisionit mbi angazhimet e pranuara sipas Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 139/2004 dhe sipas Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 802/2004 (2008/C 267/01)	Udhëzimi " Për kushte dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve"	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	08.10.2015	08.10.2015
Programi i lehtësimit nga Gjobat i	Programi i Lehtësimit nga	Autoriteti i	I plotë	17.11.02015	17.11.2015

ECN	Gjobat	Konkurrencës			
Njoftim i Komisionit mbi procedurën e thjeshtuar për trajtimin e disa përqendrimeve sipas Rregullores 139/2004	Udhëzim "Për procedurën e thjeshtuar në rastet e përqendrimeve"	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	08.06.2016,	08.06.2016
Rregullorja nr. 622/2008	Rregullorja "Mbi procedurat e angazhimeve"	Autoriteti i Konkurrencës	I plotë	05.10.2016	05.10.2016

Kuadri i Planifikuar i Politikave 2017 – 2020

Titulli (Strategji, Dokument Politikash)	Institucioni Kryesues	Periudha e referencës	Data e Miratimit	Hyrja ne fuqi
N/A	Autoriteti i Konkurrencës	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të Planifikuara 2017 – 2020

Acquis e BE-së	Statusi i Përkthimit ne shqip	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit ne anglisht	Institucioni përgjegjës	Shkalla e përafrimit e synuar	Data e miratimit e planifikuar	Hyrja ne fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Rregullorja e Komisionit Nr 316/2014 e datës 21 Mars 2014 mbi zbatueshmërinë e nenit 101(3) të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve të	JO	Rregullore "Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike''	JO	Autoriteti i Konkurrencës	Plotësisht i përputhshëm	T4	T4

transfertave teknologjike (32014R0316)							

AFAT MESËM (2018 – 2020)							
Njoftim i Komisionit mbi kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për përqendrimet (2005/C 56/03)	JO	Udhëzimi "Për kufizimet e lidhura me përqendrimet"	JO	Autoriteti i Konkurrencës	Plotësisht i përputhshëm	T2 i 2018	T2 i 2018
Njoftim mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës për vlerësimin e marrëveshjeve ne sektorin e telekomunikacioneve (98/C 265/02)	JO	Udhëzim "Për vlerësimin e marrëveshjeve në sektorin e telekomunikacionev e"	JO	Autoriteti i Konkurrencës	Plotësisht i përputhshëm	T4 i 2018	T4 i 2018
Direktiva 2014/104/EU e datës 26 Nëntor 2014 mbi rregullat lidhur me veprimet për dëmet sipas ligjeve kombëtare të shteteve anëtare dhe BE-së, për shkelje të	JO	Udhëzim "Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e	JO	Autoriteti i Konkurrencës	Pjesërisht i përputhshëm	T 2 i 2019	T 2 i 2019

dispozitave të ligjit të konkurrencës (32014L0104)		Konkurrencës" (i ndryshuar)"					

IV.2 Ndihma shtetërore

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullore Nr. 69/2001, (KE)	Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	i plotë	21.04.2005	1.01.2006
Rregullore 70/2001	Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	i plotë	21.04.2005	1.01.2006
Rregullore Nr 2204/2002	Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	i plotë	21.04.2005	1.01.2006
Rregullore Nr. 68/2001	Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	i plotë	21.04.2005	1.01.2006
Rregullore e Këshillit nr. 659/1999	Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	i plotë	21.04.2005	1.01.2006
Rregulloren e Komisionit (EC) 800/2008	Ligji nr. 10183, datë 29.10.2009: "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374,datë	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	29.12.2009	15.01.2010

	21.04.2005, “Për ndihmën shtetërore”				
Udhëzimi “Për ndihmën rajonale” Nr (98/C 74/06)	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	28.12.2005	28.12.2005
Udhëzimi i Komisionit “Për ndihmën për shpëtim dhe ristrukturim”	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 28.12.2005: “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim”,	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	28.12.2005	28.12.2005
Rregullore e Komisionit Evropian Nr. 68/2001,	Udhëzim “Për disa kategori të ndihmave horizontale”, miratuar me Vendimin e KNSH nr. 23, datë 12.12.2007	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	12.12.2007	12.12.2007
Komunikatë e Komisionit për Shtetet Anëtare për amendim të komunikatës sipas nenit 93(1) të Traktatit që zbaton nenet 92 dhe 93 të Traktatit për sigurimin afatshkurtër të kredive të eksportit (2001/C 217/02)	Udhëzim "Për metodologjinë e analizës së kostove të ndihmës shtetërore në formën e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit", miratuar me Vendimin e KNSH nr. 28, datë 25.09.2008,	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	25.09.2008	25.09.2008
Udhëzimet e Komunitetit nr. 2008/C 82/1, datë 01.04.2008	Vendim i KNSH nr. 32, date 15.02.2010 Udhëzimi “Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit”	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	15.02.2010	15.02.2010
Rregulloren e Komisionit nr. 800/2008	Vendim i KNSH, Nr. 34, Dt. 02.04.2010 Udhëzimi	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore	përafruar pjesërisht	02.04.2010	02.04.2010

	"Për ndihmën shtetërore për kërkim dhe zhvillim"	MZHETS			
Komunikatën e Komisionit "Mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës në sektorin postar dhe vlerësimin e disa masave shtetërore për shërbimet postare" (98/C 39/02)	Vendim i KNSH, Nr. 37, Dt. 01.02.2011 "Udhëzim "Për ndihmën shtetërore në sektorin postar"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	01.02.2011	01.02.2011
Udhëzimi mbi ndihmën shtetërore rajonale 2007-2013	Vendimi i KNSH nr. 43, datë 11.9.2012 "Për miratimin e hartës së ndihmës shtetërore"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	11.9.2012	11.9.2012
Rregulloren nr 1407/2013 të Komisionit Evropian për zbatimin e nenit 107 dhe 108 TFBE për ndihmën de minimis; Vendimi i Komisionit Evropian "Për zbatimin e Nenit 106(2) TFBE "Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve që janë mandatuar për të ofruar shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik; Rregullore e Komisionit nr. 651/2014, 17 qershor 2014, "Deklarimi I disa kategorive të ndihmës në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të nenit 107 dhe 108 të Traktatit"	Ligji nr 21/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9374, datë 21 4 2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	15.04.2016	15.04.2016
Rregulloren nr 1407/2013 të Komisionit Evropian për zbatimin e nenit 107 dhe 108 TFBE për ndihmën de minimis	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.08.2016 "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës De Minimis"	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	përafruar pjesërisht	08.09.2016	08.09.2016
Rregulloren nr 360/2012 te Komisionit	Vendim i Këshillit të	Sektori i Kontrollit të	përafruar pjesërisht	08.09.2016	08.09.2016

Evropian "Për zbatimin e Nenit 107 dhe 108 TFBE për ndihmën de minimis dhënë ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime të interesit të përgjithshëm	Ministrave nr. 605, datë 31.08.2016 "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës De Minimis"	Ndihmës Shtetërore MZHETS			
Vendimi i Komisionit Evropian "Për zbatimin e Nenit 106(2) TFBE "Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve që janë mandatuar për të ofruar shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.650, datë 14.09.2016 "Për përcaktimin e kritereve, intensitetit dhe të procedurës për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	Përafruar pjesërisht	24.09.2016	24.09.2016

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të Planifikuara 2017 – 2020

Acquis e BE-së	Statusi i Përkthimit ne shqip	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit ne anglisht	Institucioni përgjegjës	Shkalla e përafrimit e synuar	Data e miratimit e planifikuar	Hyrja ne fuqi
Rregullore e Komisionit nr. 651/2014, 17 qershor 2014, "Deklarimi i disa	n/a	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për disa kategori të ndihmës horizontale"	n/a	Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore MZHETS	E pjesshme	Mars 2017	Prill 2017

kategorive të ndihmës në përputhje em tregun e brendshmëm në zbatim të nenit 107 dhe 108 të Traktatit”				n/a

V.Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitulli: Politika e Konkurrencës					
Përfituesi: Autoriteti i Konkurrencës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Total (3+4+5)**
Udhëzim “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar)”	A) Pagat – stafi ekzistues	0	0	960,600	960,600
	B) Pagat – stafi I ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	0	0	0	0
	Totali për aktivitet				**960,600**
Rregullore “Për kategoritë e	A) Pagat – stafi ekzistues	814, 400	0	0	814,400
	B) Pagat – stafi i ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0

marrëveshjeve të transfertave teknologjike	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	0	0	0	0
	Totali për aktivitet				**814,400**
Udhëzimi për kufizimet e varura	A) Pagat – stafi ekzistues	0	914,500	0	914,500
	B) Pagat – stafi i ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	400,000	0	400,000
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	0	0	0	0
	Totali për aktivitet				**1,314,500**
Udhëzimi për vlerësimin e marrëveshjeve ne sektorin e telekomunikacioneve	A) Pagat – stafi ekzistues	**0**	814,400		814,400
	B) Pagat – stafi i ri	**0**	**0**	**0**	
	C) Trajnime	**0**	500,000		500,000
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	**0**	**0**	**0**	**0**
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	**0**	**0**	**0**	**0**
	Totali për aktivitet				**1,314,500**
	Buxheti total i përfituesit				**4 404 000**

Tabela B – Fondet e asistencës së huaj

Kapitulli 8: **Politika e Konkurrencës** **Autoriteti i Konkurrencës**				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	Titulli i Projektit	Titulli I Programit/donatori	Shuma në €	Aktivitetet

Autoriteti i Konkurrencës	Projekt ne lidhje me zbatimin e rekomandimeve te dala nga *Peer Review*	UNCTAD	Peraf. 75, 000 Dollar	Trajnime për gjyqësorin, për stafin e AK-së, etj.
Totali :			**75, 000 $**	

KAPITULLI 9: SHËRBIMET FINANCIARE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përmban rregulla për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve. Institucionet financiare mund të veprojnë në të gjithë BE-në në përputhje me parimin e "kontrollit kombëtar", duke krijuar degë ose duke ofruar shërbime ndërkufitare.

Objektivat kryesorë të *acquis* në lidhje me shërbimet financiare janë sigurimi i stabilitetit financiar, forcimi financiar i shoqërive që operojnë në sektorin financiar dhe mbrojtja e duhur e konsumatorëve dhe investitorëve. Shërbimet financiare sipas *acquis* të Bashkimit Evropian (BE) bazohen në parimet themelore të legjislacionet parësor (traktatet) si dhe rregullohen më në detaj nga legjislacioni dytësor (rregullore, direktiva, vendime, rekomandime dhe vendimet gjyqësore).

Qëllimi është të krijohet besim mbi tregjet financiare dhe të sigurohet një fushë loje e barabartë për të gjithë aktorët e tregut. *Acquis* për shërbimet financiare përfshijnë rregullat për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarive bankare, sigurimeve, pensioneve private vullnetare dhe tregjeve të titujve, si dhe mbi infrastrukturën e tregjeve financiare. Institucionet financiare mund të kryejnë veprimtari në të gjithë BE-në, sipas parimit të "një pasaporte të vetme" dhe "kontrollit në vendin e origjinës", duke ngritur degë ose duke ofruar shërbime ndërkufitare drejtpërsëdrejti.

I.2 Situata në Shqipëri

Në tërësi, Shqipëria ka bërë përpjekje pozitive për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm të shërbimeve financiare me *acquis*. Legjislacioni aktual i Shqipërisë në fushën e shërbimeve financiare përbën një bazë të fortë për një harmonizim të mëtejshëm dhe të plotë me legjislacionin evropian. Në fushën e shërbimeve financiare bankare është konsoliduar puna për rishikimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës duke synuar përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e Bashkimit Evropian dhe përshtatjen me standardet e Komitetit të Bazelit. Në fushën e shërbimeve financiare bankare progres i mëtejshëm është realizuar përmes përafrimit të kuadrit rregullativ mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, respektivisht me kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit, kërkesat për kapitalin rregullator të bankave dhe kërkesat minimale për publikimin e informacionit me kërkesat e rregullores nr. 575/2013 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian të datës 26 qershor 2013 "Mbi kërkesat purdenciale për institucionet e kreditimit dhe shoqëritë e investimit"; kërkesat për kontratat e kredisë konsumatorë dhe hipotekare për konsumatorin me kërkesat e Direktivës 2014/17/BE "Mbi kontratat e kredisë për konsumatorët lidhur me pasurit e paluajtshme"; kërkesat për rregullimin e veprimtarisë valutore me kërkesat e neneve 60-62 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit për liberalizimin dhe lëvizjen e lirë të kapitalit; si dhe kërkesat për sistemin e kontrollit të brendshëm të bankave me Parimet e Komitetit të Bazelit (2012).

Në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare janë thelluar përpjekjet dhe është bërë progres në përafrimin e legjislacionit të tregut të sigurimeve, titujve dhe pensioneve private përkatësisht me legjislacionin evropian si : Direktiva 2004/39/EC (MiFID) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 21 prill 2004 mbi tregjet në instrumente financiare); Direktiva 2003/41/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 qershor 2003 aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për dhënien e daljes në pension në punë; Direktiva 2009/65/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrik 2009 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me ndërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS) etj. Mbas hyrjes në fuqi të *Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".*Autoriteti ka vijuar punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e Bashkimit Evropian në fushën e tregut financiar jo-bankar.

Në tregun e titujve, AMF u miratua Ligji nr.36, datë 31.03.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", i përafruar pjesërisht me Direktivën 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 13 Korrikut 2009 "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)".

Ndërkohë ka vazhduar bashkëpunimi me Bankën Botërore nëpërmjet realizimit të projekteve: (i) për rritjen e efektivitetit, forcimin e mbikëqyrjes dhe zgjerimit të mëtejshëm të tregut të pensioneve vullnetare private; (ii) të asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve dhe (iii) të asistencës teknike në tregun e kapitaleve. Ndër sfidat e rëndësishme të AMF kanë qenë zbatimi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve; nxitja e qëndrueshmërisë në tregjet financiare nëpërmjet përmirësimit të procesit të mbikëqyrjes së konsoliduar; forcimi i punës së AMF-së në drejtim të mbrojtjes dhe edukimit konsumator.
Në funksion të rregullimit ligjor të tregut të fondeve të investimit gjithnjë e në rritje, si dhe në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të veprimtarisë së operatorëve të këtij tregu AMF ka vazhduar punën për përmirësimin e bazës rregullatore për fondet e investimeve me objektivat kryesore: (i) forcimi i regjimit të transparencës ndaj klientit/investitorit; dhe (ii) përmirësimi i kërkesave për administrimin e rreziqeve në treg.

I.3 Struktura e kapitullit

1. BANKAT
2. SIGURIMI DHE SIGURIMI PENSIONAL
3. TREGU I KAPITALEVE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Përafrimi i kuadrit ligjor në fushën e shërbimeve financiare me *acquis*, lind si detyrim për përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të neneve 50, 57, 70,82 dhe 89 të MSA-së.

Legjislacioni evropian në fushën e shërbimeve financiare përbëhet nga aktet ligjore te mëposhtme:

Aneksi I: Legjislacioni i BE-së në fushën e shërbimeve financiare

- Rregullore e BE-së nr. 648/2012 "Për mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditimit dhe shoqërive të investimit";
- Direktiva 2013/36/KE "Për aksesin e aktivitetit të institucioneve të kreditimit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditimit dhe shoqërive te investimit"
- Rregullore (BE) Nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 qershor 2013 " Mbi kërkesat e kujdesshme për institucionet e kreditimit dhe shoqëritë e investimit'' që ndryshorn Rregulloren (BE) Nr. 648/20;
-
- Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 shtator 2007 që ndryshon Direktivën e Këshillit, 92/49/KEE dhe Direktivat 2002/83/KE, 2004/39/KE, 2005/68/KE dhe 2006/48/KE në lidhje me rregullat procedurale dhe kriteret e vlerësimit për vlerësimin prudencial të blerjeve dhe rritjes së pjesëmarrjes në sektorin financiar ;
- Direktiva 2009/111/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat 2006/48/KE, 2006/49/KE dhe 2007/64/KE në lidhje me bankat që kanë lidhje me institucione qendrore, disa çështje për fondet e veta, ekspozimet e mëdha, masat mbikëqyrëse, dhe administrimin e krizave (Direktiva për Kërkesat për Kapital II) ;
- Direktiva 2010/76/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 nëntor 2010 që ndryshon Direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE në lidhje me kërkesat për kapital për portofolin e librit te tregtueshëm dhe rishikimin mbikëqyrës të politikave të remunerimit;
- Direktiva 2002/47/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 qershor 2002 mbi marrëveshjeve të kolateralit financiar;
- Direktiva 2001/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 prill 2001 për riorganizimin dhe likuidimin e institucioneve të kreditit;

- Direktiva 2008/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 prill 2008 për marrëveshjet e kredisë për konsumatorët që shfuqizon Direktivën 87/102/KEE;
- Direktiva 2002/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 shtator 2002 lidhur me marketingun në distancë të shërbimeve financiare për konsumatorin që ndryshon Direktivën 90/619/KEE dhe Direktivat 97/7/KE dhe 98/27/KE;
- Direktiva 1986/635/KEE e Këshillit e datës 8 dhjetor 1986 për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të bankave dhe institucioneve të tjera financiare ;
- Direktiva e Këshillit 1989/117/KEE e datës 13 shkurt 1989 për detyrimin e degëve të vendosura në një Shtet Anëtar të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare që i kanë selitë qendrore jashtë atij Shteti Anëtar në lidhje me publikimin e dokumenteve të llogarive vjetore ;
- Direktiva 2001/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 shtator 2001 që ndryshon direktivat 78/660/KEE, 83/349/KEE dhe 86/635/KEE në lidhje me rregullat e vlerësimit për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të disa lloj kompanive si dhe bankave dhe institucioneve të tjera financiare ;
- Direktiva 2003/51/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 qershor 2003 që ndryshon direktivat 78/660/KEE, 83/349/KEE, 86/635/KEE dhe 91/674/KEE në lidhje me rregullat e vlerësimit për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të disa lloj kompanive si dhe bankave dhe institucioneve të tjera financiare, si dhe sipërmarrjeve në fushën e sigurimeve ;
- Direktiva 2009/110/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 mbi marrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike, ndryshimit Direktivat 2005/60/ KE dhe 2006/48/ KE dhe shfuqizimi i Direktivës 2000/46/KE;
- Direktiva 2007/64/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 Nëntor 2007 në shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm që ndryshon Direktivat 97/7/ KE, 2002/65/ KE, 2005/60/ KE dhe 2006/48/ KE dhe shfuqizon Direktivën 97/5/ KE;
- Direktiva 94/19/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 30 maj 1994 për skemat e depozitave të garancisë;
- Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 Korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës;
- Direktiva e Këshillit 73/240/KEE, datë 24 Korrik 1973, që heq kufizimet mbi lirinë e vendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës;
- Direktiva 87/344/KEE, datë 22 Qershor 1987, mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sigurimin e shpenzimeve ligjore;
- Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/KEE, datë 22 Qershor 1988, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet Direktiva 73/239/KEE;

- Direktiva e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 Qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, dhe për ndryshimin e Direktivës 73/239/KEE dhe Direktivës 88/357/KEE (Direktiva e tretë për sigurimet jo- jetë);
- Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 Mars 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jo- jetë;
- Direktiva e Këshillit 91/674/KEE, datë 19 Dhjetor 1991 për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjeve të sigurimeve;
- Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27 Tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në grupin e sigurimeve;
- Direktiva 2002/92/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 9 Dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime;
  Direktiva 2005/68/KE datë 16 Nëntor 2005, dhe amenduar Direktivat e Këshillit 73/239/KEE, 92/49/KEE si dhe Direktivat 98/78/KE dhe 2002/83/KE Mbi risigurimin;
- Direktiva 2002/83/KE datë 5 Nëntor 2002, për sigurimin e jetës;
- Direktiva 2001/17/KE për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të sigurimeve;
- Direktiva 2009/138/KE datë 25 Nëntorit 2009 mbi krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit (Solvency II);
- Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 Prill 2004 "Mbi tregjet e instrumenteve financiarë" që ka ndryshuar Direktivën 85/611/KEE dhe 93/6/KEE dhe Direktivën 2000/12/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe ka shfuqizuar Direktivën 93/22/KEE;
- Direktiva 2003/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 Janar 2003 "Për trajtimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut";
- Direktiva 2003/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 4 Nëntorit 2003 "Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t'u tregtuar" që amendon Direktivën;
- Direktiva 2010/73/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 24 Nëntor 2010 që ka ndryshuar Direktivën 2003/71/KE "Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t'u tregtuar" dhe Direktivën 2004/109/KE "Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth emetuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta";
- Direktiva 2004/109/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 Dhjetorit 2004 "Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta dhe që ka ndryshuar Direktivën 2001/34/KE;
- Direktiva 2001/34/KE e Parlament Evropian dhe e Këshillit të 28 Maj 2001 "Mbi pranimin e titujve në listimin e bursave zyrtare të titujve dhe informacioni që duhet publikuar për këto tituj";

- Direktiva 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 3 Qershorit 2003 “Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale”;
- Direktiva 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 16 Shtatorit 2009 “Në lidhje me sigurimin kundër përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike”;
- Direktiva 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 13 Korrikut 2009 “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)”;
- Direktiva e Këshillit 78/473/KEE e 20 Maj 1978 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me bashkësigurimin komunitar;
- Direktiva e Këshillit 84/641/KEE e 10 Dhjetorit 1984 për ndryshimin, sidomos lidhur me asistencën turistike, e Direktivës së Parë (73/239/KEE) për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (84/641/KEE);
- Rregullorja (KE) Nr. 583/ 2010 e datës 1 Korrik 2010 që ka implementuar Direktivën 2009/65/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me informacionin kyç të investitorit dhe kushtet që duhet të plotësohen kur sigurohet informacioni kyç i investitorit ose prospektit të aksesueshëm gjatë një periudhe të përshtatshme, e ndryshme nga ajo në letër dhe në formë elektronike;
- Rregullorja (KE) Nr. 1606/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 korrik 2002 për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;
- Direktiva 2014/65KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi tregjet e instrumenteve financiarë” që ka ndryshuar Direktivën 2002/92/KE dhe Direktivën 2011/161/KE.(MiFID II).
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Total (3+4+5)**
Udhëzim mbi substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimin e tyre në lidhje me nivelet maksimale të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore	A) Paga –stafi ekzistues	470			470
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
VKM për informimin e konsumatorit në lidhje me ushqimin	A) Paga –stafi ekzistues	5024			**5024**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				

Urdhër për Sarmonellën tek derrat me karkas	A) Paga –stafi ekzistues		564		**564**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Udhezim ne lidhje me lengjet e frutave dhe produktet e ngjashme me to	A) Paga –stafi ekzistues		470		**470**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Udhezim mbi ushqimet per bebe dhe femije te vegjel, ushqime per qellime te caktuara mjeksore dhe zevendesimi i plote i dietave per kontrollin e peshes	A) Paga –stafi ekzistues		470		**470**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
Udhezim mbi perdorimin e ujit te ngrohte te ricikluar per te larguar kontaminimin mikrobiologjik siperfaqesor nga karkasat	**Totali i Aktivitetit**				
	A) Paga –stafi ekzistues		470		**470**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
Udhëzim mbi aditivët ushqimor	**Totali i Aktivitetit**				
	A) Paga –stafi ekzistues			470	**470**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Udhezim ne lidhje me rregullat per	A) Paga –stafi ekzistues			470	**470**

etiketimin e mishit te gjedhit dhe produkteve te tij	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Kapitullit				
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Total (3+4+5)**
Urdhër i Ministrit "Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë tregtinë e dhenve dhe dhive si dhe modeli certifikatave shëndetësore dhe kërkesat shëndetësore në lidhje me skrapien**.**	A) Paga –stafi ekzistues	1553			1553
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit "Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë tregtinë në vend dhe të importit nga vendet e treta të embrioneve të kafshëve shtëpiake të llojit të gjedhit"	A) Paga –stafi ekzistues	1398			**1398**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit "Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë lëvizjen dhe importin e njëthundrakëve nga vendet e treta	A) Paga –stafi ekzistues	1390			**1390**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit "Për mbrojtjen e kafshëve që përdoren për qëllime shkencore"	A) Paga –stafi ekzistues	1390			**1390**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit " Mbi përcaktimin	A) Paga –stafi ekzistues		904		**904**

e kritereve për planet kombëtare për çrrënjosjen e brucelozës, tuberkulozi dhe leukozës enzotike në gjedh.	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit "Mbi listën e produkteve mjekësore veterinare që janë substanca thelbësore për trajtimin e njëthundrakëve".	A) Paga –stafi ekzistues		904		**904**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit "Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve për importet e zogjve të caktuar dhe kushtet e karantinës së tyre"	A) Paga –stafi ekzistues		904		**904**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit "Mbi rregullat minimale për mbrojtjen e pulave mbahen për prodhimin e mishit"	A) Paga –stafi ekzistues			904	**904**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Urdhër i Ministrit "Mbi kërkesat minimale për mbledhjen e informacionit gjatë inspektimeve të vendeve të prodhimit ku kafshë të caktuara mbahen për qëllime bujqësore"	A) Paga –stafi ekzistues			904	**904**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
Përfituesi: MBROJTJA E BIMEVE					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga**	**2017**	**2018**	**2019**	**Total (3+4+5)**

	buxheti i shtetit				
Vendim i Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e PMB-ve"	A) Paga –stafi ekzistues	5000			**5000**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar"	A) Paga –stafi ekzistues		3693		**3693**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Vendim të Këshillit të Ministrave "Për rregullat për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve si dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit".	A) Paga –stafi ekzistues		3000		**3000**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Vendim i Këshillit të Ministrave"Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kritereve të vlerësimit të PMB-ve"	A) Paga –stafi ekzistues		4800		**4800**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Udhëzim për lëvizjen e bimëve ose e produkteve bimore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet edhe duke i shoqëruar ato me pasaportë bimore, e cila është një dokument i lëshuar nga prodhuesi i autorizuar. SPMB verifikon plotësimin e kushteve dhe kritereve për lëshimin e	A) Paga –stafi ekzistues		470		**470**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				

pasaportës bimore nga prodhuesit e autorizuar.					
UDHEZIM për Rregullat për njohjen e zonave të pastra .	**Totali i Aktivitetit**				
	A) Paga –stafi ekzistues		500		**500**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
UDHEZIM për Miratimi i njohjes së "zonës së pastër".	**Totali i Aktivitetit**			500	**500**
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
UDHEZIM për Procedurat, kushtet dhe kriteret për pajisjen me pasaportë bimore .	**Totali i Aktivitetit**			500	**500**
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
Përfituesi: FARAT					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Total (3+4+5)**
Udhezim "Per kerkesat e tregtimit, menyren e ambalazhimit dhe etiketimit te farave te perziera.	A) Paga –stafi ekzistues	725			725
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Vendim i Keshillit te Ministrave "Per kontrollin, marrjen e mostrave dhe	A) Paga –stafi ekzistues		4800		**4800**
	B) Paga –stafi i ri				

analizimin e materialit mbjelles e shumezues bimor”.	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
	Totali i Kapitullit	**16950**	**21949**	**3748**	**42647**

Tabela B – Fondet e planifikuar nga asistenca e huaj

	Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare			
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
MBZHRAU	Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit, për luftimin e sëmundjeve zoonotike- Faza II	IPA 2012	4,900,000	-Krijimi i sistemit për sëmundjet dhe sistemi i mbikqyrjes; -Fushatë vaksinimi; -Furnizmi me paisje laboratorike dhe reagentë; -Asistencë teknike për ISUV dhe MBZHRAU
MBZHRAU	Forcimi i Laboratorëve të Sigurisë Ushqimore	IPA 2013	4,400,000	- Ristrukturimi dhe forcimi i sigurisë ushqimore dhe rrjetit të laboratorit veterinar në Shqipëri; - Furnizim për laboratorët e sigurisë ushqimore në ISUV dhe drejtoritë rajonale të AKU
MBZHRAU	Mbeshtetje per standartet e sigurise ushqimore, veterinaries dhe fitosanitetit.(Programi eshte parashikuar nen IPA 2016 per Shqiperine.Ky project eshte	IPA 2016	5,000,000 vetem kontribut i BE-se	Aftesite e nje administrate te pershtatshme dhe te riorganizuar e krijuar ne linje me axhenden e reformes se administrates publike eshte rritur;

	parashikuar nen Buxhetin Afatmesem 2017-2019per MBZHRAU)			Kapacitetet administrative per te miratuar, zbatuar dhe integruar acquise e BE-se dhe standartet ne fushen e sigurise ushqimore, veterinaries dhe fitosanitetit eshte garantuar Ndergjegjesimi i konsumatoreve dhe pjesemarrja active e konsumatorit lidhur me organizatat eshte permiresuar persa i perket zhvillimit legjislativ dhe politikave; Siguria dhe cilesia e ushqimeve te tregut eshte permiresuar per shkak te rritjes se rolit te konsumatoreve; Kuadri institucional dhe ligjor lidhur me acquis e BE-se per standartet e sigurise ushqimore, veterinarise dhe fitosanitetit eshte ne fuqi; Acquis e pershtatshme e BE-se dhe standartet e lidhura me politikat jane krijuar, zbatohen dhe monitorohen ne konsultim me shoqerine civile dhe palet e interesuara.
Total i kapitullit:			**14,300,000 EURO**	

KAPITULLI 13: PESHKIMI

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo kërkon futjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për pjesëmarrje në politikën e përbashkët të peshkimit, e cili mbulon të politikave të tregut, të burimeve dhe të menaxhimit të flotës, inspektimin dhe kontrollin, veprimet strukturore dhe ndihmës shtetërore, si dhe organizatat dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Shqipëria ka harmonizuar kuadrin ligjor dhe dispozitat e rregulloreve kombëtare me dispozitat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, për të përgatitur në mënyrë adekuate si sektorin dhe administratën për shkarkimin e plotë të detyrimeve të tij sipas (PPP). Ky kapitull përmban një përshkrim të shkurtër të gjendjes aktuale dhe tregon planet afatmesme dhe afatshkurtra për veprimet e ardhshme.

I.2 Situata në Shqipëri

Legjislacioni i peshkimit është në procesin e përditësimit të vazhdueshëm, dhe Ligji për peshkimin (31.05.2012) është ndryshuar për të marrë parasysh elementet shtesë të Politikës së Përbashkët të Peshkimit (PPP). Gjithashtu, disa vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) plotësojnë e ligjin dhe japin elemente të veçanta te rregullave teknike. Rregullat teknike për peshkimin kanë qenë në masë të madhe të harmonizuar me dispozitat e Rregullores së Këshillit Nr 1967/2006 (i quajtur kështu rregullorja Mesdheut) dhe Ligji nr. 29/2013 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012, datë 31.5.2012 "Për Peshkimin" ka krijuar probleme në lidhje me kontrollin dhe inspektimin në peshkim. Si rrjedhim është përgatitur amendimi i tij i cili është gati për tu dërguar për mendim në ministritë e linjës. Shqipëria ka vënë gjithashtu në zbatim sistemin e lëshimit të certifikatave të kapjes për produktet e peshkimit. Shqipëria ka në plan të bëjë ndryshime në Ligjin e Peshkimit, ne fillim të vitit 2017.

Me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 34 date 12.03.2015 "Mbi aprovimin e strukturës organike te Ministrisë se Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujërave" nga muaji Prill 2015 në MBZHRAU është krijuar Drejtoria e Peshkimit. Drejtoria ka dy sektorë Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Sektori i Politikave te Akuakulturës dhe Ujërave të Brendshme me 7 pozicione në total. Me këtë ndryshim numri total i posteve dedikuar peshkimit dhe akuakulturës është rritur me 4.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar mbi peshkimin me legjislacionin e BE-së buron nga neni 96 të MSA-së. Artikulli thekson rëndësinë e gjetjes së zonave me përfitim të ndërsjellët dhe interes të përbashkët me prioritet në lidhje me acquis e BE-së në fushën e peshkimit, duke përfshirë rregullat RFMO dhe ruajtjen e resurseve të peshkimit.

Politika e Përbashkët të Peshkimit (PPP) përfshin masa të ruajtjes dhe menaxhimit, masat strukturore dhe rregullat e ndihmës shtetërore, organizimin e tregjeve, kontrollin dhe inspektimin, marrëveshjet ndërkombëtare dhe në një masë të vogël akuakulturën. Ai përbëhet nga rregulloret e shumta, të cilat janë të gjitha të vetë zbatueshme për shtetet anëtare të Bashkimit. Pas reformës së Politikës së Përbashkët të Peshkimit në vitin 2013, instrumentet kryesore ligjore në fuqi janë:

- Rregullorja (BE) Nr 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetorit 2013 mbi organizimin e përbashkët të tregjeve të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës, që ndryshon Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 1184/2006 dhe (EC) Nr 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 104/2000;
- Rregullorja (BE) Nr 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetorit 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, që ndryshon Rregulloren e Këshillit 1954/2003 dhe Rregulloren e Këshillit 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit Nr 2371/2002,Rregulloren e Këshillit, Nr 639/2004 dhe Vendimin e Këshillit dhe 2004/585/EC;
- Rregullorja (BE) Nr 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 15 maj 2014 mbi Fondin Evropian Detar dhe Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 2328/2003, (KE) Nr 861/2006, (KE) Nr 1198/2006 dhe (KE) Nr 791/2007 dhe Rregulloren (BE) Nr 1255/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

Këto tri rregullore formojnë shtyllën kurrizore të Politikës së Përbashkët të Peshkimit në periudhën 2014-2020. Përveç këtyre, ka një numër rregulloresh që rregullojnë aspekte të caktuara teknike që janë me rëndësi për Shqipërinë dhe në mënyrë të veçantë:

- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr 1224/2009 e 20 nëntor 2009, për krijimin e një Sistemi Komunitar të Kontrollit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit;
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1005/2008 e datës 29 shtator 2008, krijimin e një Sistemi Komunitar për të parandaluar, penguar dhe për të eliminuar peshkimin ilegal, të parregulluar dhe paraportuar;
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1967/2006 e datës 21 dhjetor 2006, në lidhje me masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në detin Mesdhe, që ndryshon Rregulloren(EEC) Nr 2847/93 dhe shfuqizon Rregulloren (EEC) Nr 1626/94

- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr 404/2011 e 8 prill 2011 që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1224/2009 për krijimin e një Sistemi Komunitar të Kontrollit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Shqipëria është në procesin e përafrimit të legjislacionit të saj të peshkimit me dispozitat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit. Objektivi strategjik i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural, dhe Administrimit të Ujërave është rregullimi i aktiviteteve të peshkimit, bazuar në adoptimin e vazhdueshëm të masave të ruajtjes dhe menaxhimit për të ruajtur dhe rifreskuar resurset dhe mjedisin detar në mënyrë të qëndrueshme, për të pasur një qasje në mbrojtje të biodiversitetit dhe të ekosistemit ndaj peshkimit dhe akuakulturës, për të nxitur kërkimin shkencor dhe mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të besueshme për peshkimin dhe akuakulturën. Së fundmi është miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr 701 date 12.10.2016 Strategjia Kombëtare për Peshkimin dhe Akuakulturën që vjen në interes të harmonizimit të politikës dhe administrimit me Acquis të peshkimit dhe PPP (Politikës së Përbashkët të Peshkimit), ky dokument planifikimi strategjik udhëhiqet nga legjislacioni përkatës i politikave të BE për peshkimin, dhe në mënyrë specifike nga Rregullorja (BE) Nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, "Mbi politiken e Perbashket te Peshkimit". (PPP).
Strategjia kombëtare e peshkimit përcakton drejtimet afatgjata, përparësitë dhe objektivat e zhvillimit të peshkimit, fondet e nevojshme e afatet e realizimit, si dhe përgjegjësitë që dalin në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, veçanërisht për:

a. Sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe atyre detare;

b. Përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit nëpërmjet përfshirjes së komuniteteve përkatëse në proceset e vendimmarrjes;

c. Përcaktimin e masave të ruajtjes, që garantojnë mbrojtjen e burimeve biologjike detare dhe ujërave të brendshme;

d. Garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të peshkimit, si dhe përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale për prodhuesit;

e. Nxitjen dhe përkrahjen e kërkimit shkencor e teknologjik dhe grumbullimit të dhënave në peshkim;

f. Sigurimin e funksionimit dhe menaxhimit të porteve e të qendrave të peshkimit;

g. Hartimin dhe sigurimin e një politike strukturore, me qëllim ristrukturimin e sektorit të peshkimit, sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit, forcimin e konkurrencës e zhvillimit ekonomikisht të vlefshëm të subjekteve të peshkimit, rigjallërimin e zonave që varen nga peshkimi, si dhe përmirësimin e furnizimit të tregut dhe rritjen e vlerës së prodhimit;

h. Përcaktimin e masave dhe rregullave të nevojshme për kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e politikave të peshkimit, në përputhje të plotë me politikat evropiane në këtë drejtim. Ngritjen e një sistemi kontrolli për peshkimin dhe vendosjen e procedurave të inspektimit të standardizuara dhe të koordinuara si në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Janë ndërmarrë hapa të rëndësishme në drejtim të zbatimit të dispozitave themelore të Politikës së Përbashkët të Peshkimit BE-së në vitin 2012, kur ligji "Për peshkimin" është miratuar (Ligji Nr 64, nga 31.05.2012). Ky ligj është përgatitur me asistencën e projektit IPA, në bazë të kornizës ligjore të përgatitur në kuadër të TAIEX (Projektit IPA: "Krijimi dhe Forcimi i Sistemit të Monitorimit, Kontrollit dhe Mbikëqyrjes për Peshkimin në Shqipëri (Europeaid/128433 / C / SER / AL). Gjithashtu u miratua Ligji Nr 103/2016 "Për Akuakulturën", i cili është në proces publikimi zyrtar Ligji Nr. 64, nga 31.05.2012 "Për Peshkimin" u plotësua nga katër VKM-ve dhe një rregullore teknike:

- VKM Nr. 407, datë 05/08/2013 "Për krijimin e një sistemi të kontrollit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e politikës së peshkimit të menaxhimit", në bazë të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 1224/2009 20 nëntor 2009 dhe Komisioni Zbatuese Rregullorja (BE) Nr. 404/2011 të datës 8 prill 2011 dhe të zëvendësojë VKM Nr. 1062 e datës 2008/07/16 në bazë të rregullores së Këshillit Nr. 2847/1993.
- VKM Nr. 402, datë 05/08/2013 "Për masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në detin Mesdhe", në bazë të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 1967/2006, të datës 21 dhjetor 2006, dhe të zëvendësojë rregullimi ministror të datës 11.11.2009.
- VKM Nr. 301, datë 10/04/2013 "Për krijimin e një kuadri kombëtar për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen e këshillave shkencore sipas Politikës së Peshkimit shqiptare" në bazë të Rregullores së Këshillit (EC) Nr 199/2008 e datës 25 shkurt 2008 dhe Vendimi i Komisionit i 18 dhjetor 2009 duke miratuar një Program shumëvjeçar Komunitetit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit për periudhën 2011-2013.
- VKM Nr. 302, datë 10/04/2013 "Për krijimin e një sistemi për të parandaluar, penguar dhe eliminuar peshkimi n e pa/ligjshëm, pa/raportuara dhe të pa/rregulluara (IUU) dhe vendosjen e skemave certifikuese te peshkut te zëne ", në bazë të Rregullores së Këshillit (EC) Nr .1005/2008 nga 29 shtator 2008 dhe Komisionit Nr. 1010 e datës 22 tetor 2009 që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 1005/2008 dhe zëvendësojnë MMPAU ut Nr. 9 e datës 25/01/2010

- Rregullorja Teknike "Aplikim Ligji Për Peshkimin", e cila është miratuar vetëm (e Rregullores Nr. 1, e datës 03/07/2014). Kjo rregullore rregullon në mënyrë më të detajuar aspektet teknike të parashikuara me ligj peshkimit dhe do të rishikohet në tremujorin e parë të vitit 2017.

Ligji "Për Peshkimin" mbështet dhe reflekton disa elemente të Politikë së Përbashkët të Peshkimit (PPP). Megjithatë, Ligji nuk merr parasysh ndryshimet e fundit, të cilat do të përfshihen në fazat e mëvonshme të përafrimit të legjislacionit. Dispozitat e rregulloreve të mëposhtme janë përfshirë ose në vetë ligjin ose të VKM-ve që e kanë plotësuar atë:

- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1224/2009 e 20 nëntor 2009, për krijimin e një Sistemi Komunitar të Kontrollit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit (PPP);
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1005/2008 e datës 29 shtator 2008, krijimin e një Sistemi Komunitar për të parandaluar, penguar dhe për të eliminuar peshkimin ilegal, të parregulluar dhe pa/raportuar;.
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1967/2006 e datës 21 dhjetor 2006, në lidhje me masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në detin Mesdhe, që ndryshon Rregulloren (EEC) Nr 2847/93 dhe shfuqizon Rregulloren (EEC) Nr 1626/94
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr 404/2011 e 8 prill 2011 që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1224/2009 për krijimin e një Sistemi Komunitar të Kontrollit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 1639/2001 e 25 korrik 2001 për krijimin e programeve minimal dhe të zgjeruara të Komunitetit për mbledhjen e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr 1543/2000

Në kuadrin afat mesëm, amendamente të mëtejshme të ligjit janë të parashikuara në mënyrë që të përfshihen dispozitat e rregulloreve kryesore të reja të Politikës së Përbashkët të Peshkimit PPP.

- Projektligji "Për Akuakulturën" është i bazuar në rregulloret e mëposhtme të BE-së:
- Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 Maj 2014
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 199/2008 e 25 Shkurt 2008

Për më tepër, rregulloret teknike janë duke u hartuar për të rregulluar aspekte të ndryshme të funksionimit të autoritetit të peshkimit.

Regjistri Kombëtar i anijeve të peshkimit është mbajtur dhe po përmirësohet. Masat për ndërprerjen e përkohshme të aktiviteteve të peshkimit nuk aplikohen për momentin në Shqipëri. Megjithatë, masa menaxhuese për rrjetat e peshkimit, distanca nga brigjet dhe madhësia minimale

referencë e zënieve janë në fuqi për peshkimin detar. Gjithashtu është miratuar VKM Nr. 719, datë 12.10.2016 "Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkimit". Në rregulloren e re të peshkimit që do të miratohet në tremujorin e I të vitit 2017, janë parashikuar ndërprerjet e përkohshme dhe kufizimi i ditëve të peshkimit për peshqit pelagjikë (sardele dhe acuge). Flota e Peshkimit në Shqipëri është relativisht e vogël dhe jo në gjendje të mirë teknike. Aktiviteti dhe efektiviteti i saj është në rritje si rezultat i karburantit me çmim te reduktuar.

Për sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, Shqipëria është anëtare e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) dhe Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Tonit të Atlantikut (ICCAT).Shqipëria ka përmbushur GFCM Task 1, në mënyrë të pjesshme dhe ndjek rekomandimet ne vazhdimësi. Me qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër aktiviteteve ilegale të peshkimit, Shqipëria është në fazën e fundit të ratifikimit të Marrëveshjes së FAO-s "Për masat portuale kombëtare me qëllim luftën kundër peshkimit ilegal, të parregullt dhe të paraportuar (PPP).

II.3 Institucionet përgjegjëse ne Shqipëri

Institucioni përgjegjës për menaxhimin është Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, përmes Drejtorisë së Peshkimit. Drejtoria ka dy sektorë Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Sektori i Politikave te Akuakulturës dhe Ujërave të Brendshme. Në kuadër të amendimeve te ligjit 64/2012 "Për peshkimin", po rishikohet roli dhe funksioni i Drejtorise se Shërbimeve të Peshkimit dhe Akukulturës (DSHPA) ku propozohet se sektori i monitorimit kontrollit dhe vëzhgimit, pra si inspektimi ashtu dhe sektori i grumbullimit të zënieve dhe përpunimi i tyre të kalojnë në varësi të Drejtorisë së Peshkimit. Roli i DSHPA-së do të fokusohet në menaxhimin e aseteve të peshkimit, si porte dhe qendra peshkimi, tregjet me shumice etj.Ministria harton politikat në drejtim të menaxhimit dhe mbrojtjes së burimeve të peshkimit në det, ujërat e brendshme dhe akuakulturë, në mënyrë që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të gjithë sektorit. Ajo gjithashtu bën politika në lidhje me infrastrukturën e peshkimit, forcimin e konkurrencës dhe zhvillimin ekonomik, përfitimin shoqëror për operatorët e biznesit që praktikojnë peshkim dhe akuakulturë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme, formalizmin e sektorit dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe pa-raportuar, përmirësimin e furnizimit të tregut dhe përmirësimin e vlerës së produkteve që rrjedhin nga peshkimi dhe akuakultura.

Sektori i kontrollit të Peshkimit i cili është pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, ka këtë përbërje: 1 përgjegjës sektori, dy specialistë në qendër dhe 23 inspektorë në qarqe dhe rrethe të vendit.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera:

Drejtoria përgjegjëse për peshkimin bashkëpunon me:

- **Ministrinë e Punëve të Brendshme**, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë se Shtetit, Departamentin i Migracionit dhe Kufirit nga e cila siguron mbështetjen për kontrollet dhe penalizimet për shkeljet ligjore të fushës së peshkimit që rezultojnë gjatë kontroll/inspektimet e inspektoratit;
- **Ministrinë e Mjedisit** për bashkë-zbatimin e politikave mjedisore dhe ruajtjen e resurseve dhe ekosistemeve;
- **Ministrinë e Mbrojtjes**, pjesë e së cilës është Roja Bregdetare edhe QNOD (Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, ku Ministria e Bujqësisë është palë për garantimin e monitorimit të anijeve të peshkimit në det.
- **Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës**

II.4 Tregues i alokimeve financiare 2017 – 2018

Ministria e Bujqësisë ka planifikuar këto fonde:

000/lekë

	2017	2018	2019
Buxheti Total për këtë kapitull të si institucion kryesor	7000	8656	5553
Buxheti total për këtë kapitull nga institucionet e tjera kontribuese			
Buxheti Total për Kapitull	7000	8656	5553

Për tabelën e buxhetit për secilin iniciative ligjore të planifikuar, lutem referohuni Aneksit të Tabelës së Buxhetit për Kapitullin 13.

III. Prioritetet

Kuadri aktual ligjor shqiptar është në përputhje të pjesshme me Politikën e Përbashkët të Peshkimit. Prioritetet në drejtim të harmonizimit të mëtejshëm ligjor përfshijnë ndryshime në Ligjin për Peshkimin (nr 64. Nga 31.05.2012), për të përfshirë dispozitat e Rregullores së re themelore për Politikën e Përbashkët të Peshkimit. Prioritet do ti jepet dispozitave të inspektimit dhe kontrollit, atyre për certifikimin e zënieve dhe luftën kundër peshkimit ilegal, të parregulluar dhe pa-raportuar.

Një prioritet tjetër kyç është ngritja e kapaciteteve administrative dhe teknike të administratës së ngarkuar për peshkimin dhe Akuakulturën..

Në përgjithësi, prioritetet e administratës shqiptare në aktivitetet e mëtejshme të përafrimit me BE-në janë:

- Arritja e përputhjes së mëtejshme me kuadrin ligjor me rregullat e BE në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe ujërat e brendshme. Forcimi administrativ i administratës së peshkimit, duke përfshirë shërbimet e inspektimit dhe kontrollit si dhe grumbullimi dhe perpunimi i të dhënave të zënieve për hartimin e planeve të menaxhimit të peshkimit si dhe raportimin në organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit (GFCM).
- Zbatimi i strategjisë kombëtare të zhvillimit të peshkimit
- Mbështetje për monitorimin vjetor te gjendjes së burimeve të peshkimit për të mundësuar zbatimin e politikës së peshkimit në Shqipëri.;
- Zhvillimi i mekanizmave të duhura për grumbullimin e të dhënave në nivel kombëtar, e cila duhet të jetë plotësisht në përputhje me acquiss të BE.
- Zbatimi dhe zhvillimi i politikave për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkut me shumicë dhe pakicë për të arritur kontrollin e 80% të produkteve të peshkut dhe promovuar përmirësimin e cilësisë së produkteve të peshkut.
- Për të arritur 100% monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit te peshkimit nga anijet me gjatësi mbi 12 m me anë të sistemit të monitorimit satelitor të anijeve.
- Zgjerimi i mëtejshëm i porteve të peshkimit ekzistuese, ndërtimin shkallëve t për riparimin e anijeve dhe ndërtimin e bankinave për anijet e peshkimit, në Vlorë, Sarandë dhe Shëngjinit, në mënyrë që të rritet gatishmërinë e treguesve teknike për flotën e peshkimit detar.
- Mbështetje për dhënien e kredive të buta për operatorët e peshkimit me qëllim riparimin dhe modernizimin e anijeve të tyre të peshkimit.
- Rritja e nivelit të përpunimit industrial të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës, përmirësimin e marketingut të tyre përmes rritjes së cilësisë dhe sigurisë.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2019

IV.1 Peshkimi dhe akuakulture

Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare e Peshkimit dhe Akuakulturës	MBZHRAU	2016-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
- Rregullore e Këshillit nr. 1224/2009/KEE	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012
- Direktive nr. 2000/60/KE	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012
- Rregullore nr. 1380/2013/KE Pjesërisht e përputhur	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012
- Rregullore e Këshillit nr. 1967/2006/KE	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012
- Rregullore e Këshillit nr. 1005/2008/KE	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012

- Rregullore e Këshillit (KE) nr. 199/2008	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012
- Rregullore e Këshillit nr. 1379/2013/KE Pjesërisht e përputhur	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012
- Rregullore e Zbatimit të Komisionit nr. 404/2011/BE	Ligji 64/2012 "Për Peshkimin"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	31.5.2012	15.07.2012
- Rregullore e Këshillit (EC) nr. 199/2008	Vendimi nr 301, nga 2013/10/04 Lidhur me "Krijimin e një kornize për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetje për këshilla shkencore në lidhje me Politikën e Peshkimit"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	10.4.2013	10.04.2013
- Rregullore e Këshillit (EC) nr. 18/2009	Vendimi nr 301, nga 2013/10/04 Lidhur me "Krijimin e një kornize për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetje për këshilla shkencore në lidhje me Politikën e Peshkimit"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	10.4.2013	10.04.2013

- Rregullore e Këshillit (EC) nr. 1005/2008	VKM Nr. 302, datë 10.04.2013 "Mbi krijimin e një sistemi për parandalimin, zbulimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të pa-raportuar"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	10.4.2013	10.04.2013
- Rregullore e Këshillit (EC) nr. 1010/2009	VKM Nr. 302, datë 10.04.2013 "Mbi krijimin e një sistemi për parandalimin, zbulimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të pa-raportuar"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	10.4.2013	10.04.2013
- Rregullore e Këshillit (EC) nr. 1967/2006	VKM nr. 402, datë 2013/05/08 "Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	8.05.2013	08.05.2013
- Rregullore e Këshillit (EC) nr. 1224/2009	VKM nr. 402, datë 2013/05/08 "Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	8.05.2013	8.05.2013

- Rregullore Implementimit te Këshillit (EC) nr. 404/2011	VKM nr. 407, datë 2013/05/08 "Për caktimin e një regjimi të kontrollit për të siguruar përputhjen me rregullat e politikës së menaxhimit për peshkim"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	8.05.2013	8.05.2013
- Rregullore e Këshillit (EC) nr. 1967/2006	Rregullorja Teknik "Për Peshkimit Ligji për aplikim" Rregullores Nr. 1, të 2014/03/07	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	7.03.2014	7.03.2014
- Rregullore Implementimit te Këshillit (EC) nr. 404/2011	Rregullorja Teknik "Për Peshkimit Ligji për aplikim" Rregullores Nr. 1, të 2014/03/07	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	7.03.2014	7.03.2014
- Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 Maj 2014; - Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 199/2008 e 25 Shkurt 2008;	Ligji 103/2016 "Për Akuakulturën"	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	20.10.2016	

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2019

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU acquis	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Direktiva e BE-së, 2014/89 e 23 korrikut 2014, Mbi krijimin e kuadrit për planifikim hapësinor detar.	Jo	Projekt/Vendimi i Këshillit te Ministrave "Alokimi i Zonave të Akuakulturës"	Jo	MBZHRAU	Plotë	Tremujori IV-t, 2017	Tremujori IV-t, 2017
Konventa e OKB-së mbi Ligjin e Detit, e 10 Dhjetorit 1982. Marrëveshja për të nxitur përputhshmërinë me masat Ndërkombëtare te Ruajtjes dhe masat menaxhuese për anijet e peshkimit ne det te hapur. Kodi i FAO-s i Drejtimit për peshkim te përgjegjshëm. Reg. Këshilli Nr. 1005/2008, "Për krijimin e një sistemi komunitar për të parandaluar, penguar dhe eliminuar peshkimin ilegal, të	Po	Projekt vendimi i Keshillit te Ministrave për Ratifikimin e Marrëveshjes: "Mbi masat portuale shtetërore për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin ilegal, të parregullt dhe të paraportuar"	Po	MBZHRAU	Plotë	Tremujori I-të, 2017	Tremujori I-rë,2017

parregulluar dhe të pa-raportuar (PPP)"							
AFAT MESËM (2018-2019)							
Rregullore Këshillit 1343/2011/EU	Jo	Rregullore "Mbi masat teknike për shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve peshkore"	Jo	MBZHRAU	Synon përafrimin e plote me direktivat dhe me rekomandimet e GFCM-se	Tremujori I-rë 2018	Tremujori II-të 2018
Rregullore Këshillit (EC) Nr 1380/2013	Jo	VKM: "Mbi shpalljen e zonave te mbrojtura për peshkimin"	Jo	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	Tremujori III-të 2018	Tremujori i IV-t 2018
Rregullore Këshillit (EC) Nr 1380/2013	Jo	Rregullore "Mbi masat e ruajtjes së resurseve detare për përshtatjen e kapaciteteve peshkuese te anijeve te peshkimit me mundësitë dhe disponibilitetin e peshkimit."	Jo	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	Tremujori III-të 2018	Tremujori IV-të 2018
Rregullore Këshillit (EC) Nr 508/2014	Jo	Urdhër Ministri Për mbështetjen financiare të sektorit të peshkimit dhe masat strukturore për sigurimin e qëndrueshmërie afatgjatë.	Jo	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	Tremujori III-të 2018	Tremujori IV-të 2018

Rregullore Këshillit (EC) Nr 1379/2013	Jo	Urdhër Ministri Për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës	Jo	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	Tremujori II-të 2019	Tremujori III-të 2019
Rregullore Këshillit (EC) Nr 1380/2013	Jo	VKM "Për hartimin e Planit Strategjik shumëvjeçar për Akuakulturën"	Jo	MBZHRAU	Përafrim i pjesshëm	Tremujori i I-rë 2019	Tremujori i II-të 2019

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve te buxhetit te shtetit te planifikuara per Kapitullin 13

000/lekë

Kapitulli 13: Peshkimi					
Përfituesi : Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.					
1	2	3	4	5	6
Aktiviteti	Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit	2017	2018	2019	Totali (3+4+5)
Projekt/Vendimi i Keshillit te Ministrave "Alokimi i Zonave të Akuakulturës"	A) Paga –stafi ekzistues	4.000			4.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				

	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Totali i Aktivitetit				
Projekt vendimi i Keshillit te Ministrave për Ratifikimin e Marrëveshjes: "Mbi masat portuale shtetërore për të parandaluar, frenuar dhe eliminuar peshkimin ilegal, të parregullt dhe të paraportuar"	A) Paga –stafi ekzistues	3.000			3.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Total i Aktivitetit				
Rregullore "Mbi masat teknike për shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve peshkore"	A) Paga –stafi ekzistues		1553		1553
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Total i Aktivitetit				
VKM: "Mbi shpalljen e zonave te mbrojtura për peshkimin"	A) Paga –stafi ekzistues		4.000		4.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				

	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Total i Aktivitetit				
	Buxheti total i perfituesit				
	2	3	4	5	6
	Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit	2017	2018	2019	Total (3+4+5)
Rregullore "Mbi masat e ruajtjes së resurseve detare për përshtatjen e kapaciteteve peshkuese te anijeve te peshkimit me mundësitë dhe disponibilitetin e peshkimit."	A) Paga –stafi ekzistues		1.550		1.550
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Total i Aktivitetit				
Urdhër Ministri Për mbështetjen financiare të sektorit të peshkimit dhe masat strukturore për sigurimin e qëndrueshmërie afatgjatë.	A) Paga –stafi ekzistues		1553		1553
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Total i Aktivitetit				

Kapitulli total					
Beneficiary:					
1	2	3	4	5	6
Activity	Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit	2017	2018	2019	Total (3+4+5)
Urdhër Ministri Për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës	A) Paga –stafi ekzistues			1553	1553
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Total i Aktivitetit				
VKM "Për hartimin e Planit Strategjik shumëvjeçar për Akuakulturën"	A) Paga –stafi ekzistues			4.000	4.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Total i Aktivitetit				
Totali		7.000	8.656	5.553	21.209

Tabela B – Fondet e planifikuar nga asistenca e huaj

Kapitulli 13: Peshkimi				
1	**2**	**3**	**4**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
MBZHRAU	Mbështetje për sektorin e Peshkimit.	IPA 2016	5,100,000Vetëm kontributi i BE-së.	-Dokumentet strategjikë dhe legjislacioni i peshkimit janë në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe planin buxhetorë. Ato janë zbatuar dhe monitoruar nëpërmjet treguesve të performancës; - Një administratë me staf ' të mjaftueshëm për peshkimin e cila disponon sistemet e duhura dhe kapacitetin e duhur për të zbatuar dhe monitoruar masat politike si në dokumentet strategjike; - Është përmirësuar në koordinim me agjencitë e tjera të përfshira, kapaciteti i shërbimeve të inspektimit për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar; -Përdorimi i burimeve të peshkimit është më i qëndrueshëm; -Është rritur ndërgjegjësimi publik i aktorëve të peshkimit, duke përfshirë peshkatarët dhe organizatat e tyre, komunitetin e peshkimit, qeverinë lokale, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe shkollat për mbrojtjen e burimeve natyrore. -Performanca ekonomike e flotës detare të peshkimit është përmirësuar;
		Totali për Kapitullin:	**5,100,000 Euro**	

Programi është parashikuar në Programin e Veprimit IPA 2016 për Shqipërinë. Ky projekt është parashikuar në Buxhetin Afatmesme 2017-2019 të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

KAPITULLI 14: POLITIKA E TRANSPORTIT

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 14 "*Politikat e Transportit*" trajton në mënyrë të hollësishme politikat në fushën e transportit, përfshi transportin rrugor, transportin hekurudhor, transportin ajror dhe transportin ujor. Kapitulli përmban objektiva konkrete për secilën fushë, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, duke u fokusuar posaçërisht në përafrimin e legjislacionit, reformën institucionale, hartimin e dokumenteve strategjike dhe forcimin e kapaciteteve administrative.

Legjislacioni i transportit përfshin sektorët e transportit rrugor, hekurudhor, ujor, atë ajror dhe transportin e kombinuar. Qëllimi i tij është përmirësimi i funksionimit të tregut të brendshëm duke promovuar shërbime të sigurta, efikase dhe ekologjikisht të shëndosha. Politikat në fushën e transportit që do të ndërmerren në vitet e ardhshme synojnë të përmbushin objektivat e Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të vendit, rritjen ekonomike dhe punësimin.

I.2 Situata në Shqipëri

Ligji Nr. 118 datë 13.12.2012, "Për transportin e mallrave të rrezikshme", ka për qëllim rritjen e sigurisë në transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme. Në zbatim të këtij Ligji, ka filluar hartimi i akteve nënligjore për përcaktimin e rregullave për lëshimin e certifikatës së mjeteve që kryejnë transport rrugor të mallrave të rrezikshme dhe trajnimin e këshilltarëve të sigurisë.

Njëkohësisht, Shqipëria po punon për përafrimin e kuadrit ligjor me *acquis* në fushën e lejimit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor dhe aksesin në tregun e transportit rrugor, në harmonizim të plotë me Rregulloren (KE) Nr. 1071/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 21 tetor 2009 "Vendosja e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen në ushtrimin e veprimtarinë së transportit rrugor dhe shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/26/KE". Autoriteti Rrugor Shqiptar po i kushton një rëndësi të veçantë vlerësimeve përkatëse të ndikimit në mjedis, që nga hartimi dhe deri tek zbatimi i projekteve të infrastrukturës rrugore. Do të forcohet bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e grupeve të interesit, bazuar në dokumentet strategjike në fushën e transportit, dhe për këtë qëllim do të organizohen sistematikisht konsultimet publike.

Me qëllim lehtësimin e lëvizjes dhe procedurave në pikat e kalimit kufitar, me vendim të Këshillit të Ministrave janë miratuar marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit me disa shtete fqinje si: Italia (së fundmi është bërë rinovimi 5 vjeçar i kësaj marrëveshje), Kroacia, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2017 pritet të nënshkruhet, Marrëveshja për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ligji Nr. 128/2012, datë 27.12.2012 u miratua duke ratifikuar Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për transportin hekurudhor ndërkufitar ndërmjet të dy shteteve. Për zbatimin e kësaj Marrëveshje ndërqeveritare, për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe në zbatim të masës së butë (Samiti i Vjenës 2015), në projektin e iniciativës Adriatiko-Joniane që lidh Malin e Zi me Shqipërinë, janë nënshkruar të gjithë protokollet mes autoriteteve hekurudhore dhe zyrtare kufitare ndërmjet të dy vendeve. Protokollet e nënshkruar në periudhën 20.06.2016-1.07.2016, në kuadër të Samitit të Parisit 2016 po implementohen. Aktualisht po negociohet në nivel të Komitetit të Kalimit Kufitar, gjithashtu po punohet për të përcaktuar modalitetet e punës të autoriteteve shtetërore kufitare si dhe dorëzimin e kërkesave për ambiente pune. Stacioni i përbashkët hekurudhor kufitar i Tuzit, parashikohet të funksionojë, në muajin Qershor 2017.

Përafrimi i legjislacionit dhe ratifikimi i konventave ndërkombëtare në sektorin e transportit detar ka avancuar në mënyrë të konsiderueshme. Ligji Nr 168/2013, datë 31.10.2013 "Për sigurinë në anije dhe në porte", është miratuar nga Parlamenti. Ky Ligj është në përputhje me dispozitat e Kodit Ndërkombëtar të Sigurisë në Anije dhe në Porte (NSAP) dhe Direktivën 2005/65/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26.10.2005 mbi forcimin e sigurisë në porte. Është miratuar rregullorja për përforcimin e sigurisë në anijet dhe portet detare. Po punohet për forcimin e strukturave ekzistuese të specializuara për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e transportit detar. Kujdes i posaçëm po i kushtohet administratës detare sa i takon përmbushjes së detyrimeve, përmirësimit të kushteve teknike të anijeve që mbajnë flamurin shqiptar si edhe uljen e numrit të ndalimit të këtyre anijeve në portet e shteteve të tjera. Është miratuar vendimi për zbatimin e kodit të menaxhimit të sigurisë detare (ISM CODE), si edhe pritet miratimi i projektvendimi për miratimin e rregullores së funksionimit të Kontrollit Shtetëror Portual. Këto akte ligjore do të përmirësojnë rritjen e sigurisë lundrimore të anijeve, mbrojtjen e mjedisit detar dhe përmirësimin e kushteve në punë dhe të jetesës në bordin e anijeve detare.

Në sektorin e transportit ajror, është duke u implementuar Faza e I-rë e Marrëveshjes Shumëpalëshe Transitore për Krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), në lidhje me kushtet e përcaktuara në Protokollin e I-rë. Gjithashtu, janë miratuar aktet nënligjore që synojnë përafrimin e mëtejshëm me *acquis* në lidhje me operacionet e shërbimeve ajrore, detyrimet e transportuesve ajror, të drejtat e

pasagjerëve, orët e punës për punonjësit e lëvizshëm në aviacionin civil dhe rregulloret për sigurinë.

Për prioritizimin e projekteve në transport, energjetikë dhe rrjetet e transportit, energjisë, mjedisit, etj, është kompetencë e Komitetit Kombëtar të Investimeve (KKI), rolin e të cili e luan Komiteti Ndërministror për Planifikimin Strategjik sikurse përcaktuar nga Urdhri i Kryeministrit Nr. 113, datë 26.8.2015 "Për disa shtesa në Urdhrin Nr. 18, datë 22.1.2014 të Kryeministrit, "Për krijimin e Komitetit Ndërministror të Planifikimit Strategjik". Sikurse përcaktuar në Urdhër, KKI do të të bëjë planifikimin, prioritizimin, parashikimet për mbështetjen financiare dhe miratimin e investimeve me përmasa dhe për projekte rajonale, me rëndësi të veçantë për Shqipërinë dhe bashkëpunimin në rajon.

Ngritja e KKI ishte realizim i një rekomandimi të Komisionit Evropian dhënë për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. KKI zbaton një metodologji të re pune si bazë për dhënien e menaxhimin e asistencës së BE-së për investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të kësaj metodologjie, çdo shtet do të hartojë paketat kombëtare të projekteve të përbërë nga paketat kombëtare sektoriale. Në këtë mënyrë, këto projekte do të kenë akses më të madh në burimet e financimit dhe fondet e Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare financiare.

I.3 Struktura e kapitullit

- Transporti Tokësor i Brendshëm
  - Transporti Rrugor
  - Transporti Hekurudhor
  - Transporti i Kombinuar
- Transporti Ujor
- Transporti Ajror

II. Situata Aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	0	10	0	10
	Aktiviteti i përgjithshëm	**0**	**160**	**0**	**160**
Udhëzim i Ministrit të MTI"Mbi kriteret e bashkimit të vijave hekurudhore në PERIGOT/N".	A) Pagat - Stafi ekzistues	0	150	0	150
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme Konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	0	10	0	10
	Aktiviteti i përgjithshëm	**0**	**160**	**0**	**160**
Rregullore "Mbi kriteret e lëshimit të certifikatave, autorizimeve të formimit profesional të drejtuesve të mjeteve hekurudhore, të personelit të lëvizjes së trenave, të personelit të instalimit dhe të mirëmbajtjes së sistemeve të sinjalizimit e të ndërlidhjes, të kontrollit teknik të mjeteve dhe të materialeve hekurudhore"	A) Pagat - Stafi ekzistues	0	150	0	150
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	0	10	0	10
	Aktiviteti i përgjithshëm	**0**	**160**	**0**	**160**
Urdhër i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për shfrytëzimin teknik të hekurudhave", në përputhje të	A) Pagat - Stafi ekzistues	0	150	0	150
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0

pjesshme me Standardet Teknike të Ndërveprimit, për operimin në sistemin hekurudhor)	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	0	10	0	10
	Aktiviteti i përgjithshëm	**0**	**160**	**0**	**160**
Urdhër i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, mbi ndërveprimin në sistemin hekurudhor	A) Pagat - Stafi ekzistues	0	150	0	150
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	0	10	0	10
	Aktiviteti i përgjithshëm	**0**	**160**	**0**	**160**
Urdhër i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës "Për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme	A) Pagat - Stafi ekzistues	0	150	0	150
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	0	10	0	10
	Aktiviteti i përgjithshëm	**0**	**160**	**0**	**160**
VKM për miratimin e Rregullores për Hetimin e Incidenteve Detare	A) Pagat - Stafi ekzistues	270	0	0	270
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	20	0	0	20
	Aktiviteti i përgjithshëm	290			290

VKM mbi kontrollin shtetëror Portual	A) Pagat - Stafi ekzistues	270	0	0	270
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	20	0	0	20
	Aktiviteti i përgjithshëm	290	0	0	290
Projektligj "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë"	A) Pagat - Stafi ekzistues	1350		0	1350
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	
	C) Trajnime	0	0	0	
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	90	0	0	90
	Aktiviteti i përgjithshëm	**1440**	**0**	**0**	**1440**
Projekt- Urdhër i Ministrit "Për miratimin e rregullores lidhur me sqarimin dhe thjeshtësimin e disa masave specifike të sigurisë në aviacion"	A) Pagat - Stafi ekzistues	270	0	0	270
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	20	0	0	20
	Aktiviteti i përgjithshëm	290	0	0	290
Projekt Urdhër Për miratimin e rregullores "Për kërkesat dhe procedurat administrative që lidhen me aerodromet në përputhje me Udhëzimin e Ministrit Nr.3 datë	A) Pagat - Stafi ekzistues	270	0	0	270
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0

07.02.2011, "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar".	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	20		0	20
	Aktiviteti i përgjithshëm	290	0		290
Projekt- Urdhër i Ministrit "Mbi kriteret për lejimin e përjashtimeve nga standardet e përbashkëta bazë të sigurisë në aviacionin civil dhe marrjen e masave alternative të sigurisë"	A) Pagat - Stafi ekzistues	**270**		0	270
	B) Pagat - Stafi ri			0	0
	C) Trajnime			0	0
	D) Shërbime të ndryshme			0	0
	konsulence			0	30
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	**30**		0	300
	Aktiviteti i përgjithshëm	300		0	300
Projekt- Urdhër i Ministrit "Për përcaktimin e kërkesave mbi shërbimin e komunikimit te te dhënave për qiellin e vetëm Evropian.	A) Pagat - Stafi ekzistues	0		270	270
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	0	0	30	30
	Aktiviteti i përgjithshëm	0	0	300	300

Tabela B – Fonde të planifikuara nga ndihma e huaj

Kapitulli: 14				
1	**2**	**3**	**4**	**5**
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Projekt për studime fizibiliteti dhe projektimi në nivel	Qeveria e Republikës Italiane	2.100.000 EUR	Projekti mbulon projektin përfundimtar, dhe vlerësimin e

	përfundimtar dhe studim të impaktit ambiental në Sektorin Infrastrukturor			impaktit mbi ambientin për: By Pass-in e Elbasanit Zgjerimin e rrugës ekzistuese Milot-Shkodër. Lidhjen direkte Vaqarr-Kavajë.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	65,900,000 Euro.	Ky projekt përbëhet nga komponentët e mëposhtëm: Mirëmbajtja Punon duke përfshirë monitorimin Realizimi i mirëmbajtjes periodike dhe rutinë të rrugëve Parësore dhe Dytësore të rrjetit kombëtar. Kryerja e Aktivitete për të monitoruar mirëmbajtjen e rrugëve dhe për të siguruar nivelet e përcaktuara të shërbimit, duke përfshirë: (i) kryerjen e auditimeve fillestare të sigurisë rrugore; (ii) kryerjen periodike të Programi Ndërkombëtar të Vlerësimit të Sigurisë Rrugore (IRAP) Sondazhe periodike për t'u siguruar që identifikimin i njollave të zeza shtesë dhe përforcimi I sigurisë rrugore të jenë të përfshira në punimet e mirëmbajtjes Punon për rrugët

				kryesore; dhe për zhvillimin e sistemit të transparencës sociale. Reforma Institucionale Reforma Sektoriale dhe Monitorimi i Aktiviteteve Menaxhimi i Projekteve dhe Mbështetja e Auditit
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Asistencë teknike për të mbështetur zbatimin e projekteve në Shqipëri	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	249,996 EUR	Asistencë Teknike mbi trajnimin në punë të menaxherëve të PIU-t, mbi disa çështje lidhur me kontratat FIDIC dhe procedura të ndryshme prokurimi, etj.
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Dokumenti strategjik Shqiptar për rrugët me pagesë	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	149,117.00 EUR	Përmes këtij investimi, BERZH po mbështet Qeverinë Shqiptare në reformën e sektorit rrugor. Një fushë e rëndësishme për reformën e sektorit rrugor është financimi për sektorin e rrugëve, për mirëmbajtjen dhe investimet. Aktiviteti kryesor i këtij projekti është që të përgatisë një dokument strategjik për QSH për përdorimin e rrugëve me pagesë në Shqipëri.
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Projektimi i detajuar për hekurudhën Durrës-Tiranë, për nje Terminal të Transportit Publik (PTT), për një linjë të re hekurudhore me aeroportin e	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	1.103 milion euro	Objektivi i përgjithshëm është të rigjallëroje hekurudhën shqiptare dhe të përmirësuar transportin hekurudhor duke përmirësuar infrastrukturën hekurudhore,

	Rinasit (TIA) dhe për një Vlerësim financiar dhe ekonomik të gjithë Rrjetit hekurudhor shqiptar. - Për përgatitjen e projektit konceptual për lidhjen e stacionit të trenit në Tiranë me Terminalin Publik të Transport që do të ndërtohet në Tiranë.			përmirësimin e menaxhimit të lëvizjeve të trenave, sigurinë e udhëtimit dhe ndërveprimin. Ka dy objektiva specifike: Objektivi i parë është që të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm (e projektimit të detajuar, vlerësimit ndikimet mjedisore, dokumentet e tenderit) që do të lejojë zbatimin (rehabilitimi) i linjës hekurudhore Durrës-Tiranë dhe ndërtimin e ri të lidhjes hekurudhore me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, e cila është prioriteti kryesor. Objektivi i dytë për Konsulentin, është që të sigurojë një prioritarizim racional të linjave ekzistuese hekurudhore të bazuar në një vlerësim të plotë financiar dhe ekonomik i cili do të sigurojë një plan me disa faza investimesh në hekurudhë, në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Plani Shqiptar i Qëndrueshëm i Transportit	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	289,383 EUR	Objektivi kryesor i kësaj detyre është që të përgatisë një Plan

				transportit të qëndrueshëm (PQT) për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës. Aktivitetet kryesore përfshijnë: Niveli i Përdorimit të Energji: Përcaktoni nivelet e përdorimit të energjisë dhe emetimet ekzistuese nga sektori i transportit, sipas sektorëve, bazuar në të dhënat ekzistuese; Qëndrueshmëria: Objektivat: Të shpallen objektivat e politikës së qëndrueshmërisë për sektorin e transportit, duke përfshirë synimet, në bazë të angazhimeve ekzistuese qeveritare; Përzgjedhja e Praktikës më të Mirë: Kryerja e një rishikim të praktikave më të mira ndërkombëtare në politikat e qëndrueshme të transportit, transportin kombëtar dhe transportin urban; Plani i Veprimit: Të Artikulohen politikat më të mira praktike dhe të provuara për arritjen e objektivave të deklaruara të qëndrueshmërisë për një sistem kombëtar të transportit

				multimodal, të identifikohen investimet dhe të përcaktohen afatet kohore të zbatimit të tyre.

KAPITULLI 15: ENERGJIA

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis e Bashkimit Evropian për energjinë bazohet në parimet e përgjithshme të parashikuara në Traktatin e Bashkimit Evropian dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Këto parime përfshijnë krijimin e një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë, transparent, dhe jo-diskriminues. Objektivat e politikës së BE-së për energjinë janë aftësia konkurruese, siguria dhe qëndrueshmëria e furnizimit me energji, zhvillimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe rritja e eficencës së përdorimit të energjisë. Sektori i energjisë është i rregulluar tërësisht nga legjislacioni dytësor i BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka bërë progres konkret dhe shumë të rëndësishëm në përshtatjen e legjislacionit të saj me *acquis* në fushën e energjisë. Ligji Nr. 43/2015 i datës 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", është i përafruar plotësisht me Direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 korrikut 2009 në lidhje me rregullat e përbashkëta dhe me Paketën e Tretë të tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/EC. Bazuar në ligjin e ri për sektorin e energjisë elektrike Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë miratoi Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016 "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike", i cili hyri në fuqi më 22.07.2016.

Hartimi dhe miratimi i Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike është hapi i fundit në drejtim të zhvillimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, në një treg plotësisht konkurrues të energjisë, në përputhje me obligimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ky miratim është pjesë e reformës që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë për të riorganizuar sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe politikat qeveritare për zhvillimin e këtij sektori.

Sektori i gazit natyror rregullohet me Ligjin Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror". Ligji 102/2015, është në përputhje të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë Paketën e Tretë të Tregut të Brendshëm të gazit dhe konkretisht me Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me "Rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të gazit natyror", e cila shfuqizon Direktivën 2003/55/EC; Rregulloren (EC) Nr. 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 "Mbi kushtet për qasje në rrjetet e transmetimit të gazit natyror", e cila shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 1775/2005; Direktivën 2004/67/EC të datës 26 prill 2004 në lidhje me "Masat për të mbrojtur sigurinë e

furnizimit me gaz natyror", vendosur për t'u përafruar për vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë me Vendimin Nr 2007/06/MC-EnC, të datës 18 dhjetor 2007 të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Këto ndryshime janë reflektuar në përputhje me zhvillimin e sektorit elektroenergjetik, duke ndikuar në përmirësimin e furnizimit me energji dhe hapjen e tregut të energjisë, por diversifikimi i burimeve të energjisë elektrike ende nuk është realizuar plotësisht. Kushtet për një treg të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike janë në përputhje të plotë me *acquis*.

Shqipëria do të vazhdojë reformën e sektorit energjetik, duke përfshirë liberalizimin e tregut të energjisë, në përputhje me angazhimet e saj në kuadër të MSA-së dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, për zbatimin e Paketës së Tretë të Energjisë.

Në sektorin hidrokarbur janë ndërmarrë masat për përmirësimin e legjislacionit në këtë sektor nëpërmjet përafrimit të këtij legjislacioni me direktivat përkatëse të BE-së, me synim diversifikimin e burimeve të furnizimit, tërheqjen e investitorëve të huaj me ekspertizë teknike dhe kapacitete të mëdha financiare. Procedurat e ndjekura për tërheqjen e investimeve në këtë sektor janë kryer në përputhje me parimet e konkurrueshmërisë dhe transparencës.

Në këtë kuadër me amendimin e Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, është përcaktuar detyrimi për mbajtjen e rezervës së sigurisë për naftë dhe nënproduktet e saj për 90 ditë duke filluar nga viti 2010. Grupi Ndërinstitucionali Punës, i ngritur në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 233, datë 02.12.2013, për "Ngritjen e grupit ndërinstitucional për rishikimin e kuadrit ligjor e institucional për regjimin e mbajtjes dhe të menaxhimit të rezervës së sigurisë për naftën, gazin e nënproduktet e tyre", po punon për hartimin e kuadrit të ri ligjor për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë në përputhje me Direktivën 2009/119/KE ku në fokus është zgjedhja e një modeli të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë dhe përshtatja me specifikat e tregut shqiptar, duke u bazuar në eksperiencat pozitive të vendeve të rajonit dhe atyre të BE-së

Cilësia e lëndëve djegëse rregullohet me VKM Nr. 781, datë 14.11.2012, "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)", dhe VKM nr. 147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel". Këto vendime kanë përafruar Direktivën 1999/32/EC të Këshillit, të datës 26 prill 1999 në lidhje me "Një reduktim në përmbajtjen e squfurit të disa lëndëve të djegshme dhe të lëngshme", Direktivën amenduese 93/12/KEE (ScF) si dhe Direktivën 98/70/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 Tetor 1998. Në zbatim të detyrave të përcaktuara në këto dy VKM është miratuar Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Mjedisit "Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (gas oil), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (heavy fuel oil) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (marine fuel)", nr. 3946, datë 10.06.2016, i cili së bashku edhe me Udhëzimin e Përbashkët, Nr. 6, datë 9.10.2007, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe

Administrimit të Ujërave, “Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e benzinës dhe të diezelit”, të cilat përmbushin edhe kërkesat e legjislacionit evropian për reduktimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse.

Eficenca e energjisë në Shqipëria rregullohet nga Ligji Nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për eficencën e energjisë”, i cili përafron pjesërisht Direktivën 2012/27/EC “Për Eficencën e Energjisë”. Ky ligj synon gjithashtu, hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare dhe rregullave për nxitjen, promovimin e përmirësimin e përdorimit efiçent të energjisë, me synim kursimin e energjisë sipas Objektivit Kombëtar të vendosur në Planet Kombëtare të Veprimit për Eficencën e Energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit si dhe heqjen e barrierave në tregun e energjisë.

Ligji 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” përafron pjesërisht Direktivën 2010/31/EC “Për performancën e energjisë së ndërtesave”. Ky ligj synon krijimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e performancës së energjisë së ndërtesave, duke marrë në konsideratë kushtet lokale dhe klimaterike të vendit, kushtet e komfortit të brendshëm të ndërtesave, si dhe kostot efektive në ndërtimin e ndërtesave të reja dhe në rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese. Si kërkesë e ligjit 124/2015 “Për Eficencën e Energjisë”, Këshilli Ministrave miratoi Vendimin Nr. 852, datë 7.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencisë për efiçencën e energjisë”, institucion, i cili, është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për efiçencën e energjisë.

Aktualisht, kuadri ligjor për promovimin e energjisë së rinovueshme, kryesisht nga HEC-et, përbëhet nga Ligji Nr. 138/2013 “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”, i miratuar më dt. 02.05.2013, duke përafruar Direktivën 2009/28/EC. Sipas Ligjit Nr. 138/2013 “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”, objektivat kombëtare të energjisë së rinovueshme do të miratohen nga Këshilli i Ministrave, pas një marrëveshje të arritur në kuadër të Komunitetit të Energjisë në lidhje me zbatimin e Direktivës 2009/28/KE ku Shqipëria angazhohet të arrijë objektivin 38% të konsumit në vitin 2020. Në këtë fushë ka përparim të konsiderueshëm. 100% e prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike vjen nga hidrocentralet.

Si kërkesë e ligjit 138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, në datë 20.1.2016, me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme, 2015-2020, i cili, i cili vendos objektiva kombëtarë të energjive të rinovueshme në konsumin final total të energjisë të vendit, si dhe masat mbështetëse për t’i arritur ato.

Sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Direktivat e eficencës së energjisë (2012/27/BE-së, 2010/30/EU, 2010/31), si dhe Direktiva e Energjisë së Rinovueshme po zbatohen në nivel të ngjashëm dhe me të njëjtin efekt detyrues në vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6) si dhe në BE. Vendet WB6 janë duke eksploruar mënyra dhe me efikase për të përmirësuar sistemet e tyre për monitorimin, raportimin dhe planifikimin e politikave të tyre të energjisë dhe klimës.

Shteti Shqiptar, gjatë konferencës së Parisit në korrik të 2016, ka nënshkruar udhërrëfyesin "Karta e Qëndrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor" duke nënvizuar nevojën për të implementuar eficencën e energjisë, nxitjen dhe përdorimin e energjive të rinovueshme dhe të mbështesë politikat për përmirësimin e ndryshimeve klimatike. Nënshkrimi i kësaj agjende të zgjeruar do të sjellë për Shqipërinë krijimin e legjislacionit dytësorë në fushën e eficences se energjisë me krijimin e Fondit te Eficences së Energjisë si dhe Agjencinë e Eficencës së Energjisë, Auditin e Energjisë, ESCO-t (shoqëritë e shërbimeve energjetike). Për sa i përket legjislacionit dytësor për nxitjen dhe përdorimin e energjisë se rinovueshme agjenda parashikon miratimin e ligjit për nxitjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë, krijimin e tregut të energjisë, si dhe lehtësirat ekonomike për këtë sektor strategjik. Së fundmi agjenda e Kartës së Qëndrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor parashikon dhe paketat ligjore për ndryshimet klimatike ku Shqipëria duhet të implementojë legjislacionet dytësore për përmirësimin dhe reduktimin e gazeve me efekt serë si dhe mënyrën e monitorimit të tyre.

Roli i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) lidhur me energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme përfshin licencimin e aktiviteteve të gjenerimit, miratimin e kontratave standarde, miratimin e rregullave të tregut që garantojnë akses në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, miratimin e rregullave dhe rregulloreve për dhënien e certifikatave të origjinës dhe certifikatave të gjelbra, si dhe miratimin e tarifave "feed-in" për hidrocentrale të vogla deri në 15 MË.

Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar për prodhimin e energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik arriti në 1895 MW në fund të vitit 2015, duke u rritur me 32 MW gjatë vitit 2015. Kjo rritje i dedikohej më së shumti hidrocentraleve të vogla dhe të mesme të vëna në shfrytëzim së fundmi.

Gjatë viteve të fundit në sektorin elektroenergjetik janë bërë investime të rëndësishme për të përmirësuar sigurinë e furnizimit, uljen e humbjeve dhe rritjen e kapaciteteve për shkëmbimin e energjisë dhe besueshmërisë së rrjetit të transmetimit të energjisë në rajon. Linja e interkonjeksionit Shqipëri – Kosovë u përfunduar me datë 28 qershor 2016. Ndërtimi i kësaj linje synon përmirësimin e balancimit të tregut të energjisë mes dy vendeve dhe uljen e riskut hidrologjik në Shqipëri. Ndërtimi i kësaj linje interkonjeksioni është pjesë e krijimit të një tregu të integruar rajonal të energjisë elektrike.

Gjithashtu ka përfunduar edhe Linja Unazore 110 kV e Shqipërisë së Jugut, e cila është një nga projektet me të rëndësishme të realizuara që rrit ndjeshëm sigurinë dhe parametrat e furnizimit me energji elektrike në zonën turistike dhe të gjithë zonën jug-lindore të Shqipërisë.

Projekt i rëndësishëm është Linja e Interkonjeksionit 400 kV Elbasan (Shqipëri) - Bitola (Maqedoni), si pjesë e korridorit Lindje - Perëndim, e cila mundëson lidhje direkte të sistemeve të energjisë të Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë dhe përmirëson lidhjen e sistemit të energjisë Shqiptar me rajonin. Ndërtimi i kësaj linje parashikohet të fillojë në vitin 2017. Si rezultat, dispeçerimi rajonal i energjisë në mes të sistemeve të energjisë të Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë dhe vendeve të Ballkanit më gjerësisht, do të përmirësohet duke çuar në zgjerimin e tregut të furnizimit.

Përpunimi, transportimi dhe tregtimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre rregullohet me Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar. Ndryshimet e fundit të miratuara me Ligjin Nr. 71/2014, datë 10.07.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450 të datës 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar. Ligji parashikon përkufizime të rëndësishme, rregulla të qarta për ndërtimin dhe funksionimin e rafinerive të naftës, impianteve të përpunimit si dhe detyrimin për marrjen e licencës së rafinimit dhe përpunimit. Në këtë ligj është përcaktuar gjithashtu dhe detyrimi i Operatorëve të tubacionit të naftës për të përgatitur një herë në pesë vjet planin e mirëmbajtjes, garancinë për informimin e publikut mbi rezultatet e analizave të cilësisë së nënprodukteve, inspektime në rafineritë e naftës dhe gazit, në subjektet e transportimit dhe të tregtimit, si dhe amendamentet mbi sanksionet për shkeljet e ndryshme përcaktuar me Ligjin Nr. 8450 të 24.02.1999, i ndryshuar.

Forcimi i kapaciteteve të administratës publike shqiptare për trajtimin dhe mbështetjen e projekteve të infrastrukturës së madhe të gazit dhe zbatuar masat mbrojtëse mjedisore, teknike dhe sociale gjatë ndërtimeve të infrastrukturës së gazit natyror, përmes një kuadri të përshtatshëm rregullator, dhe rritjen e kapaciteteve negociuese dhe tregtare po kryhet në kuadër të projektit "Ngritjen e Kapaciteteve për Zhvillimet e Infrastrukturave të Mëdha të Gazit në Shqipëri me Sektorin Privat" financuar nga Qeveria e Konfederatës së Zvicrës me një vlerë prej afro 6.6 milion euro. Projekti do të asistojë edhe për përgatitjen e studimeve konkrete në plotësimin e rregullave teknike për sektorin e gazit, si dhe për realizimin e projekteve konkrete për infrastrukturën e sektorit të gazit në Shqipëri. Marrëveshja përkatëse për këtë projekt u ratifikua me nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 58/2015 datë 28.5.2015 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për Grantin e Asistencës Financiare për projektin "Ngritja e kapaciteteve për zhvillimet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit në Shqipëri, II".

Në bazë të një granti me vlerë 1,1 milion Euro të akorduar në vitin 2014, nën raundin e 11 të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), po punohet për përgatitjen e Master Planit të Gazit për Shqipërinë. Master Plani i Gazit do të përgatisë terrenin për gazifikimin e Shqipërisë. Masterplani i Gazit (MPG) dhe Plani i Identifikimit të Projekteve (PIP), për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, parashikohen që të miratohen respektivisht në Këshillin e Ministrave dhe në Këshillin Kombëtar të Territorit.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal për infrastrukturën e gazit, më 10.07.2015, në Dubrovnik të Kroacisë, Shqipëria nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit në qëndrimin e përbashkët për të adresuar diversifikimin e gazit natyror dhe sigurinë e sfidave të furnizimit, si pjesë e Iniciativës për Interkonjeksionin e Gazit të Evropës Juglindore dhe Qendrore (CESEC). MoM synon të rrisë sigurinë e furnizimit dhe diversifikimin e rrugëve të furnizimit. Kjo do të kërkojë koordinimin dhe kanalizimin e përpjekjeve të përbashkëta nga të gjitha vendet nënshkruese drejt një qëllim të vetëm: duke punuar së bashku për të përshpejtuar ndërtimin e infrastrukturës së munguar të gazit, si dhe duke trajtuar çështjet rregullatore që pengojnë sigurinë e furnizimit. Ky Memorandum është i lidhur me një Plan Veprimi që përshkruan në detaje hapat e ardhshëm të nevojshme për të përmbushur qëllimin MoM.

Projekti i gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (Projekti TAP), që po zhvillohet nga kompania TAP AG ka marrë Lejen Zhvillimore Komplekse, me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) nr. 1, datë 8 Prill 2014 "Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për projektin Trans Adriatic Pipeline (Projekti TAP)". Gjatë kësaj periudhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë i ka dhënë Projektit TAP lejet ndërtimore për 17 rrugë ndihmëse si dhe për rehabilitimin ose ndërtimin e 52 urave në rrugët e projektit, për ndërtimin e Kampeve të Punëtorëve dhe Bazave të Tubove, si dhe për ndërtimin e Seksionit Tokësor të projektit TAP për Sektorin 4B. Në 3 korrik 2015 u bë inaugurimi i punimeve për ndërtimin e rrugëve ndihmëse për projektin TAP. ndërkohë që në 29.06.2016, në Selanik Greqi, u zhvillua Ceremonia e fillimit të punimeve për projektin TAP. Aktualisht ka filluar puna për ndërtimin e seksionit tokësor të projektit TAP në sektorin 4B.

Edhe për projektin e gazsjellësit Adriatiko-Jonian (Projekti IAP), ka pasur zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2016. Në konkretizim të përpjekjeve për realizimin e projektit IAP është edhe vendimi i përbashkët i ministrave për energjinë të katër vendeve pjesëmarrëse në projektin IAP, i marrë në takimin në Budva, Mali i Zi, më 06.05.2016, për ngritjen e Njësisë së Menaxhimit të Projektit (NJMP), me përfaqësues nga Ministritë dhe shoqëritë e gazit të vendeve pjesëmarrëse, ku në rolin e Sekretariatit Teknik të kësaj njësie do të jenë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë e Malit të Zi. Më 26 Gusht 2016 në Dubrovnik, Kroaci, u nënshkrua *"Memorandumi i Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Tregtisë së jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të Hercegovinës, Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Kroacisë dhe Ministrisë së Ekonomisë të Malit të Zi në lidhje me bashkëpunimin në zbatimin e Gazsjellësit Ionian Adriatik",* Ndërkohë, sipas këtij dokumenti palët kanë ftuar si vëzhgues kompaninë SOCAR (Kompania Shtetërore e Naftës e Republikës së Azerbajxhanit), si dhe palë të tjera të interesuara për të dhënë mbështetjen dhe kontributin e tyre në punën e NJMP dhe në realizimin e projektit IAP.

Ndërkohë që janë intensifikuar përpjekjet e përbashkëta të vendeve pjesëmarrëse në këtë projekt në situatën aktuale kur është në diskutim përfshirja e projektit IAP në listën e projekteve PECI 2016 (po ashtu edhe në listën e projekteve PCI). Gjithashtu Shqipëria, në bashkëpunim me Republikën e Malit të Zi ka aplikuar në Raundin e 15-të WBIF në 28.02.2016 për fonde për të përgatitur projektin teknik paraprak dhe atë kryesor të projektit IAP për pjesën shqiptare dhe malazeze të këtij projekti. Vlera e grantit të miratuar nga WBIF është 2.5 milion Euro.

Në bashkëpunim me Republikën e Kosovës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka aplikuar për 15-raundin e WBIF në 28.02.2016 për fonde për të përgatitur studimin e fizibilitetit dhe vlerësimin mjedisor për një tubacion të gazit që do të lidhë Shqipërinë me Kosovën. Për këtë projekt në mars 2016 është paraqitur një kërkesë edhe në Komunitetin e Energjisë për të përfshirë këtë projekt në listën e projekteve me interes të Komunitetit të Energjisë (Lista PECI). Nga ana e WBIF është miratuar shuma totale prej 2,5 milionë Euro për financimin përgatitjen e studimit të parafizibilitetit për gazsjellësin ALKOGAP.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 "Për sektorin e gazit natyror", lidhur me domosdoshmërinë e ndarjes së aktiviteteve të prodhimit të gazit natyror nga aktiviteti i transmetimit dhe shpërndarjes (referuar nenit 36 dhe 51 të ligjit), Ministria e Energjisë dhe Industrisë në

bashkëpunim edhe me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është duke realizuar procesin e ndarjes së shoqërisë publike "Albpetrol" sh.a. dhe ngritjen e shoqërisë së re të gazit, në trajtën e një operatori të kombinuar që do të përfshijë aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

Aktualisht është miratuar Urdhri i Ministrit të ZHETTS për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a. si dhe është miratuar ne datë 07.12.2016 VKM-ja "Për krijimin e shoqërisë "Albgaz", sh.a., dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive "Albpetrol", sh.a., dhe "Albgaz", sh.a". për ngritjen e shoqërisë së gazit "ALBGAZ" sh.a. dhe përcaktimin e përfaqësuesit të pronarit shtet për këtë shoqëri.

Prioritizimi i projekteve në transport, energjetikë dhe rrjetet e transportit, energjisë, mjedisit, etj, është kompetencë e Komitetit Kombëtar të Investimeve (KKI), rolin e të cili e luan Komiteti Ndërministror për Planifikimin Strategjik sikurse përcaktuar nga Urdhri i Kryeministrit Nr. 113, datë 26.8.2015 "Për disa shtesa në Urdhrin Nr. 18, datë 22.1.2014 të Kryeministrit, "Për krijimin e Komitetit Ndërministror të Planifikimit Strategjik". Sikurse përcaktuar në Urdhër, KKI do të bëjë planifikimin, prioritizimin, parashikimet për mbështetjen financiare dhe miratimin e investimeve me përmasa dhe për projekte rajonale, me rëndësi të veçantë për Shqipërinë dhe bashkëpunimin në rajon.

Ngritja e KKI ishte realizim i një rekomandimi të Komisionit Evropian dhënë për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. KKI zbaton një metodologji të re pune si bazë për dhënien e menaxhimin e asistencës së BE-së për investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të kësaj metodologjie, çdo shtet do të hartojë paketat kombëtare të projekteve të përbërë nga paketat kombëtare sektoriale. Në këtë mënyrë, këto projekte do të kenë akses më të madh në burimet e financimit dhe fondet e Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare financiare.

Siguria dhe mbrojtja nga rrezatimet në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Ligji Nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" i ndryshuar me Ligjin Nr. 9973, datë 28.07.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për Mbrojtjen nga Rrezatimet", që përafron Direktivën e Këshillit 96/29/Euratom e 13 Majit 1996, i cili përcakton standardet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe publikut në përgjithësi ndaj rreziqeve që vijnë nga rrezatimi jonizues, si dhe nga Ligji Nr. 26/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 8025, datë 9.11.1995", amendime të cilat janë bërë në përputhje me Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011 për "Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"

Ligji është një ligj kuadër bazë, i tillë që t'i hapë rrugë implementimit të të gjithë elementëve që përmban kjo direktivë në lidhje me sigurinë, sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimet. Elementët që nuk janë të reflektuar në ligj aktualisht janë të reflektuara ose do të reflektohen në rregulloret përkatëse.

Struktura kyçe në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, sigurisë dhe sigurimit janë: Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) dhe Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) përkatësisht si organizma rregullues, vendimmarrës dhe ekzekutivë për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues.

I.3 Struktura e kapitullit

SIGURIA E FURNIZIMIT
TREGU I ENERGJISË
EFICENCA E ENERGJISË DHE BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË
SIGURIA BËRTHAMORE DHE MBROJTJA NGA RREZATIMET

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi i përshtatjes së legjislacionit Shqiptar me legjislacionin e BE-së, parashikohet në nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Masat nga Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë

Shqipëria është shtet anëtar në Komunitetin e Energjisë dhe si pjesë e detyrimeve që burojnë nga ky kuadër, ka edhe detyrimin që përafrojë ose zbatojë *acquis* e Bashkimit Evropian të listuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian mbi energjinë përbëhet ndërmjet të tjerash nga aktet e mëposhtme:

Direktiva 2005/89/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 janar 2005 mbi masat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe të investimeve në infrastrukturë;

- Direktiva 2009/72/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, që shfuqizon direktivën 2003/54/KE;

- Rregullorja (KE) 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi kushtet e hyrjes në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, që shfuqizon Rregulloren (KE) 1228/2003;
- Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;
- Direktiva 2010/30/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi tregimin përmes etiketimit dhe informacionit standard të produktit të konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera nga produktet e lidhura me energjinë;
- Direktiva 2010/31/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi performancën energjetike të banesave;
- Direktiva 2012/27/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi eficencën e energjisë, që amendon Direktivën 2009/125/KE dhe 2010/30/BE, që shfuqizon Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE;
- Direktiva 94/22/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi kushtet për dhënien dhe përdorimin e autorizimeve për parashikimin, kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve;
- Direktiva 2009/119/EC e Këshillit, për vendosjen e një detyrimi në vendet anëtare për mbajtjen e minimumit te rezervës për naftën bruto dhe/ose nënprodukteve të saj;
- Direktiva 2009/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të gazit natyror, e cila shfuqizon Direktivën 2003/55/EC;
- Rregullorja (EC) Nr. 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 13 Korrik 2009 mbi kushtet për qasje në rrjetet e transmetimit të gazit natyror dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr. 1775/2005;
- Direktiva 2004/67/EC e datës 26 prill 2004 në lidhje me masat për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz natyror,

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Bazuar në Ligjin Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë” Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë miratoi Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016 "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike", i cili hyri në fuqi më datë 22.07.2016, datë në të cilën është publikuar në fletoren zyrtare Nr. 135.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.04.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar i aksioneve në kompanitë në sektorin e energjisë elektrike" ka hyrë në fuqi më datë 05.05.2016. Ky vendim ka bërë përfundimisht ndarjen e pronësisë të OST sh.a, nga pronësia e OSHEE sh.a dhe KESH sh.a. Në bazë të këtij vendimi, autoriteti publik, i cili përfaqëson shtetin si pronar i aksioneve të Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH SH.A), dhe Operatorit të Shpërndarjes Elektroenergjetike Shqiptare (OSSH), është Ministria e Energjisë dhe Industrisë. Autoriteti Publik, i cili përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM Nr. 449, datë 15.06.2016 “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit nga mundësia e fundit të energjisë elektrike".

Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr 101, datë 23.06.2016 “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar”, në bazë të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016 ”Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, i cili do zbatohen për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilët veprojnë në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike”, vendosi që “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH sh.a të kalojë te OSHEE sh.a dhe si rezultat, nga 1 korriku 2016, KESH sh.a nuk do të ushtrojë funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë dhe nuk do të ketë asnjë detyrim për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, dhe do të veprojë vetëm si operator publik i prodhimit të energjisë elektrike.

Në Ligjin Nr. 43/2015,të datës 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, është përfshirë edhe neni 109 (Dispozita Kalimtare), i cili parashikon daljen në treg të liberalizuar për klientët e ndryshëm, sipas nivelit të tensionit dhe konsumit të energjisë elektrike. Pika 1 e këtij neni citon: Klientët e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo klient tjetër që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike, në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madh se 50 milionë kWh, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohen se kanë dalë në treg të liberalizuar. Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV janë të detyruar të dalin në tregun e liberalizuar jo më vonë se data 30.06 2016, klientët e lidhur në tension 20 kV, jo më vonë se data 31.12.2016, ndërsa klientët e lidhur në nivelin e tensionit 10 kV dhe 6 kV, jo më vonë se data 31.12.2017. Klientët e lidhur në tension 0,4 kV kanë të drejtë të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre. Sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike, aktualisht duhet të ishin në treg të liberalizuar klientët 35 kV, 110 kV e sipër. Në bazë të vendimit nr. 13, datë 10.05.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE janë miratuar investimet në sistemin e matjes për konsumatorët e lidhur me nivelin e tensionit 35 kV. OSHEE sh.a do të kryejë këto investime në sistemin e matjes për klientët e lidhur me nivelin e tensionit 35 kV, për të mundësuar krijimin e kushteve teknike të një tregu të liberalizuar. Këto investime kanë filluar dhe pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2016,

Me hyrjen në fuqi më 30.10.2015 të ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015“Për sektorin e gazit natyror”, i cili ka përafruar direktivat e Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë Paketën e Tretë të Tregut të Brendshëm të gazit dhe konkretisht, Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; Rregulloren (EC) Nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 Korrik 2009, si dhe Direktivën 2004/67/EC e datës 26 prill 2004, Ministria e Energjisë dhe Industrisë është duke punuar për përgatitjen e legjislacionit sekondar.

Janë përgatitur katër projektvendime të Këshillit të Ministrave dhe dy Udhëzime të Ministrit, të cilat janë në procedurë shqyrtimi dhe miratimi. Po në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015"Për sektorin e gazit natyror", në datën 07.12.2016 Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për ndarjen e shoqërisë "Albpetrol" sh.a. dhe ngritjen e shoqërisë së gazit "ALBGAZ" sh.a. si dhe për përcaktimin e përfaqësuesit të pronarit shtet për këtë shoqëri.

Në fushën e Eficencës së Energjisë përveç zhvillimeve që kanë pasur në 2015 me miratimin e Ligjit Nr. 124, datë 12.11.2015 "Për Eficencën e Energjisë" i cili është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2012/27/KE, në dt. 07.12.2016 Këshilli Ministrave miratoi vendimin "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencisë për efiçencën e energjisë", institucion, i cili, është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për efiçencën e energjisë.

Po ashtu në dt. 10.11.2016, u miratua Ligji 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" përafron pjesërisht Direktivën 2010/31/EC "Për performancën e energjisë së ndërtesave". Ky ligj synon krijimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e performancës së energjisë së ndërtesave, duke marrë në konsideratë kushtet lokale dhe klimaterike të vendit, kushtet e komfortit të brendshëm të ndërtesave, si dhe kostot efektive në ndërtimin e ndërtesave të reja dhe në rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese.

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 20.1.2016 është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme, 2015-2020 .

Në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet u miratuan:

VKM Nr. 638, datë 7.09.2016 "Për miratimin e Rregullores 'Për trajtimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", rregullore e cila është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2013/59/EURATOM, e cila parashtron standardet bazë për mbrojtjen nga rreziku që mund të vijnë nga ekspozimi i rrezatimeve jonizuese".

VKM Nr. 815, datë 16.11.2016 "Për miratimin e Rregullores mbi transportin e sigurtë të materialeve radioaktive rregullore", e cila është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2013/59/EURATOM, e cila parashtron standardet bazë për mbrojtjen nga rreziku që mund të vijnë nga ekspozimi i rrezatimeve jonizuese".

II.3 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë

- Enti Rregullator i Energjisë
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Agjencia Kombëtare Bërthamore
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- Inspektorati Shtetëror, Teknik dhe Industrial
- Reparti i Inspektim dhe Shpëtim Minierave
- Nisma për transparencë në industrinë nxjerrëse.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Viti	2016	2017	2018
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	1,522	2,269	1,671
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	1, 930	1,198	1,084
Buxheti total i Kapitullit	3,452	3,467	2,755

III. Prioritetet

Prioritetet për sektorin elektro-energjitik për vitin 2017 do të jenë:

- Vazhdimi i reformës në sektorin energjetik, duke përfshirë:
  - Miratimi i Strategjisë së Energjisë
  - Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në përputhje dhe në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”
  - Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të energjisë,
  - Ndarja ligjore dhe funksionale e shoqërisë OSHEE sh.a, e cila është në proces;
  - Fillimi i ndërtimit të linjës së interkonjeksionit 400 kV Shqipëri - Maqedoni;
  - Realizimi i investimeve të planifikuara në OSHEE për vitin 2017;
  - Rritja e performancës së shoqërive publike që operojnë në sektorin elektrik duke:
    - Ulur humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike;

- Rritur arkëtimet nga shitja e energjisë elektrike.

Prioritetet në sektorin hidrokarbur për vitin 2017-2018 do të jenë:

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me *acquis* në kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, vlerësimin e rezervave hidrokarbure në përputhje të plotë edhe me Direktivën 94/22/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit;

Përfundimi i hartimit të projektligjit të ri në lidhje me modelin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj;

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 102, datë 23.09.2016, "Për sektorin e gazit natyror";

Përfundimi i Masterplanit të Gazit (MPG) dhe i Planit të Identifikimit të Projekteve (PIP) dhe miratimi i tyre respektivisht në Këshillin e Ministrave dhe në Këshillin Kombëtar të Territorit.

Vazhdimi i procesit të dhënies së lejeve për punime ndërtimore për projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe ndjekja e realizimit të punimeve ndërtimore për ndërtimin e rrugëve të kalimit dhe të urave në rrugët e projektit TAP, ndërtimi i tubacionit në tokë, si dhe stacioneve të kompresorëve të projektit TAP.

Përgatitja e studimit të parafizibilitetit për projektin e gazsjellësit Shqipëri – Kosovë (ALKOGAP) në bazë të financimit prej 300 mijë Euro të dhëna nga WBIF.

Bashkëpunim me Malin e Zi në kuadër të realizimit të projektit për përgatitjen e projekteve teknike paraprake dhe kryesore për pjesën e projektit të gazsjellësit Ionian Adriatik (Projekti IAP) për pjesën e këtij projekti në territorin e Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Ndarja e shoqërisë publike të naftës dhe gazit "Albpetrol" sh.a. dhe ngritja e shoqërisë së re të gazit si operator i kombinuar për aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes.

Miratimi i projektligjit të ri për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për transport.

Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit per prodhimin transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për transport

Hartimi i akteve nënligjore në zbatim te ligjit te ri te mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj;

Prioritetet për eficiencën e energjisë

- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit dytësor të Ligjit për Eficencën e Energjisë, në përputhje me Direktivën 2012/27/BE.
- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit dytësor të performancës së energjisë në ndërtesa në përputhje me Direktivën 2010/31/BE.

- Miratimi dhe zbatimi i planit të dytë dhe të tretë Kombëtar për Eficencën e Energjisë me qëllim arritjen e objektivave kombëtare deri në vitin 2020.

Prioritetet e Energjisë së Rinovueshme

- Rishikimi i tarifave ekzistuese për HEC-et e vogla me kapacitet të instaluar deri 15 MË, të cilat nuk mbështeten nga skemat e duhura tarifore.
- Tarifat e duhura "Feed-in" për të gjitha burimet e rëndësishme të rinovueshme të energjisë që vendi posedon dhe parashikon për t'i promovuar, do të duhet të propozohen nga ERE për miratim me qëllim për të siguruar besimin e investitorëve. OST duhet të përmirësojë transparencën në lidhje me vendosjen dhe publikimin e rregullave standarde mbi kostot e lidhjes me rrjetin të cilat janë të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë të rinovueshme.
- Koordinimi dhe vënia në dispozicion të aplikantëve nga Qendra Kombëtare për Aplikime të Energjisë i procedurave administrative, afateve, pranimit dhe trajtimit të aplikimeve të institucione të ndryshme të përfshira në proces.
- Kryerja e investimeve për shpërndarjen dhe kryesisht në rrjetet e transmetimit për të mbështetur rritjen e kapaciteteve gjeneruese të BER.
- Legjislacioni dytësor për zbatimin e Ligjit mbi biokarburantet ka nevojë të zhvillohet dhe të përshtatet më tej. Për më tepër, është e vështirë për të vlerësuar zbatimin e tij në praktikë, pasi arritjet konkrete në lidhje me përmbushjen e objektivit të biokarburanteve nuk kanë qenë të monitoruara ose të raportohen në përputhje me detyrimet e ligjit 2008.
- Transpozimi i dispozitave të Direktivës 2009/28/KE në lidhje me biokarburantet, ligjit për transportin, prodhimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme në transport, duke i përditësuar në përputhje me rrethanat.
- Sistemi për certifikimin e energjisë të prodhuar nga burimet e rinovueshme, bazuar në garancitë e origjinës, duhet zbatuar nga ERE si institucioni përgjegjës.

➢ **Objektivi strategjik i KMR në lidhje me mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin nga rrezatimet**

➢

➢ Objektivi strategjik i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, si Autoritet Kombëtar i pavarur nominuar nga Këshilli i Ministrave pranë Ministrisë së Shëndetësisë, është mbrojtja e shëndetit të punonjësve, publikut dhe mjedisit nga rreziku dhe risqet e rrezatimit jonizues dhe jojonizues.

➢

➢ Një nga angazhimet e Shqipërisë që rrjedhin në kuadër të MSA-së (Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit), konkretisht nenit 70/3 të saj, është përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë, sigurimit dhe mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2020

IV.1 Siguria e furnizimit

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare e Energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2003 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2009/72/KE	Ligji Nr. 43/2015 i datës 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	30.04.2015	13.06.2015
Direktiva 2009/28/KE	Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008 "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport", i ndryshuar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	14.02.2008	15.03.2008
Direktiva 2009/28/KE	Ligji 138/2013 "Për burimet e Rinovueshme të energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	02.05.2013	04.06.2013
Direktiva e Këshillit 2009/119/KE	Ligji Nr. 8450 të datës 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	24.02.1999	31.03.1999

	dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.				
Direktiva 2009/73/KE	Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.09.2015	30.10.2015
Rregullorja Nr. 715/2009/KE	Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.09.2015	30.10.2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Strategjia në sektorin e energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2015 – 2030	Tremujori IV, 2017	Tremujori IV, 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Direktiva 2009/28/KE	Po	Projektligj "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	Tremujori IV, 2017	Tremujori IV, 2017
Direktiva e Këshillit 2009/119/KE	Po	Projektligj "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin rezervave minimale te	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori IV, 2017	Tremujori IV, 2017

		sigurisë të naftës bruto dhe / ose nënprodukteve të saj”					
Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 347/2013	Po	Projekt VKM “Për miratimin e udhëzuesit për infrastrukturën energjetike në sektorin hidrokarbur që do të jetë pjesë e infrastrukturës energjetike Trans-Evropiane	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë.	Tremujori II, 2017	Tremujori II, 2017
AFAT MESËM (2018– 2019)							
Direktiva 2009/30/KE	Po	Projekt VKM “Për cilësinë e lëndëve djegëse”	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	E plotë	Tremujori IV, 2018	Tremujori IV, 2018

IV.2 Tregu i energjisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare e Energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2003 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2009/72/KE	Ligji Nr. 43/2015 i datës 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	30.04.2015	13.06.2015
Direktiva 2009/73/KE	Ligji Nr. 102/2015 i datës 23. 09.2015 “Për Sektorin e Gazit	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.09.2015	30.10.2015

	Natyror”				
Direktiva 2009/28/EC	Ligji Nr. 9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, i ndryshuar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	14.02.2008	15.03.2008
Direktiva e Këshillit 2009/119/EC	Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	24.02.1999	31.03.1999
Direktiva 94/22/EC	Ligji Nr. 7746, datë 28.07.1993, “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	28.07.1993	22.08.1993
Direktiva 2009/73/EC	Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “Për sektorin e gazit natyror	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.09.2015	30.10.2015
Direktiva 1999/32/EC	VKM Nr. 781, datë 14.11.2012, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Mjedisit	I plotë	14.11.2012	04.12.2012
	VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	21.03.2007	12.04.2007

	Udhëzimin e Përbashkët, Nr. 6, datë 9.10.2007, i ish-Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe ish-Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, "Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e benzinës dhe të diezelit"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Mjedisit	I plote	9.10.2007	01.02.2008
	Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Mjedisit "Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (gas oil), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (heavy fuel oil) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (marine fuel)"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave	I plote	10. 06. 2016	19.07.2016

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia në sektorin e energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2015 – 2030	Tremujori II, 2017	Tremujori II, 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017– 2020

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFATSHKURTËR (2017)							
Direktiva 2009/28/KE	Po	Projektligj "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	Tre mujori i katërt IV 2017	Tremujori IV viti 2017
Direktiva e Këshillit 2009/119/EC	Po	Projektligji "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin rezervave minimale te sigurisë të naftës bruto dhe / ose nënprodukteve të saj"	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori II 2017	Tremujori II 2017
AFATMESME (2018-2020)							
n/a	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**

IV.3 Eficenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare e Energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2003 – 2015

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/	Data e përshtatjes (Legjislacioni	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)

			mospërputhje)	Shqiptar)	
Direktiva 2009/28/KE	Ligji 138/2013 Për burimet e energjisë së rinovueshme	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	E pjesshme	02.05.2013	04.06.2013
Direktiva 2012/27/KE	Ligji 124/2015, datë 12.11.2015 Mbi eficencen e energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	E pjesshme	12.11.2015	09.12.2015
Direktiva 2010/31/KE	Ligji 116/2016 of 10.11.2016 Për performancën e energjisë së ndërtesave	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	E pjesshme	10.11.2016	07.12.2016
Direktiva 2010/30/EC	Ligji 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	E plotë	10.04.2012	21.06.2012

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia në sektorin e energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2015 – 2030	Tremujori IV, 2017	Tremujori IV, 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

AFATSHKURTRA (2017)							
EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhj e e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
Direktiva	Po	Projektligj "Për	Po	Ministria e Energjisë	I pjesshëm	Tremujori i I-rë	Tremujori i I-rë 2017

2009/28/KE		nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”		dhe Industrisë		2017	
AFATMESME (2018– 2020)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.4 Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Politikat për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë	KMR	Nr.1319/3 datë 25.03.2013
Hapat strategjike për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” Nr.435 datë14.10.2015	KMR	2017-2030
Edukimi dhe trajnimi për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues si dhe hapat për implementim”	KMR	Nr.434 datë 14.10.2015

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU *acquis*	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e	Ligji Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Mbi mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	9.11.1995	20.12.1995

shëndetit të punëmarrësve dhe publikut në tërësi ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues					
Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut në tërësi ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues	Ligji Nr. 9973, datë 28.07.2008 "Mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 8025, datë 9.11.1995 'Mbi mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	28.07.2008	19.08.2008
Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut në tërësi ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues	VKM Nr.8 datë 7.1.2010 mbi miratimin e rregullores për "Menaxhimin e Sigurtë të mbetjeve radioaktive në Shqipëri"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	7.01.2010	27.01.2010
Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut në tërësi	VKM Nr.9, datë 7.01.2010 mbi miratimin e rregullores " Mbi kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, në funksion të sigurisë, sigurimit dhe	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	7.01.2010	27.01.2010

ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues	mbrojtjes nga burimet e rrezatimit jonizues”				
Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut në tërësi ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 7.01.2010 “Mbi miratimin e Rregullores mbi licencimin dhe inspektimin e aktiviteteve me rrezatim jonizues”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	7.01.2010	27.01.2010
Direktiva 2006/117 / Euratom Mbi transportin e mbetjeve radioaktive dhe lendës djegëse Rregullorja e Këshillit 1493/93 mbi transportin e materialeve radioaktive ndërmjet Shtetit Anëtar	VKM Nr. 488 datë 23.06.2010 mbi miratimin e rregullores për " Transport të sigurtë të materialeve radioaktive”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	23.06.2010	29.07.2010
Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut të përgjithshëm ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues	VKM Nr.543 datë 7.07.2010 mbi miratimin e rregullores “ Për punë të sigurtë me burime të rrezatimit jonizues”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	7.07.2010	19.08.2010

Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut të përgjithshëm ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues	VKM Nr. 590 datë 18.08.2011 mbi miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht nga rrezatimi jonizues"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	18.08.2011	22.09.2011
2000/473/EURATOM Rekomandimi I Komisionit datë 8 Qershor 2000, Mbi zbatimin e nenit 36 të Traktatit Euroatom, për monitorimin e niveleve të radioaktivitetit në mjedis, me qëllim vlerësimin e ekspozimit të popullatës në tërësi.	VKM Nr. 313 datë 9.05.2012 mbi miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	9.05.2012	13.06.2012
Direktiva 96/29 / EC Euratom e datës 13 maj 1996, e cila parashtron standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut ndaj rreziqeve që vinë nga rrezatimi jonizues	VKM Nr. 481 of 25.07.2012 mbi miratimin e rregullores "Për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimit jonizues"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	25.07.2012	30.08.2012

Direktiva e Këshillit 97/43 / Euratom 30 qershor 1997 , Mbi mbrojtjen e shëndetit të individëve në lidhje me ekspozimet mjekësor që vinë nga rrezatimi jonizues	VKM Nr. 229 datë 20.03.2013 mbi miratimin e rregullores "Për sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	20.03.2013	16.04.2013
Direktiva 2013/59/Euratom	VKM Nr. 877 datë 30.10.2015 mbi miratimin e rregullores për "Sigurimin fizik të materialeve radioaktive ne Republikën e Shqipërisë"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	30.10.2015	30.10.2015
Direktiva 2013/59/Euratom	VKM Nr.957 datë 25.11.2015 mbi miratimin e rregullores Për nivelet udhëzuese të përqendrimit të radonit në ambientet e brendshme dhe përqendrimet e radiobërthamave në mallra, me efekt mbrojtjen e publikut"	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	25.11.2015	25.11.2015
Direktiva 2013/59/Euratom	VKM Nr. 638 datë 7.09.2016 mbi miratimin e rregullores Për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	7.09.2016	14.09.2016
Direktiva 2013/59	Vendim i Këshillit të	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	16.11.2016	25.11.2016

EURATOM 5 dhjetor si dhe dokumenti mbi ADR-në	Ministrave nr. 815, datë 16.11.2016 "Për miratimin e rregullores mbi transportin e sigurtë të materialeve radioaktive"				

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017-2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e përshtatjes**	**Hyrja në fuqi**
Plani i veprimit mbi mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet jonizuese	Ministria e Shëndetësisë	Shumëvjeçare	Tremujori III-të, 2018	Tremujori III-të, 2018

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017-2020

EU *acquis*	**Status i përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)**	**Data e planifikuar për përshtatjen**	**Hyrja në fuqi**
AFATSHKURTËR (2017)							
Direktiva 2013/59 EURATOM 5 dhjetor 2013	Jo	Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores mbi Përgatitjen dhe reagimin ne rast emergjence	Po	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	Tremujori i III-të 2017	Tremujori i III-të 2017

		radiologjike për mbrojtjen e punonjësve dhe publikut					
Direktiva 2013/59 EURATOM 5 Dhjetor 2013	Jo	Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e "Rregullores për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jonizuese	po	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	Tremujori i IV-te 2017	Tremujori i IV-te 2017
AFATMESËM (2018– 2020)							
EU *acquis*	**Status i përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)**	**Data e planifikuar për përshtatjen**	**Hyrja në fuqi**
Direktiva 2013/59 EURATOM 5 dhjetor 2013	Jo	Projekt vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar	po	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	Tremujori i IV-ët 2018	Tremujori i IV-ët 2018

		profesionalisht nga rrezatimi jonizues”					
Direktiva 2013/59 EURATOM 5 dhjetor 2013	Jo	Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Për sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues”	po	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	Tremujori i IV-ët 2019	Tremujori i IV-ët 2019
Direktiva 2013/59 EURATOM 5 dhjetor 2013	Jo	Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “ Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues”	po	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	Tremujori i III-të 2020	Tremujori i III-të 2020

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve të buxhetit të shtetit të planifikuara

000/lekë

Kapitulli 15 Energjia					
Përfituesi: Ministria e Energjisë dhe Industrisë					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali (3+4+5)**
Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport.	A) Paga –stafi ekzistues	90			90
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	30			30
	Aktiviteti total	**120**			**120**
Ligji për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin rezervave minimale te sigurisë të naftës bruto dhe / ose nënprodukteve të saj	A) Paga –stafi ekzistues	180			180
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	90			90
	Aktiviteti total	**270**			**270**
VKM "Për miratimin e udhëzuesit për infrastrukturën energjetike në sektorin hidrokarbur që do të jetë pjesë e infrastrukturës energjetike Trans-Evropiane	A) Paga –stafi ekzistues	210			210
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	90			90

	Aktiviteti total	**300**			**300**
VKM "Për cilësinë e lëndëve djegëse"	A) Paga –stafi ekzistues		210		210
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		90		90
	Aktiviteti total		**300**		**300**
Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet					
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali (3+4+5)**
Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores mbi Përgatitjen dhe reagimin ne rast emergjence radiologjike për mbrojtjen e punonjësve dhe publikut	A) Paga –stafi ekzistues	**386**			**386**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	**386**			**386**
Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e "Rregullores për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jonizuese	A) Paga –stafi ekzistues	**386**			**386**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	**386**			**386**
Projekt vendim i Këshillit të	A) Paga –stafi ekzistues	**386**			**386**

Ministrave për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht nga rrezatimi jonizues	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	**386**			**386**
Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores "Për sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues"	A) Paga –stafi ekzistues	**386**			**386**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	**386**			**386**
Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores " Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues	A) Paga –stafi ekzistues	**386**			**386**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	**386**			**386**

Tabela B – Fondet e planifikuara të asistencës së huaj

Kapitulli:				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i projektit**	**Titulli i programit/donatori**	**Vlera në €**	**Aktivitetet**
Rajoni i Lezhës dhe Lushnjës	Alterenergy	Cross Border Cooperation	3.000.000	Investime për objektet publike, në

		Programme IPA Adriatic		marrjen e masave për eficencën e energjisë dhe burimeve të rinovueshme
Godina e Qytetit Studenti Nr. 2, Tiranë	Rehabilitimi i Qytetit Studenti No.2	KFW	5.200.000	
Godina e Qytetit Studenti Nr. 2, Tiranë	Shërbime konsulence për rehabilitimin me masa të eficencës së energjisë në Qytetin Studenti N.2	KFW	651.246	Ky projekt ka për qëllim dhënien e konsulencës si dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderit, zhvillimin e tij dhe përzgjedhjen e kompanisë e cila do të kryejë punimet e rehabilitimit dhe te pajisjes me efiçencë energjie në katër godina në Qytetin Studenti Nr. 2.
Bashkia e Gjirokastrës, Vlorës dhe muzeu në Korçë	Projekti GALET rehabilitimi me masa të eficencës së energjisë në bashkitë Vlorë, Gjirokastër, Korçë	Cross Border Cooperation Programme IPA Adriatic	1.600.000	Implementimi i teknologjive mjedisore për shfrytëzimin dhe ruajtjen e energjisë në banesat publike që përcjellin një trashëgimi kulturore për turistët. Rehabilitim ndërtesash publike në lidhje me masat për eficencë të energjisë dhe burimeve të qëndrueshme
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Projekti për ngritjen e kapaciteteve në institucionet e administratës publike në lidhje me Zhvillimin e infrastrukturave të Mëdha të Gazit II	SECO	6.600.000	Ky projekt ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve në institucionet e administratës publike në lidhje me trajtimin dhe mbështetjen e projekteve të infrastrukturës së madhe të gazit edhe nëpërmjet

				forcimit dhe ngritjes së institucioneve përkatëse të kësaj fushe, për përgatitjen e studimeve konkrete në plotësimin e rregullave teknike për sektorin e gazit, si dhe për realizimin e projekteve konkrete për infrastrukturën e sektorit të gazit në Shqipëri.
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Përgatitja e Masterplanit të Gazit (MPG) për Shqipërinë dhe i Planit të Identifikimit të Projekteve (PIP)	WBIF	1 100 000	Përgatitja e Masterplanit të Gazit (MPG) dhe i Planit të Identifikimit të Projekteve (PIP) për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, si dhe miratimi i tyre respektivisht në Këshillin e Ministrave dhe në Këshillin Kombëtar të Territorit.
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Përgatitja e projekteve teknike paraprake dhe kryesore për pjesën e projektit të gazsjellësit Ionian Adriatik (Projekti IAP) për pjesën e këtij projekti në territorin e Shqipërisë dhe Malit të Zi.	WBIF	2 500 000	Bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë së Malit të Zi në kuadër të realizimit të projektit për përgatitjen e projekteve teknike paraprake dhe kryesore për pjesën e projektit të gazsjellësit Ionian Adriatik (Projekti IAP) për pjesën e këtij projekti në territorin e Shqipërisë dhe Malit të Zi..
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Studimi i parafizibilitetit për projektin e gazsjellësit Shqipëri – Kosovë (ALKOGAP).	WBIF	300 000	Bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës në kuadër të realizimit të projektit për

				përgatitjen e Studimit të parafizibilitetit për projektin e gazsjellësit që do të lidhë Shqipërinë me Kosovën (Projekti ALKOGAP).
Totali për kapitullin:			**20 951 246**	

KAPITULLI 16: TATIMET

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Objektivi kryesor lidhur me politikat tatimore është përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si edhe përmirësimi i administrimit të tatimeve në rritjen e bazës së taksueshme. Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet:

- harmonizimit të politikave tatimore me *acquis* e BE-së;
- krijimit të klimës së biznesit të favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja;
- formulimit të politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë;
- përmirësimit të menaxhimit të administratës tatimore, duke u bazuar në realizimin e të ardhurave me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, me një standard që krijon besueshmëri tek qytetarët dhe kredibilitet me partnerët ndërkombëtarë dhe komunitetin e biznesit, vendas dhe të huaj.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis*. Në kuadër të përafrimit të legjislacionit për TVSH-në me direktivën 2006/112/KE janë bërë ndryshime në udhëzimin Nr. 6, datë 30.01 2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë, i cili është miratuar në zbatim të ligjit të ri të TVSH-së Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 si dhe akte të tjera nënligjore të cilat përmenden tek paragrafi II "Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion". Gjithashtu, ndryshime janë bërë në legjislacionin e akcizës për të arritur një lidhje të mëtejshme me *acquis* e BE-së për sa i përket nivelit dhe strukturës së akcizës së cigareve dhe birrës.

Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje me FMN-në më datë 19 mars 2014, për të arritur konsolidimin fiskal nëpërmjet përmirësimit të administratës tatimore dhe forcimin e menaxhimit të financave publike. Një komponent i rëndësishëm i marrëveshjes është shlyerja e borxheve, duke përfshirë këtu edhe borxhet për TVSH-në.

I.3 Struktura e Kapitullit

1. POLITIKAT TATIMORE

2. TATIMI DIREKT
3. TATIMI INDIREKT
4. NDIHMA E NDËRSJELLË

II. Situata Aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe e legjislacionit të BE-së.

Neni 98 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon se, Shqipëria dhe BE-ja do të vendosin bashkëpunimin në fushën e tatimeve, duke përfshirë masat që synojnë reformimin e mëtejshëm të sistemit fiskal dhe ristrukturimin e administratës tatimore, me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal. Për më tepër, ky bashkëpunim duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-s në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe BE-ja e njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin tatimor. Gjithashtu, Neni 98 i MSA kërkon konsultime ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së me qëllim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve midis Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shqipërisë, për të siguruar një nivel të barabartë përsa i përket tatimit të biznesit.

Ligji i BE-së në fushën e tatimeve përbëhet nga disa akte ligjore. Në nivelin e ligjit primar, neni 110 i TFBE (Traktatit për Funksioninimin e Bashkimit Evropian), i cili ndalon diskriminimin e taksave është i një rëndësie vendimtare. Legjislacioni sekondar ndër të tjera përfshin:

- Direktivën e Këshillit 2008/118/EC, e datës 16 dhjetor 2008, "Në lidhje me masat e përgjithshme për akcizën dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/KEE";
- Direktivën e Këshillit 2006/112/KE, 28 nëntor 2006, "Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar";
- Direktivën e Këshillit 2003/48/KE, 3 qershor 2003, "Mbi tatimin nga të ardhurat e kursimeve në formën e pagesave të interesit";
- Direktivën e Këshillit 2009/133/KE, 19 tetor 2009, "Në sistemin e përbashkët të taksimit, të zbatueshëm për bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjesshme, transfertat e aktiveve dhe shkëmbimet e aksioneve në lidhje me kompanitë e Shteteve të ndryshme Anëtare dhe për transferimin e zyrës regjistruese të një Kompanie Evropiane ose Shoqërie të Bashkuar Evropiane ndërmjet Shteteve Anëtare";
- Direktivën e Këshillit 2010/24/EU, 16 mars 2010, "Mbi asistencën e ndërsjellë për rimëkëmbjen e kërkesave lidhur me taksat, detyrimet dhe masat e tjera";
- Direktivën e Këshillit 2011/16/BE, të datës 15 shkurt 2011, "Për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve";

- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 904/2010, 7 tetor 2010,"Mbi bashkëpunimin administrativ dhe luftën e mashtrimit në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar;
- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 2073/2004, 16 nëntor 2004, "Mbi bashkëpunimin administrativ në fushën e detyrimeve të akcizës";
- Rregulloren e Këshillit 2004/106/KE, 16 nëntor 2004 "Që amendon Direktivën 77/799/KEE, në lidhje me ndihmën reciproke nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në fushën e tatimeve direkte, detyrimeve të caktuara të akcizës dhe tatimit mbi primet e sigurimit dhe 92/12/KEE mbi masat e përgjithshme për produktet që i nënshtrohen akcizës dhe të mbajtjes, lëvizjes dhe monitorimit të këtyre produkteve".

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë fokusuar në përafrimin e legjislacionit fiskal me *acquis* duke synuar uljen e barrës tatimore për biznesin dhe individët, duke rritur bazën e taksueshme, hartimin e politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë.

Sistemi aktual informatikë është një sistem i ri më modern, më i avancuar dhe më praktik në përdorim, i cili ka ridizenjuar brenda një kohe shumë të shkurtër të gjitha proceset e Administratës Tatimore, duke zëvendësuar transaksionet kyçe të sistemeve të vjetruara. Projekti E-Taxtion ka për qëllim të njësojë operacionet e administratës tatimore me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian dhe projektet tatimore. Bashkëpunimi administrativ dhe asistenca e ndërsjellë, si edhe efikasiteti i sistemit të brendshëm antikorrupsion dhe të hetimit tatimor janë rritur.

Në kuadër të sistemit të ri të IT-së është implementuar në sistem ndërmjet te tjerave dhe Moduli i Analizës së Riskut, i cili është një ndër risitë e këtij sistemi. Platforma e re ofron mundësi për të ndërtuar profile më të mira rreziku, për industri të tëra apo për këdo që mendohet se përdor një metodë specifike për të shmangur taksat.

Me poshtë listohen zhvillimet dhe ndryshimet e fundit sa i përket legjislacionit tatimor:

- Ligji Nr. 99/2015, datë 23.09.2015 "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- Ligji Nr.141/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;

- Ligji Nr. 143/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 145/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së ShqipërisëNr. 33, datë 8.6.2016, “Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i neneve 5,15,16/4 dhe 18/2 i ligjit nr.99/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.
- VKM Nr. 841, datë 14.10.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- VKM nr. 38, datë 21.01.2016 “Për akcizat”;
- VKM Nr. 176, datë 9.3.2016 “Për disa ndryshime në VKM nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- VKM Nr. 460, datë 22.06.2016 “Për një ndryshim në VKM nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 31, datë 13.05.2015 “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 14/2, datë 4.9.2015 „Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit te Financave Nr. 6/5, datë 5.10.2015 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 26, datë 26.10.2015 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave, Nr.10, datë 3.5.2016. “Për një shtesë në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave, Nr. 13, datë 17.05.2016 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Financave (Përfaqësuar nga Drejtoria e Politikave dhe Marrëdhënieve Fiskale) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ministria e Financave është institucioni kryesor.

*Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe e Çështjeve Fiskale*harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik dhe bën një analizë tëthellë të ekonomisë në rajon.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe autoriteti që ka të drejtën e implementimit të ligjeve fiskale, administrimit të taksave dhe tarifave ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i DPT-së është të ndihmojë tatimpaguesit të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e zbatueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga taksat të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke i ofruar Tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

Grupi Ndër-Institucional i Punës për Integrimin Evropian, i krijuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.107, datë 28.02.2014, "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndër-Institucionale të Punës për Integrimin Evropian", për Kapitullin 16 "Tatimet" kryesohet nga Ministria e Financave dhe përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Në kuadër të pjesëmarrjes në programin e Unionit "Fiscalis 2020", bazuar në Marrëveshjen e firmosur midis Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë dhe ratifikuar në Parlamentin Shqiptar në janar 2015, kontributi financiar që Republika e Shqipërisë (DPT) duhet të paguajë në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të jetë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela e alokimeve financiare

Në Euro[4]

Viti	2017	2018	2019
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	35,000	40,000	45,000
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	N/A	N/A	N/A
Buxheti total i Kapitullit	35,000	40,000	45,000

III. Prioritetet

Aktualisht, legjislacioni fiskal shqiptar është pjesërisht në përputhje me *acquis* e BE-së. Ligji 61/2012 "Për akcizën në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është pjesërisht në përputhje me *acquis*e BE-së. Shqipëria filloi zbatimin e ligjit të ri të akcizës më 1 tetor 2012. Në një periudhë afat-mesme, fokusi ynë kryesor do të jetë përafrimi i mëtejshëm i strukturës dhe normave të akcizës me *acquis* lidhur me akcizën e alkoleve.

Gjatë vitit 2016, prioritet kryesor ka qenë zbatimi i legjislacionit të përafruar me *acquis* për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ky ligj ka përafruar legjislacionin shqiptar me Direktivën 2006/112/KE.

Për vitin 2017, prioritet është hartimi i legjislacionit të ri për Tatimin mbi të Ardhurat.

IV. Plani i Veprimit 2017 – 2020

IV.1 Politikat tatimore

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Plani Strategjik i Administratës Tatimore	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	2015 – 2019

[4]Tabela është dhënë në euro, pasi kontributi financiar që Republika e Shqipërisë (DPT) duhet të paguajë në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian bëhet në euro, sipas kërkesës së BE-së.

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2008/118/KE	Ligji nr. 61/2012, "Ligji për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	I pjesshëm	1.07.2012	1.10.2012
Direktiva 2006/112/KE	Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për TVSH-në"	Ministria e Financave Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	I pjesshëm	24 .07. 2014	01.01.2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Kuadri i politikave ekzistuese	Periudha e referuar
N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

Acquis i BE-së	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e EC	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Direktiva 2009/133/KE	Po	Ligji "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar nr. 8438, datë 28.12.1998, në lidhje me shkrirjen dhe bashkimin.	po	Ministria e Financave	I pjesshëm	T 4 2017	T 1 2018
AFAT MESËM (2018 – 2020)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.2 Tatimi direkt

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike	Ministria e Financave	2014 – 2020

Inventari i masave ligjore ekzistuese

***Acquis* I BE-së**	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Kuadri i politikave ekzistuese	Periudha e referuar
N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuarapër periudhën 2017 – 2020

***Acquis* i BE-së**	**Status i përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhj e e pjesshme)**	**Data e miratimit**	**Hyrja në fuqi**
AFAT - SHKURTËR (2017)							
Direktiva 2009/133/KE	Po	Ligji "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar nr. 8438, datë 28.12.1998, në lidhje me	Po	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e	i pjesshëm	T 4 2017	T1 2018

		shkrirjen dhe bashkimin.		Tatimeve			
AFAT- MESËM (2018-2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.3 Tatimi indirekt

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia e Financave Publike 2014-2020	Ministria e Financave	2014 – 2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

***Acquis* i BE-së**	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Direktiva 2008/118/KE	Ligji nr. 61/2012, "Ligji për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	E pjesshme	1.10.2012	1.10.2012
Direktiva 2006/112/KE	Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për TVSH-në"	Ministria e Financave Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	I pjesshëm	24 .07. 2014	01.01.2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuarapër periudhën 2017 – 2020

A*cquis* i BE-së	Status i përkthimit në	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në	Institucioni Përgjegjës dhe pika e	Niveli i synuar i përafrimit	Data e e miratimit	Hyrja në fuqi

	Shqip (po/jo)		Anglisht (po/jo)	kontaktit	(i plotë/përputhje e pjesshme)		
AFAT - SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT- MESËM (2018-2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.4 Ndihma e ndërsjellë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
N/A	N/A	N/A

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuarapër periudhën 2017 – 2020

Acquis i BE-së	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi

AFAT - SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT- MESËM (2018-2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve të buxhetit të shtetit të planifikuara

000/lekë

Kapitulli 16 "Tatimet"					
Përfituesi: Ministria e Financave					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali (3+4+5)**
[5]Projektligji „Për tatimin mbi të ardhurat"	A) Paga –stafi ekzistues	2.082.784 lekë			2.082.784 Lekë
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi	0 lekë			0 lekë
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0 lekë			0 lekë
	Aktiviteti total	**2.082.784 lekë**			**2.082.784 lekë**
Projektligji „Për tatimin mbi të ardhurat"	A) Paga –stafi ekzistues	1.180.960 lekë			1.180.960 lekë
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi	0 lekë			0 lekë
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0 lekë			0 lekë
	Aktiviteti total	1.180.960 lekë			**1.180.960 lekë**

[5] Kostot janë llogaritur vetëm për pjesën e ligjit që synon përafrim me direktivën përkatëse të BE-së

Buxheti total i përfituesit	**3.263.744**	**3.263.744**
Totali i Kapitullit	**3.263.744**	

Tabela B – Fondet e planifikuar nga asistenca e huaj

Kapitulli:				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
Totali për Kapitullin:				

KAPITULLI 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së në fushën e politikës ekonomike dhe monetare përmban kritere që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore të Shteteve Anëtare dhe ndalimin e financimit direkt të sektorit publik nga ana e bankave qendrore, ashtu si dhe aksesin e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet Anëtare priten që të koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe janë subjekt i rregullave të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes, si dhe procedurave të monitorimit të deficitit. Shtetet Anëtare të sapo-anëtarësuara angazhohen edhe në drejtim të përmbushjes së kritereve për adoptimin e euros. Para se këto Shtete të anëtarësohen në eurozonë, do të marrin pjesë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar si Shtete Anëtare me *derogation,* dhe duhet të trajtojnë politikën e tyre të kursit të këmbimit si një çështje të përbashkët me Bashkimin Evropian.

I.2 Situata në Shqipëri

Politikat ekonomike dhe monetare kanë synuar forcimin e treguesve makroekonomikë dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Autoritetet kanë ndjekur politika të harmonizuara që mbështesin kërkesën agregate dhe sigurojnë punësim të qëndrueshëm, pa shkaktuar presione inflacioniste. Politika monetare vijon të jetë stimuluese për të mbështetur kërkesën e brendshme dhe kthimin e inflacionit në objektiv në afat të mesëm. Ajo plotëson politikën konsoliduese të autoritetit fiskal, e cila synon të adresojë vulnerabilitetet e qëndrueshmërisë së borxhit publik dhe forcimin e administrimit të financave publike. Autoritetet janë angazhuar në zbatimin e një sërë reformash strukturore, të cilat sigurojnë rritje të qëndrueshme ekonomike në afat të gjatë.

Stabiliteti makroekonomik vazhdoi të mbështetet nga një politikë monetare e shëndetshme që funksionon nën një regjim të shënjestrimit të inflacionit dhe të kursit të lirë të këmbimit. Me qëllim arritjen e objektivit 3.0% të inflacionit në afat të mesëm, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese në vitet e fundit. Stimuli monetar është forcuar në pjesën e parë të vitit 2016 në përgjigje të presioneve të ulëta inflacioniste dhe zhvendosjes për poshtë të balancës së rreziqeve në këtë periudhë. Norma bazë e interesit u ul me 0.50 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin e ri historik prej 1.25% në muajin maj. Gjithashtu, për të lehtësuar përcjelljen e politikës monetare lehtësuese në tregun ndërbankar, korridori i lehtësirave të përhershme u ngushtua. Të dhënat më të fundit kanë konfirmuar natyrën kalimtare të goditjeve dizinflacioniste në tremujorin e parë. Aktiviteti ekonomik u përshpejtua në dy tremujorët e parë të vitit, dhe norma e inflacionit ka treguar prirje

rritëse në muajt e fundit në reflektim të forcimit të presioneve inflacioniste nga ekonomia e brendshme dhe zbutjes së presioneve inflacioniste nga jashtë. Në muajin nëntor, norma vjetore e inflacionit shënon 1.9%, nga 0.7% mesatarisht në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2016.

Forcimi i stimulit monetare është përcjellë në rënie të normave të interesit në të gjitha segmentet e tregut financiar. Kreditimi në monedhë vendase tregon prirje rritëse me kontribut nga kreditimi në lekë, por rimëkëmbja e qëndrueshme e kreditimit kufizohet nga kërkesa e ulët dhe rreziku i lartë i kredisë. Pesha e kredisë në lekë në totalin e kredisë shfaq trend rritës. Kreditimi pritet të përshpejtohet në vitet e ardhshme i mbështetur nga lehtësimi i kushteve financiare, përmirësimi i ndjesisë ekonomike, dhe ulja e rrezikut të kredisë si pasojë e zbatimit të planit të masave për uljen e kredive me probleme. Politika monetare do të vijojë të sigurojë stimulin e nevojshëm në përputhje me objektivin kryesor të saj arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në afat të mesëm. Aktiviteti ekonomik pritet të përforcohet dhe inflacioni ti afrohet objektivit në afatin e mesëm.

Konsolidimi i politikës fiskale ka qenë gjeneratori kryesor i bilancit fiskal për periudhën janar – gusht 2016. Gjatë këtyre 8 muajve është regjistruar një suficit prej rreth 1% të PBB-së (ose një suficit prej 13,728 milionë Lekë, e cila nënkupton rreth 181% më mirë se e njëjta periudhë e një viti më parë[6]).

Politika fiskale për periudhën afat-mesme do të jetë rigorizikisht e orientuar drejt konsolidimit fiskal. Ministria e Financave është e angazhuar të ruaj këtë drejtim me qëllim reduktimin e risqeve nga borxhi, i cili ngadalëson rritjen dhe shkakton paqëndrueshmëri makroekonomike. Në një linjë me programin e MF-ve dhe FMN-së, qeveria është e vendosur të ndjekë një ritëm të qëndrueshëm fiskal i bazuar në strategjinë e zgjerimit të bazës së taksueshme dhe të forcimit të administratës tatimore, me qëllim reduktimin e borxhit publik ndaj PBB-së nën nivelin 66% në vitin 2018 dhe në 61.6% në vitin 2019, nga rreth 71.4% që pritet të jetë në fund të vitit 2016. Konsolidimi fiskal i planifikuar për vitet në vijim është i mirë strukturuar me targetin e parashikuar nga qeveria për deficitin fiskal prej respektivisht 2% të PBB-së për vitin 2017, 1.8% të PBB-së për vitin 2018 dhe -1% të PBB-së për vitin 2019.

Duke vijuar në këtë drejtim do të jetë e mundur reduktimi i borxhit publik i cili filloi në vitin 2016 – për herë të parë që prej vitit 2010 – dhe kështu do të vijoje edhe në vitet e ardhshme. Borxhi publik pritet të reduktohet në 69.1% të PBB-së në vitin 2017, në 66.5% në vitin 2018 dhe

[6] Kjo vlerë rezulton nga pjesëtimi i bilancit fiscal progresiv të muajit Gusht 2016 (e marrë nga Statistika Fiskale – shtator 2016 / MF) ndaj vlerës nominale të PBB-së së parashikuar (të marrë nga Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2017-2020 i Rishikuar Nëntor 2016 / MF);

63% në vitin 2019. Ky objektiv do të arrihet pavarësisht mbështetjes buxhetore që qeveria ka bërë ndaj sektorit energjetik, të cilat janë marrë në konsideratë për 2 vitet në vijim. Si rrjedhojë, në skenarin bazë të Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal, Ministria e Financave është e përkushtuar të reduktojë normën e borxhit publik ndaj PBB-së (duke përfshirë këtu: garancitë dhe borxhin e qeverisë lokale) në rreth 66.2% për periudhën afat-mesme (2017-2019). Për të realizuar objektivat e deficitit fiskal, Ministria e Financave ka adoptuar masa rregulluese fiskale.

Ndërkohë, Ministria e Financave po implementon disa politika buxhetore për të mbështetur rritjen dhe për të kompensuar efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike në periudhën e shkurtër dhe afat-mesme jane ruajtur në të njëjtin nivel si më parë, në rreth 5.8% të PBB-së në fund të vitit 2016 dhe me një nivel mesatar prej 5.8% të PBB-së përgjatë 2017-2019 (duke përfshirë këtu edhe investime për zhvillimin rajonal dhe investimet në sektorin e energjisë si financim direkt nga buxheti) do të nxisë investimet totale në ekonomi, e cila luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kërkesës së brendshme në afat-shkurtër dhe të nxisë rritjen potenciale në periudhën afat-mesme dhe afat-gjatë. Pagesa totale e detyrimeve të prapambetura ndaj sektorit privat në fund të vitit 2015, e cila filloi të paguhet në vitin 2014, ka përmirësuar situatën financiare të bizneseve duke përmirësuar kapacitetet e tyre investuese. Për 2016, jane adoptuar masa stimuluese për sektorët gjeneruese të punësimit, si 'Bujqësia' dhe 'NVM'. Në veçanti, qeveria ka përjashtuar nga detyrimet doganore disa inpute bujqësore dhe ka rritur subvencionet ndaj sektorit të tekstileve. Për më tepër, punësimi në administratën publike (psh: policët, mësuesit) do të rriten si nevojë për të përballuar kërkesën e këtij sektori. Po ashtu, Plani Buxhetor Afat-mesëm i rishikuar për vitin 2016-2018 i cili u përfundua nga MF-ve në fund të gjysmës së parë të vitit 2016, ka planifikuar një rritje të pagave të nëpunësve civil që prej vitit 2017, e cila mund të çoje në një rritje të efektivitetit të punës dhe motivimit të stafit.

Reformat në Financat Publike janë esenciale në rritjen e efiçiencës së shpenzimeve publike, po ashtu edhe të krijimit të hapësirave për shpenzime në periudhën afat-mesme dhe afat-gjatë në vijim. Angazhimet disa-vjeçare për projektet e investimeve dhe marrëveshjet e tjera afatgjata kontraktuale janë futur në programin buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe priten të miratohen nga Kuvendi. Disa masa legjislative janë parashikuar për të siguruar një kuadër të qëndrueshëm fiskal. Pjesë e strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) jane gjithashtu reformat në forcimin e administratave tatimore dhe doganore, në mënyrë për të rritur efikasitetin e saj për mbledhjen e të ardhurave dhe në luftën kundër evazionit dhe informalitetit, një fushatë që qeveria filloi në tremujorin e fundit të vitit 2015 dhe të cilën e ka rifilluar në gusht të këtij viti. Gjendja e tanishme e reformave të MFP është shpjeguar në seksionin 3.8 të strategjisë.
Në të njëjtën kohë, reformat në sistemin e pensioneve dhe sektorin e energjisë janë të domosdoshme për të siguruar përmirësimin e qëndrueshëm të financave publik.. Barra aktuale dhe kontingjenti i sistemit të pensioneve dhe sektorin e energjisë në financat publike, dhe si pasojë në të gjithë ekonominë, është i madh dhe duhet të trajtohen. Reforma e energjisë tashmë ka filluar të japë rezultate të kënaqshme, pasi pronësia e kompanisë se shpërndarjes se energjisë elektrike (OSHEE) i është kthyer qeverisë. Prandaj, MF synon të kufizojë garancitë publike dhe huadhëniet neto në

3.3 miliardë lekë në vitin 2016, rreth 3 miliardë lekë në vitin 2017 dhe rreth 3.5 miliardë lekë për periudhën 2018-2019[7] me qëllim reduktimin e subvencioneve në drejtim të sektorit të energjisë elektrike për periudhën pas vitit 2020.
Gjatë tetë viteve të fundit, qeveria shqiptare ka dorëzuar pranë Komisionit Evropian, Program Ekonomik dhe Fiskal afat-mesëm. Vitin e kaluar në qershor 2015, vendi mori statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, i cili shoqërohet mekërkesa te reja për raportim të bazuar në standardet e BE. Në këtë kontekst, Shqipëria ka për detyrë çdo vit të paraqesë pranë Komisionit Europian Programin e Reformes Ekonomike (ERP). Shqipëria paraqiti zyrtarisht ERP 2016-2018 te miratuar nga Këshilli i Ministrave më 27 janar 2016.

ERP për periudhën 2016-2018 paraqet prioritetet kryesore, politikat dhe reformat e qeverisë shqiptare dhe të Bankës së Shqipërisë për aspektet ekonomike. Dokumenti është e bazuar në përputhje me Ligjin nr. 147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016" dhe në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2017-2020[8].

Ministria e Financave (MF) vlerëson të gjitha rekomandimet e vlefshme dhe vlerësimin mbi ERP 2016-2018 që do të ofrohen nga Komisionit Evropian DG ECFIN. Prej shtatorit 2016, Ministria e Financave është duke planifikuar për të filluar punën për përgatitjen e ERP së ardhshme për periudhën 2017-2019. MF do të bëjë të gjitha përpjekjet për të zbatuar rekomandimet e DG ECFIN ndërsa udhëzimet dhe politikat e Komisionit Evropian do të jenë udhëzues kryesor i politikave dhe reformave ekonomike të programit të ardhshëm.

Gjatë këtyre 8 muajve të ardhurat totale u rritën me 7.2% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015. Të ardhurat tatimore dhe doganore gjatë 8 muajve të vitit 2016 u rritën me 9.7% në terma vjetorë, krahasuar me vitin e kaluar. Kjo shifër pozitive tregon një përmirësim të qëndrueshëm në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur rritja e regjistruar për të hyrat e përgjithshme ishte 5.1% dhe rritja e regjistruar për të ardhurat nga administrata tatimore dhe doganore ishte 4.1% (në terma vjetorë). Kjo tregon se reformat e ndërmarra në drejtim të administratës Tatimore dhe Doganore kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në mbledhjen e taksave duke nënkuptuar hyrjen drejt një prirjeje pozitive. Kjo rritje është edhe për shkak të masave të reja tatimore të zbatuara që nga janari i vitit 2015, te cilat përmbajne:

(i) Rritja e tarifës së energjisë për familjet; dhe
(ii) Rritja e tatimit të hidrokarbureve (për naftë, benzinë);

[7] Sipas Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2017 - 2020 (Rishikuar) Nëntor 2016 / MF;

[8] Aprovuar nga Këshilli i Ministrave më datë 03.02.2016, Nr. 80 dhe Sipas Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2017 - 2020 (Rishikuar) Nëntor 2016 / MF;

Trendi pozitiv në mbledhjen e taksave gjatë vitit 2016 (e cila kishte një pikë kthese pozitive që prej T4/2013) ka ndihmuar në mënyrë vendimtare financat publike, si dhe stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik të vendit, duke marrë parasysh gjithashtu se qeveria kishte për të paguar një sasi të madhe të borxheve per punët publike gjatë dy viteve rresht 2014-2015. Për më tepër, gjatë 8 muajve të 2016 në buxhetin e shtetit kanë hyrë edhe të ardhurave nga lloje të tjera taksash(p.sh. të ardhurat nga pushteti vendor me një rritje prej 19.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe të ardhurat nga fondet speciale me një rritje vjetore prej 12.6%) duke treguar një performancë pozitive prej dy vitesh rresht tashmë.

Një kthesë e konsiderueshme është regjistruar për të ardhurat jo-tatimore, te cilat gjatë 8 muajve të vitit 2016 u zvogëluan me 18.4% në terma vjetorë, krahasuar me 8 muajt e 2015). Totali i të ardhurave dhe të ardhurat nga tatimet dhe doganat në terma të PBB-së gjatë këtyre 8 muajve të vitit 2016 ishin përkatësisht 17.7% dhe 12.1%, duke treguar një performancë të qëndrueshme dhe të kryer pothuajse në të njëjtin nivel të vitit 2015, (përkatësisht 0.3 dhe 0.4 pikë përqindje më i ulët).

Bilanci fiskal i përgjithshëm gjatë këtyre 8 muaj të vitit 2016 rezultoi me një tepricë të konsiderueshme prej 1.8 miliardë lekë më shumë krahasuar me objektivin e planifikuar për 8 muajt e vitit 2016. Balanca fiskale për këto 8 muaj të vitit 2016 ishte rreth 1% të PBB-së ose 3% më e lartë se sa ishte planifikuar për gjithë vitin. Kjo është kryesisht për shkak të rritjes së të ardhurave (7.2% në krahasim me 8 muaj të 2015 në terma vjetorë), si dhe nga shpenzimet kapitale të huaja më të ulëta të planifikuara (-5.7% se sa në vitin 2015). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitin e kaluar, bilanci fiskal tregon një përmirësim relativisht të lartë prej 0.9 pikë përqindjeje (krahasuar me 8 muaj të 2015), si rezultat i angazhimit të qeverisë drejt një konsolidimi fiskal të nevojshëm, si dhe efektet e programit të FMN-së.

Teprica fiskale për këto 8 muaj të vitit 2016 shkoi për uljen e huamarrjes së brendshme për shkak të maturimit të saj dhe uljes se borxhit ekzistues. Rreth 28.4 miliardë lekë janë shpenzuar për huamarrje të tjera të brendshme dhe 14 miliardë lekë janë shpenzuar për pagesat e borxhit ekzistues.

Zhvillimet në të hyrat dhe shpenzimet gjatë këtyre 8 muaj të vitit 2016 çoi në një tjetër rezultat të rëndësishëm pozitiv fiskal në lidhje me bilancin aktual fiskal. Bilanci i tanishëm fiskal për këtë periudhë ka qenë në tepricë prej rreth 0.7% të PBB-së ose 1.2[9] pikë përqindjeje më e lartë se ajo ishte e gjatë 8 muajve të 2015.

[9] Sipas Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2017 - 2020 (Rishikuar) Nëntor 2016 / MF;

Bilanci primar ishte prej rreth 2.5% të PBB-së gjatë 8 muajve të vitit 2016, tregon për një ekuilibër në suficit. Bilanci primar ishte 2.3 pikë përqindjeje më e lartë në vlerë absolute në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (2015 e cila ishte +0.2% e PBB-së).
Borxhi publik gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 (duke përjashtuar stokun e borxheve) vlerësohet të jetë 69.84% të PBB-së. Krahasuar me nivelin e borxhit gjatë gjysmës së parë të vitit të kaluar ka pasur një rritje prej 1.73 pikë përqindje[10].
Në vitin 2016, Ministria e Financave synon një deficit fiskal prej 20[11]% të PBB-së. Ky deficit fiskal do të financohet me anë të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm, përkatësisht 0.7% dhe 1.3% të PBB-së. Lidhur me harmonizimin me Sistemin Evropian Llogaritë 95, INSTAT po zbaton sistemin e llogarive evropiane në përputhje me kërkesat e koncepteve dhe metodologjisë ndërkombëtare për hartimin e llogarive kombëtare vjetore dhe tremujore duke ndjekur Programin e Statistikave Zyrtare 2012-2016. Në këtë kuadër, vlerësimeve e fundit të rishikuara që u publikuan, janë rezultat i përpjekjeve të INSTAT-it për të zbatuar metodologjinë ndërkombëtare të paraqitur nga SNA 2008 dhe ESA 2010.

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA MONETARE
2. POLITIKA EKONOMIKE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimet kryesore të Shqipërisë në kuadër të përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Bashkimit Evropian rrjedhin nga Neni 70 i MSA-së.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Aktualisht, ligji për Bankën e Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me *acquis*-në e Bashkimit Evropian. Megjithëse një pjese e mire e dispozitave te tij janë të përafruara, serish nevojiten ndërhyrje legjislative me qëllim përputhjen me parimet e përgjithshme të *acquis* së

[10] Referenca: Raporti i Borxhit – 3mujor (Drejtoria e Borxhit – Ministria e Financave);

[11] Sipas Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2017 - 2020 (Rishikuar) Nëntor 2016 / MF;

Bashkimit Evropian dhe zbatimin e rekomandimeve te Komisionit Evropian në lidhje me forcimin e pavarësisë së Bankës se Shqipërisë. Në këtë kuadër, nder te tjera, Banka e Shqipërisë do të synojë rishikimin e dispozitave të ligjit aktual në lidhje me kufizimin e huadhënies për qeverinë. Në periudhë afatmesme, në varësi të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë, Banka e Shqipërisë do të vlerësojë kalimin drejt një regjimi që ndalon huatë për qeverinë. Ndryshimet ligjore do te duhet të parashikojnë vetëm zbatimin e dispozitave të ligjit aktual të Bankës së Shqipërisë në lidhje me kreditimin vetëm për periudhën transitore, duke specifikuar se kjo kredi nuk do të jetë më shumë se 5 për qind e të ardhurave vjetore të zakonshme të qeverisë si dhe detyrimin për të mos pasur asnjë tepricë huaje në fund të vitit financiar.

Kuadri i politikës monetare parashikohet në Dokumentin e Politikës Monetare, i rishikuar për herë të fundit në muajin janar 2015. Dokumenti shpjegon regjimin e inflacionit të shënjestruar që ndjek Banka e Shqipërisë, përshkruan kuadrin teorik i cili drejton hartimin e politikës monetare dhe instrumentet për zbatimin e saj. Vendimet e politikës monetare bazohen në devijimet e inflacionit të parashikuar nga objektivi i inflacionit dhe vlerësimi i presioneve inflacioniste për periudhën në vijim. Regjimi i shenjëstrimit të inflacionit është komplementar me një regjim të lirë të kursit të këmbimit.

Vitin e kaluar Shqipëria mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, i cili implikon kërkesa të reja për raportim, bazuar në standardet evropiane. Në këtë kontekst, Shqipërisë i kërkon 1 herë në vit të dorëzojë pranë Komisionit Evropian Programin Kombëtar të Reformave Ekonomike (PKRE) – ne anglisht ERP.

ERP për periudhën 2016-2018 paraqet prioritetet kryesore, politikat dhe reformat e qeverisë shqiptare dhe të Bankës së Shqipërisë për aspektet ekonomike. Ajo është e bazuar në përputhje me Ligjin nr. 147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016" dhe në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2017-2019 dhe 2017 - 2020 Rishikuar) nëntor 2016 / MF.

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal parashikon:

i. *PBB*. Rritja reale ekonomike parashikohet qe te përshpejtohet gradualisht nga 3.4% ne 2016 ne rreth 4.2% ne vitin 2019.
ii. *Norma e papunësisë*. Objektivi kryesor është që norma e papunësisë të shkojë në nivelet e periudhës para krizës financiare, duke parashikuar për 2016 një normë papunësie prej 16.2%, që arrin një nivel prej 12.5% në vitin 2019[12].

[12] Sipas Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2017 - 2020 (Rishikuar) Nëntor 2016 / MF;

iii. *Deficiti fiskal*. Objektivi i qeverisë është të ulet deficiti me 2-3 pikë përqindje. Parashikimi për vitin 2016 është 2% e Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërkohë që skenari optimal është të arrihet një deficit prej -1.0% në vitin 2019. Të ardhurat totale parashikohen të arrijnë një nivel mesatar prej 27.3% të PBB-së për periudhën afatmesme 2017 – 2019, me një parashikim prej 27.2% të PBB-së për vitin 2016, ndërkohë që të shpenzimet totale parashikohen të arrijnë një nivel prej 28.9% të PBB-së për periudhën afatmesme 2017 – 2019, me një parashikim prej 29.2% të PBB-së për vitin 2016.

iv. *Borxhi publik*. Ky objektiv mbetet i rëndësishëm dhe njëkohësisht sensitive për opinionin publik. Qeveria me angazhimin e saj për të shlyer detyrimet e prapambertura, ka shprehur objektivin e saj për të ulur sa më shpejt është e mundur borxhin publik nën nivelin 60% të PBB-së. Kështu për vitin 2016 parashikohet një nivel prej 71.4%, duke arritur një nivel prej 63% në vitin 2019[13].

II.3 Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional përbëhet nga institucionet e mëposhtme:
Grupi ndërinstitucional për Kapitullin 17 - Politikat Ekonomike dhe Monetare përbëhet nga përfaqësues të dy institucioneve shqiptare: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave. Institucion koordinues për këtë kapitull është Banka e Shqipërisë.

Politika monetare në Republikën e Shqipërisë është një detyrë dhe e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë. Kjo Politikë hartohet me qëllim përmbushjen e objektivit kryesor "të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve".

Bashkërendimi i punës për hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikës monetare në Bankën e Shqipërisë kryhet nëpërmjet strukturave të mëposhtme:

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e udhëzimeve për zbatimin e politikës monetare të Republikës së Shqipërisë. Ai përcakton normën bazë të interesit të operacioneve të Bankës së Shqipërisë në treg të hapur, përqindjen e interesave për depozitat në Bankën e Shqipërisë dhe për skontimet dhe kreditë e Bankës së Shqipërisë, si dhe nivelin e rezervave të detyruara, që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë";
- Departamenti i Politikës Monetare, i cili përbëhet nga 25 punonjës, mbështet Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e efektivitetit të politikës monetare në funksion të përmbushjes së objektivit kryesor ligjor të Bankës;

[13] Sipas Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2017 - 2020 (Rishikuar) Nëntor 2016 / MF;

- Departamenti i Operacioneve Monetare, i cili përbëhet nga 31 punonjës, zbaton politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, administron rezervën valutore, llogarinë qendrore të Ministrisë së Financave dhe të tregut primar e të regjistrit të letrave me vlerë, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;

- Departamenti i Kërkimeve, i cili përbëhet nga 25 punonjës, kontribuon me punën e tij kërkimore në zgjerimin e njohurive për fenomenet ekonomike dhe ndihmon në marrjen e vendimeve sa më të shëndosha në lidhje me politikën monetare dhe mbikëqyrjen bankare;

- Komiteti i Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare, si organ ndër-departamental në Bankën e Shqipërisë merr vendime në lidhje me ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, si dhe mund të marrë rolin e këshilltarit për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në lidhje me qëndrimin e politikës monetare për normën bazë të interesit.

Ministria e Financës është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës fiskale në Shqipëri.

Konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale (DPPMÇF) në Ministrinë e Financave, është struktura përgjegjëse për zbatimin e politikës fiskale për arritjen e stabilitetit makroekonomik. Është përgjegjëse për analizën dhe parashikimet makroekonomike dhe fiskale në përputhje me programet e zhvillimit ekonomik te vendit.

DPPFCF -ja ka në përbërjen e saj dy drejtori dhe dy sektorë:

- Drejtorinë e Makroekonomisë dhe Statistikave, e cila është përgjegjëse për analizimin në vijimësi të zhvillimeve ekonomike në rrafshin makroekonomik, parashikimin afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afatgjatë të ecurisë së ekonomisë dhe parashikimin e burimeve financiare të buxheteve afatshkurtër, afatmesëm e afatgjatë, si dhe rekomandon objektivat kryesorë afatshkurtër dhe afatmesëm të politikës fiskale duke synuar një kurs optimal të politikës fiskale në harmonizim të plotë me zhvillimet dhe perspektivën makroekonomike të vendit. Dokumenti kryesor me anë të të cilit materializohen dhe formatizohen përgjegjësitë e mësipërme të kësaj drejtorie është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 29.01.2014 mbi Kuadrin Makroekonomik e Fiskal afatmesëm dhe atë afatgjatë, dhe rishikimet periodike të tij. Drejtoria e Makroekonomike ka në përbërjen e saj 7 punonjës.
- Drejtoria e Politikave Fiskale e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave tatimore dhe kuadrit ligjor tatimor në vend, zhvillimin e një modeli të plotë fiskal. Ajo ka në përbërjen e saj 6 punonjës.
- Sektori i Hartimit të Politikave Fiskale, i cili është përgjegjës për Hartimit të Politikave Fiskale. Ai përbëhet nga 3 punonjës
- Sektori i Hartimit të Akteve Nënligjore dhe Proçedurave, i cili është përgjegjës për Hartimit të Akteve Nënligjore dhe Proçedurave. Ai përbëhet nga 3 punonjës.

II.4 Përcaktim i alokimeve financiare

	2017	2018	2019
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	-	-	
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	-	-	
Buxheti total i Kapitullit			

III. Prioritetet

Strategjia afatmesme BSH: Me qëllim përforcimin e pavarësisë financiare, institucionale, funksionale dhe personale të Bankës së Shqipërisë dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian, objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë është hartimi i një ligji të ri organik. Ky ligj do të jetë në përputhje me standardet e Traktatit të Bashkimit Evropian dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Sipas Strategjisë Afatmesme te BSH, objektivat e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2016-2018 do të jenë:

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, në përputhje me objektivin për inflacionin dhe forcimi i besimit të publikut në stabilitetin e çmimeve dhe në monedhën kombëtare. Përmbushja e objektivit të stabilitetit të çmimeve ndihmon në stabilizimin e luhatjeve ekonomike, krijon një ambient të favorshëm për nxitjen e rritjes ekonomike, ndihmon funksionimin normal të tregjeve dhe të institucioneve financiare, si dhe nxit rritjen e mirëqenies e të barazisë sociale në ekonomi. Nga ana tjetër, forcimi i besimit të publikut në aftësinë e Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e këtij objektivi, rrit besimin e tij në monedhën kombëtare dhe në institucionet publike të shtetit shqiptar.
- Përmirësimi i aftësive analizuese dhe parashikuese, si dhe rritja e eficiencës së instrumenteve të politikës monetare dhe rrugëve të komunikimit të saj. Përmbushja e këtij objektivi ndikon direkt në aftësinë e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, edhe në prani të goditjeve të mëdha e të paparashikuara. Gjithashtu, ky objektiv është në linjë me objektivin dhe filozofinë e përgjithshme të institucionit: adoptimin dhe ruajtjen e standardeve më të mira profesionale.
- Ruajtjen dhe forcimin e kontributit në çështjet e integrimit evropian. Ndër të tjera, ky objektiv do të arrihet nëpërmjet forcimit të kontributit publik në diskutimet me rëndësi për vendin, si dhe nëpërmjet forcimit të kontakteve me institucionet homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian në Raport 2016 për Shqipërinë, prioritetet në fushën e politikës ekonomike dhe monetare renditen si me poshtë:

- në fushën e politikës monetare, Ligji për Bankën e Shqipërisë duhet të përafrohet me *acquis* sa i përket pavarësisë personale të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe llogaridhënies së Bankës;
- në fushën e politikës ekonomike është i nevojshëm harmonizimi i mëtejshëm me Direktivën mbi Kërkesat për Kuadrin Buxhetor, si dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përafruar statistikat fiskale me kërkesat e ESA-së.

Programi Kombëtar i Reformave ekonomike 2016 – 2018 është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, miratuar me Vendimin e KM nr. 348, 11.5.2016. Ky dokument është përgatitur nga një grup ndërinstitucional, i koordinuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Duhet të arrihet përputhshmëria e plotë me standardet e Sistemit Evropian të Llogarive (ESA) 95, përkatësisht ESA 2010. Nevojiten masa të tjera për përmirësimin e analizës për qëndrueshmërinë e jashtme dhe rritjen e kapaciteteve për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e politikes ekonomike; si dhe në drejtim të përafrimit me Direktivën 2011/85 e datës 8 nëntor 2011 mbi kriteret për kuadrin buxhetor të Shteteve Anëtare.

IV. Plan i Veprimeve për periudhën 2017 – 2020

IV.1 Politika monetare

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia Afatmesme e Bankës së Shqipërisë për periudhën 2016-2018	Banka e Shqipërisë	2016-2018
[14]Dokumenti i Politikës Monetare	Banka e Shqipërisë	E papërcaktuar, pa afat

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit**	**Data e përshtatjes**	**Hyrja në fuqi**

[14] Dokumenti i Politikës Monetare u miratua me vendimin nr. 4, datë 28.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

			(i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	(Legjislacioni Shqiptar)	(Legjislacioni Shqiptar)
Versionet e konsoliduara të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (2012/C326/01)	Ligji Nr. 8269, date 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"	Banka e Shqipërisë	I Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998
Protokolli (nr. 4) mbi statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian	Ligji nr. 8269, date 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"	Banka e Shqipërisë	I Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

AFAT MESËM (2018 – 2019)							
Protokolli (nr. 4) mbi statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian	Jo	Ndryshime në Ligjin nr. 8269, date 23.12.1997 Për Bankën e Shqipërisë	Jo	Banka e Shqipërisë	I Pjesshëm	T2 2018	T3 2018

IV.2 Politika ekonomike

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Programi i Reformave Ekonomike 2016-2018	Ministria e Financës	2016-2018
Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal –2017-2019	Ministria e Financës	2017-2019

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
	Ligij nr. 147/2015 Për	Ministria e Financave	Mosperputhje	17.12.2015	1.1.2016

	buxhetin e vitit 2016				
	Udhezim nr.7, date 28.02.2014 "Per pergatitjen e buxhetit 2015-2017"	Ministria e Financave	Mosperputhje	Shkurt 2014	Shkurt 2014

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e përshtatjes**	**Hyrja në fuqi**
Programi Kombëtar i Reformave Ekonomike –2017-2019	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	2017-2019	T1 2017	T1 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU *acquis*	**Status i përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)**	**Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje e pjesshme)**	**Data e planifikuar për përshtatjen**	**Hyrja në fuqi**
AFAT-SHKURTËR (2017)							
n/a							
AFAT MESËM (2018 – 2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e planifikuar e fondeve të Buxhetit të Shtetit

Kapitulli 17 "Politika ekonomike dhe monetare"					
Përfituesi:					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali (3+4+5)**

	shtetit				
Ndryshimi i Ligjin nr. 8269, date 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar[15]	A) Paga –stafi ekzistues		**2,520,471**		**2,520,471**
	B) Paga –stafi i ri		**0**		
	C) Trajnimi	**0**	**0**		**0**
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme		**0**		
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	**0**	**0**		**0**
	Aktiviteti total		**2,520,471**		**2,520,471**
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	Buxheti total i përfituesit				
	2	**3**	**4**	**5**	**6**
	Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafi ekzistues				

[15] Ky aktivitet nuk do të financohet nga buxheti i shtetit por nga buxheti i Bankës së Shqipërisë.

	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	Totali i Kapitullit				
Përfituesi :					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				

	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				

	Aktiviteti total				
TOTALI					

Tabela B – Fondet e planifikuar nga asistenca e huaj

Kapitulli:				
1	2	3	5	5
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
		Totali për Kapitullin:		

KAPITULLI 18: STATISTIKAT

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull paraqet *acquis*-të në fushën e statistikave që do të zbatohen nga çdo aktor i përfshirë në Sistemin Kombëtar të Statistikave në Shqipëri me qëllim përmirësimin e infrastrukturës statistikore të bazuar në parime si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, fshehtësinë e të dhënave individuale dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Këto parime janë të përmendura në nenet 4 dhe 4/ 1 të ligjit për statistikat zyrtare dhe janë të detyrueshme të respektohen nga INSTAT dhe të gjitha agjencitë statistikore të cilat zbatojnë aktivitete statistikore sipas Programit statistikor shumëvjeçar.

Zbatimi i *acquis* në statistika siguron INSTAT për të vepruar si pika reference dhe si spirancë për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor.

Acquis-të mbulojnë metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme siç janë statistikat demografike dhe sociale, statistikat e mjedisit, biznesit, statistikat makroekonomike, monetare dhe financiare, statistikat e tregtisë dhe bilancit të pagesave, statistikat rajonale, tregtia e jashtme, bujqësia, si dhe statistikat e teknologjisë dhe shkencave.

INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore në Shqipëri, veprojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9180, datë 5.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar, si dhe me Programin 5-vjeçar për statistikat zyrtare i cili miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Programi 5 vjeçar për Statistikat Zyrtare hartohet në përputhje me Compendiumin e Eurostat, dhe me programin shumëvjeçar të Eurostatit. Ai siguron zbatimin e metodologjisë dhe standardeve të përmendura në rregulloret e BE-së në fushën e statistikave.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka bërë progres në fushën e zhvillimit të statistikave. Në fushën e infrastrukturës statistikore, struktura e INSTAT-it përbëhet nga 8 drejtori në Zyrën qendrore dhe 11 zyra rajonale. Stafi i përgjithshëm INSTAT-it është 216 specialistë. Struktura e re organizative siguron një

menaxhim më të mirë të institucionit si dhe forcon rolin performues të tij si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor. Ligji për Statistikat është ndryshuar në shkurt 2013, duke specifikuar rolin e INSTAT-it si koordinator të Sistemit Kombëtar Statistikor.
Në zbatim të rekomandimeve të dala nga progres-raporti i fundit i BE-së, sa i përket Kapitullit 18 "Statistikat", duhet te rishikohet kuadri ligjor ekzistues për të garantuar pavarësinë profesionale të INSTAT dhe rritjen e shkallës së hierarkisë institucionale brenda sistemit të administratës publike.

Sistemi Kombëtar i Statistikës përbëhet nga INSTAT, si institucioni kryesor, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, si agjencitë kryesore statistikore të ngarkuar me ligj për të prodhuar statistika zyrtare.

I.3 Struktura e kapitullit

1. STATISTIKAT DEMOGRAFIKE-SOCIALE
2. STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE
3. STATISTIKAT PËR BIZNESIN
4. STATISTIKAT E BUJQËSISË, PYJEVE DHE PESHKIMIT
5. STATISTIKAT MONETARE, FINANCIARE, TREGTISË DHE BILANCIT TË PAGESAVE

II. Situata aktuale

Prej vitit 2014, INSTAT ka filluar implementimin e metodologjive të Sistemit Evropian të Llogarive, ESA 2010 dhe atij ndërkombëtar SNA 2008, duke dërguar një tërësi tabelash me treguesit e kërkuar në Programin e Transmetimit të të dhënave. Njëkohësisht INSTAT ka punuar për përmirësimin e statistikave të Llogarive Kombëtare duke shfrytëzuar sa më mirë burimet e ndryshme statistikore dhe administrative, si dhe duke aplikuar praktikat më të mira ndërkombëtare të pranuara në zbatimin e teknikave statistikore. Si rezultat i ndryshimeve metodologjike dhe jo vetëm, INSTAT ka kryer revizionimin e vlerësimeve të të dhënave të Produktit të Brendshëm Bruto dhe ka zhvilluar tregues të rinj të statistikave të llogarive kombëtare.

Në këtë kuadër, INSTAT, për herë të parë ka kryer publikimin e komponentëve të taksave dhe subvencioneve mbi produktet duke kaluar nga Vlera e Shtuar Bruto në PBB tremujore me metodën e prodhimit, si dhe të komponentëve kryesorë të PBB-së tremujore me metodën e shpenzimeve. INSTAT ka përpiluar Tabelat e Burime-Përdorimeve (TBP) dhe Tabelën Input-Output (TIO), të cilat u publikuan për herë të parë në Shkurt 2015. Ndërkohë një moment tjetër i rëndësishëm në fushën e statistikave makroekonomike ka qenë hartimi dhe raportimi i të dhënave të Procedurës së Defiçitit të Tejkaluar (PDT) për Shqipërinë, transmetimi i të cilave u bë për herë të parë gjatë vitit 2014. Gjithashtu Llogaritë Kombëtare kanë punuar për të hartuar në mënyrë eksperimentale vlerësimet e llogarive vjetore të sektorëve institucionale.

INSTAT vazhdon të publikojë të dhënat për Llogaritë Kombëtare Rajonale, (publikuar për herë të parë në shtator të vitit 2011), në bazë të Rregullores (EC) Nr. 1059/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 majit të vitit 2003, në bazë të klasifikimit të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS).

INSTAT, për aktivitetin statistikor mbi Indeksin e Çmimeve të Konsumit, ka rishikuar shportën e mallrave dhe peshat me të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjeve, 2014 kombinuar me të dhënat e Llogarive Kombëtare. Nga muaji Janar 2016, indeksi llogaritet duke konsideruar muajin Dhjetor 2015 si periudhë bazë. Në Shkurt 2017, INSTAT do të publikojë Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit.

INSTAT, në lidhje me statistikat vjetore të ndërmarrjeve, kryen aktivitetin mbi Statistikat Strukturore të ndërmarrjeve, nëpërmjet të cilit mbledh, përpunon dhe publikon statistikat vjetore strukturore të ndërmarrjeve ekonomike jo bujqësore me vrojtim vjetor me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri për të gjitha format legale. Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor të ndërmarrjeve, ishin aktive në dhjetor të vitit të referencës. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, prej vitit 2014, me seri kohore 2010-2014.

INSTAT kryen vrojtim tremujor pranë ndërmarrjeve ekonomike aktive prej vitit 2003. Popullata referuese është përcaktuar nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, për të gjitha format legale, ndërsa aktivitetet janë klasifikuar sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike (NVE Rev.2) prej vitit 2014, me seri kohore 2005-2016/T2; INSTAT llogarit Indeksin e Çmimeve të Prodhimit dhe Eksportit. Prej tremujorit të parë 2016 INSTAT ka publikuar për herë të parë Indeksin e Çmimeve të Importit, duke rritur nivelin e përputhshmërisë me Rregulloren e KE Nr. 1165/98 e ndryshuar me Rregulloren e KE, Nr. 1158/2005, mbi “Statistikat afatshkurtra”.

INSTAT prej vitit 2015 ka filluar prodhimin dhe publikimin e statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet, sipas karakteristikave të ndërmarrjeve si dhe statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet, sipas mënyrave të transportit.

INSTAT në vitin 2015 (vit reference 2014) ka realizuar vrojtimin e veçantë mbi Informacionin dhe Teknologjinë e Komunikimit (TIK) në ndërmarrje. Rezultatet e tij u publikuan në Korrik 2016. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Metodologjia e ndjekur është në përputhje me standartet evropiane.

INSTAT mirëmban Rregjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, Rregjistrin e Njësive Lokale duke përdorur si burime administrative, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit, ndërsa si burime statistikore, të gjitha vrojtimet pranë ndërmarrjeve. Ndarja e re administrativo-territoriale është zbatuar në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve për vitet 2010-2015.

Të dhënat mbi punësimin dhe papunësinë publikohen çdo tre muaj në përputhje me standardet e ILO-s dhe të BE-së, në bazë të Anketës tremujore të Forcave të Punës. Anketa e Kostove të Punës është kryer për herë të parë në vitin 2013 duke dhënë informacion në lidhje me kostot mesatare mujore të punës dhe kostot mesatare për orë të punës. Në 2010-2011 u krye në shkallë kombëtare Anketa e Përdorimit të Kohës për të matur sasinë e kohës që shpenzon popullsia shqiptare për aktivitete të ndryshme.

Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) është përdorur për të matur shpenzimet e konsumit të familjeve shqiptare dhe gjithashtu për të rinovuar Indeksin e Çmimeve të Konsumit dhe për të vlerësuar Konsumin Final të Familjeve si pjesë e PBB-së (me metodën e e shpenzimeve). Nga janari 2014, ABF kryhet me baza vjetore.

Një pilot i EU-SILC u krye në vitin 2014 me asistencën teknike të IPA Shumë përfitues 2012, për monitorimin e të ardhurave dhe kushteve të jetesës në vend. Ndërkohë ne vitin 2016 me mbështjetje të projektit IPA Shumë përfitues 2014 u krye faza e plotë e EU SILC e cila do vazhdojë të kryhet çdo vit sipas rekomandimeve të Eurostat.

INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë mbështjeten e Eurostat dhe suportin e projektit Kombëtar IPA 2013 Kombëtare ka planifikuar të realizojë ushtrimin kalibrues për Censusin e Bujqësisë. Nëpërmjet këtij ushtrimi do të bëhet e mundur kalibrimi i rezultateve të Censusit të Bujqësisë 2012 dhe publikimi i tyre. Gjithashtu, kjo do mundësojë dhe përditësimin e regjistrit statistikor të fermave. Rezultatet pritet të publikohen në fundin e vitit 2017.

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar për statistikat zyrtare me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 70 dhe 88 të MSA-së.

INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore veprojnë në përputhje me rregulloren kryesore të BE-së që siguron zbatimin e parimeve dhe standardeve statistikore, uniformitetin në metodologjinë që do të përdoret për secilin tregues, raportin e cilësisë dhe konfidencialitetin statistikor.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi Shqipëria ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja në këtë fushë.

- Ligji shqiptar mbi statistikat zyrtare nr. 9180 datë 05.02.2004, amenduar me Ligjin nr. 2/2012, datë 03.01.2012 dhe Ligjin nr. 7/2013, datë 14.02.2013, përafrohet pjesërisht me aktin e mëposhtëm të *acquis*-së:
  Rregullore (KE) Nr. 223/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 mars 2009 për statistikat evropiane që shfuqizon Rregulloren (EC, Euratom) Nr. 1101/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për transmetimin e të dhënave i nënshtrohet konfidencialitetit statistikor në Zyrën statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 322/97 mbi Statistikat e Komunitetit, si dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euratom për krijimin e një Komisioni për programet statistikore të Komuniteteve Evropiane, (neni 7, Komitetin ESS).
- Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", i mbështetur me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 05.10.2011 "Për publikimin e të dhënave të borxhit të qeverisë së përgjithshme dhe hartimit të raportit të tij" dhe Ligjin "Për ligjin vjetor buxhetor", në lidhje me të ardhurat e planifikuara, deficiti, shpenzimet dhe financimi i tij dhe të borxhit për çdo vit, janë përafruar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 479/2009 e datës 25 maj 2009 për zbatimin e Protokollit për procedurën e deficitit të tepruar, bashkëlidhur Traktatit themelues të Komunitetit Evropian.

II.3 Institucionet përgjegjëse

1. Instituti i Statistikave (INSTAT)
2. Ministria e Financave
3. Banka e Shqipërisë
4. Ministria e Mjedisit
5. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

6. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

II.4 Tregues i alokimeve financiare

Instituti i Statistikave ka alokuar fondet e mëposhtme në lek;

Viti	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**
Buxheti total per kete kapitull I Institucionit lider	449,000	442,000	442,000	
Buxheti total per kete kapitull I institucioneve te tjera (Banka e Shqipërisë)		2,520,471		7,721,000
Buxheti total I Kapitullit	449,000	2,962,000	442.000	7,721,000

III. Prioritetet

Qëllimi kryesor i INSTAT është të vazhdojë përafrimin me *acquis* e BE- së, lidhur me standardet statistikore evropiane, si dhe për të rritur rolin e saj si koordinatore e Sistemit Kombëtar të Statistikave.

Duke u bazuar në rekomandimet e BE-së, të përmendura në raportet periodike të progresit, prioritetet e identifikuara janë si më poshtë;

- Rritja e pavarësisë profesionale të INSTAT-it dhe agjencive statistikore;
- Riformatimi i përbërjes së Këshillit të Statistikave;
- Përmirësimi i aksesit në mikro të dhënat dhe bazën e të dhënave dhe zhvillimin e një inventar të proceseve sistematike dhe të dhënave.
- Përmirësimi i disa fushave të statistikave sektoriale për të siguruar që të dhënat statistikore të jenë të disponueshme për publikun e gjerë.
- Zbatimi i programit statistikor shumëvjeçar të punës 2017-2021, duke vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme financiare.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore dhe ministrive për të lehtësuar prodhimin efikas të statistikave të besueshme.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2020

IV.1 Statistikat demografike-sociale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2012-2016	INSTAT	2012 - 2016

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Paketa Ligjore e BE -së (EU *acquis*)	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja 0577/1998/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 2257/2003/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 0377/2008/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 1897/2000/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 1022/2009/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 1737/2005/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004

	Statistikat Zyrtare”				
Rregullorja 1726/1999/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 530/1999 /EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 862/2007/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 763/2008/EU	Ligji nr. 10 442, datë 7.7.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave” (Amenduar)	INSTAT	Pjesërisht	26.10.2000	27.03.2004
Rregullorja 1201/2009/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 519/2010/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 1151/2010/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004

Rregullorja 216/2010/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Direktivë 2009/50/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 1738/2005/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Edukimi					
Rregullorja 452/2008 EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 253/2013/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Shëndeti Publik					
Rregullorja 1338/2008/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli politikave)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017 - 2021	INSTAT	2017-2021	T 4 2016	T 1 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017– 2020

Paketa Ligjore e	Statusi i	Legjislacioni	Statusi i	Institucioni	Niveli i synuar i	Data e	Hyrja në fuqi

BE -së (EU *acquis*)	përkthimit në Shqip (po/jo)	Shqiptar (ligjet dhe nënligjet)	përkthimit në Anglisht (po/jo)	përgjegjës dhe pika e kontaktit	përafrimit (Plotë/Pjesërisht)	planifikuar e adoptimit	
AFAT SHKURTËR (2017)							
Rregullorja 223/2009/EU	jo	Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9180, dt. 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare", i ndryshuar.	jo	INSTAT	Plotësisht	T4 2017	T1 2018
AFAT-MESËM (2018 – 2020)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.2 Statistikat makroekonomike

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2012-2016	INSTAT	2012 - 2016

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Paketa Ligjore e BE -së (EU *acquis*)	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Kryesor	Niveli i përafrimit (Plotë/ Pjesërisht/ Jo i përafruar)	Data e përshtatjes(Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi(Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja 2223/96/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 " Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 549/2013 EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004

	“ Për Statistikat Zyrtare”				
Rregullorja 448/98/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “ Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Vendimi 98/715/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “ Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja1161/2005/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “ Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 1221/2002/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “ Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 715/2010/EU	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 320 “Për hyrjen në fuqi të klasifikimit të aktiviteteve ekonomike NVE Rev 2”	INSTAT	Plotësisht	28.05.2014	03.06.2014
Rregullorja 1889/2002/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “ Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 1059/2003/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “ Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 15.12.2010 “Për zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tre) rajone NUTS 2”, sipas Nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.	INSTAT	I Plotë	15.12.2010	1.1.2011
Rregullorja 1392/2007/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 “ Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004

Rregullorja 400/2009/EU	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 " Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja1749/96/KE	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 " Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 2214/96/BE	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 " Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
Rregullorja 2494/95 /BE	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 " Për Statistikat Zyrtare"	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Direktiva 96/53/BE	Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	I pjesshëm	22.07.1998	21.7.1999

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

Acquis e BE	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFATSHKURTËR (2017)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFATMESËM (2018– 2020)							
Rregullore (BE) Nr. 1315/2013	Jo	VKM "Mbi Udhëzimet e Bashkimit Evropian për Rrjetin Trans evropian TEN-T"	Jo	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Autoriteti Rrugor Shqiptar	I pjesshëm	Tremujori IV 2018	Tremujori IV 2018

IV.2 Rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor përgjegjës	Periudha kryesore e referencës
Strategjia Kombëtare e Energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2006 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e rregullimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2009/73/(KE)	Ligj nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.9.2015	30.10.2015
Rregullorja (KE) Nr 715/2009	Ligji nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror".	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.9.2015	

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Kuadri i Politikave të Planifikuara	Institucioni kryesor	Periudha e referencës	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia e Energjisë e Republikës së Shqipërisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2016 – 2030	Tremujori II 2017	Tremujori II 2017

Masat ligjore për periudhën 2017– 2020

Acquis e BE	Statusi përkthimi anglisht (po / jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi përkthimi anglisht (po / jo)	Pika Përgjegjëse dhe kontaktet	Shkalla e përafrimit	Data e planifikuar për adaptim	Hyrja në fuqi
AFATSHKURTËR (2017)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFATMESËM (2018 - 2020)							

n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve të buxhetit të shtetit

Kapitulli 21			**000/ lekë**		
Përfituesi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kostot që do të financohen nga Buxheti i Shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
VKM "Mbi Udhëzimet e Bashkimit Evropian për Rrjetin Trans evropian TEN-T"	A) Pagat - Stafi ekzistues		150		150
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	5	5	5	15
	Aktiviteti i përgjithshëm	**5**	**155**	**5**	**165**

Tabela B – Fonde të planifikuara nga ndihma e huaj

Kapitulli: 21				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i projektit**	**Titulli i Programit /dhuruesi**	**Vlera në €**	**Aktivitetet**
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i By-Pass-it të Rrogozhinës	Delegacioni Evropian.	5,689,856 EUR	By-pass-i i Rrogozhinës mbetet (ka përfunduar) segmenti më i rëndësishëm i korridorit kryesor Perëndim- Lindje, i cili lidhet me korridorin rrugor Veri-Jug. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.

Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i By-Pass-it të Vlorës.	32% DKE & 34%BERZH & 34%BEI	BERZH 18 milionë Euro (kredi) BEI 18 milionë Euro (kredi) Delegacioni Evropian (17 milionë Euro Grant) i administruar nga BERZH (IPA 2011- Ndërtimi i Bypass-it të Vlorës).	Ndërtimi i By Pass-it të Vlorës është projekt shumë i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në pjesën jugore të Shqipërisë. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore. Aktualisht punimet kanë rifilluar, pas pezullimit të tyre për një kohë të gjatë dhe rezulton se kontraktori po punon me intensitet për të arritur ritmin e punimeve sipas kushteve të parashikuara në kontratë. Ka disa problematika si: shpronësimet, ndryshime në projekt, por nuk janë problematika që ndikojnë në pengimin e punimeve.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	ByPass Shkozet dhe Nyja Vorë.	Fondi Kuvajtjan për Zhvillim.	Nyja Vore: Financimi i Huaj 4,361,858 Euro By Pass Shkozet, Financimi i Huaj: 9,006,560 Euro.	Ky projekt do të lehtësojë trafikun në të dy zonat. (ka përfunduar) Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i segmentit rrugor Damës-Tepelenë Loti.2 i Seksionit Levan-Tepelenë, pjesë e Korridorit Veri-Jug".	BEI/BERZH	45,486,200 EUR	Ky projekt i rëndësishëm është pjesë e korridorit rrugor Veri-Jug dhe vazhdim i segmentit Levan-Tepelenë, i cili do të ketë një impakt pozitiv në uljen e kohës së udhëtimit dhe në zhvillimin e zonës. (është në përfundim e

				sipër) Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i By Pass-it të Fierit.	BEI/BERZH	BERZH 35 milionë Euro (kredi) BEI 35 milionë Euro (kredi)	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Veri-Jug Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Aksit Rrugor, Tiranë – Elbasan: Segmenti 1, (Sauk – Tuneli i Kërrabës).	IDB & Abu Dhabi	90,449,491 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. (85 % e projektit përfundon në fund të vitit 2016 dhe 100% në maj 2017). Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore. Për këtë segment është marrë (no objection) nga Banka Islamike për Zhvillim. PMU shprehet se do të vijojnë procedurat për nënshkrimin e amendimit të kontratave me kontraktorin dhe supervizorin. Aktualisht punimet po vazhdojnë dhe po punohet më me intensitet në Usekun e Mulletit dhe zonën e rrëshqitjeve të Ibës. Rrëshqitjet në Km. 12+000, Km. 13+000, Km. 14+000 mbeten akoma të pazgjidhura. Projekti për

				Km. 12+000 është i përfunduar dhe është dërguar në Këshillin Teknik të ARrSh për shqyrtim. Projekti për rrëshqitjen në Km 14+000 është përfunduar (me një kosto shumë të madhe për zbatim) i cili do të dërgohet ne Këshill Teknik për shqyrtim. Projekti për Km 13+000 është drejt përfundimit dhe llogaritjes së kostos së zbatimit të tij.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Aksit Rrugor, Tiranë – Elbasan: Segmenti 3, (Tuneli i Kërrabës - Elbasan).	IDB, Abu Dhabi&OPEC Fund.	92,303,305 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. (100% në maj 2017) Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore. Realizimi i kontratës së punimeve është rreth 99% me përfundimin e periudhës së garancisë së defekteve. Pritet që brenda muajit Tetor 2016 të përfundojë procesi i marrjes në dorëzim përfundimtar të këtij segmenti nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Segmentit Rrugor Qukës-Qafë Plloçë, Seksioni Nr.1 dhe 2.	IDB	Lot-1: 38,199,652.84 USD Lot-2: 63,098,543.45 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. Aktivitetet kryesore të projektit

				lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Segmentit Rrugor Qukës-Qafë Plloçë, Seksioni Nr.3	Fondi Saudit per Zhvillim	33,396,000 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore. Aktualisht kontraktori ka përfunduar mobilizimin dhe ka hartuar projektin e ri, i cili pas miratimit nga supervizori është dorëzuar në ARrSh në fillim të muajit Gusht. Pritet mbledhja e Këshillit Teknik të ARrSh për marrjen e vendimit.
Hekurudha Shqiptare Sh.a.	Rikonstruksion i segmentit Tiranë –Durrës. Ndërtimi i segmentit Tirane – Rinas.	EBRD WBIF <u>Kontributi i përfituesit</u>	Kredi 32.9 milion Euro Grant 35.4 milion euro <u>13.2 milion Euro</u>	Ky projekt është shumë i rëndësishëm për fillimin e modernizimit të të gjithë rrjetit. Këto fonde janë ne pritje per aprovim dhe realizim.
Autoriteti Portual Vlorë	Rehabilitimi i Portit të Vlorës.	Qeveria Italiane	15,000,000 EUR (kredi) 300,000 EUR (grant)	Ndërtimi i dy kalatave lindore dhe perëndimore. Ndërtimi i një kalate për mallrat cargo. Thellimi i basenit të Portit. Rehabilitimi i sheshit të trageteve. Lehtësimi i akomodimit të udhëtarëve. Rikonstruksioni i ambienteve ekzistuese të Autoritetit Portual.

				Objektivi i këtij programi konsiston në ndërtimin e dy kalatave lindore dhe perëndimore, një kalatë për mallrat cargo, thellimin e basenit të portit, rehabilitimin e shesheve të trageteve, lehtësimin e akomodimit të udhëtarëve si dhe rikonstruksionin e ambienteve ekzistuese të Autoritetit Portual. Vepra detare do të realizohet brenda hapësirës ekzistuese të Portit të Vlorës. Aktualisht punimet në kantier vazhdojnë në përputhje me grafikun e miratuar të punimeve.
Autoriteti Portual Durrës	Ndërtimi i Terminalit të Pasagjerëve dhe Shesheve përreth tij (faza1) dhe Rehabilitimi i Kalatave 7&8 (faza 2) në Portin e Durrësit.	BEI/BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim 14 milion Euro (Kredi) Banka Evropiane e Investimeve 18 milion Euro (Kredi).	Projekti konsiston në ndërtimin e veprave civile të një terminali të ri pasagjerësh dhe rehabilitimin e kalatave 7&8 në portin e Durrësit). Punimet e fazës së parë, përfshirë dhe periudhën e garancisë, kanë përfunduar në muajin gusht të vitit 2013. Aktualisht faza e dytë e këtij projekti, afati i përfundimit të së cilës është data 31.12.2016, po zbatohet sipas grafikut të

				parashikuar të punimeve.
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Përgatitja e Masterplanit të Gazit (MPG) për Shqipërinë dhe i Planit të Identifikimit të Projekteve (PIP)	WBIF	1 100 000 euro	Përgatitja e Masterplanit të Gazit (MPG) dhe i Planit të Identifikimit të Projekteve (PIP) për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri, si dhe miratimi i tyre respektivisht në Këshillin e Ministrave dhe në Këshillin Kombëtar të Territorit.
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Përgatitja e projekteve teknike paraprake dhe kryesore për pjesën e projektit të gazsjellësit Ionian Adriatik (Projekti IAP) për pjesën e këtij projekti në territorin e Shqipërisë dhe Malit të Zi.	WBIF	2 500 000 euro	Bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë së Malit të Zi në kuadër të realizimit të projektit për përgatitjen e projekteve teknike paraprake dhe kryesore për pjesën e projektit të gazsjellësit Ionian Adriatik (Projekti IAP) për pjesën e këtij projekti në territorin e Shqipërisë dhe Malit të Zi.

KAPITULLI 22: POLITIKA RAJONALE DHE BASHKËRENDIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në kapitullin 22 konsiston në rregullore kuadër dhe zbatuese të cilat përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Strukturore dhe Fondit të Kohezionit. Ky legjislacion nuk është i nevojshëm që të përafrohet në legjislacionin e shteteve anëtare apo të shteteve kandidate si në rastin e Shqipërisë. Por, shtetet anëtare duhet të krijojnë kuadrin legjislativ dhe institucional për zbatimin e këtyre programeve. Në tërësi, shtetet anëtare duhet të respektojnë në hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve kuadrin ligjor evropian në fushën e prokurimeve, konkurrencës, mbrojtjes së mjedisit, etj.

Republika e Shqipërisë në kapitullin 22 do të përqendrohet njëkohësisht në:

- Zbatimin e nenit 110 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që përcakton se palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Asistenca financiare e ofruar nga BE parashikohet nga nenet 112-115 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA);
- Marrjen e masave për reduktimin e pabarazive ekonomike, krijimin e rajoneve konkurruese, me një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor, dhe rrjedhimisht, zhvillimi ekonomik dhe social i vendit në përputhje me standardet e BE-së;
- Parapërgatitjet e strukturave institucionale shqiptare për zbatimin pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të programeve të Bashkimit Evropian të përmendura më lart.

Në lidhje me zbatimin e nenit 110 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në tërësi për përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësim, Bashkimi Evropian i jep Shqipërisë një ndihmë të konsiderueshme. Rregullat kryesore për dhënien e kësaj ndihme janë përcaktuar në nenet 112 – 115 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

I.2 Situata në Shqipëri

Në fund të vitit 2015, Qeveria Shqiptare paraqiti një koncept të ri të zhvillimit rajonal dhe filloi ngritjen e strukturave të reja për zbatimin e politikës të zhvillimit rajonal bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 961, datë 2.12.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të agjencive të zhvillimit rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal". Krijimi i zonave të zhvillimit rajonal dhe e strukturave për zbatimin e politikës kombëtare për zhvillimin rajonal, konsiderohet si faza e parë e reformës së Zhvillimit Rajonal.

Në fazën e dytë të reformës, "faza e ndërmjetme", tetor 2015 –shtator 2016, u zhvilluan i) bazat strategjike për zhvillimin rajonal, si dokumenti i politikave dhe udhërrëfyesi i reformës, dhe propozimet për programimin e zhvillimit të 4 rajoneve të reja të zhvillimit; ii) baza për modelin

financiar për skemat e zhvillimit rajonal dhe instrumentet për financimin e politikës për zhvillimin rajonal; iii) ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionit.

Fondi i Zhvillimit Rajonal, mekanizmi ekzistues i financimit të politikës kombëtare të zhvillimit rajonal, përveç duke u reformuar në ligjin e buxhetit të vitit 2016, ka qenë pjesë e procesit të reformimit të ndërmarrë, në "fazën e ndërmjetme".

Fondi i Zhvillimit Rajonal do të organizohet për të mbështetur politikën kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionit, si dhe zbatimin e Programit Operacional përkatëse në nivel kombëtar dhe rajonal. Në këtë kontekst, një kornizë planifikimi afatmesëm do të zhvillohet për Fondin në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm. Programimi do të sigurojë koordinimin e investimeve publike duke planifikuar mes qeverive qendrore dhe lokale, si dhe të sigurojë një mekanizëm transparent për të kontrolluar ekzekutimin kundrejt alokimit të financimeve.

Për periudhën janar – shtator 2016, Komiteti për Zhvillimin Rajonal, është mbledhur tetë herë, ku janë marrë dyzet e gjashtë vendime, nga të cilat dhjetë vendime për shpalljen e thirrjeve për financim të projekteve të reja, njëmbëdhjetë vendime për financimin e projekteve të reja, dhe shtatëmbëdhjetë vendime për shlyerjen e detyrimeve të financimit për projektet në vazhdim.

Duke iu referuar politikës kombëtare për zhvillimin rajonal dhe akseve prioritare të Programit operativ për vitin 2016, i) rivitalizimi i qyteteve, fshatrave, qendrat e poli-urban dhe ekonomitë lokale; ii) kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal; iii) stimulimi i zonave dhe poleve potencial, zhvillimit të zonës; iv) Qytetet moderne; v) mbështetje për ekonominë, janë financuar 151 projekte të reja, me një vlerë financimi prej rreth 110 milion euro.

Programimi në kuadër të Instrumentit financiar të BE-së për periudhën 2007 – 2013 ka përfunduar dhe projektet e programuara janë në zbatim e sipër. Sikurse përcaktuar nga programi IPA I (2007 – 2013), Komisioni Evropian miratoi në 25 mars 2014 dhënien e kompetencave menaxhuese për komponentin I – TAIB të IPA me kontrollin *ex-ante* dhe për këtë arsye tetë projekte në total nën IPA 2012 dhe IPA 2013 po zbatohen nën përgjegjësinë e qeverisë shqiptare.

Programimi në kuadër të perspektivës së re financiare IPA II për periudhën 2014– 2020 ka filluar zbatimin për programin IPA 2014 dhe IPA 2015, ndërkohë që vijon programimi për vitet e ardhshme. Qasja aktuale e BE-së për alokimin e asistencës financiare ka ndryshuar plotësisht në perspektivën e IPA II, duke prezantuar risinë e Mbështetjes Buxhetore. Prioritetet e vendit për perspektivën e re janë përcaktuar në Dokumentin Strategjik Kombëtar 2014 – 2020. Ky dokument përcakton prioritetet e asistencës financiare të BE-së për periudhën 2014 – 2020 për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit. Ai përkthen prioritetet politike të përcaktuara në kuadrin e politikës së zgjerimit në

fusha kyçe ku asistenca financiare është më e dobishme për të përmbushur kriteret e anëtarësimit. Sektorët dhe fushat prioritare për financim brenda sektorëve janë identifikuar bashkërisht nga BE dhe Shqipëria. Janë marrë parasysh edhe strategjitë dhe politikat kyçe kombëtare të Shqipërisë.

IPA 2014, ishte programi i parë i programuar në kuadër të perspektivës së re të financimit, nën IPA II. Marrëveshja Financiare për IPA 2014 u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 987, datë 9.12.2015 "Për miratimin, në parim, të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian për Programin e Veprimit IPA 2014, për Shqipërinë". Marrëveshja e Financimit u nënshkrua nga NIPAC me datë 11.12.2015. Mbështetja buxhetore në kuadër të IPA 2014 po aplikohet në lidhje me zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike (PFM).

Marrëveshja Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Komisionit Evropian mbi Programin vjetor IPA 2015, është nënshkruar me datë 30.09.2016 nga KKIPA. Mbështetja buxhetore në kuadër të këtij programi do të jepet në fushën e administratës publike dhe atë të punësimit dhe aftësive. Gjatë muajit shtator 2016, Ministria e Financave ka paraqitur kërkesën për disbursimin e transheve të para për të dy këta sektorë.

Gjatë vitit 2016 janë përgatitur të gjithë dokumentet e veprimit për programimin e IPA 2016 dhe është miratuar vendimi financiar nga Komisionit Evropian në lidhje me këtë program. Mbështetja buxhetore në kuadër të IPA 2016 do të jepet për sektorët e transportit dhe antikorrupsionit. Marrëveshja Financiare IPA 2016 pritet të nënshkruhet gjatë muajve Shkurt – Mars 2017.

Programimi i IPA 2017, ka filluar dhe janë dërguar pranë Shërbimeve të Komisionit Evropian draftet e para të Dokumenteve të Veprimit për sektorët e Drejtësisë, uji, inovacioni dhe konkurrueshmëria. Gjithashtu mbështetje do të jepet edhe për programin Lehtësues të Integrimit Evropian, pjesëmarrjen në programet evropiane dhe shoqërinë civile.

Risia e IPA II, ndër të tjera thekson se të gjitha vendet përfituese duhet të përmbushin kriteret dhe standardet e kërkuara me qëllim përfitimin e buxhetit për çdo vit programimi si dhe të aplikojnë për transferimin e përgjegjësive për menaxhimin e buxhetit. Progresi i arritur nga vendi ynë në sektorët respektivë ka bërë që të disbursohen transhet për vitin 2015, ndërkohë kanë filluar përgatitjet për IPA 2016. Ndër të tjera, konfirmojmë se përmbushja e disa kushteve të mbetura të përfshira në Marrëveshjen Financiare IPA 2014, mbi dorëzimin e buxhetit është mbyllur. Gjithashtu një draft raport lidhur me gjetjet mbi programin IPA 2015, ju është dërguar strukturave shqiptare në muajin gusht 2016, të cilat kanë hartuar një plan veprimi për adresimin e tyre.

Në kuadër të Instrumentit të Investimeve të Ballkanit Perëndimorë (WBIF), gjatë 2016 për Shqipërinë janë miratuar projektet e mëposhtëm:

- Studimi Pre fisibilitetit e tubacionit të gazit nga Shqipëria në Kosovë (granti prej 300,000 Euro për 2 vendet);
- Studim Pre-fisibiliteti për gazsjellësin Adriatik-Jonian (IAP) (granti prej 250,000 Euro për 2 vendet);
- Studimi për hartimin e detajuar të projektit për rehabilitimin e linjës Vora – Hani i Hotit (granti prej 4,500,000 Euro);
- Dizenjo e detajuar për By-Passin e Tiranës (Kashar-Vaqarr-Mullet) (granti prej 1,500,000 Euro);
- Rehabilitimi i hekurudhës Durrës-Tiranë dhe ndërtimi i hekurudhës së re, Dega Rinas (granti prej 36,2437 milion Euro).

Paketa Kombëtare Unike të Projekteve të Relevancës Strategjike (SPP) të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Investimeve me datë 9 dhjetor 2015. Kjo Paketë përfshinte 39 projekte në katër sektorë strategjikë: transport, energji, mjedis dhe infrastruktura sociale. 15 nga këto projekte ishin projekte rajonale (ose projekte që kanë të bëjnë me ndërlidhjen/konektivitetin dhe Agjendën WB6) dhe 24 ishin projekte kombëtare (që ndikojnë kryesisht në nivel kombëtar). Nevojat totale të financimit llogariteshin në rreth 1,899 miliardë euro. Në muajin mars 2016, Paketa Kombëtare Unike e Projekteve të Relevancës Strategjike (SPP) u rishikua duke shtuar dy projekte të tjera të fokusuara në sektorin e energjisë, duke e çuar në 41 numrin e projekteve të përfshira në Paketën Kombëtare Unike.

Gjatë vitit 2016, u hartua dhe miratua Paketa e dytë Kombëtare Unike e Projekteve në dhjetor 2016. Kjo Paketë u mbështet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 11.5.2016 dhe strategjitë e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale. Hartimi i Paketës së dytë u mbështet nga Grupet e Menaxhimit Strategjik Sektorial (SSMG) të ngritura dhe funksionale për pesë sektorë: transport, energji, mjedis, infrastrukturë sociale dhe biznes.

Shqipëria merr pjesë në tetë programe të bashkëpunimit Territorial nën perspektivën IPA II 2014 – 2020, programet bilaterale: Shqipëri-Kosovë, Maqedoni-Shqipëri, Mal i Zi-Shqipëri, Greqi-Shqipëri, programet transnacionale: Adriatiko-Jonian (Adrion), Ballkan-Mediterran, MED si dhe Programi trilateral Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Të gjitha programet janë dorëzuar pranë Komisionit Evropian në kohën e duhur dhe janë miratuar gjatë vitit 2015.

Një theks të veçantë i është dhënë nënshkrimit në kohën e duhur të Marrëveshjeve të Financimit për Programet e Bashkëpunimit Territorial, hartimit të Marrëveshjeve të Partneritetit dhe Marrëveshjeve Bilaterale, ngritjes së Komiteteve të Përbashkëta të Monitorimit, hartimit dhe shpalljes së thirrjeve të para dhe të dyta për projekt propozime dhe organizimit të fushatave të gjera informuese për aplikantë të mundshëm shqiptarë. Në këtë kuadër, përfshirja e aplikantëve shqiptarë (institucione qendrore e lokale, Agjenci, organizata) në këto Programe ka qenë tejet i kënaqshëm duke lënë pas vendet e rajonit.

MIE ka përfunduar procesin e nënshkrimit të Marrëveshjeve të Financimit, për sa i përket alokimeve financiare të viteve 2014 dhe 2015, të programeve IPA CBC Shqipëri-Kosovë, Mal i Zi-Shqipëri, Maqedoni-Shqipëri përgjatë vitit 2015 dhe 2016. Ndërkohë përgjatë 2016 janë finalizuar Marrëveshjet e Financimit për Programin Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri dhe Interreg IPA CBC Itali – Shqipëri – Mali i Zi. Ndërkohë janë në proces nënshkrimi Marrëveshjet e Financimit për programet Transnacionale.

Gjashtë nga tetë programet e bashkëpunimit Territorial IPA II kanë shpallur thirrjet për projekt-propozime ndërkohë në fillim të 2017 pritet të lancohen thirrjet edhe për programet Shqipëri-Kosovë dhe Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Është vërejtur një numër tejet i lartë i aplikantëve nga Shqipëria në këto Thirrje krahasuar me vendet e tjera të Rajonit, kjo si pasojë e një fushate informuese dhe asistence nga MIE të shtrirë në të gjithë vendin por edhe në kohë reale nëpërmjet komunikimeve elektronike. Theks i veçantë është vënë në forcimin e kapaciteteve të njësive lokale (kryesisht bashkive) me qëllim rritjen e aftësive absorbuese, në përputhje kjo me synimet e Reformës Territoriale. MIE ka asistuar Njësitë e Qeverisjes Vendore për të ngritur një sektor të dedikuar brenda strukturës së tyre e cila do të merret me projekte të financuara nga BE apo donatorët. Rritja e kapaciteteve absorbuese dhe pjesëmarrja e NjQV-ve në Programet e bashkëpunimit territorial është një prioritet i MIE-së në mënyrë që t'i përgatisë ato për fondet ERDF;

Në lidhje me zbatimin e projekteve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transnacional, MIE është duke monitoruar ecurinë e projekteve të financuara nga Programet e periudhës 2007-2013. Në përgjithësi, problematikat e evidentuara lidhen me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj KE , rimbursimin e TVSH apo kapacitetet e ulëta të përfituesit, ndaj MIE po mban kontakte të vazhdueshme me institucionet përfituese dhe Delegacionin e BE në Tiranë për të mundësuar zbatimin me sukses të projekteve.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Strategjinë e BE për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) ndiqet nga MIE, MPJ dhe Ministritë përkatëse të Linjës në kuadër të strukturave të ndryshme drejtuese dhe koordinuese me të cilat operon kjo Strategji.

Shqipëria është pjesëmarrëse në 8 Programe Evropiane; “Horizon 2020”, “COSME”, “ERASMUS +”, “Europa Krijuese”, “Europa për Qytetarët”, “Doganat 2020”, “Fiscalis 2020”, “EaSI” dhe duke filluar nga viti 2017, Shqipëria do të përfitojë dhe nga “Programi për Drejtësinë”. Pjesëmarrja e Shqipërisë sigurohet nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare, e cila përfshin edhe sigurimin e pagesës së biletës hyrëse për secilin program nga institucioni përfitues.

Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve IPA është fokusuar në (i) monitorimin dhe ndërmjetësimin e zgjidhjes së çështjeve problematike të projekteve të centralizuara të raportuara nga Delegacioni i Bashkimit Evropian dhe (ii) monitorimin e zbatimit të projekteve të para nën

menaxhim të decentralizuar/indirekt (programet IPA 2012, 2013 dhe 2014). Monitorimi i këtyre të fundit kryhet nëpërmjet raporteve të progresit, vizitave verifikuese, takimeve me përfituesit, DBE dhe misioneve të Komisionit Evropian, etj.

Referuar programeve të mbështetjes buxhetore të financuara nga BE për reformimin e sektorëve kyç të administrimit publik, është miratuar nga KE disbursimi i transhit të parë dhe pjesërisht të transhit të dytë (në total 13,5 milion Euro) të programit të mbështetjes buxhetore për reformën në menaxhimin e financave publike IPA 2014, pas plotësimit të kushteve dhe indikatorëve përkatës nga autoritetet shqiptare.

Referuar programit të mbështetjes buxhetore për Reformën në Administratën Publike nën programin IPA 2015, iu dërgua Komisionit Evropian paketa e plotë e dokumentacionit për disbursimin e transhit të parë fiks të mbështetjes buxhetore në këtë sektor.

Është në proces ngritja e Komiteteve Sektoriale të Monitorimit sipas fushave kryesore të mbështetjes IPA II, të cilat do të integrohen nën Grupet të Integruara të Menaxhimit të Politikave (GIMP)- të cilat funksionojnë nën strukturën e Këshillit të Ministrave. Është kontraktuar asistencë teknike nga Komisioni Evropian e cila do të mbështesë procesin e ngritjes dhe funksionimit të Komiteteve Sektoriale të monitorimit të IPAs.

Në 15 shtator 2016, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin 90/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë".

Ky ligj përcakton rregullat e organizimit, funksionimit, detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian si dhe dispozitat e nevojshme që sigurojnë pavarësinë e nevojshme funksionale dhe financiare, të Agjencisë e cila vepron si Autoriteti Auditues i Instrumentit të Para - Anëtarësimit IPA.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE-së

Neni 110 i MSA-së parashikon se palët do të forcojnë bashkëpunimin për zhvillimin rajonal dhe vendor, me objektivin për të kontribuuar në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Konkretisht palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet

bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe interrajonal. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal.

Asistenca financiare që jep BE-ja përcaktohet në nenet 112 – 115 të MSA-së. Këto nene shprehen qartë se Shqipëria mund të përfitojë nga BE-ja asistence financiare në formën e granteve dhe huave, por së pari, Shqipëria duhet të përcaktojë prioritetet dhe të garantojë kapacitetet e duhura për përthithjen e kësaj asistence. MSA-ja kërkon që kontributet e Komunitetit të jepen në bashkërendim të ngushtë me kontributet prej burimeve të tjera si Shtetet Anëtare, vende të tjera dhe institucione financiare ndërkombëtare.

Konkretisht, në përputhje me Nenin 112 të MSA, Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë hua nga Banka Evropiane e Investimeve, BERZH etj. Ndihma e BE varet nga përmbushja e parimeve dhe kushteve të parashikuara në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 29 prill 1997, duke marrë parasysh rezultatet e raporteve vjetore të vendeve në Procesin e Stabilizim Asociimit, Partneriteteve Evropiane, dhe të konkluzioneve të tjera të Këshillit, të cilat i përkasin në mënyrë të veçantë respektimit të programeve rregulluese. Sipas MSA, ndihma që i jepet Shqipërisë do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, përparësive të zgjedhura dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate, si edhe masave të marra për reformimin dhe ristrukturimin e ekonomisë.

Për sa i përket Nenit 113 të MSA, Asistenca financiare, në formën e granteve, duhet të trajtohet nga masat operacionale të parashikuara në Rregulloren përkatëse të Këshillit brenda kuadrit indikativ shumëvjeçar të caktuar nga Unioni pas konsultimeve me Shqipërinë. Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 114 i MSA sanksionon se, me kërkesë të Palës shqiptare dhe në rastet e nevojës së veçantë, Unioni, duke u koordinuar me institucionet ndërkombëtare financiare, mund të shqyrtojë mundësinë, duke bërë përjashtim, e dhënies së asistencës makro-financiare, e cila varet nga kushte të caktuara dhe duke marrë parasysh disponimin e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet vetëm kur përmbushen kushtet që do të vendosin në kontekstin e një programi për të cilin është rënë dakord mes Shqipërisë dhe FMN-së.

Sa i përket nenit 115 të MSA, BE dhe Shqipëria garantojnë që kontributet e BE të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me ato kontribute të ardhura nga burime të tjera si prej Shteteve Anëtare, vendeve të tjera dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë drejtim, informacioni për çdo burim të asistencës shkëmbehet rregullisht ndërmjet Palëve.

E drejta e BE-së në fushën e bashkëpunimit financiar konsiston, ndër të tjera, nga këto akte ligjore:

1. Rregullorja Zbatuese (BE) e Komisionit nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014 për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që përcakton Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II);
2. Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Mars 2014 që përcakton Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II);
3. Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që përcakton rregulla dhe procedura të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e masave të jashtme;
4. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 e datës 17 korrik 2006 që përcakton instrumentin për asistencën e para-anëtarësimit (IPA);
5. Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 718/2007 e datës 12 qershor 2007 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 që përcakton instrumentin për asistencën e para-anëtarësimit (IPA).
6. Vendimi i Komisionit i datës 25.03.2014 mbi transferimin e menaxhimit të komponentit I – TAIB, të IPAs për Shqipërinë.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore normative

Në kuadër të perspektivës së re financiare IPA II (2014-2020), Marrëveshja Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të BE në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit, u nënshkrua në 9 prill 2015 dhe u ratifikua me Ligjin Nr. 37/2015.

Për t'i hapur rrugën implementimit të programit, më 20 shtator 2016, ZKA/NAO dorëzoi pranë Komisionit Evropian kërkesën për marrjen e detyrave të zbatimit të buxhetit për programin IPARD II (2014 - 2020). Në datat 5 – 9 dhjetor 2016, një Mision Auditimi i DG AGRI bëri vlerësimin e gatishmërisë së strukturave të Programit IPARD 2014 – 2020 për zbatimin e Buxhetit të akorduar për këtë program. Priten të jepet vlerësimi dhe vendimi për marrjen e besimit të zbatimit të buxheteve për Programin IPARD.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional përgjegjës për bashkërendimin e instrumenteve financiarë të BE-së në Shqipëri përbëhet nga këto institucione:

1. Ministria e Integrimit Europian
2. Ministria e Financave
3. Strukturat Zbatuese

4. Kryeministria (DZhPFNH)
5. AZHBR / Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)
6. INSTAT
7. Agjencia Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga BE/ Autoriteti Auditimit
8. Komiteti Kombëtar i Investimeve

Ministria e Integrimit Evropian (MIE) është institucioni qendror përgjegjës për programimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës financiare të BE-së. Ky institucion është ngarkuar me koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet e BE-së, si dhe koordinimin e aplikimeve të Shqipërisë në raundet e WBIF dhe programeve me shumë vende. MEI, e përfaqësuar nga Ministri, është përcaktuar Koordinator Kombëtar i IPA (KKIPA). KKIPA është kundërpala kryesore e Komisionit për procesin e përgjithshëm të planifikimit strategjik, koordinimit të programimit, monitorimit dhe implementimit, vlerësimit dhe raportimit të asistencës IPA II. Zyra e KKIPA drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të projekteve të asistencës së BE-së, i cili është Drejtues i Zyrës së KKIPA.

Zv.ministri i Integrimit Europian kryen funksionin e Zëvendës KKIPA për veprimtarinë e përditshme të zyrës së KKIPA.

MIE është gjithashtu përgjegjëse edhe për koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet e Bashkëpunimit Territorial dhe mban rolin e Strukturës Operative për këto programe. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë vepron *ex-officio* si Drejtues i Strukturës Operative për këto programe.

Në Ministrinë e Integrimit Evropian ka dy drejtori që janë përgjegjëse për asistencën financiare të BE-së:

1) Drejtoria e Programit dhe Monitorimit të projekteve të Asistencës së BE-së, që përbëhet nga 4 sektorë (i) sektori i programeve të BE-së në fushat e Demokracisë, Qeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe të drejtave Themelore (ii) sektori për programet e BE-së në Bujqësi, Ekonomi, dhe Kohezionin Social (iii) sektori për koordinimin e programeve horizontale, dhe (iv) sektori për monitorimin dhe vlerësimin e Asistencës së BE-së.
2) Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial, që përbëhet nga 2 sektorë: (i) Sektori për bashkëpunimin ndërkufitar dhe transnacional dhe (ii) Sektori për monitorimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar dhe transnacional.

Ministria e Financave: Zëvendësministri i Financave, në cilësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO), mbart përgjegjësinë kryesore për menaxhimin financiar të fondeve të BE-së në Republikën e Shqipërisë dhe për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve dhe shpenzimeve nën programet IPA I dhe II.

ZKA në kryerjen e detyrave të tij mbështetet nga struktura menaxhuese të cilat përbëhen nga Fondi Kombëtar dhe Zyra e Mbështetëse e ZKA-se. Të dyja janë struktura të veçanta të Ministrisë së Financave, të varura drejtpërdrejtë nga ZKA-së për zbatimin e operacioneve të programeve IPA.

Drejtoria e Fondit Kombëtar është strukturë e veçantë në Ministrinë e Financave në varësi funksionale të Zëvendësministrit të Financave në rolin dhe funksionin e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO) për menaxhimin financiar efektiv të fondeve të Bashkimit Evropian në sistemin e Decentralizuar/Indirekt , duke shërbyer si njësi qendrore thesari, me kompetenca buxhetore, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës e cila përbëhet nga 3 sektorë: (i) Sektori i Kontrollit Financiar (ii) Sektori i Menaxhimit Financiar, dhe (iii) Sektori i Kontabilitetit.

Drejtoria Mbështetëse e ZKA (DM ZKA), është strukturë e veçantë në Ministrinë e Financave, në varësi funksionale të drejtpërdrejtë të ZKA, dhe është përgjegjëse për të asistuar ZKA duke siguruar funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm për fondet IPA dhe IPARD. Veçanërisht, DM ZKA mbështet ZKA për hartimin e deklaratës vjetore të garancisë dhe menaxhimit të cilën ja përcjell atë KE duke u bazuar në një sëre procesesh kontrolli e monitorimit të sistemit.

CFCU, pjesë përbërëse e strukturës operative, është përgjegjëse për procedurat e tenderimit, kontraktimit, kontabilitetit, pagesave dhe raportimin e kontratave të lidhura në kuadër të menaxhimit indirekt për fondet IPA.

Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Programit IPA është përgjegjëse për procesin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), hapjes së negociatave për anëtarësim në BE, si dhe është pjesë e strukturës operative përgjegjëse për implementimin dhe monitorimin e projekteve IPA.

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar të BE-së është organi i caktuar për auditimin e jashtëm të asistencës së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, sikurse përcaktuar nga Ligji nr. 90/2016, date 15.09.2016 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë" Agjencia është person juridik publik, buxhetor, i organizuar në formën e agjencisë autonome, nën mbikëqyrjen e Kryeministrit dhe kryen veprimtarinë e pavarur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s, Zyrtari Kombëtar i Autorizuar, strukturat menaxhuese dhe strukturat operuese të asistencës së Bashkimit Evropian. Veprimtaria e Agjencisë kryhet në përputhje me kërkesat e Marrëveshjeve Kuadër IPA dhe të çdo marrëveshjeje tjetër sektoriale dhe/ose financiare në zbatim të marrëveshjeve kuadër. Auditimet e Agjencisë mbulojnë fushat e pajtueshmërisë, ligjshmërisë, rregullshmërisë,

menaxhimin financiar të fondeve të BE-së, si dhe ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të këtyre fondeve në përputhje me konceptet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Agjencia e Auditimit si Agjenci Autonome është në proces organizimi për shtimin dhe forcimin e kapaciteteve. Struktura dhe mënyra e organizimit e përshtatshme me kërkesat e ligjit 90/2016 pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave brenda vitit 2016. Kjo do të sjellë ndryshim në numrin e punonjësve (aktualisht 6 në 16 punonjës) po ashtu dhe në mënyrën e organizimit të punës.

Komiteti Kombëtar i Investimeve është krijuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 18, datë 22.1.2014 "Për krijimin e Komitetit të Planifikimit Strategjik Ndërministror" ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr 113, date 26.08.2015 "Për disa ndryshime në Urdhrin e Këshillit të ministrave Nr. 18, datë 22.1.2014 mbi themelimin e Komitetit të Planifikimit Strategjik Ndërministror". Urdhri atribuon qartë për Komitetin ekzistues Ndërministror të Planifikimit Strategjik dhe rolin dhe funksionet e Komitetit Kombëtar të Investimeve. Në këtë kontekst dhe me të njëjtën metodologji KKI është duke u mbështetur nga Sekretariati i Përgjithshëm (Departamenti për Zhvillim, Financim dhe Ndihmës së Huaj, Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim).

Paketa Kombëtare e Projekteve (Single Project Pipeline), forcon identifikimin, përgatitjen dhe selektimin e projekteve në sektorët e energjisë, transportit, mjedisit, sektorit social dhe infrastrukturën mbështetëse e biznesit është parakusht për marrjen e mbështetjes së IPA II për bashkë-financim. Në këtë kontekst, janë hartuar Paketat Sektoriale të Projekteve (Single Sector Project Pipeline) për këto sektorë, të cilat më pas shkrihen në një Paketë të vetme Kombëtare. Në këtë mënyrë do të kenë akses më të madh në burimet e financimit dhe fondet e Bashkimit Evropian dhe institucione të tjera ndërkombëtare financiare. Ekspertet e IFICO kane dhënë mbështetjen për këtë proces.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) është përgjegjëse për ngritjen e një Autoritetit Menaxhues dhe Agjencisë së IPARD si organe zbatuese të programit të Zhvillimit Bujqësor dhe Rural 2014-2020. Të dyja strukturat kanë përgatitur e trajnuar stafin mbi procedurat kryesore për implementimin e IPARD. Autoriteti Menaxhues është një strukturë e pavarur në MBZHRAU i cili merret me programimin, monitorimin, komunikimin dhe vizibilitetin e programit operacional IPARD. Agjencia e pagesave është një agjenci e pavarur nga Ministria dhe shërben si organi zbatues për programin IPARD, në veçanti përgjegjëse për pranimin, para-seleksionimin, përzgjedhjen dhe ekzekutimin e pagesave.

Instituti i Statistikave: Në zbatim të kuadrit ligjor për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, (VKM nr. 707, datë 21.08.2013 dhe VKM nr. 541 datë 18.06.2015), INSTAT ka krijuar strukturën e Zyrtarit të Lartë të Programit (Senior Programme Officer), për menaxhimin e fondeve të BE-së (IPA I, komponenti i I-rë (2007-2013) dhe IPA II (20014-2020). Drejtoria e Integrimit Evropian, koordinimit të

projekteve dhe publikimeve në INSTAT, ka ndjekur punën në lidhje me funksionimin me efiçencë të strukturës së Zyrtarit të Lartë të Programit (SPO) për IPA I dhe II duke komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë e Kontraktimeve dhe Financimeve të Huaja (CFCU) në Ministrinë e Financave për mirëmbajtjen e dosjes së SPO-së, përgatitjen e dokumentacionit dhe shkresave, përditësimin e dokumentacionit të domosdoshëm për funksionimin e strukturës së SPO-së për INSTAT, analizën e ngarkesës së punës, menaxhimin e riskut, përditësimin e regjistrit të riskut, raportimin mbi parregullsitë, etj. Në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, INSTAT ka dhënë inputet e veta për përditësimin e PKIE 2016-2018 në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze duke koordinuar punën me strukturat teknike të INSTAT si dhe me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave për mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit.

II.4 Parashikimet financiare indikative (ALL)

II.4 Përcaktim i alokimeve financiare (të hartohet në përputhje me buxhetin e parashikuar nga qeveria për vitet vijuese 2017 – 2018-2019)

	2017	**2018**	**2019**
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider për 3 vitet në vijim			
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	**201.11000**	**201.11000**	**201.11000**
Buxheti total i Kapitullit			

III. Prioritetet

Prioritetet e Shqipërisë në një perspektivë afatshkurtër, bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit në Raportin e tij për Shqipërinë për vitin 2016 janë:

- Forcimi i kapaciteteve administrative të Njësisë Qendrore të Financimeve dhe Kontraktimeve, Autoritetit të Auditit dhe veçanërisht të Zyrës Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA);
- Përshpejtimi i përgatitjes së dokumenteve të projekteve IPA për të evituar vonesat në përthithjen e fondeve të BE-së, përfshirë programet e mbështetjes buxhetore;

- Rritja e kapaciteteve programuese në përputhje me përqasjen sektoriale dhe përmirësimin e funksionimit të listës së projekteve sektoriale të maturuara;
- Programimi sektorial shumëvjeçar në përputhje me përqasjen sektoriale të IPA 2014 – 2020 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm;
- Forcimi i koordinimit ndërmjet Ministrisë së Integrimit Europian, Ministrisë së Financave, Këshillit të Ministrave, etj për hartimin e politikave dhe programeve rajonale të zhvillimit, realiste dhe të buxhetuara;
- Rritja e numrit të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave;
- Përfshirja e partnerëve për zhvillim, autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile në dialogun mbi zhvillimin rajonal;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të sekretariateve të menaxhimit të integruar të politikave, përfshirë adoptimin e rolit të Komiteteve të Monitorimit Sektorial për monitorimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian si dhe përfshirja e partnerëve të zhvillimit, organeve të pushtetit lokal dhe organizatave të shoqërisë civile në dialogun sektorial.
- Në lidhje me bashkëpunimin territorial, procesi i decentralizimit do të përparojë dhe dokumentet e nevojshme, të tilla si marrëveshjet implementuese dhe operacionale ndërmjet zyrtarit kombëtar autorizues, kreut te Strukturës Operative dhe zyrtarit autorizues te Programit, do të miratohen;
- Rritja e pjesëmarrjes së suksesshme të Shqipërisë në Strategjinë e BE-së për rajonin e Adriatik dhe Jonit (EUSAIR) si dhe lehtësimin e hartimit të projekteve rajonale në mbështetje të Strategjisë;

IV. Plani për periudhën 2017-2020

IV.1 Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Kryeministria	2015-2020
Dokumenti Strategjik Kombëtar	Komisioni Evropian Ministria e Integrimit Evropian	2014 – 2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n./a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)	EU acquis	Legjislacioni Shqiptar
AFATSHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFATMESME (2018 – 2020)							

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e planifikuar e fondeve

Kapitulli 22: Zhvillimi rajonal dhe koordinimi i instrumenteve strukturore					
Përfituesi: MIE					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali (3+4+5)**
	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	n/a	n/a	n/a	n/a

Tabela B – Fondet e planifikuara të asistencës së huaj

Kapitulli:				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i projektit**	**Titulli i programit/donatori**	**Vlera në €**	**Aktivitetet**
INSTAT	Projekt i Bashkëpunimit Statistikor ndërmjet INSTAT dhe Statistikave Suedeze, Faza e katërt	Sida - Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar	ONGOING	Projektit është të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm statistikor në Shqipëri. Një sistem i qëndrueshëm statistikor do të ndihmojë vendimmarrjen bazuar në informacione statistikore të sakta dhe të besueshme të cilat plotësojnë kërkesat kombëtare si dhe standardet e Bashkimit Evropian. Përfitues është kryesisht INSTAT, por gjithashtu edhe sistemi statistikor në Shqipëri. Projekti përmban planifikimin e aktiviteteve për tre vitet e ardhshme (2014-2017) por gjithashtu dhe një parashikim të përgjithshëm për periudhën e tjetër (2018 - 2020). Në fillimet e vitit 2017, është parashikuar një vlerësim afat-mesëm mbi rezultatet e arritura nga zbatimi i projektit. Rezultatet e këtij rishikimi afat-

				mesëm do të shërbejnë si bazë për INSTAT dhe SCB për më tej, për një planifikim të detajuar për fazën tjetër të mbështetjes për periudhën e mbetur të projektit 2018-2020. Fushat prioritare të asistencës teknike gjatë gjithë fazës së projektit përfshijnë Menaxhim, Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit, Statistikat Ekonomike dhe Biznesit, Metodologjia Statistikore, Statistikat Sociale, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, etj. Statistikat e Mjedisit janë përfshirë nën komponentin e Bujqësisë, për shkak të kërkesave të BE për zhvillimin e statistikave në këtë fushë, këto statistika janë pjesë e kuadrit të Llogarive Kombëtare. Në asistencën për statistikat sociale është përfshirë edhe perspektiva gjinore. Të dhënat e integruara gjinore janë mbledhur në bashkëpunime të mëparshme të tilla si nëpërmjet Statistikave të Përdorimit të Kohës
INSTAT	Projekt i Bashkëpunimit Rajonal për Evropën Juglindore	Sida - Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar	ongoing	Është të zhvillojë sistemet statistikore në rajon duke u

				mbështetur në metoda dhe praktika të shëndosha statistikore në përputhje me standardet e BE-së. Përveç programeve kombëtare me institucionet partnerë përkatës në Ballkanin Perëndimor, me mbështetjen financiare të Sida-s, Statistikat Suedeze (SCB) kanë gjithashtu programe të bashkëpunimit rajonal. Qëllimi i përqasjes rajonale është të inkurajojë bashkëpunimin rajonal nëpërmjet zyrave statistikore dhe shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave të mira në rajon, rritjen e kapaciteteve dhe në të njëjtën kohe duke kontribuar në përdorimin sa më të mirë dhe krahasueshmërinë e të dhënave statistikore nëpërmjet harmonizimit të metodologjisë dhe praktikave statistikore, duke shpërndarë praktikat më të mira dhe duke mësuar nga praktikat e njëri-tjetrit. Ekziston një strukturë e quajtur Komiteti Rajonal për Statistikat (RSC), i cili është në krye të menaxhimit të projektit, dhe është i përbërë nga përfaqësues nga institucionet partnere të INSTAT,

Në kuadër të këtij Kapitulli, janë vlerësuar periodikisht rekomandimet e Komisionit Evropian pasqyruar në Raportet e Progresit për Shqipërinë me fokus luftën kundër krimit të organizuar, veçanërisht masat e ndërmarra në menaxhimin e kufijve dhe migracionin, luftën kundër krimit të organizuar, luftën kundër drogës, luftën kundër terrorizmit etij. Në raport progresin 2016 lidhur me luftën kundër krimit të organizuar në tërësi vlerësohet se janë bërë përparime në këtë fushë. Shqipëria ka arritur të realizojë një numër të konsiderueshëm operacionesh të cilat kanë çuar në shkatërrimin e kultivimit në masë të kanabisit.

Gjatë vitit 2015 e në vazhdim, në Policinë e Shtetit po vazhdon procesi i reformimit, i cili synon përmbushjen e standardeve më të larta të funksionimit të organizatës policore, zbatimin në vijimësi të një modeli pune të bazuar në zbatimin e ligjit, konsolidimin e marrëdhënieve me institucionet e pavarura dhe bashkëpunim intensiv me partnerët ndërkombëtarë.
Gjatë kësaj periudhe janë miratuar: Strategjia e Rendit Publik (Policia e Shtetit) 2015 – 2020 dhe Plani i Veprimit 2015 – 2017; (VKM nr. 702, datë 26.08.2015); Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe plani i veprimit; (VKM Nr.247, datë 20.03.2015); Strategjia kundër ekstremizmit të dhunshëm, (VKM nr. 930, datë 18.11.2015); Plani Kombëtar i Veprimit 2015 – 2017 "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të mjeteve motorike"; Plani Kombëtar i Veprimit kundër trafikimit të pasurive kulturore; VKM Nr. 476, datë 29.06.2016 janë miratuar propozimet e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8750, datë 26.03.2001, për "Parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope, të ndryshuar", miratuar me Ligjin Nr. 88/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8750, datë 26.3.2001, "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope", të ndryshuar".

Në kuadër të analizave dhe vlerësimit të riskut Policia e Shtetit ka hartuar raportin SOCTA për vitin 2016 dhe përdorimi i produkteve analitike nga sektorët e hetimit të krimit të organizuar dhe hetimet është në rritje.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional janë realizuar marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstitucional midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ILDKP, ALUIZNI dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Objekti i marrëveshjeve të nënshkruara është rregullimi i marrëdhënieve dhe modaliteteve për dhënien e të drejtës së përdorimit të bazave të të dhënave të institucioneve respektive.

Në fushën e bashkëpunimit në luftën kundër drogës, është intensifikuar lufta kundër trafikimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe ka vazhduar bashkëpunimi me EMCDDA-në, Europolin, Interpolin, vendet e BE-së apo ato kandidate të rajonit të Ballkanit dhe janë zhvilluar

operacione të përbashkëta e trajnime të ndryshme. Janë zbatuar programet lidhur me reduktimin e prodhimit dhe trafikimit të drogave, si dhe garantimit të një kontrolli efektiv për sigurimin e territorit.

Duke marrë në konsideratë progres raportin, realizimi i objektivave vjetor për krimin e organizuar, hetimet financiare, pastrimin e parave vijojnë si më poshtë:
-Realizimi i objektivave vjetor të vendosur lidhur me numrin e rasteve të goditura ndaj shitjes e trafikimit të narkotikëve (mbi 800) është 128 % më i lartë se objektivi i caktuar, numrin e operacioneve të zhvilluara (45) 224% më shumë se objektivi vjetor i caktuar dhe numri i grupeve kriminale të goditura (45) 111% më shumë se objektivi vjetor i caktuar.
-Realizimi i objektivit vjetor i vendosur lidhur me hetimet proaktive për trafikimin e personave (të rritet me 10), krahasuar me vitin 2014 është 129%, për operacionet policore (40 operacione) realizimi i objektivit është 135%.
-Realizimi i objektivit vjetor lidhur me zhvillimin e operacioneve ndërkombëtare në bashkëpunim me agjencitë homologe të EU dhe rajonit të angazhuara në luftën kundër krimit të organizuar (rritje 3%) është rritur në vitin 2015 me 145%.
-Realizimi i objektivit vjetor të vendosur lidhur me rritjen e numrit të hetimeve proaktive për fillimin e hetimeve pasurore (rritja 3%) është 101%.
-Realizimi i objektivit vjetor të vendosur lidhur me rritjen e numrit të procedimeve penale të pastrimit të produkteve të veprës penale (rritja 6%) është 114%.
-Realizimi i objektivit vjetor të vendosur lidhur me rritjen e vlerës së aseteve të sekuestruara për pastrim të produketeve të veprës penale (jo më pak se 4 milion Euro) është +27 155 646 Euro.

Në kuadër të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm janë ndërmarrë disa masa të rëndësishme si:

- Ndryshime në Kodin Penal të RSH-së, me ligjin Nr. 98/2014, “Për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit të shtetasve shqiptarë".
- Rritjen e kapaciteteve me burime njerëzore dhe logjistike të strukturave të luftës kundër akteve terroriste e konkretizuar me krijimin e Drejtorisë së Antiterrorit në Policinë e Shtetit.
- Hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe Planit të Veprimit 2016-2020.
- Nënshkrimi dhe zbatimi i disa marrëveshjet të bashkëpunimit me SHBA, si dhe disa vende të rajonit dhe të Evropës, në fushën e sigurisë dhe për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit.
- Kryerjen e disa hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta ndërkombëtar të cilat janë finalizuar me dënimin dhe arrestimin e disa individëve të dyshuar për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.
- Rritjen e bashkëpunimit në nivel operacional në shkëmbimin e shpejtë të informacionit midis strukturave ligjzbatuese në vend.

Janë miratuar Ligji “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 121/ 2014, datë 14.10.2014 , Ligji “Për të huajt” Nr. 108, datë 28.03.2013, dhe ligjit Nr. 74, datë 14.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 108/2013 "Për të huajt" i ndryshuar i cili synon përafrimin me acquis në fushën e politikës së vizave dhe trajtimit të të huajve. Në lidhje me masat e marra për kufijtë e jashtëm, në prill 2012, u nënshkruan tre marrëveshje me Kosovën për kontrollin e përbashkët kufitar. Janë ngritur dhe funksionojnë qendrat e bashkëpunimit policor për shkëmbimin e informacionit me Kosovën dhe Maqedoninë. Është miratuar Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe plani i veprimit 2014-2020. Në lidhje me bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit të organizuar, ka vazhduar ky proces bashkëpunimi si në planin ndërinstitucional ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave, janë implementuar rekomandimet e raundit të fundit vlerësues të MONEYVAL, si dhe ka filluar procedura e “forcimit të respektimit”.

Në Seancën e 48-të Plenare, Komiteti Moneyval në Këshillin e Europës, i cili pasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga autoritetet Shqiptare për daljen nga procedura e monitorimit të vazhdueshëm dhe bazuar në raportin/sugjerimet e Sekretariatit të Moneyval, vendosi heqjen e vendit tonë nga lista e vendeve anëtare që janë subjekt i këtij procesi.

Zbatimi i kuadrit ligjor si dhe rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, ka forcuar sigurinë e kufijve dhe ka ndihmuar në reduktimin e trafikimit. Për parandalimin e pastrimit të parave, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit të sistemit parandalues dhe shkallës së përafrimit me standardet ndërkombëtare. Janë përmirësuar ndjeshëm. Nga strukturat përkatëse janë bërë përpjekje të vazhdueshme për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në atë ndërkombëtar, për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të subjekteve dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre, si edhe për forcimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme.

I.3 Struktura e kapitullit

1. KUFIJTË E JASHTËM
2. MIGRACIONI
3. POLITIKA E VIZAVE
4. AZILI
5. BASHKËPUNIMI POLICOR DHE LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR
6. LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT
7. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR DROGËS
8. SISTEMI DOGANOR (referuar në kapitullin 29)

9. BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe legjislacionit të BE-së

MSA:
Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, përcaktohet në Nenin 70 të MSA-së. Disa dispozita të tjera të MSA-së lidhur me marrëdhëniet me jashtë, drejtësi dhe punë të brendshme janë të përcaktuara edhe në Nenet 4, 78, 80, 81, 82, 83, 84 dhe 85. Bashkëpunimi në fushën e menaxhimit të kufijve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Gjithashtu, bashkëpunimi në fushën e migracionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4, 80 dhe 81 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Bashkëpunimi në fushën e politikës së vizave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, është parashikuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Bashkëpunimi në fushën e azilit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, është parashikuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ku përcaktohet se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në këtë fushë, do të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit të brendshëm,në përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të NeëYork, të vitit 1967, duke siguruar në këtë mënyrë respektimin e parimit të mos-kthimit të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4, 82, 84 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër trafiqeve të paligjshme, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër pastrimit të parave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 4 dhe 82 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Gjithashtu, në Nenet 5, 82 dhe 84 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së në fushën e luftës kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit sigurojnë bashkëpunimin në fushën e luftës kundër drogës. Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim

Asociimit, të parashikuara në nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97. Bashkëpunimi në fushën e çështjeve penale është përcaktuar në Nenin 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Legjislacioni relevant i BE-së.

Në vijim të hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë rregullohet nga Kapitulli V-të i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (Neni 67-89). Për më tepër, Karta e të Drejtave Themelore është bërë e detyrueshme dhe Bashkimi Evropian, sipas Nenit 6 të Traktatit të Bashkimit Evropian, është në rrugën e anëtarësimit në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Protokolli Nr. 36 i Traktateve Themelore rregullon statusin e legjislacionit para-Lisbonës që është miratuar në kuadrin e ish Shtyllës së Tretë të Bashkimit Evropian. Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë e përbën legjislacionin sekondar në tre fusha kryesore: Imigracioni, Vizat dhe Azili; Bashkëpunimi Gjyqësor dhe Policor në Çështjet Kriminale dhe Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Civile. Dy fushat e para dominohen nga direktivat dhe vendimet kuadër, ndërsa e fundit përmban rregullore direkt të aplikueshme. Listat e mëposhtme nuk janë të plota. Legjislacioni primar dhe sekondar është i plotësuar nga një volum i madh i praktikave gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Migrimi, Vizat dhe Azili:

- Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare;
- Rregullorja (BE) nr. 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e vendeve anëtare përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare të dorëzuar në një nga vendet anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë ose nga një person pa shtetësi;
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 343/2003 e datës 18 shkurt 2003 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e vendeve anëtare përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve për azil të dorëzuar në një nga vendet anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë ose nga një person pa shtetësi;
- Rregullorja (KE) nr. 1560/2003 e datës 2 shtator 2003 e cila përcakton rregulla të detajuara për aplikimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 343/2003 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin vendin anëtar përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për azil të dorëzuar në një nga vendet anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë;
- Rregullorja Implementuese e Komisionit (KE) nr. 118/2014 e 30 janar 2014 që amendon Rregulloren e (KE) nr. 1560/2003 parashtron rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 343/2003 mbi vendosjen e kritereve dhe mekanizmave për

përcaktimin e shtetit anëtar përgjegjës për shqyrtimin e një kërkese për azil dorëzuar në një nga vendet anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë;

- Rregullorja (KE) nr. 862/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 mbi statistikat e Komunitetit mbi emigrimin dhe mbrojtjen ndërkombëtare dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (ËC) Nr. 311/76 mbi hartimin e statistikave për punëtorët e huaj,
- Direktiva e Këshillit 2003/86/KE e datës 22 shtator 2003 mbi të drejtën për bashkim familjar;
- Direktiva e Këshillit 2009/50/KE e datës 25 maj 2009 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimin e qytetarëve të vendeve të treta, për qëllim të punësimit të kualifikimit të lartë;
- Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të qytetarëve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda korporatës;
- Direktiva 2011/98/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi procedurën e aplikimit të vetëm për një leje të vetme për qytetarët e vendeve të treta për të punuar dhe qëndruar në një vend anëtar dhe mbi një set të përbashkët të drejtash për punëtorët e vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në një vend anëtar;
- Direktiva e Këshillit 2003/109/KE e datës 25 nëntor 2003 që lidhet me statusin e qytetarëve të vendeve të treta të cilët janë rezidentë afatgjatë;
- Konventa zbatuese e marrëveshjes Schengen;
- Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi standardet për kualifikimin e qytetarëve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues st mbrojtjes ndërkombëtare, për një status të unifikuar për refugjatët ose për personat që kualifikohen për mbrojtje suplementare dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë;
- Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të qytetarëve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punëtorë sezonalë;
- Direktiva e Këshillit 2005/85/KE e datës 1 dhjetor 2005 mbi minimumin e standardeve të procedurave në vendet anëtare për dhënien dhe tërheqjen e statusit të refugjatit;
- Direktiva e Këshillit 2001/55/KE e datës 20 korrik 2001 mbi minimumin e standardeve për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rast të një fluksi hyrës masiv të personave të zhvendosur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh mes shteteve anëtare në marrjen e këtyre personave dhe mbajtjen e pasojave që e shoqërojnë;
- Direktiva 2008/115/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet anëtare për kthimin e qytetarëve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë jo ligjore;
- Rregullorja (KE) nr. 810/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 që përcakton një kod komunitar për vizat (kodi i vizave);

- Rregullorja (KE) nr. 863/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 që përcakton një mekanizëm për krijimin e Skuadrave të Ndërhyrjes së Shpejtë Kufitare dhe Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2007/2004 që lidhet me këtë mekanizëm dhe që rregullon detyrat dhe kompetencat e oficerëve të ftuar;
- Vendimi i Këshillit 2010/252/BE i datës 26 prill 2010 si suplement i Kodit Schengen të Kufijve përsa i përket survejimit të kufijve të jashtëm detar në kontekstin e bashkëpunimit operacional të koordinuar nga Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në kufijtë e jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian;
- Rregullorja (KE) nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 Mars 2006 që përcakton një kod Komunitar mbi rregullat e lëvizjes së personave nëpërmjet kufijve (Kodi Schengen i Kufijve);
- Direktiva 2008/115 /KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt;
- Direktiva e Këshillit 2005/71/KE e datës 12 tetor 2005 mbi procedurat specifike për pranimin e qytetarëve të vendeve të treta për qëllime të kërkimit shkencor;
- Direktiva e Këshillit 2004/82/KE e datës 29 prill 2004 mbi detyrimin për të komunikuar të dhënat e pasagjerëve;
- Vendimi Kuadër i Këshillit të çështjeve të brendshme dhe drejtësisë 2002/946/ i datës 28 nëntor 2002 mbi forcimin e kuadrit penal për të shtrënguar ndalimin e hyrjes së paautorizuar, transitit dhe rezidencës;
- Direktiva 2014/42KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 Prilll 2014 "Mbi ngrirjen dhe konfiskimin e përfitimeve dhe produkteve të veprës penale në Bashkimin Evropian**".**
- Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 maj 2014, "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes";
- Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punonjës sezonal";
- Rregullorja (BE) 2016/399 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 9 mars 2016, "Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)".

Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështje Penale

- Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/DÇB i datës 25 tetor 2004 që përcakton dispozitat bazë për elementët përbërës të akteve kriminale dhe penaliteteve në fushën e trafikimit të drogës;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2003/568/DÇB i datës 22 korrik 2003 për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 475/2002/DÇB i datës 13 qershor 2002 për luftën kundër terrorizmit;

- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave;
- Direktiva 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 për luftën ndaj abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë;
- Direktiva 2013/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 gusht 2013 për sulmet ndaj sistemeve të informacionit;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 465/2002/DÇB i datës 13 qershor 2002 për ekipet e përbashkëta hetimore;
- Direktiva e Këshillit 2004/80/KE e datës 29 prill 2004 për kompensimin e viktimave të krimit;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/212/DÇB i 24 shkurtit 2005 për konfiskimin e të ardhurave, instrumenteve dhe pasurive me origjinë kriminale;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/214/DÇB i datës 24 shkurt 2005 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjelltë të penaliteteve financiare;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2006/783/DÇB i datës 6 tetor 2006 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjelltë të urdhrave të konfiskimit;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/584/DÇB i datës 13 qershor 2002 për mandat-arrestin evropian dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shteteve Anëtare;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2003/577/DÇB i datës 22 korrik 2003 për ekzekutimin në Bashkimin Evropian të të ardhurave për ngrirjen e pasurive apo provave;
- Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 për urdhrin evropian të mbrojtjes;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/978/DÇB i datës 18 dhjetor 2008 për mandatin evropian të provës për qëllime të marrjes së objekteve, dokumenteve dhe të dhënave që të përdoren në çështje penale;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2009/829/DÇB i datës 23 tetor 2009 për aplikimin, ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, të parimit të njohjes së ndërsjelltë të vendimeve për masat mbikëqyrëse si alternativë ndaj arrestimit me burg;
- Direktiva 2014/41/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014 për Urdhrin Evropian Hetimor për çështje penale;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/947/DÇB i datës 27 nëntor 2008 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe dënimeve alternative (shërbim prove), në funksion të mbikëqyrjes së masave dhe sanksioneve alternative;
- Direktiva 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014 për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/909/DÇB i datës 27 nëntor 2008 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve në çështje penale që imponojnë vendime izolimi ose masa për privim lirie me qëllim ekzekutimin e tyre në Bashkimin Evropian;
- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet bazë për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;

- Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 për të drejtën e përkthimit me gojë dhe shkrim në procedime penale;
- Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 për të drejtën e informimit në procedime penale;
- Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013 për të drejtën e mbrojtjes me avokat në procedime penale dhe në procedimet e mandat-arrestin evropian, si edhe për të drejtën për të informuar një palë të tretë për privimin e lirisë dhe për të komunikuar me palë të treta dhe autoritetet konsullore gjatë kohës së privimit të lirisë;
- Direktiva 2014/62/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 për mbrojtjen e euros dhe monedhave të tjera ndaj falsifikimit me të drejtë penale;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/841/DÇB i datës 24 tetor 2008 për luftën kundër krimit të organizuar.

Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështje Civile

- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 44/2001 e datës 22 dhjetor 2000 për juridiksionin si dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare;
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2201/2003 e datës 27 nëntor 2003 për juridiksionin si dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështje martesore dhe çështjet e përgjegjësisë prindërore;
- Direktiva e Këshillit 2002/8/KE e datës 27 janar 2003 për përmirësimin e aksesit në drejtësi në mosmarrëveshje ndërkufitare, duke vendosur rregulla të përbashkëta bazë në lidhje me ndihmën juridike për këto mosmarrëveshje;
- Rregullorja (BE) nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 dhjetor 2012 për juridiksionin si dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare;
- Rregullorja (KE) nr. 593/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 qershor 2008 për legjislacionin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore (Romë I);
- Rregullorja (KE) nr. 1896/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 dhjetor 2006 që krijon urdhrin evropian për procedurën e pagimit;
- Rregullorja (KE) nr. 805/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004 për krijimin e Urdhër-Ekzekutimit Evropian për pretendimet e paankimuara;
- Rregullorja (KE) nr. 861/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 që përcakton Procedurën Evropiane për Pretendimet e Vogla;
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1206/2001 e datës 28 maj 2001 për bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare në marrjen e provave në çështje civile dhe tregtare;

- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 4/2009 e datës 18 dhjetor 2008 për juridiksionin, legjislacionin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si dhe bashkëpunimin në çështje që lidhen me detyrimet ushqimore;
- Rregullorja (BE) nr. 650/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 qershor 2012 për juridiksionin, legjislacionin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si edhe pranimin dhe ekzekutimin e instrumenteve autentike në çështje të trashëgimisë dhe në krijimin e Certifikatës Evropiane të Trashëgimisë;
- Rregullorja (KE) nr. 1393/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 nëntor 2007 për dorëzimin në Shtetet Anëtare të dokumenteve gjyqësore dhe ekstragjyqësore në lidhje me çështje civile apo tregtare (dorëzimi i dokumenteve);
- Rregullorja (KE) nr. 864/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 për legjislacionin e zbatueshëm për detyrimet jokontraktore (Romë II);
- Rekomandim i Komisionit i datës 4 prill 2001 për parimet e organeve jashtëgjyqësore të përfshira në zgjidhjen konsensuale të mosmarrëveshjeve konsumatore.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Shqipëria po vazhdon përafrimin e ligjeve të saj me *acquis* e BE-së të Kapitullit 24. Arritjet e fundit janë listuar si më poshtë:

Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror Nr. 9861, datë 24.01.2008, është i përafruar pjesshëm me:

- Rregulloren (KE) Nr. 562/2006 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian që vendos një Kod të Përbashkët mbi rregullat që mbizotërojnë në lëvizjen e personave ne pikat kufitare (Kodi Kufitar i Schengen).

Ligji Nr. 108/2013 “Për të huajt”, datë 28.3.2013 është përputhur pjesërisht me:

- Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Nr. 810/2009, datë 13 qershor 2009 "Mbi ngritjen e Kodit të Komunitetit mbi vizat".
- Direktivën 2009/52/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 qershor 2008, "Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve për punonjësit nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm".
- Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, "Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar".

- Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, "Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt".
- Direktivën e Këshillit 2005/71/KE, datë 12 tetor 2005, "Mbi procedurat specifike për pranimin e shtetasve të vendeve të treta për qëllime të kërkimeve shkencore".
- Direktivën e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004 "Për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët".
- Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004 "Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente".
- Direktivën e Këshillit 2004/114/KE, datë 13 dhjetor 2004, "Mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim studimi, programe të shkëmbimit për nxënës, trajnim pa pagesë ose shërbim vullnetar".
- Direktivën e Këshillit 2003/109/KE, datë 25 nëntor 2003 në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë,
- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003 "Mbi të drejtën e bashkimit familjar".
- Vendimin Kuadër të Këshillit, 2002/946/DÇB, datë 28 nëntor 2002 "Për forcimin e kuadrit penal me qëllim forcimin e ndalimit të hyrjeve të paautorizuara, transitit dhe qëndrimit".

Ligji Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” është përafruar plotësisht, (përjashtuar dispozitat që u referohen vendeve anëtare të BE-së) është përafruar pjesërisht me:

- Rregulloren 2016/399 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen).

Ligj Nr. 74/2016 “për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt”

- Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nr. 810/2009 datë 13 qershor 2009 “Mbi ngritjen e Kodit të Komunitetit mbi vizat”,
- Direktivën 2009/52/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 qershor 2008 “Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve për punonjësit nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm”.
- Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009 “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”.
- Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2008 “Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet e anëtare për kthimin shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt”.

- Direktivën e Këshillit 2005/71/KE, datë 12 tetor 2005 “Mbi procedurat specifike për pranimin e shtetasve të vendeve të treta për qëllime të kërkimeve shkencore”.
- Direktivën e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004 “Për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët”.
- Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004 “Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente”.
- Direktivën e Këshillit 2004/114/KE, datë 13 dhjetor 2004 “Mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim studimi, programe të shkëmbimit për nxënës, trajnim pa pagesë ose shërbim vullnetar”.
- Direktivën e Këshillit 2003/109/KE, datë 25 nëntor 2003 në lidhje me statusin shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë.
- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003 “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”.
- Vendimin Kuadër të Këshillit, 2002/946/DÇB, datë 28 nëntor 2002 “Për forcimin e kuadrit penal me qëllim forcimin e ndalimit të hyrjeve të paautorizuara, transitit dhe qëndrimit”.
- Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000 që vendos një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion.
- Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 Maj 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes,
- Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 26 Shkurt 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punonjës sezonal,
- Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009 “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”,
- Direktivën 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetori 1996 në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve.

“Ligji nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, është i përafruar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001, "Standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh ndërmjet shteteve anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përballimin e pasojave".
- Direktivën e Këshillit 2003/9/KE, datë 27 janar 2003 "Për përcaktimin e standardeve minimale për pritjen e azilkërkuesve".

- Direktivën e Këshillit 2003/86/ KE, datë 22 shtator 2003, "Mbi të drejtën e bashkimit familjarDirektivën e Këshillit 2005/85/KE, datë 1 dhjetor 2005, "Për përcaktimin e standardeve minimale të procedurave në shtetet anëtare për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit"..
- Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2011/95/BE, datë 13 dhjetor 2011 "Standardet për cilësimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët dhe për personat e pranueshëm për mbrojtje plotësuese dhe përmbajtja e mbrojtjes së dhënë".

Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar

- Direktiva 2005/60/KE e Parlamenti Evropian dhe e Këshillit e datës 26 Tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar me qëllim pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.
- Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit datë 27 Dhjetor 2001 mbi luftën kundër terrorizmit.
- Vendimi i Këshillit 2000/642/DÇB në lidhje me dispozitat për bashkëpunim midis drejtorisë së inteligjencës financiare të Shteteve Anëtare në lidhje me shkëmbimin e informacioneve.
- Vendimi kuadër i Këshillit 2005/212/DÇB datë 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e të ardhurave kriminale, instrumenteve dhe pronave.
- Vendimi i Këshillit 2007/845/DBÇ datë 6 Dhjetor 2007 në lidhje me bashkëpunimin midis Zyrës së Konfiskimit të Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimin e llojit të produkteve, apo pronave të tjera në lidhje me krimin.

Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", është pjesërisht i përafruar me:

- Vendimin e Përbashkët të Këshillit të datës 27 Dhjetor 2001 mbi luftimin e terrorizmit,
- Vendimin kuadër të Këshillit 2002/475/DBÇ të datës 13 Qershor 2002 mbi luftimin e terrorizmit,
- Vendimin kuadër të Këshillit të datës 28 Maj 2001 mbi luftimin e evazionit dhe falsifikimin e mjeteve jo-monetare të pagesave,
- Vendimin kuadër të Këshillit të datës 26 Qershor 2001 mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit,
- Vendimin kuadër të Këshillit 2002/475/DBÇ të datës 13 Qershor 2002 mbi luftën kundër terrorizmit,
- Vendimin e Këshillit 2005/671/DBÇ të datës 20 Shtator 2005 mbi shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin në lidhje me kundërvajtjet e terrorizmit,
- Vendimin kuadër të Këshillit 2006/783/DBÇ të datës 6 Tetor 2006 mbi aplikimin e njohjes së përbashkët të urdhrave të konfiskimit,
- Vendimin kuadër të Këshillit të datës 28 Maj 2001 mbi luftën kundër evazionit dhe falsifikimin e mjeteve jo-monetare të pagesave.

Ligji Nr.157/2013, datë 10.10.2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit". Ky ligj është i përafruar pjesërisht me legjislacionin e BE-së:

- Vendimin e Këshillit 2007/845/DBÇ datë 6 Dhjetor 2007 në lidhje me bashkëpunimin midis Zyrës së Konfiskimit të Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimin e llojit të produkteve, apo pronave të tjera në lidhje me krimin,
- Vendimin kuadër të Këshillit 2005/212/DÇB e datës 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e të ardhurave kriminale, instrumenteve dhe pronave.
- Ligj Nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" është pjesërisht i përafruar me:
- Directiva 2011/36/EU, e datës 5 Prill 2001, për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave.
- Vendim Kuadër 2003/577/DÇB i datës 22 Korrik, 2003 mbi ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave të ngrirjes së pronës ose provës.
- Vendim Kuadër 2006/783/ DÇB i datës 6 tetor 2006 mbi aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të urdhrave të konfiskimit.
- Vendim Kuadër 2009/299/ DÇB i datës 26 shkurt 2009 i cili amendon Vendimin Kuadër 2002/584/FZ, 2005/214/FZ, 2006/783/FZ, 2008/909/FL dhe 2008/947/FZ, duke rritur të drejtat procedurale të personave dhe nxitjen e zbatimit të parimit të njohjes së ndërsjellë për vendimet e dhëna në mungesë të personit të interesuar në gjyq.
- Direktiva 2005/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime pastrimi parash dhe financim terrorizmi.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucioni përgjegjës për këtë kapitull, është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në Shqipëri dhe është e përbërë nga strukturat e mëposhtme:

- Policia e Shtetit (DPSH)
- Drejtoria e Azilit
- Drejtoria e Antitrafikut

Institucionet e përfshira janë:

- Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave)

- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- Ministria e Punëve të Jashtme (Shërbimi Konsullor)
- Ministria e Mbrojtjes (Forca Detare/ Roja Bregdetare)
- Qendra Ndër-operacionale Detare (Ministria e Mbrojtjes)
- Prokuroria e Përgjithshme
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- Shërbimi Informativ Shtetëror
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- INSTAT

II.4 Parashikimet financiare

Për Drejtorinë e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Hetimin e Krimeve

Numri i punonjësve dhe kostoja për vitet 2016; 2017; 2018 dhe 2019:

Nr	2016	2017	2018	2019
Nr. i punonjësve	1,424	1,424	1,424	1,424
Paga dhe shpenzime personeli	2,078,900	2,166,571	2,166,571	2,166,571
Sigurimet Shoqërore	325,209	332,276	332,276	332,276
Totali	2,404,109	2,498,847	2,498,847	2,498,847

Për Drejtorinë e Antiterrorit

Numri i punonjësve dhe kostoja për vitet 2016; 2017; 2018 dhe 2019:

Nr.	2016	2017	2018	2019
Nr. punonjësve	74	86	86	86
Paga dhe shpenzime personeli	72.327	84.055	84.055	84.055

Sigurime Shoqërore	**11.600**	**13.481**	**13.481**	**13.481**
Totali	**83.927**	**97.536**	**97.536**	**97.536**

Për Drejtorinë e Përgjithshme tëë Kufirit dhe Migracionit

Numri i punonjësve dhe kostoja për vitet 2016; 2017; 2018 dhe 2019:

Nr.	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**
Nr. punonjësve	**1653**	**1653**	**1653**	**1653**
Paga dhe shpenzime personeli	**1,684,084**	**1,684,084**	**1,935,167**	**1,935,167**
Sigurime Shoqërore	**281,242**	**281,242**	**323,173**	**323,173**
Totali	**1,965,326**	**1,965,326**	**2,258,340**	**2,258,340**

III. Prioritetet

Në kuadër të Pregres Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2016, prioritet mbetet:

- Rritja e numrit të hetimeve të bazuar në informacionin sekret dhe hetimet financiare për pastrimin e parave dhe trafikimin e drogës si dhe rritja e konfiskimit të pasurisë së fituar në rrugë kriminale;
- Rritja e kapaciteteve operacionale dhe logjistike të Drejtorisë së Anti-Terrorit, veçanërisht për sa i përket investigimeve speciale dhe operacioneve siç janë mbikëqyrja dhe përgjimet;
- Progres i mëtejshëm në ngritjen e një historiku solid të investigimeve, ndjekjeve dhe dënimeve në luftën kundër krimit të organizuar;
- Të ndërmerren veprime të menjëhershme dhe të vendosura, duke përfshirë edhe mekanizmin e monitorimit të procesit pas liberalizimit të vizave, për të adresuar efektivisht aplikimet e pabazuara të azilit në BE dhe të përmirësohet më tej kapaciteti i saj për tu marrë me flukset e përziera të migracionit.

Prioritetet kryesore për Kapitullin 24 të bazuara mbi dokumentet strategjikë dhe progres raportet:

- Duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve të përfshira në menaxhimin e kufirit blu dhe të gjelbër duhet të sigurohet qëndrueshmëria financiare e mekanizmave të mbikëqyrjes;
- Të forcohet koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve që bëjnë pjesë në QNOD, dhe asetet dhe kapicitetet operacionale të vëna në dispozicion të QNOD-së të mbahen në gatishmëri;
- Të përmirësohet harmonizimi i statistikave institucionale në lidhje me vijimësinë e rezultateve të hetimeve, ndjekjeve penale dhe

dënimeve. Shqipëria duhet të miratojë një Strategji dhe Plan Veprimi të përforcuar për Migracionin, duke marrë në konsideratë mësimet e dala nga zbatimi i Strategjisë së mëparshme.

- Policia e Kufirit dhe Migracionit duhet të tregojë vëmendje të veçantë kundër-korrupsionit, analizës së riskut dhe bashkëpunimit të përmirësuar me njësitë e tjera të zbatimit të ligjit;
- QNOD në bashkëpunim me institucionet pjesëmarrëse te koordinojnë punën për përzgjedhjen e informacionit për realizimin e analizës se riskut;
- Lëshimi i dokumenteve të reja të identitetit për të huajt duhet të rishikohen dhe monitorohen;
- Forcimin e masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve në parametrat e vendeve të BE-së;
- Forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e migracionit;
- Krijimin e një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe të harmonizuar me standardet e BE-së dhe Rregullores Schengen,të përafrohet plotësisht me standardet e BE-së qarkullimi i mallrave, mjeteve dhe udhëtarëve në kufi, duke garantuar lehtësi për tregtinë e ligjshme dhe kufij të sigurtë;
- Të rritet kapaciteti i punës së laboratorit të kriminalistikës, sidomos për interpretimin e ADN-së, data bazën e ADN-së;
- Zbatimi i ligjit për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurise;
- Të fuqizohet më tej bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Agjencive të tjera të zbatimit të ligjit brenda dhe jashtë vendit;
- Sigurimi i të dhënave dhe statistikave që mundësojnë vlerësimin e progresit në luftën kundër krimit të organizuar dhe track-recordet aktuale duhet të përmirësohen dhe të harmonizohen sipas standardeve Evropiane;
- Niveli dhe eficenca e hetimeve duhet të rritet dhe duhet të çojë në krijimin e një *trackrecord-i* solid dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë. Duhet të përdoren mundësitë dhe mjetet e siguruara nga Ligji Anti-mafia për kapjen dhe konfiskimin e aseteve kriminale;
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore duhet të zbatohet nëpërmjet një qasjeje holistike dhe ndërdisiplinore;
- Përpjekjet në luftën kundër drogës duhet të vazhdojnë më tej duke u mbështetur në analizën e rreziqeve, hetimet pro aktive si dhe në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe atë ndërkombëtar përfshirë zbatimin efektiv të Planit për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike;
- Menaxhimi i azilit drejt një sistemi më efektiv dhe të qëndrueshëm i cili duhet të sigurojë koordinimin e duhur edhe menaxhimin e tij dhe pajisja e refugjatëve me karta identiteti dhe dokumente udhëtimi;
- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional, me agjencitë dhe institucionet e përfshira në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

- Bashkëpunimi me institucione dhe agjenci të tjera shtetërore për të bërë të mundur zgjerimin e aksesit në ato databaza të cilat janë të nevojshme në kuadër të analizës dhe shpërndarjes së informacionit për agjencitë e zbatimit të ligjit;
- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit me standardet ndërkombëtare të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar dhe Acquis e BE-së; Vlerësimi përputhshmërisë së legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit me direktivën e BE Nr. 2015/849 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian e datës 20 Maj 2015.
- Rritja e bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse/licencuese të subjekteve të ligjit në drejtim të rritjes së përputhshmërisë së këtyre të fundit me legjislacionin në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Forcimi i sistemit parandalues për rritjen dhe përmirësimin e raportimit të transaksioneve të dyshimta;
- Në rritjen e rezultateve në goditjen e krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike, për shkak të natyrës së tyre, veprimet hetimore duhet të kryhen vetëm nga njësi të specializuara të policisë, të cilat të jenë në gjendje të kryejnë veprime hetimore njëkohësisht në disa pjesë të territorit, të koordinojnë me agjenci të huaja të zbatimit të ligjit, të përdorin metodat speciale të hetimit si dhe të disponojnë kapacitetet e duhura njerëzore dhe teknike për shkak të kompleksitetit që shfaq hetimi i krimit të organizuar;
- Krijimi i një track – recordi të qëndrueshëm të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale, dënimeve, përfshirë edhe goditjen e rrjeteve të krimit të organizuar;
- Amendimi i legjislacionit përkatës në fushën e përgjimeve dhe mbikqyrjen, kohën e hetimeve dhe ruajtjen e provave për të rritur efektivitetin e hetimeve në luftën kundër krimit të organizuar në perputhje me standardet europiane dhe praktikat më të mira;
- Ndjekja e një politike efektive për burimet njerëzore bazuar në meritat dhe kjo të aplikohet në radhët e Policisë së Shtetit si dhe alokimin e mjaftueshëm të këtyre burimeve në polici dhe prokurori; Ndërprerja e aktiviteteve të rrjeteve dhe individëve që tërheqin njerëz në terrorizëm.
- Angazhimi i komunitetit në kundërvënie ndaj mesazhit të ekstremizmit të\ dhunshëm.
- Mbështetja e individëve që gjykohet se janë ekspozuar ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit.
- Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.
- Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, ruajtjes, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit.
- Forcimi i masave në luftën kundër financimit të terrorizmit.
- Zvogëlimi i kërcënimit nga aktet e mundshme terroriste në vend, apo nëpërmjet vendit tonë.
- Bashkëpunimin në dimensionin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit.
- Mbrojtja e infrastrukturës kritike të vendit nga aktet e mundshme terroriste.
- Forcimi i masave në kontrollin kufitar për monitorimin e individëve të dyshuar për veprimtari që lidhen me terrorizmin.

Realizimi i këtyre prioriteteve do të synojnë:

- Nxitjen e hetimeve proaktive: objektivi është nxitja e strukturave të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunimi i ngushtë me to për të mundësuar rritjen e kapaciteteve për të përballuar një numër më të lartë të hetimeve proaktive;
- Përsosjen e metodave të hetimeve: objektivi është nxitja e bashkëpunimit me policinë gjyqësore në drejtim të përdorimit me sukses të teknikave speciale të hetimeve;
- Rritja e rezultateve në hetimin e aseteve kriminale: Si mjet i rëndësishëm në goditjen e krimit të organizuar konsiderohet zbatimi i ligjit "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit përmes masave parandaluese kundër pasurisë", zgjerimi i hetimeve praaktive në këtë fushë.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2019

IV.1 Kufijtë e jashtëm

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit Policia e Kufirit dhe Migracionit dhe institucionet kontribuese	2014 – 2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullore 562/2006/KE	Ligji Nr. 9861, datë 24.01.2008, "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror".	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit Policia e Kufirit dhe Migracionit	I Pjesshëm	24.01.2008	11.02.2008
Rregullore 562/2006/KE	VKM Nr. 1018, datë 30.09.2009, "Për përcaktimin e standardeve dhe kritereve në Pikat e Kalimit të Kufirit, në Republikën e Shqipërisë".	Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Shtetit Policia e Kufirit dhe Migracionit	I Pjesshëm	30.09.2009	20.11.2009

Direktiva 2002/59/KE	Ligji Nr. 8875, datë 04.04.2002, "Për Rojen Bregdetare Shqiptare" (i ndryshuar).	Ministria e Mbrojtjes dhe Roja Bregdetare	I Pjesshëm	04.04.2002	04.04.2002
	VKM Nr. 606, datë 04.12.2002, "Për Miratimin e Manualit të RojesBregdetare Shqiptare".	Ministria e Mbrojtjes dhe Roja Bregdetare	I Pjesshëm	04.12.2002	04.12.2002
	Vendim Nr. 954, datë 30.09.2009, "Për organizimin, strukturën, funksionimin e QNOD dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det", i ndryshuar.	Ministria e Mbrojtjes dhe QNOD	I Pjesshëm	30.09.2009	30.09.2009
	Ligj Nr. 10435, datë 23.06.2011, "Për Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë".	Forcat Detare dhe Roja Bregdetare	I Pjesshëm	23.06.2011	23.06.2011
Rekomandimi 83/419/ KEE	VKM Nr. 742, datë 16.10.2012, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit".	Ministria e Mbrojtjes dhe Roja Bregdetare	I Pjesshëm	16.10.2012	16.10.2012
Rregullore 4055/86/KEE	Ligji Nr. 8875, datë 04.04.2002, "Për Rojen Bregdetare Shqiptare", (i ndryshuar).	Ministria e Mbrojtjes dhe Roja Bregdetare	I Pjesshëm	04.04.2002	04.04.2002
Kapitulli 25 "Shkenca dhe kërkimi shkencor", duke iu referuar kapitullit përkatës të *Acquis Communitaire*(*AC*) pasqyron nismat strategjike dhe ligjore të ndërmarra në vend në kuadër të nxitjes, mbështetjes dhe financimit të shkencës, jep kuadrin ligjor në fuqi dhe parashikon angazhimet ligjore, institucionale e financiare që duhet të përmbushen për të garantuar në nivel kombëtar standardin e nevojshëm të institucioneve të kërkimit shkencor, që të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive e të suksesshme në Programet Kuadër të BE-së, për Kërkimin Shkencor e Inovacionin, Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (*ERA*), si dhe në format e ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës.

Në parim, *Acquis Communitaire* në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor nuk kërkon përafrimin (*transposition*) e legjislacionit kombëtar me rregullat e BE-së. Megjithatë, zbatimi me sukses i *Acquis* në këtë fushë përfshin plotësimin e kushteve të nevojshme që bëjnë të mundur rritjen e kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore në kërkimin shkencor, duke synuar bashkërendimin e duhur me parimet dhe orientimet e BE-së në këtë sektor.

Në këtë kuadër përfshihet synimi që çdo vend:

a) të rrisë në mënyrë të përshkallëzuar shpenzimet për kërkimin shkencor e zhvillim deri në 2% të GDP-së brenda vitit 2020,
b) të nxisë qendrat e ekselencës së kërkimit shkencor në bazë të parimit të një specializimi të zgjuar (*smart specialization*),
c) të financojë kërkimin shkencor në përputhje me kriteret ndërkombëtare të vlerësimit të cilësisë së kërkimit shkencor,
d) të mbështesë politikat e shkencës së hapur (*open science*) dhe marrje informacioni (*open access*) mbi rezultatet e botimeve shkencore që financohen nga fondet publike,
e) të garantojë një sistem të saktë e të besueshëm të statistikave për nivelin e investimeve publike e private për kërkim shkencor & zhvillim,
f) të lehtësojë procedurat ligjore e administrative për qarkullimin dhe punësimin e studiuesve të huaj në Shqipëri,
g) të ndihmojë përmes veprimtarive në këtë fushë për arritjen e objektivave të BE-së për Unionin e Novacionit.

I.2 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është një vend i vogël, nga pikëpamja e popullsisë, me nivel relativisht të ulët të të ardhurave edhe pas dy dekadave të një rritjeje të qëndrueshme. Ndërsa ka një progres të dukshëm në ristrukturimin e ekonomisë dhe rritjen e produktivitetit, aftësia konkurruese e saj është ende e ulët dhe e mbështetur më tepër në kostot e faktorëve (puna), sesa në një vlerë të shtuar. Shqipëria ka aktualisht rreth 430 biznese të mëdha, 1580 biznese të mesme dhe rreth 85 mijë biznese të vogla. Përbërja sektoriale anon më tepër drejt veprimtarive me teknologji të ulët (punësimi në bujqësi mbetet relativisht i lartë) dhe eksportet janë të ulëta në terma absolute e relative. Për të mundësuar një rregullim strukturor drejt veprimtarive me më tepër dije dhe vlerë të shtuar është e domosdoshme një politikë efektive në shkencë, teknologji dhe inovacion, në mënyrë që të plotësohen masat e tjera që mbështesin modernizimin e ekonomisë. Në mesin e viteve '90, qeveria shqiptare miratoi një kuadër ligjor që rregullonte veprimtarinë e institucioneve kërkimore–shkencore, i cili kishte në qendër të tij Ligjin nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për Shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik". Gjatë periudhës 1990-2005, kuadri ligjor për kërkimin shkencor e zhvillimin teknologjik u përqendrua tek ky ligj.

Pas vitit '90 kërkimi shkencor u zhvillua përreth sistemit të 12 instituteve kërkimore në vartësi të Akademisë së Shkencave, rreth 30 instituteve e qendrave kërkimore në vartësi të ministrive të linjës dhe 14 universiteteve publike. Pas vitit 2000 në Shqipëri filluan veprimtarinë universitetet jo-publike, që iu shtuan sistemit institucional të kërkimit shkencor në Shqipëri. Ndërkohë mungon një informacion i plotë lidhur me veprimtarinë kërkimore shkencore në sektorin e biznesit privat, veçanërisht atë prodhues, qoftë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (*SME*) apo kompani të mëdha. Qeveria shqiptare e dalë nga zgjedhjet e 29 Qershorit 2005, në vitin 2006 ndërmori një reformë të sistemit të kërkimit shkencor dhe

emëroi një grup ekspertësh nga komuniteti akademik, i cili mbi bazën e një vlerësimi të thelluar hartoi një platformë për reformën e sistemit të kërkimit shkencor. Sugjerimet e grupit të ekspertëve u pasqyruan me hollësi nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH) dhe mbi këtë bazë, qeveria mori një sërë vendimesh për riorganizimin e rrjetit të institucioneve të kërkimit shkencor:

a) Akademia e Shkencave me 12 institute kërkimore vartëse që prej vitit 1972 u riorganizua duke funksionuar si një bashkësi e zgjedhur shkencëtarësh, të organizuar në seksionet e shkencave humane e natyrore, si një institucion (*honorific*) me financim nga buxheti i shtetit, por që nuk administronte më institute kërkimore.

b) Institutet kërkimore të Akademisë së Shkencave u shkëputën prej saj dhe u përfshinë në sistemin e arsimit të lartë si më poshtë:

1) qendra dhe institute kërkimore ndërdisiplinore:

• Qendra e Studimeve Albanologjike;

• Instituti kërkimor universitar i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) pranë UniversitetitPoliteknik të Tiranës (UPT);

• Instituti kërkimor Universitar i Gjeoshkencave pranë UPT-së (INGJEO).

2) dy fakultete të reja:

• Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit pranë UPT-së,

• Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës(UBT).

3) dy qendra/departamente të reja në përbërje të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës (UT):

• Qendra e Fizikës së Aplikuar dhe Bërthamore;

• Departamenti i Bioteknologjisë.

c) Institutet kërkimore pranë ministrive u riorganizuan dhe mbi bazën e tyre ukrijuan 19 qendra, institute dhe agjenci në varësi të ministrive, që kanë si mision kryesor transferimin e teknologjive e të njohurive, si dhe mbështetjen teknike për hartimin e politikave në fushat përkatëse.

Ndërkohë në shtator 2013, qeveria e re shqiptare e dalë nga zgjedhjet e 23 Qershorit 2013, ngriti Komisionin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, i cili në korrik 2014 nxori "Raportin Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor". Një ndër rekomandimet kryesore ishte miratimi e një ligji të ri për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, që u miratua në

tetor 2015 përmes Ligjit 80/2015. Sistemi aktual i kërkimit shkencor nëvend përfshin institucionet e arsimit të lartë publike dhe jo publike, institutet, qendrat apo agjencitë në vartësi të ministrive të linjës, qendrat kombëtare kërkimore dhe sipërmarrjet private që veprojnë në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe novacionit.

a) Institucionet e arsimit të lartë publike dhe jopublike janë institucione mësimore-kërkimore, që sipas Ligjit 80/2015 kanë si mision arsimin e lartë, kërkimin shkencor, zhvillimin dhe transferimin e njohurive dhe të teknologjisë. Niveli i kërkimit shkencor në universitetet e ndryshme është i ndryshëm. Deri në shtator 2013, Shqipëria kishte 58 institucione të arsimit të lartë, nga të cilat 14 ishin publike dhe 44 ishin private apo jo-publike. Një pjesë e tyre këtyre të fundit u mbyllën nga MAS për shkak tëmos-përmbushjes së kritereve të cilësisë dhe numri i tyre pas procesit të rivlerësimit është 25. Ato kanë një "moshë" shumë të re (shkolla e parë e lartë private ka vetëm 15 vjet veprimtari), megjithëse disa prej tyre kanë filluar të shfaqin potencialin e tyre edhe në fushën e kërkimit.

b) Qendrat kombëtare kërkimore janë institucione kërkimore-mësimore që kanë simision kërkimin shkencor, formimin e thelluar universitar në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, zhvillimin dhe transferimin e njohurive dhe të teknologjisë. Deri tani është ngritur Qendra e Studimeve Albanologjike (QSA) mbi bazën e riorganizimit të instituteve albanologjike të Akademisë së Shkencave.

c) Institutet/Qendrat/Agjencitë publike të kërkimit shkencor, zhvillimit dhe transferimit të teknologjisë në vartësi të Ministrive, kanë për mision kryerjen e studimeve dhe projekteve zhvillimore, si dhe transferimin e njohurive dhe teknologjive në praktikën e prodhimit të produkteve dhe të ofrimit të shërbimeve. Në varësi të ministrive të linjës ekzistojnë institutet/qendrat/agjencitë e mëposhtme:

-6 qendra/institute pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural & Administrimit të Ujërave;
-1 agjenci pranë Ministrisë së Mjedisit;
-2 agjenci/institute pranë Ministrisë së Kulturës;
-2 qendra/agjenci pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës;
-2 qendra/Institute pranë Ministrisë së Shëndetësisë;
-1 institut pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës;
-1 institut pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban;
-1 institut pranë Ministrisë së Drejtësisë;
-1 institut pranë Ministrisë së Brendshme;
-1 qendër pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

ç) Qendrat/agjencitë/institutet dhe sipërmarrjet e tjera private që veprojnë në kërkim, zhvillim dhe transferim të teknologjisë dhe njohurive. Nuk ka të dhëna apo studime që të mundësonin një vlerësim mbi vëllimin e veprimtarisë së novacionit (shpenzimet për novacion, etj.), ose prodhimet në sektorin e ndërmarrjeve (p.sh. shitjet nga produktet dhe shërbimet e reja, etj.).

Aktualisht programet e vetme "financuese të kërkimit shkencor nga buxheti i shtetit" ishin Programet Kombëtare të Kërkim-Zhvillimit (PKKZH), të cilat nga viti 1994-2009 administroheshin nga Drejtoria e Arsimit të Lartë & Shkencës pranë MAS. Ndërsa, që prej vitit 2009 me krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit(AKTI, tani AKKSHI), këto programe financohen dhe menaxhohen nga Drejtoria e Programeve Kombëtare pranë kësaj agjencie. Banka Botërore dhe Programi TEMPUS i BE-së përmes projekteve të veçanta kanë financuar infrastrukturën e kërkimit shkencor, por ende ngelet shumë për të bërë. Përmes një plani afatmesëm (2008-2009) të zbatimit të Programit "Brain Gain", Qeveria shqiptare, për herë të parë, mobilizoi fonde nga buxheti i shtetit dhe hapi rreth 550 vende të reja pune pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor ku u punësuan studiues të ndryshëm që kishin kryer studimet universitare e pasuniversitare jashtë vendit. Nga ana tjetër financimi i kërkimit shkencor prej qeverisë bëhet edhe përmes një numri ministrish të linjës dhe organizatave publike, të angazhuara drejtpërsëdrejti ose jo në veprimtaritë/politikat e kërkimit dhe novacionit.

Ministria e Bujqësisë financon aktivitete në fushën e kërkimit të aplikuar dhe transferimit të teknologjisë në fusha të veçanta, kryesisht në përgjigje të nevojave të komunitetit bujqësor. Aktivitetet janë kryer nga gjashtë qendrat për transferimin e teknologjive bujqësore (QTTB), që varen nga ministria.

Ministria e Mbrojtjes parashikon intensifikimin e veprimtarive të K&ZH për sigurinë dhe mbrojtjen, si pjesë e një plani afatgjatë për zhvillimin e Forcave të Armatosura deri në vitin 2020. Për më tepër, anëtarësimi në NATO nënkupton pjesëmarrjen e komunitetit te kërkuesve shqiptarë, në Programin e NATOS të Shkencës për Siguri e Paqe (PSP).

Ministria e Shëndetësisë ka programin e saj të kërkimit, Institutin e Shëndetit Publik dhe Qendrën Bio-mjekësore, që i shërbejnë përmirësimit të shërbimeve në këtë sektor.

Ministria e Industrisë dhe Energjetikës mbështet dy agjenci të mëdha, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), që kryejnë studime dhe shërbime në fushën e burimeve natyrore, energjisë, shkencave të tokës, etj.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Sipërmarrjes, Tregtisë e Turizmit ka ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Investimeve (AIDA), një Qendër për Ndërmjetësimin e Inovacionit (BRIC), e cila siguron shërbime për ndërmarrjet që lidhen me transferimin e novacionit dhe të teknologjisë.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka një program që jep grante për studime në fushat që mbulon, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit që u krijua nga shkrirja e Institutit të Mjedisit, kryen një sërë studimesh, analizash e vlerësimesh në fushën e mjedisit.

Megjithatë numri i kufizuar i botimeve shkencore, veçanërisht në gjuhë të huaj, apo numri i artikujve në revistat ndërkombëtare shkencore me faktor ndikimi(*impact factor*) të lartë apo treguesit e patentave të regjistruara nga kërkuesit shqiptarë pranë Drejtorisë së Patentave e Markave (DPM), dëshmojnë nivelin ende të ulët të "produktit" të sistemit të kërkimit shkencor në Shqipëri.

Dimensioni ndërkombëtar është jetik për integrimin me shpejtësi të parimeve të ekselencës dhe të kompetencës në Shkencë, Teknologji dhe Inovacion (SHTI) në sistemin kombëtar të kërkimit. Ky mundëson përfshirjen në programet ndërkombëtare të financimit në këtë fushë. Shqipëria ka tashmë përvojë bashkëpunimi ndërkombëtare në fusha të gjera të zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe në arsimin e lartë, p.sh: programet e BE-së për arsimine lartë Tempus, Erasmus. Nga ana tjetër projekti "Cilësi e Barazi në Arsim" (CBA) 2006-2011, i mbështetur nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI), kredia për zhvillimin e arsimit përmes Iniciativës së novacionit 2010 dhe Bankës Botërore, Banka e Këshillit të Evropës (CEB) ishin dëshmi e interesit të organizmave financiarë për zhvillimin e kërkimit shkencor në Shqipëri. Bashkëpunimi në një fushë specifike si shkenca, teknologjia dhe novacioni është ende i kufizuar, megjithëse një numër marrëveshjesh bashkëpunimi dypalëshe për kërkimin shkencor kanë qenë shumë të rëndësishme nga pikëpamja simbolike e financiare, në krijimin e bazës për shkëmbime përvojash dhe krijimin e bashkësive të përbashkëte kërkuesish. Pjesëmarrja e plotë në "Programin e 7-të Kuadër të Zhvillimit dhe Kërkimit të Teknologjisë (FP7)" të BE-së 2007-2013 (që nga 2008) ishte hapi i parë në integrimin gradual në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) që ka hapur perspektivën e financimeve të tjera në sistemin e kërkimit në nivel afatmesëm.

Aktualisht Shqipëria ka në fuqi rreth 21 marrëveshje të bashkëpunimit shkencor dypalësh me vende të ndryshme të rajonit, BE dhe më gjerë, ndërsa aktualisht po zbatohen përmes financimit të projekteve dypalëshe vetëm marrëveshjet me Austrinë dhe Turqinë. Ndërkohë pas përfundimit të Programit të 7-të Kuadër të Zhvillimit dhe Kërkimit të Teknologjisë (FP7) të BE-së 2007-2013, Shqipëria merr pjesë në Programin Kuadër për Kërkimin Shkencor dhe Novacionin*Horizon* 2020 (2014-2020). ShTI-ja synon të japë një kuadër përmes të cilit, forumi shumë-palësh i donatorëve dhe bashkëpunimi dypalësh të mund të ndihmojnë në një mënyrë të strukturuar në fuqizimin e kërkuesve shqiptarë të K&ZH. Përparësie lartë nga pikëpamja e ndërkombëtarizimit është përshtatja graduale e një procesi të ngjashëm me "planet e reformimit kombëtar" në shtetet anëtare të BE-së, sipas të cilit qeveria shqiptare do të ketë një angazhim për prioritetet afatgjata në fushat e politikave të kërkimit dhe novacionit.

Bashkëpunimi rajonal në fushën e kërkimit shkencor

Është rritur bashkëpunimi rajonal në fushën e kërkimit shkencor në Ballkanin Perëndimor në mënyrë që vendet e këtij rajoni të jenë pjesë e Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) gjatë procesit të integrimit. Në këtë kuadër janë nxitur një sërë programesh që synojnë bashkëpunimin rajonal në fushën e kërkimit shkencor. Një nga këto programe është *Regional Research Promotion Program*, që zgjati nga 2008-2016 dhe u bashkërendua nga *Interfaculty Institute for Central and Eastern Europe* (IICEE) në Universitetin e Fribourg (Zvicër) dhe synoi të nxisë forcimin e aftësive kërkimore në fushën e shkencave sociale në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi,

Maqedoni, Kosovë, Mal i Zi). Ai program u pasua nga Projekti PERFORM (Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme) me të cilin Ministria e Arsimit e Sportit ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në korrik 2016. Ndërkohë në vijim të nismës së Kancelares Merkel, konkretizuar në KonferencënNdërqeveritare mbi Ballkanin Perëndimor në Berlin, 27 gusht 2014, dhe më pas në Vjenë 2015 e Paris 2016, tashmë i njohur si Procesi i Berlinit, është ndërmarrë një iniciativë nga Akademia Kombëtare Gjermane Leopoldina,që ky proces të shtrihet edhe në fushën e shkencës. Ndërmjet të tjerave,nisma e qeverisë gjermane synon të ripohojë angazhimin evropian për Ballkanin Perëndimor dhe të forcojë përpjekjet e ndryshme për të integruar rajonin në BE, e orientuar në tri drejtime kryesore: i) zgjidhjen e çështjeve politike, ii) zhvillimin ekonomik të rajonit duke përmirësuar infrastrukturën rajonale dhe iii) rritjen e bashkëpunimit shkencor e shoqëror, i cili përfshin një bashkëpunim intensiv të faktorëve të shkencës, arsimit dhe kërkimit në rajon. Deklarata përfundimtare e 27 korrikut 2014 (Berlin), e Konferencës së Përbashkët Shkencore për Rajonin e Ballkanit Perëndimor në 2015 në Vjenë nxit qeveritë e Ballkanit Perëndimor të arrijnë nivelin 3% GDP për investimet në shkencë e novacion. Në këto konferenca morën pjesë kryetarët e akademive kombëtare të shkencave dhe kryetarët ose përfaqësues të konferencave të rektorëve të Shqipërisë, Austrisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Kroacisë e Italisë. Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit diplomatikë të vendeve pjesëmarrëse dhe të Francës, që është përfshirë në iniciativën për Ballkanin Perëndimor duke synuar një partneritet bashkëpunimi në fushën e shkencës për periudhën 2015-2018.

Një nga treguesit në drejtim të bashkëpunimirajonal në fushën e shkencës dhe novacionit është pjesëmarrja e Shqipërisë në procesin e hartimit të disa strategjive. Në këtë kuadër është Strategjia e Evropës Juglindore2020 (South East EuropeStrategy 2020 - SEE) e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (Regional Cooperation Council) me qendër në Sarajevë (ish Paktii Stabilitetit), e miratuar në 21 shkurt 2013 në një konferencë të ministrave të ekonomisë së Ballkanit Perëndimor, ku përfshihej edhe Shqipëria. Strategjia synon të përmirësojë kushtet e jetës në rajon, aftësinë konkurruese dhe zhvillimin ekonomik, duke ndjekur vizionin e BE-së në strategjinë e saj 2020. Ajo synon që vendet e Ballkanit Perëndimor të hapin 1 milion vende pune deri në 2020, të rrisin tregtinë rajonale nga 94 miliardë Euro në 210 miliardë Euro dhe rritjen e të ardhura për frymë në 44 % të mesatares së vendeve të BE, duke i shtuar deri në 2020 forcës së aftë për punë në rajon rreth 300 000 individë shumë të kualifikuar. Kjo strategji vlerësohet çdo vit për treguesit e realizimit të saj përmes një metodologjie të caktuar. Një nga shtyllat e saj është shtylla e kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Nga ana tjetër, një dokument i rëndësishëm është Strategjia për Kërkim Shkencordhe Novacionin e Ballkanit Perëndimor, e cila u nxit fillimisht nga një Deklaratë e Përbashkët e Ministrave të Arsimit dhe Shkencës në 2009. Më pas, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian nënshkruan në shtator 2011 një marrëveshje për financimin me 1,5 milion Euro nga fondet IPA për hartimin e kësaj strategjie. Ndërkohë për bashkërendimin e kësaj strategjie, vendet e rajonit kanë rënë dakord të krijojnë *Western Balkans Innovation Strategy Excercise Facility* (WISE), me qendër në Split të Kroacisë, një mekanizëm që mbështet e nxit iniciativat në këtë fushë.

Gjithashtu duhet theksuar Strategjia e BE për Rajonin Adriatiko-Jonian(*EU Strategy for the Adriatic and Ionian Region* –EUSAIR), ku bën pjesë edhe Shqipëria së bashku me Slloveninë, Kroacinë , Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë. Kjo strategji u kërkua nga Samiti i BE-së i 13-14 dhjetorit 2012, që të hartohej nga ana e KomisionitEvropian para fundit të vitit 2014. Duke u mbështetur në eksperiencat e strategjive rajonale për Rajonin e Detit Balltik (*EU Strategy for the Baltic Sea Region*) dhe Rajonin e Danubit (*EU Strategy for the Danube Region*), Komisioni Evropian e miratoi atë më 17 qershor 2014, të shoqëruar me një plan veprimi. Brenda kësaj strategjie u përfshi edhe Strategjia Detare për Detet Adriatik e Jon (*Maritime Strategy for the Adriatic and Ionian Seas*) e cila ishte miratuar nga KomisioniEvropian në 30 nëntor 2012. Kjo Strategji iu paraqit më pas Këshillit të Ministrave të Jashtëm të BE-së (GAC) më 29 shtator 2014 dhe u miratua nga Samiti i BE-së më 24 tetor 2014. Në katër fushat e saj kryesore si *Rritja blu* (rritja ekonomike e mbështetur tek shfrytëzimi i burimeve detare),lidhja e rajoneve, cilësia e mjedisit dhe turizmi i qëndrueshëm, synohet që kontributi i kërkimit shkencor të studiuesve të ndërlidhet me realizimin e tyre.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor e novacionit synon të përputhet me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim (SKZHI), e cila përfshin një numër të gjerë të sektorëve me përparësi (energjia, turizmi, bujqësia e industria agro-përpunuese, IT, gjeo-shkencat, etj.). Shfrytëzimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës e novacionit nga ana e komunitetit të kërkimit shkencor shqiptar, ka për qëllim të përqendrohet në ato fusha parësore, ku ekzistojnë përvojat, aftësitë njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore,për të arritur rezultate në dobi të zhvillimit social-ekonomik dhe një specializim më të thellë në disa fusha kërkimi.

I.3 Struktura e kapitullit

1. Masat kombëtare në fushën e shkencës dhe financimit të kërkimit shkencor.

2. Pjesmarrja në Programin Kuadër të BE-së për Kërkim–Shkencor & Inovacion Horizon 2020 - H2020.

3. Integrimi në Zonën Europiane të Kërkimit Shkencor- ERA.

4. Veprimet në drejtim të afrimit me Unionin e Inovacionit BE.

5. Bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë nisma politike, ligjore, institucionale e financiare brenda Kapitullit 25 në dobi të forcimit të sistemit të kërkimit shkencor, buron nga Neni 109 i MSA-së, që përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë e Bashkimit Evropian në fushën e KërkimitShkencor e Zhvillimit Teknologjik (Titulli VIII- Politikat e Bashkëpunimit/ Bashkëpunimi në Kërkimin Shkencor e Zhvillimin Teknologjik).

"Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në kërkimet shkencore me karakter civildhe në lidhje me zhvillimin teknologjik në bazë të përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme, aksesin e duhur në programet e tyre përkatëse, të kushtëzuara nga nivele të përshtatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale e tregtare. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin teknologjik. Bashkëpunimi do të zbatohet në bazë të marrëveshjeve specifike që do të negociohen dhe përfundohen në bazë të procedurave të miratuara nga secila palë."

Vëmendja kryesore e qeverisë shqiptare në fushën e kërkimit shkencor në planin afatgjatë është përputhja sa më e gjerë e politikave, kuadrit strategjik e ligjor në këtë sektor me orientimet e parimet e BE-së. Në këtë drejtim synohet të arrihet një cilësi e sistemit institucional të kërkimit shkencor që do të jetë në gjendje t'u përgjigjet sfidave të zhvillimit socio-ekonomik në vend dhe të ndërveprojë në mënyrë të pavarur, aktive dhe të suksesshme me iniciativat e programet e BE-së.

E drejta e BE-së në fushën e kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik e novacionit përcaktohet nga një sërë nenesh të parashikuara në Traktatin për Funksionimin e BE-së apo siç njihet Traktati i Lisbonës (TFBE) dhe Traktatin e Euratomit. Ato janë pjesë e Legjislacionit Parësor të BE-së, të cilat kanë përcaktuar me dispozitat e tyre prioritetet dhe hapësirat ligjore që nxisin miratimin e iniciativave apo programeve kuadër në fushën e kërkimit në nivel të BE-së.

Neni 179 i TFEU përcakton se BE ka si objektiv forcimin e bashkëpunimit shkencor e teknologjik mes vendeve anëtare për të arritur një Zonë Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) në të cilën studiuesit, njohuritë shkencore dhe teknologjia të qarkullojnë lirisht duke e bërë atë konkurruese dhe duke nxitur aktivitete kërkimore shkencore si nevojë e shoqërive. BE inkurajon universitetet, qendrat kërkimore të ndërmarrin aktivitete kërkimore me cilësi të lartë.
Ndërkohë, Neni 180, 181 e 182 i TFEU-së përcakton se BE dhe Shtetet Anëtare koordinojnë aktivitetet e tyre të kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik duke ndjekur prioritete që plotësojnë ato të Shteteve Anëtare të tilla si:

a) zbatimi i programeve të kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik dhe demonstrimit praktik duke nxitur bashkëpunimin me dhe ndërmjet sipërmarrjes, qendrave kërkimore dhe universiteteve;
b) nxitjen e bashkëpunimit mes BE-së e vendeve të treta në kërkim shkencor e zhvillim teknologjik;
c)përhapja dhe përmirësimi i rezultateve të kërkimit shkencor në nivel të BE;
d) mbështetja e kualifikimit e lëvizjes së studiuesve brenda BE-së.

Ndërsa, Neni 187 i TFEU përcakton mundësinë që BE të krijojë iniciativa të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik, që mund të shërbejnë të gjithë vendeve anëtare dhe më gjerë. Nga ana tjetër, Neni 189 i TFEU ka përfshirë për herë të parë politikën hapësinore të BE që mund të nxisë iniciativa të përbashkëta kërkimi, ashtu sikurse Neni 5, 6, 8 e 10 i Traktatit të Euroatomit të BE parashikon një sërë elementesh të mbështetjes së fushave të kërkimit shkencor për energjinë bërthamore. Gjithashtu, Kapitulli i II-të i Traktatit të Euratomit dhe përkatësisht nenet 12, 13 e 14 përcaktojnë aspekte të veçanta për qarkullimin e përhapjen e informacionit shkencor lidhur me kërkimet në fushën e energjisë bërthamore.

Legjislacioni dytësor i BE-së në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor përfshin, ndër të tjera, këto akte:
Akte Ligjore (*Legislative Acts, Regulations, Directive, Decisions*)

1. Rregullore e Këshillit Nr. 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimin e programeve Komunitare OJ L 11, 16.1.2003, p.
2. Rregullore Nr. 294/2008e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) e 11 Marsit 2008 për krijimin e Institutit Evropian të Teknologjisë e Novacionit - EIT OJ L 97, 9.4.2008, p. 1.
3. Rregullore e Këshillit Nr. 723/2009 e 25 Qershorit 2009 për kuadrin ligjor të Komunitetit Evropian mbi Konsorciumin Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor – ERIC OJ L 206, 8.8.2009, p. 1.
4. Direktiva 2010/63/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 22 Shtatorit 2010 për mbrojtjen e kafshëve që përdoren për qëllime shkencore OJ L 276, 20.10.2010, p. 33–79.
5. Vendim i Këshillit 2013/743/EU i 3 Dhjetorit 2013 për krijimin e një programi të veçantë që zbaton Programin Kuadër për Kërkimin Shkencor dhe Novacionin 2014-2020 – Horizon 2020 dhe shfuqizon Vendimet 2006/971/EC, 2006/972/EC, 2006/973/EC, 2006/974/EC and 2006/975/EC OJL 347/964 20.12.2013.
6. Rregullore Nr. 1291/2013 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e 11 Dhjetorit 2013 për përcaktimin e rregullave mbi pjesëmarrjen dhe shpërndarjen e informacionit në Programin Kuadër për Kërkimin Shkencor e Inovacionin 2014-2020 Horizon 2020 dhe shfuqizimi i Vendimit Nr. 1982/2006/EC OJL 0 374/104 20.12.2013.

7. Rregullore e Këshillit (Euratomi) Nr. 1314/2013 e 11 Dhjetorit 2013 mbi Programin e Kërkimit Shkencor dhe Kualifikimit të Komunitetit të Energjisë Atomike (2014-2018) për të plotësuar Programin Kuadër për Kërkimin Shkencor dhe Novacionin 2014-2020 – Horizon 2020OJL 0 948/104 20.12.2013.
8. Rregullorja nr. 1287/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e programit për konkurrencën e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME)
9. Rregullorja nr. 1296/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e Programit të Bashkimit Evropian për Punësim dhe Inovacion Social (EaSI)
10. Propozim për ndryshimin e Rregullores së Këshillit të Rregullores Ec Nr 723/2009 në lidhje me Kornizën Ligjore të Komunitetit për një Konsorciumit të Infrastrukturës Kërkimore Evropiane (ERIC).
11. Vendim i Komisionit të Përbashkët të EEA Nr.93/2008 e 4 korrikut 2008 ndryshon Protokollin 31 të Marrëveshjes EEA, për bashkëpunim në fusha të veçanta jashtë katër lirive

Akte joligjore (*Non Legislative Acts:Recommendation, Opinion)*
(Komunikatat e Komisionit nuk përfshihen tek aktet joligjore, por janë dokumente informuese të politikave të kërkimit *guidelines*)

1. Rekomandimi i Komisionit Evropian 10 Prillit 2008 mbi administrimin e pronësisë intelektuale në aktivitetet e transferimit të njohurive dhe Kodi iPraktikës për universitetet dhe institucionet e tjera publike të kërkimit shkencor OJ ,1329, of 10.4.2008.
2. Komunikata Përfundimtare nga Komisioni Evropian (COM/2012 392) e 17 Korrikut 2012 për Parlamentin, Këshillin Evropian, Komitetin Evropian Social & Ekonomik dhe Komitetin e Rajoneve mbi Partneritetin e Përforcuar të Zonës Evropiane për Kërkim Shkencor (ERA) në lidhje me një shkencë të nivelit të lartë dhe rritje ekonomike.
3. Rekomandimi i Komisionit, Bruksel 17.07.2012 C(2012) 4890 final i 17 Korrikut 2012 Mbi aksesin dhe ruajtjen e informacionit shkencor.
4. Komunikata e Komisionit Evropian COM(2012) 401 e 17 Korrikut 2012 për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik e Social dhe Komitetin e Rajoneve- Drejt një marrjeje më të mirë të informacionit shkencor: Rritja e përfitimeve nga investimet publike në kërkimin shkencor.
5. Komunikata Përfundimtare nga Komisioni Evropian (COM/2014 339) e 10 Qershorit 2014 për Parlamentin, Këshillin Evropian, Komitetin Evropian Social & Ekonomik dhe Komitetin e Rajoneve mbi Kërkimin Shkencor dhe Novacionin si burime të rritjes së re ekonomike.

6. Komunikata Përfundimtare nga Komisioni Evropian(COM/2016 0178 final) e 19 Prillit 2016 për Parlamentin, Këshillin Evropian, Komitetin Europian Social & Ekonomik dhe Komitetin e Rajoneve mbi Iniciativën Europiane Cloud- Ndërtimi i një ekonomie konkurruese në Evropë të të dhënave dhe dijes.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Ndër aktet kryesore ligjore që rregullojnë funksionimin e sistemit të kërkimit shkencor në Shqipëri dhe bashkëpunimin me programet kuadër të BE në fushën e kërkimit shkencor dhe novacionit janë Ligji nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik"; Ligjinr. 8401, datë 09.09.1998 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik"" dhe Ligji nr. 80/2015, datë 06.10.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM nr. 607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit (AKKSHI); Ligjinr. 132/2014, datë 02.10.2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër "Horizon 2020 - Programi për kërkim dhe inovacion"".
Gjithashtu Ministria e Arsimit e Sportit ka ndërmarrë një proces për hartimin e një kuadri të ri strategjik, ligjor e institucional për zhvillimin e kërkimit shkencor duke ngritur tri grupe pune, përmes Urdhrit të Ministrit nr. 296, datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Strategjisë sëKërkimit Shkencor, Teknologjisë e Inovacionit 2017-2022", Urdhrit të Ministrit nr. 297, datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Grupit të Punës për Reformimin e Sistemit Institucional të Kërkimit Shkencor në RSH" dhe Urdhrit të Ministrit nr. 298, datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektligjit "Për Shkencën e Zhvillimin Teknologjik"".

Ndërkohë në fuqi janë një sërëligjesh, vendimesh të KM e Udhëzimesh që rregullojnë veprimtarinë e kërkimit shkencor në Shqipëri, të tilla si:

1. VKM nr. 567, datë 23.10.1995 "Për shpërblimin e këshillave, komisioneve dhe ekspertizave të veprimtarisë shkencore dhe teknologjisë";
2. VKM nr. 197, datë 18.03.1996 "Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore";
3. Ligji nr. 8366, datë 02.07.1998 "Për krijimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar(SHGjSH);
4. VKM nr. 333, datë 15.07.1999 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 18.03.1996 "Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore"";
5. VKM nr. 278, datë 02.06.2000 "Për krijimin e Institutit të Policisë Shkencore (IPSH)";
6. VKM nr. 178, datë 30.03.2001 "Për bashkimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit dhe Promocionit të shëndetit me Institutin e Shëndetit Publik";
7. VKM nr. 384, datë 19.06.2004 "Për një ndryshim në VKM nr. 197, datë 18.03.1996 "Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore";
8. Urdhri i Ministrit të Punëve Publike e Transportit nr. 225, datë 29.06.2004 "Për krijimin e Institutit të Ndërtimit";

9. VKM nr. 515, datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore–shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit”;
10. VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore(AKBN)”;
11. VKM nr. 579, datë 23.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve AMP)”;
12. Ligj nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;
13. VKM nr. 807, datë 06.12.2006 “Për ristrukturimin e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Industrisë së Lehtë(ISPIL)”;
14. VKM nr. 163, datë 21.03.2007 “Për disa shtesa në VKM nr. 515, datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore–shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit”;
15. VKM nr. 146, datë 28.03.2007 “Për shkrirjen e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së aplikuar dhe riorganizimin e tij, si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe për një ndryshim në vendimin nr.440, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave"”;
16. VKM nr. 202, datë 11.04.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)”;
17. VKM nr. 255, datë 27.04.2007 “Për fondin e ekselencës, për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer”;
18. VKM nr. 364, datë 13.06.2007 “Për një shtesë në VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”;
19. VKM nr. 382, datë 20.06.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 515, datë 19.07.2006 “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore–shkencore në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit””;
20. VKM nr. 559, datë 22.08.2007 “Për bashkimin e disa instituteve te Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre ne Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj Qendre ne periudhën kalimtare”;
21. VKM nr. 560, datë 22.8.2007 “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit(IEUM) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare”;
22. VKM nr. 561, datë 22.8.2007 “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave(IGJ) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit për periudhën kalimtare”;
23. VKM nr. 562, datë 22.08.2007 “Për shkëputjen e Institutit të Kërkimeve Biologjike nga Akademia e Shkencave dhe Integrimin e tij në Universitetin e Tiranës”;
24. VKM nr. 563, datë 22.08.2007 :Për krijimin e Qendrës së Fizikës Bërthamore të zbatuar dhe Autoritetit Atomik Shqiptar, pranë Universitetit të Tiranës”;

25. VKM nr. 467, datë 18.07.2007 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik”;
26. VKM nr. 661, datë 18.10.2007 “Për përcaktimin e masave për organizimin e qendrave ose të instituteve të kërkimit dhe zhvillimit, për fillimin e veprimtarisë në periudhën kalimtare”;
27. VKM nr. 861, datë 21.11.2007 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Institutit të Transportit(IT)”;
28. Ligj nr. 9853, datë 26.12.2007 “Për disa shtesae ndryshime në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;
29. VKM nr. 156, datë 13.02.2008 “Për disa ndryshime në VKM nr. 559, datë 22.08.200 “Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike (QSA), si dhe funksionimin e kësaj Qendre në periudhën kalimtare”;
30. VKM nr. 349, datë 27.03.2008 “Për ngritjen e komisionit përzgjedhës (kp) të anëtarëve të rinj të Akademisë së Shkencave”;
31. VKM nr. 399, datë 27.03.2008 “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve të përhershëm të Akademisë së Shkencave”;
32. Ligj nr. 9949, datë 07.07.2008 “Për disa shtesa në Ligjin Nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;
33. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 29.07.2008 Me objekt: 1. Shfuqizimi i ligjit nr. 9853, datë 26.12.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë" si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 2. Pezullimi i këtij ligji, deri në shqyrtimin përfundimtar të tij;
34. VKM nr. 863, datë 29.07.2009 “Për miratimin e Strategjisë së Shkencës, të Teknologjisë dhe Inovacionit, 2009-2015”;
35. Ligj nr. 10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”;
36. Ligji nr. 10271, datë 22.04.2010 “Për disa shtesa në ligjin Nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;
37. VKM nr. 399, datë 26.05.2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;
38. VKM nr. 787, datë 24.09.2010 “Për një ndryshim dhe shtesë në VKM nr. 399, datë 27.03.2008 “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve të përhershëm të Akademisë së Shkencave””;
39. VKM nr. 380, datë 18.05.2011 “Për ngritjen, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit Shkencor të Institutit të Shëndetit Publik (ISHP)”;
40. Udhëzim i Ministrit të Arsimit nr. 19, datë 31.05.2011 “Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin “Për kërkim fondamental dhe ekselencë””;

41. VKM nr.490, datë 6.7.2011 “Për shfuqizimin e VKM nr. 560 datë 22.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare”” dhe VKM nr.561, datë 22.8.2007 “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave dhe pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit për periudhën kalimtare””;
42. Urdhri i Ministrit të Arsimit nr. 371, datë 28.07.2011 “Për krijimin e Institutit të Gjeoshkencës dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) pranë Universitetit Politeknik”;
43. Urdhër i Ministrit të Arsimit nr. 105, datë 23.03.2012 “Për miratimin e rregullores “Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese”;
44. VKM nr. 150, datë 27.02.2013 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”;
45. VKM nr. 47, datë 29.01.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e agjencive rajonale të mjedisit”.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucioni kryesor shtetëror përgjegjës për hartimin e politikave, kuadrin ligjor e strategjik në fushën e kërkimit shkencor është Ministria eArsimit e Sportit (MAS) dhe Këshilli Kombëtar për Arsimin e Lartë dhe Shkencën (KALKSH), si organ këshillimor pranë Ministrit të Arsimit e Sportit. Ndërkohë lidhur me financimin e kërkimit shkencor në nivel kombëtar do të jenëpërgjegjës Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), që do të financojë kërkimin shkencor në IAL-të publike përmes grantit vjetor dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit (AKKSHI) që mbështet financiarisht projektet kombëtare të kërkim-zhvillimit në bazë të konkurrimit të hapur dhe fushave prioritare të kërkimit shkencor të përcaktuar nga qeveria shqiptare.

Përsa i përket politikave në fushën e Inovacionit që janë të lidhura me aspekte të veçanta të kapitullit 25, një pjesë e vendimmarrjes i përket Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Sipërmarrjes dhe Turizmit përmes iniciativave që mbështeten në sektorin e SME-ve nga Agjencia Shqiptare e Investimeve-AIDA. Për shkak të karakterit ndërsektorial të fushës së kërkimit shkencor, përveç Ministrisë së Arsimit e Sportit për zhvillimin dhe financimin e shkencës në Shqipëri ka edhe një sërë ministrish që kanë në vartësi të tyre institute me karakter kërkimi dhe shërbimi, të tilla si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, etj.

1. Ministria e Arsimit e Sportit-MAS;
2. Këshilli për Arsimin e Lartë dhe Shkencën-KALSH;

3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit (AKKSHI) –ish AKTI;
4. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë –AKFAL;
5. Instituti i Statistikave –INSTAT;
6. Ministria e Financave-MF;
7. Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike-MIAP;
8. Ministria e Shëndetësisë –MSH;
9. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural e Administrimit të Ujërave-MBZHRAU;
10. Ministria e Industrisë e Energjetikës-MIE;
11. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Sipërmarrjes, Tregtisë e Turizmit-MZHETST;
12. Ministria e Mjedisit-MM;
13. Ministria e Kulturës-MK;
14. Drejtoria e Patentave dhe Markave-DPA;
15. Agjencia Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit-ASHMDA;
16. Akademia e Shkencave-ASH;
17. Institucionet e Arsimit të Lartë Publik-IALP;
18. Institucionet e Arsimit të Lartë Jo- Publik-IALJP.

II.4 Përcaktimi i alokimeve financiare

	2016	2017	2018
Buxheti total për këtë kapitull i institucionit drejtues(në milionë lekë)	**300 800**	**415 800**	**625 800**
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera (i parashikuar)	**52200**	**65 000**	**105 000**
Buxheti total iKapitullit	**353 000**	**480 800**	**730 800**

III. Prioritetet

Një nga përparësitë kryesore të Shqipërisë në këtë fushë është reformimi dhe përmirësimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor duke synuar rritjen e financimit në nivel kombëtar për shkencën e zhvillimin, nxitjen e qasjes së bashkëpunimit të trefishtë qeveri-akademi-biznes (*Triple Helix*), si dhe përballimin e zgjidhjen e sfidave social-ekonomike të vendit përmes një kërkimi shkencor sa më cilësor. Nga ana tjetër,qeveria shqiptare ka për qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore të kërkimit shkencor për të rritur pjesëmarrjen dhe nivelin e suksesit në Programet kuadër të BE-së për Kërkimin Shkencor & Inovacionin. Në këtë kuadër, identifikimi i fushave të kërkimit shkencor ku Shqipëria ka më shumë nevojë, do të jetë një ndër përparësitë bazë që mban parasysh zbatimin e qasjes së specializimit të zgjuar (*smart specialization*). Gjithashtu thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës e kërkimit shkencor, qoftë në nivel rajonal e ndërkombëtar, përbën një objektiv dhe prioritet të rëndësishëm për fuqizimin e këtij sektori. Përfshirja dhe zbatimi i parimeve të Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor–ERA në hartimin ekuadrit strategjik e ligjor për zhvillimin e shkencës në Shqipëri do të pasohet nga ndjekja e aktiviteteve që afrojnë Shqipërinë me Unionin e Novacionit.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2020

SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2015

Inventar i Masave Ligjore Ekzistuese

Akti Evropian *(Nr. Celex dhe titulli)*	**Akti ligjor shqiptar** *(numri, data dhe titulli)*	**Institucioni përgjegjës**	**Niveli i përafrimit** *(I plotë, i pjesshëm)*	**Data e Miratimit të Aktit**	**Data e hyrjes në fuqi**
Rregullore Nr. 1291/2013 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e 11 Dhjetorit 2013 për përcaktimin e rregullave mbi pjesëmarrjen dhe shpërndarjen e informacionit në Programin Kuadër për Kërkimin Shkencor e Inovacionin 2014-2020 Horizon 2020 dhe shfuqizimi i Vendimit Nr.1982/2006/EC OJL 0 374/104 20.12.2013.	Ligji Nr. 132/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Kuadër Horizon 2020- programi IBE-së për Kërkimin dhe Inovacionin"	MAS	I plotë	10.2.2014	11.06.2014
Rregullore e Këshillit Nr. 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimin e programeve Komunitare OJ L 11, 16.1.2003,	Ligj Nr. 7893, datë 22.12.21994 "Për zhvillimin shkencor dhe teknologjik"	MAS	I Pjesshëm	22.12.1994	22.12.1994

Rregullorja nr. 1287/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e programit për konkurrencën e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME)	Ligj Nr. 61/2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë e Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme- COSME 2014-2020""	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	I Plotë	11.6.2015	23.6.2015
Rregullorja nr. 294/2008/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e ndryshuar me rregulloren (BE) nr. 1292/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e cila krijon Institutin Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë	Vendimi Nr. 798, datë 2014/11/19 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Evropiane për Kërkime Bërthamore (CERN), në lidhje me bashkëpunimin shkencor dhe teknik në fizikë të lartë të energjisë"	MAS	I plotë	19.11.2014	17.12.2014
Rregullorja nr. 1296/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2013, për krijimin e Programit të Bashkimit Evropian për Punësim dhe Inovacion Social (EaSI)	Ligj Nr. 75/2015 datë 09.07.2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë e Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Unionit për punësim e inovacion social –EaSI"	MMSR	I plotë	9.7.2015	27.7.2015
Deklaratë për bashkëpunim të përbashkët në Shkencë dhe Novacion, firmosur në Sarajevë në vitin 2013; Deklaratë për Strategjinë Rajonale të Kërkimit dhe Zhvillimit për novacion firmosur në Zagreb në vitin 2013	Ligji Nr. 16/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e qendrës së kërkimit shkencor dhe novacionit të Ballkanit Perëndimor (WISE)"	MAS	I plotë	10.3.2016	15.4.2016 FZ 47/2016

Kuadri politik i planifikuar 2017-2020

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, për periudhën 2017-2022	MAS AKKSHI	2017 – 2022	T1 2017	T1 2017

Masat ligjore të planifikuara 2017 – 2020

Legjislacioni i BE-SË	I përkthyer Po/Jo	Legjislacioni (aktet nënligjore) shqiptare	Institucion përgjegjës	Niveli i përafrimit	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
Afatshkurtër (2017)						
Rregullore e Këshillit Nr 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 Për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimine programeve Komunitare	Jo	VKM "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik"	MAS	I pjesshëm	Katërmujori I 2017	Katërmujori I 2017
Rregullore e Këshillit Nr. 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 Për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimine programeve Komunitare	Jo	Vendim "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit nga AKKSHI"	MAS AKKSHI	I pjesshëm	Katërmujori I 2017	Katërmujori I 2017
Rregullore e Këshillit Nr 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 Për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimin e programeve Komunitare	Jo	Ligji "Për Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë"	MAS	I pjesshëm	T4 2017	T4 2017
Rregullore e Këshillit Nr	Jo	Dokumenti për reformimin	MAS	I pjesshëm	T4 2017	T4 2017

58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 Për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimin e programeve Komunitare		institucional të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë				
Afatmesëm (2018– 2020)						
Rregullore e Këshillit Nr 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 Për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimine programeve Komunitare	Jo	VKM "Për klasifikimin e revistave shkencore"	MAS	I pjesshëm	T4 2018	T4 2018
Rregullore e Këshillit Nr 58/2003 e 19 Dhjetorit 2003 Për përcaktimin e statutit të agjencive ekzekutive që do t'u besohen detyra të caktuara në administrimine programeve Komunitare	Jo	Udhëzim për menaxhimin e financave të IAL-ve publike në kuadër të H2020	MAS/MF	I pjesshëm	T4 2018	T4 2018

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitulli: Kapitulli : Shkenca dhe Kërkimi Shkencor					
Përfituesi: Ministria e Arsimit dhe Sportit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Fonde për t'u financuar nga Buxheti i Shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Mbështetje për studentët e shkëlqyer	A) Paga –stafi aktual				
	B) Paga–staf i ri				
	C) Trajnim				
	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative	120,000	132,000	150,000	402,000
	Aktivitet total	**120,000**	**132.000**	**150,000**	**402,000**
Pjesëmarrje në Horizont 2020	A) Paga –stafi aktual				
	B) Paga–staf i ri				
	C) Trajnim				
	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative	120,000	140,000	140,000	400,000
	Aktivitet total	**120,000**	**140,000**	**140,000**	**400,000**
Mbështetje për kërkuesit e rinj shkencorë	A) Paga –stafi aktual		15,000	15,000	30,000
	B) Paga–staf i ri				
	C) Trajnim				
	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative	60,800	128,800	320,000	509,000
	Aktivitet total	**60,800**	**143,800**	**335,800**	**1,341,600**

	Buxheti i përfituesit total	**300,800**	**415,800**	**625,800**	**1,341,600**
Përfituesi: Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktivitet	**Fonde për t'u financuar nga Buxheti i Shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Fonde për Kërkim dhe Zhvillim, Teknologji dhe Inovacion, dhe Programe Dypalëshe	A) Paga – Stafi aktual	52,200	65,000	105,000	222,200
	B) Paga – staf i ri				
	C) Trajnim				
	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative				
	Aktivitet total	**52,200**	**65,000**	**105,000**	**222,200**
	Buxheti i përfituesit total	**222,200**			
	Kapitull total	**1,124,600**			

KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli *Arsimi dhe Kultura* synon të japë një panoramë të qartë të situatës aktuale në fushën e arsimit, formimit profesional dhe kulturës, duke nxjerrë në pah nismat e ndërmarra për ngritjen e cilësisë së arsimit në përputhje me standardet evropiane. Ky kapitull përmban masat ligjore të planifikuara dhe prioritetet për reformat në funksion të Integrimit Evropian të vendit. *Acquis* për arsimin dhe kulturën konsiston kryesisht në kuadrin e bashkëpunimit të përbërë nga programe dhe metoda të koordinimit të hapur (OMC), që synojnë konvergjencën e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Në fushën e arsimit dhe kulturës shtetet anëtare duhet të sigurojnë menaxhimin e mirë të programeve të decentralizuara të Bashkimit Evropian. *Acquis* kërkon gjithashtu, që shtetet anëtare të lehtësojnë arsimin për fëmijët e punëtorëve emigrantë në Bashkimin Evropian dhe që ata të mos diskriminohen kundrejt shtetasve të BE-së. Në fushën e kulturës, Konventa e UNESCO-s e vitit 2005, "Mbi mbrojtjen dhe nxitjen e diversitetit të shprehjeve kulturore" e cila është ratifikuar nga Bashkimi Evropian, është një komponent kryesor i *acquis*. BE kontribuon gjithashtu, në promovimin e çështjeve sportive evropiane.

Acquis i BE për kulturën bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga "Traktati për Bashkimin Evropian" dhe "Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian". Qëllimi i politikave të BE-së për kulturën është për të inkurajuar bashkëpunimin në mbështetje dhe për plotësimin e veprimeve që lidhen me rritjen e dijes dhe përhapjen e kulturës, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, shkëmbimet kulturore dhe krijimet letrare dhe artistike duke përfshirë dhe sektorin audiovizual. BE gjithashtu fokusohet dhe inkurajon pjesëmarrjen në programet e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Gjatë vitit 2015-2016, janë ndërmarrë një sërë përmirësimesh thelbësore në legjislacion dhe në procedura në fushat e arsimit dhe kulturës. Në lidhje me fushën e arsimit kanë vijuar reformat në arsimin parauniversitar dhe në arsimin e lartë. Në arsimin paraunivesitar janë ndërmarrë një sërë reformash për përmirësimin e cilësisë si dhe hartimi i akteve të ndryshme nënligjore. Është miratuar VKM Nr.11, datë 11.1.2016 "Për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të arsimit Parauniversitar për periudhën 2014-2020".

Në përputhje me Ligjin "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, me synimin për të zhvilluar politikat arsimore në përputhje me parimet dhe standartet e Bashkimit Europian, gjatë periudhës 1 Maj – 31 Korrik 2016 është draftuar Udhëzimi Nr.14, datë 28.07.2016, "Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar dhe të lartë" me synimin për të përmirësuar sistemin arsimor parauniversitar. Në janar 2016 u identifikuan nevojat për zhvillimin profesional të mësuesve. Përmes testimit në nivel kombëtar dhe me teknologji bashkëkohore u analizua situata aktuale dhe u identifikuan nevojat për zhvillim profesional sipas fushave përkatëse dhe në Mars 2016 u publikua raporti kombëtar për nevojat për zhvillimin profesional të mësuesve.

MAS në bashkëpunim me UNICEF hartoi dhe miratoi profilin e mësuesit gjithpërfshirës. Aktualisht vijojnë trajnimet e mësuesve për zbatimin e tyre në katër rajone të vendit, Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Gjirokastër. Në zbatim të marrëveshjes midis MAS dhe MASHT dhe MED Kosovë janë ngritur grupet e punës dhe janë hartuar draft kurrikula për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë, draft-standardet e mësuesit në diasporë si dhe draft-marrëveshja midis MAS dhe MASHT për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës në diasporë.

Duke filluar nga Maji 2016, Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) ka vazhduar punën me trajnimin e 11,000 mësuesve të klasave II, VII për arsimin bazë dhe mësuesve të klasave X për arsimin e mesëm. Procesi i trajnimit ka vazhduar rreth 39 ditë, 3 ditë për çdo Drejtori Arsimore Rajonale të Republikës së Shqipërisë. Procesi i trajnimit konsistoi në aplikimin e kurrikulës së re, orë praktike dhe metodologjia për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me bazë koompetencat. Në kuadër të reformës kurrikulare në sistemin arsimor parauniversitar vijon pilotimi i kurrikulës së re me bazë kompetëncën në klasat III, VIII, në 26 shkolla pilot në shkallë vendi. Kurrikula e re me bazë kompetencat po zbatohet në sistemin arsimor parauniversitar në klasat II, VII, X.

Është miratuar gjatë kësaj periudhe Ligji Nr 63/2014 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8872, datë 29.03.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nëpërmjet të cilit kemi rregulluar aspektin ligjor të kalimit të varësisë së arsimit të mesëm profesional nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nën varësinë e Ministrisë së Mirëqenies dhe Rinisë. Kemi miratuar VKM Nr. 297, datë 08.04.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional (KKAFP)", nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, i cili është një organ këshillimor i qeverisë për politikat dhe strategjitë në fushën e AFP-së. Gjithashtu po gjatë kësaj periudhe (2014-2015) janë miratuar një sërë aktesh nënligjore (Udhëzime, Udhëzime të përbashkëta me MAS, etj), nëpërmjet të cilave kemi rregulluar aktivitetin dhe funksionimin e ofruesve të AFP-së.

Ndërkohë për t'iu përgjigjur reformës në AFP si dhe për përmirësuar elementë shumë të rëndësishëm si menaxhimi, financimi, decentralizimi, etj., po punojmë për hartimin e një drafti të ri të Ligjit të AFP-së.

Në drejtim të regjistrimeve të nxënësve në shkollat e mesme profesionale si gjatë vitit shkollor 2014-2015 ashtu edhe gjatë këtij viti është rritur numri i te riregjistruarve. Konkretisht vjet numri i të regjistruarve ishte rreth 5.400 nxënës në vitet e para, këtë vit ky numër është mbi 5.800 nxënës. Ndërkohë në qendrat publike të formimit profesional publik, është rritur në mënyrë të ndjeshme numri i kursantëve të trajnuar. Konkretisht vjet ku numër ishte mbi 13.000 persona të certifikuar në këto qendra, ndërsa këtë vit, për periudhën Janar – Gusht 2015, numri i të trajnuarve është mbi 11.000 persona. Në rritjen e numrit të pjesëmarrësve në kurset e formimit profesional ka ndikuar edhe zbatimi i Urdhrit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 286, Datë 16.12.2013, me anë të të cilit tarifat për punëkërkuesit e papunë të regjistruar pranë zyrave përkatëse të punësimit janë falas.

Duke konsideruar artin dhe trashëgiminë kulturore si një faktor të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, *Ministria e Kulturës gjatë vitit 2016* ka intensifikuar investimet në infrastrukturë për rehabilitimin, ruajtjen dhe promovimin e artit dhe trashëgimisë kulturore.. Është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura e muzeve dhe parqeve arkeologjike dhe specifikisht është inauguruar më 9 maj 2016 Muzeu Kombëtar "Marubi", në 3 Tetor inaugurohet godina e re e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, ka përfunduar rehabilitimi i ndërtesës "Muzeu Gjethi" dhe është në proçes zbatimi i projektit të muzealizimit të godinës si dhe realizimi i Pavionit Etnografik në Muzeun Historik Kombëtar. Është punuar intensivisht për krijimin e një Sistemi Informatik Kombëtar të Administrimit të Trashëgimisë Kulturore si dhe është përmirësuar kuadri ligjor për menaxhimin e qendrave historike Berat, Gjirokastër, Pogradec, Korçë etj, ndërsa është intensifikuar bashkëpunimi me autoritetet lokale në kuadrin e këtyre rregulloreve. Janë miratuar qendrat historike dhe rregulloret për administrimin e tyre dhe të zonës së mbrojtur përreth për fshatrat Vuno, Qeparo, Dhërmi, Himarë dhe Bënjë, si dhe janë në proces miratimi për qendrat historike të fshatit Rehovë dhe Qytetit të Përmetit.

Është përmirësuar kuadri ligjor dhe institucional nëpërmjet miratimit të VKM Nr. 312, datë 27.04.2016 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtëshme 2016-2018" e cila është në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa / Ligji nr. 8523, datë 09.09.1999 "Për aderimin e RSH në Konventën e UNESCOS për mjetet e ndalimit dhe të parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore; VKM Nr. 339, datë 04.05.2016 "Për krijimin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë Marubi"; janë miratuar rreth 70 urdhëra të Ministrit të Kulturës në kuadër të promovimit të vlerave muzeore, pjesë e fondeve të muzeve kombëtare; Udhëzimi Nr. 3067, datë 14.06.2016 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin dhe funksionimin e këndeve (Souvenir, Art & Libra - "SAL") për tregtimin e suvenireve dhe botimeve pranë mjediseve në administrimin të Ministrisë së Kulturës dhe Institucioneve të saj të varësisë. Ky udhëzim përcakton kriteret për krijimin e këndeve të shërbimit (souvenir, art & libra), të përcaktuara si Këndet "SAL", me qëllim tregtimin e suvenireve dhe botimeve; rregullimin e proçesit të prodhimit të objekteve/produkteve të tregtueshme në këto qendra; sigurimin e cilësisë së tyre në formë dhe përmbajtje si dhe funksionimin e veprimtarisë financiare të këtyre këndeve.

Janë realizuar rreth 126 ndërhyrje për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e monumenteve te Kulturës nga Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës, Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastër, Vlorë dhe Zyrave të Administrimit te Parqeve Arkeologjikë Butrint, Apolloni, Bylis, si dhe janë në proçes unifikimi i proçedurave për formatin dhe çmimin e biletës në muze, parqe arkeologjike dhe monumentet e kulturës. Në Këshillin kombëtar të Restaurimeve gjatë vitit 2016 janë miratuar 253 projekte, ndërsa në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë 122 projekte.

Gjithashtu, gjatë vitit 2015, janë hartuar projektet e restaurimit për investime në infrastrukturën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, Teatrit Kombëtar, Kapanoni (Skena e re), Teatri "Andon Zako Çajupi" në Korçë dhe Teatri "Migjeni" në Shkodër. Gjatë vitit 2016, ka vijuar me sukses restaurimi i Teatrit "Migjeni" dhe "Andon Zako Çajupi" të cilat priten të përfundohen brenda këtij viti si dhe është miratuar me vendimin Nr. 515, datë 13.07.2016 "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2017-2019" realizimi i Rehabilitimit të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor si dhe Rikonstruksioni i ish-Laboratorit të Hidroteknikës dhe kthimi i tij në Qendër Arti "Skena e Re". Njëkohësisht, ka përfunduar dhe projekti për zgjerimin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Në fund të vitit 2016, 29 Nëntor inagurohet godina e re e Qendrës së Fëmijëve.

Platforma kombëtare "Edukimi përmes Artit" po implementohet me sukses nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë. Gjatë vitit 2016, është rritur numri i programeve specifike që mbështesin krijimtarinë letrare dhe përkthimin nëpërmjet thirrjeve për aplikime për projekte mbështetur nga Ministria e Kulturës si dhe u realizua portali i autorëve shqiptarë (në shqip dhe anglisht) si dhe katalogu përfaqësues i tyre. Janë mbështetur dhe realizuar rreth 400 projekte artistike për të mbështetur skenën e pavarur artistike me fokus edukimin, zhvillimin e audiencave dhe integrimin gjinor. Gjithashtu, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me INSTAT ka botuar zyrtarisht në raportin "Shqipëria në shifra", të dhëna statistikore vjetore për artin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore për vitet 2013-2015. Është intensifikuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë, është realizuar pjesëmarrja e suksesshme e Shqipërisë në Programin e Bashkimit Evropian "Evropa Krijuese"; Pavionin shqiptar në Bienalen e Artit në vitin 2015 dhe Arkitekturës 2016 në Venecia; Kalendari i përbashkët kulturor me Kosovën. Janë firmosur disa programe të rëndësishme kulturore me Republikën Popullore të Kinës, Kroacinë, Francën si dhe janë duke u hartuar programe të bashkëpunimit kulturor me Italinë, Serbinë dhe Federatën Ruse.

Me urdhrin e Ministres nr. 278, datë 21.07.2015 është ngritur grupi i punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2016-2021", strategji e cila pritet të përfundojë brenda vitit 2017. Sfidat në të ardhmen në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore e vendosin produktin kulturor me përparësi në axhendën e zhvillimit social, ekonomik dhe promovues të vendit. Mirëmenaxhimi efikas dhe efektiv në parametra bashkëkohorë si dhe dixhitalizimi i pasurive kulturore dhe krijimtarisë artistike si mjet për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore do të synojnë përmirësimin e produktit kulturor duke orientuar dhe sensibilizuar rolin dhe rritjen e aksesit të publikut pranë artit dhe vlerave të trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Grupi i punës në bashkëpunim me ekspertët e jashtëm të kontraktuar nga UNESCO pas realizimit të një analize të situatës aktuale të sektorit, fokusuar në arritjet dhe problematikat dhe sfidat e sektorit ka përcaktuar përparësitë strategjike: Përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore / Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza / Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë / Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare (materiale dhe shpirtërore) në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare/ Sjellja e përvojave më të mira në skenat shqiptare / Hartimi dhe zbatimi i platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore dhe në sistemin parauniversitar. Drafti i parë i Strategjisë së Kulturës do të jetë gati brenda muajit Tetor dhe më pas do të konsultohet jo vetëm me ekspertë të fushës dhe përfaqësues të institucioneve dhe komunitetin e artistëve, por edhe me përfaqësues të pushtetit lokal.

I.3 Struktura e kapitullit

1. ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL
2. KULTURA

II Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në arsim me *Acquis* të BE-së buron nga neni 70 MSA për përafrimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafrimin e legjislacionit në arsim dhe trajnim. Në fushën e kulturës neni 101 i MSA thekson se ‘palët zotohen të ndërmarrin bashkëpunim kulturor. Ky bashkëpunim do të shërbejë gjithashtu edhe për rritjen e mirëkuptimit të përbashkët dhe të respektit reciprok ndërmjet individëve, komunitetit dhe njerëzve. Palët gjithashtu zotohen të bashkëpunojnë për promovimin e diversitetit kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjes kulturore.”

Në përputhje me Partneritetin Evropian prioritetet afatgjatë dhe afatshkurtër në fushën e arsimit dhe trajnimeve, përshkruhen si më poshtë:

Prioritete afatshkurtër:

- Përmirësimi i administrimit të sistemit arsimor, trajnimi i mësuesve dhe infrastrukturës arsimore.

- Zbatimi i ligjit të ri të arsimit të lartë.
- Pjesëmarrje me aktive në programet komunitare të BE-së si Horizont 2020, 2020 Erasmus + me synim përfitimin maksimal prej tyre.

Prioritete afatmesme:

- Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe krijimi i një sistemi bashkëkohor të arsimit dhe formimit profesional , inkurajimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e arsimit të lartë.

Kërkesa të cilat rrjedhin nga akte/direktiva të tjera në fuqi që kanë lidhje me përafrimin janë:

- Rezoluta e Këshillit 16 Nëntor 2007 mbi Agjendën Evropiane;
- Komunikata e Komisionit, Këshillit, Parlamentit, ECSC dhe Komitetit të Rajoneve mbi një Agjendë Evropiane mbi Kulturën (2007);
- Raporti i Komisionit mbi zbatimin e Agjendës për Kulturën (2010);
- Komunikata e Komisionit mbi promovimin e kulturës dhe sektorëve krijues për rritje dhe punësim në BE (2012);
- Konkluzione të Këshillit mbi Qeverisjen Kulturore;
- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 1295/2013 për lançimin e Programit "Creative Europe";
- Direktiva 2014/60/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Maj 2014 për kthimin e objekteve kulturore të lëvizura kundër ligjit nga territori i një Shteti Anëtar.
- Rregullore e Këshillit (KE) nr. 116/2009 e 18 Dhjetorit 2008 mbi eksportimin e mallrave kulturore.
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 1081/2012 e 9 Nëntorit 2012 për qëllimet e Rregullores së Këshillit (BE) nr. 116/2009 mbi eksportimin e mallrave kulturore

II.2 Përmbledhje e arritjeve legjislative kryesore

Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" synon:

- Fuqizimin e kompetencave të institucioneve që realizojnë drejtpërdrejt shërbimin arsimor nëpërmjet decentralizimit, dekoncentrimit e autonomisë shkollore dhe saktësimi i rolit të nivelit qendror në politika bërje e vendosjen e standardeve të cilësisë së shërbimit arsimor.
- Përmirësimin e ndjeshëm të aftësive menaxhuese në sistemin arsimor nëpërmjet përcaktimit më të qartë të përgjegjësive të institucioneve e individëve, vlerësimit të jashtëm, vetëvlerësimit e raportimit periodik të punonjësve arsimorë e institucioneve dhe shtimit të transparencës së performancës së tyre. Vendosjen e baraspeshës ndërmjet përgjegjësive dhe hapësirës vendimmarrëse.
- Shtimin e larmisë së kurrikulës që t'i shkojë më përshtat larmisë së prirjeve, mundësive dhe aspiratave të karrierës së nxënësve.

Ligji Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
Risitë kryesore të këtij ligji janë si vijon:

- Rrit lirinë akademike, autonominë financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit;
- Garanton arsimimin e lartë jo vetëm për ata që kanë mundësi financiare, por dhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit, por që nuk kanë mundësi financiare për të studiuar .
- Krijon kushtet për një arsim të lartë që t'i përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit;
- Unifikon dhe standardizon sistemin e arsimit të lartë;
- Heq maturën shtetërore, përcakton notën mesatare si kriter bazë dhe u jep IAL-ve të drejtën të përcaktojnë kritere shtesë për pranimin e studentëve dhe të përzgjedhin ata fitues;
- Krijon mekanizma të qëndrueshme të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të IAL-ve, në mënyrë që të sigurohen standarde evropiane për arsimin e lartë;
- Krijon baza financiare të qëndrueshme dhe mundësi për të shfrytëzuar burime të ligjshme financimi;
- Ligji sanksionon raportin që duhet të ekzistojë midis pranimeve në IAL dhe aftësive të këtyre të fundit për të përthithur fluksin e studentëve;
- Mundëson konkurrencën e lirë mes IAL-ve, personelit akademik dhe studentëve;
- Përcakton detyrimin për të mbështetur vetëm institucionet publike të arsimit të lartë me infrastrukturë të nevojshme kërkimore-shkencore;
- Krijon fondin për mbështetjen studentore (studentë të shkëlqyer, studentë në programet e studimit që janë prioritet kombëtar, studentë të shtresave në nevojë) për studentë të institucioneve publike të arsimit të lartë;
- Mundëson dhënien e kredive studentëve për të përballuar kostot e studimeve dhe kreditë për institucionet publike me qëllim zhvillimin e tyre institucional dhe infrastrukturor;
- Krijon dy qendra të reja: Qendra për Shërbimet Arsimore që ofron shërbime për qytetarët dhe akses publik në të dhënat për arsimin e lartë; dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të lartë;
- Ristrukturon institucionet ekzistues si Agjencia e Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia e Akreditimit Publik të Arsimit të Lartë dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar synon:

- Përgatitjen e të rinjve me njohuri e shprehi të përshtatshme me kërkesat dinamike të tregut të punës përmes modernizimit të AFP, duke u bazuar në kërkesat e niveleve të kualifikimit sipas KSHK.
- Ofrimin e mundësive për përditësim të dijeve e aftësive të të rriturve në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

Ligji Nr. 10 247, datë 04.03.2010 "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve",përafrohet plotësisht me "Kornizën e Kualifikimeve në Sistemin e Arsimit të Lartë Evropian", miratuar nga Ministrat përgjegjës të arsimit të lartë evropian në Konferencën e Bergen, datë 20.05.2005; Ky akt është hartuar dhe ndryshuar në përafrim të plotë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Projekt – ligji për Trashëgiminë Kulturore

Ka përfunduar përgatitja e draftit të ri të ligjit pas një konsultimi të kujdesshëm me grupet e interesit/palët e interesuara. Hartimi i këtij ligji ka qenë një proces kompleks, sepse përveç analizës së mangësive të ligjit aktual, ka qenë i nevojshëm studimi i legjislacionit në fuqi që rregullon pjesë të caktuara që janë objekt i ligjit të trashëgimisë kulturore si dhe krijimi i një modeli të qartë veprimi duke marrë parasysh jo vetëm ruajtjen e trashëgimisë kulturore të vendit, por edhe administrimin e tyre në bashkëpunim me biznesin. Ky projektligj përafron legjislacionin shqiptar me Direktivën 2014/60/EU për " Kthimin e objekteve kulturore të trafikuara në mënyrë të paligjshme nga territori i një vendi anëtar", si dhe me Rregulloren e Këshillit (EC) Nr.1081/2012 mbi "Eksportin e mallrave kulturorë". Gjithashtu, projektligji mbi trashëgiminë kulturore është fokusuar në përmirësimin dhe riorganizimin e mbrojtjes së siteve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë rishtazi dhe peizazhin dhe do të përmirësojë sistemin e administrimit të siteve të trashëgimisë kulturore duke prezantuar forma të tilla administrimi dhe mbikëqyrjeje të trashëgimisë kulturore që do të mundësojnë nga njëra anë, një situatë të përmirësuar inputesh në to, dhe nga ana tjetër një mbikëqyrje rigoroze të vlerave kulturore që administrohen nga institucionet e trashëgimisë kulturore dhe një promovim më të mirë të tyre. Projekt-ligji parashikon sanksione ligjore të një forme të plotë dhe të diversifikuar për ashpërsimin e masave administrative për personat fizikë dhe juridikë që shkelin rëndë dispozitat e këtij projektligji. Ministria e Kulturës ka nënshkruar në Korrik 2016 një marrëveshje me AADF, Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillimin, për mbështetjen me ekspertizë ligjore në fazën finale të projektligjit. Projektligji parashikon dispozita të rëndësishme për Institucionet e specializuara në fushën e Trashëgimisë Kulturore; Organet Kolegjiale të Trashëgimisë Kulturore; mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore; përdorimin, vlerësimin dhe administrimin e pasurive kulturore; qarkullimin, parablerjen, shpronësimin e pasurive kulturore; pasuritë e pejsazhit si dhe sanksionet administrative që aplikohen për rastet e shkeljes së dispozitave. Projektligji është parashikuar të përfundojë në Dhjetor 2016 si dhe është parashikuar të miratohet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë brenda tremujorit të 2017.

Projekt –Ligji "Për Muzetë"

Grupi i punës që po punon për draft-Ligjin "për Trashëgiminë Kulturore" ka vendosur që në këtë draft ligj të përfshijë edhe draft pjesën që rregullon sistemin e muzeve në Shqipëri si një komponent i rëndësishëm i mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore. Për pasojë, amendimet në Ligjin Nr. 9387, datë 04.05.2005 "Për muzetë", të parashikuar brenda vitit 2015, nuk do të realizohen, dhe ky ligj do të shfuqizohet. Kjo do të mundësojë realizimin e objektivit për të pasur një ligj plotësisht të integruar në rendin juridik shqiptar për Trashëgiminë Kulturore, si në rastin e praktikave ligjore më të mira të vendeve evropiane dhe më gjerë.

II.3 Përmbledhje e institucioneve përgjegjëse kryesore

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
- Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP),
- Agjencia e Arsimit dhe Zhvillimit (AAZh) ,
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit (IShA),
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve,
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL),
- Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZhA),
- Inspektorati Kombëtar i Arsimit Para-universitar (IKAP),
- Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFPK),
- Ministria e Kulturës
- INSTAT
- Ministria e Shëndetësisë

II.4 Përcaktimi i Alokimeve Financiare

në 000/Lek

	2017	**2018**	**2019**
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	58.221.910	59.369.600	60.541.402
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	23.323.000	23.323.000	23.323.000
Buxheti total i Kapitullit	81.544.910	82.692.600	83.864.402

III. Prioritetet

Prioritetet janë si më poshtë:

1. Rritja e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor
    - Zhvillimi i kapitalit njerëzor duke investuar në fëmijërinë e hershme

- Mundësi hyrjeje dhe përfshirje masive e të gjithë fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor
- Rritja e cilësisë së shërbimit të mësimdhënies dhe të të nxënit.

2. Reforma në sistemin parauniversitar
    - Reforma në sistemin parauniversitar do të përqendrohet në radhë të parë në rritjen e cilësisë së sistemit arsimor, duke hartuar dhe zbatuar një sistem drejtimi dhe kontrolli vendor dhe kombëtar më të besueshëm. (reformë strukturore 5+4+3 vjet, rishikimi i altertekstit, kurrikula të reja bazuar në kompetenca dhe jo objektiva, karta e performancës/arritjeve për çdo shkollë, vlerësim kombëtar të nxënësve, përmirësimi i procesit të Maturës Shtetërore). Krijimi i një baze të dhënash për menaxhimin efikas administrativ dhe digjitalizimin e çdo procesi të administrimit arsimor, si mjet i domosdoshëm për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.
    - Përmirësimi i infrastrukturës shkollore: sistemi EMIS të jetë tërësisht funksional, planifikim shkollash të reja, shkolla si qendra komunitare.
    - Proces më të mirë vendimmarrjeje duke krijuar një komunikim të ri shkollë-prindër-qeveri, duke e bërë prindin pjesë të komunikimit dhe arsimimit, do të realizohet llogaridhënia e ndërsjellë dhe do të garantohet cilësia në rekrutimin e mësuesve. Procedura e re e rekrutimit të mësuesve, ku shkolla bashkë me bordin e senatin e saj, komitetin e prindërve, komunitetin e qeverisjes vendore dhe nxënësit, vendos bashkërisht për zgjedhjen e mësuesve, do të institucionalizohet më tej.
    - Gjithëpërfshirje sasiore dhe cilësore e grupeve të margjinalizuara (uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën, pakësimi i dukurisë së korrupsionit: zbatimi i rreptë i masave ndëshkuese për të gjitha praktikat korruptive të denoncuara dhe evidentuara).
    - Zhvillimi profesional i mësuesve dhe forcimi i kapaciteteve drejtuese dhe menazhuese në institucionet e AP.
3. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë
    - Ofrimi i një cilësie shumë të mirë në arsimin e lartë: ngritja e cilësisë në standardet evropiane dhe qëndrueshmëri, për të fituar besimin e shoqërisë dhe të institucioneve kombëtare; reformë thelbësore në kuadrin ligjor si në drejtim të programeve të studimit (zhvillimi i panevojshëm i disa profesioneve dhe i mangët i disa profesioneve të tjera më të kërkuara në tregun e punës, e deri në cilësinë e diplomave)
    - Efiçencë financiare nëpërmjet menaxhimit dhe alokimit efikas
    - Njohje ndërkombëtare dhe emër/përfaqësim më të mirë
    - Hartimin e një skeme të re financiare për universitet publike, bazuar në arritje dhe rezultate të institucioneve arsimore, vendosjen e një mekanizmi të ri për dhënie llogari ndaj shtetit dhe aktorëve të tjerë publikë.
    - Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2016-2021, përparësitë strategjike të së cilës, në përputhje dhe me programin e qeverisë shqiptare si dhe me planifikimin buxhetor afatmesëm do të jenë: 1) Përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore; 2) Ruajtja dhe mbrojtja e

trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza ; 3) Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve; 4) Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare (materiale dhe shpirtërore) në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare; 5) Hartimi dhe zbatimi i platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore dhe në sistemin parauniversitar.

- Zbatimi me sukses i Platformës kombëtare "Edukimi përmes Artit" nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë;
- Forcimi i partneritetit publik dhe privat për realizimin e projekteve rijetezuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Rishikimi i ligjit "për Artin dhe Kulturës" Nr. 10352, datë 18.11.2010,me fokus përmirësimin e kuadrit ligjor në funksion të menaxhimit të sistemit kulturor institucional e më gjerë brenda vitit 2016;
- Rishikimi i Ligjit për Librin, Nr. 9616, datë 27.09.2006 për hartimin e bazës ligjore për krijimin e Qendrës Kombëtare të Librit, brenda vitit 2016;

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2020

IV.1 Arsimi dhe formimi profesional

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e Referuar**
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)	2014 – 2020
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë(MMSR)	2014 – 2020

Kuadri i masave ligjore ekzistuese

***Acquis* i BE-së s**	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni Kryesor**	**Niveli i përafrimit**	**Data e miratimit të legjislacionit Shqiptar**	**Data e Hyrjes në Fuqi të legjislacionit shqiptar**
Direktiva Nr.(2000/c, 364/01) c 364/1 (celex no. 12010p001); (2006/962/ec	Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë "Ligj Nr. 56/2015 "Për disa ndryshime në	MAS	I pjesshëm	22.7.2015	21.9.2015

(celex no. 32006h0962)OJ C 115 date 9.5.2008, p 120-1; ROJ(2009/C 155/02); ('ET 2020') OJ(2009/C 119/02; 16459/08 EDUC 278 SOC 736 MI 499; OJ (2006/C 298/05 date 8.12.2006);	ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".				
Deklarata e Bolonjës datë 19 korrik 1999	Ligji Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"	MAS	I plotë	12.9.2015	27.9.2015
Direktiva 2005/36 EC	Ligj Nr. 8872 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me Ligjin 63/2014	MMRS/MAS	I pjesshëm	26.6.2014	18.07.2014
Vendimi i Këshillit 2005/517/KE, datë 22 Nëntor 2004 "Mbi firmosjen e një Marrëveshje Kuadër ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Bashkimit Europian" CELEX 32005L0517, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria	Ligji nr. 117/2014, datë 11.09.2014 "Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Erasmus +, programi i BE-së për Rininë dhe Sportin	MAS	I plote	11.09.2014	26.9.2014.

L, Nr. 192, dt. 22. 07. 2005. Rregullorja (BE) Nr. 1288/2013 e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 "Mbi krijimin e 'Erasmus +': Programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin" (shfuqizon Vendimet Nr. 1719/2006/KE, Nr. 1720/2006/KE dhe Nr. 1298/2008/KE), CELEX 32013L1288,					

Kuadri i politikave të planifikuara 2017-2020

Titulli (Strategji, PV, AP, Dokument Politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha referencë**	**Data e miratimit**	**Hyrja në fuqi**
Amendimi i Ligjit te i Arsimit Parauniveritar	MAS	2017 – 2020	Katërmujori i I i 2017	Katërmujori i I i 2017
Plani i Punës për pilotimin e kurrikulës së re në institucionet arsimore të arsimit bazë në sistemin arsimor parauniversitar" 2015-2019	MAS IZHA	2017 – 2019	T2 2017	T3 2017

Masat e Planifikuara Ligjore 2017 – 2020

Acquis i BE-së	Statusi i përkthimi në Shqip (Po/Jo)	Legjislacioni Shqiptar;	Statusi i përkthimit në anglisht (Po/Jo)	Institucioni Përgjegjës/Pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e Planifikuar e Miratimit	Data e Hyrjes në fuqi
AFAT SHKURTRA (2017)							
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për shpërndarjen e fondeve nga buxheti i shtetit në institucionet e arsimit të lartë publik, granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese", për vitin 2017-2018	Jo	MAS	I Plotë	Katërmujori i I i 2017	Katërmujori i I i 2017
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendimi "Për caktimin e tarifave të shërbimit ndaj të tretëve për qendrën e shërbimeve arsimore";	Jo	MAS	I Plotë	Katërmujori i I i 2017	Katërmujori i I i 2017
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për organizimi dhe funksionimin e Agjencisë Kombetare e Financimit te Arsimit te Larte"	Jo	MAS	I Plotë	Katërmujori i I i 2017	Katërmujori i I i 2017
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për organizimin dhe funksionimin e	Jo	MAS	I Plotë	Katërmujori i I i 2017	Katërmujori i I i 2017

		Agjencisë së Sigurimit të Cilësië në Arsimin e Lartë, Bordit te Akreditimit dhe tarifave te vleresimit te cilesise ne arsimin e larte"					
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për Hartimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë "	Jo	MAS	I Plotë	Katermujori II 2017	Katermujori II 2017
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për skemen e kreditimit studentor dhe kushtet qe duhen plotesuar per aplikimin per kredi	Jo	MAS	I Plotë	Katermujori II 2017	Katermujori II 2017
Direktiva 200/78/KE	Jo	Projektligji për AFP	Jo	MMSR	I pjesshëm	T4 2017	T4 2017
AFAT MESËM (2018 – 2019)							

IV.2 Kultura

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e Referuar
Programi i Qeverisë Shqiptare 2013-2017. Seksioni Shërbimet Publike / Kultura dhe Trashëgimia Kulturore	Ministria e Kulturës	2013 – 2017

Kuadri i masave ligjore ekzistuese

Acquis i BE-së s	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Kryesor	Niveli i përafrimit	Data e miratimit të legjislacionit Shqiptar	Data e Hyrjes në Fuqi të legjislacionit shqiptar
Direktiva 2014/60/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e dt. 15.05.2014 mbi kthimin e objekteve kulturore te hequra ne mënyre te jashtëligjshme nga territori i një Shteti Anëtar dhe që amendon Rregulloren (KE) Nr 1024/2012	Ligji nr. 9386, dt. 4.5.2005 "Për muzetë "	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	4.05.2005	26.06.2005
	Ligji nr. 9048 dt. 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore "	Ministria e Kulturës	I pa–përafruar	7.04.2003	02.06.2003
Rregullore (EU) Nr 1081/2012 mbi eksportin e mallrave kulturore	Ligji nr. 9386, dt. 4.5.2005 "Për muzetë"	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	4.05.2005	26.06.2005
	Ligji nr. 9048 dt. 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore "	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	7.04.2003	02.06.2003

Kuadri i Planifikuar i Politikave 2017 – 2020

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e Referimit	Data e Miratimit	Data e hyrjes në Fuqi
Strategjia Kombëtare e Kulturës 2017-2021	Ministria e Kulturës	2017 – 2021	Qershor 2017	

Masat e Planifikuara Ligjore 2017 – 2020

Acquis i BE-së	Statusi i përkthimi në Shqip (Po/Jo)	Legjislacioni Shqiptar;	Statusi i përkthimit në anglisht (Po/Jo)	Institucioni Përgjegjës/Pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e Planifikuar e Miratimit	Data e Hyrjes në fuqi
AFAT SHKURTRA (2017)							

Rregullore (BE) Nr. 1081/2012 mbi eksportin e mallrave kulturore	Jo	Ligji i ri "Për trashëgiminë kulturore"	Jo	Ministria e Kulturës	I Plotë	2017	2017
AFAT MESËM (2018 – 2020)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura					
Përfituesi: Ministria e Arsimit dhe Sportit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Kontributi per procesin e Integrimit	A) Pagat – stafi ekzistues	104,000	83,520	69,600	257,120
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet	**104.000**	**83520**	**69600**	**257.120**
	A) Pagat – stafi ekzistues				
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet				

	operative				
	Totali për aktivitet	**29.058.955**	**29.643.040**	**30.235.901**	**88.937.896**
Hartimi I Akteve Ligjore ne Zbatim te Ligjit te Arsimit te Larte	A) Pagat – stafi ekzistues	29.058.955	29.643.040	30.235.901	88.937896
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet	**29.058.955**	**29.643.040**	**30.235.901**	**88.937.896**
Buxheti i përfituesit total		**58.221.910**	**59.369.600**	**60.541.402**	**178.132.912**

Kapitulli : 26					
Përfituesi: Ministria e Kulturës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2016-2021 dhe hartimi i kuadrit ligjor për realizmin e kësaj strategjie	A) Pagat – stafi ekzistues	11,748,667 Lekë	11,748,667 lekë	11,748,667 Lekë	35,246,001 Lekë
	B) Pagat – stafi I ri	-	-	-	-
	C) Trajnime	-	-	-	-
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	1,200,000 Lekë	1,200,000 Lekë	1,200,000 Lekë	3,600,000 Lekë
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	3,000,000 Lekë	3,000,000 Lekë	3,000,000 Lekë	6,000,000 Lekë
	Totali për aktivitet	**15,948,667 Lekë**	**15,948,667 Lekë**	**15,948,667 Lekë**	**47,846,001Lekë**
	A) Pagat – stafi ekzistues	5,874,333 Lekë	5,874,333 Lekë	5,874,333 Lekë	17,622,999 Lekë

Hartimi i ligjit të ri " Për trashëgiminë kulturore " dhe hartimi i kuadrit ligjor per adoptimin e ligjit të ri	B) Pagat – stafi I ri	-	-	-	-
	C) Trajnime	-	-	-	-
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	-	-	-	-
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	1,500,000 Lekë	1,500,000 Lekë	1,500,000 Lekë	4,500,000 Lekë
	Totali për aktivitet	**7,374,333 Lekë**	**7,374,333 Lekë**	**7,374,333 Lekë**	**22,122,999 Lekë**
	Total kapitulli				69,969,000 All

Tabela B – Fondet e asistencës së huaj

Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
Ministria e Kulturës	ArtVision ("Adriatic Live Art Channel")	IPA Adriatik	198.713 Euro	Objektivi i përgjithshëm i projektit ArtVision është ngritja e sasisë dhe cilësisë së komunikimit ndër-kulturor ndërmjet popullsive të ndryshme të vendeve të Adriatikut që synojnë të përdorin strategji këtë tematik të komunikimit televiziv e satelitore dhe për të aktivizuar metodologji inovative të planifikimit pjesë e politikave kulturore në nivel institucional, përfshirë direkt vendimmarrësit

				Adriatik. Aktivitetet: 1 Future Kërko Konferenca dhe politikave bashkëkohore kulturore – krahasim krijues; 5 Art në Port - Adriatikut Art Ngjarje; 125 artet audiovizuale produkteve të prodhuara; Një Plan Qëndrueshmëria ndërkufitar në mënyrë që të transmetojë dhe promovimin e produkteve të krijuara në kuadër të projektit
Ministria e Kultures	Adrifort (Adrifort-Adriatic fortresses and military areas)	IPA Adriatik	138.183 Euro	Projekti synon ide efektive dhe zgjidhje të aplikueshme që mund të transferohen në kontekste të tjera dhe trashëgimive kulturore ekzistuese në të gjithë zonën e Adriatikut. Rrjeti ADRIFORT përfshin një seri të mjeteve të punës të hapura për të gjithë për një të vërtetë njohuri evropian të përbashkët: një hartë e fortesave të Adriatikut, një laborator vizuale, një qendër kryq dokumentacionit kufitar, shumë punëtorive territoriale, investimet mbi

				kështjella, pjesë e projektit; web site dhe gazetat periodike.
Ministria e Kultures	Rehabilitim i manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe peizazhit të vendit arkeologjik të Apolonisë, Fier Shqipëri	IPA Multibeneficiary	780.000 Euro	Restaurimi dhe Konservimi i Manastirit të Shën Mërisë në parkun arkeologjik të Apollonisë; Përmirësimi i peizazhit të parkut
		Totali për Kapitullin:	**1.116,896 Euro**	

KAPITULLI 27: MJEDISI

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e Kapitullit

Politikat e BE-së për mjedisin kanë si qëllim që të promovojnë ndërmarrjen e veprimeve më të forta ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe mbrojtjes së mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen mbi integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin ndotësi paguan, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim dhe ndarjen e përgjegjësive. Legjislacioni mjedisor i BE-së përfshin dispozita që trajtojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, organizmat e modifikuara gjenetikisht, kimikatet, zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme, por sjell edhe përfitime të rëndësishme. Një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal është e domosdoshme për aplikimin dhe zbatimin e *acquis*.

I.2 Situata Aktuale në Shqipëri

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat kryesorë të Shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit siguron bazat për akte ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, etj. Megjithëse, Shqipëria është në një fazë të hershme të përgatitjeve në këtë fushë, ka pasur disa përparime në fushën e mjedisit dhe atë të ndryshimeve klimatike. Përafrimi me *acquis* ka përparuar, por përsëri nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një përafrim të plotë me *acquis* mjedisor të BE-së. Në këtë kuadër, si dhe me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, Shqipëria ka vijuar me hartimin dhe amendimin e disa ligjeve kryesore, si dhe hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e mjedisit dhe atë të ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, edhe procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përmirësuar ndjeshëm, por duhet të forcohet edhe më shumë, veçanërisht në sektorin e hidrocentraleve dhe atë të minierave.

Në korrik 2016, Qeveria Shqiptare ratifikoi Marrëveshjen e Parisit si hapi kryesor drejt zbatimit të saj. Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë drejtuar Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (Tetor 2016), ka identifikuar një seri masash prioritare lidhur me reduktimin e gazeve serrë dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke bërë të mundur që Shqipëria të aktivizojë burimet që bazohen në mekanizmat politikë dhe të tregut.

Planifikimi sistematik strategjik në fushën e menaxhimit të interguar të burimeve ujore po zhvillohet në përputhje me kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/EC dhe të gjithë kuadrit ligjor evropian. Një sërë dokumentash të rëndësishëm për këtë fushë janë në proces hartimi, me asistencë të Bankës Botërorë dhe SIDA-s, të cilat janë në funksion të një përqasje të re në politikat e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

Në vijim të reformës së ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare me fokus mirë qeverisjen dhe menaxhimin e integruar të ujit, si dhe reformës territoriale administrative, lindi nevoja për reformimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotur. Në këtë kuadër, si dhe në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, ka përfunduar riorganizimi i rreth 60 % të Shoqërive Aksionere të Ujësjellës - Kanalizimeve. Gjithashtu, progres ka patur edhe në fushën e menaxhimit të ujërave ndërkufitarë me vendet fqinje si Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia, ku për secilin prej tyre janë përgatitur marrëveshjet dypalëshe me këto shtete për menaxhimin e ujërave ndërkufitarë.

Që nga shkurti 2015, fusha e menaxhimit të ujërave është përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), ndërkohë që është krijuar edhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), me rol kryesor në koordinimin e punës për çështjet dhe problematikat e sektorit të ujit në vend. Me VKM nr. 386, datë 6.05.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Ujit (ISHU)” është krijuar Struktura e Inspektoriatit Shtetëror të Ujit. ISHU është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën e ujërave në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ujërat. Kjo strukturë inspekton burimet ujore dhe merr masat përkatëse për ndërshkimin e përdoruesve të ujit pa leje apo të atyre që shkelin kushtet e lejes përkatëse të përdorimit të burimit ujor.

Për tu theksuar është fakti se disa vendime të qeverisë kanë përmirësuar ndjeshëm partneritetin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile. Miratimi i VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për miratimin e rregullave, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", miratimi i VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, miratimi i VKM nr. 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit

strategjik mjedisor", rritja e numrit të stafit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) i përfshirë drejt për drejt në shqyrtimin e aplikimeve për lejet mjedisore, kryerja rregullisht e konsultimeve me publikun për planet e mjedisit, programet dhe legjislacionin, organizimi i takimeve të rregullta me OJQ-të mjedisore, si dhe shpërndarja e Buletineve Mjedisore Javore dhe Mujore, kanë përmirësuar ndjeshëm situatën lidhur me ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrjen mjedisore, si dhe aksesin e publikut për informacion mjedisor. Gjithashtu, miratimi i Ligjit nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10440/2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis'", i cili bëri të mundur që aplikimet për vlerësimin e ndikimit në mjedis të mos kryhen më pranë QKL-së (sot QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit), por direkt pranë Ministrisë së Mjedsit (MM), ka ndikuar në përmirësimin e procesit të informimit dhe konsultimeve të publikut, si dhe ka eleminuar konceptin "miratim në heshtje" për procesin e VNM-së.

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së dëgjesave me publikun dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, AKM në mars 2016 ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi me secilën prej tre Qendrave të Aarhusit në Shqipëri (Qendra e Aarhusit Tiranë, Qendra e Aarhusit Shkodër dhe Qendra e Aarhusit Vlorë). Këto MoU synojnë rritjen e bashkëpunimit ndërmjet AKM-së dhe Qendrave të Aarhusit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është riorganizuar ku përveç ndryshimit të emrit në Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si dhe shtimit të përgjegjësive, është rritur edhe numri i punonjësve. Në varësi të AKM-së kanë kaluar edhe 12 Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), të cilat operojnë dhe koordinojnë punën dhe funksionet e tyre me ato të AKM-së si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar.

Me organizimin e ri të AKM-së dhe në përputhje të plotë me detyrat dhe përgjegjësitë e saj, vëmendje e veçantë i është dhënë edhe forcimit të Laboratorit të AKM-së. Laboratori është zhvendosur në një vend të ri, plotësisht të rinovuar dhe në përputhje me standardet e kërkuara *ISO 170 25* të manualit të cilësisë. Përveç rinovimit të ndërtesës së Laboratorit të AKM-së, është realizuar edhe blerja e pajisjeve teknike për analizimin dhe monitorimin e parametrave themelor të cilësisë së ujit, si dhe është rritur numri i stacioneve të monitorimit të ajrit. Tashmë AKM realizon edhe monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor, lumenjve, liqeneve dhe ujërave bregdetar, si dhe përcaktimin e metaleve të rënda në lumenj. Numri i stacioneve të monitorimit në lumenj, liqene dhe në pjesët bregdetare është rritur ndjeshëm. Megjithatë, pavarësisht forcimit në mënyrë të konsiderueshme të kapacitetit administrativ të AKM-së, si dhe përmirësimit të sistemit të montorimit mjedisor, përsëri ka nevojë për më shumë financime.

Gjithashtu, AKM-ja ka ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm për të adresuar çështjen e vetë-monitorimit të emetimeve, të cilët janë shoqëruar me një përparim të dukshëm për sa i përket procesit të dorëzimit të raporteve të vetë-monitorimin, verifikimit të cilësisë së të dhënave, si dhe respektimit të afateve të përcaktuara për dorëzimin e raporteve. Tashmë, mbledhja, verifikimi dhe regjistrimi i të dhënave nga raportet e

vetë-monitorimit të dorëzuara në AKM nga të gjithë operatorët privatë që i nënshtrohen lejes mjedisore është një proces i rregullt. Të dhënat e marra nga këto raporte janë përdorur për të ushqyer sistemin elektronik të të dhënave të AKM-së, i cili është pjesë e Sistemit Kombëtar të Informimit.

Në shkurt 2014, është krijuar Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP), i cili është një institucion publik, i financuar nga buxheti i shtetit, në varësi të MM-së. Misioni i tij është garantimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e mjedisit dhe pyjeve.

Me qëllim përmirësimin e zbatimit të ligjit, Inspektorati i Mjedisit ka rritur ndjeshëm numrin e kontrolleve në zonat industriale, ku në kryerjen e kësaj detyre ka bashkëpunuar ngusht me inspektoratet dhe institucionet e tjera shtetërore. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë një sërë masash administrative për sa i përket shkeljeve të kushteve të lejes mjedisore, si dhe detyrimeve të tjera që lindin nga legjislacioni mjedisor.

Gjithashtu, me qëllim mbrojtjen e natyrës dhe ndalimin aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura, janë ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm siç janë **(i)** amendimi i ligjit për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës. Tashmë, Qendra Kërkimore për Florën dhe Faunën duhet të konsultohet përpara se të lëshohet një leje për tregtimin e tyre, **(ii)** miratimi i akteve ligjore që ndalojnë gjuetinë apo transportin e qymyrit të drurit, **(iii)** nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme "Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pyjeve", i cili krijon Task Forcën mbi Pyjet, **(iv)** rritja e numrit të kontrolleve nga ana e Policisë Pyjore, **(v)** vendosja e masave administrative për të gjithë shkelësit e legjislacionit mjedisor, etj. Bazuar në VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", janë krijuar Drejtoritë e Pyjeve në çdo bashki që menaxhon fondin pyjor e kullosor të transferuar sipas VKM-ve.

Në kuadër të reformës për menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura, në shkurt 2015, u krijua Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) si një institucion në varësi të MM-së, që siguron për herë të parë në vend krijimin e administratave të pavarura të zonave të mbrojtura, jashtë strukturave të shërbimit pyjor. Në këtë kontekst, është hartuar Programi Strategjik 2015-2020 për Zonat e Mbrojtura, i cili synon përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare dhe eksperiencës së vendeve evropiane, duke ruajtur dhe përdoruar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore në to.

Qeveria Shqiptare ka konsideruar çështjen e mbetjeve, si një ndër gjashtë prioritetet e programit analitik, duke i dhënë rëndësi të lartë trajtimit dhe depozitimit fundor të mbetjeve të ngurta urbane. Në përputhje me politikat e Qeverisë Shqiptare për garantimin e një mjedisi të pastër e të shëndetshëm, shumë prej burimeve njerëzore dhe financiare të qeverisë i janë dedikuar zhvillimit të një kuadri të mirë ligjor, bazuar në

transpozimin e legjislacionit të BE-së për fushën e mbetjeve. Në mënyrë që të ofrohet një zgjidhje e qëndrueshme për këtë problem dhe të rritet niveli i kontrollit në depozitimin e mbetjeve, është miratuar VKM nr. 645, datë 14.09.2016 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave, si marrës, dhe KfW, Frankfurt am Main, për financimin e shërbimeve të ekspertit ndaj marrësit në kuadër të një studimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri, financuar nga një fond i veçantë (nr. 11469) të dhënë nga Qeveria Gjermane". Ky grant do të ndihmojë në zhvillimin e një plani kombëtar, i cili do të orientojë, kostojë dhe prioritizojë investimet në këtë sektor, duke u bazuar në situatën aktuale në terren, si dhe duke marrë parasysh detyrimet që lindin nga procesi i përafrimit në BE.

Ky studim, i cili pritet të zbatohet gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2017, do të shërbejë për të përcaktuar metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet në të ardhmen në këtë sektor, si dhe ofrimin e një plani investimesh të shkallëzuar për infrastrukturën vendore dhe rajonale në lidhje me grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve dhe pajisjeve për trajtimin dhe/ose asgjësimin e mbetjeve.

Me qëllim evidentimin e zonave të ndotura, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) në vitin 2015, ka ndërtuar hartën dhe databazën e parë të venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane për të gjithë territorin e Shqipërisë. Harta është një platformë interaktive e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS), e cila është bërë e aksesueshme për të gjithë publikun. Harta momentalisht paraqet 92 venddepozitime aktive, por në vazhdim informacioni do të përditësohet me zhvillime të tjera në terren, si dhe krijimin e modelimeve për landfillet.

Miratimi i Ligjit nr. 27, datë 17.03.2016 "Për menaxhinin e kimikateve", si dhe miratimi i 3 akteve nënligjore që rregullojnë importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme, kufizimet dhe ndalimet e tyre përpara vendosjes në treg, listën e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë, si dhe krijimi i zyrës së kimikateve, është hapi i parë në krijimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut nga kimikatet me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit.

Me qëllim vazhdimin me sukses të hapave të ndërmarrë për forcimin e zbatimit të ligjit, lindi nevoja e riorganizimit të stafit të MM-së në të gjithë territorin e vendit. Për këtë qëllim, në mars 2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar strukturën e re të MM-së dhe institucioneve të saj të varësisë. Në këtë kuadër, është rritur me 62 punonjës numri i inspektorëve pyjorë pranë ISHMP. Gjithashtu, po në këtë kuadër, si dhe duke qënë se fizikisht është e pamundur për të ngritur struktura të mirëfillta më vete të shërbimit këshillimor (ekstensionit), është menduar që specialistët që do të kryejnë këtë funksion të jenë të atashuar për efekt administrimi pranë Administratës së Zonave të Mbrojtura në 12 qarqe ku aktualisht funksionon AKZM, numri i punonjësve të së cilës ka ndryshuar nga 224 punonjës në 274, pra ka pësuar një rritje prej 50 punonjësish.

Referuar komunikimeve të herë pas herëshme me institucionin e Prokurorit të Përgjithshëm, në ristrukturimin e ri është parashikuar edhe emërimi i 13 Oficerëve të Policisë Gjyqësore (OPGJ). Një nga Oficerët do të akomodohet pranë zyrave qendrore të ISHMP-së ndërsa të tjerët në secilën prej degëve të ISHMP-së në qarqe. Përveçse kërkesë e legjislacionit "Për prokurorinë në RSH", nevoja për emërimin e këtyre OPGJ-ve vjen edhe si masë në luftën kundër prerjes së pyjeve në mënyrë të paligjshme, pasi Qeveria e Shqipërisë dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kanë miratuar Ligjin nr. 5/2016, datë 04.02.2016 "Për Shpalljen e Moratoriumit në Pyje në Republikën e Shqipërisë", i cili kufizon ndërhyrjen në fondin pyjor për një periudhë prej 10 vjetësh. Kjo iniciativë ligjore, e cila ka si qëllim përmirësimin e zonave të degraduara pyjore, parandalimin dhe kontrollin e erozionit, si dhe përmirësimin e peisazhit dhe rehabilitimin e zonave të dëmtuara nga prerjet ilegale, ndër të tjera kërkon marrjen e masave administrative dhe të inspektimit me qëllim realizimin me sukses të moratoriumit si të gjuetisë ashtu edhe të pyjeve. OPGJ-të do të administrojnë, plotësojnë dhe përfaqësojnë interesat e ISHMP/MM në këtë proçes pranë prokurorive përkatëse, ndërkohë që territori do të mbulohet me inspektorë pyjorë.

Gjithashtu, për të përmbushur sa më mirë prioritetet e Qeverisë Shqiptare në fushën e mjedisit, si dhe për të përshpejtuar përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Kapitullit 27 "Mjedisi", ndryshime ka pësuar edhe struktura e MM-së. Në këtë kuadër, Njësia e Jetësimit të Prioriteteve nuk do të jetë më një drejtori më vete, por ajo do ti bashkohet Drejtorisë së Mjedisit, e cila tashmë do të ketë 5 sektorë (Sektori i Mbetjeve, Sektori i VSM-së, VNM-së dhe Standarteve Mjedisore, Sektori i Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike, Sektori i Kimikateve, Zhurmave dhe Aksidenteve Industriale, si dhe Sektori i Jetesimit të Prioriteteve).

I.3 Struktura e Kapitullit

1. Legjislacioni Horizontal;
2. Cilësia e Ajrit dhe Ndryshimet Klimaterike;
3. Menaxhimi i Mbetjeve;
4. Menaxhimi i Ujërave;
5. Mbrojtja e Natyrës;

6. Ndotja Industriale, Menaxhimi i Risqeve dhe Aksidentet;
7. Organizmat e Modifikuara Gjenetikisht;
8. Kimikatet;
9. Mbrojtja nga Zhurmat;
10. Pyjet

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e Kërkesave të MSA-së dhe Legjislacionit të BE-së

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit Shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-së, rrjedh nga Neni 108 i MSA-së, në të cilin citohet si më poshtë vijon:

- Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore;
- Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për fushën e mjedisit.

Legjislacioni i BE-së në fushën e mjedisit është i përbërë nga aktet ligjore të mëposhtme:

Për fushën e Legjislacionit Horizontal

- Direktiva 2004/35/ EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21.04.2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi mjedisin", amenduar me Direktivën 2006/21/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 15.03.2006 "Mbi menaxhimin e mbetjeve nga industria nxjerrëse", Direktivën 2009/31/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 Prill 2009 "Mbi depozitimin

gjeologjik të dyoksidit të karbonit" dhe Direktivën 2013/30/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 Qershor 2013 "Mbi sigurinë e operacioneve të naftës dhe gazit në det të hapur";

- Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27.06.2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara";
- Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë13.12.2011 "Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private", amenduar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.04.2014;
- Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26.05.2003 mbi "Tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve e programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi të Direktivave të Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC";
- Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, datë 28.01.2003 mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/313/EEC;
- Vendimi i Këshillit të BE-së 2005/370/EC, datë 17.02.2005 për miratimin në emër të Komunitetit Evropian të Konventës për të drejtën për informim, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatave për çështjet mjedisore.

Për fushën e Cilësisë së Ajrit

- Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 21 Maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën;
- Direktiva 2004/107/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 15 Dhjetor 2004, lidhur me arsenikun, kadmiumin, mërkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit;
- Direktiva 2001/81/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Tetor 2001 mbi Tavanet Kombëtare të Shkarkimit për disa ndotës atmosferik e amenduar nga Direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja 219/2009/EC;

- Direktiva e Këshillit 1999/32/EC e datës 26 Prill 1999 në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në disa lëndë djegëse të lëngshme dhe amendon Direktivën 93/12/EC siç amendohet nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 219/2009 dhe Direktivat 2005/33/EC dhe 2009/30/EC;

- Direktiva 2012/33 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Nëntor 2012 që amendon Direktivën e Këshillit 1999/32/EC në lidhje me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse në transportin detar;

- Direktiva 2010/75/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 24 Nëntor 2010, për shkarkimet industriale (kontrolli dhe parandalimi i integruar i ndotjes), që shfuqizon Direktivën e Këshillit 1999/13/EC e datës 11 Mars 1999 mbi kufizimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme (VOC) për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa aktivitete dhe instalime, e ndryshuar me Rregulloren1882/2003, Direktivën 2004/42/EC dhe Direktivën 2008/112/EC;

- Vendimi i Këshillit 2000/541/EC i datës 6 Shtator 2000 mbi kriteret për vlerësimin e planeve kombëtare në përputhje me Nenin 6, të Direktivës së Këshillit 1999/13/EC (njoftuar në kuadër të dokumentit numër C(2000) 2473);

- Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 94/63/EC e datës 20 Dhjetor 1994 mbi kontrollin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme (VOC) që burojnë nga depozitimi i karburantit dhe nga shpërndarja e tij nga terminalet tek stacionet e shërbimit siç amendohet nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008;

- Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 2009/126/EC e datës 21 Tetor 2009 mbi rikuperimin e avujve të karburantit të Fazës së II, gjatë rimbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shërbimit;

- Direktiva 2004/42/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Prill 2004 mbi limitimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa bojëra dhe llaqe të caktuara dhe produkteve për rilyerjen e automjeteve që amendon Direktivën 1999/13/EC dhe 2009/112/EC dhe Rregulloren (EC) 1137/2008;

- Direktiva e Këshillit 70/220/EEC e datës 20 Mars 1970 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të merren kundër ndotjes së ajrit nga gazet e çliruara nga mjetet motorike me motor me ndezje pozitive;

- Direktiva 97/68/EC e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 16 Dhjetor 1997 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të

brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore, amenduar nga Direktiva 2002/88/EC dhe Direktiva 2004/26/EC, dhe amendimi i fundit i Direktivës 2006/105/EC;

- Direktiva 2005/55/EC e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 28 Shtator 2005 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete;

- Direktiva e Komisionit 2000/71/EC e muajit nëntor të vitit 2000 për adaptimin e metodave të matjes sipas percaktimeve në Anekset I, II, III dhe IV të Direktivës 98/70/EC të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës për progresin teknik të parashikuar në nenin 10 të kësaj Direktive;

- Direktiva 2003/17/EC e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 3 Mars 2003 që amendon Direktivën 98/70/EC në lidhje me cilësinë e lëndëve djegëse benzen dhe naftë;

- Direktiva e Këshillit 96/62/EC e datës 27 Shtator 1996 mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit të mjedisit;

- Rregullorja (EC) 715/2007 e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 20 Qershor 2007 mbi aprovimin e tipit të motorëve të automjeteve në lidhje me shkarkimet nga automjetet për pasagjer dhe tregëtar (Euro 5 dhe Euro 6) dhe mbi aksesin për riparimin e automjeteve dhe mirëmbajtjen e informacionit. Që prej Janarit 2013 kjo Rregullore shfuqizon Direktivat: 70/220/EEC, 72/306/EEC, 77/102/EEC, 74/290/EEC, 78/665/EEC, 80/1268/EEC, 83/351/EEC, 88/76/EEC, 88/436/EEC, 89/458/EEC, 91/441/EEC, 93/59/EEC, 93/116/EC, 94/12/EC, 96/44/EC, 96/69/EC, 98/69/EC, 98/77/EC, 1999/100/EC, 1999/102/EC, 2001/1/EC, 2001/100/EC, 2002/80/EC, 2003/76/EC, 2004/3/EC;

- Rregullorja (EC) 1882/2003 e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës e datës 29 Shtator 2003 që adapton Vendimin e Këshillit 1999/468/EC mbi parashikimet lidhur me komitetin që asiston Komisionin në ushtrimin e fuqisë së tij zbatuese që përcakton instrumentat subjekt i procedurave të referuara në nenin 251 të Traktatit të EC;

- Vendimi i Komisionit 2002/159/EC i datës 18 shkurt 2002 mbi formatin e përbashkët të dorëzimit të të dhënave të përmbledhura kombetare të cilësisë së lëndës djegëse (e njoftuar nën dokumentin me numër C(2002) 508).

Për fushën e Ndryshimeve Klimatike

Mekanizmi Monitorues

- Vendimi i Këshillit 2002/358/EC i datës 25 Prill 2002 në lidhje me miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve;
- Vendimi i Komisionit 2005/166/EC i datës 10 Shkurt 2005 që parashtron rregullat e zbatimit të Vendimit 280/2004/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian lidhur me mekanizmin për monitorimin e emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit dhe për zbatimin e Protokollit të Kiotos;
- Vendimi i Komisionit i datës 14 Dhjetor 2006 që përcakton nivelet përkatëse të emisioneve të akorduara për Komunitetin dhe për secilin nga Shtetet Anëtare të tij sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Vendimit të Këshillit 2002/358/EC (njoftuar nën numrin e dokumentit C (2006) 6468) (2006/944 /EC);
- Vendimi i Komisionit 2010/778/EC i datës 15 Dhjetor 2010 i cili amendon Vendimin 2006/944/EC për përcaktimin e niveleve përkatëse të emetimeve të akorduara Komunitetit dhe secilit prej Shteteve Anëtare të tij sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Vendimit të Këshillit 2002/358/EC;
- Rregullorja (EU) 525/2013 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Maj 2013 e mekanizmit për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë dhe për raportimin e informacioneve të tjera në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian në lidhje me Ndryshimet Klimatike dhe shfuqizimin e Vendimit 280 /2004/EC.

Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të BE

- Direktiva 2003/87/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Tetor 2003 për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit e cila amendon Direktivën e Këshillit 96/61/EC;

- Direktiva 2004/101/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 27 Tetor 2004 e cila amendon Direktivën 2003/87/EC për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e Protokollit të Kiotos-s;

- Vendimi i Komisionit 2006/780/EC i datës 13 Nëntor 2006 mbi shmangien nga llogaritja e dyfishtë e reduktimit të emisioneve të gazeve me efekt serrë sipas skemës për tregtimin e emisioneve të Komunitetit për projektet e aktiviteteve sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe te Këshillit Evropian;

- Direktiva 2009/29/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Prill 2009 e cila amendon Direktivën 2003/87/EC në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit;

- Vendimi i Komisionit 2010/2/EC i cili përcakton një listë të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes se karbonit;

- Rregullorja e Komisionit (EU) 389/2013 e datës 2 Maj 2013 për krijimin e një Regjistri të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, Vendimet 280/2004/EC dhe 406/2009/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, e cila shfuqizon Rregulloret e Komisionit (EU) 920/2010 dhe 1193/2011;

- Rregullorja e Komisionit (EU) 1031/2010 e datës 12 Nëntor 2010 mbi afatin kohor, administrimin dhe aspekte të tjera të ankandit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë në zbatim të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për krijimin e një skeme për tregtimin e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit;

- Rregullorja e Komisionit (EU) 550/2011 datë 7 Qershor 2011 mbi përcaktimin e disa kufizimeve të zbatueshme për përdorimin e krediteve ndërkombëtare nga projektet që përfshijnë gazet industriale në përputhje edhe me kërkesat e Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian;

- Rregullorja e Komisionit (EU) 1123/2013 e datës 8 Nëntor 2013 për përcaktimin e të drejtave ndërkombëtare të krediteve në zbatim të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe Tekstit të Këshillit Evropian në përputhje me Agjencinë Evropiane të Mjedisit;

- Vendimi i Komisionit 2011/278/EU për përcaktimin e rregullave transitore të Bashkimit Evropian të zgjeruar për harmonizimin e shpërndarjes së lirë të njësive të lejuara të emisioneve në përputhje me Nenin 10a të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian (të njoftuar në dokumentin C (2011) 2772);
- Vendimi i Komisionit 2013/447/EU i datës 5 Shtator 2013 për faktorin standard të përdorimit të kapaciteteve në përputhje me nenin 18 (2) të Vendimit 2011/278/EU Tekst me rëndësi nga Agjencia Evropiane e Mjedisit;
- Vendimi i Komisionit 2011/745/EU i cili amendon Vendimet 2010/2/EU dhe 2011/278/EU sa i përket sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohen të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit;
- Rregullorja e Komisionit 600/2012 për verifikimin e raporteve të emetimeve të gazeve me efekt serrë dhe raportet ton-kilometër dhe akreditimin e verifikuesve sipas Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian. Tekst me rëndësi nga Agjencia Evropiane e Mjedisit;
- Rregullorja e Komisionit 601/2012 mbi monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë në zbatim të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe te Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 176/2014 e datës 25 Shkurt 2014 e cila amendon Rregulloren (EU) 1031/2010 në veçanti për të përcaktuar vëllimin e njësive të lejuara të emetimeve të gazeve me efekt serrë që do te dalin në ankand në 2013-2020.

Sistemi i Tregtimit të Emisioneve: Aktivitetet e Aviacionit

- Direktiva 2008/101/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 19 Nëntor 2008 e cila amendon Direktivën 2003/87/EC në mënyrë që të përfshijë aktivitetet e aviacionit në skemën e tregtisë së njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit;
- Vendimi i Komisionit 2009/450/EC i datës 8 Qershor 2009 mbi interpretimin e detajuar të aktiviteteve të aviacionit të listuara në Aneksin I të Direktivës 2003/87/EC;

- Vendimi 377/2013/EU i Parlamentit Evropian dhe e Këshillit i datës 24 Prill 2013 për shmangien përkohësisht nga Direktiva 2003/87/EC për krijimin e një skeme të tregtisë për njësitë e lejuara të emetimeve të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit.

Vendimi për Shpërndarjen e Përpjekjeve

- Vendimi 406/2009/EC i Parlamentit dhe i Këshillit Evropian i datës 23 Prill 2009 mbi përpjekjet e Shteteve Anëtare për të reduktuar emetimet e tyre të gazeve me efekt serrë për të përmbushur angazhimet e Komunitetit Evropian për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë deri në vitin 2020.

Substancat Ozonholluese

- Rregullorja (EC) 1005/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 Shtator 2009 mbi substancat që hollojnë shtresën e ozonit;
- Vendimi i Komisionit 2010/372/EC i datës 18 Qershor 2010 mbi përdorimin e substancave të kontrolluara si agjentë të procesit sipas nenit 8 (4) të Rregullores (EC) Nr. 1005/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 744/2010 e datës 18 Gusht 2010 e cila amendon Rregulloren (EC) 1005/2009 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit në lidhje me përdorimet kritike të haloneve;
- Rregullorja e Komisionit (EU)291/2011 e datës 24 Mars 2011 për përdorimin thelbësor të substancave të kontrolluara përveç hydroklorofluorokarboneve për laboratorët dhe për qëllime analitike në Bashkimin Evropian sipas Rregullores (EC) 1005/2009 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 537/2011 e datës 1 Qershor 2011 e mekanizmit për alokimin e sasive të kontrolluara të substancave të lejuara për përdorime laboratorike dhe analitike në Bashkimin Evropian nën Rregulloren (EC) 1005/2009 e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit.

Gazet e Florinuara

- Rregullorja (EC) 517/2014 “Mbi gazet serrë të florinuara” që shfuqizon Rregulloren 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Maj 2006, mbi krijimin e formatit për raportimin që duhet të dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e disa gazeve serrë të florinuara;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 1493/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Dhjetor 2007 mbi krijimin e formatit për raportimin që duhet të dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e disa gazeve serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 842/2006;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 1494/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Dhjetor 2007 mbi krijimin e formatit të etiketave dhe kërkesave shtesë të etiketimit për sa i përket produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 842/2006;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 1516/2007 e datës 19 Dhjetor 2007 mbi përcaktimin e kërkesave standarde të kontrollit të rrjedhjeve për stacionet fikse ftohëse, kondicionimin e ajrit dhe pompat e nxehtësisë që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 2015/2067 e datës 17 Nentor 2015 qe ne perputhje me Rregulloren (EC) 517/2014 te Parlamentit dhe e Këshillit Evropian percakton kërkesat dhe kushtet minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e personave fizike sa i përket stacioneve fikse ftohëse, kondicionimit te ajrit dhe pompat e nxehtësisë dhe njesive frigoriferike te kamioneve dhe trailerve frigoriferike që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara dhe per certifikimin e kompanive sa i përket stacioneve fikse ftohëse, kondicionimit te ajrit dhe pompat e nxehtësisë, që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 304/2008 e datës 2 Prill 2008 mbi përcaktimin e kërkesave dhe kushteve minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit sa i përket sistemeve të pa lëvizshme të mbrojtjes nga zjarri dhe shuarësve të zjarrit që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;

- Rregullorja e Komisionit (EC) **2015/2066** e datës 17 Nentor 2015 qe ne perputhje me Rregulloren (EC) 517/2014 te Parlamentit dhe e Këshillit Evropian percakton kërkesat dhe kushtet minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e personave fizike qe kryejne instalimin, sherbimin, mirembajtjen dhe rikuperimin ose largimin e disa gazeve serrë të florinuara nga kutia e shpejtësisë së tensionit të lartë, oe rikuperimin e gazeve serrë të florinuara nga kutia e shpejtësisë së tensionit të lartë

- Rregullorja e Komisionit (EC) 306/2008 e datës 2 Prill 2008 mbi përcaktimin e kërkesave dhe kushteve minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit për rikuperimin nga pajisjet, të disa tretësve me bazë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 307/2008 e datës 2 Prill 2008 mbi përcaktimin e kërkesave për programet e trajnimit dhe kushtet për njohje të përbashkët të certifikimit të trajnimit për personelin përsa i përket sistemeve të kondicionimit të ajrit, në disa mjete motorike që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 2015/2065 e datës 17 Nentor 2015 qe ne perputhje me Rregulloren (EC) 517/2014 te Parlamentit dhe e Këshillit Evropian krijon formatin e njoftimit për programet e trajnimit dhe certifikimit të Vendeve Anëtare.

Cilësia e Lëndës Djegëse

- Direktiva 98/70/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Tetor 1998 në lidhje më cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe naftë dhe që amendon Direktivën e Këshillit 93/12/EEC;

- Direktiva e Komisionit 2002/159/EC e datës 18 Shkurt 2002 mbi një format të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjeve të të dhënave kombëtare mbi cilësinë e lëndës djegëse (të njoftuara në kuadër të dokumentit me numër C(2002) 508);

- Direktiva 2009/30/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian që amendon Direktivën 98/70/EC përsa i përket specifikimeve të benzinës, naftës dhe gas-nafte dhe prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe amendimin e Direktivës së Këshillit 1999/32/EC për sa i përket specifikimit të lëndës djegëse të përdorur nga mjetet në brendësi të rrugëve ujore dhe shfuqizimin e Direktivës 93/12/EC.

Emetimet e CO2 nga Makinat dhe Furgonat

- Direktiva 1999/94/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Dhjetor 1999 në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndës djegëse dhe emetimet e CO2 në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve;
- Rregullore (EC) 443/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Prill 2009 që vendos standardet e performancës së emetimeve për makinat e reja të pasagjerëve si pjesë e përqasjes së integruar të Komunitetit për të reduktuar emetimet e CO2 nga makinat e lehta;
- Rregullore e Komisionit (EU) 1014/2010 e datës 10 Nëntor 2010 mbi monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi regjistrimin e makinave të reja të pasagjerëve në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Rregullore e Komisionit (EU) 63/2011 e datës 26 Janar 2011 mbi përcaktimin e masave të detajuara për aplikimin për shmangien nga objektivat specifike të emetimeve të CO2 në përputhje me Nenin 11të Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Rregullore (EU) 510/2011 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 11 Maj 2011 që vendos standardet e performancës së emetimeve për makinat e reja tregtare të lehta si pjesë e përqasjes së integruar të Bashkimit Europian për të reduktuar emetimet e CO2 nga makinat e lehta;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (EU) 725/2011 e datës 25 Korrik 2011 që vendos një procedurë për miratimin dhe certifikimin e teknologjive novatore për reduktimin e emetimeve të CO2 nga makinat e pasagjerëve, në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Vendimi i Komisionit 2012/100/EU i datës 17 Shkurt 2012 mbi metodën për grumbullimin e shpërblimeve për emisionet e tepërta të CO2 nga makinat e reja të pasagjerëve në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (EU) 293/2012 e datës 3 Prill 2012 mbi monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi regjistrimin e makinave të reja të lehta tregtare në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 510/2011;

- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit 2012/99/EU e datës 17 Shkurt 2012 mbi marrëveshjet e detajuara për grumbullimin e shpërblimeve për emisionet e tepërta të CO2 nga makinat e reja të lehta tregtare në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EU) 510/2011. Teksti përkatës me EEA;

- Rregullorja e Komisionit (EU) 397/2013 e datës 30 Prill 2013 që amendon Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009 përsa i përket monitorimit të emetimeve të CO2 nga makinat e reja të pasagjerëve;

- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (EU) 396/2013 e datës 30 Prill 2013 që amendon Rregulloren (EU) 1014/2010 për sa i përket disa kërkesave për monitorimin e emetimeve të CO2 nga makinat e reja të pasagjerëve.

Pyjet dhe Bujqësia

- Vendimi i Parlamentit dhe i Këshillit Evropian 529/2013/EU i datës 21 Maj 2013 mbi rregullat e llogaritjes së emetimeve të gazeve serrë dhe heqjeve që rezultojnë nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës, pyjet, si dhe mbi masat që lidhen me këto aktivitete.

Kapja dhe Depozitimi i Karbonit

- Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2009/31/EC e datës 23 Prill 2009 mbi depozitimin gjeologjik të dyoksidit të karbonit, që amendon Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 85/337/EEC, Direktivat e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2000/60/EC, 2001/80/EC, 2004/35/EC, 2006/12/EC, 2008/1/EC dhe Rregulloren (EC) 1013/2006;

- Direktiva e Komisionit 2010/670/EU e datës 3 Nëntor 2010 që përcakton kriteret dhe masat për financimin dhe projektet treguese tregtare që synojnë kapjen dhe depozitimin gjeologjik të sigurt nga ana mjedisore të dyoksidit të karbonit, si dhe projektet që tregojnë teknologjitë e reja të energjisë së rinovueshme në kuadër të skemës për tregtimin e emetimeve të lejuara të gazeve serrë brenda Komunitetit të përcaktuar nga Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2003/87 (njoftuar në kuadër të dokumentit K(2010) 7499).

Për Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve

- Direktiva 2008/98/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 19 Nëntor 2008 mbi mbetjet;
- Direktiva 86/278/EEC "Për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të tokës kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në bujqësi", ndryshuar nga Direktiva 91/692/EEC, Rregullorja (EC) 807/2003 dhe Rregullorja (EC) 219/2009;
- Direktiva 2006/66/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 6 Shtator 2006 "Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët", e amenduar nga Direktivat 2008/12/EC, 2008/103/EC dhe 2013/56/EU, si dhe Vendimet e Komisionit 2008/763/EC, 2009/603/EC dhe 2009/851/EC;
- Direktiva 94/62/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 Dhjetor 1994 "Për Ambalazhet dhe Mbetjet nga Ambalazhet", e amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 219/2009, si dhe Direktivat 2004/12/EC, 2005/20/EC dhe 2013/2/EU;
- Direktiva 96/59/EC e datës 16 Shtator 1996 "Për asgjësimin e bifenileve të poliklorinuara dhe trifenileve të poliklorinuara (PCB/PCT)", e amenduar nga Rregullorja (EC) 596/2009;
- Direktiva 2000/53/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 18 Shtator 2000 "Për automjetet në fund të jetës";
- Direktiva 2002/96/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 27 Janar 2003 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)", e amenduar nga Direktiva 2003/108/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 8 Dhjetor 2003;
- Direktiva e Këshillit 1999/31/EC e datës 26 Prill 1999 "Mbi landfillin e mbetjeve", e amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008, si dhe Direktiva 2011/97/EU;
- Direktiva 2006/21/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 15 Mars 2006 "Për menaxhimin e mbetjeve nga industria nxjerrëse", që amendon Direktivën 2004/35/EC dhe Rregulloren 596/2009/EC, e amenduar nga Vendimet e Komisionit 2009/335/EC, 2009/337/EC, 2009/358/EC, 2009/359/EC dhe 2009/360/EC;

- Rregullorja 333/2011 e datës 31 Mars 2011 “Për vendosjen e kritereve që përcaktojnë kur disa lloje metalesh skrap pushojnë së qeni mbetje” sipas Direktivës 2008/98 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Rregullorja 2150/2002 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25 Nëntor 2002 “Për statistikat e mbetjeve”;
- Rregullorja 1257/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 Nëntor 2013 “Për riciklimin e anijeve”, që amendon Rregulloren 1013/2006 dhe Direktivën 2009/16/EC;
- Rregullorja 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 14 Qershor 2006 “Për transferimin e mbetjeve”, e amenduar nga Rregulloret 1379/2007/EC, 669/2008/EC, 219/2009/EC, 255/2013/EU, 308/2009/EC, 664/2011/EU dhe 135/2012/EC;
- Direktiva 2012/19/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 4 Korrik 2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)”;
- Direktiva 2011/65/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 8 Qershor 2011 “Për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike”, e amenduar nga Direktivat 2012/50/EU, 2012/51/EU, 2014/1/EU dhe 2014/16/EU;
- Rregullorja 1069/2009/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 Tetor 2009 që përcakton rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produktet e përftuara prej tyre jo të destinuara për konsum njerëzor dhe duke shfuqizuar Rregulloren (EC) 1774/2002 (Rregullore për nënproduktet shtazore) .

Për Fushën e Cilësisë së Ujërave

- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000 për krijimin e një kuadri në fushën e politikave të ujit, amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EC dhe 2014/101/EU;
- Direktiva e Këshillit 91/271/EEC e datës 21 Maj 1991 për trajtimin e ujërave të ndotur urban, amenduar nga Direktivat 98/15/EC dhe 2016/64/EC, si dhe nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008;

- Direktiva 2008/56/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 Qershor 2008 për krijimin e një kuadri në fushën e politikave mjedisore detare (Direktiva për kuadrin e strategjisë detare);
- Direktiva e Këshillit 98/83/EC e datës 3 Nëntor 1998 për cilësinë e ujit të pijshëm, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 596/2009, si dhe nga Direktiva 2015/1787/EC;
- Direktiva e Këshillit 91/676/EEC e datës 12 Dhjetor 1991 për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet e përdorura në bujqësi, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008;
- Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 Shkur 2006 për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes që shfuqizon Direktivën 76/160/EEC te amenduar me Rregulloren (EC) 596/2009 dhe Direktiven 2013/64/EC;
- Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 Dhjetor 2006 për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotja dhe degradimi, amenduar nga Direktiva 2014/80/EC;
- Direktiva 2013/39/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 Gusht 2013, e cila amendon Direktivën 2000/60/EC dhe 2008/105/EC për sa i përket substancave prioritare në fushën e politikave të ujit;
- Direktiva 2009/90/EC e datës 31 Korrik 2009 që parashtron në zbatim të Direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujit;
- Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2007 për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet.

Për Fushën e Mbrojtjes së Natyrës

- Direktiva 2009/147/EC e datës 30 Nëntor 2009 “Për ruajtjen e shpendëve të egër” (versioni i konsoliduar);
- Direktiva 92/43/EEC e datës 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër”, e ndryshuar nga Direktivat 97/62/EC dhe 2006/105/EC, si dhe Rregullorja (EC) 1882/2003;

- Direktiva 1999/22/EC e datës 29 Mars 1999 lidhur me mbajtjen e kafshëve në kopshtet zoologjike;
- Rregullore EC/338/97 e datës 9 Dhjetor 1996 për mbrojtjen e llojeve të faunës së egër duke rregulluar tregtinë e tyre, ndryshuar me Rregulloren EC/865/2006;
- Rregullore EEC/3254/91 e datës 4 Nëntor 1991 që ndalon përdorimin e leqeve (kurtheve) në Komunitet dhe hyrjen në Komunitet të gëzofit dhe prodhimeve të disa llojesh të faunës së egër me origjinë nga vendet që i kapin ato duke përdorur metodat e kurtheve (leqeve) që nuk plotësojnë standardet njerëzore ndërkombëtare të zënies me kurthe (leqe);
- Direktiva 83/129/EEC e datës 28 Mars 1983 lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve të derivuara prej tyre;
- Rregullore e Këshillit 348/81/EEC e datës 20 Janar 1981 për rregullat e përbashkëta për importin e balenave dhe produkteve të tjera të cetaceve dhe amendimet.

Për fushën e Kontrollit të Ndotjes Industriale dhe Menaxhimit të Riskut

- Direktiva 2010/75/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 24 Nëntor 2010 për shkarkimet industriale;
- Rregullore EC/166/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi Regjistrin Evropian të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
- Rregullore (EC) 66/2010 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 17 Korrik 2000 mbi EU ECOLABEL;
- Rregullore (EC) 1221/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 25 Nëntor 2009 mbi Pjesëmarrjen Vullnetare të Organizatave në Komunitetin e Eko-Menaxhimit dhe Skemat e Auditit (EMAS);
- Direktiva 2012/18/EC e datës 4 Korrik 2012 “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme”, ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/82/KE.

Për fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht

- Direktiva 2001/18/EC e datës 12 Mars 2001 për lëshimin e kontrolluar në mjedis të Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht;
- Vendimi 2002/811/EC i datës 3 Tetor 2002 që vendos udhëzues për Aneksin shtesë VII të Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për lëshimin e kontrolluar në mjedis të Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 90/220/EEC;
- Vendim i Komisionit 2002/813/EC i datës 3 Tetor 2002 që vendos sipas Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, formatin për informacionin përmbledhës të lajmërimit për lëshimin e kontrolluar në mjedis të OMGJ-ve për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg;
- Vendim i Komisionit 2003/701/EC i datës 29 Shtator 2003 që vendos në vijim të Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit një format për paraqitjen e rezultateve të hedhjes së kontrolluar në mjedis të bimëve të larta të modifikuara gjenetikisht për qëllime përveç hedhjes së tyre në treg;
- Rregullore 1830/2003 e datës 22 Shtator 2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me gjurmueshmërinë dhe etiketimin e OMGJ-ve dhe gjurmueshmërinë e ushqimeve dhe produkteve ushqimore të prodhuara nga OMGJ-te dhe që amendon Direktivën 2001/18/EC.

Për fushën e Kimikateve

- Rregullorja (EC) 1907/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 18 Dhjetor 2006 në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve ECHA, që amendon Direktivën 1999/45/EC dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) 793/93, si dhe Direktivën e Këshillit 76/769/EEC dhe Direktivat e Komisionit 91/155/EEC, 93/67/EEC, 93/105/EC dhe 2000/21/EC;

- Rregullorja (EC) 1272/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 Dhjetor 2008 mbi Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve, që amendon dhe shfuqizon Direktivat 67/548/EEC dhe 1999/45/EC, dhe amendon Rregulloren (EC) 1907/2006;
- Rregullorja (EC) 1102/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2008 mbi ndalimin e eksportit të mërkurit metalik dhe të disa komponimeve dhe përzierjeve dhe depozitimin e sigurt të mërkurit metalik;
- Direktiva e Këshillit 87/217/EEC e datës 19 Mars 1987 mbi parandalimin dhe reduktimin e ndotjes mjedisore nga asbesti siç amendohet nga Direktiva 91/692/EEC dhe Rregullorja (EC) 807/2003;
- Direktiva 98/8/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 Shkurt 1998 në lidhje me hedhjen në treg të produkteve biocide siç është amenduar nga Rregullorja (EC) 1882/2003 dhe Direktivat 2006/50/EC, 2006/140/EC dhe 2009/151/EC;
- Rregullorja (EU) 528/2012 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 Maj 2012 në lidhje me përdorimin dhe disponueshmërinë në treg të produkteve biocide;
- Rregullorja (EC) 850/2004 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 29 Prill 2004 mbi ndotësit organik të qëndrueshëm dhe që amendon Direktivën 79/117/EEC dhe Rregulloret (EC) 1195/2006, (EC) 172/2007, (EC) 323/2007, (EC) 219/2009 dhe (EC) 304/2009, amenduar nga Rregullorja 519/2012;
- Rregullore (EC) 649/2012 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 4 Korrik 2012 në lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme;
- Direktiva 2010/63/EU e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 Shtator 2010 mbi mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore.

Për fushën e Zhurmave

- Direktiva 2002/49/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropiandatë e datës 25 Qershor 2002 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”;
- Direktiva e Këshillit 70/157/EEC e datës 6 Shkurt 1970 mbi përafrimin e legjislacionit te Shteteve Anëtare ne lidhje me nivelin e lejueshëm te zhurmave dhe sistemin e shkarkimit të mjeteve motorike, siç është amenduar nga Direktivat 73/350/EEC, 77/212/EEC, 81/33/EEC, 84/372/EEC, 84/424/EEC, 87/354/EEC, 89/491/ EEC, 92/97/EEC, 96/20/EC, 1999/101/EC dhe 2007/34/EC;
- Direktiva 97/24/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 17 Qershor 1997 ne lidhje me disa komponente dhe karakteristika te mjeteve motorrike me dy ose 3-rrota, siç është amenduar nga Direktivat 2002/51/EC, 2003/77/EC, 2005/30/EC, 2006/27/EC, 2006/72/EC dhe 2006/120/EC;
- Direktiva 2001/43/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 27 Qershor 2001 qe amendon Direktivën e Këshillit 92/23/EEC ne lidhje me gomat për mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre te përshtatshme me to;
- Direktiva 2009/40 EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datë 6 Maj 2009 "Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”;
- Rregullore (EU) 598/2014 e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 16 Prill 2014 mbi vendosjen e rregullave dhe procedurave në lidhje me prezantimin e masave kufizuese që lidhen me zhurmat në aeroportet e Komunitetit brenda një qasje të balancuar dhe që shfuqizon Direktivën 2002/30 /EC.

Për fushën e Pyjeve

- Rregullorja (EC) 2152/2003 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 Nëntor 2003 për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimit mjedisor në vendet Komunitare (Fokus Pyjet);

- Rregullorja e Komisionit (EC) 1737/2006 e datës 7 Nëntor 2006 "Për heqjen e disa rregullave të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) 2152/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimin mjedisor në vendet e Komunitetit";
- Rregullorja e Këshillit (EEC) 1615/89 e datës 29 Maj 1989 për krijimin e Sistemit Evropian të Informacionit Pyjor dhe të Komunikimit (Efics);
- Rregullorja e Këshillit (EC) 2173/2005 e datës 20 Dhjetor 2005 mbi krijimin e një skeme lejesh FLEGT për importet e lëndës drusore në Komunitetin Evropian, e ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (EC) 1024/2008 e datës 17 Tetor 2008 që përcakton masat e detajuara për zbatimin e Rregullores së mësipërme;
- Rregullorja 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 Tetor 2010 që formulon detyrimet e operatorëve, të cilët vendosin lëndën drusore dhe prodhimet e drurit në treg.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në fushën e *legjislacionit horizontal* është shënuar progres për sa i përket transpozimit të Direktivave të VNM-së dhe VSM-së, por nuk ka ndonjë progres për sa i përket Direktivave të tjera. Transpozimi i Direktivës së VNM-së (2011/92/EU) ka përparuar së tepërmi duke arritur në masën 100 % nëpërmjet amendimit të Ligjit për VNM–në në shkurt 2015 dhe akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj, të cilat janë miratuar gjatë viteve 2015 dhe 2016. Ndërkohë do të punohet me transpozimin e Direktivës 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014, e cila ka amenduar Direktivën (2011/92/EU), amendim ky që parashikohet të transpozohet brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2018. Progres në fushën e VNM-së është bërë edhe me miratimin e VKM-së 912/2015 "Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis", e cila ka hyrë në fuqi më 1 shtator 2016. Kjo VKM do të ndihmojë në zbatimin korrekt të paketës ligjore në fushën e VNM-së, si dhe pritet të rrisë cilësinë e raporteve të VNM-së. Gjithashtu, progres i rëndësishëm shënohet edhe për sa i përket transpozimit të Direktivës së VSM-së, duke arritur në masën 100 %. Pjesa më e madhe e dispozitave të kësaj Direktive janë transpozuar me miratimin e Ligjit 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, në Shkurt 2013, ndërsa pjesa e mbetur është transpozuar nëpërmjet akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj, të cilat janë miratuar gjatë vitit 2015, duke arritur transpozimin e plotë të kësaj Direktive. Pritet që gjatë vitit 2017 të miratohet me udhëzim të veçantë të Ministrit të Mjedisit "Metodika Kombëtare e Vlerësimit Strategjik Mjedisor", e cila do të ndihmojë në zbatimin korrekt të

paketës ligjore në fushën e VSM-së dhe lehtësimin e zbatimit të procesit të VSM-së. Ligjit 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, transpozon Anekset dhe shumicën e dispozitave, si dhe siguron bazën ligjore për miratimin e legjislacionit dytësor. Transpozimi i plotë i Direktivës mbi Aksesin në Informacion dhe asaj mbi Pjesëmarrjen e Publikut është arritur që në vitin 2012.

Në fushën e *cilësisë se ajrit*, Ligji i ri nr. 162, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit" dhe VKM Nr. 352, datë 29.04.2015 "Mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat në lidhje me disa ndotës" transpozojnë 99% dispozitat e Direktivës 2008/50/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën, si dhe të Direktivës 2004/107/EC. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit është miratuar me VKM nr. 594, datë 10.09.2014 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit”.

Pavarësisht se ka vazhduar progresi lidhur me transpozimin e legjislacionit për *menaxhimin e mbetjeve*, përpjekje të tjera janë të nevojshme për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të menaxhimit të mbetjeve. Për sa i përket transpozimit të Direktivës Kuadër të Mbetjeve, ai ka arritur në masën rreth 95%.

Në këtë fushë progres shënohet edhe në transpozimin e Direktivës mbi Llumrat e Ujërave të Ndotura, e cila është transpozuar plotësisht me miratimin e VKM nr.127, datë 11.02.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura”.

Transpozimi i Direktivës së Baterive ka përparuar për shkak të miratimit të VKM-së nr. 866, datë 4.12.2012 "Mbi bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre". Niveli i transpozimit është i lartë duke arritur afërsisht 90 %. Megjithatë, legjislacioni kombëtar nuk ka transpozuar ende gjashtë dispozitat e mbetura të kësaj Direktive.

Transpozimi i Direktivës mbi Mbeturinat e Paketimeve ka përfunduar në vitin 2012, me miratimin e Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në Shtator 2011, si dhe VKM 177/2012 "Për paketimin dhe mbeturinat e tyre", në Mars 2012.

Miratimi i VKM 705/2012 "Për menaxhimin e automjeteve në fund të jetës", në Tetor 2012, ka përmirësuar dukshëm transpozimin e Direktivës përkatëse. Niveli i transpozimit ka arritur në 83%.

Niveli i transpozimit të Direktivës së re WEEE (2012/19/EU) është në fazë të hershme dhe shkalla e transpozimit prej 8% është rezultat i përputhshmërisë me Direktivën 2002/96/EC, i cili është përafruar me VKM nr. 957, datë 19.12.2012 “Mbi mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike.”

Transpozimi i Direktivës së Landfilleve është në shkallën 98 %. Vetëm dy dispozita të Direktivës (neni 2 dhe 14 (d)), mbeten për tu transpozuar në legjislacionin kombëtar. Progresi në transpozim është arritur nëpërmjet miratimit të VKM "Për landfillet e mbetjeve", në Korrik 2012.

Nëpërmjet miratimit të VKM 178/2012 “Për incenerimin e mbetjeve”, është arritur progres edhe në transpozimin e Direktivës 2000/76/EC për incinerimin e mbetjeve.

Në zbatim të Ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” janë miratuar 17 aktet nënligjore duke bërë më të plotë kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Gjithashtu, është miratuar VKM nr. 428, datë 8.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, për hartën dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane”, e cila do të miratojë hartën GIS, të krijuar me informacione që reflektojnë situatën aktuale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane, si dhe zhvillime të tjera në terren.

Në fushën e *cilësisë së ujërave* progres është bërë në drejtim të transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit me miratimin e Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", në Nëntor 2012, VKM nr. 246, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë’’, VKM nr. 267, datë 07.05.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore”, si dhe VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ka transpozuar edhe disa prej dispozitave të Direktivës së Ujërave të Ndotur Urban.

Si pjesë e progresit në fushën e administrimit të ujërave konsiderohet edhe miratimi i VKM nr. 662, datë 21.09.2016 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta”, VKM nr. 342, datë 4.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorial dhe hidrografik të baseneve ujore në RSH dhe qendrën dhe përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”, si dhe VKM nr. 416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”.

Transpozimi i Direktivës së Ujit të Pijshëm është realizuar në masën 100% me miratimin e VKM-së nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm”. Edhe Direktiva e Ujërave të Larjes është transpozuar plotësisht me VKM-në "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes", të miratuar që në vitin 2010.

Në fushën e *mbrojtjes së natyrës*, ka vazhduar progresi në transpozimin e legjislacioniut për këtë fushë. Transpozimi i Direktivës së Shpendëve të egër është pothuajse i plotë, aktualisht në masën 92 %, pas miratimit të VKM nr. 866, datë10.12.2014 "Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian". Transpozimi i plotë i kësaj Direktive është parashikuar të përfundojë pas anëtarësimit të vendit në BE.

Gjithashtu, ka vijuar harmonizimi i legjislacionit kombëtar me kërkesat e Direktivës së Habitateve, e cila vlerësohet pothuajse e plotë, në masën 98%. Progresi ka ndodhur pas miratimit të Ligjit nr. 68/2014, datë 3.07.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen e biodiversitetit" nr. 9587, datë 20/07/2006" dhe të VKM nr. 866, datë10.12.2014 "Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian".

Në fushën e *kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut*, transpozimi i Direktivës së Emetimeve Industriale mendohet te jetë rreth 44%, ku progresi kryesor është arritur në vitin 2011 nëpërmjet miratimit të disa akteve ligjore. Shumica e përkufizimeve të kësaj Direktive, të përcaktuara në Kapitullin I, janë transpozuar nga Ligji nr. 10448, date 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Lidhur me Kapitullin II, III, IV dhe V të kësaj Direktive, me rëndësi për transpozim është Ligji "Për Lejet e Mjedisit". Përveç ligjit "Për Lejet e Mjedisit", një akt tjetër i rëndësishëm për transpozimin e dispozitave të kësaj Direktive është miratimi i VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja", si dhe aktet që kanë të bëjnë me impiantet e incenerimit të mbetjeve dhe impiantet e co-incenerimit të mbetjeve, siç është VKM nr. 178, datë 06.03.2012 "Për djegien e mbetjeve".

Progres është shënuar edhe për sa i përket transpozimit të legjislacionit për fushën e kimikateve, ku gjatë vitit 2016 janë miratuar Ligji nr. 27, datë 17.03.2016 "Për menaxhinin e kimikateve" dhe tre aktet nënligjore të tij. Konkretisht, VKM nr. 488, datë 29.6.2016 "Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve", VKM nr. 489, datë 29.6.2016 "Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e SVHC dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC", VKM nr. 665, datë 21.09.2016 "Për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme".

Progres është shënuar edhe për sa i përket transpozimit të *Direktivës së Zhurmave Mjedisore.* Progres ky i arritur në Janar 2013 për shkak të miratimit të Udhëzimit nr. 2, datë 7.01.2013 "Për treguesit, metodat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike të metodologjisë për vlerësimin e nivelit të zhurmës, dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për të zgjidhur dhe për të përmirësuar situatën". Megjithatë, ka ende disa dispozita që ende duhen transpozuar.

Në fushën e *ndryshimeve klimatike*, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, në Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), që nga Janari 1995 dhe Protokollit të Kiotos që prej vitit 2005. Aktualisht, Shqipëria ka përgatitur tre Komunikime Kombëtare të UNFCCC në 2002, 2009 dhe 2016.

Gjithashtu, në vitin 2015 Shqipëria ka miratuar dokumentin e INDC-së me VKM nr. 762, datë 16.09.2015 "Për miratimin e kontributit kombëtar të pikësynuar ndaj UNFCCC-së" dhe e dorëzoi atë pranë Sekretariatit të UNFCCC-së në datën 24 Shtator 2015. Mbas nënshkrimit në 22 Prill 2016 në New York të Marrëveshjes së Parisit, Parlamenti Shqiptar ratifikoi Marrëveshjen e Parisit nëpërmjet Ligjit nr. 75, datë 14.07.2016 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit". Angazhimet për reduktimin e emisioneve të Gazeve me Efekt Serrë (GES) janë përfshirë në dokumentin e miratuar të INDC-së dhe synohet një reduktim prej 11.5% të GSE-ve deri në vitin 2030. Ky objektiv kombëtar është reflektuar gjithashtu edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Për të adresuar çështjet ndërsektoriale që lidhen me ndryshimet klimatike, është krijuar Grupi Ndërministror i Punës për Ndryshimet Klimatike, me Urdhërin e Kryeministrit nr.155, datë 25.04.2014.

Në Shkurt 2015, filloi puna për hartimin e Planit Kombëtar për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike (PKA) dhe integrimin e ndryshimeve klimatike në politikat dhe strategjitë sektoriale përkatëse. PKA u finalizua në Korrik 2016 dhe në vijim është duke u hartuar strategjia e financimit të dokumentit të PKA. Gjithashtu, adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike është integruar edhe në disa dokumenta strategjik sikurse janë **(i)** Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, **(ii)** Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Ujore, **(iii)** Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural , **(iv)** Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, si dhe **(v)** Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin.

Strategjia për Ndryshimet Klimatike, në linjë me kuadrin politik të parashikuar për Klimën dhe Energjinë EU 2030, është në proces draftimi dhe parashikohet të miratohet brenda Dhjetorit 2017.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Për fushën e Legjislacionit Horizontal

MM - është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për fushën e mbrojtjes së mjedisit, vlerësimit të ndikimit në mjedis, vlerësimit strategjik mjedisor, si dhe për fushën e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje mjedisore. Gjithashtu, MM dhe institucionet e saj të varësisë (AKM, AKZM, ARM-të dhe ISHMP) kanë angazhimin për të garantuar zbatimin e tyre.

Përveç MM-së dhe institucioneve të saj të varësisë, edhe ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të fushës së tyre të përgjegjësisë janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe plotësimin e standardeve mjedisore, sigurimin e procesit të VNM-së dhe VSM-së, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje me ndikim në mjedis. Në këtë kuadër përmendim:

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI),
- Ministria e Shëndetësisë (MSH),
- Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU),
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI),
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS),
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU),
- si dhe çdo Ministri apo institucion tjetër që harton plane/programe apo projekte që janë objekt i procesit të VNM-së apo VSM-së.

Autoritetet vendore, kanë një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e procedurës së VSM-së dhe në përmbushjen e detyrimeve për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje mjedisore, veçanërisht për sa i përket hartimit të planeve dhe programeve që janë objekt i procesit të VSM-së, si edhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga paketa e ligjore për VNM-në për projekte të mëdha publike.

Për fushën e Cilësisë së Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike

MM - është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nga ndotja.

AKM - është organi qendror për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, nëpërmjet institucioneve të kontraktuara nga MM. AKM grumbullon dhe përpunon të dhënat e monitorimit, si dhe bën publike raportin e gjendjes së cilësisë së ajrit.

ISHMP - është autoriteti kompetent që kontrollon kushtet e lejes së mjedisit të aktiviteteve industriale dhe të ndërtimit lidhur me shkarkimet në ajër.

Gjithashtu, **MM** është institucioni që harton politikat kombëtare për *ndryshimet klimatike* dhe koordinon integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike në politikat sektoriale të bujqësisë, turizmit, shëndetësisë, energjisë, transportit, pyjeve, ujërave, etj. MM është përcaktuar si Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP) në kuadër të detyrimeve të vendit ndaj Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos, si dhe për ndjekjen e projekteve të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër.

Përveç MM-së, përgjegjëse për fushën e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike janë edhe MEI, MTI, MSH, MBZHRAU, si dhe Ministria e Integrimit Evropian (MIE).

Për Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve

MM - është institucioni kryesor i përfshirë në menaxhimin dhe hartimin e politikave në fushën e mbetjeve. MM harton rregullat/ligjet për menaxhimin e mbetjeve për të gjitha fazat (ndarja, ripërdorimi, riciklimi, kompostimi, hedhja dhe djegia), vlerëson dhe jep lejet për transitimin dhe për eksportin e mbetjeve, vendos rregullat për monitorimin dhe inspektimin/kontrollin për zbatimin e akteve lidhur me mbetjet, si dhe organizon dhe menaxhon regjistrat lidhur me çështje të ndryshme të mbetjeve.

MZHU - në përputhje me legjislacionin përkatës, ushtron veprimtarinë e saj në fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial, si dhe fushën e menaxhimit të projekteve të zhvillimit urban.

MTI - ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i landfilleve rajonal dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane, duke përcaktuar rregullat, teknikat dhe metodat e trajtimit të tyre, në çdo fazë, duke përfshirë krijimin, ndarjen, grumbullimin, ruajtjen, transportin, riciklimin, trajtimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe në zvogëlimin e ndikimit të tyre.

Gjithashtu, MTI është përgjegjëse edhe për:

- **Planifikimin dhe ndjekjen e investimeve** - bazuar në prioritetet e përfshira në PBA duhet të sigurojë realizimin e studimeve, projektimeve dhe implementimin e tyre për mbylljen e vend-depozitimeve ekzistuese dhe ndërtimin e impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve;

- **Sensibilizimin**, koordinimin dhe bashkëpunimin me strukturat dhe institucionet përkatëse, donatorët dhe NjQV-të për të vënë në jetë parimet më të rëndësishme të metodave bashkëkohore (parandalimi, pakësimi, riciklimi dhe më pas asgjësimi i mbeturinave);
- **Hartimin** e regjistrit vjetor të mbetjeve në rang bashkie, qarku apo vendi, me qëllim njohjen dhe vlerësimin e situatës mjedisore të shkaktuar nga mbetjet në vend. Përgatitjen e raporteve të nevojshme për evidentimin e problemeve dhe rrugët e zgjidhjes;
- **Identifikimin** e metodave të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve të ngurta, duke bërë të mundur reduktimin e rreziqeve ndaj shëndetit të banorëve.

MSH - sëbashku me MM kanë përgjegjësi për të hartuar rregulloret për menaxhimin e mbetjeve spitalore. Spitalet dhe të gjithë gjeneruesit e mbetjeve shëndetësore kanë përgjegjësi të hartojnë dhe azhornojnë planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me planet kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planet e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme.

MEI - sëbashku me MM ka përgjegjësi për të hartuar rregulloret për mbetjet industriale dhe mbetjet minerare, si dhe në rehabilitimin e vendeve të hedhjes sipas specifikave të përmbajtjes së mbetjeve.

Ministria e Mbrojtjes - në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë rregulloret lidhur me mbetjet ushtarake.

Ministria e Financave (MF) - në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë legjislacionin për taksat e ndryshme mjedisore. MF harton rregullat mbi garancitë financiare për lejet mjedisore të vendeve të mbetjeve të rrezikshme, të cilat miratohen më vonë nga Këshilli i Ministrave.

MBZHRAU - në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë rregulloret për mbetjet bujqësore dhe të kafshëve.

Për Fushën e Menaxhimit të Ujërave

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) - është organi qëndror vendimarrës për menaxhimin e burimeve ujore. Ai përbën një forum të nivelit të lartë ndërministror për planifikimin dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të ujit. Kryesohet nga Kryeministri dhe anëtarë të tij janë Zëvendëskryeministri, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministri i Mjedisit, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Energjisë dhe Industrisë, Ministri i Financave, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Zhvillimit Urban, si dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin (GMIP) - është i kryesuar nga Kryeministri dhe anëtarë të tij janë ministrat përgjegjës për një fushë të caktuar të sektorit të ujit, si dhe përfaqësues të donatorëve që operojnë në vend. Ky organ ka si qëllim kryesor koordinimin dhe drejtimin e punës për zhvillimin dhe monitorimin e reformave në sektorin e ujit, nëpërmjet hartimit të një programi kombëtar sektorial.

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU) - si organi ekzekutiv i KKU-së ka objekt të veprimtarisë së tij projektimin dhe ngritjen e sistemit total të integruar të ujit, si dhe monitorimin e garantimin e funksionimit efikas të menaxhimit të integruar të këtij sistemi. Ai luan rolin e Sekretariati Teknik të GMIP-së për ujin, përgjegjës për koordinimin në nivel ndërinstitucional për të gjitha çështjet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

MBZHRAU - është institucioni lider për menaxhimin e burimeve ujore, ujitjen, kullimin dhe menaxhimin e përmbytjeve.

ISHU - është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën e ujërave në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ujërat.

Komisioni i posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitarë - ka si qëllim kryesor të hartojë, shqyrtojë dhe propozojë marrëveshje bashkëpunimi me secilin vend fqinj, duke trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me menaxhimin e integruar të burimeve ujore ndërmjet vendeve respektive. Anëtar të tij janë përfaqësues të lartë nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministria e Drejtësisë (MD), MM, MBZHRAU, MZHU, MZHETTS, MF, Ministria e Mbrojtjes, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, MSH, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Ministria e Kulturës (MK), MTI, Akademia e Shkencave, si dhe STKKU.

MTI - është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) - është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Ajo mbështet teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale, si dhe politikat përkatëse për administrimin e ujërave dhe mbrojtjen mjedisore të cilësisë së ujërave.

MM - është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nxitjen dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe ndryshimeve klimatike.

AKM - është institucioni kryesor publik përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit, përfshi edhe burimet ujore.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) - ka rolin kryesor në emergjencat civile përfshi edhe emergjencat nga përmbytjet. Është përgjegjëse për hartimin e planit kombëtar të emergjencave civile.

MSH - përcakton kërkesat higjieno-sanitare që duhet të plotësojë uji i pijshëm dhe pajisjet e furnizimit nga pellgu ujëmbledhës deri tek përdoruesi, si dhe kryen monitorimin, inspektimin dhe ekspertizën e cilësisë së ujit të pijshëm.

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) - është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, sipërfaqësor, ujërave për larje dhe monitorimin e standardeve të ujit sipas WHO, hartimin dhe zbatimin e planeve të kontrollit të cilësisë së burimeve të ujit të pijshëm dhe largimit të ujit të ndotur.

MEI - është institucioni me rol kryesor në hidroenergji e cila operon nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). MEI është përgjegjëse për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet.

AKBN - është institucion në varësi të MEI dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, si dhe monitorimin në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) - vepron në varësi të MEI dhe është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujërave nëntokësore.

MF - është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në investimet kapitale financiare në sektorin e ujit.

Këshilli i Basenit Ujor (KBU) - janë autoritetet lokale përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në basenet përkatëse. Përbëhet nga 9 – 19 anëtarë që përfaqësojnë institucione të ndryshme të lidhura me ujin, për një basen të caktuar. Ato drejtohen nga prefekti.

Agjencia e Basenit Ujor (gjashtë) - është organi ekzekutiv i Këshillit të Basenit në varësi të MBZHRAU. Është përgjegjës për hartimin e inventarit të përdorimit të burimeve ujore në sasi dhe cilësi dhe prodhojnë raporte periodike për KBU.

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) - është përgjegjës për monitorimin e ujërave sipërfaqësore në cilësi dhe sasi. IGJEUM gjithashtu kryen studime të ndryshme në lidhje me rrjedhjen e ujit, reshjet atmosferike dhe për parandalimin nga përmbytjet.

Inspektorati Sanitar Shtetëror (ISSH) - është përgjegjës për monitorimin në terren të cilësisë së ujit.

Enti Rregullator i Ujit (ERrU) - është një autoritet i pavarur kombëtar përgjegjës për vendosjen e tarifave (për ujë të pijshëm dhe kanalizime), për licencimin e shoqërive të ujësjellës – kanalizimeve, si dhe monitorimin e performancës së tyre.

Akademia e Shkencave (ASH) - është institucioni përgjegjës për propozimin dhe kryerjen e kërkimeve e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës.

Për fushën e Mbrojtjes së Natyrës

MM - mbulon çështjet lidhur me hartimin e politikave për mbrojtjen e natyrës, si dhe hartimin e dokumentave strategjik në këtë fushë. Bashkëpunimi shtrihet edhe me institucionet zbatuese të saj si AKZM, AKM, ISHMP, si dhe me Strukturat e Shërbimit Pyjor pranë 61 Bashkive të vendit. Pas reformës së shërbimit pyjor të zbatuar në fillim të vitit 2016, strukturat e shërbimit pyjor pranë Bashkive do të luajnë një rol të rëndësishëm dhe do të jenë partner startegjik për çështjet që lidhen me administrimin e habitateve dhe ekosistemeve pyjore dhe të faunës së egër.

Gjithashtu, në fushën e mbrojtjes së natyrës MM bashkëpunon edhe me **MBZHRAU-**në për biodiversitetin bujqësor, **MZHU-** në për bashkëpunimin në vendim-marrjen për përdorimin e territorit, **MPB-**në për bashkërendimin e punës për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë sportive dhe turistike, **MSHÇV-**në për menaxhimin e burimeve natyrore lokale në pronësi komunale, si dhe **Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave** (DPD) për kontrollin doganor të tregtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër.

Për fushën e Kontrollit të Ndotjes Industriale dhe Menaxhimit të Riskut

MM - është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për parandalimin e ndotjes industriale dhe minimizimin e saj. Përkatësisht, AKM, ARM-të dhe ISHMP janë institucionet e varësisë së MM që janë përgjegjëse për procedurën e lëshimit të lejeve të mjedisit për instalimet industriale, si dhe për monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve të mjedisit.

Përveç MM-së dhe institucioneve të saj të varësisë, edhe ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes industriale, sigurimin e procesit të lëshimit të lejeve të mjedisit, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendim-marrje për lejet e mjedisit. Këtu mund të përmendim **MEI**, **MSH**, **MZHU**, **MTI**, **MZHETTS**, si dhe **MBZHRAU**.

MM - është përgjegjëse edhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, rregulloreve dhe strategjive për fushën e aksidenteve industriale. Gjithashtu, MM bën edhe vlerësimin e efekteve të aksidenteve mbi mjedisin. Ministritë e linjës të cilat trajtojnë kimikatet apo substancat e rrezikshme janë gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për këtë fushë.

Për fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht

Si një fushë ndër-tematike, nuk ka struktura të përcaktuara me ligj për OMGJ-të. Ndërkohë, në kuadër të zbatimit të Protokollit të Kartagjenës për Biosigurinë të Konventës së Biodiversitetit (CBD) janë identifikuar aktorët kryesorë. Në këtë kontekst kjo fushë kërkon kontributin e të gjithë aktorëve kryesorë të përcaktuar dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre.

Institucionet kryesore janë **MBZHRAU** për mbjelljet, ushqimet dhe tregtimin, si dhe **MM** për introduktimin e kontrolluar në mjedis, duke përfshirë vendosjen dhe mënyrat e sistemit të lajmërimit (notifikimit) midis shteteve Palë të Protokollit të Biosigurisë.

Në nivel kombëtar, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, u krijua Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në varësi të MBZHRAU-së, ku një prej detyrave të saj është edhe drejtimi i procesit të vlerësimit të riskut në fushën e ushqimit dhe ushqimeve për kafshët.

Aktorë të tjerë për politikat janë **MSH** për mikroorganizmat në gjendje të mbyllur dhe ndikimet në shëndetin e njeriut dhe **MAS** për zhvillimin e bioteknologjisë. DPD është përgjegjëse për zbatimin e Protokollit të Biosigurisë lidhur me lëvizjet ndërkufitare të OMGJ-ve.

Në kuadër të reformës së institucioneve kërkimore shkencore, është krijuar Departamenti i Bioteknologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, i cili në bashkëpunim me institucione të tjera në varësi të Ministrive të përmendura më lart dhe me ASH janë të rëndësishëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit të rrezikut të OMGJ-ve.

Për fushën e Kimikateve

Çështjet e menaxhimit të kimikateve janë detyrë e disa institucioneve, përkatësisht e **MM**, **MSH**, **MEI**, **MBZHRAU**, **Ministrisë së Mbrojtjes**, **MTI**, **Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)**, si dhe **MF**.

Ligji nr. 27, datë 17.03.2016 “Mbi menaxhimin e kimikateve” ka përcaktuar si autoritet përgjegjës për kimikatet **MM-në** dhe zyrën e kimikateve (Sektori i Kimikateve, Aksidenteve Industriale dhe Zhurmave në MM).

MM është gjithashtu Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e Konventës së Roterdamit. Ligji nr. 27/2016 përcakton gjithashtu edhe kompetencat e autoriteteve të tjera që lidhen me kimikatet, ku:

- ***Ministria përgjegjëse për tregtinë*** është autoriteti kompetent për kontrollin e kimikateve në treg;
- ***Ministria përgjegjëse për industrinë*** është autoriteti kompetent për licensimin e aktiviteteve që lidhen me kimikatet e rrezikshme, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe
- ***Ministria përgjegjëse për shëndetin***, është përgjegjëse për sigurimin e informacionit mbi sigurinë dhe rrezikun e kimikateve në shëndet, në mënyrë që të përgatiten masat parandaluese kurative, veçanërisht në raste emergjencash.

MSH - është gjithashtu përgjegjëse për hartimin e legjislacionit të biocideve, përcaktimin e procedurave të vlerësimit të riskut në shëndet, autorizimin e importit dhe përdorimit të biocideve. Kontrolli i menaxhimit të biocideve kryhet nga ISSH.

MBZHRAU - është përgjegjëse për lejet e prodhimit dhe të importimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe plehrave kimike, vlerësimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre. Importi dhe eksporti i tyre kontrollohen nga kjo ministri, përmes AKU-së. Në kontrollin e PMB-ve (Produktet e Mbrojtjes së Bimëve) janë të angazhuar institutet kërkimore në varësi të MBZHRAU-së, si Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), si dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) në Fushë Krujë. Gjithashtu, ministria mbulon Direktivat që lidhen me produktet e mbrojtjes së bimëve dhe përdorimet në bujqësi, si dhe për mbrojtjen e kafshëve të laboratorit.

MMSR - ka përcaktuar punët e vështira ose të rrezikshme, si dhe listën e substancave të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë nga përdorimi i tyre. Inspektorati Shtetëror i Punës në vartësi të kësaj ministrie, në bashkëpunim me inspektoratet e tjera të shtetit koordinojnë punën për të siguruar zbatimin e legjislacionit të punës nga punëdhënësit dhe personat e siguruar prej tyre.

MTI - përgjigjet për transportin e mallrave të rrezikshme. Ajo lëshon lejen për automjetet që transportojnë mallrat e rrezikshme, bën kontrollin teknik dhe bashkërisht me MPB i shoqëron këto mallra deri në destinacion brenda vendit.

Ministria e Mbrojtjes - jep lejet dhe ka përgjegjësinë kryesore për importin, eksportin, testimin e lëndëve eksplozive. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksportit (AKSHE) pajis me liçencë importi, eksporti, transiti, me autorizim, me çertifikatë ndërkombëtare importi, çertifikatën e përdoruesit të fundit, çertifikatë shpërndarjeje dhe çertifikatë doganore, të mbërritjes së mallit në destinacion, subjekte fizike ose juridike, që kryejnë transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave me përdorim të dyfishtë, si dhe të teknologjive të tyre.

Autoritetet Doganore - regjistrojnë ngarkesën me substanca dhe përzjerje të rrezikshme, që kalon kufirin shtetëror, si dhe kontrollojnë dokumentacionin shoqërues sipas legjislacionit në fuqi.

Për fushën e Pyjeve

MM dhe institucionet e saj të varësisë - janë institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e pyjeve.

Bashkitë - janë përgjegjëse për menaxhimin e fondit pyjor e kullosor në territorin administrativ të tyre.

ISHMP - është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fondin pyjor kullosor.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

	2017	**2018**	**2019**
Buxheti Total për Këtë Kapitull i Institucionit Lider	11.035.020	9.405.715	6.085.157
Buxheti Total për Ketë Kapitull i Institucioneve të Tjera	41.674.495	1.980.000	495.000
Buxheti Total i Kapitullit	**52.709.515**	**11.385.715**	**6.580.157**

III. Prioritetet

Për sa i përket mjedisit, në fushën e *legjislacionit horizontal*, disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me **(i)** zbatimin e legjislacionit kombëtar që ka transpozuar Direktivën 2001/42/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara" dhe Direktivën e VNM-së (2011/92/EU) amenduar me Direktivën 2014/52/EU, si dhe transpozimi i plotë i Direktivës 2014/52/EU, **(ii)** forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor, **(iii)** garantimin siç duhet të informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje duke përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Aarhusit, **(iv)** ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të pushtetit vendor për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve, si dhe **(v)** edukimin e brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes.

Miratimi i planit kombëtar për *cilësinë e ajrit* dhe akteve nënligjore që lidhen me ndotësit organik të qëndrueshëm janë disa nga hapat kryesorë në këtë fushë, për vitin 2017. Gjithashtu, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit, si prioritete të MM-së janë gjithashtu edhe **(i)** hartimi i planeve lokale të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit, **(ii)** forcimi i sistemit kombëtar të monitorimit të ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër sipas standardeve evropiane, si dhe **(iii)** forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave të cilësisë së ajrit në strategjitë sektoriale të tyre.

Megjithëse, janë miratuar aktet nënligjore për *menaxhimin e mbetjeve*, si dhe janë përgatitur draftplanet rajonale të menaxhimit të mbetjeve për 12 rajonet, përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të punës së MM-së. Disa nga prioritet në këtë fushë janë ndarja e mbetjeve në burim, rritja e nivelit të riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, mbyllja e vend-depozitimeve ilegale që nuk plotësojnë asnjë kriter për depozitimin e mbetjeve, orientimi drejt ngritjes së impianteve të djegies së mbetjeve (inceneratorëve), ndërtimi i landfilleve sipas standardeve të BE-së, sigurimi i faciliteteve për mbetjet e rrezikshme mjekësore ose ndërtimore, nxitja e partneritetit publik privat (PPP), si dhe sigurimi i investimeve të reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve.

Në fushën e *menaxhimit të integruar të burimeve ujore* dhe *cilësisë së ujërave*, MBZHRAU ka si prioritet të punës së saj **(i)** përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, **(ii)** vlerësimin e shkallës së dëmtimit të baseneve të lumenjve si rezultat i aktiviteteve të subjekteve që shfrytëzojnë inertet lumore dhe ndërmarrjen e masave ndëshkuese, **(iii)** krijimin e regjistrit kombëtar te burimeve ujore, si dhe **(iv)** përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore në nivel baseni dhe kombëtar nëpërmjet hartimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, hartimit të 2 planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve Drin-Bunë dhe Seman, si dhe krijimit të kadastrës elektronike kombëtare të burimeve ujore.

Ndërkohë që për sektorin e ujësjellës kanalizimeve, MTI ka si prioritet **(i)** sigurimin e mbështetjes për zbatimin e reformës për Sh.a Ujësjellës Kanalizime, **(ii)** sigurimin e asistencës teknike në mbështetje të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në kuadër të ndryshimeve si pasojë e reformës territoriale, **(iii)** çertifikimin e Stafit Menaxherial Operacional (për staf menaxherial deri në nivelin e mesëm drejtues), **(iv)** hartimin e një Sistemi Kombëtar të Inventarizimit të Aseteve në webGIS, **(v)** sigurimin e mbështetjes financiare për mbulimin e diferencës ndërmjet të ardhurave nga veprimtaria kryesore e shitjes UK dhe kostos totale-Amortizimin UK, **(vi)** projekt kombëtar për ndërhyrje në efiçencën e energjisë, si dhe **(vii)** studimi dhe hartimi i bazës ligjore për marrjen në administrim të shoqërive nga AKUK.

Në fushën *e mbrojtjes së natyrës*, do të punohet për të garantuar **(i)** menaxhimin e integruar të zonave të mbrojtura, **(ii)** identifikimin e zonave potenciale Natura 2000 për Shqipërinë, **(iii)** marrjen e masave për ndalimin e veprimtarive të paligjshme si prerja e drurëve dhe ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura, si dhe **(iv)** forcimin e kapaciteteve administrative të Zonave të Mbrojtura (AKZM dhe AdZM-ve) për eliminimin e këtyre fenomeneve.

Për sa i përket fushës së *ndotjes industriale, menaxhimit të risqeve dhe aksidentet* një nga prioritetet kryesore është përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me Direktivën 2010/75/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), si dhe me Direktivën 2012/18/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 4 Korrik 2012 "Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme", ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/82/EC.

Për sa i përket *politikave për zhurmën në mjedis*, një nga prioritetet kryesore në këtë fushë është forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës së ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare.

Në fushën e *kimikateve*, prioriteti kryesor i MM-së është ngritja e kapaciteteve të sektorit që mbulon kimikatet dhe inspektoratit të mjedisit për zbatimin e legjislacionit të miratuar në këtë fushë dhe plotësimi i bazës ligjore që siguron zbatimin e legjislacionit të kimikateve.

Për sa i përket *ndryshimeve klimatike*, përafrimi i plotë me legjislacionin e BE-së, hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, ngritja e sistemit kombëtar të inventarëve të shkarkimeve në ajër dhe të gazeve me efekt serrë, si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave të ndryshimeve klimatike në strategjitë e tyre sektoriale, janë disa nga prioritetet në këtë fushë.

Në fushën e *pyjeve*, prioritetet e MM-së kanë të bëjnë me **(i)** përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushë, si dhe hartimine akteve nënligjore që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë, **(ii)** hartimin e Strategjisë së Re 10-vjeçare për Pyjet dhe Kullotat, **(iii)** Regjistrimin e fondit pyjor dhe kullosor kombëtar në sistemin kadastral të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet krijimit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve, si dhe **(iv)** Pyllëzimin e sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2020

IV.1 Legjislacioni Horizontal

Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli	Institucioni Lider	Periudha e Referuar
Strategjia Ndersektorale e Mjedisit	Ministria e Mjedisit	2007 – 2013
Metodologjia Kombëtare e Procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	Ministria e Mjedisit	1 Shtator 2016 – në vazhdim

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Lider	Niveli i Përafrimit	Data e Miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në Fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2004/35/EC	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	09.06.2011	30.12.2013
Direktiva	Ligji nr. 91, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	28.02.2013	04.04.2013

2001/42/EC	(VSM)”; VKM nr. 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”;	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	11.03.2015	01.04.2015
	VKM nr. 620, datë 07.07.2015 “Për miratimin e rregullave, përgjegjësive dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar”;	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	07.07.2015	16.07.2015
Direktiva 2011/92/EU	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)”, të ndryshuar;	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	07.07.2011	01.02.2013
	Ligji nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	26.02.2015	01.09.2015

	VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave dhe kërkesave të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore;	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	30.04.2014	21.05.2014
	VKM nr. 598, datë 01.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”;	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	01.07.2015	01.09.2015
	VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	29.07.2015	01.09.2015
	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, të ndryshuar;	Ministria e Mjedisit	I plotë	09.06.2011	30.12.2013

Direktiva 2003/35/EC	Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit";	Ministria e Mjedisit	I plotë	26.10.2000	10.11.2000
	VKM nr. 994, datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e publikut në vendimmarrje për mjedisin”;	Ministria e Mjedisit	I plotë	02.07.2008	24.07.2008
	Urdhëri i Ministrit nr. 1, datë 03.03.2009 “ Për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis”	Ministria e Mjedisit	I plotë	03.03.2009	03.03.2009

Direktiva 2003/4/EC	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, të ndryshuar;	Ministria e Mjedisit	I plotë	09.06.2011	30.12.2013
	Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit";	Ministria e Mjedisit	I plotë	26.10.2000	10.11.2000
	Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;	Të gjitha institucionet publike	I plotë	18.09.2014	02.11.2014
	VKM nr.16, datë 04.01.2012 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”.	Ministria e Mjedisit	I plotë	04.01.2012	03.02.2012

Kuadri i Politikave të Planifikuara për Periudhën 2017 – 2020

Titulli	Institucioni Lider	Periudha e Referuar	Data e Miratimit	Hyrja në fuqi
Metodika Kombëtare e Vlerësimit Strategjik Mjedisor	Ministria e Mjedisit	2018– në vazhdim	Tremujori 3, 2017	Tremujori 4, 2017
Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit	Ministria e Mjedisit	2018-2023	Tremujori 4, 2017	Tremujori 4, 2017

Masat Ligjore të Parashikuara për Periudhën 2017 – 2019

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit, nenet 13, 14, 15, 34, 43, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 41 dhe Protokolli 4 përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në veçanti neni 97 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin për të përafruar legjislacionin doganor shqiptar me atë të BE-së, bashkëpunimin mes Palëve duke pasur parasysh Acquis Communautaire në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencë të ndërsjellë administrative në çështje doganore.

Legjislacioni doganor mbështetet kryesisht në aktet e BE-së të përmendura më poshtë:

- Rregullore e Këshillit 2913/92/EEC "Për Kodin Doganor Komunitar";
- Rregullore e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 952/2013, "Kodi Doganor i Bashkimit";
- Rregullore e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93 "Për përcaktimin e dispozitave për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2913/92 (31992R2913) për themelimin e Kodit Doganor të Komunitetit";
- Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC "Për tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe për tarifat e përbashkëta doganore";
- Rregullore (EC) nr. 1186/2009, "Mbi përjashtimet nga detyrimet doganore";
- Direktiva 2007/74/EC e Këshillit Evropian, "Mbi përjashtimet nga TVSH dhe Akcizën për mallrat e importuara nga udhëtarët";
- Rregullore Zbatuese e Komisionit, që amendon shtojcën I të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2658/87 mbi Tarifën dhe Nomenklaturën Statistikore dhe mbi Tarifën e Përbashkët Doganore;
- Direktiva e Këshillit 2008/118/EC në lidhje me masat e përgjithshme për akcizën dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/EEC. Celex 32008L0118;
- Direktiva 2003/96/KE e Këshillit që ristrukturon kuadrin Komunitar për taksimin e produkteve të energjisë dhe elektricitetit;
- Direktiva 92/83/KEE mbi harmonizimin e strukturave të taksës së akcizës mbi alkoolin dhe pijet alkoolike;
- Direktiva 92/84 KEE mbi harmonizimin e niveleve te detyrimit të akcizës mbi alkoolin dhe pijet alkoolike;
- Direktiva 92/12/EEC për rregulla te përgjithshme për mbajtjen, lëvizjen dhe mbikëqyrjen e produkteve të akcizës;
- Vendimi i Komisionit nr. 428 që përcakton një markim të përbashkët fiskal për gazin dhe vajgurin;
- Rregullore 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, lidhur me zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë, e cila shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1383/2003;
- Rregullore Zbatuese e Komisionit Nr. 1352/2013,"Për vendosjen e formularëve të parashikuar në Rregulloren (BE) Nr 608/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë.

II.2. Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi, Administrata Doganore Shqiptare ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA.

Është miratuar ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i cili është pjesërisht i përafruar me Rregulloren Nr. 952/2013 "Kodi Doganor i Bashkimit" si dhe bazohet në një sërë aktesh të tjera evropiane që rregullojnë elementë specifikë doganorë. Kodi i Ri Doganor ka hyrë pjesërisht në fuqi. Administrata Doganore aplikon gjithashtu ligjin nr. 8449, datë 19.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së

Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji nr. 32, datë 2.04.2015, ka ndryshuar ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014, përmes të cilit lejohet hapja e duty free shops edhe në pikat e kalimit kufitar tokësor dhe detar, duke synuar vendosjen e kushtëzimeve të atilla që sigurojnë mbikqyrje dhe kontroll doganor efektiv në balancë me nevojën e tregtisë dhe të hapjes së këtyre dyqaneve.

Përmes VKM Nr. 919, datë 29.12.2014 "Mbi dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" janë bërë një sërë përmirësimesh, lehtësime e thjeshtime të rregullave dhe procedurave doganore, duke synuar kështu përshtatjen dhe ecjen paralelisht me zhvillimet e tregtisë ndërkombëtare si dhe me nevojat e operatorëve ekonomikë. Vendimi erdhi si domosdoshmëri për zbatimin e dispozitave të Kodit të ri Doganor për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, procedurat e thjeshtuara, përjashtimet nga detyrimet, duke përafruar disa akte të BE-së.

Përmes VKM nr. 366, datë 30.04.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 205, datë 13.4.1999 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar, janë përafruar dispozita të Rregullores nr. 2454/93, për të bërë të mundur fillimin e zbatimit të proçedurës së thjeshtuar të zhdoganimit në ambientet e operatorëve ekonomik (zhdoganimi lokal), duke plotësuar në këtë mënyrë kuadrin e plotë të thjeshtimeve doganore që aktualisht zbatohet në Bashkimin Europian.

Legjislacioni mbi akcizat, i cili administrohet nga dogana ka përafruar pjesërisht disa akte të BE-së. Në zbatim të ligjit nr. 61/2012 është VKM 612/2012, datë 09.05.2012 "Mbi Dispozitat Zbatuese të Ligjit "Mbi Akcizat", i ndryshuar, përmes të cilit Shqipëria përdor praktikat më të mira të legjislacionit francez dhe italian.

NK e Mallrave 2016 është miratuar me VKM nr. 1089, datë 28.12.2015 "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për vitin 2016" dhe ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2016.

Është miratuar VKM nr. 247, datë 20.3.2015 "Për miratimin e strategjisë sektoriale kundër korrupsionit", pjesë e së cilës është edhe administrata doganore për forcimin e integritetit të nëpunësve doganorë. Ka një Memorandum të përbashkët "Mbi shkëmbimin e informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta dhe kryerjen e testit të integritetit" ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, ku struktura zbatuese janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me qëllim parandalimin dhe luftën ndaj sjelljeve të parregullta apo veprimeve të kundërligjshme në strukturat respektive.

Administrata doganore është pjesë e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, miratuar me VKM nr. 663, datë 17.7.2013, të ndryshuar..

Përmes VKM nr. 1090, datë 28.12.2015 “Për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë” janë përafruar pjesërisht Rregullorja Nr. 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës të datës 12 Qershor 2013, në lidhje me zbatimin në doganë të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1383/2003, si dhe Rregullorja e Komisionit Nr. 1352/2013, të datës 4 dhjetor 2013,”Për vendosjen e formularëve të parashikuar në Rregulloren Nr. 608/2013, duke unifikuar procedurat e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Doganën Shqiptare me ato të Bashkimit Evropian.

Përmes ligjit nr. 184/2014, datë 24.12.2014 Republika e Shqipërisë merr pjesë në Programin e Bashkimit Doganor “Doganat 2020”.

Në 2016 është nënshkruar protokolli për implementimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet të dyja vendeve.

Republika e Shqipërisë ka aderuar në disa konventa në fushën e doganave, marrëveshje ndërkombëtare në fushën e tregtisë së lirë dhe marrëveshje bilaterale me administratat homologe doganore.

II.3. Institucionet përgjegjëse

Administrata Doganore Shqiptare përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga Degët Doganore. Ajo varet nga Ministria e Financave dhe është nën mbikëqyrjen e saj. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka si mision të saj sigurinë e tregjeve dhe të popullatës (mbrojtja e konsumatorëve, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e kufijve kombëtare) nëpërmjet mbikëqyrjes efikase nga doganat dhe bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit; mbledhjen e detyrimeve dhe akcizës; krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e biznesit, nëpërmjet aplikimit të metodave moderne të punës.

Autoritetet doganore janë përgjegjëse për kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor për mallrat në hyrje dhe në dalje të territorit doganor shqiptar, parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara, konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve doganore, përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e doganave, mbikëqyrjen dhe kontrollin e mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve doganore, etj.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrim Evropian i ngarkuar me Kapitullin 29 (Doganat) drejtohet nga Ministria e Financave.

II.4. Sqarime në lidhje me parashikimet financiare

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka të akorduar buxhet në vite si më poshtë:

000/lekë

Viti	2016	2017	2018
Buxheti total per kete kapitull iinstitucionit lider	3,753,312	3,786,318	3,572,232
Buxheti total per kete kapitull i institucioneve te tjera	0	0	0
Buxheti total i Kapitullit	3,753,312	3,786,318	3,572,232

Projektet e huaja nga të cilat përfiton Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë:

1. Programi IPA 2012
   - Projekt binjakëzimi për përafrimin e legjislacionit doganor dhe procedurave me ato të BE-së nga pikëpamja e ndërveprimit të sistemeve të TI me sistemet e BE-së (Vlera e Grantit 1,800,000 € (co-financing 50,000€).
   - Blerja e makinave te specializuara për Drejtorinë e Anti-Kontrabandës dhe pajiset përkatëse (Vlera e Grantit 1,000,000 €).
   - Përfundimi i Rehabilitimit te PKK Morine Faza II dhe ndërtimi i PKK Hani i Hotit (Vlera e Grantit 3,000,000 €).
2. Programi IPA 2013
   - Kontratë binjakëzimi për përafrimin e procedurave dhe legjislacionit ne fushën e tarifës (Vlera e Grantit 1,800,000 €).
   - Kontratë shërbimi për zhvillimin e modulit ITMS (Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifës) (Vlera e Grantit 2,400,000 €).
   - Projekti i ANEAS "Vendosja e një sistemi kontrolli dhe instalimi pilot i pajisjeve zbuluese për të siguruar kontrollin e materialeve radioaktive (Vlera e Grantit 800,000 €).

Vlera totale e Grantit të Programit "Doganat 2020" është 345,000 €. Për vitin 2016 është planifikuar një shumë prej 55.000 Euro për aktivitetet e periudhës 1 prill 2016 - 31 mars 2017. Vazhdon pjesëmarrja e administratës doganore në kuadrin e këtij Programi në takime dhe vizita pune.

III. Përparësitë

Përparësitë afat-shkurtra:

- Përafrim i mëtejshëm i legjislacionit doganor, akcizat dhe procedurat me praktikat e BE-së;

- Përditësimi në kohë i tarifave kombëtare mbi bazën e Nomenklaturës së Kombinuar më të fundit;
- Përmirësimi dhe përforcimi i legjislacionit doganor për të drejtat e pronësisë intelektuale;
- Vënia në eficencë e sistemit të menaxhimit të informacionit në laboratorin doganor;
- Shmangia e praktikave të parregullta dhe korrupsionit në administratën doganore.

Përparësitë afat-mesme:

- Të përafrohet më tej legjislacioni shqiptar për doganat me *acquis* e BE-së*;*
- Përditësimi në kohë i tarifave kombëtare mbi bazën e Nomenklaturës së Kombinuar më të fundit;
- Të shtohen kapacitetet administrative për përmbushjen e misionit doganor dhe pajtueshmërinë me legjislacionin doganor;
- Të shtohen kapacitetet administrative në kuadër të luftës kundër korrupsionit, krimit ndërkufitar dhe evazionit fiskal.
- Përmirësimi i transparencës dhe shkëmbimit të informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë shmangien apo evazionin e taksave.
- Përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI-së, kryerja e veprimeve të mëtejshme për tu përgatitur për ndërveprimin e sistemeve TI të DPD me ato të BE-së;

IV. Plani i Veprimit 2017-2020

BASHKIMI DOGANOR

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia për menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020	MF	2014 – 2020
Strategjia e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare	MF	2013 – 2017
Strategjia e Teknologjisë së Informacionit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2013 – 2017
Strategjia ndër-sektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020	Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit	2013 – 2020

Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit	Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit	2014 – 2020
Strategjia Ndër-sektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020.	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit, (institucione përgjegjëse janë shumë institucione përfshirë edhe doganën)	2015 – 2020
Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve	Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore	2010 – 2025

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullore 2913/92/EEC	Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	MF	I pjesshëm	27.01.1999	06.03.1999
Rregullore e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 952/2013, datë 09 tetor 2013 "Union Customs Code"	Ligji Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	I pjesshëm	31.07.2014	disa nene kanë hyrë në fuqi 15 dite pas botimit në FZ, disa më 1 janar 2015 e disa pritet të hyjnë në fuqi me 1 qershor 2017.

Rregullore e Këshillit (KE) nr. 1186/2009, datë 16, nëntor 2009, mbi përjashtimet nga detyrimet doganore	Ligji Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	I pjesshëm	31.07.2014	nenet për përjashtimet kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2015.
Direktiva e Këshillit 2007/74/KE datë 20 Dhjetor 2007.	Ligji Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	I pjesshëm	31.07.2014	nenet për përjashtimet kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2015.
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC	Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore", i ndryshuar,	MF	I pjesshëm	21.12.2005	01.01.2006
Rregullore e BE No.1754/2015, datë, që amendon shtojcën I të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2658/87	VKM Nr. 1089, datë 28.12.2014 "Mbi miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2015"	MF	I plotë	29.12.2014	01.01.2015
Direktiva e BE-se nr. 2008/118 ne lidhje me akcizën	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Direktiva e Këshillit 2003/96/ të datës 27 Tetor 2003	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Direktiva 92/83/KEE e datës 19 tetor 1992.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012

	ndryshuar				
Direktiva 92/84 KEE e datës 19 tetor 1992.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Direktiva 92/12/EEC e 25 shkurt 1992.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Vendimi i Komisionit nr. 428, datë 22.06.2006	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Rregullore e Komisionit EC 2008/450.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Rregullore e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93, të datës 02.07.1993	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 205, datë 13.04.1999, "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar	MF	I pjesshëm	13.04.1999	28.04.1999
Rregullore Nr. 608/2013 dhe Rregullore nr. 1352/2013	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1090, datë 28.12.2015 "Për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë".	MF	I pjesshëm	28.12.2015	13.01.2016
Rregullore nr. 2454/93/	VKM nr. 919, datë	MF	I pjesshëm	29.12.2014	1.01.2015

	29.12.2014 "Mbi dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i RSH".				
Rregullore (EC) Nr. 1186/2009,	VKM nr. 919, datë 29.12.2014 "Mbi dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i RSH".	MF	I pjesshëm	29.12.2014	1.01.2015
Direktiva 2007/74/EC	VKM nr. 919, datë 29.12.2014 "Mbi dispozitat zbatuese te ligjit nr. 102/2014"Kodi Doganor i RSH".	MF	I pjesshëm	29.12.2014	1.01.2015
Rregullore e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93, të datës 02.07.1993, e ndryshuar	VKM nr. 366, datë 30.04.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar	MF	I pjesshëm	30.04.2015	15.05.2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2020

EU *acquis*	Status i	Legjislacioni Shqiptar	Status i	Institucioni	Niveli i synuar i	Data e	Hyrja në fuqi

	përkthimit në Shqip (po/jo)	**(ligjet dhe aktet nënligjore)**	**përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**përafrimit (i plotë/përputhje e EC**	**planifikuar për përshtatjen**	
AFAT SHKURTËR (2017)							
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987	Jo	Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2017"	Jo	MF	I pjesshëm	T 4 2016	T 1 2017
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987	Jo	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave"	Jo	MF	I pjesshëm	T 4 2017	T 1 2018
AFAT MESËM (2018 – 2020)							
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987	Jo	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave"	Jo	MF	I pjesshëm	T 4 2018	T 1 2019
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987	Jo	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave"	Jo	MF	I pjesshëm	T 4 2019	T 1 2020
Rregullore zbatuese e komisionit (EU) 2015/2447, datë 24 Nentor 2015 që	po	VKM "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014.	jo	MF	I pjesshëm	T 4 2020	T 4 2020

përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e disa dispozitave të Rregullores (EU) Nr. 952/2013 e Parlamentit Evropian dhe Keshillit							
Rregullore e deleguar e Komisionit (EU) 2015/2446 , datë 28 July 2015 e cila plotëson Rregulloren (EU) Nr. 952/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Keshillit	po	VKM "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014.	jo	MF	I pjesshëm	T 4 2020	T 4 2020

V.Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e planifikuar e fondeve

Kapitulli 29: Bashkimi Doganor					
Përfituesi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Fondet totale të planifikuara të buxhetit të shtetit	A) Paga–stafi ekzistues	**1.080.000.000**	**1.080.000.000**	**1.080.000.000**	**3.240.000.000**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot	**1.981.433.000**	**1.981.433.000**	**1.981.433.000**	**5.944.299.000**

	në vazhdim				
	Aktiviteti total	**3.061.433.000**	**3.061.433.000**	**3.061.433.000**	**9.184.299.000**
Totali i Kapitullit		**9.184.299.000**			

Tabela B – Fondet e planifikuar nga asistenca e huaj

Kapitulli:	**Bashkimi Doganor**			
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera në €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
Bashkimi Doganor	Projekt binjakëzimi për përafrimin e legjislacionit doganor dhe procedurave me BE-në nga perspektiva e interfunksionalitetit të sistemeve të IT-së me sistemet e BE-së	IPA 2012	1,800,000	
Bashkimi Doganor	Rehabilitimi i Doganës së Morinës, Faza II dhe ndërtesës së PKK Hani Hotit	IPA 2012	3,000,000	
BashkimiDoganor	Blerja e makinave të specializuara për Drejtorinë e Antikontrabandës dhe pajisjet përkatëse.	IPA 2012	1,000,000	
Bashkimi Doganor	Kontratë binjakëzimi për përafrimin e procedurave doganore dhe legjislacionin në fushën e tarifës	IPA 2013	1,800,000	
Bashkimi Doganor	Kontratë shërbimi për zhvillimin e modulit të ITMS totalisht në përputhje me ITMS e BE-së	IPA 2013	2,400,000	
Bashkimi Doganor	Vendosja e një sistemi kontrolli dhe instalimit pilot	IPA 2013	800,000	

	të pajisjeve të detektimit për mbikqyrjen e materialeve radioaktive			
Bashkimi Doganor	Programi Dogana 2020		420,000	
Totali për Kapitullin:			11,220,000	

KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis e BE-së në fushën e marrëdhënieve me jashtë, në një pjesë të konsiderueshme mbështetet në legjislacionin e politikës së përbashkët tregtare. Ajo gjithashtu përmbledh edhe legjislacionin për politikat e zhvillimit dhe ndihmës humanitare. Legjislacioni i BE-së në fushën e politikës së përbashkët tregtare përbëhet kryesisht nga ligjet primare (Traktati), nga aktet nënligjore të BE-së (kryesisht në formën e rregulloreve) si dhe nga marrëveshjet shumëpalëshe dhe dypalëshe të BE-së. Shqipëria do të duhet të sigurojë që regjimi i tij tregtar të jetë në përputhje me regjimin e BE-së.

Përveç marrëdhënieve ekonomike e tregtare, kapitulli marrëdhëniet me jashtme i *acquis* së BE-së, gjithashtu, përfshin edhe bashkëpunimin në aspektin e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare. Në fushën e politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare, shtetet anëtare, duhet të përputhin me legjislacionin e BE-së, angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë kapacitetin për të marrë pjesë në zhvillimet dhe në politikat humanitare të BE-së.

Legjislacioni shqiptar do të duhet të shfuqizohet sapo Shqipëria të hyjë në BE ndërsa rregulloret e BE-së do të funksionojnë menjëherë në rendin ligjor kombëtar. Vetëm aspektet institucionale të zbatimit, duhet të rregullohen nga ligjet shqiptare që mund të referohen për normat e tyre për Rregulloren e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria zbaton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe tregtare. Politika tregtare e Shqipërisë ndjek parimet e politikës së përbashkët tregtare të Bashkimit Evropian. Shqipëria, krahas parimeve të OBT-së, respekton edhe rregullat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian, CEFTA, EFTA dhe Turqinë.

Forcimi i kapaciteteve administrative është një komponent i domosdoshëm, kriteret kryesore e të cilave janë rritja e njohurive të administratës publike për Politikën e Përbashkët Tregtare, thjeshtimi i instrumenteve për hartimin dhe bashkërendimin e politikës tregtare, në mënyrë që të përputhet me politikën e përbashkët tregtare të BE-së.

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA TREGTARE
2. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe legjislacionit të BE-së

1. POLITIKA TREGTARE

Detyrimi për përafrimin e ligjit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 MSA-së, dispozitë nga cila Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me të drejtën e BE-së, por edhe të sigurohet se ajo të zbatohet. Marrëveshje Stabilizim-Asociimit (MSA) përfshin një pjesë kryesore të tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e OBT-së ose të detyrimeve ndërkombëtare. Detyrimet e Shqipërisë sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare në mënyrë të përmbledhur janë nenet relevante të MSA-së për këtë kapitull, si: 7, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 33, 34, 40, 59, 60, 70, 71, 72, 73, 74, 97.

3. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE

- Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndryshime legjislative në politikën e zhvillimit dhe të ndihmës humanitare, të cilat mbeten në një fazë të hershme të harmonizimit. Nuk ka ndonjë nuk ka një buxhet dedikuar ndihmës humanitare ose agjenci për administrimin e ndihmës humanitare. Sa i përket ndihmës humanitare, ligji Nr. 9900, date 10.04.2008 "Per Rezervat Materiale të Shtetit" përcakton dispozitat në këtë fushë.

Këshilli i Ministrave merr ad-hoc, rast-pas-rasti vendime për të dhënë kontribute në raste të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile ndërkombëtare.

Legjislacioni kryesor i Bashkimit Evropian në këtë fushë përmbledh:

Politika e Përbashkët Tregtare kërkon një politikë të përbashkët tregtare të regjimit të Import/Eksportit, Masat Tregtare të Mbrojtjes si dhe Kuadrin Tregtar Shumëpalësh të OBT-së.

- Rregullorja (BE) Nr. 428/2009 "Për krijimin e regjimit të Komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferim, ndërmjetësimin dhe transitin e mallrave me përdorim të dyfishtë" e amenduar;
- Rregullorja (BE) Nr. 260/2009 "Për rregullat e përbashkëta në importe të BE-së e amenduar";
- Rregullorja (BE) Nr. 1225/2009 "Mbi mbrojtjen kundër dumpingut në importe nga vendet jo anëtare të BE-së e amenduar";
- Direktiva 98/29/KE "Mbi harmonizimin e dispozitave kryesore lidhur me sigurimin e kredive të eksportit për transaksionet afatmesme dhe afatgjatë (e ndryshuar me Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 806/2003)".
- Direktiva e 84/568/KEE "Mbi detyrimet reciproke të organizatave të sigurimit të kredive të eksportit të vendeve anëtare që veprojnë në emër të shtetit ose me mbështetjen e saj, ose të departamenteve publike që veprojnë në vend të këtyre organizatave, në rastin e garancive të përbashkëta për një kontratë që përfshin një ose më shumë te nënkontraktuar në një ose më shumë shtete anëtare të Komunitetit Evropian".

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

1. POLITIKA TREGTARE

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë nga shtatori i vitit 2000 dhe **politika tregtare** ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj të brendshëm më atë të BE-së në fushën e importit të mallrave, ndihmës shtetërore, prokurimit publik, aviacionit civil, subvencioneve, etj, në përputhje me angazhimet e saj në ketë organizatë. Shqipëria ndjek të gjitha zhvillimet ne OBT dhe përditëson në mënyrë periodike legjislacionin e saj në përputhje me parimin e transparencës.

E gjithë strategjia e politikës tregtare pas anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë është mbështetur në (i) Raportin e Anëtarësimit së Shqipërisë në këtë organizatë, (ii) Ligjin Nr. 8649, datë 28.07.2000, "Për ratifikimin e rezultateve të Raundit të Uruguait të negociatave tregtare shumëpalëshe".

Shqipëria ka depozituar instrumentin e pranimit te Marreveshjes së Lehtësimit të Tregtisë ne Sekretariatin e OBT në Maj 2016. Ndërkohë është krijuar Komiteti Kombëtar për Koordinimin e Politikës Tregtare me urdhrin e Kryeministrit Nr. 80 e datës 12.05.2016 dhe është funksionale që nga muaji qershor i 2016. Plani Kombëtar 2016-2020 për lehtësimin e tregtisë pritet të finalizohet brenda muajit nëntor 2016.

Në lidhje me Marrëveshjen e Teknologjisë së Informacionit në OBT, Shqipëria ka bashkë-sponsorizuar propozimin e BE-së dhe ka mbështetur deklaratën dhe listën e produkteve të propozuar që do të mbulohen nga kjo marrëveshje.Ndryshimet ligjore në këtë fushë priten të finalizohen brenda vitit 2016

Shqipëria ka tashme në zbatim marrëveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendet e Evropës Juglindore (CEFTA 2006), vendet EFTA dhe Turqisë

Negociatat mbi Protokollin Shtesë 5 në lehtësimin e tregtisë në marrëveshjen CEFTA janë përfunduar dhe pritet miratimi nga të gjitha palët e CEFTA-s gjatë takimit të Komitetit të Përbashkët në muajin nëntor 2016. Shqipëria ka marrë pjesë aktive në të gjitha takimet dhe aktivitetet e CEFTA-s. Negociatat mbi liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë në shërbime ndërmjet vendeve CEFTA vazhdojnë
Është miratuar me VKM-në nr. 665, datë 29.7.2015 ndryshimi i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me shtetet e EFTA-s duke shtuar një kapitull mbi Tregtinë dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm, e cila u nënshkrua, më 18 shtator 2015 në Gjenevë.

Shqipëria ka miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 703 datë 12.10.2016 "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë" e cila transpozon Shtojcën I të Rregullores (BE) 2015/2420 E DELEGUAR NGA KOMISIONI e 12 tetorit 2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 428/2009 për vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe tranzitit të sistemeve me përdorim të dyfishtë" si dhe Vendimin e Këshillit të BE-së, LISTA E PËRBASHKËT USHTARAKE E BASHKIMIT EVROPIAN e miratuar nga Këshilli më 9 shkurt 2015 (pajisje që i mbulon Qëndrimi i Përbashkët të Këshillit 2008/944/CFSP që përcakton rregullat e përgjithshme për kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake) (përditëson dhe zëvendëson Listën e Përbashkët Ushtarake e Bashkimit Evropian, të miratuar nga Këshilli më 17 mars 2014(CFSP) (2015/C 129/01)

Republika e Shqipërisë ka në zbatim *43 marrëveshje dypalëshe* për "Nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve", të cilat janë aktualisht në fuqi. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve janë: Austri; Azerbajxhan; Unioni i përkohshëm Belgjik-Luksemburg; Bosnje Hercegovina; Britani e Madhe; Bullgari; Çeki; Danimarkë; Egjipt; Finlandë; Francë; Greqi; Gjermani; Holandë; Hungari; Itali; Izrael; Katar; Kinë; Koreja e Jugut; Kroaci; Kuvajt; Lituani; Malajzi; Maltë; Maqedoni; Moldavi; Poloni; Portugali; Qipro; Rumani; Rusi; San Marino; Serbi; Slloveni; Spanjë; Suedi; Tunizi; Turqi; Ukrainë; SHBA; Zvicër, Kosovë(UMNIK).

Shqipëria ka vazhduar të përmirësojë marrëdhëniet e saj tregtare me disa shtete, në veçanti me Emiratet e Bashkuara Arabe duke nënshkruar Marrëveshjen "Për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve" dhe gjithashtu është nënshkruar Marrëveshja n e re "Për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve" me Kosovën. Shqipëria, aktualisht po negocion Marrëveshjet "Për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve" me Kanadanë, Islandën, Marokun dhe Libanin.

Republika e Shqipërisë ka në zbatim 37 marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik/memorandume me vende të ndryshme në zhvillim. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik janë: Arabi Saudite; Argjentinë; Austri; Unioni i përkohshëm Belgjik Luksemburg; Bullgari; Brazil; Çeki; Danimarkë; Emiratet e Bashkuara Arabe; Egjipt; Finlandë; Francë; Gjermani; Greqi; Hungari; Izrael; Japoni; Katar; Kinë; Kroaci; Koreja e Jugut; Kuvajt; Libi; Malajzi; Maqedoni; Poloni; Rumani; Rusi; Serbi; Slloveni; Sllovaki; Suedi; Turqi; Ukrainë; Uruguai; SHBA; Zvicër.

- Aktualisht, është në fuqi Marrëveshja e re "Për bashkëpunimin ekonomik dhe teknik" me Kinën;
- Shqipëria ka miratuar dhe nënshkruar, por ende jo në fuqi, Marrëveshjen "Për Bashkëpunim Ekonomik" me Malin e Zi dhe Memorandumin institucional të "Bashkëpunimit në fushën e zhvillimit të eksporteve industriale" me Shtetin e Kuvajtit;
- Shqipëria ka miratuar në parim Marrëveshjet e "Bashkëpunimit Ekonomik" me Kazakistanin dhe Korenë, cilat janë ende të panënshkruar dhe jo në fuqi;
- Në proces negocimi teknik janë Marrëveshjet e "Bashkëpunimit ekonomik e teknik" me Bosnjë-Hercegovinën, Indinë, dhe Moldavinë.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për politikën tregtare përfshijnë:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri,
2. Ministria e Integrimit Evropian,
3. Ministria e Drejtësisë,
4. Ministria e Financave,
5. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujërave,
6. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,
7. Ministria e Mbrojtjes,
8. Ministria e Shëndetësisë,
9. Ministria e Zhvillimit Urban,
10. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,
11. Ministria e Mjedisit,
12. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,
13. Banka e Shqipërisë,
14. Autoriteti i Konkurrencës,
15. Agjencia e Prokurimit Publik;
16. Ministri për Inovacionin, dhe Administratën Publike,
17. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave;

18. Zyra shqiptare për të Drejtat e Autorit;

19. Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil,

20. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; si dhe çdo ministri apo institucion tjetër që prek tregtinë.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Viti	**2017**	**2018**	**2019**
Buxheti total per kete kapitull I Institucionit lider MZHETTS		0	0
Buxheti total per kete kapitull I institucioneve te tjera	274,775.6	0	0
Buxheti total I Kapitullit	274,775.6	0	0

III. Prioritetet

Me anëtarësimin në Bashkimi Evropian, Shqipëria do të jetë e detyruar të përshtatë politikën e përbashkët tregtare me atë të BE-së. Për këtë, Shqipëria do të zbatojë të gjitha marrëveshjet tregtare autonome (preferenciale dhe jo preferenciale) që BE-ja u garanton disa vendeve jo anëtare të BE-së, duke përfshirë edhe Sistemin e Përgjithësuar të Preferencave (SPP).

Shqipëria do të duhet të përfundojë të gjitha marrëveshjet e saj të tanishme preferenciale tregtare me vendet jo anëtare të BE-së dhe të sjellë të gjitha marrëveshje te tjera, duke përfshirë marrëveshjet jo preferenciale të tregut, në përputhje me detyrimet e anëtarësimit në BE. Shqipëria do të bëhet palë e Zonës Ekonomike Evropiane dhe pas pranimit, do të duhet të zbatojnë të gjitha marrëveshjet e tregtisë ndërkombëtare të BE-së, përfshirë këtu OBT-në.

Në përputhje me detyrimet e MSA-së, Shqipëria duhet të:

- Vlerësojë mundësitë për zgjerimin e koncesioneve për produktet bujqësore dhe peshkun;

- Të ndjekë të gjitha zhvillimet në politikën e përbashkët tregtare të BE-së.

Mbështetur në sa sipër prioritetet shqiptare përfshijnë:

- Ngritja e kapaciteteve të administratës publike për të ndjekur zhvillimet e Politikës së Përbashkët Tregtare me Bashkimin Evropian;
- Thellimi i integrimit rajonal në kuadër të Marrëveshjes CEFTA. Avancimi i negociatave për liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve me vendet palë të kësaj marrëveshje.

Në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe ndihmës humanitare, Shqipëria do të duhet të zhvillojë politikën e saj kombëtare dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në mënyrë që të përputhen me standardet e BE-së.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017– 2020

IV.1 Politika tregtare

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja (BE) Nr. 260/2009	Ligji Nr. 9790, datë 19/07/2007 "Për masat mbrojtëse në Importe"	MZHETTS	I pjesshëm	19.07.2007	3.08. 2007
Rregullorja (BE) Nr. 597/2009	Ligji Nr. 9796 23/07/2007 "Për Antidumping dhe Masave Kundër balancuese"	MZHETTS	I pjesshëm	23.07.2007	7.08. 2007
Rregullorja Nr. 1225/2009	Ligji Nr. 9796 23/07/2007 "Për Antidumping dhe Masave Kundër balancuese"	MZHETTS	I pjesshëm	23.07.2007	7.08. 2007
Rregullorja(BE) Nr.	Ligji Nr. 9707, datë	AKSHE	I pjesshëm	24.04.2007	9.05.2007

1334/2000	5.4.2007“Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë” nr. 9707, datë 5.4.2007				
Rregullorja(BE) Nr. 428/2009	VKM Nr. 106 datë 9/2/ 2011 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”,	AKSHE	I pjesshëm	09.02.2011	24.02.2011
Regullore e Deleguar e Komisionit 2015/2420 e datës 12 Tetor 2015.	VKM nr.703, datë 12.10.2016 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”.	AKSHE	I plotë	12.10.2016	20.10.2016

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017– 2020

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Hartimi i dokumenti strategjik	MPJ ne bashkepunim me	2018	Tremujori i III	Tremujori i IV

"Ndihma per politikat e zhvillimit dhe ndihmes humanitare"	MZHETTS			

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017– 2020

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet	Status i përkthim-it në Anglisht	Institucion Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje I pjesshëm)	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Rregullorja e BE Nr. 428/2009 e amenduar	jo	Ndryshime në ligjin, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë" nr. 9707, datë 5.4.2007	jo	AKSHE	I plotë	Tre mujori i tretë 2017	Tre mujori i katërt i 2017
AFAT MESËM (2018– 2019)							

V.Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitull 30 : Marredheniet me Jashte					
Përfituesi: Ministria e Mbrojtjes					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**

	buxheti i shtetit				
	Totali për aktivitet				**137,400.1**
Ndryshime në ligjin, nr. 9707, datë 5.4.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrav eushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë"	A) Pagat – stafi ekzistues		274,775.6		
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet				**274,775.6**
	Buxheti total i kapitullit	**412,175.7**			

KAPITULLI 31: POLITIKAT E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Shqipëria vazhdon njehsimin e saj me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acquis) në fushën e Politikës së Jashtme, të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Shqipëria mbështet fuqishëm politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, e cila ka për qëllim forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si entitet politik me ndikim gjithnjë e në rritje në politikën ndërkombëtare.

Samiti i Selanikut në qershor 2003 konfirmoi perspektivën e qartë evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor. Shqipëria që prej janarit 2004, i është bashkuar rregullisht qëndrimeve të përbashkëta të Bashkimit Evropian në fushën e PJSM. Për më tepër, Shqipëria ka kontribuar dhe kontribuon në misionet ushtarake të Bashkimit Evropian të ndërmarra në kuadër të PJSM.

Shqipëria, zhvillon një dialog politik të ngushtë me institucionet e Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare të tij. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) në datën 1 Prill 2009, dialogu politik institucional me Bashkimin Evropian zhvillohet në kuadër të takimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, të Komitetit dhe gjashtë Nënkomiteteve të Stabilizim Asociimit, si dhe në kuadër të Komitetit ndër-parlamentar midis Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Shqipëria ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2009 dhe iu dha statusi kandidat në qershor të vitit 2014. Me këtë rast, Këshilli konfirmoi pesë prioritetet që duhet të përmbushë Shqipëria për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Dialogu politik zhvillohet intensivisht në disa nivele ndërmjet institucioneve shqiptare edhe atyre të Bashkimit Evropian për përmbushjen e kritereve të përcaktuara për të ndërmarrë këtë hap, veçanërisht në kuadrin e Dialogut të Nivelit të Lartë për Pesë Prioritet Kyçe dhe të pesë grupeve të përbashkëta të punës për pesë prioritetet kyçe.

Komisioni Evropian në Paketën e Zgjerimit të vitit 2016 për Shqipërinë, krahas njohjes së progresit të qëndrueshëm të bërë për përmbushjen e pesë prioriteteve kyçe, rekomandon hapjen e negociatave të anëtarësimit në varësi të arritjes së rezultateve të pritshme në reformën në drejtësi, dhe specifikisht në ligjin e vettingut.

Ecuria e integrimit evropian të Shqipërisë diskutohet gjithashtu edhe në nivel dypalësh me vendet anëtare të Bashkimit Evropian me rastin e vizitave të nivelit të lartë.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka vazhduar të angazhohet në një dialog të rregullt politik me Bashkimin Evropian për çështjet e politikës së jashtme të sigurisë. Sa i përket PPJS (CFSP), Shqipëria i është bashkuar të gjitha qëndrimeve të Bashkimit Evropian dhe vendimeve të Këshillit, kur i është kërkuar në nivelin 100 %. Ky fakt është konfirmuar edhe nga raporti i vitit 2016 të KE-së për Shqipërinë. Shqipëria i është bashkuar gjithashtu edhe qëndrimeve të BE në OKB, dhe ka bashkë-sponsorizuar rezolutat e Bashkimit Evropian. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në operacionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Shqipëria beson thellësisht në vlerat evropiane të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në themel të vizionit të politikës së jashtme të Shqipërisë qëndron ndërtimi i marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe të karakterizuara nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Në zbatim të këtij orientimi themelor të politikës së jashtme, Shqipëria ka adoptuar gjithnjë e më shumë një rol të dukshëm aktiv në favor të paqes dhe stabilitetit në rajon, e më gjerë.

Republika e Shqipërisë konsideron se bashkëpunimi rajonal dhe pronësia rajonale janë jo vetëm parakushte të integrimit evropian, por edhe domosdoshmëri e kohës për të transformuar përfundimisht imazhin e rajonit tonë. Ky orientim i politikës sonë të jashtme reflektohet në pjesëmarrjen tonë proaktive në të gjitha nismat dhe organizatat shumëpalëshe që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë. Në Shqipëri do të vendoset Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF), një nismë e mbështetur nga Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit.

Selia e Fondit do të jetë në Tiranë dhe Drejtor Ekzekutiv i tij është emëruar një diplomat shqiptar. Si vendi pritës i kësaj nisme, Republika e Shqipërisë ka mundësuar bërjen funksionale të zyrave.

Në partneritet të ngushtë me vendet e Grupit të Vishegradit (V4), MPJ e Shqipërisë po drejton procesin për arritjen e konsensusit në lidhje me dokumentet kryesore të krijimit të Fondit, me objektivin për të hapur rrugën për aktivitetet praktike të Fondit, duke filluar nga fillimi i vitit të ardhshëm.

Shqipëria iu bashkua nismës Bashkëpunimi i Përforcuar në Kuadër të Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit (Enhanced Cooperation within the Stabilization and Association Process / ECSAP), e cila do t'i ofrojë mbështetje politike procesit të bashkëpunimit rajonal në kontekstin e Procesit të Stabilizim Asociimit, duke u përqëndruar në fushat e sundimit të ligjit, qeverisjes ekonomike dhe ndërlidhjes.

Shqipëria është mbështetëse e përkushtuar e Procesit të Berlinit dhe ka një angazhim të plotë në këtë nismë, si në dimensionin politik të rigjallërimit të procesit të zgjerimit, edhe për agjendën e ndërlidhjes. Në mars 2016, Shqipëria organizoi takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku vendet e rajonit shqyrtuan stadin e reformave të projekteve të ndërlidhjes dhe zbatimin e masave të buta në transport dhe energji, të identifikuara nga Konferenca e Vjenës para Samitit të Parisit. Në takim u propozua gjithashtu një agjendë bashkëpunimi gjithëpërfshirëse për krizën migratore, duke vendosur theksin në forcimin e mëtejshëm të partneritetit BE – Ballkani Perëndimor për migracionin. Gjithashtu filloi puna për ngritjen e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Qendrës së Bashkëpunimit Rinor (RYCO), të cilat do të kenë selitë përkatëse në Tiranë. Këto çështje u ndoqën dhe u avancuan më tej në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Paris, më 4 korrik 2016. Samiti i ardhshëm i "Procesit të Berlinit" do të organizohet nga Italia në vitin 2017.

Përmirësimi i perspektives së brezave të rinj ka një rëndësi të jashtëzakonshme në sigurimin e qëndrueshmërisë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përparimit. Për të përmirësuar një bashkëpunim rajonal të qëndrueshëm në radhët e të rinjve, si dhe për të krijuar marrëdhënie të reja midis të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim me Rininë (RYCO) të Vendeve të Ballkanit Perëndimor me asistencën e Zyrës Franko-Gjermane për Rininë. Dokumenti themelues është nënshkruar nga Kryeministrat në kuadrin e Samitit të Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Paris, më datën 4 korrik 2016. Selia e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim me Rininë do të jetë në Tiranë.

RYCO do të ketë për qëllim:

- Nxitjen e vlerave demokratike dhe diversitetit;
- Përmirësimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm rajonal midis të rinjve dhe krijimin e marrëdhënieve të reja në radhët e të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- Nxitjen e pajtimit dhe qasjeve konstruktive ndaj kujtesës;
- Nxënien ndërkulturore;
- Rritjen e lëvizshmërisë rajonale, qytetarisë aktive, dhe pjesëmarrjes së të rinjve;
- Promovimin e frymës evropiane të bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe tolerancës.

Në nivelin ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë i kushton vëmendje të veçantë pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimit të saj në organizatat ndërkombëtare, me të cilat ajo ndan vlera të përbashkëta.

Shqipëria do të vazhdojë të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin në planin kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, me qëllim që të zvogëlojë në maksimum rrezikun ndaj terrorizmit që lidhet me vendin dhe interesat tona, duke siguruar përmirësimin e elementeve të sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve dhe fenomeneve terroriste.

I.3 Struktura e kapitullit

1. DIALOGU POLITIK
2. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE
3. KONTROLLI I ARMËVE
4. ZBATIMI I MASAVE KUFIZUESE DHE SANKSIONEVE EKONOMIKE
5. LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT
6. POLITIKA EUROPIANE E SIGURISË DHE MBROJTJES
7. SISTEMI I VIZAVE

II. Situata aktuale

Shqipëria vijon të kontribuojë në 2 (dy) misione/operacione të drejtuara nga BE, përkatësisht në operacionin e "Althea" në Bosnje- Hercegovinë, ka vijuar kontributin me 1 (një) ushtarak në funksionin “Këshilltar për Trajnimin e Shtabeve dhe Përfaqësues i Lartë Ushtarak i palës shqiptare” dhe në misionin trajnues “EUTM Mali” ku që nga muaji nëntor 2016, po merr pjesë me 4 (katër) ushtarakë si pjesë e grupit EOD (Explosive Ordinance Disposal), në mbështetje të Kompanisë së Ruajtjes së Bazës në Koulikoro, në Republikën e Malit, në Afrikë. Në vitin 2015, Ministria e Mbrojtjes mbylli me sukses sfidën madhore për asgjësimin e municioneve të tepërta jashtë nevojave të Forcave të Armatosura.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për përmbylljen e një regjistri kombëtar të armëve dhe municioneve nën menaxhimin e Policisë së Shtetit.

Shqipëria nuk e ka miratuar Ligjin për Masat Kufizuese që do të ofrojë procedurën e unifikuar për zbatimin e masave kufizuese si ndaj vendeve të treta ashtu edhe ndaj aktorëve jo-shtetërorë. Baza ligjore për zbatimin e masave kufizuese të vëna nga BE dhe OKB mund të gjenden në Kushtetutën e Shqipërisë.

Megjithatë, masat kufizuese financiare në fjalë janë të rregulluara në detaje në Ligjin nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit" i cili parashikon përkufizimin bazë të fondeve, pasurive dhe pronave të tjera që janë objekt i masave të synuara financiare kufizuese.

Konkretisht objekt i këtij ligji janë persona të shpallur, ku përfshihet çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, person fizik apo juridik, i çdo lloj forme apo emërtimi të regjistruar ose jo:

a) i cili është cilësuar dhe përfshirë në listë si terrorist apo person që financon terrorizmin, me vendim të Këshillit të Ministrave, në mbështetje të rezolutave 1267 (1999) dhe 1988 (2011) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të akteve përkatëse të organizatave ndërkombëtare ose të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
b) i cili është shpallur i tillë me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, rezolutave të tjera të nxjerra në zbatim të saj ose rezolutave të tjera të ngjashme, që lidhen me luftën kundër financimit të terrorizmit, në përputhje me procedurat e brendshme të parashikuara në këtë ligj.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masave të synuara financiare kufizuese është Ministria e Financave, e cila merr vendimin për një bllokim të përkohshëm, sekuestrim apo ngrirje të fondeve dhe të pasurive të tjera financiare.

Përveç kësaj, ligji parashikon që Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP), të jetë autoriteti përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe shkëmbimin e të dhënave për zbatimin e masave kundër terrorizmit. Struktura organizative dhe funksionet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave janë dhënë në kuadër të Ligjit 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit" dhe Ligjit 9917 datë 19.05.2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", i ndryshuar. Në bazë të këtij ligji, DPPPP i raporton drejtpërdrejtë Ministrit të Financave dhe shërben si Njësi e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë.

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar mbi informacionin e klasifikuar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh prej nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Përsa i përket Armëve të Shkatërrimit në Masë, strategjia e BE nënvizon rëndësinë e të vepruarit në mënyrë që të zgjidhen, parandalohen, frenohen, ndalohen dhe të eliminohen programet për shtimin e këtyre armëve dhe raketave. BE është e angazhuar në sistemin e traktateve

shumëpalëshe, të cilat ofrojnë bazat ligjore dhe normative për të gjitha përpjekjet për mos shtimin e këtyre armëve. Politika e BE është e angazhuar në zbatimin dhe universalizimin e normave ekzistuese të çarmatimit dhe të mospërhapjes. Për këtë qëllim, ne do të angazhohemi në universalizimin e Traktatit për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë (NPT), të marrëveshjeve të Sigurisë së Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA) dhe protokollet shtesë të tyre, Konventa e Armëve Kimike (CWC), Konventa e Armëve Biologjike dhe Toksine (BTWC), Kodi i Sjelljes së Hagës (HCoC), dhe hyrjes së menjëhershme në fuqi të Traktatit për Ndalimin e Gjithanshëm të Testeve Bërthamore (CTBT). Politikat e BE-s kërkojnë që të përparohet në luftën kundër armëve biologjike dhe kimike të deklaruara universalisht të jashtëligjshme në përputhje me ligjet e detyrueshme ndërkombëtare. Politikat e BE-s zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare në ndalimin e materialeve të zbërthyeshme të armëve bërthamore ose të pajisjeve të tjera bërthamore. BE do të asistojë vendet e treta në përmbushjen e detyrimeve të tyre të bazuara në konventat dhe regjimet shumëpalëshe.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Shih më poshtë.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) është institucioni udhëheqës për GNP të Kapitullit 31. Institucione të tjera të përfshira, janë:

- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Këshilli i Ministrave;
- INSTAT.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë është Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Shpërndarja financiare sipas buxhetit të shtetit

	2014	2015	2016	2017
Shpenzimet totale				

Buxheti i Shtetit	2350	2296	2216.2	2216.2
Asistencë e Huaj				

III. Prioritetet

Objektivi është që të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e acquis në fushën e politikës së përbashkët të jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes në të ardhmen e afërt. Prioritetet e Shqipërisë janë të lidhura me politikat e BE-së në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.

Shqipëria vijon njehsimin e saj me acquis në këtë drejtim. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përmbylljen e regjistrit elektronik të armëve dhe municioneve nën menaxhimin e Policisë së Shtetit. Në tërësi, përgatitjet në fushën e Politikës së Jashtme të Sigurisë dhe Mbrojtjes janë në rrugën e duhur.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2016 – 2018

IV.1 Dialogu politik

Integrimi Evropian i Shqipërisë është konsideruar si një objektiv strategjik dhe një garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit dhe më gjerë. Në këtë kontekst, Shqipëria është e gatshme të ndërmarrë të gjitha reformat e nevojshme përsa i përket procesit të Integrimit Evropian, me qëllim hapjen e negociatave për anëtarësim.

Shqipëria zhvillon një dialog politik intensiv me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të saj. Ky dialog zhvillohet në vazhdimësi në kuadrin e Këshillit të Stabilizim Asociimit dhe të strukturave të tjera të përbashkëta nën Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA).

IV.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Organizatat Rajonale

Organizata rajonale	Data e pranimit
SEECP Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore	1996
RCC Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal	27 Shkurt 2008
CEI Nisma e Evropës Qendrore	1996
BEDZ/BSEC Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi	25 Qershor 1992
NAJ Nisma Adriatiko-Joniane	20 Maj 2000
MARRI Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët	2003
RACVIAC Qendra Rajonale për Verifikimin e Kontrollit të Armëve	20 Shtator2000
SHBA Karta e Adriatikut (A-5)	2 Maj 2003
FBP Fondi për Ballkanin Perëndimor (me seli në Tiranë)	13 Nëntor 2015
Task Forca Mjekësore e Ballkanit (BMTF)	Nëntor 2011
Iniciativa Adriatiku dhe Joniane (ADRION)	20 maj 2000
Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Jug-Lindore (SEDM)	1996

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare

Organizatë Ndërkombëtare	Data e pranimit
OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara	14 Dhjetor 1955
OSBE	20 Qershor 1991
Këshilli i Evropës	13 Korrik 1995
IAEA Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike	29 Korrik 1957
CTBTO - Organizata e Traktatit për Ndalimin Gjithëpërfshirës të Provave Bërthamore	1996
IOF - Organizatën Ndërkombëtare e Frankofonisë	1999
UNAOC - Aleanca e Qytetërimeve e Kombeve të Bashkuara	2005
UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën	1958
IACA – Akademia Ndërkombëtare Antikorrupsion	21 Shtator 2011
Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut NATO	4 prill 2009

IV.3 Kontrolli i armëve

Shkatërrimi i municioneve të tepërta

Në vitin 2015, Ministria e Mbrojtjes mbylli me sukses sfidën madhore për asgjësimin e municioneve të tepërta jashtë nevojave të Forcave të Armatosura, e cila përbën një arritje të rëndësishme për ruajtjen e sigurisë kombëtare dhe sigurimin e stabilitetit rajonal.

Në zbatim të Direktivës së Mbrojtjes 2016 dhe "Planit të veprimit për asgjësim, tjetërsim municionesh të dala tepër pas rishikimit të TOP (Tabela e Organizimit dhe Pajisjeve) të Forcave të Armatosura", miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 625, datë 16.04.2016, Forcat e Armatosura kanë vijuar planin e veprimit për demontimin/tjetërsimin e sasive të reja të municioneve të tepërta dhe jashtë nevojave dhe për trajtimin/eliminimin e materialeve të tepërta të evidentuara gjatë vitit 2016, duke synuar mbylljen e këtij procesi brenda vitit. Gjithashtu ka vijuar edhe procesi i tjetërsimit përmes shitjes së municioneve. Këto procese përbëjnë procedura të zakonshme, të cilat kryhen në bazë periodike vjetore sa herë që evidentohen pajisje të tepërta në inventarizimin vjetor të municioneve.

Programi i Pastrimit të Hotspoteve me Municione të Paplasura (UXO)

Për periudhën janar – shtator 2016 është pastruar një zonë prej 463,441 m². Toka e pastruar në këto hotspote është çertifikuar si e pastër nga municionet dhe i është dorëzuar autoriteteve lokale për përdorim të mëtejshëm. Plani deri në fund të vitit 2016 është për të vijuar pastrimin në hotspotet e evidentuara të një zonë prej 256,354 m². Për vitet 2017 – 2018 është planifikuar pastrimi i një hotspot-i në Jubë – Sukth – Durrës nga organizata ndërkombëtare e pastrimit Norwegian People's Aid (NPA) si dhe një hotspot në Suç, Burrel nga Kompania EOD (Explosive Ordinace Disposal) e FA të RSH-së, në një zonë prej 1,335,064 m².

Për periudhën deri në shtator 2016, ekipi EOD i FA të RSH-së në bashkëpunim me zyrën e AMMCO ka kryer inspektimin dhe çertifikimin e katër ish depove ushtarake të municioneve.

Gjatë periudhës shtator – dhjetor 2016, është planifikuar kryerja e aktiviteteve të mëposhtme:

- Kontrolli për zbatimin e masave të sigurisë dhe kontrollin e cilësisë së pastrimit gjatë operacioneve të pastrimit të kryera nga kompania NPA dhe kompania EOD;

- Kryerja e takimeve periodike për informimin e autoriteteve vendore lidhur me aktivitet e pastrimit si dhe për të siguruar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre;
- Hartimi dhe shpërndarja e materialeve të ndryshme ndërgjegjësuese;
- Organizimi i vizitave me donatorë të interesuar për njohjen me aktivitetet e pastrimit;
- Kryerja e vlerësimeve teknike të ish-poligoneve të asgjësimit të SHPFARSH;
- Inspektimi dhe çertifikimi i ish-depove ushtarake.

Në bazë të planit të Komandës Mbështetëse për vitin 2017 është planifikuar të vijojë puna për reduktimin, pastrimin, kontrollin dhe certifikimin e disa grup-depove të planifikuara.

VKM nr. 256, datë 6.03.2016 miratoi "Memorandumin e Bashkëpunimit (MoU) midis UNDP dhe Ministrisë së Mbrojtjes në mbështetje të aktiviteteve të kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta dhe të sigurisë fizike dhe menaxhimit të stoqeve të municioneve në Shqipëri". Aktivitetet e planifikuara në këtë MoU janë financuar nga projekti "EUSAC" (përmes vendimit të Këshillit Evropian 2013/730/CFSP), i cili mbështet aktivitet e çmilitarizimit dhe kontrollit të armëve në Europën Juglindore. Aktivitetet konkrete të planifikuara në Shqipëri përfshijnë:

- Përmirësimin e sigurisë së armatimeve/ municioneve/ infrastrukturës së magazinimit të armatimeve;
- Shkatërrimin e 4,500 armëve të vogla e të lehta të kategorizuara si të tepërta;
- Organizimin e dy trajnimeve rajonale për Sigurinë Fizike dhe Menaxhimin e Stoqeve.

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të BE-së të 9 dhjetorit 2013, dhe të Strategjisë së BE-së për Luftën ndaj grumbullimit të paligjshëm, kursimit dhe trafikut të paligjshëm të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) si edhe të fishekëve, Ministria e Punëve të Jashtme Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNDP dhe SEESAC ngritën grupin e punës për Komitetin Ndër-Ministror për Armët e Vogla dhe të Lehta (SALW) në Republikën e Shqipërisë. Detyra kryesore është hartimi i Dokumentit Strategjik të AVL dhe Planit respektiv të Veprimit. Ky komitet do të shërbejë si organ koordinimi institucional përgjegjës për politikat e zhvillimit, kërkimit, koordinimit, zbatimit dhe të monitorimit të përpjekjeve për parandalimin, luftën dhe eliminimin e posedimit dhe tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta, dhe trajtimin në nivel kombëtar të problemeve, pasojave dhe çështjeve të lidhura me të gjitha aspektet e AVL.

Aktualisht, ne kemi ngritur një grup pune në nivelin kombëtar, e cila do të fillojë hartimin e draftit të parë të kësaj strategjie.

Policia e Shtetit Shqiptar ka krijuar në vitin 2015, regjistrin kombëtar elektronik për regjistrimin e të dhënave të të gjitha armëve të vogla dhe të lehta në vend. Me mbështetjen e UNDP/ SEESAC, bazuar në Vendimin e Këshillit të BE-së 2013/730 / CFSP, Policia e Shtetit Shqiptar ka instaluar këtë vit pajisjet informatike, ku përfshihen 110 kompjuterë, 110 UPSs, 60 printera, 15 skaner, një server, dhe gjashtë porta interneti në qarqet dhe drejtoritë e policisë në të gjithë vendin. Përveç kësaj, personeli i policisë është trajnuar, në përputhje me rrethanat e reja, për përdorimin e të dhënave të regjistrit të armëve. Regjistri elektronik do të përmirësojë kapacitetet kombëtare në mënyrë efektive dhe efikase përsa i përket kontrollit të posedimit të të dhënave të sakta të armëve të vogla dhe armëve të lehta në vend. Përveç kësaj, krijimi i regjistrit elektronik do të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe ekspertizën e rajonit të Evropës Juglindore, për të luftuar trafikimin e paligjshëm, zotërimin e armëve të zjarrit, njëkohesisht reduktimin e kërcënimit të paqes, stabilitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Githashtu Drejtoria e Policisë së Shtetit ka përgatitur një plan për pajisjen me "Autorizim mbajtje arme" dhe po bën përpjekje për realizimin dhe pajisjen e të gjithë shtetasve që posedojnë armë. Prodhimi i këtyre kartave elektronike do të konsistojë në marrjen e të dhënave nga regjistri elektronik i regjistrimit të armatimit. Nga ana tjetër personalizimi i kartave për autorizimin e mbajtjes së armëve do të përfshijë një sërë elementësh sigurie si: chip me ose pa kontakt, hologram, vijëzime sigurie, shkrime mikrotekst, laminime me folje dhe elemente sigurie, të dhëna identifikuese nga regjistri elektronik i armatimit etj. Ky projekt do të mundësojë kontrollin e armëve të lehta dhe të brezit në të gjithë territorin e vendit.

Përsa i përket VKM-ve, në vijim të ligjit "Për armët" janë nxjerrë 6 VKM, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë një kuadër të plotë për administrimin e armëve të lehta dhe të brezit në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Në fushën e kontrollit të eksporteve të materialeve dhe armatimeve ushtarake, Autoriteti Kombëtar Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve (AKSHE) brenda Ministrisë së Mbrojtjes ka përditësuar listën ushtarake, në përputhje me Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së (*CFSP* 2015/C129/01).

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia e Sigurisë Kombëtare	Ministria e Mbrojtjes	2014 – vijimësi
Strategjia Ushtarake	Ministria e Mbrojtjes	2015 – vijimësi
Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA 2016-2025	Ministria e Mbrojtjes	2016 – 2025

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	2013 – 2020
Direktiva e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	vjetore

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1334/2000	Ligji "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i ndryshuar. nr. 9707, datë 05.04.2007	Ministria e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve)	I pjesshëm	24.04.2007	09.05.2007
Lista e përbashkët ushtarake e Bashkimit Evropian (2010/C 69/03)	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve" nr. 106, datë 09.02.2011	Ministria e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve)	I plotë	09.02.2011	24.02.2011
Direktivë (91/477/KEE)	Ligji nr. 74/2014 "Mbi armët"	Ministria e Punëve të Brendshme	I pjesshëm	10.7.2014	27.08.2014
CFSP 2015/C129/01 Mbi Listën e Përbashkët Ushtarake	Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe listës së mallrave e	Ministria e Mbrojtjes (Autoriteti Shtetëror i Kontrollit të Eksporteve)	I plotë	12.10.2016	20.10.2016

	teknologjive , me përdorimin e dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksportit" Nr. 703, datë 20.10.2016				

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2020

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Nuk aplikohet	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
AFAT MESËM (2018 – 2019)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.4 Zbatimi i masave kufizuese dhe sanksioneve ekonomike

Në këtë kontekst, ministritë përkatëse të linjës kanë zbatuar vendimet PPJS, sidomos në lidhje me masat kufizuese për personat dhe entitetet përgjegjëse për ngjarjet në Ukrainën Lindore. Shqipëria do të vazhdojë angazhimet e saj për një dialog politik të rregullt me BE-në për çështjet e PPJS, duke synuar 100% përputhshmëri me vendimet në kuadër të PPJS.

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar
Nuk aplikohet	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1167/2008	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 106, datë 9.02.2011 "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve"	Ministria e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve)	I plotë	9.02.2011	24.02.2011
	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 43, datë 16.01.2008:"Për organizimin, funksionimin dhe statusin e autoritetit të kontrollit shtetëror të eksporteve"	Ministria e Mbrojtjes (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve)	I pjesshëm	30.01.2008	30.01.2008
	Ligji nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	10.10.2013	13.11.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Nuk aplikohet	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.5 Lufta kundër terrorizmit

Shqipëria jep kontributin e saj proaktiv në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit global dhe qëndron në mënyrë të vendosur në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj terroristë. Shqipëria i është bashkuar në vitin 2014 Aleancës Globale kundër ISIL dhe ka mbështetur aleatët dhe partnerët që nga fillimi i luftës së përbashkët kundër terrorizmit ndërkombëtar. Si pjesë e përpjekjeve të këtij koalicioni në luftën kundër terrorizmit, Shqipëria renditet ndër vendet me kontribute konkrete.

Në përpjekjet e saj për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë, Shqipëria ka ndërmarrë hapa konkrete të reflektuara në legjislacionin kombëtar, që synojnë forcimin e aftësisë së adresimit të problemit të luftëtarëve të huaj terroristë, duke e konsideruar të paligjshme dhe të ndëshkueshme pjesëmarrjen, organizmin apo çdo nxitje për pjesëmarrje në veprime ushtarake të një vendi të huaj. Në plotësim të kërkesave të Rezolutës 2178 (2014) të KS të OKB, janë kryer ndryshime në kuadrin ligjor dhe janë marrë masa konkrete që kriminalizojnë rekrutimin e luftëtarëve të huaj terroristë.

Masa të tilla të ndërmarra në luftën kundër terrorizmit janë paraprire nga krijimi i strukturave të specializuara dhe kapaciteteve njerëzore me logjistikën përkatëse.

Objektivi ynë ka qenë i qartë, shkatërrimi i ISIL / Daesh dhe luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm bazuar në programe e strategji gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Shqipëria ka miratuar në korrik 2014 Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, dhe në nëntor 2015, Parlamenti Shqiptar miratoi Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2012-2016.

Kjo Strategji përfshin politika të rehabilitimit dhe të riintegrimit, përmes paketave sociale, politike, ligjore, programeve arsimore e ekonomike, si dhe zhvillimit dhe promovimit të tolerancës kulturore e fetare dhe angazhimit të shoqërisë civile.

Të vendosur për të arritur rezultate të prekshme dhe për të treguar progres real, janë marrë masa për rishikimin, forcimin dhe ndryshimin e mekanizmave aktualë të kontrollit të financimit të terrorizmit dhe ngrirjes së aseteve për individë dhe subjekte të përfshirë në aktivitete terroriste.

Shqipëria synon që përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në iniciativat rajonale, të japë një kontribut proaktiv për paqen dhe stabilitetin dhe të qëndrojë vendosmërisht në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Një hap konkret në rrafsh kombëtar dhe rajonal, në forcimin e përpjekjeve për luftën ndaj radikalizmit dhe dhunës ekstreme, ishte bashke-organizimi nga Shqiperia i Konferencës Koordinuese të Këshillit te Bashkëpunimit Rajonal për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm (CVE) , me datë 11 nëntor 2016, në Tiranë. Ky takim prodhoi disa rekomandime praktike në fushën e sigurisë për vitin 2017, që do t'i shërbejnë bashkëpunimit rajonal në të ardhmen.
Të gjitha rekomandimet do të jenë subjekt shqyrtimi nga insitucionet ligjzbatuese (hetimet e përbashkëta, vënia e filtrave për ndalimin e përmbajtjeve radikalizuese në internet, bashkëpunimi për programet e rehabilitimi në burgje, zgjerimi i skemave të përfshirjes sociale për FtF e kthyer, etj) dhe do të përfshihen në agjendën e RCC-së në takimet e ardhshme.

Shqipëria respekton, zbaton dhe i bashkohet listave të publikuara nga Këshilli i Sigurimit, që lidhen me individë dhe organizata që financojnë terrorizmin. Në këtë kuadër, janë miratuar masa konkrete ligjore kundër personave dhe organizatave të përfshira në këto lista.
Në periudhën 2015-2016 Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka miratuar një numër vendimesh si më poshtë:

- VKM Nr. 31, datë 21.01.2015
- VKM Nr. 124, datë 11.02.2015
- VKM Nr. 162, datë 25.02.2015
- VKM Nr. 273, datë 01.04.2015
- VKM Nr. 311, datë 15.04.2015
- VKM Nr. 351, datë 29.04.2015
- VKM Nr. 431, datë 20.05.2015
- VKM Nr. 488, datë 10.06.2015

- VKM Nr. 721, datë 02.09.2015
- VKM Nr. 852, datë 21.10.2015
- VKM Nr. 931, datë 18.11.2015
- VKM Nr. 951, datë 25.11.2015
- VKM Nr. 985, datë 09.12.2015
- VKM Nr. 1087, datë 28.12.2015
- VKM Nr. 20, datë 20.1.2016
- VKM Nr. 51, datë 27.1.2016
- VKM Nr. 201, datë 16.3.2016
- VKM Nr. 256, datë 6.4.2016
- VKM Nr. 331, datë 4.5.2016
- VKM Nr. 479, datë 29.6.2016
- VKM Nr. 512, datë 13.7.2016
- VKM Nr. 537, datë 27.7.2016
- VKM Nr. 689, datë 5.10.2016
- VKM Nr. 593, datë 31.08.2016
- VKM Nr. 744, datë 26.10.2016
- VKM Nr. 769, datë 02.11.2016

Këto masa kanë luajtur një rol pozitiv, me impakt të madh në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ministria e Punëve të Jashtme vlerëson nevojën e rishikimit dhe hartimit të një ligji mbi zbatimin e të gjithë sanksioneve ndërkombëtare, përveç sanksioneve që lidhen me Rezolutat 1267, 1988 dhe 1373 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që rregullohen me Ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet fakti se progresi i bërë nga Shqipëria në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT), është njohur nga Task Forca e Veprimeve Financiare (FATF), e cila në takimet plenare, më 25 deri 27 shkurt 2015, uroi dhe përshëndeti progresin e rëndësishëm të Shqipërisë dhe ka përsëritur se Shqipëria ka adresuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe rregullator, duke përmbushur kështu angazhimet e saj.

Një vlerësim i tillë dhe masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare çuan në një vlerësim pozitiv të Konventës Kuadër MONEYVAL të Këshillit të Evropës, e cila më 18 shtator 2015 arriti në përfundimin se Shqipëria nuk është më subjekt i procesit vjetor të monitorimit. (Vazhdimësi e rregullt).

Shqipëria synon që vetëm përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në iniciativat rajonale, të japë një kontribut proaktiv për paqen dhe stabilitetin dhe të qëndrojë vendosmërisht në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Qeveria shqiptare po përgatit, përmes një programi pilot, futjen në programet mësimore të këtij viti akademik, kurrikulën mësimore me titull "Sekularizmi dhe Kultura e Besimeve”. Mësimdhënia e ‘Kulturës së Fesë’ në institucionet arsimore është një përpjekje konkrete për të mbrojtur shoqërinë tonë dhe për të ruajtur kohezionin tonë social, por edhe për të bërë dallimin e qartë midis radikalizmit dhe ekstremizmit që nuk ka asnjë lidhje me besimin fetar.

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Nuk aplikohet	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendimi I Këshillit 2002/475/DCB	Kodi Penal, i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar.	Ministria e Punëve të Brendshme	I pjesshëm	27.01.1995	01.06.1995

Shih më tej Kapitullin 24 të Planit Kombëtar

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.6 Politika evropiane e sigurisë dhe mbrojtjes

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në menaxhimin e krizave dhe operacioneve ushtarake civile, nën Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (CSDP).

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në misionin Althea të EUFOR në Bosnje-Hercegovinë (me një anëtar të shtabit të përgjithshëm).

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 722 më 02.09.2015 për dërgimin e personelit të Forcave të Armatosura të RSH-së në operacionin ushtarak të BE-së, me mision trajnues (EUTM Mali), si pjesë e grupit EOD, në mbështetje të Kompanisë së Ruajtjes së Bazës në Koulikoro, në Republikën e Malit, në Afrikë. Misioni i trupave EOD ka filluar në muajin nëntor 2015 dhe po vijon me pjesëmarrjen e trupave në mision me rotacionin e III-të 6-mujor.

Në muajin dhjetor 2015, Ministri i Mbrojtjes miratoi vijimin e kontributit të Forcave të Armatosura të RSH-së në këtë mision deri më 1 qershor 2017. Forcat e Armatosura të RSH-së po marrin pjesë në mision me 4 (katër) trupa EOD që prej muajit nëntor 2016, si pjesë e rotacionin e III-të 6-mujor.

DSIK është duke punuar për një ligj të ri "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror', NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare". Ky ligj do të shfuqizojë ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", i ndryshuar.

Qëllimi i kësaj iniciative legjislative është përafrimi i plotë i kuadrit ligjor për informacionin e klasifikuar me Vendimin e Këshillit të BE-së 2013/488/EU, "Për rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit të klasifikuar të BE-së", i ndryshuar.

Në fushën e informacionit të klasifikuar janë rishikuar këto Vendime të Këshillit të Ministrave:

- VKM nr. 189, datë 04.03.2015, "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror', NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare";
- VKM nr. 188, datë 04.03.2015 "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit";
- VKM nr. 190, datë 04.03.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 81, datë 28.01.2008, për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'";
- VKM nr. 836, datë 14.10.2015, "Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së".

Si çështje sigurie, Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (BE) për shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të Informacionit të Klasifikuar, është nënshkruar në Tiranë më 3 Mars 2016.
Në kuadër të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe BE-së në fushën e sigurisë, Ministri i Punëve të Jashtme, Z. Ditmir Bushati dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë, Znj. Frederica Mogherini nënshkruan me datë 3 Mars 2016 në ambientin e Kryeministrisë, "Marrëveshjen midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi procedurat e sigurisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar". Raundi i parë i negociatave u zhvillua në Bruksel në zyrat e EEAS (External European Action Services) midis përfaqësueseve të Strukturave të Sigurisë në BE dhe delegacionit të DSIK-së. Raundi i dytë u zhvillua në Tiranë më 15.5.2015, në zyrat e përfaqësisë së BE-së në Shqipëri.

Ky ligj hyri në fuqi më 1 shtator 2016.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane "Mbi mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar", ratifikuar me ligjin nr. 28/ 2015, datë 26.03.2015.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Spanjës "Mbi shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar", ratifikuar me ligjin nr. 59/2015, datë 11.06.2015.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë "Mbi shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar", ratifikuar me ligjin nr. 34/2015, datë 02.04.2015.

Në vitin 2012, në kuadër të Iniciativës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes DECI, vendet anëtare dhe Shqipëria, ranë dakord për mundësinë e mbështetjes në të ardhmen të Bashkimit Evropian me një "Battle Group" dhe theksuan nevojën për të rritur numrin e trajnimeve të përbashkëta duke nënvizuar interesin reciprok për të shkëmbyer kapacitetet e Forcave të Armatosura respektive dhe theksuar mundësinë për të vazhduar favorizimin e projekteve të sigurisë dhe zhvillimit rajonal. Në vitin 2016, Shqipëria u bë zyrtarisht pjesë e Iniciativës së DECI duke iu bashkuar familjes së vendeve anëtare në DECI.

Angazhimet e marra në kuadër të Iniciativës DECI janë përforcuar edhe me partneritetin NATO - BE, ku në vitin 2015 u nënshkrua Letra e Qëllimit në kuadër të "Framework Nations Concept - FNC". Ky partneritet, në të cilën marrin pjesë vendet anëtare të Iniciativës DECI, ndër të tjera, ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit për identifikimin e një shporte asetesh dhe kapacitetesh me qëllim atashimin e mundshëm në rotacione të ardhshme në kuadër të Forcës së Reagimit Shumë të Shpejtë të NATO-s dhe të "EU Battle Groups".

Këto përbëjnë iniciativa konkrete dhe serioze në kontekstin e angazhimit tonë dhe pjesëmarrjen në strukturat e sigurisë dhe të mbrojtjes, e cila kontribuon në forcimin e stabilitetit ndërkombëtar dhe rajonal.

Shqipëria për më tepër, është e angazhuar të bashkëpunojë me organizata të tjera ndërkombëtare (OKB, NATO, OSBE, Këshilli i Europës, etj).

Në mars 2015, vendi ynë ka dërguar dy vëzhgues, si pjesë e OSBE-së për të monitoruar zgjedhjet parlamentare në Taxhikistan. Aktualisht, në kuadër të OSBE-së, Shqipëria vazhdon të kontribuojë me katër vëzhgues në Ukrainë: Tre vëzhgues në MPM / EMS (Mision i Posaçëm Monitorimi / Mision i Posaçëm Monitorimi) dhe një vëzhgues në Misionin Monitorues. Shqipëria gjithashtu i është përgjigjur pozitivisht thirrjes për të kontribuar me personel ushtarak në qendrën e trajnimit "Ekipi Partner i Ndërtimi të Kapaciteteve (BPC-T) & Këshillimit & të Ndihmës" në Erbil, Irak.

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendim i Këshillit 2001/264/KE,	Ligji "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 "Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 "Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e "Certifikatës së Sigurisë" personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror" në marrëdhëniet ndërkombëtare"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror" që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendimi 2001/844/KE	Ligji "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 "Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 "Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e "Certifikatës së Sigurisë" personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror" në marrëdhëniet ndërkombëtare"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror" që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2009/81/KE	Ligji "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 "Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 "Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e "Certifikatës së Sigurisë" personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror" në marrëdhëniet ndërkombëtare"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror" që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2019

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017– 2019

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
Vendim 2013/488/EU	n/a	Ligj i "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare"	n/a	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	I pjesshëm	Tremujori i dytë 2017	Tremujori i dytë 2017
Vendim 2013/488/EU	n/a	VKM për sigurimin e informacionit në sistemet e komunikimit	n/a	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	I pjesshëm	Tremujori i dytë 2017	Tremujori i dytë 2017
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.7 Sistemi i vizave

Shih kapitullin 24

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve te buxhetit të shtetit të planifikuara

Chapter 31: "Politikat e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes					
Përfituesi: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Total (3+4+5)**
Ligji mbi "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare"	A) Paga –stafi ekzistues	2,506,992	-	-	2,506,992
	B) Paga –stafi i ri	-	-	-	-
	C) Trajnimi	-	-	-	-
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	-	-	-	-
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	50,000	-	-	50,000
	Aktiviteti total	**2,556,992**	**-**	**-**	**2,556,992**
	Totali i buxhetit për përfituesin	**2,556,992**			
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Total (3+4+5)**
VKM mbi "Siguria e informacionit të klasifikuar në sistemet e komunikimit"	A) Paga –stafi ekzistues	2,156,592	-	-	2,156,592
	B) Paga –stafi i ri	-	-	-	-
	C) Trajnimi	-	-	-	-
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	-	-	-	-
	E) Infrastrukturadhe kostot në vazhdim	50,000	-	-	50,000
	Aktiviteti total	**2,206,592**	**-**	**-**	**2,206,592**
	Totali i buxhetit për përfituesin	**2,206,592**			
	Totali i kapitullit	**4,763,584**			

KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë kapitull lidhet me zbatimin e parimeve ndërkombëtare të rëna dakord për përshtatjen e legjislacionit të BE-së, standardet dhe metodat e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) që duhet të zbatohen për sistemet e kontrollit të brendshëm në të gjithë sektorin publik, duke përfshirë edhe shpenzimet e fondeve të BE-së. Në veçanti, acquis kërkon ekzistencën e një menaxhimi financiar dhe sisteme kontrolli transparente dhe efektive (duke përfshirë kontrollin e përshtatshëm ex-ante, kontrollin financiar në vazhdim dhe ex-post, apo inspektimin); sisteme të brendshme auditimi funksionale dhe të pavarura; struktura organizative përkatëse (duke përfshirë koordinimin në nivel qendror); organizim auditimi të jashtëm operativ dhe funksional për të vlerësuar mbi të gjitha, cilësinë e sistemeve të reja të KBFP. Ky kapitull përfshin gjithashtu *acquis* për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe luftën kundër mashtrimit duke përfshirë fondet e BE- së.

I.2 Situata aktuale e Shqipërisë

Auditimi i jashtëm realizohet nga Institucioni Suprem i Auditimit (KLSH), i quajtur Kontrolli i Lartë i Shtetit. Mandati i KLSH është i sanksionuar në Kushtetutën e vendit, nenet 141-145 dhe në ligjin e ri të KLSH-së Nr.154/2014, datë 27/11/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe Gjykata Austriake e Auditimit do të realizojnë një proces rishikimi mes Institucioneve Supreme të Auditimit "Peer Revieë", *lidhur me Pavarësinë e SAI-ve* për të gjitha organizatat e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit. Nga EUROSAI (Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit) është përzgjedhur KLSH. Aktualisht, është nënshkruar Memorandumi i bashkëpunimit dhe në muajin shkurt 2016, ekipi që do të realizojë këtë proces do të jetë në Shqipëri.Procesi i Peer Revieë ka përfunduar dhe raporti final do të publikohet brenda muajit nëntor 2016. Raporti final është publikuar dhe është vendosur në WEB-in e KLSH-së dhe i është dërguar edhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në Shqipëri ekziston kuadri ligjor i kompletuar për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për rritjen e kapaciteteve për zbatimin e tij. Në këtë fushë prioritetet do të jenë asistenca e institucioneve publike për zbatimin e duhur dhe të përshtatshëm të këtyre koncepteve. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (DH/MFK) udhëheq këtë proces dhe ju ofron trajnime dhe asistencë institucioneve publike. Fushat kryesore të mbështetjes janë fokusuar në implementimin e MFK në institucionet publike dhe vazhdimin

e profesionalizimit të funksionit të AB. Implementimi i KBFP është pjesë e shtyllës së pestë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, miratuar me VKM nr.908, datë 17.12.2014

Kuadri ligjor për implementimin e KBFP-së është përcaktuar në:

- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligjin nr. 114/2015 "Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik" si dhe
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Ky ligj është rishikuar dhe miratuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Baza ligjore e sipërpërmendur, krijon një kuadër të përshtatshëm ligjor për zbatimin e tri shtyllave të KBFP, përkatësisht, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), një funksionim të pavarur të Auditimit te Brendshëm (AB) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit (DPH) për zhvillimin e metodologjive dhe standardeve për MFK dhe AB. Roli kryesor dhe përgjegjësitë për zhvillimin dhe implementimin e KBFP i mbeten Ministrisë së Financave, e cila përmbush këtë rol nëpërmjet veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, e cila përbëhet nga dy drejtori: Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (DH/MFK) dhe Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (DH/AB) dhe Shërbimit të Inspektimit Financiar në marrëveshje me të gjithë institucionet buxhetore.

Fokusi i Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit (DPH) është përcaktimi i udhëzimeve metodologjike për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK) dhe Auditimin e Brendshëm (AB) si edhe sigurimin e trajnimeve në të dyja fushat. DPH ka përmirësuar raportin vjetor të KBFP në sektorin publik, duke përfshirë edhe informacion mbi zbatimin e MFK-së në nivel institucional dhe paraqitur dobësitë kryesore të fushës së menaxhimit financiar dhe kontrollit si edhe masat afatshkurtra dhe afatmesme për t'i korrigjuar ato. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2014-2020, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 17.12.2014, është fokusuar në forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si një nga prioritetet kryesore të saj.

Në vend është përcaktuar një kornizë e mirë ligjore dhe operative si dhe një plan veprimi për zhvillimin dhe zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar zbatohet për të gjitha institucionet publike, përfshirë edhe fondet ekstra-buxhetore dhe shoqëritë tregtare, edhe në pronësi të pjesshme nga shteti. Në mënyrë që të mbulohen disa

prej mangësive të konstatuara nga zbatimi i kërkesave të këtij ligji, është rishikuar dhe miratuar Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2015 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Gjithashtu, DH/MFK organizon në mënyrë të vazhdueshme seminare ndërgjegjësimi në nivel qëndror dhe lokal lidhur me zbatueshmërinë dhe rëndësinë e përdorimit të mjeteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Këto seminare shërbejnë për të rritur ndërgjegjësimin e niveleve të larta për forcimin e kontrollit të brendshëm në institucionet publike dhe janë të bazuarar në standartet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira dhe kanë për qëllim të rrisin efektivitetin dhe efikasitetin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik.

Në muajin Tetor 2015, u miratua Ligji i ri nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", me synim forcimin e parimit të pavarësisë së auditimit të brendshëm, përcaktimin e përgjegjësive të titullarëve të njësive publike, drejtuesve dhe audituesve të brendshëm, vendosjen e kritereve specifike të punësimit të audituesve, si dhe forcimin e proçesit të çertifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik.
Ligji "Për Inspektimin Financiar Publik" është miratuar në Parlament, me nr.Nr.112/2015, datë 15 .10.2015. Qëllimi kryesor i ligjit është mbrojtja e interesave financiarë të njësive publike, kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Banka e Shqipërisë[1] është autoriteti përgjegjës për sekuestrimin dhe ***konfiskimin e kartëmonedhave dhe monedhave false.*** Në përmbushjen e objektivit të mbrojtjes së euros nga falsifikimi, Banka e Shqipërisë ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e euros nga falsifikimi, nëpërmjet miratimit të rregulloreve të posaçme për kontrollin e autenticitet te tyre, si dhe bërjen funksionale të Qendrës Kombëtare të Analizës. Kjo strukturë ka kapacitete teknike administrative të nevojshme dhe është e pajisur me kabinetin *forensic* për ekspertizën e kartëmonedhave. Gjithashtu, janë instaluar pajisjet shtesë për ekspertizën e monedhave, në përputhje me kërkesat e dala nga rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 1338 e datës 28.06.2001 dhe Vendimit të Këshillit 2001/887/JHA mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi.

I.3 Struktura e kapitullit

1. AUDITIMI I JASHTËM (SHTETËROR)
2. AUDITIMI I BRENDSHËM

[1]Në bazë të ligjit për Bankën e Shqipërisë

3. KONTROLLI I BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK (KBFP)
4. INSPEKTIMI FINANCIAR PUBLIK
5. MBROJTJA E EURO-S NGA FALLSIFIKIMI

II. Situata Aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimet për të përafruar legjislacionin shqiptar për Kontrollin financiar me atë të BE-së rrjedhin nga Nenet 70, 85 dhe 90 të MSA.

Legjislacioni i BE-së përfshin dispozita bazë mbi mbledhjen dhe analizën e të dhënave teknike dhe statistikore në lidhje me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara si dhe mbi bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare në vendet e BE-së, Komisionit, Bankës Qendrore Evropiane, vendeve jo anëtare të BE-së dhe organizatave ndërkombëtare.

- Vendimi i Komisionit 2005/909 /KE i datës 14 dhjetor 2005 mbi "Ngritja e një grupi ekspertësh për të këshilluar Komisionin dhe për të lehtësuar bashkëpunimin mes sistemeve të mbikqyrjes publike për audituesit dhe firmave të auditimit";
- Rregullorja Nr. 537/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian të 16 prill 2014 mbi "Kërkesat specifike në lidhje me auditimin e entiteteve me interes publik dhe Vendimin e Komisionit 2005/909 / KE;
- Rregullore 1338/2001/KE mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi në eurozonë dhe rregullorja amenduese 44/2009/KE;
- Rregullore 1339/2001 mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi jashtë eurozonës dhe rregullorja amenduese 45/2009/KE;
- Rregullorja e Këshillit Nr. 45/2009 datë 18 dhjetor 2008 amendon Rregulloren Nr. 1339/201 duke zgjeruar efektet e Rregullores Nr. 1338/2001 që përcakton masat e nevojshme mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi të shteteve anëtar të cilat nuk e kanë adoptuar euron;
- Vendimit të Këshillit 2001/887/JHA mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi;
- Rregullore 1210/2010 e Parlamentit dhe e Këshillit datë 15 dhjetor 2010 mbi autenticitetin e monedhave euro dhe trajtimin e monedhave të papërshtatshme për qarkullim;
- Rregullore 2182/2004 mbi medaljonet dhe xhetonat me pamje të ngjashme me monedhat euro në eurozonë dhe rregullorja amenduese 46/2009;
- Rregullore 2183/2004 për shtrirjen e zbatimit të Rregullores 2182/2004 mbi medaljonet dhe xhetonat me pamje të ngjashme me monedhat euro në eurozonë edhe në Shtetet Anëtare jo-pjesëmarrëse.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi, Shqipëria ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA.

Kuadri ligjor për auditimin e jashtëm:

Aktiviteti i KLSH-së rregullohet nga:

- Nenet 158/5, 162 - 165 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë[1];

Ligji i ri "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në 27 nëntor 2014[2].
Në fushën e **auditimit të jashtëm**, janë bërë ndryshime organizative dhe janë futur procedura të reja për të rritur efikasitetin e KLSH:

- KLSH-ja ka miratuar "Strategjinë e menaxhimit të Riskut", nr.41, datë 30/03/2015.
- Me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, nr.196, datë 31/12/2015, është miratuar "Manuali i Auditimit Financiar" dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë".
- KLSH ka miratuar "Strategjinë e Implementimit të ISSAI-ve[3], 2015-2016", me vendimin nr.58, datë 30/06/2015, me qellim që veprimtaria e tij të jetë në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t;

Kuadri ligjor për auditimin e brendshëm:

- Ligji 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.116, datë 17.02.2016, "Për menyrën e funksionimit dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe percaktimin e tarifave te trajnimit".

[1]Fletorja Zyrtare e Shqipërisë, Nr. 28, fq. 1073, 07/12/1998.
[2]Fletorja Zyrtare e Shqipërisë, Nr.217, fq. 12899, 06/02/2015

[3]Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

- Vendim i Keshillit të Ministrave Nr.160, datë 02.03.2016"Për menyren e funksionimit, kompetencat dhe perberjen e Komitetit te Auditimit te Brendshem ne njesite publike"
- VKM Nr.353, date 11.05.2016 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik";
- Urdhëri i Ministrit të Financave Nr. 3, datë 08.01.2016, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik"
- Urdhëri i Ministrit të Financave Nr.37, datë 16.03.2016, "Për procedurat për çertifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik".
- Urdheri i Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"

Kuadri ligjor për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk ka acquis të detyrueshme. Megjithatë, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në këtë fushë, janë hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian, Bruksel.

Baza ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin përfshin:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Ky ligj është rishikuar dhe miratuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

–

- VKM nr.908, datë 17.12.2014 "Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020";
- Manualin e MFK i miratuar me Urdhër të Ministrit të Fiancave nr. 108, datë 17.11. 2016;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike";
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 21, datë 25.10.2016 "Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve" ;

- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 28, datë 15.12.2011, i Ministrit të Financave "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike";

- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 i Ministrit të Financave, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe gjurmët përkatëse të auditit, i ndryshuar me udhëzimin Nr. 20, datë 17.11.2014 dhe Udhëzimin nr. 11, datë 06.05.2016;

- Udhëzimi i i Ministrit të Financave Nr. 2, datë 06.02.2012 i Ministrit të Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", së bashku me gjurmët standarte të auditit I rishikuar me Udhëzimin Nr. 3 datë 16.01.2015 "Për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin Nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit";
- Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 8, datë 29.03.2012, "Për procedurat standarte për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm" së bashku me gjurmët standarte të auditit;
- Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 68, datë 08.06.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik";

- Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 89 datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Njësive Publike";

- Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 57, datë 12.06.2014, "Për gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë më të vogël se 400 000 lekë pa TVSH dhe të më të lartë se 400 000 lekë pa TVSH".

Kuadri ligjor për Inspektimin Financiar Publik

- Ligji "Për Inspektimin Financiar Publik", Nr.112/2015, datë 15.10.2015.
- Udhëzimi Nr.29, datë 27/11/2015"Për kriteret e fillimin të inspektimit financiar publik.
- Udhëzimi Nr.30, datë 27/11/2015 "Për rregullat dhe proçedurat e kryerjes së Inspektimit Financiar Publik".
- Urdhëri i Ministrit të Financave, nr.26 datë 17.02.2016 "Për miratimin e manualit të inspektorëve financiare publikë".
- Urdhëri i Ministrit të Financave Nr.84, datë 09/12/2015"Për formimin e rrjetit të raportimit të shërbimit AFCOS".
- Urdhëri Nr.32, datë 27/02/2014 "Për kriteret e përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë".
- VKM Nr.492, datë 06/07/2011 "Për shpërblimin e inspektoreve financiare publike.

Bazuar në ligjin e Bankës së Shqipërisë, neni 40 - sipas të cilit Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për sekuestrimin dhe konfiskimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike false - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar dy rregullore gjatë vitit 2013:

Vendimi nr. 41, datë 26.06.2013 për miratimin e rregullores "Për Trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dyshuara si të falsifikuara" dhe

Vendimi nr.49, datë 31.07.2013 për miratimin e rregullores "Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro e të tjera të huaja të dyshuara të falsifikuara".

II.3 Institucionet përgjegjëse kryesore

- Ministria e Financave,
- Kontrolli i Lartë i Shtetit,
- Banka e Shqipërisë.

Grupi Ndër-institucional i Punës për Integrimin Evropian, i krijuar me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 107, datë 28.02.2014, "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndër-institucionale të Punës", për Kapitullin 32 "Kontrolli financiar" kryesohet nga Ministria e Financave. Institucione të tjera kontribuese janë:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit (Institucioni i Auditit Suprem (
- Banka e Shqipërisë.

II.4 Përcaktim i alokimeve financiare

Në 000 lekë

	2017	2018	2019
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider për tre vitet në vijim	**0**	**0**	**0**
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	**776,490.00**	2,520,471	**0**
Buxheti total i Kapitullit	**776,490.00**	2,520,471	**0**

Për tabelat buxhetore të legjislacionit të planifikuar, ju lutem referojuni Aneksit të Tabelave Buxhetore

III. Prioritetet

Në fushën e **auditimit të jashtëm**, janë bërë ndryshime organizative dhe janë futur procedura të reja për të rritur efikasitetin e KLSH:

- Në muajin Mars të vitit 2015, me vendimin Nr.42, datë 31/03/2015, është rishikuar strategjia e zhvillimit të institucionit për periudhën 2015-2017 dhe është përditësuar plani i veprimit për periudhën e mbetur deri në 2017.
- Nuk ka ndjekje sistematike të rekomandimeve të KLSH-së nga Parlamenti.

  Lidhur me këtë pikë, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në datën 20/10/2016 rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015, dërguar në KLSH me shkresën me nr. 197/4 prot, datë 25/10/2016, në të cilën është cilësuar shprehimisht sa më poshtë:

Kuvendi i Shqipërisë

Në funksion të detyrimeve të tij kushtetuese por dhe në zbatim të rekomandimeve të Progres raportit 2015 për ngritjen e një mekanizmi më efikas nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, shpreh angazhimin e tij maksimal në këtë drejtim, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së sa më poshtë:

Të bashkëpunojë me KLSH-në dhe Qeverinë që të rritet shkalla e ndërveprimit gjithëpërfshirës me të gjitha institucionet e administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;

–

Për rekomandimet në aspektin e përmirësimit të legjislacionit, sugjerohet që, Kuvendi dhe KLSH-ja të organizojnë, të paktën 2 herë në vit, seanca dëgjimore me institucionet përkatëse dhe grupet e interesit, me qëllim vlerësimin e situatës ligjore dhe finalizimin e nismave ligjvënëse;
Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në ushtrim të kontrollit parlamentar, duhet të angazhohet që të realizojë auditimin e llogarive financiare të KLSH-së dhe t'i bëjë ato publike;

Të shikojë mundësinë e krijimit të Nënkomisionit parlamentar brenda Konisionit për Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe zbatimin e rekomandimeve.
Të gjitha këto masa do të ndikojnë në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Prioritetet afat-mesme të KLSH-së, të përfshira në Planin Strategjik 2013-2017, të rishikuar për periudhën e mbetur 2015-2017 janë:

- Thellimi dhe konsolidimi i auditimit financiar;
- Zhvillimi dhe rritja e numrit të auditimeve të performancës; Zhvillimi i auditimit të IT; Përmirësimi i qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Auditimit të brendshëm

Në përputhje me rekomandimet e Raport Progresin e Komisionit Evropian të vitit 2015 dhe 2016 në fushën e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, prioritetet kryesore janë:

- Zhvillimi i procesit të vlerësimit të riskut dhe menaxhimi i tij në drejtim të minimizimit të risqeve që pengojnë arritjen e objektivave të njësive publike;

- Rritja e kapaciteteve profesionale të DH dhe njësive të tjera publike në drejtim të ngritjes së sistemeve të shëndosha të kontrollit të brendshëm;
- Rishikimi i manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit per t'i ardhur në ndihmë si niveleve drejtuese ashtu edhe të gjithë menaxherëve të njësive publike;
- Monitorimi në vend i njësive publike lidhur me zbatueshmërinë e mjeteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe realizimi i një vlerësimi kryesisht duke u fokusuar në institucionet që kryejnë shpenzime të mëdha;
- Ndjekja me efikasitet në vlerësimin vjetor të KBFP-së duke adresuar dobësitë sistematike kryesisht në fushën e delegimit të detyrave dhe raportimit të performancës;
- Koordinimi dhe menaxhimi i politikës së trajnimeve të auditueve të brendshëm si edhe monitorimi e vlerësimi i njësive të auditit të brendshëm në institucionet publike, do të jenë në fokus të CHU/IA. krahas forcimit të kapaciteteve te CHU/IA dhe AB.

Për Inspektimin Financiar Publik

Në përputhje me raport progresin e vitit 2015, në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së, prioritetet janë si më poshtë:

- Shtimi i numrit të punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik nëpërmjet shtimit të numrit të punonjësve të kësaj njësie me specialistë për inspektim financiar publik dhe specialiste për mbulimin e shërbimit AFCOS.[1],
- Hartimi i një strategjie kombëtare antikorrupsion, në mbrojtje të interesave të Bashkimit Evropian, [2]
- Mbrojtja e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian. [3]dhe shtimi i përdoruesve në sistemin AFIS portal, me punonjës parregullsish të strukturave menaxhuese të fondeve IPA. [3]
- Rritje e kapaciteteve administrative si edhe trajnimi i punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik[4]. Rritje e kapaciteteve inspektuese profesionale, për të garantuar rritje cilësore të shërbimit të inspektimit financiar publik[5].

Mbrojtja e euro-s ndaj falsifikimit

Në lidhje me **mbrojtjen e euro-s ndaj falsifikimit**, Banka e Shqipërisë ka zbatuar rregulloren mbi sigurimin e autencitetit të kartëmonedhave dhe ka krijuar një laborator *forensic* që do të ekzaminojë të gjitha kartëmonedhat e falsifikuara, duke përfshirë kartëmonedhat euro.

Në përputhje me Raport Progresin e Komisionit Evropian 2016 në fushën e mbrojtjes së Euro-s nga falsifikimi prioritetet janë:

- Ratifikimi i Konventës Ndërkombëtare (Konventa e Gjenevës e vitit 1929) për Ndalimin e Falsifikimit të Parave ;

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane ;

- Përafrim i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së parasë nga falsifikimi ;
- Përafrimi i kuadrit legjislativ të BE-së që rregullon medaljonet dhe xhetonat me pamje të ngjashme me monedhat euro.

Në përputhje me rekomandimet e Bankës Qëndrore Evropiane prioritetet janë :

- Rishikimi i ligjit për Bankën e Shqipërisë me qëllim reflektimin e dispozitave të cilat rregullojnë përgjegjësinë e Bankës së Shqipërisë si autoriteti i vetëm për ekspertizën analitike dhe sasiore mbi vërtetësinë e kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara si të fallsifikuara;

Në përputhje me Strategjinë Afatmesme te Bankës së Shqipërisë prioritetet janë :

- Përmirësimi i cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim nëpërmjet rritjes së efektivitetit dhe kapacitetit në veprimtarinë përpunuese ;

- Mbrojtja ndaj falsifikimit përmes rritjes së aftësisë në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së monedhave nga falsifikimi.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2019

IV.1 Auditimi i jashtëm

Kuadri i Politikave ekzistuese

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia e zhvillimit të KLSH 2013-2017 dhe Plani i veprimit 2013-2017	KLSH	2013-2017
Rishikimi i Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2015-2017	KLSH	2015-2017
Strategjia e menaxhimit të Riskut	KLSH	2015-2018
Strategjia e implementimit të ISSAI-ve, 2015-2016	KLSH	2015-2016

Inventari i Masave Ligjore ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm /mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni shqiptar)
Neni 287 i Traktatit për Funksionimin e BE	Neni 158/5, 162 - 165 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë	KLSH	Përputhshmëri e pjesshme me Standardet e INTOSAI	21.10. 1998	Tetor 1998
Neni 287 i Traktatit për Funksionimin e BE	Ligji nr. 8270, dt. 23.12.1997 "Ligji për Kontrollin e Lartë të Shtetit";	KLSH	Përputhshmëri e pjesshme me Standardet e INTOSAI	23.12. 1997	15.01.1998
Neni 287 i Traktatit për Funksionimin e BE	Amenduar me Ligjin nr. 8599, dt. 01.06.2000.	KLSH	Përputhshmëri e pjesshme me Standardet e INTOSAI	01.06.2000	Qershor 2000
Neni 287 i Traktatit për Funksionimin e BE	Ligji Nr,154/2014, datë 27/11/2014 "Per organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të shtetit".	KLSH	Përputhshmëri e plotë me Standardet e INTOSAI	27/11/2014	06/02/2015

Kuadri i Politikave i planifikuar 2017 – 2020

Titulli (Strategjia ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e përshtatjes**	**Hyrja në fuqi**
Strategjia e Komunikimit e KLSH[1]	KLSH	2016-2018	T2 2017	T2 2017

[1]Ne rekomandimet e Progres Raportit 2015 nuk ka rekomandime te drejtpërdrejta qe lidhen me Strategjine e komunikimit te KLSH-se, por ne mënyrë te tërthortë mund te lidhet me pjesën ku thuhet "Raportet e auditimit përmblidhen çdo katër muaj dhe botohen në faqen në internet të KLSH. Ministria e Financave zhvilloi një plan veprimi për ndjekjen e gjetjeve të SAI-t, por një ndjekje sistematike ka nevojë të fuqizohet akoma. Raporti vjetor për auditimet që KLSH çon në Parlament, diskutohet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, por sërisht nuk ka ndjekje sistematike parlamentare" (4.32.Kapitulli 32, faqe 73).

Masat Ligjore të planifikuara 2017 – 2019

Acquis e BE	Statusi i përkthimit ne shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhshmëri e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja ne fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2018 – 2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	

IV.2 Auditimi i brendshëm

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, miratuar me VKM nr.908, datë 17.12.2014.	Ministria e Financave	2014-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2019

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuarapër periudhën 2017-2019

Acquis e BE	Statusi i përkthimit ne shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhshmëri e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja ne fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT-MESËM (2018 – 2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike miratuar me VKM nr.908, datë 17.12.2014.	Ministria e Financave	2014-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EUacquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2019

Titulli (Strategji, PV, AP, dokumentpolitikash)	Institucionikryesor	Periudha reference	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuarapër periudhën 2017 – 2019

EU *Acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2018 – 2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.4 Inspektimi financiar publik

Plani i veprimeve për periudhën 2017 – 2019

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
5. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike miratuar me VKM nr.908, datë 17.12.2014.	Ministria e Financave	2014-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2019

Titulli politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuarapër periudhën 2017 – 2019

EU *acquis*	Statusi i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2018 – 2019)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.5 Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Plani i veprimit 2016– 2018

Kuadri i Politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2016-2018.	Banka e Shqipërisë	2016 - 2018

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/pjesshëm/mospërputhje	Data e përshtatjes (Legjislacioni	Hyrja në fuqi (Legjislacioni

				shqiptar)	shqiptar)
Rregullore 1338/2001/KE mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi në eurozonë dhe rregullorja amenduese 44/2009/EC.	Vendimi nr. 49, datë 31.07.2013 për miratimin e rregullores "Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro e të tjera të huaja të dyshuara të falsifikuara.	Banka e Shqipërisë	I pjesshëm	31.07.2013	12.09.2013
Rregullore e BE-së Nr 1210/2010 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 15 dhjetor 2010 mbi autenticitetin dhe dorëzimin e monedhave Euro të papërshtatshme për qarkullim.	Vendimi i Keshillit Mbikëqyres nr. 81, datë 06.07.2016 për miratimin e rregullores "Për kontrollin e autenticitetit dhe kriteret e riciklimit te monedhave metalike shqiptare".	Banka e Shqipërisë	I pjesshëm	06.07.2016	03.08.2016

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2017 – 2019

Titulli (Strategji, PV, AP, dokumentpolitikash)	Institucionikryesor	Periudhareferencë	Data e miratimit	Hyrjanëfuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2017 – 2019

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit (email)	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2018-2019)							
Vendimi i BQE i datës 20 Mars 2003 mbi emërtimin, specifikimin, riprodhimin, këmbimin dhe tërheqjen e kartëmonedhave euro 2003/205/EC; Rregullore 2182/2004 mbi medaljonet dhe xhetonat me pamje të ngjashme me monedhat euro në eurozonë dhe rregullorja amenduese 46/2009.	Jo	[1]Rishikimi i ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.	Jo	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	T2 2018	T3 2018

[1] Përcaktimi i rishikimit të ligjit për Bankën e Shqipërisë si masë afatmesme pritet që të zyrtarizohet përmes miratimit nga ana e administratorit të Bankës së Shqipërisë.

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve të planifikuara të Buxhetit të Shtetit

Kapitulli 32 : Kontrolli Financiar					
Përfituesi: Banka e Shqipërisë					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2017**	**2018**	**2019**	**Totali(3+4+5)**
[1]Rishikimi i ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar	A) Paga –stafi ekzistues		2,520,471		2,520,471
	B) Paga –stafi i ri		0		
	C) Trajnimi		0		
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme		0		
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		0		
	Aktiviteti total		2,520,471		
	A) Paga –stafiekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi	0			0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0			0
	Aktiviteti total				
"[2]	A) Paga –stafi ekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi	0			**0**
	D) Shërbimembështetësetë ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0			**0**
	Aktiviteti total				

[1] Ky aktivitet nuk do të financohet nga buxheti i shtetit por nga buxheti i Bankës së Shqipërisë

[2]

	A) Paga –stafiekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
Buxheti total i përfituesit		2,520,471			
Përfituesi : Kontrolli i Lartë i Shtetit					
	2	**3**	**4**	**5**	**6**
	Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Hartimi i Strategjisë së Komunikimit të KLSH-së	A) Paga –stafiekzistues		591,540.00		
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi		184,950.00[1]		
	D) Shërbimembështetësetë ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total				
	A) Paga –stafiekzistues				
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total		**776,490.00**		
TOTALI			**3,296,961**		

[1] Training cost includes cost of Activity 1.2.2 9 (Seminar of HSC ëith Parliament) of IPA Project , amount 1350 EURO. Exchange rate refers to the date 23.09.2016 issued by Bank of Albania (1 Euro=137 ALL)

Tabela B – Fondet e planifikuara nga asistenca e huaj

Kapitulli : 32				
1	**2**	**3**	**4**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/donatorë**	**Vlera në €**	**Aktivitetet**
KLSH– Kontrolli i Lartë i Shtetit	"Forcimi i kapaciteteve te auditimit të jashtëm"	IPA 2013	20,725.00	**Komponenti 1: Përmirësimi i kornizës ligjore të KLSH-së .** *Aktiviteti 1.2.2:* Seminar për bashkëpunimin mes KLSH-së dhe Parlamentit
KLSH– Kontrolli i Lartë i Shtetit	"Forcimi i kapaciteteve te auditimit të jashtëm"	IPA 2013	15,380.00	**Komponenti 3: Forcimi i kapaciteteve institucionale të KLSH-së dhe përmirësimi i impaktit të raporteve të auditimt.** Aktiviteti 3.2.7 : Komunikimi i jashtëm. Media tradicionale vs.media moderne. Rishikimi i rolit të shtypit/medias
		Totali për kapitullin:	**36,105.00**	

KAPITULLI 33: DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull përfshin rregulloret në lidhje me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së ('burimet vetjake'). Këto burime përbëhen nga të ashtuquajturat burimet tradicionale vetjake nga detyrimet doganore dhe taksat për sheqerin; një burim i bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar; dhe më në fund, një burim bazuar në të ardhurat bruto kombëtare (GNI) të çdo shteti.

Për më shumë informacion lutemi referohuni kapitullit 16 "Tatimet" dhe 29 "Bashkimi doganor".

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka një sistem kombëtar të TVSH-së. Zbatohen tarifat doganore për importet ndërsa për llogaritjen e PBB-së përdoret metodologjia ESA 95. INSTAT ka krijuar një version zyrtar për të ardhurat e brendshme bruto.

Në bazë të nenit 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë "Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera financiare, kombëtare dhe lokale, reduktimi i tarifave doganore dhe dhënia e përjashtimeve për disa kategori të caktuara taksapaguesish, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre", përcaktohen me ligj. Në raste të tilla, ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese". Ky përkufizim përfshin edhe detyrimet e importit (detyrimet doganore dhe taksa të tjera që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore që duhen paguar në importimin e mallrave).

Shqipëria ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis*. Në kuadër të përafrimit të legjislacionit për TVSH-në me direktivën 2006/112/KE janë bërë ndryshime në udhëzimin Nr. 6, datë 30.01 2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në R. Sh, i cili është miratuar në zbatim të ligjit të ri të TVSH-së Nr. 92/2014, datë 24.07.2014" si dhe akte të tjera nënligjore.

Për informacione të mëtejshme për TVSH, lutemi referohuni Kapitullit 16.

Procedurat e mbledhjes, të kontabilitetit dhe të kontrollit për detyrimet doganore, taksat e importit dhe akcizën kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD). Administrata Doganore Shqiptare përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga Degët Doganore.

Ajo varet nga Ministria e Financave dhe është nën mbikëqyrjen e saj. Në fushë e doganave janë bërë përparime në përafrimin e legjislacionit me aktet e BE-së. Administrata Doganore aplikon pjesërisht ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i cili ka përafruar pjesërisht Rregulloren Nr. 952/2013 "Kodi Doganor i Bashkimit" dhe disa akte të tjera të BE-së. Gjithashtu, aplikohet ligji nr. 8449, datë 19.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Legjislacioni i ri mbi akcizat është i përafruar pjesërisht me aktet e BE-së, dhe administrohet nga DPD. Lidhur me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, në përputhje me MSA-në është përditësuar NK e Mallrave 2016, sipas CN 2016 të BE-së.

Për informacione të mëtejshme për doganën, lutemi referohuni Kapitullit 29.

Në fushën e ***programimit buxhetor***, qeveria shqiptare synon të përmirësojë procesin e programimit afatmesëm dhe harmonizimin e plotë të tij me dokumentet strategjikë, nën konceptet bazë të Sistemit të Planifikimit të Integruar. Kjo reformë synon shpërndarjen strategjike të burimeve në përputhje me objektivat dhe politikat e qeverisë, përmirësimin e lidhjes së objektivave afatmesme me ato të buxhetit vjetor si dhe buxhetimin në bazë programesh dhe performance. Veprimtaria e buxhetimit në Shqipëri rregullohet nëpërmjet Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar me ligjin 57/2016, datë 02.06.2016, i cili ka si objekt kryesor përcaktimin e procedurave për buxhetimin si dhe evidentimin e rolit të institucioneve në kuadër të procesit të buxhetimit. Ligji organik i buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin 57/2016, datë 02.06.2016, është hartuar në përputhje me praktikat me te mira lidhur me menaxhimin e sistemeve buxhetore. Në zbatim të ketij ligji, duke filluar prej vitit 2010 procesi i planifikimit të buxhetit afatmesëm (PBA) është zbatuar në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre. Objektivi kryesor i ligjit të mësipërm është përmirësimi i procedurave të buxhetimit nëpërmjet forcimit të lidhjes mes politikave dhe buxhetit si dhe rritjen e efiçencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të BE-së

Neni 70 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit të brendshëm të Shqipërisë me *acquis* të BE-së, që përfshin edhe këtë kapitull.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Aktet ligjore kryesore relevante për këtë kapitull përfshijnë:

- Ligji nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore".
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 9981, datë 8.9.2008, "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore";
- Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 " Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji nr. 90/2015, datë 23.07.2015 "Për një ndryshim në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM nr. 205, datë 13.4.1999, "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar;
- VKM 612/2012, datë 09.05.2012 "Mbi Dispozitat Zbatuese të Ligjit "Mbi Akcizat", i ndryshuar.
- VKM nr. 920, datë 29.12.2014 "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për vitin 2015";
- VKM nr. 919, datë 29.12.2014 "Mbi dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"";
- Udhëzimi nr. 2, datë 6.2.2012, "Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit"
- Udhëzimi nr. 8, datë 29.3.2012, "Për procedurat standard për përgatitjen e PBA-së".

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucioni Kryesor për këtë kapitull është Ministria e Financave. Strukturat kontribuuese janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Fiskale dhe Të Ardhurave Publike;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

IV. Plani

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Shkalla e përafrimit (e plotë/e pjesshme/ mospërputhje)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni shqiptar)
Rregullorja 2913/92/KEE	Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",	MF	E pjesshme	27.01.1999	06.03.1999
Rregullore e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 952/2013, datë 09 tetor 2013 "Union Customs Code"	Ligji Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	E pjesshme	31.07.2014	disa nene kanë hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në FZ, disa më 1 janar 2015 e disa me 1 qershor 2017.
Rregullore e Këshillit (KE) nr. 1186/2009, datë 16, nëntor 2009, mbi përjashtimet nga detyrimet doganore	Ligji Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	E pjesshme	31.07.2014	nenet për përjashtimet kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2015.
Direktiva e Këshillit 2007/74/KE datë 20 Dhjetor 2007.	Ligji Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	E pjesshme	31.07.2014	nenet për përjashtimet kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2015.
Rregullore e BE No.1101/2014, datë 16.10.2014, që amendon shtojcën I të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2658/87	VKM Nr. 920, datë 29.12.2014 "Mbi miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2015"	MF	E plotë	29.12.2014	01.01.2015
Direktiva e BE-se nr. 2008/118 ne lidhje me akcizën	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Per akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar	MF	E pjesshme	24.05.2012	01.10.2012
Rregullorja 2658/87/KEE	Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005 "Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore", i ndryshuar	DPD	E plotë	21.12.2005	01.01.2006

Rregullorja (KEE) 2454/93	VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor“, i ndryshuar	DPD	E pjesshme	13.04.1999	28.04.1999 (Fletore Zyrtare Nr. Ekstra 2004),
Rregullorja 1383/2003/KE	VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor“, i ndryshuar	DPD	E pjesshme	1.05.2008	1.5.2008
Rregullore nr.2454/93/	VKM nr. 919, date 29.12.2014 “Mbi dispozitat zbatuese te ligjit nr.102/2014“Kodi Doganor i RSH”.	MF	E pjesshme	29.12.2014	1.01.2015
Regulation (EC) No 1186/2009,	VKM nr. 919, date 29.12.2014 “Mbi dispozitat zbatuese te ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i RSH”.	MF	E pjesshme	29.12.2014	1.01.2015
Directive 2007/74/EC	VKM nr. 919, date 29.12.2014 “Mbi dispozitat zbatuese te ligjit nr.102/2014“Kodi Doganor i RSH”.	MF	E pjesshme	29.12.2014	1.01.2015
Direktiva 2006/112/KE	Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në”	Ministria e Financave	I pjesshëm	24.07.2014	01.01.2015

Masat ligjore të planifikuara*

Acquis e BE-së	Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni përgjegjës dhe Pika e kontaktit	Shkalla e synuar e përafrimit	Data e planifikuar për miratimin	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2017) **N/a**							
AFAT MESËM (2018 – 2020) **N/a**							

* Ndryshimet në legjislacionin tatimor dhe doganor janë planifikuar përkatësisht në Kapitujt 16 dhe 29.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 7112 lekë